

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

Eruditi, juristi dhe komentuesi

NASER MEKARIM SHIRAZI

KOMENTIM I PËRSOSUR I KUR'ANIT

(Xhuzi i dhjetë)

Nga ajeti 41 i sures "Enfal" deri tek ajeti 92 i sures "Teube"

TIRANË, 2016

Titulli: **KOMENTIM I PËRSOSUR I KUR'ANIT**

(Xhuzi i dhjetë)

Autori: *Eruditi, juristi dhe komentuesi*

Naser Mekarim SHIRAZI

Recensent: **Vullnet MERJA**

E përktheu nga persishtja: **Valbona HORZOVA**

E redaktoi: **Klodiana SMAJLAJ & Jerida KULLA**

Korrektura teknike: **Ledio DEMOLLI**

Korrektura letrare: **Vjollca KARAJ**

Përkujdesja grafike: **Sabrie FEZA**

Kapaku: **Sabrie FEZA**

Botoi: **Shoqata "FLLADI"**

Copyright: **Shoqata "FLLADI"**

Shtypshkronja e shtëpisë botuese **LILLO**

Ajeti 41

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

﴿وَأَعْلَمُوا أَنَّمَا غَنِمْتُمْ مِنْ شَيْءٍ فَإِنَّ لِلَّهِ خُمُسَهُ وَلِلرَّسُولِ وَلِذِي الْقُرْبَىٰ
وَالْيَتَامَىٰ وَالْمَسْكِينِ وَأَبْنِ السَّبِيلِ إِن كُنْتُمْ ءَامَنْتُمْ بِاللَّهِ وَمَا أَنْزَلْنَا
عَلَىٰ عَبْدِنَا يَوْمَ الْفُرْقَانِ يَوْمَ التَّقَىٰ أَجْمَعِينَ ۗ وَاللَّهُ عَلَىٰ كُلِّ شَيْءٍ

قَدِيرٌ ﴿٤١﴾

"Ta dini se çfarëdo që të fitoni si plaçkë lufte, një e pesta i takon All'Ilahut, të Dërguarit dhe të afërmëve të tij, jetimëve, të varfërve dhe udhëtarit (që ka ngelur në rrugë), nëse besoni në All'Ilahun dhe në atë që ia kemi shpallur robit Tonë në ditën e fitores (luftën e Bedrit), ditën kur u ndeshën dy ushtritë. Vërtet, All'Ilahu është i Fuqishëm për çdo gjë."

Komentimi

Një e pesta (khums-i), obligim i rëndësishëm Islam

Në fillim të kësaj sureje mësuam se si disa myslimanë polemizuan për ndarjen e plaçkës së luftës pas betejës së Bedrit.

All'lahu i Lartësuar urdhëroi ndaljen e polemikave, duke e vënë plackën e luftës në dispozicion të Profetit (*Paqja dhe bekimet e All'lahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), që ta shpërndante atë si ta shihte të arsyeshme. I Dërguari e shpërndau atë me barazi ndërmjet luftëtarëve myslimanë.

Në këtë ajet flitet përsëri për çështjen e plackës së luftës, për shkak të përshtatjes me ajetet e mëparshme, të cilat flisnin për luftën dhe për tematikat e saj të ndryshme. Meqenëse, në të shumtën e rasteve, lufta është e lidhur me çështjen e plackës së luftës, atëherë është e përshtatshme që të përmenden rregullat e plackës së luftës. Po ashtu, do të vërejmë se Kur'ani e trajton këtë çështje përtej kufijve të saj.

All'lahu i Lartësuar thotë: **“Ta dini se çfarëdo që të fitoni si plackë lufte, një e pesta i takon All'lahut, të Dërguarit dhe afërmëve të tij...”** që janë imamët prej Ehli *Bejtit* (*Paqja qoftë mbi ta!*), **“...jetimëve, të varfërve dhe udhëtarit** (që ka ngelur në rrugë)...”.

Më pas, ajeti thekson: **“...nëse besoni në All'lahun dhe në atë që ia kemi shpallur robit Tonë në ditën e fitores** (luftën e Bedrit), **ditën kur u ndeshën dy ushtritë...”**.

Edhe pse thënia e ajetit i drejtohet besimtarëve dhe ai flet për plackën e luftës islame dhe padyshim që luftëtarët janë besimtarë, mirëpo ajeti thotë: **“...nëse besoni në All'lahun...”**. Kjo tregon se vetëm pretendimi se jam besimtar nuk konsiderohet si argument për besimin, madje edhe pjesëmarrja në fushën e luftës nuk mund të jetë argument i besimit. Pas kësaj mund të ketë çështje të tjera, kështu që besimtar i plotësuar është ai që i nënshtrohet të gjitha urdhrave të All'lahut dhe i zbaton ato, sidomos ndaj urdhrave dhe dispozitave financiare, duke mos bërë

dallim në zbatimin e tyre.

Në fundin e tij, ajeti tregon për fuqinë e pafundme të All'Ilahut dhe thotë: “...**Vërtet, All'Ilahu është i Fuqishëm për çdo gjë.**”

Pra, edhe pse numri juaj ishte i vogël në ditën e Bedrit dhe armiku ishte i shumtë në dukje, dijeni se All'Ilahu i Plotfuqishëm i poshtëroi ata dhe ju ndihmoi juve, duke ju bërë fitimtarë.

Hulumtime

1 - Dita e ndarjes mes të vërtetës dhe të kotës (Dita e Furkanit)

Dita e luftës së Bedrit është quajtur dita e ndarjes mes të vërtetës dhe të kotës si dhe e përballjes mes grupit të mohuesve dhe grupit të besimit, për shkak të treguesve të mëposhtëm:

Së pari: Në ditën e Bedrit u shfaqën argumentet për vërtetësinë e Profetit (*Paqja dhe bekimet e All'Ilahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), sepse ai u premtoi myslimanëve fitoren para se ajo të ndodhte, edhe pse në dukje argumentet nuk tregonin atë gjë.

Shkaqet e fitores u bashkuan në një formë të papritur, nga ku erdhi fitorja. Këtë fitore nuk mund t'ia adresojmë rastësisë dhe marrëveshjes. Duke u bazuar në këto, vërtetësia e ajeteve që i zbritën Profetit, atë ditë, ndodhej po në brendinë e atyre ajeteve.

Së dyti: Lufta e Bedrit: “**ditën kur u ndeshën dy ushtritë**”, në të vërtetë ishte një prej mirësive të mëdha të All'Ilahut për myslimanët, sepse disa prej tyre ishin të frikësuar në fillim. Por ajo përballje dhe fitore i shtyu ata me hapa të mëdhenj përpara.

Jehona dhe fama e tyre u përhap në të gjitha anët e Gadishullit Arabik. Kjo fitore i ftoi të gjithë që të mendojnë sa më shumë rreth kësaj feje të re dhe aftësive e mundësive të saj të mahnitshme. Ajo ditë ishte një ditë e vështirë për ummetin islam i cili ishte i paktë në numër në atë kohë. Në atë ditë u dalluan besimtarët e sinqertë nga pretenduesit gënjeshtarë. Ajo ditë ishte me të gjitha aspektet e saj, dita e dallimit mes të vërtetës dhe të kotës (të pavërtetës).

2 - Nuk ka antagonizëm (kundërshti) mes dy ajeteve

Në fillim të sures kemi përmendur se nuk ka antagonizëm mes ajetit të plaçkës së luftës (Enfal-it) dhe ajetit në fjalë. Njëri prej këtyre dy ajeteve nuk duhet të konsiderohet si abrogues për tjetrin, sepse sipas ajetit të "Enfal-it", plaçka e luftës i takon Profetit (*Paqja dhe bekimi i All'Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), por ai i dhuroi katër të pestat për luftëtarët myslimanë dhe ruajti një të pestën e mbetur për kategorinë e veçantë që përmend ajeti. Për më shumë qartësim, shih studimin tonë në komentimin e ajetit të parë të kësaj sureje.

3 - Kujt i referohet fraza "Dhil kurba" (të afërmit)?

Kjo shprehje në këtë ajet nuk ka për qëllim të gjithë të afërmit (farefisin) dhe as të gjithë të afërmit e Profetit (*Paqja dhe bekimi i All'Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), por ka për qëllim (prijësit) Imamët e Ehli Bejtit (familjes së shtëpisë) së Profetit. Argument për këtë çështje janë transmetimet e shpeshta (*mutevatire*), të cilat na kanë ardhur nga Profeti nëpërmjet rrugëve

të transmetimit të Ehli Bejtit (familjes së shtëpisë së tij).¹

Argumente të tjera mbi këtë çështje gjenden edhe në librat e Ehli Synetit.

Bazuar në ato, ai që vëren se një pjesë prej një të pestës (Khums-it), lidhet me të gjithë të afërmit e Profetit (*Paqja dhe bekimi i All'lahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), do të përballet me këtë pyetje: Ç'është ky privilegj që dha Islami për të afërmit e Profetit dhe fisit të tij, kur dihet se kjo fe është larg prej favorizimeve fisnore, nacionaliste dhe etnike?

Por nëse e specifikojmë “Dhil Kurba” (të afërmit) me Imamët, prijësit prej Ehli Bejtit, të afërmit e shtëpisë profetike, duke theksuar se ata janë pasardhësit e Profetit dhe udhëheqësit e ymetit Islam, atëherë qartësohet shkaku i dhënies së kësaj pjese të “Khums-it” (një të pestës).

Me fjalë të tjera, tre pjesët e tjera: pjesa e All'lahut, e Profetit dhe e të afërmit, të gjitha i kthehen udhëheqësit të qeverisë myslimane, prej tyre shpenzon për çështjet e jetës së tij të thejshme e normale dhe ato që ngelin prej tyre i shpenzon për nevojat e njerëzve dhe shoqërisë.

Meqenëse disa prej komentuesve të Ehli Synetit (për shembull, autori i librit “El Menar”) mendojnë se “Dhil Kurba” (të afërmit) janë të gjithë të afërmit, ata janë çoroditur në përgjigjen rreth pyetjes së sipërpërmendur. Autori i këtij komentimi arriti ta ngjasojë Profetin (*Paqja dhe bekimi i All'lahut qoftë mbi të dhe mbi mbi familjen e tij!*) me mbretërit dhe sulltanët, që të tërheqë popullin dhe fisin e tij me pasuritë që zotëronte!

Është e qartë pavlefshmëria e kësaj logjike, e cila bie në kundërshtim edhe me logjikën e qeverisë botërore humane, që

¹ “Uesailu Shia”, vëll. 6, kapitulli i pestë: “Usul El Kafij”, vëll.1, f. 294, 414.

nuk njih privilage fisnore. (Kjo çështje do të sqarohet më shumë në studimet e ardhshme).

4 - Kujt i referohet fraza e ajetit “...jetimëve, të varfërve dhe udhëtarit (që ka ngelur në rrugë)...”

Kjo frazë e përmendur në ajet u referohet tre grupeve prej fisit Beni Hashim, edhe pse në pamje të jashtme, ajeti është i përgjithshëm dhe jopërcaktues. Argumenti ynë për përcaktimin janë transmetimet e shumta që kanë ardhur nëpërmjet Ehli Bejtit të Profetit¹. Ne dimë se shumë prej dispozitave të përgjithshme në tekstet kur'anore i ka përcaktuar (kufizuar) syneti i Profetit, i cili ka vendosur kushte për to. Kjo çështje nuk është e kufizuar vetëm me ajetin në fjalë dhe nuk duhet të habitemi për këtë.

Përveç kësaj, edhe Zekati (dhënia dhe pranimi prej tyre) është i ndaluar për nevojtarët e fisit Beni Hashim, kështu që për ta duhet të sigurohet një burim tjetër. Kjo tregon se ajeti ka të bëjë me të varfërit e fisit Beni Hashim në veçanti.

Kështu, në një hadith nga Imam Sadiku (*Paqja qofshin mbi të!*) lexojmë: “Kur All'Ilahu i Lartësuar na e ndaloi sadakanë, Ai zbriti për ne një të pestën (*Khums-in*). Prandaj sadakaja është e ndaluar për ne, ndërsa një e pesta (*Khumsi*) është e lejuar.”²

¹ “Uesailu Shia”, vëll. 9, f. 509, 510.

² “Uesailu Shia” vëll. 6, kapitulli i pestë; Tefsiri “Mekhmaul Bejjan”, rreth ajetit në fjalë.

5 - A janë të kufizuara plaçkat vetëm në plaçkën e luftës?

Një temë tjetër e rëndësishme në këtë ajet, që është edhe baza e tij është se: Fjala "*el ganijmeh*" që përmendet në ajet, a përdoret vetëm për plaçkat e luftës, apo ka një kuptim më të gjerë dhe përfshin çdo shtesë në pasuri?

Në pamje të parë, ajeti tregon vetëm një të pestën (khumsin) e plaçkës së luftës. Kurse "khumsi", një e pesta, në vende të tjera duhet që njohja e tij të bazohet te syneti i Profetit dhe te transmetimet e vërteta. Nuk është problem që Kur'ani të trajtojë një pjesë të dispozitave të "khumsit", një të pestës, së bashku me ato dispozita që janë në përputhje me dispozitat e xhihadit dhe syneti profetik të trajtojë pjesët e tjera të "khumsit".

Për shembull, pesë kohët e faljeve në Kur'an kanë ardhur të qarta, ashtu siç edhe u tregua për namazin e Tavafit, që është gjithashtu prej faljeve të domosdoshme (vaxhibe). Në Kur'an nuk ka ardhur asnjë tregues për faljen e namazeve të dukurive të frikshme (salatul ajet), për të cilin janë të një mendimi si synitët ashtu edhe shi'itët për domsdoshmërinë e faljes së këtij namazi.

Asnjë nuk thotë se ky namaz nuk duhet falur sepse nuk është përmendur në Kur'an. Gjithashtu, askush nuk thotë se Kur'ani ka treguar për disa lloje larjesh (gusl) dhe të tjerat që nuk i përmend Kur'ani nuk duhen vepruar! Këtë logjikë nuk e pranon asnjë mysliman.

Bazuar në këtë, nuk ka ndonjë pengesë që Kur'ani të tregojë vetëm një pjesë prej pjesëve të "khumsit" dhe qartësimin e pjesëve të tjera t'ia lërë synetit të Profetit. Në Jurisprudencën islame ka shumë çështje të ngjashme me këtë çështje.

Që çështja të qartësohet më shumë, duhet të shohim

kuptimin e fjalës "el ganimetu" në gjuhësi e në mesin e njerëzve. Vallë, kuptimi i kësaj fjale është i kufizuar vetëm me plaçkën e luftës, apo përfshin çdo lloj fitimi dhe shtese në pasuri?

Ajo çka mësohet nga librat gjuhësorë është se rrënja e kësaj fjale nuk tregon për atë që merret prej armikut në luftë, por përfshin çdo lloj shtese financiare dhe të tjera përveç saj.

Këtu do të paraqesim disa prej librave të njohur gjuhësorë, në të cilët bazohen dijetarët e gjuhës arabe dhe shkrimtarët, për t'i sjellë si shembull dhe argument.

Në librin "Lisan el Arab" (Gjuha e Arabëve), në vëllimin e dymbëdhjetë, lexojmë se "el gunmu", ka kuptimin e fitimit të diçkaje pa mundim. Gjithashtu, aty thuhet se "el gunmu", "el ganiymetu" dhe "el magnemu" janë me kuptimin: "el feju" - **dhuratë**.¹

Në vëllimin e nëntë të librit "Taxh el Arus" thuhet se "el gunmu", është fitimi i diçkaje pa mundim."²

Edhe në librin "El Kamus", thuhet se fjala "el ganiymeh" ka po të njëjtin kuptim.

Në librin "El Mufredat" të Er Ragib thuhet se origjina e fjalës "el ganiyme" vjen nga "el ganem" (dele, bagëti) dhe më pas ajo u përdor për çdo gjë të fituar nga armiqtë dhe të tjerët.

Madje edhe ata që thanë se kuptimi i kësaj fjale është plaçka e fituar e luftës, nuk e mohojnë se kuptimi i saj në origjinë është i gjerë dhe përfshirës për çdo mirësi që bie në dorën e njeriut pa lodhje dhe mundim.

Në mesin e njerëzve fjala "el ganime", njihet si e kundërta e fjalës "el garamë" (pagesë, gjobë, taksë). Ashtu sikurse kuptimi i

¹ "Lisanul Arab", vëll. 12, f. 445.

² "Taxhul Arus", vëll. 9, f. 7.

fjalës “*el garamë*” është i gjërë dhe përfshin çdo lloj pagese, po ashtu edhe kuptimi i fjalës “*el ganime*” është i gjërë dhe përfshin çdo lloj fitimi.

Kjo fjalë është përmendur shumë herë në librin “Nehxhul Belagah” me të njëjtin kuptim të përmendur. Kështu, në fjalimin e shtatëdhjetë e gjashtë, lexojmë thënien: “*Përfitoni nga afati kohor*”. Në fjalimin e 129 thotë “*Ai që e ndjek rrugën e fesë, arrin në qëllim dhe fiton.*”

Në shkresën e pesëdhjetë e tretë të tij drejtuar Malik El Eshter imam Aliu thotë: “*Mos u sill me ata si egërsirë gllabëruese që të përfitosh ushqimin e tyre.*”

Ashtu thotë edhe në shkresën e dyzetë e pestë drejtuar Othman ibn Hunejf: “*...për Atë Zot, unë nuk kam ruajtur nga kjo botë ndonjë flori, as kam mbledhur male me pasuri apo grumbulluar rroba dhe veshje...*”

Shprehjet dhe fjalët që tregojnë moskufizimin e kuptimit të fjalës “*el ganijmeh*” (fitim) në plaçkën e luftës, janë të shumta.

Thëniet e komentuesve

Shumica e komentuesve që u morën me kërkimin rreth këtij ajeti, kanë thënë se fjala “*el ganijmeh*” ka kuptim të gjerë në gjuhë. Ajo përfshin plaçkën e luftës dhe çdo gjë tjetër që mund ta arrijë njeriu pa mundim. Madje edhe ata që thanë se ky ajet i përkon vetëm plaçkës së luftës (kjo sipas fetvasë së dijetarëve të Ehli Syneetit), e pranojnë se kuptimi gjuhësor i saj është i pakufizuar, por ata e kufizuan me një argument tjetër.

Kurtubiu, komentuesi i njohur i Ehli Syneetit, ka shkruar se “*el ganimeh*” sipas gjuhësisë, janë të mirat që i arrin individi ose një

bashkësi me kërkim dhe përkushtim.¹

Dijetarët e Ehli Syneetit kanë rënë dakord se qëllimi me fjalën “*el ganimeh*”, fitimi, që është përmendur në ajetin: “**Ta dini se çfarëdo që të fitoni...**” është pasuria që njerëzit e arrijnë nëpërmjet forcës në luftë. Këtu duhet të vërejmë se ky kufizim nuk është i përmendur në gjuhë, por në traditën sheriatike (dispozitat islame).

Në tefsirin e tij, Fakhru Raziu thotë: “*El gunmu*” është fitimi i diçkaje”. Dhe pas kësaj thotë: “Kuptimi ligjor i fjalës “*el ganimeh*” në gjykimin e dijetarëve të Ehli Syneetit është plaçka e luftës.²

Autori i librit “*El Manar*” e ka përmendur këtë fjalë me kuptim të gjerë dhe nuk e ka specifikuar atë me plaçkën e luftës, edhe pse ai ka bindjen në domosdoshmërinë e kufizimit të kuptimit të gjërë me kufizues ligjor (shariat). Ai e specifikon ajetin me plaçkën e luftës.³

Në tefsirin e tij “*Ruhul Meanij*”, El Alusij thotë: “*el gunmu*” në origjinë ka kuptimin e çdo fitimi dhe dobie”.⁴

Autori i librit “*Mexhmaul Bejjan*”, në fillim të fjalës së tij thotë: “*El ganimeh*” ka kuptimin e plaçkës së luftës, por kur tregon kuptimin e ajetit, ai thotë: Kanë thënë dijetarët tanë: Një e pesta (khums-i) është e detyrueshme në çdo përfitim që arrin njeriu prej të ardhurave dhe fitimeve tregtare, si edhe nga thesaret, metalet dhe ato që nxirren nga zhytja, e të tjera që janë përmendur në libra. Është e mundur që të argumentojmë për ato me këtë ajet, sepse në traditën gjuhësore, të gjitha emërtohen me fjalën “*el*

¹ Tefsiri “*El Kurtubi*”, vëll. 4, f. 284.

² Tefsiri “*El Kebijr*”, vëll. 15, f. 163, rreth ajetit në fjalë.

³ Tefsiri “*El Manar*”, vëll. 10, f. 703, rreth ajetit në fjalë.

⁴ Tefsiri “*Ruhul Meanij*”, vëll. 10, f. 2, rreth ajetit në fjalë.

gunmu” dhe “*el ganimeh*.”¹

Është e habitshme se disa njerëz tendenciozë (sikur të jenë të urdhëruar të lëshojnë helmin në mendime) i shtrembëruan fjalët e autorit të librit “*Mexhmaul Bejjan*”, në një libër që e shkruan për çështjen e “*Khums-it*” (një të pestës). Aty, ata përmendën fjalët e tij të para në komentimin e fjalës “*el ganimeh*” (fitimit), prej së cilës kuptohet plaçka e luftës, por ata nuk treguan shpjegimet e kësaj fjale rreth përgjithësimin të kuptimit gjuhësor dhe të kuptimit të ajetit, që ai e përmendi së fundmi. Ata gënjyen me atë çka ia mveshën këtij komentuesi të madh mysliman, sikur ata menduan se libri “*Mexhmaul Bejjan*” ishte vetëm në duart e tyre dhe nuk e lexon kush tjetër. Më e habitshme se kjo është se ata, jo vetëm që bënë këtë tradhti intelektuale, por ndërhyjnë edhe në libra të tjerë, ku morën atë që u bënte dobi atyre dhe lanë atë që u bënte dëm.

Në tefsirin “*El Mijzan*” thuhet qartazi – duke u bazuar te dijetarët e lëmit të gjuhës – se fjala “*el ganimeh*” ka kuptimin e çdo dobie që vjen nëpërmjet tregtisë, fitimit ose luftës. Edhe pse shkaku i zbritjes së ajetit është plaçka e luftës, kjo gjë nuk e specifikon kuptimin e ajetit dhe përgjithësinë e tij.²

Në përfundim të asaj që përmendëm më lart, themi:

Ajeti i plaçkës së luftës ka një kuptim të gjerë, që përmbledh çdo dobi dhe fitim, sepse kuptimi gjuhësor i plaçkës së luftës është i përgjithshëm dhe nuk ekziston ndonjë argument përcaktues për këtë ajet.

Gjëja e vetme në të cilën u mbështetën komentuesit e Ehli Syneetit, është se ajetet e mëparshme dhe ajetet pasuese të këtij ajeti, kanë lidhje me luftën dhe se kjo çështje është argument që

¹ Tefsiri “*Mexhmaul Bejjan*”, vëll. 4, f. 543, rreth ajetit në fjalë.

² Tefsiri “*El Mijzan*”, vëll. 9, f. 89.

fraza: "**çfarëdo që të fitoni**" ka të bëjë me plaçkën e luftës.

Por shkaqet e zbritjes së ajetit dhe konteksti i ajeteve nuk përcakton përgjithësimin e tij, ashtu siç është edhe e njohur.

Me fjalë më të qarta: Nuk ka ndonjë pengesë që kuptimi i ajetit të jetë i përgjithshëm dhe në të njëjtën kohë të jetë shkaku i zbritjes së ajetit placka e luftës.

Të ngjashme me këto gjykime janë të shumta në Kur'anin fisnik dhe në rrugën e pastër profetike, ku gjykimi i ajetit është i përgjithshëm dhe përmbajtja e tij është e pjesshme (e veçantë).

Për shembull, në ajetin e shtatë të sures "El Hashr" lexojmë fjalën e All'Ilahut të Lartësuar: "**Atë që ua jep Profeti, merreni, e atë që ua ndalon, lëreni**". Ky ajet ka gjykim të përgjithshëm në domosdoshmërinë e përmbajtjes së urdhrave të Profetit (*Paqja dhe bekimi i All'Ilahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), edhe pse shkaku i zbritjes së këtij ajeti është pasuria që bie në duart e myslimanëve pa luftë, e cila njihet në terminologji me termin "*el feju*" (dhuratë).

Gjithashtu, në ajetin 233 të sures "El Bekare" gjejmë një gjykim të përgjithshëm në fjalën e All'Ilahut të Lartësuar: "**Askush nuk ngarkohet më tepër, vetëm aq sa e ka mundësinë**", edhe pse ky ajet ka të bëjë me gratë që i japin gji fëmijës dhe se urdhri u është drejtuar baballarëve të foshnjave që ushqehen me qumësht gjiri, për t'u dhënë gjidhënësive pagën e tyre sipas mundësive. Duke qenë se ky ajet ka ardhur për këtë çështje të veçantë, nuk e pengon gjykimin e përgjithshëm me të cilin ka ardhur ai, që është mosngarkimi më shumë sesa mundësitë.

Konkluzioni është se ajeti që po studiojmë, ka ardhur në kontekstin e ajeteve të luftës, por ai thotë se "për çdo dobi dhe fitim që ju e arrini - ndër të cilat edhe plaçka e luftës - është obligim për ju që të jepni një të pestën (Khums-in)".

6 - Të mos konsiderohet gjysma e një të pestës që i jepet fisit Beni Hashim, si largues ndërmjet myslimanëve

Disa mendojnë se kjo taksë gjithëpërfshirëse islame e një të pestës së shumë prej pasurive, të pjesës (njëzet përqind) ku gjysma e tyre jepet për zotërinjtë prej bijve të Profetit (*Paqja dhe bekimi i All'Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), është një lloj diskriminimi racor ose dallimi në marrëdhëniet familjare dhe se kjo gjë nuk përshtatet as me frymën e drejtësisë shoqërore të Islamit, e as të pozitës së kësaj feje si gjithëpërfshirëse dhe universale.

Përgjigje: Këta nuk i kanë studiuar rrethanat e këtij gjykimi dhe specifikat e tij me saktësi të mjaftueshme, sepse përgjigjja për këtë pyetje qëndron e fshehur në ato specifika. Për ta sqaruar këtë, themi:

Së pari: Gjysma e një të pestës, që ka të bëjë me fisin Beni Hashim, u jepet vetëm nevojtarëve dhe të varfërve të tyre, që t'u mjaftojë për një vit të vetëm e jo më shumë. Kështu, këto para shpenzohen për ata që janë me aftësi të kufizuara për punë, për të sëmuret dhe të vegjëlit prej jetimëve, ose për ata që janë ngushtë dhe në vështirësi për një arsye apo një tjetër. Ata që janë të aftë për punë (me veprim ose fuqi) dhe ata që kanë mundësi ta menaxhojnë jetesën e tyre, nuk mund të marrin prej një të pestës (khums-it).

Ndërsa ajo që thonë disa prej shumicës se zotërinjtë e Ehli Bejtit mund të marrin një të pestën, edhe sikur dysHEMEJA e shtëpisë së tyre të jetë prej floriri, është një arsyetim naiv dhe i pabazë.

Së dyti: Nevojtarëve dhe të dobtëve prej zotërinjve të fisit

Beni Hashim nuk u takon të marrin gjë prej Zekatit. Për këtë shkak, atyre iu lejua të marrin vetëm prej kësaj pjese të një të pestës (khums-it).¹

Së treti: Nëse tepron pjesa e përcaktuar për fisin Beni Hashim mbi nevojat e tyre, këto teprica i kthehen arkës së shtetit për fondet publike (Bejtul Mali), që të investohen në çështje të tjera. Gjithashtu, nëse kjo pjesë është e mangët dhe nuk u mjafton për nevojat e tyre, atëherë ajo plotësohet duke ua paguar nga arka e shtetit për fondet publike (Bejtul Mali), ose nga pjesa e Zekatit. Duke i marrë në konsideratë këto pika, na bëhet e qartë se në të vërtetë, nuk ka dallim nga ana materiale mes zotërinjve Beni Hashim dhe të tjerëve .

Nevojtarët që nuk janë nga fisi Beni Hashim mund t'i plotësojnë nevojat e tyre nga Zekati, por iu ndalohet një e pesta (khums-i), ndërsa zotërinjtë prej Beni Hashimit i plotësojnë nevojat e tyre nga një e pesta (khums-i), por u ndalohet Zekati. Në të vërtetë ka dy fonde: fondi i "Khums-it" (një të pestës) dhe fondi i Zekatit. Kështu, secilit prej dy grupeve u lejohet të marrë nga njëri prej dy fondeve në mënyrë të barabartë ndërmjet tyre, pra atë që e kanë të nevojshme për një vit të vetëm.

Ata që nuk e kanë thëlluar vështirimin në këto kushte dhe specifika, menduan se pasardhësit e Profetit (*Paqja dhe bekimi i All'llahut qofshin mbi të dhe familjen e tij*) kanë të drejtë të marrin nga arka e shtetit për fondet publike (Bejtul Mali) më shumë sesa

¹ Ndalimi i marrjes së Zekatit nga fisi Beni Hashim është i njohur dhe është përmendur në shumicën e librave të Hadithit dhe në verdiktet e dijetarëve dhe në librat e tyre të Fikhut. A është e logjikshme që Islami të ketë menduar për çështjen e të varfërve dhe nevojtarëve që nuk janë prej fisit Benu Hashim e të mos ketë trajtuar çështjen e nevojtarëve prej fisit Benu Hashim dhe të lërë ata në udhëkryq?! "Usulul Kafij", vëll.1, f. 540.

të tjerët dhe se ata gëzojnë privilegje të veçanta.

Pyetja e vetme që lind këtu është: Nëse themi se nuk ka dallim ndërmjet tyre, atëherë cili është qëllimi i kësaj pike në këtë rast?!

Përgjigjen e kësaj pyetjeje mund ta nxjerrim duke konstatuar se ndërmjet Zekatit dhe Khums-it (një të pestës) ka një dallim të madh: Zekati vjen nga taksat e fondeve publike të shoqërisë islame, të cilat shpenzohen në përgjithësi në këtë drejtim, ndërsa “Khums-i” (një e pesta) vjen nga taksat e qeverisë islame, të cilat shpenzohen për udhëheqjen dhe qeverinë islame, nëpërmjet të cilave plotësohen nevojat e tyre.

Ndalesa për zotërinjtë Beni Hashim e fondeve publike (Zekatit), në të vërtetë është bërë me qëllimin që të mos jetë pretekst në dorën e armiqve e të thonë se Profeti (*Paqja dhe bekimi i All'Ilahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) i ka lëshuar të afërmit e tij mbi fondet publike.

Nga ana tjetër është e domosdoshme që të plotësohen nevojat e të dobtëve dhe të varfërve prej zotërinjve (pasardhësit e familjes së Profetit). Prandaj u vendos që nevojat e tyre të plotësohen nga buxheti i qeverisë islame dhe jo nga fondi publik.

Në të vërtetë, “Khums-i” (një e pesta) nuk është privilegj për fisin Beni Hashim, por shërben për t’i distancuar ata për shkak të interesit publik, në mënyrë që të mos përhapet mendimi i keq për ta.

Ajo që të tërheq vëmendjen është se për këtë çështje është treguar në hadithet e shijave dhe të synive. Në hadithin e ardhurr nga imam Sadiku lexojmë: “Disa njerëz prej fisit Beni Hashim erdhën tek Profeti (*Paqja dhe bekimi i All'Ilahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) dhe kërkuan prej tij që t’i punësonte ata në sadakatë e bagëtive. Ata i thanë: “Le të jetë për ne kjo pjesë, të cilën All'Ilahu i

Lartësuar e bëri për kujdestarët e saj. Neve na takon të parëve". I Dërguari i All'llahut u tha: "O bijtë e Abdul Muttalibit (Hashimit)! Sadakaja nuk më lejohet as mua dhe as juve, por mua më është premtuar ndërmjetësimi (shefaati)". Pastaj tha: "A mos po ju duket se po ju lë nën ndikimin e të tjerëve?!"¹

Ky hadith tregon se fisi Beni Hashim shihte mosfavorizim në atë çështje dhe se Profeti (*Paqja dhe bekimi i All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) u premtoi atyre që të ndërmjetësojë për ta (Shefaat).

Në librin "Sahih El Muslim", që konsiderohet si një ndër burimet më të rëndësishme të Ehli Synetit, lexojmë një hadith, ku thuhet se Abbasi dhe Rebia ibn El Harith erdhën tek Profeti dhe kërkuan prej tij që t'i urdhëronte dy bijtë e tyre (që ishin të rinj), Abdul Muttalib ibn Rebia dhe El Fadl ibn Abbasin, për të mbledhur Zekatin, në mënyrë që të merrnin pjesë nga ajo që u jepet punonjësve të Zekatit, ashtu si të tjerët. Kështu, ata do të siguronin buxhetin e duhur për martesën e tyre. Profeti (*Paqja dhe bekimi i All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) nuk i lejoi ata dhe urdhëroi që të plotësohej nevoja e tyre me një rrugë tjetër, që ishte "Khums-i" (një e pesta).

Nga ky hadith mësohet se Profeti këmbëngulte që t'i largonte të afërmit e tij nga marrja e Zekatit, që ishte nga fondet publike të njerëzve.

Nga përmbledhja e asaj që thamë, na bëhet e qartë se "Khums-i" (një e pesta) nuk është privilegj për zotërinjtë e Beni Hashimit, por është një lloj privimi për të ruajtur interesat publike.

¹ "Uesailu Shia", vëll. 6, f. 186; "Usulul Kafij", vëll. 4, f. 58.

7 - Çfarë nënkuptohet me frazën “Pjesa e All'Ilahut”?

Përmendja e pjesës që thuhet se është pjesë e All'Ilahut, bëhet për të theksuar rëndësinë e çështjes së “Khums-it’ (një të pestës) dhe vërtetësinë e saj si dhe për të përforcuar udhëheqësinë e të Dërguarit dhe udhëheqjen islame.

Pra, ashtu sikurse All'Ilahu i Lartësuar bëri pjesë në emër të Tij dhe i takon vetëm Atij që të veprojë në to, ashtu i ka dhënë edhe Profetit dhe Imamit, të drejtën e mandatit dhe të veprimit në to. Kështu që pjesa e All'Ilahut (tek Khums-i) vendoset në dispozicion të Profetit ose Imamit, të cilët e përdorin në vendin e duhur, sepse dihet se All'Ilahu nuk ka nevojë për ndonjë pjesë të caktuar.

Ajetet 42 - 44

إِذْ أَنْتُمْ بِالْعُدْوَةِ الدُّنْيَا وَهُمْ بِالْعُدْوَةِ الْقُصْوَى وَالرَّكْبُ أَسْفَلَ
 مِنْكُمْ ۚ وَلَوْ تَوَاعَدْتُمْ لَأَخْتَلَفْتُمْ فِي الْمِيعَدِ ۗ وَلَكِنَّ لِيَقْضِيَ اللَّهُ أَمْرًا
 كَانَ مَفْعُولًا لِيَهْلِكَ مَنْ هَلَكَ عَن بَيْنَةٍ وَيَحْيَىٰ مَنْ حَيَّ عَن
 بَيْنَةٍ ۗ وَإِنَّ اللَّهَ لَسَمِيعٌ عَلِيمٌ ﴿٤٢﴾ إِذْ يُرِيكُهُمُ اللَّهُ فِي مَنَامِكَ قَلِيلًا ۗ وَلَوْ
 أَرَاكَهُمْ كَثِيرًا لَّفَشِلْتُمْ وَلَتَنزَعْتُمْ فِي الْأَمْرِ وَلَكِنَّ اللَّهَ سَلَّمَ ۗ إِنَّهُ
 عَلِيمٌ بِذَاتِ الصُّدُورِ ﴿٤٣﴾ وَإِذْ يُرِيكُمُوهُمْ إِذِ التَّقَيْتُمْ فِي أَعْيُنِكُمْ قَلِيلًا
 وَيُقَلِّلُكُمْ فِي أَعْيُنِهِمْ لِيَقْضِيَ اللَّهُ أَمْرًا كَانَ مَفْعُولًا ۗ وَإِلَى اللَّهِ
 تُرْجَعُ الْأُمُورُ ﴿٤٤﴾

"Kur ju ishit në bregun e afërt të luginës, ata ndodheshin në bregun e largët, ndërsa karvani poshtë jush. Edhe sikur t'i kishit lënë takim njëri-tjetrit, nuk do të ishit pajtuar për kohën e ndeshjes. Por All'Ilahu e përmbushi atë ngjarje që ishte e caktuar, me qëllim që kush duhej të vdiste, të vdiste me prova të qarta dhe, kush duhej të mbetej gjallë, të jetonte me prova të qarta. Vërtet, All'Ilahu i dëgjon të gjitha dhe di çdo gjë."

"(Kujto) kur All'Ilahu të tregoi në ëndërr se ata janë pak. Sikur të të tregonte se ishin shumë, ju do të humbisnit guximin dhe do të grindeshit për atë çështje, por All'Ilahu ju shpëtoi. Ai e di se çfarë keni në zemrat tuaja."

"Kur u përballët (me armikun), Ai ua shfaqti ata në sytë tuaj sikur ishin pak, ndërsa juve ju bëri të dukeshit pak në sytë e atyre, për të përmbushur atë që ishte caktuar. Tek All'Ilahu kthehen të gjitha çështjet."

Komentimi

Çështje e domosdoshme

Në këto ajete fisnike, me përshtatjen e fjalëve në ajetet e mëparshme mbi ditën e Furkanit, ditën e luftës së Bedrit dhe fitores së myslimanëve në atë situatë të rrezikshme, Kur'ani tregon për disa fragmente nga ajo betejë, për t'ua vënë në dukje myslimanëve rëndësinë e asaj fitoreje madhështore.

Ajeti i parë ndër ajetet që janë objekt studimi, thotë: **"Kur ju ishit në bregun e afërt të luginës, ata ndodheshin në bregun e largët..."**

Fjala *"el uduetu"* rrjedh prej *"el adue"* në metrikën e fjalës *"es serue"* dhe kuptimi i saj në origjinë është *"tejkalimi"*. Por kjo fjalë përdoret edhe për anët e çdo gjëje dhe çfarë ka përreth, sepse e tejkalon limitin e mesëm deri te njëra prej anëve. Në këtë ajet, fjala ka ardhur me këtë kuptim, pra *"skajet dhe anët"*.

Fjala *"ed dunia"* rrjedh prej fjalës *"ed dunu'u"*, sipas metrikës së fjalës *"el ulu'u"*, që ka kuptimin *"më të afërt"*. E kundërta e

kësaj fjale është “*el aksaa*” dhe “*el kasu'aa*” që kanë kuptimin “më e largët”.

Myslimanët ishin në anën e veriut të fushëbetejës, që ishte më e afërt me Medinen dhe armiqtë ishin në anën e jugut, e cila ishte më larg.

Më pas, ajeti thotë: “**...ndërsa karvani poshtë jush...**”

Ashtu si edhe më parë, e vumë re se në kohën kur Ebu Sufjani mësoi mbi lëvizjen e myslimanëve, ai e ndryshoi drejtimin e karvanit të tij në një drejtim tjetër anës Detit të Kuq, derisa rrugëtoi afër Mekës. Sikur myslimanët të mos humbisnin gjurmët e karvanit, ndoshta do t'i ndiqnin dhe nuk do të kishin mundësi të përballëshin me armiqtë e tyre e të luftonin kundër tyre në luftën e Bedrit, luftë në të cilën u bë realitet fitorja madhështore dhe ngadhënjimi i qartë.

Pavarësisht këtyre, numri i forcave myslimane dhe potenciali i tyre ishte më i vogël se ai i forcave armike, e parë kjo nga të gjitha aspektet. Për këtë ngjarje, ajeti fisnik thotë:

“...Edhe sikur t'i kishit lënë takim njëri-tjetrit, nuk do të ishit pajtuar për kohën e ndeshjes...”

Kjo, sepse shumë prej jush do të njihnit dobësinë tuaj në pamje të parë, përballë armiqve dhe do të dështonit në luftim me ta, por All'llahu ju vuri përballë një çështjeje të caktuar, ashtu siç edhe e thotë ajeti: **“...Por All'llahu e përmbushi atë ngjarje që ishte e caktuar...”** që të njihet e vërteta nga e pavërteta nën hijen e fitores së papritur dhe të një mrekullie të qartë: **“...me qëllim që kush duhej të vdiste, të vdiste me prova të qarta dhe, kush duhej të mbetej gjallë, të jetonte me prova të qarta...”**

Qëllimi i fjalës “jetë” (el hajat) dhe fjalës “shkatërrim” (el heleketu), këtu është udhëzimi dhe humbja, sepse në ditën e Bedrit, e cila u quajt Dita e Dallimit (Furkanit), u dha ndihmesa e

All'lahut për të fituar myslimanët. Atë ditë u vërtetua se ata (myslimanët) kanë lidhje me All'lahun dhe se e vërteta është me ta.

Në fund ajeti thotë: **“...Vërtet, All'lahu i dëgjon të gjitha dhe di çdo gjë.”**

Ai e dëgjoji thirrjen tuaj për ndihmë dhe i dinte qëllimet tuaja. Për këtë arsye, Ai ju ndihmoi me fitoren e Tij mbi armiqtë tuaj.

Të dhënat tregojnë se disa prej myslimanëve, po të dinin madhësinë e fuqisë së armiqve të tyre, do të përmbaheshin pa u përballur me ta. Ndër ta ishte edhe një grup tjetër prej myslimanëve, të cilët ishin të bindur ndaj Profetit (*Paqja dhe bekimi i All'lahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), për të përballuar të gjitha vështirësitë. Për këtë arsye, All'lahu i Lartësuar i bëri çështjet që të rridhnin në atë mënyrë që myslimanët donin apo jo, të takoheshin me armiqtë e tyre, dhe bëri të mundur që të ndodhte përballja vendimtare.

Profeti (*Paqja dhe bekimi i All'lahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), kishte parë në ëndërr se një numër i pakët politeistësh i luftonin myslimanët. Kjo ëndërr ishte një shenjë e fitores dhe përgëzim për të. Profeti ua tregoi atë ëndërr myslimanëve dhe ky rrëfim atyre u shtoi vullnetin për marshim drejt luftës së Bedrit.

Natyrisht, ëndrra e Profetit ishte e saktë, sepse fuqia e armiqve dhe numri i tyre, edhe pse në dukje ishte i shumtë, ata në të vërtetë ishin të pakët në brendësinë e tyre, ishin të dobët dhe të paaftë për t'u përballur me myslimanët. Ne e dimë se ëndrra përmban tregues dhe shenja dhe se ëndrra e saktë dhe e vërtetë është ajo që zbulon pamjen e brendshme të çështjeve.

Ndërsa ajeti i dytë nga ajetet që janë objekt studimi, tregon për urtësinë e këtyre çështjeve dhe për mirësinë që u dha All'lahu

i Lartësuar myslimanëve nëpërmjet kësaj rruge. Në të thuhet: **“(Kujto) kur All'Ilahu të tregoi në ëndërr se ata janë pak. Sikur të të tregonte se ishin shumë, ju do të humbisnit guximin... ”** dhe do të binte morali juaj. Dhe gjërat nuk do të ndalnin me aq, por mes jush do të lindnin grindje dhe përçarje: **“...dhe do të grindeshit për atë çështje, por All'Ilahu ju shpëtoi...”**; u shpëtoi në këtë situatë nëpërmjet ëndrrës, e cila u bëri të qartë gjendjen e brendshme të ushtrisë së armiqve, edhe pse All'Ilahu e di zemrën tuaj: **“...Ai e di se çfarë keni në zemrat tuaja”**.

Ajeti pasues tregon për një etapë tjetër të luftës së Bedrit, që ndryshon nga ato të mëparshmet. Në këtë etapë si pasojë e fjalëve ndikuese të Profetit, e përgëzimeve nga All'Ilahu, shikimi i ndodhive gjatë përgatitjes për luftë, si rënia e shiut për të shuar etjen dhe bërja e rërës e butë në fushën e betejës, u ripërtërit morali dhe u rrit shpresa për fitore. Vullneti i zemrave u forcua dhe ata e shihnin ushtrinë armike si të ishte e vogël, e dobët dhe e pafuqishme. Ajeti i begatë thotë: **“Kur u përballët (me armikun), Ai ua shfaqti ata në sytë tuaj sikur ishin pak...”**

Ndërsa armiku, meqenëse nuk e njihte moralin e myslimanëve dhe gjendjen e tyre, i shihnin në pamje të jashtme dhe u dukeshin shumë pak, madje më pak se ç'ishin në të vërtetë. Në lidhje me këtë, ajeti thotë: **“...ndërsa juve ju bëri të dukeshit pak në sytë e atyre...”**

Madje transmetohet se Ebu Xhehli, për të treguar sasinë e vogël të myslimanëve, tha: *“Shokët e Muhammedit nuk janë veçse ca ngrënës të një deveje”*¹. Gjithashtu, ata mendonin se do ta mbyllnin këtë çështje në një ditë të vetme, nga mëngjesi deri në mbrëmje. Nga të dhënat tregohet se ata therrnin në ditë dhjetë deve për t'u

¹ “Tefsiri El Kurtubi” rreth këtij ajeti; “Durul Menthur”, vëll. 3, f. 167.

ushqyer, sepse numri i ushtrisë së Kurejshëve ishte rreth njëmijë luftëtarë.

Ndikimi i këtyre dy çështjeve në fitoren e myslimanëve ishte i madh, sepse ata nga njëra anë panë ushtrinë e armikut të pakët në numër dhe iu largua çdo frikë dhe tmerr në vetvete, dhe nga ana tjetër numri i myslimanëve në sytë e armikut u shfaq i vogël, në mënyrë që të mos tërhiqeshin në luftën e tyre kundër myslimanëve e të largoheshin nga lufta, që në fund çoi në humbjen e tyre.

Për këtë, ajeti thotë më pas: **“...për të përmbushur atë që ishte caktuar...”**

Kjo luftë, jo vetëm që përfundoi sipas caktimit të All'Ilahut, por caktimi i Tij zbatohet në çdo gjë: **“...Tek All'Ilahu kthehen të gjitha çështjet.”**

Në ajetin e trembëdhjetë të sures “Ali Imran” ka tregues për një etapë të tretë të luftës së Bedrit. Në të tregohet se kur u ndez rreptësia e luftës dhe armiqtë panë goditjet e forta të ushtrisë myslimane që binin si rrufe mbi kokat e tyre, ata i kaploi një tmerr dhe një frikë e madhe. Ata ndjenë sikur ushtrisë myslimane iu shtua dhe iu shumëfishua numri. Si rrjedhojë, atyre u ra morali, gjë që çoi në humbjen e në shpartallimin e tyre.

Nga sa përmendëm më lart, na bëhet e qartë se nuk ka asnjë kontradiktë, as ndërmjet ajeteve për të cilat po flasim dhe as ajetit trembëdhjetë të Sures “Ai Imran”, sepse secili nga këto ajete tregon një etapë të caktuar të luftës së Bedrit.

Etapa e parë - para luftës, është ajo që tregohet për ëndrrën e Profetit (*Paqja dhe bekimi i All'Ilahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), ku ushtria e politeistëve u shfaq e pakët në numër.

Etapa e dytë - është zbritja e tyre në fushën e betejës, në tokën e Bedrit, njohja e disa prej myslimanëve me numrin e

armiqve dhe potencialin e tyre dhe frika e disa myslimanëve në përballjen me ta.

Etapa e tretë - është ndodhia e përballjes së armatosur, ajo çfarë All'illahu i Lartësuar u dha atyre nga mirësitë dhe çfarë panë nga ngjarjet, të cilat çuan në pakësimin e numrit të armiqve në sytë e tyre.

Ajetet 45 - 47

يَأْتِيهَا الَّذِينَ ءَامَنُوا إِذَا لَقِيتُمْ فِئَةً فَاثْبُتُوا وَاذْكُرُوا اللَّهَ كَثِيرًا
لَعَلَّكُمْ تُفْلِحُونَ ﴿٤٥﴾ وَأَطِيعُوا اللَّهَ وَرَسُولَهُ وَلَا تَنزَعُوا فَتَفْشَلُوا
وَتَذْهَبَ رِجَالُكُمْ ۖ وَأَصْبِرُوا ۗ إِنَّ اللَّهَ مَعَ الصَّابِرِينَ ﴿٤٦﴾ وَلَا تَكُونُوا
كَالَّذِينَ خَرَجُوا مِنْ دِيَارِهِمْ بَطْرًا وَرِئَاءَ النَّاسِ وَيَصُدُّونَ عَنْ سَبِيلِ
اللَّهِ ۗ وَاللَّهُ بِمَا يَعْمَلُونَ مُحِيطٌ ﴿٤٧﴾

"O ju që keni besuar, kur të ndesheni me ndonjë forcë armike, qëndroni të patundur dhe përmendni shumë All'Ilahun që të fitoni."

"Bindjuni All'Ilahut dhe të Dërguarit të Tij dhe mos u grindni ndërmjet jush, sepse do të humbni guximin e do t'ju lërë fuqia. Bëhuni të durueshëm, se All'Ilahu, me të vërtetë, është me të durueshmit."

"Mos u bëni si ata (jobesimtarët e Mekës) që dolën nga shtëpitë e tyre me mendjemadhësi e për sy e faqe të botës, duke dashur t'i pengojnë njerëzit nga rruga e All'Ilahut. All'Ilahu e di mirë çfarë punojnë ata."

Komentimi

Gjashtë çështje të tjera për luftën

Komentuesit kanë thënë se Ebu Sufjani, pasi pati mundësinë të shpëtojë me karvanin tregtar të Kurejshëve nga përballja me myslimanët, dërgoi një lajmës tek Kurejshët, të cilët ishin duke shkuar drejt fushës së Bedrit dhe u bëri thirrje që të ktheheshin, sepse ai pa se nuk ishte e nevojshme lufta. Por Ebu Xhehli, egoisti, jotoleranti dhe kryeneçi, u betua se nuk do të ktheheshin derisa të mbërrinin në tokën e Bedrit (Bedri, para kësaj beteje ishte prej qendrave ku mblidheshin arabët dhe çdo vit aty zhvillohej tregtia) dhe të qëndronin aty tre ditë, të thernin devetë, të hanin çfarë t'u shijonte, të pinin verë dhe t'u këndonin këngëtalet. E kjo të ndodhte derisa fiset arabe ta dëgjonin dhe me këtë të vërtetohej fuqia dhe aftësia e tyre!

Por çështja e tyre arriti në humbje. Ata pinë nga gotat e dëshirave të porealizueshme në vend të gotave me verë dhe këngëtalet u mblodhën përreth duke vajtuar mbi trupat e tyre.

Ajetet për të cilat po flasim tregojnë për këtë çështje dhe ua ndalojnë myslimanëve të bëjnë vepra të tilla. Këtu nxirren mësimet e reja për çështjen e luftës, duke shtuar edhe çfarë ka kaluar më parë nga këto çështje.

Në pamje të përgjithshme, në këto ajete ka gjashtë çështje për t'u analizuar për myslimanët, të cilat janë:

1- Ajeti thotë: "O ju që keni besuar, kur të ndesheni me ndonjë forcë armike, qëndroni të patundur..."; pra njëra prej shenjave të besimit është qëndresa në të gjitha rrethanat e në veçanti në përballjen me armikun.

2- “...dhe përmendni shumë All'Ilahun që të fitoni.”

Nuk ka dyshim se qëllimi me përmendjen e All'Ilahut këtu, nuk është vetëm përmendja verbale (me fjalë), por qëllimi është për praninë e përmendjes në zemër dhe përmendjen e diturisë, fuqisë së Tij absolute dhe mëshirës së Tij të gjerë. Ky drejtim nga All'Ilahu i Lartësuar e forcon vullnetin e luftëtarëve dhe i bën ata të ndiejnë se kanë një mbështetje të fuqishme me vete, të cilën nuk ka mundësi asnjë forcë në ekzistencë që ta mposhtë në fushën e luftës. Nëse vritet, luftëtari do të arrijë lumturinë madhështore, shkallën e lartë të dëshmorit dhe afërsinë e mëshirës së All'Ilahut. Përmendja e All'Ilahut i jep luftëtarit qetësi, forcë, aftësi dhe qëndrueshmëri në vetvete.

Veç kësaj, përmendja e All'Ilahut dhe dashuria për të, e nxjerr dashurinë e gruas, pasurisë dhe të fëmijëve nga zemra e tij.

Drejtimi për nga All'Ilahu i Lartësuar heq nga zemra çdo gjë që e dobëson dhe e trondit atë, ashtu siç edhe thotë Imam Ali ibn Husein Zejn El Abidijn (*Paqja qoftë mbi të!*) në lutjen e tij, të njohur (në Sahijfen Es Sexhadije) si lutja e luftëtarëve: *“Dhe harrojua atyre kur të përballen me armikun, përmendjen e kësaj bote mashtruese; fshije nga zemrat e tyre dashurinë e pasurisë sprovuese dhe vendose Xhennetin para syve të tyre!”*

3- Baza më e rëndësishme e përballjes është bindja ndaj urdhrave të udhëheqësit dhe të drejtuesit, të atij drejtuesi pa të cilin nuk do të realizohej fitorja në luftën e Bedrit.

Për këtë, ajeti më pas thotë: **“Bindjuni All'Ilahut dhe të Dërguarit të Tij...”**

4- "...dhe mos u grindni ndërmjet jush, sepse do të humbni guximin... "

Konflikti dhe përçarja në sy të armiqve çon në dobësim dhe në rënien e vullnetit. Rezultati i këtij dobësimi është rënia e prestigjit të myslimanëve, e forcës dhe e madhësisë së tyre: **"...e do t'ju lërë fuqia..."**

Fjala *"er rijh"* në gjuhën arabe ka kuptimin *"ajër, erë, frymë"*, çka do të thotë se konflikti sjell dobësi dhe plogështi.

Ndërsa largimi i ajrit (frymës, erës) tuaj, këtu ka një tregues që të jep të kuptosh rënien e fuqisë, të madhësisë, mosmbarëvajtjen e çështjeve ashtu siç duhet dhe mosrealizimin e qëllimit, sepse lëvizja e erës andej nga duhet, e çon anijen në qëllimet e saj. Në atë kohë, era ishte fuqia më e rëndësishme që lëvizte anijet; ajo kishte një rëndësi të madhe e të domosdoshme për atë ditë.

Lëvizja e erës në flamuj dhe bajrakë tregon për ngritjen e flamurit që është shenja e fuqisë, e qeverisjes dhe shprehja e lartpërmendur është eufemizëm për këtë kuptim.

5- Më pas, ajeti urdhëron për durim përballë armikut dhe para ngjarjeve të vështira e thotë: **"...Bëhuni të durueshëm, se All'Ilahu, me të vërtetë, është me të durueshmit."**

Ndryshimi ndërmjet qëndresës së këmbëve në çështjen e parë dhe qëndresës e durimit në çështjen e pestë, është se nga njëra anë qëndresa e këmbëve përfaqëson anën e jashtme (fizike) ndërsa qëndresa dhe durimi nuk janë të dukshëm, por këto të dyja janë çështje shpirtërore dhe morale.

6- Ajeti i fundit nga këto ajete u bën thirrje myslimanëve për t'iu larguar punëve të kota dhe ngritjes së zërave të zbrazët.

Në të tregohet për çështjen e Ebu Sufjanit dhe për stilin e

mendimit të tij dhe të shokëve të tij. Ajeti thotë: **“Mos u bëni si ata (jobesimtarët e Mekës) që dolën nga shtëpitë e tyre me mendjemadhësi e për sy e faqe të botës, duke dashur t’i pengojnë njerëzit nga rruga e All’liahut...”**

Qëllimet e tyre nuk janë të shenjta, po ashtu edhe mjetet e tyre për të arritur tek ato. Ne pamë se si u shfaros dhe u shpërbë çdo gjë me të cilën ata erdhën, me forcë dhe me armatim. Disa prej tyre ranë të pllakosur në tokë në gjakun e tyre dhe të tjerët atyre u veshën lotët dhe shprehitë në vajet e tyre, në vend që të pinin verën në festën e gëzimit të tyre. Më pas, ajeti mbyllet duke thënë: **“...All’lillahu e di mirë çfarë punojnë ata.”**

Ajetet 48 - 51

وَإِذْ زَيْنَ لَهُمُ الشَّيْطَانُ أَعْمَلَهُمْ وَقَالَ لَا غَالِبَ لَكُمْ الْيَوْمَ مِنَ
النَّاسِ وَإِنِّي جَارٌ لَّكُمْ فَلَمَّا تَرَأَتِ الْفِئْتَانِ نَكَصَ عَلَى عَقِبَيْهِ وَقَالَ
إِنِّي بَرِيءٌ مِّنْكُمْ إِنِّي أَرَىٰ مَا لَا تَرَوْنَ إِنِّي أَخَافُ اللَّهَ وَاللَّهُ شَدِيدُ
الْعِقَابِ ﴿٤٨﴾ إِذْ يَقُولُ الْمُنْفِقُونَ وَالَّذِينَ فِي قُلُوبِهِم مَّرَضٌ غَرَّ
هَؤُلَاءِ دِينَهُمْ وَمَنْ يَتَوَكَّلْ عَلَى اللَّهِ فَإِنَّ اللَّهَ عَزِيزٌ حَكِيمٌ ﴿٤٩﴾
وَلَوْ تَرَىٰ إِذْ يَتَوَفَّى الَّذِينَ كَفَرُوا الْمَلَائِكَةُ يَضْرِبُونَ وُجُوهَهُمْ
وَأَدْبَرَهُمْ وَذُوقُوا عَذَابَ الْحَرِيقِ ﴿٥٠﴾ ذَلِكَ بِمَا قَدَّمْت أَيْدِيكُمْ
وَأَنَّ اللَّهَ لَيْسَ بِظَلَمٍ لِلْعَبِيدِ ﴿٥١﴾

"Djalli ua zbukuroi atyre veprat e këqija dhe u tha: 'Askush në botë nuk do t'ju mundë sot dhe unë jam mbrojtësi juaj'. Mirëpo, kur u ndeshën dy ushtritë (me engjëjt përkrah besimtarëve), ai u kthye nga thembrat e tij dhe u tha (jobesimtarëve): 'Unë nuk kam të bëj me ju; unë shoh atë që ju nuk e shihni dhe i frikësohem All'lahut, sepse All'lahu ndëshkon ashpër.'"

"Hipokritët dhe ata që kishin sëmundje (dyshim) në zemrat e veta, thoshin: 'Këta i ka mashtruar feja e tyre!' Por ai që mbështetet tek All'Ilahu, me të vërtetë, do ta gjejë Atë të Plotfuqishëm dhe të Urtë."

"Eh, sikur të shihje sesi engjëjt ua marrin shpirtrat mohuesve! I godasin ata në fytyrë dhe shpinë (duke u thënë): 'Shijoni dënimin e zjarrit!'"

"Kjo është për shkak të asaj që keni bërë me duart tuaja, sepse All'Ilahu nuk është i padrejtë me robërit e Vet."

Komentimi

Politeistët, hipokritët dhe ngacmimet e shejtanit

Edhe një herë tjetër vërejmë në këto ajete formësimin e një ane tjetër të luftës së Bedrit, me atë që përshtatet me ajetet e mëparshme në këtë çështje, ose me atë që përshtatet me ajetin e fundit, ku flitet për veprat (punët) satanike të politeistëve në Ditën e Bedrit.

Thirrësit e të vërtetës ndihmohen nga All'Ilahu dhe engjëjt e Tij. Në rrugën që ndoqën pasuesit e të kotës dhe të humburit, ata janë të ndikuar nga ngacmimet e shejtanit dhe nga kurthet e tij.

Në disa prej ajeteve të mëparshme pamë se si engjëjt i mbrojtën luftëtarët myslimanë në Bedër. Ajeti i parë nga këto ajete që janë objekt studimi, flet për mbrojtjen e shejtanëve ndaj

politeistëve. Në fillim, ajeti thotë: **“Djali u zbukuroi atyre veprat e këqija...”**

Zbukurimi i veprave nga shejtani ndodh nëpërmjet vënies në lëvizje të ndjenjave, epsheve dhe veseve të këqija. Kështu, njeriut i zbukurohet vepra (puna) e tij, derisa ta shohë atë me pëlqim, mahni dhe ta konsiderojë si një vepër të arsyeshme nga të gjitha anët, si një mendim të arsyeshëm e fisnik.

Më pas, ajeti thotë: **“...dhe u tha: 'Askush në botë nuk do t'ju mundë sot dhe unë jam mbrojtësi juaj...'"**

Nuk kam për të kursyer asnjë mundësi për t'ju ndihmuar; do t'ju ndihmoj ashtu siç ndihmon fqinji-fqinjin e tij, ndërsa i tregon besnikëri dhe sinqeritet. Unë do të jem pas jush ashtu siç qëndron hija pas trupit.

Ndoshta këtu në këtë ajet, në komentimin e fjalës *“xharun lekum”*, nuk është për qëllim fqinji afër shtëpisë, por ai që e ndihmon tjetrin dhe i jep besën se do ta mbrojë, sepse nga tradita e arabëve, veçanërisht fiset dhe disa prej grupimeve të fuqishme prej tyre, i garantonin dikujt se ishte në besën e tyre prej shokëve të tyre dhe se do t'i ofronin mbrojtje me çdo forcë që kishin.

Edhe shejtani u jep shokëve (pasuesve) të tij politeistë sigurinë dhe kartën e azil kërkuetit.

Më pas, ajeti thotë: **“...Mirëpo, kur u ndeshën dy ushtritë (me engjëjt përkrah besimtarëve), ai u kthye nga thembrat e tij dhe u tha (jobesimtarëve)...”**. Pra, u justifikua për zbrapsjen e tij me dy argumente, të cilët janë:

Së pari, thënia e tij: **“...unë shoh atë që ju nuk e shihni...”**

Ai shikonte shenjat e fitores shumë qartë në fytyrat e zemëruara të myslimanëve. Në to shihnte shenjat e mirësisë së All'Ilahut, të ndihmës së fshehtë dhe mbështetjen e engjëjve për ta. Kështu që natyrisht që do të zbrapset nga të gjitha këto ndihmesa të All'Ilahut dhe këto fuqi të fshehta.

Së dyti, thënia e shejtanit: **“...dhe i frikësohem All'Ilahut...”**

Sepse ndëshkimi i All'Ilahut nuk është çështje e lehtë që mund t'i bëjë ballë, por është dënim i dhimbshëm: **“...sepse All'Ilahu ndëshkon ashpër.”**

A u erdhi shejtani atyre nëpërmjet ngacmimit, apo iu personifikua fizikisht?

Ndërmjet komentuesve është folur rreth çështjes së ndikimit të shejtanit në zemrat e politeistëve, fjalës së tij në fushën e Bedrit dhe mënyrës se si ndodhi ky ndikim. Të gjitha mendimet e hershme dhe të mëvonshme përmbledhen në dy interpretime:

1- Disa besojnë se kjo çështje ndodhi nëpërmjet ngacmimeve të brendshme, ngaqë ua zbukuroi atyre veprat në sytë e tyre dhe ua pasqyroi sikur ata zotëronin fuqi që nuk mposhtet. I mashtrou dhe ua pasqyroi se vetëm tek ai do të gjenin strehim, veçse ata pas luftës së rreptë me myslimanët dhe ngjarjeve të mrekullueshme që realizuan fitoren për myslimanët, i rrënuan ngacmimet nga zemrat e tyre. Ata e ndjenë thyerjen dhe nuk kishte për ta strehim në asnjë vend vetëm se në atë që i priste nga ndëshkimi i All'Ilahut dhe dënimi i rreptë.

2- Disa të tjerë besojnë se shejtani iu shfaq atyre në formën

e njeriut. Në një transmetim që librat e hadithit e kanë transmetuar më shumë, thuhet: Kurejshët, kur vendosën të marshojnë drejt Bedrit, kishin frikë se mos sulmoheshin nga fisi Beni Kinaneh për një grindje që kishte ndodhur mes tyre. Atëherë u erdhi shejtani (Iblisi), në pamjen e Suraka ibn Malikut, i cili ishte prej të parëve të fisit Beni Kinaneh, dhe i siguroi ata se fisi i tyre i përkrah në këtë çështje e se ata do të fitonin. Por ai (shejtani) u zmbrajs kur pa zbritjen e engjëjve. U largua menjëherë dhe ushtria u mund nga goditjet e rrepta të myslimanëve.

Kurejshët, pasi u kthyen në Mekë, thanë: “Suraka ishte shkaku për humbjen e ushtrisë”. Atëherë i shkoi lajmi Surakës, i cili u betua se nuk kishte njohuri për atë ngjarje. Kur disa prej njerëzve i treguan atij se çfarë kishte thënë ditën e Bedrit, ai i mohoi të gjitha ato fjalë, u betua se nuk kishte dalë nga Meka dhe se nuk i kishte ndodhur asgjë nga këto që thuhën. Nga kjo u kuptua se ai që u dha garanci Kurejshëve nuk ishte Suraka ibn Maliku.¹

Argumenti i grupit të parë të komentuesve është që Iblisi nuk mund të formësohet në formën e njeriut.

Ndërkohë që grupi i dytë beson se asnjëherë nuk ekziston argument për pamundësinë e kësaj çështjeje. Transmetohet se kjo ngjarje i përngjan një ndodhie në kohën e emigrimit të Profetit (*Paqja dhe bekimi i All'Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), kur erdhi një njeri në pamjen e një të moshuari nga krahina e Nexhdit në vendin e kuvendimit (Dar En Nedua), duke shtuar se konteksti

¹ E transmetuar shkurtimisht nga Tefsiri “Mekhmaul Bejjan, nga Tefsiri “Nuruth Thekalejn” dhe nga të gjithë tefsiret e tjera.

i ajetit dhe paraqitja e jashtme e bashkëbisedimit, përshtatet me formësimin e shejtanit.

Sido që të jetë, ajeti tregon se nëse njerëzit ecin në rrugën e të vërtetës, ose të kotës në çështjet e përbashkëta (kolektive), një mori përkrahjesh dhe fuqish të fshehta ose fuqish satanike, do të jenë në lëvizje me to. Edhe ata që ecin në rrugën e së vërtetës dhe nën urdhëresat e All'Ilahut, duhet të bëjnë kujdes nga kjo çështje.

Ajeti vijues tregon për gjendjen shpirtërore të atyre që anonin nga politeizmi në ditën e Bedrit. Në të thuhet:

“Hipokritët dhe ata që kishin sëmundje (dyshim) në zemrat e veta, thoshin: 'Këta i ka mashtruar feja e tyre...'”; kjo në një kohë kur ata menduan se do të fitonin mbi myslimanët për shkak të numrit të pakët dhe armatimit të pakët të myslimanëve dhe se ata do të arrinin martirizimin dhe jetën e pafundme në këtë drejtim.

Por këta, për shkak të mosbesimit dhe paditurisë mbi çështjen e ndihmesës së All'Ilahut, i mohuan ato fakte të qarta, sepse ashtu siç edhe thotë ajeti i begatë:

“...Por ai që mbështetet tek All'Ilahu, me të vërtetë, do ta gjejë Atë të Plotfuqishëm dhe të Urtë.”

Komentuesit nuk janë në pajtim në qëllimin e kuptimit të fjalës” (hipokritët): **“dhe ata që kishin sëmundje (dyshim) në zemrat e veta...”**

Nuk përjashtohet mundësia që këto dy shprehje të tregojnë për hipokritët në Medine, sepse Kur’ani fisnik, kur përmend çështjen e hipokritëve në fillim të sures “El Bekare”, thotë:

“Zemrat e tyre kanë sëmundje, e All'llahu ua shtoi atyre sëmundjen.”¹

Këta që përmend ajeti që është objekt studimi, ose janë prej hipokritëve që hynë në radhët e myslimanëve të Medines, të cilët e shprehnin dhe paraqisnin Islamin, besimin, por në të vërtetë nuk ishin të tillë; ose mund të jenë nga ata që u paraqitën me besim që në Mekë, por nuk emigruan për në Medine dhe në luftën e Bedrit iu bashkangjitën radhëve të politeistëve. Kur panë pakicën e myslimanëve në luftën e Bedrit përballë ushtrisë së politeistëve, ata thanë: “Këta (myslimanët) i ka mashtruar feja e tyre e re dhe erdhën në këtë fushë për të luftuar”.

Sidoqoftë, All'llahu i Lartësuar tregon për qëllimet e fshehta që ata kanë dhe e bën të qartë mënyrën e gabuar të mendimeve të tyre dhe të ngjashmëve me këta.

Ajeti vijues personifikon mënyrën e vdekjes së politeistëve dhe fundin e jetës së tyre. Ajeti i drejtohet me kumtesë Profetit (*Paqja dhe bekimi i All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) dhe i thotë: **“Eh, sikur të shihje sesi engjëjt ua marrin shpirtrat mohuesve! I godasin ata në fytyrë dhe shpinë (duke u thënë): 'Shijoni dënimin e zjarrit!'”**

Edhe pse folja “*tera*” (t'i shihje) në gjuhën arabe është folje e tashme e vazhdueshme, prania e fjalës “*leu*” (sikur) tregon për kohën e shkuar. Kështu që ajeti është tregues për gjendjen e shkuar të politeistëve dhe për vdekjen e tyre të dhimbshme. Prandaj disa prej komentuesve mendojnë se ky është tregues për

¹ Sure “El Bekare”, ajeti 10.

vrasjen e atyre nga duart e engjëjve në Bedër. Në lidhje me këtë, ata kanë paraqitur disa transmetime të pakonfirmuara. Të dhënat, siç e treguam më lart, tregojnë për mosndërhyrjen e engjëjve në mënyrë të drejtpërdrejtë në luftë ose betejë. Duke u bazuar në këtë shpjegim, ajeti që është objekt studimi flet për engjëjt e vdekjes, për mënyrën e marrjes së shpirtave dhe për ndëshkimin e dhimbshëm që iu jepet armiqve të së vërtetës në ato çaste.

Ndërsa fraza “Shijoni dënimin e djegies!” është tregues për dënimin në Ditën e Kiametit dhe ndëshkimin në të. Kjo shprehje ka ardhur në ajete të tjera të Kur’anit, si në ajetin 22 të sures “El Haxh” dhe në ajetin 10 të sures “El Mearixh” me të njëjtin kuptim.

Më pas, atyre u thuhet: **“Kjo është për shkak të asaj që keni bërë me duart tuaja...”**

Shprehja “*ejdikum*” (duart tuaja), thuhet sepse shumica e veprave të njeriut kryhen me dorë, por ajeti këtu përfshin të gjitha veprat fizike dhe morale.

Ajeti i fundit thotë: **“...sepse All'illahu nuk është i padrejtë me robërit e Vet.”**

Termi “*Edh Dhal'lam*” është nga format e ekzagjerimit dhe kuptimi i tij është “Shumë i padrejtë”.

Ajetet 52 - 54

كَدَّابِ ءَالَ فِرْعَوْنَ وَالَّذِينَ مِنْ قَبْلِهِمْ كَفَرُوا بِآيَاتِ اللَّهِ فَأَخَذَهُمُ اللَّهُ
 بِذُنُوبِهِمْ إِنَّ اللَّهَ قَوِيٌّ شَدِيدُ الْعِقَابِ ﴿٥٢﴾ ذَلِكَ بِأَنَّ اللَّهَ لَمْ يَكُ مُغَيِّرًا
 نِعْمَةً أَنْعَمَهَا عَلَىٰ قَوْمٍ حَتَّىٰ يُغَيِّرُوا مَا بِأَنْفُسِهِمْ وَأَنَّ اللَّهَ سَمِيعٌ عَلِيمٌ
 ﴿٥٣﴾ كَدَّابِ ءَالَ فِرْعَوْنَ وَالَّذِينَ مِنْ قَبْلِهِمْ كَذَّبُوا بِآيَاتِ رَبِّهِمْ
 فَأَهْلَكْنَاهُمْ بِذُنُوبِهِمْ وَأَغْرَقْنَا ءَالَ فِرْعَوْنَ وَكُلُّ كَاذِبٍ ظَلِيمٍ ﴿٥٤﴾

"Kështu u ndodhi edhe ithtarëve të Faraonit dhe atyre që kanë qenë para tyre. Ata i mohuan shpalljet e All'Ilahut dhe Ai i dënoi për shkak të gjynaheve të tyre. Me të vërtetë, All'Ilahu është i Fuqishëm dhe ndëshkon ashpër."

"Kjo ndodh se All'Ilahu nuk ia ndryshon kurrë një mirësi që ia ka dhënë një populli, derisa ata të ndryshojnë atë që kanë në veten e tyre. Vërtet, All'Ilahu dëgjon dhe di gjithçka."

"(Sjelljet e jobesimtarëve të Mekës) ngjajnë me sjelljet e ithtarëve të Faraonit dhe të tjerëve që jetuan para tyre. Ata i përgënjeshtroan shpalljet e Zotit të tyre dhe kështu Ne i shkatërruam për shkak të gjynaheve të tyre, ndërsa ithtarët e Faraonit i fundosëm. Të gjithë ata ishin të padrejtë."

Komentimi

Vendimi dhe caktimi i All'Ilahut nuk pranon ndërhyrje dhe ndryshime

Në këto ajete tregohet për ligjin e përhershëm të All'Ilahut, që ka të bëjë me popujt, kombet dhe shoqëritë, në mënyrë që të mos mendojnë disa njerëz se ajo çfarë i preku politeistët në Ditën e Bedrit, ishte diçka e jashtëzakonshme, sepse çdokush që ka bërë të tilla vepra në të shkuarën, apo do t'i veprojë ato në të ardhmen, do të marrë të njëjtin ndëshkim.

Ajeti i parë nga ajetet që po studiojmë, thotë: **“Kështu u ndodhi edhe ithtarëve të Faraonit dhe atyre që kanë qenë para tyre. Ata i mohuan shpalljet e All'Ilahut dhe Ai i dënoi për shkak të gjynaheve të tyre. Me të vërtetë, All'Ilahu është i Fuqishëm dhe ndëshkon ashpër.”**

Bazuar në këtë ajet, Kurejshët, politeistët dhe adhuruesit e putave në Mekë, të cilët i mohuan argumentet e All'Ilahut, madje qëndruan përballë të vërtetës dhe i luftuan udhëheqësit e njerëzimit, nuk janë të vetmit që morën ndëshkimin për atë çka vepruan. Ai ndëshkim është një ligj i vazhdueshëm, një vendim dhe caktim i All'Ilahut, i cili përfshin edhe më të fuqishmit se ata – ashtu si familjen e Faraonit – por edhe popujt e dobët.

Ajeti vijues e qartëson origjinën e kësaj çështjeje dhe thotë: **“Kjo ndodh se All'Ilahu nuk ia ndryshon kurrë një mirësi që ia ka dhënë një populli, derisa ata të ndryshojnë atë që kanë në veten e tyre. Vërtet, All'Ilahu dëgjon dhe di gjithçka.”**

Me fjalë të tjera, mëshira e All'Ilahut është e përgjithshme dhe i përfshin të gjitha krijesat, por kjo mëshirë u arrin njerëzve me atë që u përshtatet aftësive dhe çështjeve të tyre. Kështu që

All'lahu i Lartësuar, fillimisht jep mirësitë (begatitë) e Tij materiale dhe morale të gjithë njerëzve. Nëse ata i përdorin këto mirësi në rrugëtimin e tyre drejt përsosmërisë, për të arritur të vërtetën dhe për ta falënderuar All'llahun e Lartësuar për ato mirësi, atëherë All'lahu i Lartësuar do t'ua bëjë të qëndrueshme ato mirësi dhe do t'ua shtojë ato. Nëse shfrytëzohen ato dhunti për tirani, devijim dhe racizëm si edhe për mohimin e të mirave, kryeneçësi dhe shkatërrim, All'lahu do t'ua marrë ato mirësi atyre dhe do t'ua shndërrojë në sprova e fatkeqësi. Duke u bazuar në këtë, ndryshimi vjen gjithmonë prej nesh; në të kundërt, mirësitë e All'llahut nuk ikin kurrë.

Duke e komentuar këtë qëllim, Kur'ani kthehet për të treguar gjendjen e tiranëve - si Faraonin dhe popujt e tjerë - dhe thotë: **“(Sjelljet e jobesimtarëve të Mekës) ngjajnë me sjelljet e ithtarëve të Faraonit dhe të të tjerëve që jetuan para tyre. Ata i përgënjeshtroan shpalljet e Zotit të tyre dhe kështu Ne i shkatërroam për shkak të gjynaheve të tyre, ndërsa ithtarët e Faraonit i fundosëm. Të gjithë ata ishin të padrejtë.”** Ata i bënë padrejtësi vetes, por edhe të tjerëve.

Përgjigje për një pyetje

Këtu mund të na lindë një pyetje, e cila është: Përse shprehja **“Kështu u ndodhi edhe ithtarëve të Faraonit”**, është përsëritur dy herë në ajete, me një ndarëse të shkurtër dhe me një ndryshim të lehtë?

Për t'iu përgjigjur kësaj pyetjeje duhet patur parasysh diçka interesante që është: Megjithëse përsëritja apo përforcimi i çështjeve delikate janë prej bazave të retorikës, që vërehen në thëniet e retoricienëve dhe gjuhëtarëve, por në ajetet në fjalë ka një

dallim të rëndësishëm që e nxjerr këtë shprehje nga forma e përsëritjes, sepse në ajetin e parë tregohet për ndëshkimin e All'Ilahut kundrejt mohimit të argumenteve të vërteta dhe të përgënjeshtimit të tyre, pastaj pasqyrohet gjendja e këtyre me popullin e Faraonit dhe të popujve të mëparshëm.

Në të vërtetë, një pjesë e thënies është për largimin e mirësive dhe pjesa tjetër është për ndryshimin e mirësive dhe transformimin e tyre.

Hulumtime

Shkaqet e jetesës së popujve dhe të vdekjes së tyre

Historia na paraqet popuj dhe kombe të ndryshëm. Një grup arriti të ngjisë shkallët e lartësimit e të përparimit me shpejtësi, grupi i dytë ra në etapat më të ulëta të rrënimit, grupi i tretë jeton në hallakatje, humbje, rivalitet, përçarje dhe më pas u fuqizua, ndërsa grupi i katërt, në të kundërtën e tyre, ra nga pozitat më të larta të krenarisë në shkallën më të poshtme të luginës së poshtërimit dhe të humbjes.

Shumë prej njerëzve kalojnë pa i vënë re ngjarjet e ndryshme historike, duke mos bërë asnjë meditim rreth tyre. Shumë prej tyre, në vend të hulumtimit të shkaqeve dhe arsyeve reale të jetesës së popujve dhe shkatërrimit apo vdekjes së tyre, ua adresojnë ato shkaqeve të paqena dhe imagjinare.

Ndërsa disa të tjerë ua adresojnë lëvizjes së planeteve dhe rrotullimit të tyre pozitivisht dhe negativisht.

Së fundmi, disa prej tyre gjetën arsye tek çështja e vendimit dhe caktimit, por me konceptin e tyre të shtrembër, ose tek çështjet e fatit të mirë e të keq. Kështu, çdo ngjarje të mirë, apo të keqe, ata ua adresojnë këtyre çështjeve. E gjithë kjo për shkak të frikës së shkaqeve të vërteta të tyre.

Në ajetet e mëparshme, Kur'ani Fisnik vendos gishtin e hetimit mbi origjinë dhe mbi burim dhe qartëson llojet e kurave, shkaqet e fitores e të humbjes. Kur'ani thotë se për të njohur shkaqet e qenësishme, nuk është e nevojshme të kërkosh në qiej e në tokë, as të shkosh pas përfytyrimeve dhe imagjinatës, por ato duhet të kërkohen në qenien tuaj, në të menduarit tuaj, në shpirtrat, në moralin dhe në sistemet tuaja shoqërore.

Popujt që kanë menduar me kujdes, që kanë vënë në lëvizje logjikën, që i kanë bashkuar forcat dhe janë vëllazëruar ndërmjet tyre, që kanë qenë me vullnet të fortë dhe kanë sakrifikuar kur ka qenë e domosdoshme, këta pa dyshim që janë popuj fitimtarë.

Nëse dobësia, poshtërimi dhe dembelizmi zënë vendin e punës e të përpjekjeve të vazhdueshme, prapambetja zë vendin e zhvillimit, hipokrizia dhe përçarja zënë vendin e unitetit e të bashkimit, egoizmi zë vendin e flijimit, mburrja dhe të shtirurit zënë vendin e sinqeritetit e të besimit, atëherë nis rënia dhe fatkeqësia.

Në të vërtetë, fjalia: **“Kjo ndodh se All’Ilahu nuk ia ndryshon kurrë një mirësi që ia ka dhënë një populli, derisa ata të ndryshojnë atë që kanë në veten e tyre...”** sqaron ligjin më të lartë të jetës dhe qartëson se shkolla e Kur'anit të shenjtë është shkolla ideologjike më fisnike për jetën e shoqërive njerëzore. Madje, ajo është shkolla më e qartë edhe për ata, të cilët në kohën

e kozmosit e të atomit kanë harruar vlerën e njeriut dhe çdo gjë e lidhin me fabrikat, uzinat e me çështjet ekonomike.

Shkolla e Kur'anit thotë: *Vërtet, ju gabuat shumë kur morët pasojën dhe latë shkakun origjinal, ose e harruat atë. Ju u kapët me një degë prej degëve të pemës së madhe dhe e braktisët trungun e saj.*

Mos të shkojmë shumë larg, sepse historia e Islamit, apo më mirë historia e jetës së myslimanëve, dëshmon për triumfe madhështore në fillimet e saj e pas tyre, për thyerje e mposhtje të vështira e të hidhura.

Në shekujt e parë, Islami u përhap me shpejtësi në botë dhe në çdo vend përçonte dritat e dijes e të lirisë. Ai e shpërndau hijen e tij në popuj duke përhapur shkencat dhe kulturën. Ai vuri në lëvizje mendjet dhe solli një qytetërim të lulëzuar e të pashoq në historinë e njerëzimit. Mirëpo, nuk kaluan shumë kohë kur dembelizmi dhe plogështia zunë vendin e lëvizjes. Përçarja, dobësimi, ndarja, prapambetja etj., zunë vendin e përparimit e të lartësimit, derisa myslimanët filluan të zgjasin duart e tyre nga të tjerët në kërkim të mjeteve më të thjeshta të jetesës. Ata filluan të dërgojnë fëmijët e tyre në vendet e huaja për të marrë dije e kulturë, ndërkohë që universitetet myslimane ishin më të lartat nga ana e dijes dhe e shkencës si dhe qendra e dëshirave të miqve e të armiqve për t'u pajisur me njohuri. Mirëpo çështja arriti deri në atë cak, ku ata nuk eksportuan asgjë, as dije e as prodhim, përkundrazi importuan nga jashtë vendeve të tyre gjithçka për të cilën kishin nevojë.

Tokën e Palestinës, e cila ishte qendra e krenarisë dhe e madhështisë së myslimanëve, për dyqind vjet me radhë kryqëtarët nuk arritën ta merrnin nga duart e luftëtarëve, edhe pse u vranë e u plagosën me miliona. Por erdhi një kohë kur ata e lëshuan për gjashtë ditë e me lehtësinë më të madhe. Ndërkohë, ata

organizojnë ndër vite konferenca të ndryshme për të rikthyer një pëllëmbë tokë prej saj dhe akoma nuk dihet se ku do të arrijnë.

All'llahu u ka premtuar robëve të Vet duke u thënë: **“...Është detyra Jonë që t'i ndihmojmë besimtarët.”**¹

Ai ka thënë: **“...Në të vërtetë, fuqia është e All'llahut, e të Dërguarit të Tij dhe e besimtarëve...”**²

Dhe: **“Ne shënuam në Zebur, pas Teuratit, që tokën do ta trashëgojnë robërit e Mi të mirë.”**³

Vallë, a është i pafuqishëm All'llahu (Zoti na ruajtë!) në realizimin e premtimeve të Tij? A i harroi ato? Apo i ndryshoi? Nëse nuk është i tillë, atëherë ku shkoi e gjithë ajo krenari, madhështi e lartësim?

Vërtet, Kur'ani në këtë ajet të shkurtër u përgjigjet të gjitha atyre pyetjeve dhe fton në kthimin në brendinë e vetave dhe do të shihni se ndryshimi ka filluar në vetat tuaja dhe se mirësitë dhe begatitë e All'llahut i përfshijnë të gjithë. Ju jeni ata që i shpërdoruat aftësitë, fuqitë dhe mundësitë tuaja dhe arritët aty ku jeni.

Ajeti nuk flet vetëm për të shkuarën, që të thuhet se ajo ka kaluar me gjithë hidhërimet e gëzimet, një e shkuar që nuk kthehet e që nuk sjell dobi, por gjithashtu flet edhe për të ardhmen. Nëse ju ktheheni tek All'llahu, i forconi themelet e besimit tuaj, logjikoni drejt, i kujtoni premtimet dhe përgjegjësitë tuaja, i shtrëngoni dorën njëri-tjetrit dhe përpiqeni e sakrifikoni me vepra në çdo fushë, atëherë ujërat do të ecin në rrjedhën e tyre, ditët e errëta do të largohen, do të shihni horizonte të ndriçuara

¹ Sure “Er Rum”, ajeti 47.

² Sure “El Munafikun”, ajeti 8.

³ Sure “El Enbija”, ajeti 105.

dhe do t'ju kthehet krenaria e madhështia më e madhe dhe më e ndritur se më parë.

Ndryshoni vetet dhe gjendjen tuaj. Dijetarët tuaj të shkruajnë, luftëtarët tuaj të luftojnë, tregtarët dhe punëtorët tuaj të përpiqen, të rinjtë tuaj të lexojnë e të studiojnë më shumë, të pastrojnë shpirtrat e tyre dhe të shtojnë njohuritë e tyre; një gjak i ri të qarkullojë nëpër damarët e shoqërisë tuaj, me qëllim që të duken aftësitë dhe mundësitë tuaja. Në këtë mënyrë, armiku juaj do t'ua kthejë çdo pëllëmbë toke nga toka juaj.

Është e domosdoshme që të përmendim se udhëheqja ndikon shumë në rrugëtimin e popujve. Nuk duhet të harrojmë se popujt që kuptojnë, zgjedhin për vete një udhëheqje të urtë e të përshtatshme. Kurse udhëheqësit e dobët, mendjemëdhenj apo të padrejtë, do t'i shporrë e do t'i zhdukë zemërimi i popujve dhe vullneti i tyre i fortë. Nuk duhet të harrojmë se besimtarët e sinqertë kanë gjithmonë mbështetjen e All'llahut.

Nuk ka imponim në dënim e as në çështje të tjera

Një tjetër tematikë e rëndësishme që përçohet qartë nga këto ajete është se për njeriun nuk ka ndonjë përfundim të posaçëm e të caktuar më parë. Njeriu as nuk ndikohet prej atij që quhet imponim i historisë dhe i kohës, sepse historinë së bashku me ndryshimet që ndodhin në jetë i bën vetë ai. Bazuar në këtë, ata që besojnë në caktimin dhe vendimin e imponuar dhe thonë se të gjitha çështjet dhe ndodhitë ndodhin me dëshirën dhe vullnetin e All'llahut, e marrin përgjigjen nga ky ajet.

Çdo gjë që thuhet për imponimin a detyrimin, e kundërshton Kur'ani, shkolla islame, sepse njeriu është i lirë dhe ai është që e vendos mënyrën e të jetuarit dhe rrugëtimin në jetë.

Vërtet, njeriu është ai që ka në dorë vetë çështjet e veta. Ai e çon veten e tij në vështirësi e poshtërsi. Gjithashtu, ai e çon veten e tij drejt krenarisë, triumfit dhe lumturisë. Në dorën e tij është sëmundja dhe ilaçi. Nëse ai nuk e ndryshon veten e tij dhe nuk përpiqet në ndërtimin e personalitetit të tij, atëherë nuk do të përparojë kurrë.

Ajetet 55 - 59

إِنَّ شَرَّ الدَّوَابِّ عِنْدَ اللَّهِ الَّذِينَ كَفَرُوا فَهُمْ لَا يُؤْمِنُونَ ﴿٥٥﴾
 الَّذِينَ عَاهَدتَّ مِنْهُمْ ثُمَّ يَنْقُضُونَ عَهْدَهُمْ فِي كُلِّ مَرَّةٍ
 وَهُمْ لَا يَتَّقُونَ ﴿٥٦﴾ فَمَا تَتَّقِفْنَهُمْ فِي الْحَرْبِ فَشَرِدَ بِهَم مِّنْ
 خَلْفِهِمْ لَعَلَّهُمْ يَذَّكَّرُونَ ﴿٥٧﴾ وَإِمَّا تَخَافَنَّ مِنْ قَوْمٍ خِيَانَةً
 فَانْبِذْ إِلَيْهِمْ عَلَى سَوَاءٍ ۗ إِنَّ اللَّهَ لَا يُحِبُّ الْخَائِبِينَ ﴿٥٨﴾ وَلَا
 تَحْسَبَنَّ الَّذِينَ كَفَرُوا سَبَقُوا ۗ إِنَّهُمْ لَا يُعْجِزُونَ ﴿٥٩﴾

"Krijesat më të këqija tek All'Ilahu janë ata që mohojnë dhe që nuk do të besojnë."

"Janë ata me të cilët ke bërë marrëveshje, por që çdo herë e shkelin atë dhe nuk frikësohen."

"Nëse ti i ndesh ata në luftë, shpartalloji, që të vënë mend ata që vijnë pas tyre."

"Nëse ke frikë se ndonjë fis e thyen besën, edhe ti prishja marrëveshjen me të njëjtën mënyrë, sepse All'Ilahu nuk i do ata që tradhtojnë."

"Le të mos mendojnë kurrsesi ata që nuk besojnë se do të fitojnë, sepse nuk mund të Na pengojnë."

Komentimi

Përballje me atë që kundërshton ashpër marrëveshjen

Në këto ajete të begata tregohet për një grup tjetër prej armiqve të Islamit, të cilët u dhanë goditje të dhimbshme myslimanëve në kohën e Profetit (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), kohë e cila ishte e mbushur me shumë ngjarje. Mirëpo, ata armiq morën atë që vepruan vetë, që ishte diçka e hidhur, dhe ajo ishte humbja. Ata ishin jehudinjtë e Medinës, të cilët bënë disa herë marrëveshje me Profetin (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*).

Këto ajete sqarojnë metodën e ashpër që duhet të ndërmerrete Profeti ndaj tyre, metodë e cila përmban mësim edhe për të tjerët dhe ishte larguese e rrezikut të këtij grupi.

Ajeti i parë prej ajeteve në fjalë, e përshkruan këtë grup si më të këqinjët e krijesave që ekzistojnë në këtë jetë. Ai thotë: **“Krijesat më të këqija tek All'llahu janë ata që mohojnë dhe që nuk do të besojnë.”**

Ka mundësi që fraza **“ata që mohojnë”** të tregojë se shumica e jehudinjëve në Medinë kishin lajmëruar dashurinë e tyre për Profetin (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) dhe besimin e tyre para se ai të vinte, sipas asaj që kishin të shkruar në librat e tyre. Madje ata ftonin njerëzit dhe parapërgatisnin ardhjen e tij. Mirëpo, pasi Profeti erdhi dhe panë që interesat e tyre materiale i kërcënonte rreziku, ata e mohuan atë dhe shfaqën kokëfortësinë e ashpër ndaj kësaj çështjeje derisa nuk

mbeti asnjë pikë shprese nga besimi i tyre, siç thotë edhe Kur'ani:
“dhe që nuk do të besojnë.”

Ajeti vijues thotë: **“Janë ata, me të cilët ke bërë marrëveshje, por që çdo herë e shkelin atë...”**¹ Të paktën ata të ruanin asnjë besim dhe të mos u bënin keq myslimanëve e as të përkrahnin armiqtë kundra tyre. Ata as nuk i frikësohen All'Ilahut të Madhëruar, as nuk duan t'ia dinë për kundërshtimin e urdhrave të Tij dhe as nuk kujdesen për parimet njerëzore e humane: **“...dhe nuk frikësohen.”**

Përshkrimet me thëniet **“e shkelin”** dhe **“dhe nuk frikësohen”** janë folje në kohën e tashme dhe ky lloj përshkrimi tregon vazhdimësi. Po ashtu, ai tregon se ata i shkelnin vazhdimisht marrëveshjet, çka jepet qartë në frazën **“çdo herë”**.

Ajeti tjetër prej ajeteve në fjalë sqaron metodën e përballjes me ata, ku thotë: **“Nëse ti i ndesh ata në luftë, shpartalloji dhe ata që vijnë pas tyre...”**, pra, luftoju ata në mënyrë shkatërruese, që grupet që do të vijnë pas tyre të nxjerrin mësim e të ndahen prej tyre.

Fraza **“tethkifennehum”** është marrë nga fjala **“eth thekf”**, që ka kuptimin e arritjes së diçkaje me shpejtësi e hollësi. Ajo tregon për obligimin e vëmendjes dhe njohjen e shpejtë dhe të hollësishme të vendimeve të tyre dhe përgatitje për t'u dhënë një

¹ Fjala **“min”**, prej, në frazën **“minhum, prej tyre”**, ose mund të jetë me kuptimin e përveçimit të disave. Kështu, këtu ajo ka kuptimin: Ti bërë marrëveshje me parinë e tyre dhe me të njohurit e tyre prej jehudinjëve të Medines; ose ka kuptimin e lidhshmërisë, pra të marrëveshjes.

goditje të fuqishme si rrufeja, përpara se ata të të surprizojnë ty me ndonjë sulm.

Fjala *"sherr' rrede"* rrjedh nga *"et teshrijdu"* dhe ka kuptimin e ndarjes së shoqëruar me shqetësim. Pra, duhet që sulmi ndaj tyre të jetë në atë mënyrë që grupet e tjera, prej armiqve dhe shkelësve të marrëveshjes, të ndahen prej tyre dhe të mos mendojnë për sulm ndaj jush. Ky urdhër ka ardhur që armiqtë e tjerë të marrin mësim. Madje edhe armiqtë në të ardhmen gjithashtu, të heqin dorë nga lufta me myslimanët dhe nga shkeljet e marrëveshjeve me ta, apo me ata që do të bëjnë marrëveshje në të ardhmen: **"...që të vënë mend."**

Ajeti tjetër thotë: **"Nëse ke frikë se ndonjë fis e thyen besën, edhe ti prishja marrëveshjen me të njëjtën mënyrë...".** Mos e fillo sulmin ndaj tyre pa i lajmëruar për anulimin e marrëveshjes: **"...Vërtet, All'Ilahu nuk i do ata që tradhtojnë."**

Edhe pse ky ajet i jep kompetencë Profetit për prishjen e marrëveshjes kur e ndjen tradhtinë e tyre, apo shkeljen e marrëveshjes nga ata, është e qartë se frika e shkeljes nga ana e tyre nuk mund të jetë pa shkak. Por, kur ata veprojnë diçka që tregon se mendojnë për prishjen dhe shkeljen e marrëveshjes dhe bien dakord me armiqtë për sulm, kjo masë e lejon Profetin që t'i lajmërojë ata për anulimin e marrëveshjes.

Fjalja *"fenbidh ilejhim"* vjen nga fjala *"el inbadhu"* që ka kuptimin e lajmërimit, njoftimit dhe kthimit. *Pra, ti kthejua atyre marrëveshjet dhe lajmëro haptazi për anulimin e tyre.*

Përshkrimi me **“të njëjtën mënyrë”** mund të jetë ose me kuptimin që, ashtu siç e shkelën ata marrëveshjen me veprat që bënë, edhe ti anulloje atë sepse ky është gjykim i drejtë. Ose mund të jetë me kuptimin e lajmërimit të anulimit në mënyrë të qartë, pa patur në të as tradhti e as paqartësi.

Sido që të jetë, ajeti në fjalë, në kohën që paralajmëron myslimanët për shkeljen e marrëveshjes, u tërheq vëmendjen që mos kenë për qëllim sulmin ndaj armikut, por të ruajnë parimet humane në respektimin e marrëveshjeve apo në anulimin e tyre.

Ajeti i fundit prej ajeteve në fjalë u drejtohet shkelësve të marrëveshjes dhe i paralajmëron ata për fundin e asaj vepre, ku thotë: **“Le të mos mendojnë kurrsesi ata që nuk besojnë se do të fitojnë, sepse nuk mund të Na pengojnë.”**

Ajetet 60 - 64

وَأَعِدُّوا لَهُمْ مَا اسْتَطَعْتُمْ مِنْ قُوَّةٍ وَمِنْ رِبَاطِ الْخَيْلِ تُرْهَبُونَ
 بِهِ عَدُوَّ اللَّهِ وَعَدُوَّكُمْ وَءَاخِرِينَ مِنْ دُونِهِمْ لَا تَعْلَمُونَهُمُ اللَّهُ
 يَعْلَمُهُمْ ۗ وَمَا تُنْفِقُوا مِنْ شَيْءٍ فِي سَبِيلِ اللَّهِ يُوَفَّ إِلَيْكُمْ وَأَنْتُمْ
 لَا تَظْلَمُونَ ﴿٦٠﴾ وَإِنْ جَنَحُوا لِلسَّلْمِ فَاجْنَحْ لَهَا وَتَوَكَّلْ
 عَلَى اللَّهِ إِنَّهُ هُوَ السَّمِيعُ الْعَلِيمُ ﴿٦١﴾ وَإِنْ يُرِيدُوا أَنْ تَخْدَعُوكَ
 فَإِنَّ حَسْبَكَ اللَّهُ هُوَ الَّذِي أَيْدَكَ بِنَصْرِهِ وَبِالْمُؤْمِنِينَ
 ﴿٦٢﴾ وَأَلْفَ بَيْنَ قُلُوبِهِمْ ۗ لَوْ أَنْفَقْتَ مَا فِي الْأَرْضِ جَمِيعًا مَا
 أَلْفَتْ بَيْنَ قُلُوبِهِمْ وَلَكِنَّ اللَّهَ أَلْفَ بَيْنِهِمْ ۗ إِنَّهُ عَزِيزٌ حَكِيمٌ
 ﴿٦٣﴾ يَا أَيُّهَا النَّبِيُّ حَسْبُكَ اللَّهُ وَمَنِ اتَّبَعَكَ مِنَ الْمُؤْمِنِينَ ﴿٦٤﴾

“Përgatisni kundër tyre sa të mundni forcë dhe prej kuajve të stërvitur, që të tmerroni armikun e All’llahut dhe armikun tuaj, si dhe të tjerë, përveç tyre, të cilët ju nuk i njihni, por që All’llahu i njih. Çfarëdo që të shpenzoni në rrugën e All’llahut, do t’ju shpërblehet dhe nuk do t’ju bëhet padrejtësi.”

“Nëse ata shfaqin prirje për paqe, atëherë edhe ti ano nga ajo dhe mbështetu tek All’Ilahu, sepse, vërtet, Ai dëgjon dhe di gjithçka.”

“Por, nëse ata synojnë të të mashtrojnë, të mjafton All’Ilahu (si Mbrotjtës). Ai të ka forcuar me ndihmën e Tij dhe me besimtarët.”

“Duke i bashkuar zemrat e tyre (si një zemër e vetme). Sikur të shpenzoje tërë pasurinë që gjendet në Tokë, nuk do të mund t’i bashkoje zemrat e tyre, por All’Ilahu i bashkoi ato. Ai është vërtet i Plotfuqishëm dhe i Urtë.”

“O Profet! All’Ilahu të mjafton ty dhe besimtarëve që të pasojnë.”

Komentimi

Shtimi i mobilizimit ushtarak dhe qëllimi i tij

Ajeti i parë këtu - në vazhdim të bisedës në ajetet e mëparshme rreth Xhihadit - tregon për një parim të rëndësishëm pas të cilit myslimanët duhet të kapen në çdo kohë dhe në çdo vend. Ai është domosdoshmëria e mobilizimit ushtarak për t'u përballur me armiqtë. Ajeti thotë: **“Përgatisni forcë kundër tyre sa të mundni...”**. Pra, mos prisni që armiku t'ju sulmojë, por përgatituni për t'u përballur me të. Madje është detyrë që ju të keni përgatitjet dhe mundësitë e duhura për të përballuar sulmet e mundshme të armiqve.

Ajeti shton: **“... dhe prej kuajve të stërvitur...”**.

Fjala "*ribatun*" ka kuptimin e lidhjes së diçkaje. Kjo përdoret më shumë me kuptimin e lidhjes së kafshës në një vend për

ruajtjen dhe kujdesjen e saj. Kjo fjalë ka ardhur këtu në përputhje me kuptimin e përgjithshëm të ruajtjes dhe të mbikëqyrjes.

Fjala "*el murabitatu*" ka kuptimin e ruajtjes së kufirit. Po ashtu, ajo vjen edhe me kuptimin e mbikëqyrjes së diçkaje tjetër. Gjithashtu, përdoret edhe për vendin e lidhjes së kafshës. Arabët kanë quajtur me këtë emër edhe vendet ku rrinin luftëtarët.

Dy hulumtime

1- Në një fjali të shkurtër, të lartpërmendur, sqarohet një parim i rëndësishëm i Xhihadit dhe i ruajtjes së ekzistencës së myslimanëve, i krenarisë, madhështisë dhe lartësisë së tyre. Fraza në ajet është e gjerë deri në atë shkallë, saqë përputhet plotësisht me çdo kohë dhe me çdo vend.

Fjala "*kuetun*" ka kuptim të gjerë dhe domethënie të thellë. Ajo nuk është e posaçme vetëm për pajisjet ushtarake dhe armatimet moderne të çdo kohe, por përfshin të gjitha llojet e fuqive dhe të mundësive që ndikojnë në fitore ndaj armiqve, qoftë materialisht apo moralisht.

Ata që mendojnë se rruga e vetme për fitore ndaj armiqve është sasia e armatimit, gabojnë shumë sepse ne shohim në kohën tonë se popuj të paktë në numër dhe me armatime jo moderne, kanë dalë fitimtarë ndaj popujve që janë më të fortë dhe që zotërojnë armë moderne të sofistikuara, siç ndodhi me popullin mysliman algjerian në përballje me shtetin e fuqishëm francez!

Bazuar në këtë dhe në shtesë të domosdoshmërisë së pajisjes me armë moderne në çdo kohë, duhet të forcohet edhe vendosmëria e ushtarëve, me qëllim që të jenë sa më të fortë.

Gjithashtu, nuk duhen neglizhuar mundësitë dhe fuqitë ekonomike, kulturore dhe politike, të cilat hyjnë nën ombrellën e “fuqisë” dhe që ndikojnë shumë te armiku.

Edhe transmetimet islame kanë përmendur komentime të ndryshme rreth kuptimit të fjalës "*kuuetun*", fuqi, forcë. Kjo zbulon kuptimin e gjerë të kësaj fjale. Në disa transmetime islame thuhet se Profeti (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ka sqaruar se kuptimi i fjalës "*el kuuetu*" është për shigjetat, heshtat dhe ushtat.¹

Në një transmetim tjetër lexojmë se qëllimi me fjalën "*el kuuetu*", fuqi, është për të gjitha llojet e armëve.²

Po ashtu, në tefsirin e Ajjashit lexojmë se kuptimi i kësaj fjale është për shpatën dhe mburojën.³

Në një transmetim tjetër lexojmë se kuptimi i saj është “lyerja me bojë të zezë”.⁴

Në Islam është e pëlqyeshme që edhe të mëdhenjtë në moshë t'i lyejnë flokët e tyre me bojë të zezë, me qëllim që armiku t'i shohë si djem të rinj e të goditet nga frika e tmerri. Kjo çështje zbulon kuptimin e gjerë të fjalës “fuqi” (*el kuuetu*).

Bazuar në këtë, ai që e komenton fjalën “fuqi” vetëm me një të vërtetë të kufizuar, ka anashkaluar shumë shpërblime. Fatkeqësisht, edhe pse gjenden këto mësim të qarta, nuk shohim te myslimanët shenja të forcimit të vendosmërisë e as të anës shpirtërore në mesin e rreshtave të tyre. Me sa duket, ata kanë harruar gjithçka. As fuqitë dhe potencialet e tyre ekonomike,

¹ Tefsiri “Nuruth Thekalejn”, vëll. 2, f. 164-165.

² Tefsiri “Nuruth Thekalejn”, vëll. 2, f. 164-165.

³ Tefsiri “Nuruth Thekalejn”, vëll. 2, f. 164-165.

⁴ Po aty.

kulturore, politike e ushtarake nuk i përdorin për t'u përballur me armiqtë e tyre.

Më e habitshmja është se edhe pse e kemi neglizhuar këtë çështje dhe e kemi lënë pas dore atë, akoma themi se jemi myslimanë! Fajin e prapambetjes e të rënies tonë ia hedhim në qafë Islamit dhe themi se nëse Islami fton në përparim e lartësim, atëherë përse ne myslimanët jemi në prapambetje?! Ne besojmë se kjo moto e madhe islame: “përgatituni atyre sa të mundeni prej fuqisë”, nëse do të jetë përgjithësuese për çdo vend, që e shqipton i madh e i vogël, i dituri e i padituri, shkrimtari dhe oratori, ushtari dhe komandanti, bujku dhe tregtari dhe e zbatojnë atë në jetën e tyre, kjo do të mjaftonte për të zhdukur prapambetjen.

Vërtet, jetëshkrimi praktik i Profetit (*Paqja dhe bekimet e All'Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) dhe i Imamëve tregon se ata kanë shfrytëzuar çdo gjë për përballjen e armikut, si: përgatitja e ushtarëve dhe e armëve, ngritja e vendosmërisë dhe forcimi i anës shpirtërore, ndërtimi i kampeve për stërvitje ushtarake, zgjedhja e kohës dhe e vendit të duhur për mësymje e sulm si dhe shfrytëzimi e përdorimi i metodave të ndryshme lutarake. Pra, Profeti ka bërë gjithçka për këtë çështje.

Është e njohur se në ditët e betejës së Hunejnit, Profetin e lajmëruan se në Jemen është prodhuar një armë e re dhe ndikuese. Ai menjëherë dërgoi njerëz në Jemen për blerjen e këtyre armëve.

Në lajmet e luftës së Uhudit lexojmë se Profeti (*Paqja dhe bekimet e All'Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) iu kundërpërgjigj slloganeve të idhujtarëve “rroftë Hebeli, rroftë Hebeli”¹, me sllogane më të forta se ajo, si “All'illahu është më i Larti, më i Madhërishti”; kurse slloganit të tyre “Ne kemi Uzanë,

¹ “Biharul Enuar”, vëll. 20, f. 23, 44 dhe 56.

kurse ju nuk keni Uza”¹, ai iu përgjigj duke thënë: “All’lillahu është Mbrotjtësi ynë, kurse ju nuk keni mbrotjtës”. Kjo çështje tregon se Profeti dhe myslimanët po ashtu, nuk e kanë neglizhuar zgjedhjen e slloganeve më të forta në përballjen e armiqve dhe kundërpërgjigjes së doktrinave dhe slloganeve të tyre.

Një prej mësimëve të rëndësishme islame në lidhje me këtë temë është garimi i kuajve dhe hedhja e shtizës dhe atë që jurisprudenca e ka lejuar për këto të dyja: fitimin dhe humbjen, pasi ai është një shembull tjetër i mendimit të thellë islam në anën e përgatitjes në përballjen e armiqve dhe nxitjes së myslimanëve për këtë gjë.

2- Mirësia tjetër e rëndësishme që e nxjerrim si përfundim nga ajeti i lartpërmendur, është universaliteti dhe përjetësia e kësaj feje hyjnore. Perceptimet e kësaj feje dhe përmbajtjet e saj me dimensionet e gjera nuk krijohen me kalimin e kohës dhe nuk dekompozohen apo abrogohen pavarësisht progresit. Kështu, fraza “**E ju përgatituni sa keni mundësi force** (mjete luftarake)” ka pasur një kuptim të gjallë para më shumë se njëmijë vitesh, ashtu siç është situata sot dhe do mbetet një kuptim i gjallë edhe për dhjetëra mijëra vite të tjera, sepse çdo armë që paraqitet në të ardhmen është e përfshirë në fjalën tubuese “*elkuv’vetu*” (forca), ku fraza “**sa keni mundësi**” është e përgjithshme, ndërsa fjala “**forcë**” është një emër i papërcaktuar që përforcon parimin e përgjithshëm të asaj fraze, që të përfshijë çdo forcë.

3- Këtu na lind një pyetje: Përse citohet shprehja “*ribatul khajli*” (kuaj të caktuar për betejë) pas fjalës “*kuv’vetun*” (forcë), e cila nuk ka kuptim të gjerë?

¹ “Biharul Enuar”, vëll. 20, f. 23, 44.

Përgjigjja e kësaj është: Pavarësisht se ajeti përmban një rregull gjithëpërfshirës për çdo kohë dhe periudhë, ai në të njëjtën kohë mbart një mesazh të rëndësishëm e specifik për kohën e Profetit, që është koha e zbritjes së Kur'anit. Në realitet, ky nocion i përgjithshëm ka sjellë një model të qartë për atë kohë, sepse kali ka qenë një prej mjeteve më të rëndësishme të luftës. Ai është një mjet i rëndësishëm për luftëtarët guximtarë dhe heronj në sulmin dhe luftimin e tyre të shpejtë dhe rëndësia e tij i ngjason rëndësisë së avionëve dhe tankeve në kohën tonë moderne.

Qëllimi i përgatitjes së armatimit dhe i shtimit të mjeteve ushtarake

Pas këtij mesazhi të rëndësishëm, Kur'ani zhvendoset në një qëllim logjik dhe njerëzor prapa kësaj teme dhe thotë: Me të vërtetë, ajo që synohet nuk është pajisja e njerëzve në mbarë botën apo në shoqërinë tuaj me lloj-lloj armësh shkatërruese, të cilat shkatërrojnë qytetet dhe djegin barin e thatë dhe të njomë, nuk synohet prej saj pushtimi i tokave të të tjerëve dhe pasuritë e tyre dhe nuk ka synim zgjerimin e kufijve dhe të kolonializimit në botë. Përkundrazi, ajo që synohet është: **“ta frikësoni armikun e All'Ilahut dhe armikun tuaj!”**

Kjo për arsye se shumica e armiqve nuk e dëgjojnë fjalën e vërtetë, nuk i përgjigjen thirrjes së logjikës dhe parimeve njerëzore dhe nuk kuptojnë asgjë tjetër veç gjuhës së forcës. Nëse myslimanët janë të dobët, atëherë armiqtë do t'i obligojnë ata me çdo gjë që dëshirojnë, por nëse ata kanë forcën e mjaftueshme, atëherë nuk ka dyshim se armiqtë e së vërtetës, të drejtësisë, të

pavarësisë dhe të lirisë do të ndjejnë frikën dhe nuk do ta mendojnë shkeljen e ligjit dhe armiqësinë.

Sot – kur ne jemi në komentimin e këtij ajeti – pa dyshim se një pjesë e tokave islame në Palestinë dhe shtete të tjera rreth saj janë shtypur nga këpucët e ushtarëve të cionizimit dhe në sulmin e tyre të fundit kanë pushtuar Libanin dhe bënë që të arratisen mijëra familje, kanë vrarë mijëra njerëz të pafajshëm, kanë shkatërruar shumë lagje dhe blloqe banesash dhe i kanë transformuar në rrënoja. Kësaj tragjedie të tmerrshme i shtuan edhe një krim tjetër regjistrit të tyre të zi ... në kohën që opinioni publik ndërkombëtar e dënoi këtë veprim të shëmтуar, edhe miqtë e Izraelit, Shtetet e Bashkuara, dhanë një deklaratë duke bërë thirrje për lëshimin e këtyre tokave, por ky popull i cili nuk i kalon disa milionë banorë nuk dëshiron të dëgjojë asnjë fjalë të drejtë apo një gjuhë njerëzore, kjo për shkak të posedimit të forcës dhe përgatitjes së mjaftueshme për luftë, që e ka përgatitur për vite të tëra për këtë lloj armiqësie.

Gjuha e vetme që mund t'i kundërpërgjigjesh këtyre është gjuha e ajetit, ku thuhet: **“e ju përgatitni forcë sa të keni mundësi”**. Duket sikur ky ajet ka zbritur në kohën tonë aktuale dhe për ne, që të na thotë: Përgatisni vetet tuaja dhe forcohuni aq sa armikun tuaj ta prekë frika që të largohet nga toka juaj dhe të shkojë në vendin e vet.

Ajo që tërheq vëmendjen është se ajeti këtu ka tubuar shprehjet “armikun e All’llahut” dhe “armikun tuaj”. Kjo është një tregues i mosekzistencës së dobive dhe interesave personale në luftën dhe mbrojtjen e Islamit. Madje qëllimi është ruajtja e mesazhit njerëzor të Islamit, pasi ata që ju armiqësojnë juve, në të vërtetë, janë armiqtë e All’llahut dhe armiqtë e së vërtetës dhe

drejtësisë, të besimit, njehsimit dhe moraleve njerëzore, prandaj duhet t'u jepet kundërpërgjigja duke u nisur nga ky aspekt.

Në të vërtetë, kjo shprehje ngjason me shprehjen “në rrugë të All'llahut” ose “lufta në rrugë të All'llahut”, e cila tregon se lufta apo mbrojtja e Islamit nuk i ngjason çlirimit të qyteteve në historinë e së kaluarës dhe as betejave të kolonializimit të zgjerimit të sotëm, as me panoramën e pushtimeve të fiseve arabe në kohën e injorancës, por e gjitha kjo bëhet për hir të All'llahut të Madhëruar, në rrugë të Tij dhe në rrjedhën e ringjalljes së të vërtetës dhe të së drejtës.

Pastaj ajeti thotë se shtimi i përgatitjeve tuaja ushtarake i frikëson armiqtë e tjerë që ju nuk i njihni dhe thotë: **“dhe të tjerët, të cilët ju nuk i njihni, por All'llahu i di ata.”**

Dy hulumtime

1- Cilët janë ata që nënkuptohen në ajet me frazën “ju nuk i njihni ata”?

Pavarësisht se komentuesit e Kur'anit kanë hedhur hipoteza të shumta për grupin për të cilin flitet në frazën **“ata që ju nuk i njihni”**, një pjesë e tyre kanë thënë se ata janë çifutët e Medines, të cilët e fshihnin armiqësinë e tyre, kurse disa të tjerë kanë thënë se kjo frazë është një tregues për armiqtë në të ardhmen, si shteti i Romës dhe i Persëve, me të cilët myslimanët nuk e prisnin se do të luftonin në të ardhmen.

Por siç e shikojmë, më e vërteta është se ata që nënkuptohen janë hipokritët, të cilët kishin hyrë në radhët e

myslimanëve pa e ditur ata. Nëse forcohet ushtria myslimane, ata do të futen pa dyshim në dilemë e shqetësim dhe do të largohen. Kjo dëshmohet në ajetin 101 të sures “Et Teube, ku thuhet: **“e edhe nga banorët e Medines që janë përcaktuar me hipokrizi, ti nuk i di ata, Ne i dimë”**.”

Supozohet se nocioni i ajetit përfshin të gjithë armiqtë e panjohur të Islamit, pjesa më e madhe prej hipokritëve, por edhe të tjerë veç tyre.

2- Përgatitja në çdo vend dhe në çdo kohë

Gjithashtu, ajeti përmban një mësim për myslimanët e sotëm. Në të thuhet se ata nuk duhet të mjaftohen vetëm me përgatitjen ndaj armiqve të Islamit që i njohin, por duhet të kenë kujdes edhe ndaj armiqve të mundshëm ose t’i japin rëndësi forcës dhe të përgatiten derisa të jenë në shkallën më të lartë të saj. Nuk ka dyshim se nëse myslimanët do të tregonin kujdes për këtë çështje të rëndësishme, atëherë ata nuk do të befasoheshin nga sulmet e papritura të armiqve.

Në fund të ajetit flitet për një temë tjetër të rëndësishme: përgatitja ushtarake dhe grumbullimi i armëve, i pajisjeve luftarake dhe i mjeteve të ndryshme të mbrojtjes, të gjitha këto kanë nevojë për mbështetje financiare. Prandaj, ajeti i urdhëron myslimanët për bashkëpunim shoqëror për ta grumbulluar atë shumë parash dhe se ajo që ata shpenzojnë për këtë çështje është dhuratë në rrugën e All’llahut dhe kurrë nuk i pakësohet gjë Atij: **“çfarëdo që shpenzoni për rrugë të All’llahut, ajo do t’ju kompesohet”**; prandaj gjithçka kthehet tek ju, madje edhe më shumë sesa keni shpenzuar **“dhe juve nuk ju bëhet padrejtësi”**; ju do të merrni shpërblimin e kësaj në këtë botë me triumfin e

Islamit, forcën dhe madhësinë e tij. Prandaj, në bazë të kësaj, nuk ka dyshim se ajo çfarë ju shpenzoni në këtë rrugë do ju kthehet në një mënyrë tjetër dhe në një masë më të madhe e më të mirë. Ashtu siç ju pret një shpërblim i madh në Jetën Tjetër afër mëshirës së All'Ilahut, ashtu edhe nuk do t'ju bëhet padrejtësi por do të merrni mirësi të madhe.

Ajo që na e tërheq vëmendjen është se fjalia e lartpërmendur ka në të shprehjen "*shej'un*", e cila ka një nocion të gjerë. Me fjalë të tjera, ajo çfarë ju shpenzoni nuk i fshihet All'Ilahut të Madhëruar, qoftë pasuri, mendim, shpirt, logjikë, fuqi apo çdo gjë tjetër që shpenzohet në forcimin e strukturës mbrojtëse dhe ushtarake të myslimanëve. Pa dyshim, All'Ilahu i Madhëruar do ta depozitojë atë me bollëk dhe do t'ju rikthejë kur duhet.

Një pjesë e komentuesve kanë supozuar se fjalia "**dhe juve nuk ju bëhet padrejtësi**" është e lidhur me frazën "*turhibune*" (ta frikësoni); domethënë nëse ju përgatisni forcën e duhur për t'u përballur me armiqtë, atëherë ata do të frikësohen për t'ju sulmuar, për t'ju bërë padrejtësi apo për t'ju lënduar. Duke u bazuar në këtë, juve nuk do ju prekë kurrë ndonjë padrejtësi.

Synimet e luftës në Islam dhe shtyllat e saj

Mirësia tjetër që përftohet nga ky ajet dhe që shërben si përgjigje për shumë pyetje të injorantëve dhe problemet e tyre, është sqarimi i formës së luftës, qëllimi dhe metoda e saj. Ajeti thotë qartë: Pa dyshim se ajo që synohet me të nuk është vrasja e njerëzve, apo bërja padrejtësi ndaj të drejtave të të tjerëve, por frikësimi juaj për armiqtë që të mos t'ju sulmojnë dhe t'ju

frikësojnë. Prandaj duhet që të gjitha përpjekjet dhe mundimet tuaja të jenë të fokusuara në rrugën e prerjes së të ligës së armiqve të All'Ilahut të Madhëruar, të së vërtetës dhe drejtësisë.

Në besimin tonë, përgjigjja për të gjithë këta është që të rikthehen tek Kur'ani dhe të mendojnë për synimin thelbësor të kësaj teme, në mënyrë që atyre t'ju qartësohen mirë të gjitha ato çështje.

Gadishmëria për paqe

Edhe pse ajeti i lartpërmendur e sqaroi mirë synimin e luftës në Islam, ajeti që pason e që flet për paqen mes myslimanëve, e sqaron këtë çështje në një mënyrë më të kthjellët dhe thotë: **“Në qoftë se ata anojnë nga Paqja, ano edhe ti nga ajo”**.

Në komentimin e kësaj fjalie paraprirëse presupozohet se nëse ata i shtrijnë krahët e paqes, atëherë edhe ti shtriji, sepse fjala *“xhenehu”* është folje e paskajores *“elxhunuhu”*, e cila ka kuptimin *“anim”*. Për çdo shpend thuhet se është *“xhenahun”* (anues), sepse çdo krah tek zogu anon në njërën anë. Kështu, në komentimin e këtij ajeti mund të mbështetemi herë në rrënjën e gjuhës, e herë tjetër në nocionin e saj dytësor.

Meqë në shumicën e rasteve njerëzit kishin dyshime kur synohej marrëveshja e paqes, ajeti e urdhëron Profetin (*Paqja dhe bekimet e All'Ilahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) për të mos pasur mëdyshje në këtë çështje nëse kushtet janë të drejta dhe të harmonizuara me logjikën e shëndoshë. Në ajet thuhet: **“... dhe mbështetu tek All'Ilahu. Me të vërtetë, Ai është Dëgjuesi dhe i Gjithëdijsmi”**.

Megjithatë, ajeti e paralajmëron Profetin (*Paqja dhe bekimet e All'Ilahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) dhe myslimanët, që të kenë kujdes prej hipotezës së dyshimit dhe mashtrimit në ftesën e armiqve për paqe, pasi mund të jetë një ftesë kamuflimi dhe dëshirë për një goditje të papritur, ose qëllimi i tyre mund të jetë vonimi i luftës, në mënyrë që të kenë mundësi të përgatisin forcat më tepër. Por ajeti e qetëson Profetin që edhe për këtë çështje të mos frikësohet sepse All'Ilahu i Madhëruar do t'i mjaftojë çështjes së tyre dhe do ta ndihmojë atë në të gjitha situatat. Ajeti thotë: **“po nëse duan të mashtrojnë me të (me Paqen) ty të mjafton All'Ilahu”**.

O Profet, historia jote e mëparshme është dëshmitare e kësaj të vërtete, sepse: “Ai është që ju mbështeti ju me triumfin e tij dhe me besimtarët”.

Sa kanë dashur të të fusin në kurth dhe sa të tjerë kanë përgatitur dhe thurur plane shkatërruese, aq sa nuk mund të triumfohej ndaj tyre me metodat e zakonshme e të mundshme, por All'Ilahu i Madhëruar të ruajti dhe të mbrojti ty në përballjen e gjithë asaj.

Veç kësaj, shtoi edhe besimtarët e singertë që të kanë rrethuar ty nga çdo anë dhe nuk kanë kursyer asgjë për mbrojtjen tënde. Para kësaj, ata kanë qenë të përçarë dhe armiqësorë me njëri-tjetrin, por All'Ilahu ua hapi zemrën me dritën e udhëzimit: “Ai është që bashkoi zemrat e tyre”.

Lufta e zgjatur me vite të tëra ndërmjet dy grupimeve Eus dhe Khazrexh, kishte arritur kulmin dhe zemrat e tyre vlonin nga inati e zemërimi ndaj njëri-tjetrit, deri aty sa askush nuk mund ta imagjinonte se një ditë ata do të jetonin me njëri-tjetrin në dashuri dhe paqe dhe do të bëheshin një rresht i konsoliduar. Por All'Ilahu, i Afti dhe i Drejti, e bëri të mundur këtë me begatinë e Islamit dhe nën hijen e Kur'anit. Ky problem nuk ka qenë i veçantë vetëm për Eusin dhe Khazrexhin, të cilët janë prej

Ensarëve, por ka qenë gjithashtu edhe ndërmjet muhaxhirëve (emigruesve), që erdhën nga Meka, ku para Islamit ndërmjet tyre nuk kishte dashuri dhe respekt dhe zemrat e tyre qenë të mbushura me mllef dhe urrejtje. Por All'Ilahu i pastroi ato zemërimet dhe mllefet dhe i pastroi ato sepse nga 313 heronj të Bedrit, prej tyre afërsisht 80 individë ishin prej muhaxhirëve kurse pjesa tjetër prej Ensarëve. Ata ishin një ushtri e vogël, por e bashkuar dhe e fortë, e cila arriti të thyente fuqinë e armikut dhe ta shkatërronte forcën e tij.

Pastaj ajeti shton e thotë se bashkimi i atyre zemrave ose gjenerimi i atij raporti dhe harmonie nuk është bërë me mjetet e zakonshme apo ato materiale: **“Edhe sikur të shpenzoje gjithçka që është në tokë, nuk do të mund t’i bashkoje zemrat e tyre, por All’Ilahu bëri bashkimin e tyre”**.

Pa dyshim se ata që e njohin situatën e shpirtave fanatikë dhe të ligë, si ata që kanë qenë në periudhën e injorancës, po ashtu e dinë se ato inate dhe urrejtje ishte e pamundur të hiqeshin, as me pasuri dhe as me forcë e pozitë, sepse tek ata nuk shuheshin ndryshe vetëm se me hakmarrje, e cila përsëritej në mënyrë të vazhdueshme ndërmjet tyre dhe çdo herë ishte në një formë më të ashpër, më të egër dhe më kriminale. Gjëja e vetme që bëri të mundur shkëlqimin e rrënjëve të prishura nga themelet e tyre, ishte bërja e një revolucionit të madh dhe një ndryshim gjithëpërfshirës në mendime, shpirta dhe doktrina, një revolucion që të shndërronte personalitetet e tyre, të zëvendësonte metodikat e të menduarit të tyre dhe t’i ngrente ata nga fundi ku ishin. Me këtë, ata pastrojnë shpirtat e tyre dhe u qëndrojnë larg ligësive e papastërtive si dhe fanatizmit të verbër të mëparshëm.

Këto çështje nuk mund të gjenerohen me pasuri dhe para, por vetëm nën hijen e besimit dhe njehsimit të sigurtë.

Më pas, ajeti shton në përfundim të tij: **“Ai është i Gjithëfuqishëm, i Urtë”**.

Fuqia e Tij obligon pamundësinë e të tjerëve të qëndrojnë përballë Tij dhe Urtësia e Tij kërkon që të gjitha çështjet e Tij të ndodhin sipas një llogarie precize dhe një sistemi të drejtë. Prandaj, me të vërtetë, plani i hollësishëm i unifikoi zemrat e përçara dhe i bëri ato t'i binden Profetit (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) për të përhapur dritën e udhëzimit në çdo skaj të botës.

Dy hulumtime

1- Disa komentues kanë thënë se ajeti që po diskutojmë flet për konfliktet ndërmjet fisit Euz dhe Khazrexh, të cilët janë vetëm prej Ensarëve, por duke parë se që të gjithë Muhaxhirët dhe Ensarët u ngritën në ndihmë të Profetit (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), bëhet më i qartë kuptimi i gjerë i ajetit.

Mbase ata mendonin se konfliktet kanë qenë ndërmjet Euzit dhe Khazrexhit dhe jo të tjerëve. Edhe pse konfliktet kanë qenë të shumta në nivelet klasore dhe shoqërore midis të varfërve dhe të pasurve, të mëdhenjve dhe të vegjëlve, mes këtij fisi dhe atij fisi, ato kontradikta dhe përçarje i fshiu Islami, duke i pastruar gjurmët e tyre, siç thotë edhe Kur'ani famëlartë në një vend tjetër: **“Përkujtojeni mirësinë e All'llahut ndaj jush, kur ju (para se të**

pranonit fenë islame) **ishit të armiqësuar e Ai i bashkoi zemrat tuaja dhe ashtu me mëshirën e Tij u bëtë vëllezër.**¹

2- Pa dyshim se ky ligj nuk është specifik vetëm për myslimanët e parë, sepse sot, Islami e ka shtrirë hijen e tij mbi tetëqind milionë myslimanë në të gjithë botën, duke qenë prej racave të ndryshme, kombeve të largëta dhe shoqërive të larmishme. Midis këtyre nuk mund të gjendet asnjë hallkë lidhjeje përveç asaj të besimit dhe të njehsimit. Pa dyshim që pasuritë, paratë dhe konferencat nuk mund të bëjnë asgjë të rëndësishme në këtë aspekt. Ajo që mund t'i unifikojë ata është vetëm ndezja e pishtarit të besimit në zemrat e tyre, ashtu siç ka ndodhur te myslimanët e parë, sepse triumfi nuk realizohet ndryshe vetëm se me anë të kësaj mënyre që është rruga e vëllazërimit islam mes të gjithë njerëzve.

Ajetet e fundit që po diskutojmë, i drejtohen Profetit (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) duke i thënë: **“O Profet! All'llahu të mjafton ty dhe besimtarëve që janë me ty”**.

Një pjesë e komentuesve të Kur'anit kanë transmetuar se ky ajet ka zbritur kur një grup çifutësh prej Beni Kurejdhave dhe Beni Nedhirit i thanë Profetit: *“Ne bëhemi myslimanë dhe të ndjekim ty”*, pra jemi të gatshëm të të ndjekim dhe të të ndihmojmë. Pas kësaj zbriti ky ajet, duke e paralajmëruar Profetin (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) që të mos mbështetej tek ata, por tek All'llahu dhe te besimtarët.²

¹ Sure, “Ali Imran”, ajeti 103.

² Tefsiri “Et Tibjan”, vëll. 5, f. 152.

Hafiz Ebu Neimi - që është prej dijetarëve të mëdhenj synitë - në librin “Virtytet e Sahabëve” ka përmendur në senedin e tij se ky ajet ka zbritur në të drejtën e Aliut, Prijësit të besimtarëve dhe se ajo që nënkuptohet me fjalën “besimtarët” është Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*).¹

Kemi thënë shpesh se komentime të tilla dhe shkaqet e zbritjes nuk i bëjnë ajetet të jenë të kufizuara. Përkundrazi, ajo që synohet në të është se një njeri si Aliu ibn Ebu Talibi, i cili ka qenë në radhën e parë të besimtarëve, është pika e mbështetjes së parë për Profetin pas All'llahut në mesin e myslimanëve, edhe pse pjesa tjetër e besimtarëve janë ndihmësit e Profetit (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) dhe mbështetësit e tij.

¹ “El Gadir”, vëll. 2, f. 51.

Ajetet 65 - 66

يَأْتِيهَا النَّبِيُّ حَرَضِ الْمُؤْمِنِينَ عَلَى الْقِتَالِ ۚ إِنْ يَكُنْ مِنْكُمْ
 عَشْرُونَ صَابِرُونَ يَغْلِبُوا مِائَتِينَ ۚ وَإِنْ يَكُنْ مِنْكُمْ مِائَةٌ يَغْلِبُوا أَلْفًا
 مِّنَ الَّذِينَ كَفَرُوا بِأَنَّهُمْ قَوْمٌ لَّا يَفْقَهُونَ ﴿٦٥﴾ أَلَمْ تَرَ كَيْفَ
 أَلَّفَ اللَّهُ عَنْكُمْ وَعَلِمَ أَنَّ فِيكُمْ ضَعْفًا ۚ فَإِنْ يَكُنْ مِنْكُمْ مِائَةٌ
 صَابِرَةٌ يَغْلِبُوا مِائَتِينَ ۚ وَإِنْ يَكُنْ مِنْكُمْ أَلْفٌ يَغْلِبُوا أَلْفِينَ بِإِذْنِ اللَّهِ
 وَاللَّهُ مَعَ الصَّابِرِينَ ﴿٦٦﴾

"O Profet! Jezu zemër e nxiti besimtarët për luftë! Nëse mes jush gjenden njëzet të qëndrueshëm, ata do të mundin dyqind (mohues) e, nëse nga ju janë njëqind të qëndrueshëm, ata do të mundin një mijë mohues, sepse ata janë njerëz që nuk kuptojnë."

"Tani, All'Ilahu ju ka lehtësuar ju, ngaqë Ai e di se keni dobësi. Kështu, nëse ka prej jush njëqind të qëndrueshëm, ata do të mundin dyqind (mohues) dhe, nëse nga ju janë një mijë (të qëndrueshëm), me vullnetin e All'Ilahut, ata do të mundin dy mijë (mohues). All'Ilahu është me të qëndrueshmit."

Komentimi

Mos prisni barazinë e forcave!

Në këto dy ajete radhiten mësimet ushtarake si dhe rregullat e luftës.

Ajeti i parë i flet të Dërguarit dhe i thotë: **“O Profet! Jepu zemër e nxiti besimtarët për luftë!...”**

Nuk ka dyshim se ushtarëve dhe luftëtarëve, sado përgatitje të kenë, duhet që para luftës t'u ngrihet lart gjendja shpirtërore dhe t'u hiqen shqetësimet e tyre. Ky rregull është i njohur në të gjitha sistemet ushtarake në botë, ku komandanti i ushtrive dhe drejtuesit e tyre, para se të lëvizin drejt fushëbetejës, ngrihen dhe mbajnë një fjalim për t'i motivuar luftëtarët, për t'ua forcuar atyre anën shpirtërore dhe për t'i paralajmëruar për disfatën dhe frikën.

Duhet përmendur se çështja e nxitjes dhe motivimit për luftë është e kufizuar në shkollat materialiste dhe e gjerë në fetë qiellore. Bazuar në mësimet hyjnore, në ndikimin e besimit në Zot, në pozitën e shehidave (dëshmorëve) tek Zoti i tyre si dhe shpërblimi i madh e i pakrahasueshëm që i pret ata, të gjitha këto e motivojnë shpirtin e heroizmit dhe qëndrueshmërinë në shpirtrat e ushtarëve. Leximi i disa ajeteve kur'anore në luftërat islame ia forcojnë vendosmërinë dhe kurajon ushtarit dhe ndezin brenda tij mallin dhe dëshirën për sakrificë.

Megjithatë, nuk ka dyshim se ajeti qartëson rëndësinë e informimit dhe përcjelljes së mesazhit, trajtimit të shqetësimeve të luftëtarëve dhe ushtarëve dhe shpirtrave të tyre, duke e konsideruar atë një mësim të rëndësishëm islam.

Ajeti mbyllet me një mësim të dytë dhe thotë: **“...Nëse mes jush gjenden njëzet të qëndrueshëm, ata do të mundin dyqind (mohues) e, nëse nga ju janë njëqind të qëndrueshëm, ata do të mundin një mijë mohues...”**

Pavarësisht se ajeti është në formën e lajmërimit për mposhtjen nga një njeri i vetëm të dhjetë vetëve, duke e krahasuar ajetin pas tij **“Tani, All’llahu ju ka lehtësuar”**, qartësohet se qëllimi i tij është përcaktimi i ligjit ose detyrës, planit dhe metodës, jo se është thjesht një lajm. Prandaj myslimanët nuk duhet të presin derisa numri i tyre të arrijë një shifër që t’i barazohet forcës së armikut dhe numrit të tij, në mënyrë që të lëvizin drejt fushëbetejës dhe Xihadit. Përkundrazi, ata duhet të angazhohen me detyrat e tyre sikur armiku i tyre të jetë dhjetëfish më shumë se ata.

Pastaj ajeti na tregon shkakun e këtij gjykimi dhe thotë: **“...sepse ata janë njerëz që nuk kuptojnë...”**. Ky komentim duket i çuditshëm në shikim të parë. Lind pyetja se ku qëndron lidhja midis njohurisë e kuptimit me triumfin, apo mungesa e njohurisë me dështimin? Por e vërteta është se lidhja ndërmjet atyre të dyjave është e afërt dhe e fortë, sepse besimtarët e dinë shtegun që kanë zgjedhur dhe e kuptojnë qëllimin e krijimit dhe të ekzistencës së tyre. Ata u besojnë rezultateve përfundimtare pozitive të krijimit në këtë botë, shpërblimin e madh që i pret ata në Botën Tjetër dhe e dinë mirë përse luftojnë, për hir të kujt, në rrugën e cilit qëllim të shenjtë sakrifikojnë e në dorën e kujt do të jetë llogaria e tyre nëse sakrifikohen dhe bien dëshmorë. Kjo rrjedhë e qartë e kombinuar me njohuri dhe kuptim, u jep atyre vendosmëri, durim dhe qëndrueshmëri.

Sa u përket atyre që nuk e besojnë All’llahun dhe as Ditën e Gjykimit, siç janë adhuruesit e statujave, ata nuk e dinë se për

çfarë kauze luftojnë e për hir të kujt. Ata nuk e dinë se kush do ta marrë hakun e gjakut të tyre nëse vriten. Me traditën e tyre të verbër dhe zakonet e tyre injorante, ata shkuan pas këtyre mendimeve. Kështu që errësitat e rrugës dhe mungesa e njohurisë së tyre për rezultatet e veprave që bëjnë i çojnë në dobësim e shkatërrim duke i bërë krijesa të dobëta.

Pas atij dënimi të rëndë për luftimin e armiqve, edhe nëse janë dhjetë herë më shumë në numër, All'Ilahu ua lehtëson besimtarëve gjendjen dhe zbret një rregull, i cili i forcon ata dhe u thotë: **“Tani, All'Ilahu ju ka lehtësuar ju, ngaqë Ai e di se keni dobësi...”**. Pastaj thotë: **“...Kështu, nëse ka prej jush njëqind të qëndrueshëm, ata do të mundin dyqind (mohues) dhe, nëse nga ju janë një mijë (të qëndrueshëm), me vullnetin e All'Ilahut, ata do të mundin dy mijë (mohues)...”**. Sido që të jetë, ju nuk duhet ta harroni shpëtimin e All'Ilahut: **“...All'Ilahu është me të qëndrueshmit.”**.

Hulumtime

Këtu duhet të kthejmë vëmendjen në disa çështje:

1- A është abroguar ajeti i parë?

Siç e kemi vënë re, ajeti i parë i urdhëron besimtarët që të mos dështojnë në përballjen me armiqtë, edhe nëse ata janë dhjetë herë më shumë në numër, por ajeti i dytë e zbret këtë numër në vetëm dyfish.

Kjo kontradiktë e qartë midis dy ajeteve bëri që një pjesë e komentuesve të thonë: Me të vërtetë, ajetin e parë – prej ajeteve që po komentojmë – e ka abroguar ajeti i dytë; ose e kanë komentuar ajetin e parë si rekomandim, kurse të dytin si obligim. Me fjalë të tjera, nëse numri i armiqve është dyfish i numrit të myslimanëve, atëherë ata nuk duhet të kthehen pas e të tërhiqen nga fushëbeteja. Nëse numri i tyre shkon deri në dhjetëfish më i madh, atëherë në këtë rast, ata nuk duhet t'i luftojnë, ndonëse më e mira për ta është që të mos tërhiqen nga luftimi i armikut.

Por një pjesë e komentuesve të Kur'anit mendojnë se kontradikta sipërfaqësore që gjendet ndërmjet dy ajeteve, nuk tregon për abrogim e as për "*istihbab*", preferencë, pëlqim. Përkundrazi, secili prej dy ajeteve ka një gjykim të përcaktuar. Kështu që, kur myslimanët sprovohen me dobësi dhe u shtohen luftëtarë pa eskperiencë, pa trajnim dhe të pagatshëm për luftë, në këtë rast kriteri i numrave bëhet në propocion të dobësisë. Mirëpo nëse luftëtarët janë të përgatitur plotësisht, të fortë në besimin dhe vendosmërinë e tyre si shumë prej heronjve të Bedrit, atëherë raporti në këtë rast rritet deri në dhjetëfish. Në bazë të kësaj, të dy gjykimet në dy ajetet që po komentojmë lidhen me dy grupime dhe me dy situata të ndryshme. Me këtë nuk ka asnjë abrogim këtu në ajet dhe nëse ka në transmetimet që shprehen për abrogim, atëherë duhet të shihet me kujdes se abrogimi ka një kuptim të gjerë dhe përfshin specifikimin në disa çështje.

2- Legjenda e balancimit të forcave

Dy ajetet që po komentojmë, përmbajnë ligjin e padiskutueshëm, se myslimanët nuk duhet të presin balancimin e forcave të jashtme mes tyre dhe armikut. Përkundrazi, ata e kanë

për detyrë të përballen me të, edhe nëse kanë një numër të pakët luftëtarësh, madje ndonjëherë edhe nëse janë dhjetëfish më tepër në numër se ata, e të mos largohen nga armiku për shkak të numrit të vogël të tyre.

Ajo që na tërheq vëmendjen është se në shumicën e betejave që janë zhvilluar midis myslimanëve dhe armiqve të tyre, fuqia anonte nga krahu i armikut dhe në shumicën e rasteve myslimanët kanë qenë pakicë. Kjo gjë nuk ka ndodhur vetëm në luftërat e Islamit në kohën e Profetit (*Paqja dhe bekimet e All'Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) - si Bedri, Uhudi, lufta e aleatëve, apo beteja e Mutas, për të cilën transmetohet se ushtria e myslimanëve nuk i kalonte tremijë luftëtarë, kurse ushtria e armikut, numri më i vogël që thuhet për ta është se kanë qenë njëqind e pesëdhjetë mijë. Edhe në luftërat pas kohës së Profetit është përmendur se ka pasur një diferencë tepër të madhe midis ushtrisë së Islamit, e cila çliroi Persinë, dhe ushtrisë së Sasanidëve. Ushtria islame nuk i kalonte pesëdhjetë mijë luftëtarë, ndërsa ushtria e Khosrov Parvizit ishte pesëqind mijë luftëtarë.

Ndërsa në betejën e Jermukut, që u bë midis myslimanëve dhe romakëve, historianët kanë thënë se ushtria që mblodhi Herkuli ishte afro njëqind mijë luftëtarë, ndërsa ushtria islame nuk i kalonte njëzet e katërmijë luftëtarë.

Gjëja më e habitshme që përmendin historianët është se numri i të vrarëve të romakëve në betejën e Jermukut ishte më i madh se shtatëdhjetë mijë.

Nuk ka dyshim se balancimi midis forcave apo zhvillimit ushtarak është një nga shkaqet e triumfit sipas asaj që duket, por cili ishte shkaku që qëndronte pas triumfit të myslimanëve të pakët në numër në beteja të tilla?

Përgjigjen e kësaj pyetjeje të rëndësishme e ka përmendur Kur'ani në dy ajetet që po komentojmë në tre fraza:

Fraza e parë: Thëniet: **“njëzet të durueshëm”** dhe: **“njëqind të durueshëm”** kanë kuptimin për ata që kanë qëndrueshmëri dhe vendosmëri. Ajo që nënkuptohet këtu si qëllim, është se shpirti i qëndrueshmërisë dhe i vendosmërisë, që është fryti i pemës së besimit, ishte arsyeja që një mysliman të triumfonte ndaj dhjetë jobesimtarëve.

Fraza e dytë: **“se ata janë njerëz që nuk kuptojnë** (pse luftojnë)” do të thotë: mungesa e njohurisë nga ana e armikut për qëllimin dhe njohja nga ana juaj e qëllimit tuaj të shenjtë, e bën të obliguar subjektin e numrit tuaj të pakët kundër numrit të madh të armikut.

Fraza e tretë është thënia e All'llahut të Madhëruar në ajetin që po komentojmë: **“me ndihmën e Zotit”** do të thotë: nuk ka dyshim se mbështetja e padukshme, mirësia e All'llahut dhe mëshira e Tij i përfshin këta luftëtarë të tillë durimtarë dhe u jep triumfin ndaj armikut të tyre.

Në kohën tonë, myslimanët përballen me armiq të ashpër dhe të fuqishëm. Është e habitshme se ushtria e myslimanëve në shumicën e betejave janë më të shumtë në numër se armiku, por megjithë këtë arsye, nuk ka ndonjë gjurmë të triumfit të myslimanëve dhe duket sikur ata ecin në drejtim të kundërt të rrugës që kanë ndjekur myslimanët e parë.

Shkaku është se myslimanët e sotëm nuk kënaqen me njohurinë e mjaftueshme dhe është për të ardhur keq, se ata kanë humbur shpirtin e durimit dhe të qëndrueshmërisë për shkak të përkuljes së tyre ndaj faktorëve të shkatërrimit dhe zbukurimit të jetës materiale dhe bukurisë së saj, sikur mbështetja e padukshme dhe mbrojtja e All'llahut janë marrë prej tyre për shkak të

përlyerjes së tyre me gjynahe dhe janë sprovuar me një ndëshkim të tillë.






Por, rruga e rikthimit vazhdon të jetë akoma e hapur dhe shpresojmë që të vijë ajo ditë që myslimanët ta kuptojnë përsëri nocionin e këtyre dy ajeteve dhe shembujt e tyre që t'ia zhveshin vetes së tyre gjendjen e poshtëritimit dhe të përbuzjes.

3- Çfarë nënkuptohet prej dy ajeteve?

Ajo që na e tërheq vëmendjen është se fjala në ajetin e parë ishte për raportin e një njeriu me dhjetë dhe ajeti jep shembullin: **"...Nëse mes jush gjenden njëzet të qëndrueshëm, ata do të mundin dyqind"**. Por në ajetin e dytë, fjala është për raportin e dobësisë si shembulli i njëqind vetëve përballë dyqind të tjerëve dhe njëmijë përballë dymijë të tjerëve: **"Kështu, nëse ka prej jush njëqind të qëndrueshëm, ata do të mundin dyqind (mohues) dhe, nëse nga ju janë një mijë (të qëndrueshëm), me vullnetin e All'Ilahut, ata do të mundin dy mijë"** etj ..

Duket sikur ky shembull elokuent dëshiron të sqarojë se burrat e fuqishëm, me vendosmëri të plotë dhe besim të fortë, munden të formojnë një ushtri të fuqishme edhe sikur të jenë njëzet të tillë. Por nëse janë të dobët, atëherë ata nuk mund të formojnë një ushtri prej njëzet vetash, por ata duhet të jenë disa herë më të shumtë në numër për të formuar një ushtri (prandaj vërejeni me imtësi).

Ajetet 67 - 71

مَا كَانَ لِنَبِيِّ أَنْ يَكُونَ لَهُ أَسْرَى لَهُ حَتَّى يُشْخِنَ فِي الْأَرْضِ ^ج
 تُرِيدُونَ عَرَضَ الدُّنْيَا وَاللَّهُ يُرِيدُ الْآخِرَةَ ^ظ وَاللَّهُ عَزِيزٌ حَكِيمٌ
 لَوْلَا كِتَابٌ مِّنَ اللَّهِ سَبَقَ لَمَسَّكُمْ فِيمَا أَخَذْتُمْ عَذَابٌ 
 عَظِيمٌ  فَكُلُوا مِمَّا غَنِمْتُمْ حَلَالًا طَيِّبًا ^ج وَاتَّقُوا اللَّهَ ^ج
 إِنَّ اللَّهَ غَفُورٌ رَّحِيمٌ  يَتَأْتِيهَا النَّبِيُّ قُلٌّ لِّمَن فِي أَيْدِيكُمْ
 مِّنَ الْأَسْرَىٰ إِنَّ يَٰعْلَمُ اللَّهُ فِي قُلُوبِكُمْ خَيْرًا يُؤْتِكُمْ خَيْرًا مِّمَّا
 أَخَذَ مِنْكُمْ وَيَغْفِرَ لَكُمْ ^ظ وَاللَّهُ غَفُورٌ رَّحِيمٌ  وَإِن
 يُرِيدُوا خِيَانَتَكَ فَقَدْ خَانُوا اللَّهَ مِن قَبْلُ فَأَمْكَنَ مِنْهُمْ ^ظ وَاللَّهُ
 عَلِيمٌ حَكِيمٌ 

"Asnjë Profet s'ka të drejtë të ketë rob për vete, derisa të arrijë fitore të plotë në Tokë. Ju dëshironi të mirat kalimtare të kësaj bote, kurse All'Ilahu dëshiron Botën Tjetër. All'Ilahu është i Plotfuqishëm dhe i Urtë."

"Sikur të mos ishin urdhërimet e mëparshme të All'Ilahut (për lejimin e plaçkës së luftës), do t'ju godiste një dënim i madh për atë që keni marrë."

"Gëzojeni plaçkën e luftës që keni fituar si gjë të lejueshme dhe të mirë dhe frikësojuni All'Ilahut! Vërtet, All'Ilahu është Falës e Mëshirëplotë."

"O Profet! Thuaju robërve që gjenden në duart tuaja: 'Nëse All'Ilahu gjen mirësi në zemrat tuaja, do t'ju japë diçka edhe më të mirë nga ajo që ju është marrë dhe do t'ju falë'. Se All'Ilahu është Falës dhe Mëshirëplotë."

"E, nëse ata duan të të tradhtojnë, dije se më parë kanë tradhtuar All'Ilahun dhe prandaj Ai ta mundësoi ty fitoren ndaj tyre. All'Ilahu është i Gjithëdijshëm dhe i Urtë."

Komentimi

Robërit e luftës

Ajetet e mëparshme na sqaruan disa rregulla të rëndësishme të luftës dhe përballjen e armiqve, kurse në këto ajete bëhet plotësimi i asaj çfarë na parapriu në ekspozimin e një pjese të ligjeve të robërve të luftës, sepse pjesa më e madhe e luftërave shoqërohet me zënien rob të një grupi luftëtarësh nga pala tjetër dhe Islami i ka dhënë një rëndësi të madhe çështjes së robërve të luftës, duke filluar që nga mënyra e trajtimit të tyre, gjithashtu edhe qëllimeve të Xhihadit.

Tema e parë që parashtrohet në lidhje me këtë çështje, është ajo që ka thënë ajeti i bekuar se asnjë Profet nuk ka të drejtë në robërimin e individëve të armikut vetëm pasi të forcojë këmbët e tij në tokë dhe të peshojë goditjet finale ndaj armiqve: **“Asnjë Profet s’ka të drejtë të ketë rob për vete, derisa të arrijë fitore të plotë në Tokë...”**.

Folja *“jethkhanu”* është marrë nga *“ethikhanu”* njësoj si *“elmihenu”* dhe kuptimi i saj në origjinë është trashësia, ashpërsia dhe rëndesa. Pastaj kjo shprehje është përdorur me kuptimin e fitores, forcës, triumfit dhe fuqisë, për shkakun e përmendur më lart.

Disa komentues të Kur’anit kanë thënë se kuptimi i frazës **“derisa të arrijë fitore të plotë në Tokë”** na argumenton hiperbolizimin dhe ashpërsinë në vrasjen e armiqve. Kuptimi i saj është se marrja e robërve duhet të ndodhë pas një beteje të madhe me armiqtë, por duke parë me kujdes fjalën *“në tokë”* dhe duke u kthyer te rrënja e kësaj fjale, e cila do të thotë *“ashpërsi”* dhe *“fortësi”*, na qartësohet se kuptimi i ajetit nuk është ai që ata kanë cituar. Synimi është përparësia ndaj armikut dhe shfaqja e forcës, e fuqisë dhe e ruajtjes së kontrollit ndaj zonës.

Megjithatë, ajeti i ka paralajmëruar myslimanët për një pikë të rëndësishme në luftë: që ata nuk duhet të angazhohen dhe të mendojnë për kapjen e robërve para disfatës së plotë të armikut. Kjo për shkak se disa myslimanë luftëtarë – siç përftohet nga disa transmetime – u përpoqën të merrnin numrin më të madh të robërve në fushëbetejën e Bedrit, sepse ishte zakon që për robin e luftës paguhej një sasi parash në formë haraçi, ose takse, që ai të lirohej pas mbarimit të luftës.

Kjo çështje konsiderohet një vepër e mirë në disa vende, por ajo është një vepër e rrezikshme para se të krijohet siguria për

disfatën e plotë të armikut, sepse angazhimi me robërit e armikut, lidhja e tyre dhe transferimi në një vend tjetër, e gjitha kjo në shumicën e rasteve i largon luftëtarët nga thelbi i qëllimit të luftës. Në këtë gjendje, armikut të plagosur mund t'i jepet rasti të bashkojë forcat e tij dhe të vazhdojë sulmin, ashtu siç ndodhi në betejën e Uhudit, ku një pjesë e myslimanëve u angazhuan në grumbullimin e plaçkës së luftës dhe armiku e shfrytëzoi rastin duke u dhënë goditjen përfundimtare myslimanëve.

Në bazë të kësaj, nuk ka dyshim se robërimi i armiqve lejohet në atë mënyrë, që të sigurohet plotësisht arritja e triumfit ndaj tij. Përndryshe, armikut duhet t'i drejtohen goditje të forta dhe të pandërprera për paralizimin dhe dobësimin e fuqive të tij. Nëse arrihet bindja me këtë, pa dyshim se qëllimet njerëzore obligojnë ndalimin e vrasjes dhe mjaftimin me robërimin e tyre.

Ajeti i ka sqaruar këto dy pika të rëndësishme: ushtarake dhe njerëzore në një shprehje të shkurtër. Pastaj në të fajësohen ata që e kundërshtuan këtë urdhër dhe thuhet: **"...Ju dëshironi të mirat kalimtare të kësaj bote, kurse All'Ilahu dëshiron Botën Tjetër..."**

Fjala *"el ardhu"* do të thotë "çështje të paqëndrueshme, të pavërtetuar". Përderisa pajisjet materiale kanë qenë të paqëndrueshme në këtë botë, për to është përdorur fjala *"ardhun"* (përjetimet e kësaj bote).

Siç e kemi thënë edhe më parë, nuk ka dyshim se interesimi për anën materiale në lidhje me robërit e luftës dhe hutimi ndaj qëllimit përfundimtar, domethënë triumfi ndaj armikut, jo vetëm që e fshin shpërblimin e Ahiretit, por e dëmton jetën e njeriut në dynja, në forcën e tij, dinjitetin dhe stabilizimin e tij, pasi në të vërtetë, këto qëllime të përmendura për individin në jetën e kësaj

bote, konsiderohen prej çështjeve të pandryshueshme të dynjasë, prandaj nuk duhet t'i vëmë në rrezik dobitë afatgjata të së ardhmes vetëm për të përfituar dobitë materiale kalimtare!

Ajeti mbyllet me thënien se mësimi i lartpërmendur është përzierje e forcës, triumfit, mençurisë dhe kontrollit sepse ato burojnë nga ana e All'Ilahut të Madhërueshëm **“All'Ilahu është i Plotfuqishëm dhe i Urtë.”**

Ajeti që vjen më pas kritikon ata që vënë në rrezik dobinë publike dhe interesin shoqëror, vetëm për të arritur disa dobi materiale kalimtare. Në të thuhet: **“Sikur të mos ishin urdhërimet e mëparshme të All'Ilahut (për lejimin e plaçkës së luftës), do t'ju godiste një dënim i madh për atë që keni marrë”**.

Në lidhje me thënien e All'Ilahut të Lartësuar: **“Sikur të mos ishin urdhërimet e mëparshme të All'Ilahut”**, komentuesit e Kur'anit kanë përmendur kuptime të ndryshme, por kuptimi më i përafërt është: “Sikur All'Ilahu të mos kishte caktuar më herët që të mos i ndëshkonte robërit e Tij, për atë që Profeti i Tij nuk ua kishte sqaruar ligjin, atëherë do t'ju kishte marrë me forcë në dënim për shkak se zutë robër armikun tuaj, me dëshirën e madhe për dobitë materiale, duke vënë ushtrinë e Islamit dhe triumfin e tij përfundimtar në një rrezik të madh. Siç e kanë sqaruar ajetet e bekuara në Kur'an, nuk ka dyshim se rruga e All'Ilahut e ka obliguar që të sqarojë mirë ligjet e Tij, e më pas të shpërblejë a të dënojë ata që e kundërshtojnë urdhrin e Tij. Për këtë, All'Ilahu i Madhëruar thotë: **“E Ne nuk dënuam askënd para se t'ia dërgojmë të Dërguarin.”**¹

¹ Sure, “El Isra”, ajeti 15.

Hulumtime

1- Në aparence ajeti trajton temën e marrjes së robërve në luftë dhe jo të marrjes së “haraçit” pas saj. Me këtë zgjidhen të gjitha problemet që shkaktuan një grup komentuesish në lidhje me kuptimin e ajetit.

Gjithashtu, qortimi dhe ashpërsia janë të veçantë për një grup njerëzish, të cilët para fitores përfundimtare, ata u morën me zënien rob të armikut për qëllime të kësaj bote. Kjo nuk ka lidhje fare me Profetin (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) dhe as me sahabet e tij besimtarë, qëllimi i të cilëve ishte xihadi në rrugën e All'llahut.

Me këtë mohohen të gjitha diskutimet që janë cituar, siç është thënia se gjoja Profeti ka bërë një gjynah! Po si mund të bashkohet kjo vepër me pagabueshmërinë (el ismetu) e Profetit (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij?*) Prandaj, kjo nuk është e vërtetë.

Po ashtu, vërtetohet kotësia e haditheve të ndryshme të cilat i kanë trasmetuar disa burime të Ehli Synetit dhe përgënjeshtrimi i tyre, lidhur me komentimin e këtij ajeti. Ato thënie thonë se ajeti¹ ka zbritur për marrjen e haraçit nga ana e Profetit dhe e disa myslimanëve në këmbim të robërve të luftës pas betejës së Bedrit dhe para se All'llahu i Madhëruar ta lejonte këtë gjë. Dhe ai i cili e kundërshtoi këtë çështje dhe këkroi vrasjen e robërve ishte vetëm Omeri – ose S'ad ibn Muadhi. E Profeti paska thënë: "Nëse do të zbriste ndonjë ndëshkim ndaj nesh, i vetmi që do të shpëtonte është Omeri – ose S'ad ibn Muadhi."

¹ Tefsiri “El Manar”, vëll. 10, f. 90; Tefsiri “Ruhul Meanij”, vëll. 10, f. 32 dhe Tefsiri “El Kebijr”, vëll. 15, f. 198.

Nuk ka asnjë dyshim se të gjitha këto janë të zhveshura nga e pavërteta dhe nuk kanë asnjë bazë dhe ato trasmetime janë shumë larg komentimit të këtij ajeti.

2- Ajetet që po komentojmë nuk e kundërshtojnë marrjen e haraçit dhe lirimin e robërve nëse plotësohet ose e kërkon interesi i shoqërisë islame. Madje këto ajete thonë se luftëtarët nuk duhet të kenë si objektiv të tyre robërit e luftës për hir të haraçit që do marrin. Në bazë të kësaj ky ajet është në përputhje me ajetin 4 të sures “Muhammed”, në të gjitha drejtimet, i cili thotë: **“Kur të përballeni në luftë me mohuesit, goditini në qafë, derisa t’i rraskapitni e t’i shkatërroni ata dhe pastaj lidhini fort. Mandej ose i lironi me zemërgjerësi, ose me shpërblim, derisa të bëhet armëpushimi...”**

Këtu do të trajtojmë një çështje shumë të rëndësishme, që është: nëse në mesin e robërve të luftës ka nga ata që shkaktojnë ngatërresa në lirimin e tyre, në shpërthimin e zjarrit të luftës, duke e rrezikuar triumfin e myslimanëve, atëherë myslimanët kanë të drejtë që persona të tillë t’i vrasin. Argumenti për këtë subjekt është i fshehur në vetë ajetin që po komentojmë me kontekstin e “jethkhanu” dhe artikullimit në ajetin 4 të sures “Muhammed” me fjalën “ethkhantumuhum”.

Për këtë, në disa trasmetime islame thuhet se Profeti (*Paqja dhe bekimet e All’llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) urdhëroi vrasjen e dy prej robërve të luftës së Bedrit: Akabe bin Ebi Muiti dhe Nadr bin Harithi, dhe nuk pranoi kurrë që të jepen kundrejt haraçit.¹

3- Në ajetet që po komentojmë ka një konfirmim përsëri për temën e lirisë së vullnetit të njeriut dhe mohimin e doktrinës së

¹ Tefsiri “Nuruth Thekalejn”, vëll 2, f. 135.

parashikimit. Në to thuhet: Me të vërtetë, All'illahu dëshiron për ju Ahiretin, por disa prej jush i kanë mashtruar dobitë materiale kalimtare dhe kanë krijuar varësi ndaj tyre.

Ajeti që vijon më pas, na tregon një prej ligjeve të tjera të robërve të luftës, që është rregulli i marrjes së haraçit.

Në disa transmetime lidhur me zbritjen e këtyre ajeteve¹, thuhet se pas përfundimit të Betejës së Bedrit dhe marrjes së robërve dhe pas urdhrimit të Profetit (*Paqja dhe bekimet e All'illahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) për prerjen e kokës së dy robërve të rrezikshëm të luftës: Akabe bin Ebi Muiti dhe Nedir bin Harithi, ensarët u frikësuan se ky ligj do të zbatohet edhe për pjesën tjetër të robërve dhe do të privoheshin nga marrja e haraçit. Kështu, ata i thanë: “O i Dërguar i All'illahut! Ne vramë shtatëdhjetë burra dhe zumë rob shtatëdhjetë të tjerë dhe që të gjithë janë nga fisi yt. Na i jep neve këta robër lufte, që të marrim haraçin për ta”. Profeti po priste që t'i zbriste shpallja dhe zbritën këto ajete që e lejonin marrjen e haraçit në këmbim të dhënies së lirisë së robërve.

Transmetohet se shuma më e madhe e caktuar për marrjen e haraçit për robërit ishte katërmijë derhemë, kurse më e ulëta ishte njëmijë derhemë. Sapo kurejshët e dëgjuan këtë, dërguan haraçet njëri pas tjetrit derisa i liruan të gjithë robërit.

E çuditshme ishte se dhëndri i Profetit, burri i vajzës së tij, Ebu Asi, ka qenë mes robërve të luftës së betejës së Bedrit dhe bashkëshortja e tij, Zejnebja, dërgoi gjerdanin e saj që ia pati dhuruar e ëma, Hatixheja, që të paguante haraçin e burrit të vet. Kur Profetit i shkuan sytë tek ky gjerdan dhe iu kujtua sakrifica e Hatixhesë, Xhahadi dhe qëndrimet e saj, ajo iu mishërua para

¹ Tefsiri “Nuruth Thekalejn”, vëll 2, f. 136.

syve. Profeti (*Paqja dhe bekimet e All'lahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) tha: "All'lahu e mëshiroftë Hatixhenë! Këtë gjerdan e ka bërë Hatixheja për vajzën time, Zejneb".

Sipas disa transmetimeve, Profeti refuzoi ta pranonte këtë gjerdan në shenjë respekti dhe nderimi për Hatixhenë dhe myslimanët pranuan që ta kthenin gjerdanin. Pastaj Profeti¹ e liroi Ebi Asin, me kusht që t'ia kthente në Medine vajzën e vet, Zejneben, e cila ishte martuar me Ebi Asin para Islamit. Ai e pranoi këtë kusht dhe më pas e shpagoi.²

Megjithatë, nuk ka dyshim se ajeti që po komentojmë, i lejoi myslimanët që të bënin ç'të donin me plaçkën e luftës dhe me shumën e parave që do të merrnin si haraç për robërit e luftës. Në ajet thuhet: "**Gëzojeni plaçkën e luftës që keni fituar si gjë të lejueshme dhe të mirë...**".

Kjo fjali ka mundësi të ketë një kuptim më të gjerë dhe mund të përfshijë edhe plaçkat e tjera të luftës veç haraçit. Më pas, ajeti i urdhëron ata për devotshmëri dhe thotë: "**...dhe frikësojuni All'lahut!...**". Ky është një tregues se lejimi i marrjes së plaçkave të luftës dhe zënia rob e armikut që të marrin haraçin nuk duhet të jetë qëllimi i luftëtarëve në betejë. Nëse në zemrat e tyre kanë këto nijete të këqija, atëherë ata duhet të pastrojnë zemrat prej atyre nijeteve dhe All'lahu u premtonte atyre falje për atë që ka kaluar dhe thotë ajeti: "**...Vërtet, All'lahu është Falës e Mëshirëplotë.**"

¹ Në "El Kamilu", i Ibn Ethirit, vëll. 2, f. 134 thuhet: "Sapo i Dërguari i All'lahut e pa atë, ndjeu një shtrëngesë të fortë dhe tha: 'Nëse mendoni se mund t'ia lironi robin e saj dhe t'ia ktheni mbrapsht atë që ka sjellë, atëherë bëjeni!'" Ata e liruan robin e luftës dhe ia kthyen edhe gjerdanin.

² Tefsiri "El Mijzan", vëll. 9, f. 139.

Pyetje: Si harmonizohet marrja e haraçit në këmbim të lirisë së robit të luftës dhe principeve të drejtësisë? A nuk është kjo një lloj shitblerjeje e njeriut?

Përgjigje: Përgjigja për këtë pyetje bëhet e qartë kur të dimë se haraçi është një nga taksat ushtarake apo gjobë lufte, pasi çdo luftë shkakton rrjedhjen e shumë energjive ekonomike dhe fuqive njerëzore, kështu që grupimi i cili lufton për kauzën e drejtë, ka të drejtë që të kompensojë dëmet e saj pas lufte dhe një nga mënyrat e kompensimit është “haraçi”. Duke parë se haraçi në atë kohë sillej mes katërmijë derhemësh për një rob lufte të pasur dhe njëmijë derhemësh për ata që ishin të varfër, bëhet mëse e qartë se pasuritë që iu morën kurejshëve nuk ishin të shumta, madje nuk ishin as e mjaftueshme për mbulimin e dëmeve financiare dhe njerëzore të myslimanëve në atë betejë.

Për më tepër, myslimanët braktisën shumë pasuri në Mekë, kur u shpërngulën të detyruar për në Medine. Këto pasuri mbetën në duart e armiqve kurejshë dhe myslimanët kishin të drejtën të merrnin haraç për kompensim të dëmeve dhe pasurive të tyre në ditën e Bedrit.

Duhet patur parasysh se çështja që përmendet në ajetin 4 të sures “Muhammed”, që është se çështja e haraçit, nuk është obligative, prandaj qeveria islame mund të shkëmbejë robër lufte kur e shikon me interes ose të bëjë një favor dhe t’i lirojë ata pa asnjë kompensim. Çështja tjetër e rëndësishme në lidhje me robërit e luftës është tema e reformimit, e edukimit dhe e udhëzimit të tyre. Mbase kjo çështje nuk ekziston në doktrinat materialiste, por kësaj i duhet kushtuar kujdes në Xhihad për hir të liritimit të njeriut, ndreqjes së tij dhe përhapjes së vërtetës dhe të drejtësisë.

Prandaj edhe ajeti i katërt prej ajeteve që po komentojmë, i flet Profetit (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) që t'i ftojë robërit e luftës në besimin në Zot dhe reformimit të veteve të tyre, e u nxit atyre interesin në gjithçka duke thënë: **“O Profet! Thuaju robërve që gjenden në duart tuaja: Nëse All'llahu gjen mirësi në zemrat tuaja, do t'ju japë diçka edhe më të mirë nga ajo që ju është marrë dhe do t'ju falë...”** .

Ajo që nënkuptohet nga fjala *“khajren”* në fjalinë e lartpërmendur **“...Nëse All'llahu gjen mirësi në zemrat tuaja...”**, është besimi dhe pranimi i Islamit, ndërsa ajo që kuptohet nga fjala *“khajrun”* në fjalinë tjetër: **“ju jep juve më shumë të mira”**, është shpërblimi ose pagesa materiale dhe shpirtërore që merret me begatinë e Islamit dhe ai është më i madh tek All'llahu sesa haraçi.

Kësaj i shtohet edhe mirësia dhe falja e All'llahut për gabimet dhe të këqijat tuaja: **“...Se All'llahu është Falës dhe Mëshirëplotë.”**

Por meqë ekzistonte mundësia që robërit të shfrytëzonin rastin duke shfaqur Islamit për ta dëmtuar atë dhe për ta mashtruar Profetin e për t'u hakmarrë ndaj myslimanëve, atëherë ajeti që vijon, e paralajmëron Profetin dhe myslimanët dhe u thotë: **“E, nëse ata duan të të tradhtojnë, dije se më parë kanë tradhtuar All'llahun...”** .

A ka tradhëti më të madhe se sa mospërgjigjia e thirrjes së natyrës së pastër, largimi nga thirrja e të vërtetës, e logjikës dhe duke i shoqëruar ortak All'llahut me adhurimin e statujave në vend të adhurimit të Tij? Pastaj ata nuk duhet ta harrojnë triumfin që të dha All'llahu ty: **“...dhe prandaj Ai ta mundësoi ty fitoren ndaj tyre...”** .

E nëse duan të të mashtrojnë në të ardhmen, atëherë ata nuk do të shpëtojnë dhe do të pësojnë poshtërim, dështim dhe mposhtje përsëri, sepse All'llahu i di mirë qëllimet e tyre dhe të gjitha mësimet në lidhje me robërit e luftës janë sipas mençurisë së Tij: **“All'llahu është i Gjithëdijshëm dhe i Urtë”**.

Në lidhje me dy ajetet që po komentojmë, në librat e dy grupimeve – shi'ite dhe synite - thuhet se Abbasi, xhaxhai i Profetit, ka qenë rob lufte i Bedrit. Një grup ensarësh kërkuan që prej tij të mos merrej haraç për nder të të Dërguarit të All'llahut. Ai u tha: *“Pasha All'llahun, mos lëshoni qoftë edhe një derhem!”* (domethënë, përderisa haraçi është një ligj i përgjithshëm islam, atëherë nuk duhet të bëhet dallim mes xhaxhait tim dhe asnjë robi tjetër). Profeti i tha xhaxhait të tij, Abbasit: *“Paguaj haraçin për veten tënde dhe për djalin e vëllait tënd, Akilin”*.

Abbasi (që ishte i marrosur pas pasurisë) i tha atij: *“O Muhammed, a dëshiron të më bësh të varfër aq sa t'u shtrij dorën kurejshëve?!”* Kurse Profeti (Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) i tha atij: *“Jepe haraçin nga pasuria që ia ke dorëzuar Ummu Fadlit, gruas tënde, për të cilën i the: “Nëse unë vritem në luftë, shpenzoje atë për veten dhe fëmijët e tu”*.

Abbasi u habit nga kjo gjë dhe tha: *“Kush ta tha ty këtë, kur asnjë nuk e di?”* I Dërguari i All'llahut i tha: *“Më lajmëroi Xhebraili”*.

Abbasi tha: *“Betohem në atë që betohet Muhammedi, se këtë gjë nuk e di askush veç meje dhe gruas time!”* Pastaj tha: *“Dëshmoj se ti je i Dërguari i All'llahut”* dhe deklaroi Islamin.

Të gjithë robërit e Bedrit u kthyen në Mekë përveç Abbasit, Akilit dhe Nufelit, pasi u bënë myslimanë dhe qëndruan në Medine dhe ajetet që po komentojmë, na tregojnë situatën e tyre.¹

Në disa histori në lidhje me pranimin e Islamit të Abbasit, thuhet se ai u kthye në Mekë pasi u bë mysliman dhe i shkruante Profetit (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) për kurthet e idhujtarëve. Pastaj ai emigroi në Medine para vitit të tetë të Hixhretit, "vitin e çlirimit të Mekës".

Në librin "*Kurbul Esnad*", është transmetuar nga Imam Bakiri i cili ka transmetuar nga babi i tij Zejnul Abidin (*Paqja qoftë mbi ta!*), se një ditë i sjellin të Dërguarit të All'llahut shumë pasuri. Profeti (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) kthehet nga Abbasi dhe i thotë: Shtroje xhyben tënde dhe merr nga këto para. Abbasi veproi dhe mori nga ato para. Profeti tha: "Kjo është ajo që ka thënë All'llahu i Madhërueshëm dhe lexoi fjalën e Tij: **"O Profet! Thuaju robërve që gjenden në duart tuaja..."**"²

Ky është një tregues se premtimi i All'llahut u përmbush në praktikë, duke i dhënë Abbasit mirësi më tepër sesa iu morën atij. Nga ky hadith mësohet se Profeti (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ishte në proces të kompensimit të robërve, të cilët u bënë myslimanë, për atë që u morën atyre, duke ngjallur tek ata interesin dhe dëshirën dhe duke ua kthyer pasuritë e marra në formën më të mirë të mundshme.

¹ Shih Tefsirin "Nuruth Thekalejn", "Reudatul Kafij", Tefsiri i "Kurtubijut", Tefsiri "El Manar", fundi i ajeteve që janë objekt studimi.

² Tefsiri "Nuruth Thekalejn", vëll.2, f. 168.

Ajetet 72 - 75

إِنَّ الَّذِينَ ءَامَنُوا وَهَاجَرُوا وَجَاهَدُوا بِأَمْوَالِهِمْ وَأَنْفُسِهِمْ فِي سَبِيلِ
 اللَّهِ وَالَّذِينَ ءَاوَأُوا وَنَصَرُوا أَوْلِيَّكَ بَعْضُهُمْ أَوْلِيَاءُ بَعْضٍ ۚ وَالَّذِينَ
 ءَامَنُوا وَلَمْ يُهَاجِرُوا مَا لَكُمْ مِّنْ وَلِيَّتِهِم مِّنْ شَيْءٍ حَتَّىٰ يُهَاجِرُوا ۚ
 وَإِنِ اسْتَنْصَرُوكُمْ فِي الدِّينِ فَعَلَيْكُمْ النَّصْرُ إِلَّا عَلَىٰ قَوْمٍ بَيْنَكُمْ
 وَبَيْنَهُم مِّيثَاقٌ ۗ وَاللَّهُ بِمَا تَعْمَلُونَ بَصِيرٌ ﴿٧٢﴾ وَالَّذِينَ كَفَرُوا بَعْضُهُمْ
 أَوْلِيَاءُ بَعْضٍ ۚ إِلَّا تَفَعَّلُوهُ تَكُن فِتْنَةٌ فِي الْأَرْضِ وَفَسَادٌ كَبِيرٌ
 ﴿٧٣﴾ وَالَّذِينَ ءَامَنُوا وَهَاجَرُوا وَجَاهَدُوا فِي سَبِيلِ اللَّهِ وَالَّذِينَ
 ءَاوَأُوا وَنَصَرُوا أَوْلِيَّكَ هُمُ الْمُؤْمِنُونَ حَقًّا ۚ لَهُمْ مَغْفِرَةٌ وَرِزْقٌ كَرِيمٌ
 ﴿٧٤﴾ وَالَّذِينَ ءَامَنُوا مِن بَعْدِ وَهَاجَرُوا وَجَاهَدُوا مَعَكُمْ فَأُولَٰئِكَ
 مِنكُمْ ۚ وَأُولَٰئِكَ الْأَرْحَامُ بَعْضُهُمْ أَوْلَىٰ بِبَعْضٍ فِي كِتَابِ اللَّهِ ۗ إِنَّ اللَّهَ
 بِكُلِّ شَيْءٍ عَلِيمٌ ﴿٧٥﴾

"Vërtet, ata që besuan dhe mërguan (për hir të besimit), e më pas luftuan me pasurinë dhe jetën e tyre në rrugën e All'Ilahut dhe ata që u dhanë strehim e i ndihmuan, janë miq e mbrojtës për njëri-tjetrin. Por, ata që besojnë e që nuk kanë mërguar, nuk të kërkohet t'i mbrosh, derisa të mërgojnë. E, nëse ju luten që t'i ndihmoni për çështjen e fesë, atëherë jeni të detyruar t'u dilni në ndihmë, përveçse (kur ju duhet të luftoni) kundër një populli me të cilin keni marrëveshje. All'Ilahu e sheh mirë atë që veproni."

"Kurse jobesimtarët janë miq e mbrojtës të njëri-tjetrit. Nëse nuk veproni ashtu siç jeni urdhëruar, do të bëhet ngatërrësë dhe shkatërrim i madh në Tokë."

"Ata që besojnë, mërgojnë e luftojnë për çështjen e All'Ilahut dhe ata që u japin strehim atyre e i ndihmojnë, pa dyshim, janë besimtarë të vërtetë; për ta ka falje dhe shpërblim bujar."

"Edhe ata që u bënë besimtarë më vonë, që mërguan dhe luftuan bashkë me ju, janë prej jush; dhe ata që kanë lidhje farefisnore, janë më të afërt për njëri-tjetrin. Me të vërtetë, All'Ilahu është i Dijshëm për çdo gjë."

Komentimi

Katër grupime të ndryshme

Këto ajete që mbyllin suren "Enfal" e që konsiderohen si kapitulli i fundit i tyre, flasin rreth grupimeve të migruesve, ensarëve dhe grupimeve të tjera të myslimanëve si dhe shfaqin

vlerën e të gjithë atyre, duke i dhënë secilit grup vlerën e vet dhe duke plotësuar atë që mbeti nga trajtimi i ajeteve të mëparshme në lidhje me Xhihadin dhe luftëtarët.

Thënë ndryshe: Pa dyshim se këto ajete trajtuan sistemin e shoqërisë islame për sa u përket lidhjeve të ndryshme, sepse plani i luftës dhe i paqes, si të gjitha planet dhe metodat e përgjithshme, nuk mund të realizohet pa formuar lidhjen e vërtetë shoqërore.

Këto ajete kanë trajtuar pesë grupe: katër janë prej myslimanëve, kurse njëri është jomysliman. Ato janë:

- 1- *Migruesit e parë.*
- 2- *Ensarët e Medines.*
- 3- *Besimtarët që nuk migruan.*
- 4- *Ata që besuan më pas dhe migruan.*

Ajeti i parë i grupit të ajeteve që po komentojmë, thotë: **“Vërtet, ata që besuan dhe mërguan (për hir të besimit), e më pas luftuan me pasurinë dhe jetën e tyre në rrugën e All’lilaut dhe ata që u dhanë strehim e i ndihmuan, janë miq e mbrojtës për njëri-tjetrin...”**

Në këtë pjesë të ajetit tregohet për dy grupe: i pari dhe i dyti [migruesit dhe ensarët], domethënë ata që besuan në Mekë dhe migruan prej saj drejt Medines dhe ata që besuan në Medine e më pas strehuan Profetin (*Paqja dhe bekimet e All’lilaut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), e ndihmuan dhe e mbrojtën atë si dhe migruesit. Ajeti i përshkruan ata si miq dhe mbrojtës të njëri-tjetrit.

Ajo që tërheq vëmendjen është se ajeti e ka përshkruar grupin e parë me katër cilësi, të cilat janë: besimi, migrimi, përpjekja financiare dhe ekonomike (nëpërmjet lënies së pasurive

të tyre në Mekë dhe asaj që shpenzuan në luftën e Bedrit) dhe cilësia e katërt është lufta me vetet, me gjakun dhe shpirtrat e tyre. Ndërsa ensarët, ajeti i ka përshkruar me dy cilësi, që janë: strehimi dhe ndihma.

Ky ajeti i ka bërë të gjithë përgjegjës për njëri-tjetrin, duke e obliguar secilin për shokun e tij me frazën: **“janë miq e mbrojtës për njëri-tjetrin”**.

Në të vërtetë, këto dy grupime përfaqësonin dy grupe të lidhura bashkë, që nuk mund të bëjnë pa njëri-tjetrin përderisa prej tyre formohet struktura e shoqërisë islame, sepse ata janë njësoj si boshti (druga) i perit.

Më pas, ajeti flet për grupin e tretë dhe thotë: **“Por, ata që besojnë e që nuk kanë mërguar, nuk të kërkohet t’i mbrosh, derisa të mërgojnë...”**

Pastaj, në fjalinë që vijon më pas është përjashtuar vetëm një përgjegjësi në lidhje me këtë grupim dhe thuhet: **“...E, nëse ju luten që t’i ndihmoni për çështjen e fesë, atëherë jeni të detyruar t’u dilni në ndihmë, përveçse (kur ju duhet të luftoni) kundër një populli me të cilin keni marrëveshje.”**

Thënë ndryshe: Obligohet mbrojtja e tyre nëse ata përballen me një armik të përbashkët, por nëse ata përballen me jobesimtarë, me të cilët keni marrëveshje, atëherë pa dyshim se ju duhet të përmbushni marrëveshjen, e cila ka përparësi ndaj mbrojtjes në këtë formë.

Ajeti nxit ruajtjen e premtimeve dhe të marrëveshjeve si dhe përpikmërinë në zbatimin e kësaj përgjegjësie, duke paralajmëruar se All’lillahu është i Gjithëdijsëm për çdo gjë. Në ajeti thuhet: **“...All’lillahu e sheh mirë atë që veproni.”**

Ai i shikon të gjitha veprat tuaja dhe e di mirë se çfarë përpjekjesh bëni si i zbatoni detyrat apo përgjegjësisë që keni. Po

ashtu është i Gjithëditur edhe për atë që nuk i jep rëndësi çështjeve, për dobësinë, delikatesën dhe mungesën e ndjenjës së përgjegjësisë përballë këtyre detyrave dhe obligimeve të mëdha.

Sa i përket ajetit të dytë, ai na tregon të kundërtën e shoqërisë islame, domethënë shoqërinë e mosbesimit dhe armiqtë e Islamit ku thotë: **“Kurse jobesimtarët janë miq e mbrojtës të njëri-tjetrit...”** Pra, nuk ka dyshim se lidhjet janë të kufizuara ndërmjet jush dhe juve nuk ju lejohet që të bëni marrëveshje me ta, t’i mbroni, apo të kërkoni prej tyre ndihmë për veten tuaj, apo të strehohen tek ju, e ju të strehoheni tek ata.

Me fjalë më të përmbledhur: Jobesimtarët nuk lejohen të futen në strukturën e shoqërisë islame dhe as myslimanëve nuk u lejohet të futen në strukturën e jobesimtarëve. Më pas, ajeti i paralajmëron myslimanët për kundërshtimin e këtij mësimi dhe thotë: **“...Nëse nuk veproni ashtu siç jeni urdhëruar, do të bëhet ngatërresë dhe shkatërrim i madh në Tokë”**. A ka shkatërrim më të madh sesa nëpërkëmbja e triumfit tuaj, depërtimi i intrigave të armiqve dhe planifikimi i tyre për shkatërrimin e fesë tuaj, feja e së vërtetës dhe e drejtësisë, në mesin e shoqërisë tuaj?

Në ajetin që pason jepet edhe një herë tjetër shkalla e lartë e muhaxhirëve dhe e ensarëve si dhe pozita e ndikimi i tyre në realizimin e qëllimeve të shoqërisë islame. Ajeti i lavdëron duke thënë: **“Ata që besojnë, mërgojnë e luftojnë për çështjen e All’llahut dhe ata që u japin strehim atyre e i ndihmojnë, pa dyshim, janë besimtarë të vërtetë...”**. Ata nxituan në ndihmë të Islamit në ditët më të vështira dhe çdonjëri prej tyre mori pjesë me një lloj ndihme për All’llahun dhe të Dërguarin e Tij: **“...për ta ka falje dhe shpërblim bujar.”**; ata janë fitues të shpërblimit të

All'Ilahut dhe mirësisë së Botës Tjetër, ashtu siç do t'u jepet fuqi, krenari dhe respekt në këtë botë.

Ndërsa ajeti i fundit na tregon për grupin e katërt të myslimanëve, pra ata të cilët besuan dhe migruan më pas. Në ajet thuhet: **“Edhe ata që u bënë besimtarë më vonë, që mërguan dhe luftuan bashkë me ju, janë prej jush...”**

Me fjalë të tjera, nuk ka dyshim se shoqëria islame nuk është një shoqëri e kufizuar dhe e izoluar në veten e saj. Përkundrazi, dyert e saj janë të hapura për të gjithë besimtarët, migruesit dhe luftëtarët. Edhe nëse migruesit e parë kanë një pozitë më të veçantë dhe një gradë më të nderuar, kjo nuk do të thotë se besimtarët e rinj dhe migruesit në të ardhmen nuk do të konsiderohen pjesë e shoqërisë islame dhe nuk janë pjesë e strukturës së saj. Në mbyllje, ajeti flet për ruajtjen e lidhjeve farefisnore me njëri-tjetrin dhe për ruajtjen e ligjeve që All'Ilahu ka vënë për robërit dhe thotë: **“...dhe ata që kanë lidhje farefisnore, janë më të afërt për njëri-tjetrin...”**

Në të vërtetë, ajetet e mëparshme na flasin për mbrojtjen e besimtarëve dhe myslimanëve në përgjithësi (“njëri-tjetrin”), ndërsa ajeti që po komentojmë e konfirmon këtë temë në lidhje me farefisninë dhe të afërmit, pasi përveç gjendjes së besimit dhe migrimit, ata marrin kënaqësinë e mbrojtjes së farefisnisë. Kështu, ata trashëgojnë dhe lënë trashëgimi njëri-tjetrin. Por mes besimtarëve të tjerë, që nuk kanë lidhje farefisnore, me ta nuk ka trashëgimi. Duke u bazuar në këtë, atëherë ajeti i fundit nuk flet për trashëgiminë, por për një temë më të gjerë që përfshin edhe subjektin e trashëgimisë.

E nëse në trasmetimet islame dhe në librat e jurisprudencës gjejmë ndonjë thënie që thonë se ky ajet dhe ajeti i ngjashëm me këtë që është në suren A'hzab tregojnë për trashëgiminë, kjo nuk

do të thotë se ajeti që argumenton trashëgiminë është i kufizuar vetëm në lidhje me të. Përkundrazi, ai sqaron mirë një ligj gjithëpërfshirës dhe trashëgimia është një pjesë e saj. Për këtë shohim se si argument në këtë ajet që po komentojmë, është sjellë trashëgimia e Profetit (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), megjithëse ajo nuk përfshihet në temën e trashëgimisë pasurore.¹

Ky është marrë si argument edhe për argumentimin e përparësisë së larjes së të vdekurit, siç e kanë sqaruar qartë trasmetimet islame.²

Duke parë me kujdes çfarë përmendëm më lart, sqarohet se nuk ka argument për atë që kanë këmbëngulur një pjesë e komentuesve për kufizimin e këtij ajeti në çështjen e trashëgimisë. Nëse duam të zgjedhim një komentim të tillë, atëherë pa dyshim se rruga e vetme është që ta konsiderojmë trashëgiminë të përjashtuar nga juridiksioni apo rregulli absolut, të cilën e kanë sqaruar ajetet e mëparshme për të gjithë migruesit dhe ensarët. Themi: Me të vërtetë, ajeti i fundit thotë se kujdesi i të gjithë myslimanëve për njëri-tjetrin nuk e përfshin trashëgiminë.

Kurse, supozimi se ajetet e mëparshme e përfshijnë atë, gjithashtu, edhe trashëgiminë, pastaj ajeti i fundit këtë rregull të saj e ka abroguaar, kjo është shumë larg realitetit, sepse lidhja e kuptimit midis të gjitha këtyre ajeteve, qoftë nga ana shpirtërore apo edhe ngjashmëria shprehimore, e gjitha kjo tregon se ajetet kanë zbritur së bashku në të njëjtën kohë. Për këtë nuk mund të thuhet se ka abrogim midis këtyre ajeteve.

¹ "Usulul Kafij", vëll. 1, f. 285, 287, 288.

² Shih "Xheuahirul Kelam", vëll. 4, f. 33 e më pas.

Megjithatë, nuk ka dyshim se komentimi që është më tepër në harmoni me këto ajete, është ai që sqaruam më lart.

Në fjalinë e fundit të këtij ajeti - e cila është edhe fjalia e fundit e sures "Enfal" - All'llahu i Madhëruar thotë: **"...Me të vërtetë, All'llahu është i Dijshëm për çdo gjë."**

Çdo rregull dhe ligj që ka zbritur në këtë sure ka lidhje me prenë e plaçkën së luftës dhe mësimet e Xihadit e të paqes, me rregullat e robërve të luftës dhe luftën, si dhe me atë çfarë lidhet me migrimin. E gjitha kjo ishte sipas një llogarie precize që harmonizon edhe shpirtin e shoqërisë njerëzore, emocionet njerëzore dhe interesat e përgjithshme.

Hulumtime

1- Migrimi dhe Xihadi

Studimi i historisë islame na tregon se këta dy elementë ishin prej faktorëve kryesorë të triumfit të myslimanëve përballë armikut të tyre. Sikur të mos ishte bërë migrimi, Islami do ishte varrosur në Mekë, e sikur të mos ishte Xihadi, kjo fe nuk do të përhapej apo zgjerohej. Hixhreti e nxorri Islamin nga një zonë specifike drejt vendit të mikpritjes dhe e bëri atë botërore, kurse Xihadi u mësoi myslimanëve se nëse ata nuk mbështeten edhe tek forcat e veta, pa dyshim se armiku i tyre, i cili nuk respekton asnjë prej vendimeve, nuk ka për t'ua njohur as të drejtën më elementare dhe nuk ka për t'ua dhënë të drejtat e tyre legjitime.

Sot, nëse ne duam të ruajmë Islamin nga rrugët qorre dhe të largojmë pengesat që armiqtë kanë vënë në rrugën e tij nga çdo

anë, atëherë nuk ka rrugë tjetër përveç ringjalljes së këtyre dy cilësive: migrimi dhe Xhahadi.

Sa i përket migrimit, ai e përçon zërin e myslimanëve në veshët e të gjithë botës dhe shuan etjen e zemrave për të vërtetën e drejtësinë.

Kurse Xhahadi u jep myslimanëve lëvizjen dhe jetën dhe u largon armiqtë e tyre, të cilëve nuk u bën dobi asgjë veç gjuhës së forcës.

Hixhreti në Islam ka ndodhur shumë herë. Në fillim ka qenë migrimi i i myslimanëve nga Meka në Abisini, ku ata mbollën Islamin jashtë Gadishullit të Arabisë dhe ndërtuan një mburojë për myslimanët e parë përballë presioneve të armiqve të tyre.

Pastaj ka ndodhur hixhreti i Profetit (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) dhe i myslimanëve të parë drejt Medines. Këta muhaxhirë, të cilët emërtohen me emrin "migruesit e Bedrit", kanë një rëndësi të madhe në historinë e Islamit, sepse ata u drejtuan drejt një të ardhmeje të panjohur e të errët, i mbyllën sytë për gjithçka kishin në rrugë të All'llahut dhe i refuzuan mbeturinat e dynjasë. Këta emigrantë, pra "emigrantët e parë", në të vërtetë simbolizuan gurin e themelit të strukturës së Islamit dhe Kur'ani i lavdëron ata dhe u jep një kujdes të veçantë, sepse ata kanë qenë myslimanët që kanë bërë sakrificën më të madhe.

Termi "Emigrimi i dytë" është përdorur për emigrimin e një grupi tjetër të myslimanëve drejt Medines. Kjo ka ndodhur pas marrëveshjes së pajtimit të Hudejbijes dhe arritjes së një mjedisi relativisht të sigurtë pas kësaj paqeje. Emri i migrimit është

përdorur për çdo emigrant nga Meka drejt Medines, që pas ngjarjes së Bedrit e deri në kohën e çlirimit të Mekës.

Pas çlirimit të Mekës u shfuqizua emigrimi nga Meka në Medine, sepse edhe Meka u bë një qytet mysliman dhe hadithi profetik i njohur *“Nuk ka hixhret pas çlirimit”*, e konfirmon këtë kuptim. Mirëpo kjo thënie nuk do të thotë se kuptimi i hixhretit u fshi totalisht nga fjalori i principeve islame, siç e mendojnë një pjesë. Por ligji i migrimit mbetet në fuqi dhe do të qëndrojë për sa kohë që Islami zgjerohet derisa ta përfshijë të gjithë botën. Për fat të keq, për shkak të harresës së kësaj baze të rëndësishme islame, shumica e myslimanëve u vetëizoluan, ndërkohë që shikojmë kristianët predikues, grupet e humbura dhe kolonialiste që emigrojnë në çdo cep të banueshëm, duke shkuar deri tek fiset dhe grupimet e vetmuara, të cilët hanë mishin e njeriut në vende të panjohura afrikane, lundrojnë në të dyja polet e ngurtësuar, Polin e Jugut dhe të Veriut, në rrugën e realizimit të qëllimeve të tyre. Megjithëse kjo është detyrë e myslimanëve, puna ka nisur nga të tjerët!

Gjëja më e habitshme është ekzistenca e shumë vendeve afër qyteteve të mëdha islame, në një distancë jo shumë të largët, por që banorët e tyre nuk dinë asgjë rreth Islamit, nuk i njohin as rregullat e tij dhe mbase nuk kanë parë kurrë as fytyrën e ndonjë përcjellësi të mesazhit islam atje. Prandaj mjedisi i tyre është i përgatitur për zhvillimin e mikrobit të shkatërrimit dhe të shthurjes, të doktrinave të ndryshme dhe risive që i shpik kolonializimi. Ne nuk e dimë se si do t'i përgjigjen myslimanët, që janë trashëgimtarët e emigruesve të parë, Zotit të tyre në Ditën e Kiametit, për këtë situatë të mjerë.

Pavarësisht se së fundmi shohim shfaqjen e disa lëvizjeve në lidhje me këtë, ato janë të kufizuara dhe të pamjaftueshme. Si

do që të jetë, tematika e migrimit, ndikimi i tij në historinë islame dhe rrugëtimi i myslimanëve është më e gjerë se sa kjo përmbledhje. (Ne do të flasim në lidhje me këtë tek komentimi i ajeteve që trajtojnë këtë temë, në dashtë All'Ilahu).

2- Ekzagjerimi dhe për përpjekjet e shumta për pastrimin e Sahabëve

Disa nga vëllezërit tanë të Ehli Synetit janë përpjekur të konstatojnë kujdesin dhe respektin që u ka dhënë Kur'ani muhaxhirëve të parë, se ata nuk do bëjnë asnjë mëkat deri në fund të jetës së tyre. Ata thonë për respektimin dhe nderimin e tyre pa përjashtim dhe pa e kundërshtuar këtë apo atë. Pastaj këtë thënie, ata e përgjithësuan për të gjithë sahabët - në respekt të muhaxhirëve. Kjo për shkak të lavdërimit që u ka bërë Kur'ani në blerjen e kënaqësisë e të tjera gjëra, dhe thanë se sahabët - pa i parë veprat e tyre - janë njerëz të dalluar. Kështu që nuk i lejohet askujt t'i kritikojë ata dhe të vërtetojë sjelljet e tyre.

Pjesë e këtyre është komentuesi i njohur i Kur'anit, autori i librit "El Manar", i cili në komentimin e këtyre ajeteve që po diskutojmë, ka sulmuar egërsisht shí'itët, sepse ata i kritikojnë muhaxhirët e parë. Ai nuk e kthen shikimin për të parë se një bindje e tillë nuk është në kundërshtim as me shpirtin e Islamit e as me historinë islame!!

Nuk ka asnjë dyshim se sahabët - në mënyrë të veçantë ata që emigruan - kanë një paprekshmëri specifike. Por kjo paprekshmëri qëndronte për sa kohë që ata ishin në rrugën e vërtetë dhe sakrifikonin për hir të vërtetës. Mirëpo, ajo që pajtohet, është se pikëpamja e Kur'anit apo gjykimi i tij për disa prej tyre, ndryshoi

që kur një pjesë e tyre devijuan nga rruga e drejtë dhe e vërtetë. Për shembull, si mundemi ne të shfajësojmë Talhan dhe Zubejrin për prishjen e besës së imamit të tyre, që e zgjodhën myslimanët (pa marrë parasysh thëniet e sakta të Profetit për pozitën dhe gradën e Imam Aliut"? Talha dhe Zubejri ishin prej atyre myslimanëve që i dhanë besën Imam Aliut. Si mund të shfajësohen ata nga gjaku i 17000 myslimanëve që u vranë në luftën e Xhemelit? Dihet se para All'llahut nuk ka justifikim e shfajësim për gjakderdhjen e një njeriu të vetëm, sido që të jetë ai. Atëherë, si do të jetë gjendja e një numri kaq të madh të vvarësh?

Vallë, a mundet që Imam Aliun (*Paqja qoftë mbi të!*) dhe shokët e tij në luftën e Xhemelit t'i konsiderojmë të njëjtë me armiqtë e tyre?! Po ashtu, a mund t'i konsiderojmë Talhanë, Zubejrin dhe kushdo që ka qenë me ata të dy se kanë qenë me të vërtetën?! A e pranon logjika këtë antagonizëm flagrant?

A mund t'i mbyllim sytë vetëm për hir të emërtimit "pastrimi i sahabëve" dhe të mos e shikojmë historinë dhe të harrojmë gjithçka që ka ndodhur pas vdekjes së Profetit (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) dhe ta hedhim pas shpine rregullin e Kur'anit: **"Më i miri ndër ju tek All'llahu është ai më i devotshmi"**?¹

Si gjykoni kështu?!

Çfarë e pengon njeriun që të jetë prej banorëve të Xhennetit, duke mbështetur të vërtetën një ditë, dhe të jetë prej banorëve të Xhehennemit, duke mbështetur të kotën dhe armiqtë e së vërtetës ditën tjetër? ... A janë të gjithë të mbrojtur nga mëkati? A nuk i shohim me sytë tanë ndryshimet e gjendjeve të njerëzve?!

¹ Sure, "Huxhurat", ajeti 13.

Historia e "Es'habu er riddeti" dhe renegati i një grupi myslimanësh pas udhëtimit të Profetit (*Paqja dhe bekimet e All'Ilahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) është e përmendur në librat e Ehli Syneetit dhe të Shi'itëve. Khalifi i parë u përball me ata dhe i luftoi. A mund të mohohet se askush prej "Es'habu er rideti" nuk e kanë parë Profetin dhe nuk kanë qenë pjesë e sahabëve?

Më e çuditshmja është se një pjesë kapen pas ixhtihadit¹ për të shpëtuar nga rruga qorre dhe kundërshtitë e thanë: Vërtet, të njëjtët si Talha, Zubejri, Muaviu dhe ata që ishin përrreth tyre bënë ixhtihad dhe kanë gabuar por nuk janë gjynahqarë. Madje ata janë të shpërblyer për veprat e tyre tek All'Ilahu i Madhëruar! Sa logjikë e turpshme është kjo?!

A është kryengritja kundër khalifit të Profetit, shkelja e betimit dhe gjakderdhja e mijëra njerëzve të pafajshëm, për hir të kryesive të kësaj bote dhe dashurisë për pasuri, diçka komplekse, e paqartë dhe askush nuk e di se çfarë të këqijash ka në të?! Vallë, në gjakderdhjen e gjithë atyre njerëzve të pafajshëm ka një shpërblim tek All'Ilahu?!

Nëse dëshirojmë shfajësimin apo justifikimin e disa sahabëve për krimet që kanë kryer, atëherë nuk do të shohim asnjë kriminel apo mëkatar në këtë botë. Me këtë logjikë do të shfajësojmë e do të justifikojmë të gjithë vrasësit, kriminelët dhe tiranët.

Vërtet, një mbrojtje e tillë - për sahabët - është e palogjikshme dhe do të shkaktonte keqkuptim për thelbin e Islamit.

Së fundmi themi se ne nuk kemi rrugë tjetër veç respektimit të të gjithëve, e veçanërisht sahabët e Profetit (*Paqja*

¹ Ixhtihad ka kuptimin e përpjekjes për të arritur në një mendim të caktuar.

dhe bekimet e All'lahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) për sa kohë që ata nuk kanë devijuar nga rruga e drejtë dhe e vërtetë islame. Përndryshe s'ka respekt.¹

3 - Trashëgimia në rregullat e Islamit

Siç e kemi cituar më parë në komentimin e sures “En Nisa”, njerëzit në periudhën e injorancës trashëgoheshin nëpërmjet tre mënyrave:

1- Prejardhjes, origjinës (që ishte e kufizuar te fëmijët meshkuj, kurse fëmijët femra dhe gratë ishin të përjashtuar nga trashëgimia).

2- “Adoptimit”, duke e bërë djalin e dikujt tjetër të tijin.

3- Besëlidhjes, që shprehej me besnikëri.²

Në fillim të Islamit, zbatoheshin njëta gjë deri sa zbriti ligji dhe rregulli i trashëgimisë. Por, kur u krye vëllazëria islame dhe migruesit trashëguan vetëm ensarët. Ata janë që u vëllazëruan dhe i dhanë besën vëllazërisë islame. Pasi Islami u zgjerua gjithnjë e më shumë, u legjitimua ligji i trashëgimisë, i cili e abrogoi ligjin e vëllazërisë islame në trashëgimi.

Për këtë na kanë treguar ajetet që po diskutojmë si dhe ajeti 6 i sures “El Ahzab”, ku thotë: “**...Sipas Librit të All'lahut, pjesëtarët e farefisit janë më të afërt për njëri-tjetrin...**”

E gjitha kjo është konfirmuar në histori. Por – siç e kemi thënë më parë – fjalia “**pjesëtarët e farefisit**” e përmendur në

¹ Rreth drejtësisë dhe ruajtjes së sahabëve nga mëkati, përsërit fundin e ajetit 100 të sures “Et Teube”.

² E kemi trajtuar në mënyrë të detajuar temën e trashëgimisë me besëlidhje në Xhuzin e tretë.

ajetet që po diskutojmë, nuk është e posaçme vetëm me çështjen e trashëgimisë. Përkundrazi, ajo ka një kuptim më të gjerë dhe trashëgimia është pjesë e saj.

4- Çfarë nënkuptohet me fjalët “trazirë” dhe “shkatërrim i madh”?

Në komentimin e këtyre dy fjalëve të përmendura në ajetet që janë objekt studimi, komentuesit e Kur'anit kanë dhënë shumë mendime. Më i sakti ndër to është mendimi se ajo që nënkuptohet me “fitnen” (trazirën) është kontradikta, përçarja dhe tronditja e themeleve të doktrinës islame nën ndikimin e cytjeve të armiqve.

Kurse “fesadi” (shkatërrimi) përfshin çdo prishje dhe shkatërrim të sistemeve të ndryshme shoqërore, e në mënyrë të veçantë gjakderdhjen e njerëzve të pafajshëm, terrori dhe të ngjashmet me të.

Kur'anit famëlartë i paralajmëron myslimanët se nëse nuk i forcojnë lidhjet vëllazërore dhe bashkëpunimin ndërmjet tyre e nëse nuk e ndërpresin lidhjen e tyre me armikun, atëherë xhematit të tyre do t'i shtohet copëtimi ditë pas dite dhe me depërtimin e armiqve brenda shoqërisë islame, cytjet dhe tundimet e tyre do të trondisin themelet e besimit dhe shtyllat e tij. Në këtë mënyrë, myslimanët sprovohen me një trazirë të madhe.

Po kështu, nëse lidhjet shoqërore nuk janë të forta, atëherë armiku depërton me shpejtësi në shoqëri dhe shkakton llojet e të këqijave të terrorit, gjakderdhjes, humbjes së pasurive, mashtrimin e fëmijëve dhe dobësia dhe e keqja e madhe e përfshin të gjithë vendin.

*O Zoti ynë, zgjoje shoqërinë tonë islame me mëshirën Tënde! Na paralajmëro për rreziqet e bashkëpunimit me armiqtë dhe krijimit të lidhjes me ta dhe mbaje larg shoqërinë tonë nga ngatërresa, e keqja e madhe, me dritën e dijes dhe unitetin e fjalës!
Pranoje, o Zot i botëve!*

Sure “Et Teube”

**Kjo sure ka zbritur në Medine
dhe ka 129 ajete**

Disa shënime:

Para se të fillojmë me komentimin e kësaj sureje, është e nevojshme të marrin në konsideratë disa pika:

Emrat e kësaj sureje

Komentuesit e Kur'anit kanë përmendur më shumë se dhjetë emra për emërtimin e kësaj sureje. Emërtimet më të njohura janë: "Beraet", "Teube" dhe "Fadh'iha". Secili prej këtyre emrave ka një argument të qartë. Emërtimi i sures me emrin "Beraet" është bërë, sepse kjo sure fillon me besëthyrjen dhe pakënaqësinë e Zotit ndaj politeistëve tradhtarë.

Emërtimi i sures me emrin "Teube" është, sepse në këtë sure flitet shumë për pendimin, kurse emërtimi "Fadh'ihe" është bërë, sepse ajete të ndryshme të kësaj sureje flasin për komprometimin, turpërimin dhe çnderimin e hipokritëve, si dhe për zbulimin e veprave të tyre.

Kur ka zbritur kjo sure?

Kjo është sureja e fundit apo një prej sureve të fundit që i ka zbritur Profetit (*Paqja dhe bekimet e All'lahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) në Medine dhe ka 129 ajete.

Thuhet se zbritja e ajeteve të kësaj sureje ka filluar në vitin e nëntë të hixhretit. Përmbajtja e ajeteve të kësaj sureje bën të qartë, se një pjesë e saj ka zbritur para luftës së Tebukut, një pjesë gjatë përgatitjes për këtë luftë, kurse pjesa tjetër e saj ka zbritur pas kthimit nga lufta.

Ajetet nga 1-28 kanë zbritur në prag të ritualit të përvitshëm të Haxhit. Këto ajete flasin për gjendjen e papërcaktuar të politeistëve dhe iu komunikuan njerëzve nga Imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*) gjatë pelegrinazhit të Haxhit.

Përmbajtja e sures “Et Teube”

Duke pasur parasysh faktin që kjo sure ka zbritur në kohën kur Islami po arrinte kulmin e vet në Gadishullin Arabik e njëkohësisht po dobësohej qëndresa e politeistëve, përmbajtja e saj ka rëndësi të veçantë. Kjo sure ka fraza të ndjeshme.

a- Një pjesë e rëndësishme e saj ka të bëjë me politeistët e mbetur, me idhujtarët, me ndërprerjen e marrëdhënieve me ta, si dhe me anulimin e traktateve, që i kishin lidhur me myslimanët (për shkak të shkeljeve të njëpasnjëshme të marrëveshjeve nga ana e tyre), në mënyrë që të hiqen përgjithmonë mbetjet e idhujve nga mjedisi islam.

b- Me përhapjen e Islamit dhe thyerjen e radhëve të armiqve, një grup njerëzish ndryshuan fytyrë dhe hynë në radhët e myslimanëve me synimin, që, me t’u krijuar kushtet e përshtatshme, ta godisnin Islamin. Kjo përbën pjesën tjetër të rëndësishme të kësaj sureje, ku flitet për hipokritët dhe fatin e tyre dhe myslimanët paralajmërohen ashpër, duke numëruar shenjat e hipokritëve.

c- Pjesa tjetër e kësaj sureje ka të bëjë me rëndësinë e xhihadit (luftës në rrugën e Zotit); sepse, në këtë periudhë, neglizhimi i kësaj çështjeje jetike, do të shkaktonte dobësimin, sprapsjen, madje humbjen e myslimanëve.

d- Pjesa tjetër e rëndësishme e sures, si plotësuese e trajtesave të kaluara, ka të bëjë me devijimin e njerëzve të Librit

(çifutëve dhe të krishterëve) nga e vërteta e monoteizmit, tregon për heqjen dorë të dijetarëve nga përgjegjësia e udhëheqjes dhe e ndriçimit shpirtëror.

e- Gjithashtu, në disa ajete të saj, në vazhdimësi të diskutimeve për xhihadin, u bën thirrje myslimanëve për unitet dhe për forcim të rreshtave, kurse kundërshtarët, pra individët përtacë dhe të dobët, që me anë të justifikimeve të ndryshme, i iknin përgjegjësisë së xhihadit, i qorton dhe i fajëson shumë ashpër. Në antitezë me frikacakët, falënderon dhe lavdëron myslimanët e parë, si dhe besimtarët e vërtetë.

f- Edhe pse shoqëria islame e asaj kohe kishte kërkesa dhe nevoja të ndryshme që duhej të plotësoheshin, përmend çështjen e zekatit, mos grumbullimin dhe kapitalizimin e pasurisë, thekson domosdoshmërinë e nxënies së diturisë, si dhe përhapjen e dijes te personat e paditur.

g- Përveç çështjeve të lartpërmendura, në këtë sure, sipas rastit, janë pasqyruar dhe çështje të tjera, si: shpërngulja e Profetit (*Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*), ndalimin e luftës në muaj të veçantë (të shenjtë), çështjen e dhënies së xhizjes (pagesë që bëhej nga jomyslimanët për ta gëzuar lirinë në fe e në jetë në shtetin islam) nga ana e minoriteteve fetare dhe shembuj të ngjashëm me to.

Pse kjo sure nuk nis me fjalën “Bismil’lah”?

Përgjigjen e kësaj pyetjeje na e jep fillimi i sures, ku deklarohej lufta kundër armiqve, tradhtarëve, shfaqjen e urrejtjes, mospëlqimin, si dhe ballafaqimin e ashpër dhe të fortë kundër atyre. Gjithashtu, në fillim shprehet zemërimi i Zotit ndaj këtij grupi, që nuk përpunet me kuptimin e shprehjes “Bismil’lahir-

Rrahmanir-Rrahim", që është shenjë e paqes, dashurisë dhe përshtetësisë së cilësisë së mëshirës së All'Ilahut.

Kjo çështje është pasqyruar në një hadith të transmetuar nga Imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*).¹

Një grup tjetër komentuesish janë të mendimit se kjo sure pason suren "El Enfal", pasi në këtë sure është diskutuar për traktatet, kurse në këtë sure është folur për prishjen e këtyre traktateve nga ana e besëprerëve. Kjo është arsyeja e mospërmendjes së fjalës "Bismil'lah".

Në lidhje me këtë çështje është transmetuar një hadith nga Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*).² Nuk ka asnjë problem që heqja e "Besmeles" të mbështetet në të dy argumentet, hadithet e lartpërmendura.

Mirësitë e leximit të kësaj sureje

Në transmetimet islame i është kushtuar një rëndësi e veçantë leximit të kësaj sureje dhe sures "El Enfal". Një hadith i transmetuar nga Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) flet për vlerën e leximit të kësaj sureje: "Ai që lexon çdo muaj suren "Beraet"- "Et Teube" dhe suren "El Enfal", në zemrën e tij nuk do të ketë vend për shpirtin e hipokrizisë dhe do të jetë prej pasuesve dhe ndjekësve të drejtë të Imam Aliut (*Paqja qoftë mbi të!*)".³

¹ "Mexhmaul Bejjan", fillimi i sures "Et Teube", "Mustredekul Uesail", vëll. 4, f. 229; "Biharul Enuar", vëll. 82, f. 53, vëll. 90, f. 145; "Seedul seud", f. 71-72, shtëpia botuese "Dhekhair", Kum.

² "Mexhmaul Bejjan", Fillimi i sures "Et Teube", "Nuruth Thekelejn", vëll. 2, f. 176, Fondacioni "Ismailijan", "Biharul Enuar", vëll. 29, f. 277; Tefsiri "Ijashi", vëll. 2, f. 73, Shtypshkronja "Ilmije Teheran".

³ "Uesailu Shia", vëll. 6, f. 250; "Mustedrek", vëll. 4, f. 339-340; "Biharul Enuar", vëll. 29, f. 277 dhe vëll. 94, f. 133.

E kemi përmendur shumë herë, në hadithe të ndryshme rëndësinë e jashtëzakonshme që ka leximi i sureve të ndryshme, por kjo nuk nënkupton që leximi pa mend dhe pa veprim të ketë këto efekte fantastike. P.sh, nëse një person i lexon fjalët e sures “Beraet” dhe “Enfal” pa ditur kuptimin e tyre, nuk është e thënë që ai do të jetë larg hipokrizisë dhe do të renditet në mesin e punëdrejtëve.

Por këto synojnë përmbajtjen e sures dhe efektin konstruktiv të saj në edukimin e individit dhe të shoqërisë, gjë që nuk është e mundur pa perceptimin e kuptimit dhe zbatimin praktik të saj.

Në këto dy sure janë përcaktuar qartë rreshtat e besimtarëve të drejtë dhe të hipokritëve dhe linjat ndarëse të jetës së tyre. Për ata që janë njerëz të veprës dhe jo të fjalës, u ka bërë plotësisht të qartë rrugën. Si rrjedhojë, leximi i këtyre sureve, duke medituar dhe duke perceptuar përmbajtjen dhe mënyrën e jetësimit të tyre në rrjedhën e jetës, ka efekt të jashtëzakonshëm. Ata që Kur'anin dhe ajetet e ndritura të tij, i shohin si një magji, janë të huaj nga shpirti i këtij Libri edukues dhe formues të njeriut.

Rëndësia e këtyre çështjeve, që parashtrohen në këtë sure, është kaq e madhe, sa është përmendur edhe nga transmetimet e ardhura nga Profeti (*Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) në të cila thuhet: *“Suret ‘Beraet’ dhe ‘Teuhid’ më kanë zbritur mua së bashku me 70 mijë rreshta engjëjsh. Secili prej tyre porosiste rëndësinë e këtyre dy sureve.”*¹

¹Tefsiri “Mekhmaul Bejjan”, vëll. 5, f. 1, ajeti në fjalë; “Buhuth fi tarikhel Kur’an”, f. 48, botimet “Xhamiul Muderresin”; Tefsiri “Ebi Seud”, fundi i sures “Et Teube”; Tefsiri “Bejdhauij”, fundi i sures “Et Teube”; Tefsiri “Keshshaf”, fundi i sures “Et Teube”.

Perceptimi i një të vërtete historike

Pothuajse të gjithë komentuesit dhe historianët janë të mendimit se në momentin që zbriti kjo sure, ose ajetet e para të saj dhe i anuloi marrëveshjet e politeistëve, që i kishin me myslimanët, Profeti (*Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) i dha këtë urdhër Ebu Bekrit që gjatë kryerjes së Haxhit në Mekë, t'ia komunikojë popullit. Më pas e mori atë dhe ia dorëzoi Imam Aliut, kështu që ai u përcaktua për shpalljen e tij. Gjatë pelegrinazhit të Haxhit, Imam Aliu ua komunikoi të gjithë të pranishmëve.

Edhe pse detajet e saj janë rrëfyer në mënyra të ndryshme, duke u bazuar te pikat e mëposhtme do të qartësohen shumë paqartësi:

a- Ahmed Hanbel, dijetari i shquar i Ehli Syneetit në librin e tij "Musned", nga Ibn Abbasi transmeton: "*Profeti, filan personi (ka për synim Ebu Bekrin, që do të bëhet e qartë nga transmetimet e ardhshme) e dërgoi dhe i dha suren 'Et Teube', që t'ua kumtojë njerëzve gjatë pelegrinazhit të Haxhit. Pas tij dërgoi Imam Aliun, i cili deklaroi: 'Komunikimi i kësaj sureje duhet të jetë vetëm nga ai person që është prej meje dhe unë jam nga ai.'*"¹

Gjithashtu, në të njëjtin libër, nga Enes bin Malik, është transmetuar se Profeti (*Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) suren "Beraet" e dërgoi me anë të Ebu Bekrit. Por kur arriti në Dhil Hulejfe (i quajtur dhe Mesxhidi i Shexheres dhe ishte një *Farsakh*² larg nga Medina), tha: "*Këtë sure nuk duhet ta*

¹ "Musned Ahmed", vëll. 1, f. 331, shtëpia botuese "Sadir", Bejrut, në 6 vëllime.

² Një Farsakh është njësi matëse dhe afërsisht është e barabartë me 5.5 km.

komunikojë askush tjetër përpos meje, ose atij personi që është nga Ehli Bejti im (Familja ime). Më pas suren e dërgoi me Imam Aliun.”¹

Po ashtu, në po të njëjtin libër, me një rrugë tjetër transmetohet nga Imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*) se, kur Profeti (*Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ia dha suren “Beraet”, Imam Aliu iu drejtua atij me këto fjalë: “O i Dërguari i Zotit! Unë nuk jam orator dhe predikues.”

Profeti iu përgjigj: “Nuk kam rrugëzgjdhje tjetër përpos kësaj, ose Unë duhet ta komunikoj atë, ose ti.”

Imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*) tha: “Meqë është kështu, unë do ta komunikoj.”

Profeti tha: “Shko se Zoti yt do ta forcojë gojën tënde dhe do ta udhëzojë zemrën.”

Më pas Profeti (*Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) vendosi dorën e tij në gojën e Imam Aliut (*Paqja qoftë mbi të!*), që me anë të bekimit të tij të fliste rrjedhshëm.²

Nisaiu, udhëheqës i njohur i Ehli Syneetit, në librin e tij “Khasais” transmeton nga Zejd ibn Juthej, nga Imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*): “Profeti (*Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*), me anë të Ebu Bekrit, e dërgoi suren ‘Beraet’ drejt banorëve të Mekës. Më pas ai dërgoi Imam Aliun dhe i tha: ‘Merrja letrën atij dhe nisu drejt popullit të Mekës.’”

¹ “Musned Ahmed”, vëll. 3, f. 212; shtëpia botuese “Sadir”, Bejrut, në 6 vëllime.

² “Musned Ahmed”, vëll. 3, f. 212; shtëpia botuese “Sadir”, Bejrut, në 6 vëllime.

Imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*) gjatë rrugës e arriti Ebu Bekrin, ia mori letrën. Ndërkohë Ebu Bekri, i mërzhitur dhe i zemëruar, u kthye te Profeti dhe iu drejtua atij: “A ka zbritur ndonjë ajet për mua?” (që më shkarkove mua nga kjo punë).

Profeti iu përgjigj: “Jo, Unë jam përcaktuar që këto ajete t’i komunikoj vetë, ose një person prej familjes sime.”¹

Gjithashtu, në bazë të një transmetimi tjetër nga Abdullah ibn Rakimi, kemi se Profeti (*Paqja dhe bekimi i All’llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) caktoi Ebu Bekrin për komunikimin e sures “Beraet”. Por, pasi kishte bërë një pjesë të rrugës, dërgoi Imam Aliun (*Paqja qoftë mbi të!*) t’ia marrë atij suren dhe ta çojë në Mekë.

Ndërkohë Ebu Bekri, ndjeu një lloj keqardhjeje dhe shqetësimi brenda vetes dhe shkoi te Profeti (*Paqja dhe bekimi i All’llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*).

Ai iu përgjigj: “Askush tjetër veç meje ose një person prej familjes sime, nuk ka të drejtë ta komunikojë këtë sure.”²

Dijetari i njohur Ibn Kethiri, në tefsirin e tij transmeton nga Ahmed ibn Hanbeli, ky i fundit transmeton përmes Haneshit nga Imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*) hadithin në vijim: “Në kohën që Profetit (*Paqja dhe bekimi i All’llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) i zbritën dhjetë ajetet e para të sures ‘Beraet’, e thirri Ebu Bekrin dhe e caktoi atë që këto ajete t’ua komunikojë popullit të Mekës.”

Më pas më dërgoi mua pas tij dhe më tha: “Shko pas Ebu Bekrit dhe, kur ta takosh, merrja letrën atij.”

¹ “Khasaisu Nisai”, f. 28.

² Po aty.

Kur Ebu Bekri u kthye te Profeti (*Paqja dhe bekimi i All'Ilahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*), e pyeti: “A ka zbritur ndonjë gjë rreth meje?”

Profeti iu përgjigj: “Jo. Por Xhebraili më tha se këtë sure duhet ta komunikoj ose unë, ose një prej familjes sime.”¹

b- Të njëjtën përmbajtje ka transmetuar Ibn Kethiri nga Zejd Ibn Juthej.²

c- Po ashtu, i njëjti dijetar i Ehli Synetit këtë hadith e ka cituar në tefsirin e vet, me një zinxhir transmetimi tjetër nga Imam Bakiri (*Paqja qoftë mbi të!*) (Ebu Xhaferr Muhammed bin Ali bin Husejn bin Ali).³

d- Dijetari i shquar Ibn Ethir, një dijetar tjetër i Ehli Synetit, në “Xhamiul Usul” ka transmetuar nga Termidhiu, nga Enes ibn Maliki: “Profeti, suren ‘Beraet’ e dërgoi me Ebu Bekrin. Më pas e thirri atë dhe i tha: ‘Askush nuk është i denjë për komunikimin e kësaj sureje përpos një burri nga familja ime.’ Më pas e thirri Imam Aliun (*Paqja qoftë mbi të!*) dhe ia dorëzoi suren.”⁴

e- Muhibbud-Din Taberiu, dijetar i Ehli Synetit, në librin “Dhehair-ul Ukba” ka transmetuar nga Ebu Saidi: “Profeti caktoi si kujdestar të Haxhit Ebu Bekrin. Kur arriti në Dhexhnan, dëgjoi zërin e devesë së Aliut (*Paqja qoftë mbi të!*). E njohu atë, iu afrua dhe i tha atij: ‘Përse ke ardhur?’

¹ Tefsiri i “Ibn Kethirit”, vëll 2, f. 332.

² Po aty.

³ Po aty.

⁴ “Xhamiul Usul”, vëll. 9, f. 475; “Sunene Termidhij”, vëll. 4, f. 339, shtëpia botuese “El-Fikr Bejrut”, Botim i dytë, Hulumtim i Abdurrahman Muhammed Osmanit.

Imam Aliu (Paqja qoftë mbi të!) tha: 'Profeti suren 'Beraet' e dërgoi me mua'. Kur Ebu Bekri u kthye te Profeti, i shprehu shqetësimin për ndërrimin e misionit. Profeti iu përgjigj: 'Këtë sure nuk e komunikon askush përveç meje dhe personit që është prej meje, Aliu (Paqja qoftë mbi të!).''¹

Në hadithe të tjera janë dhënë hollësi dhe shpjegime të shumta, për shembull: Profeti (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) devenë e tij ia dha Imam Aliut (*Paqja qoftë mbi të!*), që të niset në drejtim të Mekës për të komunikuar këtë mesazh. Kur Imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*) ishte në mes të rrugës, Ebu Bekri e dëgjoi dhe e njohu zërin e devesë.

Ky hadith dhe ajo që u tha më sipër, qartësojnë çështjen e devesë. Deveja ishte e Profetit (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), por ia dha Imam Aliut për të kryer këtë detyrë të rëndësishme.

Në shumë libra të tjerë të dijetarëve të Ehli Syneetit, ky hadith ndonjëherë është transmetuar me zinxhir të plotë transmetimi, ndonjëherë jo. Vlen të theksohet se ky hadith është prej atyre haditheve që nuk mund të kundërshtohet, që askush nuk ka vërejtje ndaj thelbit të tij.

Në përputhje me disa hadithe, që janë transmetuar nga dijetarët syni, Ebu Bekri, pasi u largua nga pozita e komunikimit të kësaj sureje, shkoi në Mekë si udhëheqës i haxhinjve dhe ishte përgjegjës për Haxhin.

¹ "Dhekhairul Ukba", f. 69, botoi: "Mektebejel Kudsij" i Husamuddine Kudsij, marrë nga kopja e Bibliotekës Kombëtare të Egjiptit dhe kopja e Khezainetul Tejmurieh.

Sqarim dhe shqyrtim

Ky hadith vërteton në mënyrë të qartë një virtut të lartë të Imam Aliut (*Paqja qoftë mbi të!*). Por fatkeqësisht, si shumë hadithe të tjera të ngjashme me këtë, janë lënë pas dore. Një grup njerëzish përpiqen ta nënvlerësojnë atë në tërësi, ose t'ia ulin vlerën, duke zgjedhur disa rrugë:

1- Ndonjëherë, si autori i “El Manarit”, prej haditheve që kanë të bëjnë me këtë pjesë, përzgjedh vetëm ato hadithe që flasin për kujdestarinë e Ebu Bekrit mbi Haxhin. Ndërsa ngjarjen e marrjes së sures “Beraet” prej Imam Aliut, nuk e ka përmendur fare, madje as fjalët që i ka thënë Profeti për Imam Aliun (*Paqja qoftë mbi të!*).

Ndërkohë që nuk duhen të lihen jashtë të gjitha ato hadithe që lidhen me këtë ngjarje, pasi metoda e hulumtimit kërkon që të merren parasysht të gjitha hadithet, sado kundër dëshirës apo paragjykimeve të hulumtuesit të jenë.

2- Herë tjetër, i njëjti komentues, që u përmend më lart, zbeh zinxhirin e transmetimit të disa haditheve, si p.sh. hadithet, që transmetimi i tyre përfundon me “Simakun” dhe “Hanashin”.

Ky hadith nuk ka vetëm një apo dy zinxhirë transmetimi dhe transmetuesit e tij nuk janë vetëm Simaku dhe Hanashi, por janë dhënë dhe zinxhirë të ndryshëm transmetimi.

3- Ndonjëherë hadithit i janë veshur justifikime “të mahnitshme”, si p.sh: Profeti e caktoi Imam Aliun përgjegjës për kumtimin e sures “Beraet”, sepse kështu ishte zakoni arab,

komunikimi i anulimit të marrëveshjeve duhet të kryhet nga vetë personi apo nga një prej familjarëve të tij.

Duhet të theksojmë:

Së pari, në mënyra të shumta është përshkruar qartë se Profeti (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ka deklaruar: “Këtë urdhër ma solli Xhebraili!” ose “Jam ngarkuar me një mision të tillë.”

Së dyti, në disa prej transmetimeve të këtyre haditheve, që u përmendën më lart, lexojmë se Profeti (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ka thënë: “Nëse ti nuk e kryen këtë vepër, unë jam i detyruar ta kryej vetë atë”

A nuk kishte vallë persona si Abbasi, xhaxhai i Profetit (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ose njerëz të tjerë prej farefisit të tij, që, nëse nuk shkonte Aliu, duhet të shkonte me patjetër Profeti (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*)?

Së treti, për këtë zakon të arabëve nuk kanë cituar asnjë lloj dëshmie, kështu që kuptohet se hamendësimi dhe mendimi për të justifikuar hadithin e lartpërmendur ka qenë sipas dëshirës së tyre.

Së katërti, në disa prej zinxhirëve të këtij hadithi, fjalia “Këto ajete duhet të komunikohen vetëm nga burri që është prej meje dhe unë prej tij” ose ngjashëm me të, e bën të qartë se Profeti e

konsideronte Aliun nga vetja dhe veten nga Aliu. (Të njëjtën kuptim e hasim në ajetin e Mubahes.)¹

Nga e gjithë ajo që u tha më lart, arrijmë në përfundim, duke i lenë mënjanë paragjykimet dhe fanatizmin, se Profeti, me anë të kësaj vepre, ka përcaktuar pozitën më të lartë të Imam Aliut, në krahasim me shokët e tjerë.

¹ "Musned Ahmed", vëll. 1, f. 331, Bejrut, në 6 vëllime. "El Mestedrekul Nishaburi", vëll. 3, f. 133, Shtëpia botuese "El Mearif", Bejrut.

Ajetet 1 - 2

بَرَاءَةٌ مِّنَ اللَّهِ وَرَسُولِهِ إِلَى الَّذِينَ عَاهَدْتُمْ مِّنَ الْمُشْرِكِينَ ﴿١﴾
 فَسِيحُوا فِي الْأَرْضِ أَرْبَعَةَ أَشْهُرٍ وَاعْلَمُوا أَنَّكُمْ غَيْرُ مُعْجِزِي
 اللَّهِ وَأَنَّ اللَّهَ مُخْزِي الْكَافِرِينَ ﴿٢﴾

"Lirim (i deklaruar) nga ana e All'Ilahut dhe të Dërguarit të Tij prej çdo detyrimi ndaj idhujtarëve me të cilët kishit bërë marrëveshje."

"Udhëtoni nëpër botë ju (idhujtarë) edhe katër muaj (të sigurt), por ta dini se nuk do të mund t'i shpëtoni All'Ilahut dhe se All'Ilahu do t'i poshtërojë mohuesit."

Komentimi

Marrëveshjet e politeistëve do të shfuqizohen

Në fillimin e thirrjes së Islamit ekzistonin grupe të ndryshme njerëzish dhe Profeti (*Paqja dhe bekimet e All'Ilahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), me secilin prej tyre, sillej sipas qëndrimeve të tyre.

Një grup prej tyre nuk kishin lidhur asnjë lloj marrëveshje me Profetin (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) dhe Profeti (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) nuk kishte asnjë lloj angazhimi kundrejt tyre.

Grupe të tjera në Hudejbije dhe të ngjashëm me të, kishin lidhur marrëveshje për heqjen dorë nga konflikti me Profetin (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*). Disa prej këtyre marrëveshjeve kishin afat të caktuar, ndërsa disa të tjera nuk kishin.

Përveç kësaj, disa nga fiset që kishin lidhur marrëveshje me Profetin (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), si çifutët e Beni Nazirit dhe Beni Kurejdhes, e thyen, pa ndonjë shkak, këtë marrëveshje, këtë besëlidhje, sepse dëshironin të bashkëpunonin me armiqtë e Islamit, apo përpiqeshin për zhdukjen e Profetit.

Për këtë arsye Profeti (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ndaj këtyre veproi me forcë dhe i dëboi nga Medina. Por një pjesë e këtyre marrëveshjeve akoma ishin në fuqi, duke përfshirë këtu marrëveshjet me afat dhe pa afat kohor.

Ajeti i parë i diskutimit tonë i njofton të gjithë politeistët se do t'u shfuqizohet çdo lloj marrëveshje që kanë pasur me myslimanët: **“Lirim (i deklaruar) nga ana e All'llahut dhe të Dërguarit të Tij prej çdo detyrimi ndaj idhujtarëve me të cilët kishit bërë marrëveshje.”**

Më pas atyre u përcaktohet një afat kohor, prej katër muajsh, që të meditojnë, të mendojnë dhe të vendosin për

qëndrimin e tyre. Pas përfundimit të afatit të caktuar (katër muaj), ata ose të heqin dorë nga adhurimi i idhujve, ose të përgatiten për luftë, siç e thotë ajeti: **“Udhëtoni nëpër botë ju (idhujtarë) edhe katër muaj (të sigurt),¹ por ta dini se nuk do të mund t’i shpëtoni All’llahut dhe se All’llahu do t’i poshtërojë mohuesit.”**

Hulumtime

1- A është i drejtë anulimi i njëanshëm i marrëveshjeve?

Dimë se Islami i ka kushtuar një rëndësi të veçantë çështjes së besës dhe respektimit të marrëveshjeve, madje edhe ndaj politeistëve dhe armiqve. Tani lind pyetja: Si është e mundur që Kur’ani urdhëron për shfuqizimin dhe anulimin e njëanshëm të marrëveshjes me politeistët?

Përgjigjja e kësaj pyetjeje do të bëhet e qartë me shpjegimin e çështjeve të mëposhtme:

Së pari, ashtu siç thuhet dhe në ajetet 7- 8 të kësaj sureje, ky anulim dhe prishja e marrëveshjes nuk ishte pa themel, sepse ishin ravijëzuar dhe kishin ndodhur një mori shenjash të shkeljes së marrëveshjes nga ana e politeistëve, të cilët ishin në gatishmëri, që, kur u jepej rasti, duke mos treguar as kujdesin më të vogël ndaj marrëveshjeve që kishin lidhur me myslimanët, i godisnin rëndë ata.

Është tepër e logjikshme se, nëse njeriu shikon se armiku po thyen besën dhe marrëveshjen, si dhe vëren shenja të

¹ Fjala “*sijhu*” rrjedh nga fjala “*sejahet*” dhe është në kuptimin e udhëtimit të shoqëruar me qetësi.

mjaftueshme incidentesh për një gjë të tillë, para se të kapet në befasi, shpall prishjen e marrëveshjes dhe ngrihet kundër tij.

Së dyti, marrëveshjet të cilat i imponohen një populli për shkak të kushteve dhe rrethanave të veçanta dhe ata e ndiejnë veten të detyruar për pranimin e saj, nuk ka asnjë pengesë që pas arritjes së fuqisë, marrëveshje të tilla të anulohen në mënyrë të njëanshme!

Idhujtaria nuk ishte as fe dhe as ndonjë shkollë racionale, por ishte një besim i rrezikshëm, bazuar në besëtytni e imagjinata. Idhujtaria duhej të hiqej nga shoqëria njerëzore. Edhe pse ndikimi i idhujtarëve në Gadishullin Arabik ishte shumë i madh, sa që Profeti u detyrua të pranonte paqen dhe të lidhte marrëveshje me ta, ky nuk është argument që në momentin e fuqizimit t'i qëndronte besnik një marrëveshjeje të tillë të imponuar, e cila ishte kundër logjikës, arsyes dhe urtësisë.

Kjo është e ngjashme me atë person reformator, që kërkon të zhdukë adhurimin e lopës, siç është në disa shtete, që për arsye të ndryshme jetësore, të lidhë marrëveshje me adhuruesit. Me të gjetur pasues dhe ithtarë të mjaftueshëm, reformatori bën kryengritje dhe rifillon fushatën e tij "të fshesës" ndaj këtyre ideve të vjetra dhe të kalbura, si dhe anulon marrëveshjen me ta.

Ky urdhër u përkiste vetëm politeistëve, kurse Njerëzve të Librit dhe popujve të tjerë, të cilët jetonin nëpër rrethinat e Hixhazit, që në një farë mënyre kishin lidhur marrëveshje me Profetin (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), u është respektuar marrëveshja deri në çastin e fundit të jetës së Profetit.

Përveç kësaj, anulimi i marrëveshjes së politeistëve nuk u bë në mënyrë të menjëhershme. Përkundrazi atyre iu dha katër muaj kohë për të medituuar dhe për të reflektuar për këtë çështje. Lajmërimi iu bë të gjithëve në ditën e festës së Kurbanit Bajramit, pranë Qabesë, për të vetmen arsye, që të hiqnin dorë nga ky besim i devijuar, i cili ishte shkak i prapambetjes, i injorancës, i përçarjes dhe i ligësisë.

Zoti i Madhëruar asnjëherë nuk ishte dakord që ky lajm t'i kapte në befasi dhe t'ua hiqte atyre mundësinë për të medituuar dhe për të reflektuar. Madje, edhe nëse nuk do të pranonin Islamin, iu dha kohë e mjaftueshme për të mbledhur forcat që ta mbronin vetveten, në mënyrë që të mos përfshihen në një luftë të padrejtë.

Nëse Profeti nuk do të kishte synime edukative dhe nuk do të respektonte parimet njerëzore, asnjëherë nuk do ta zgjonte armikun, duke i dhënë katër muaj kohë, si dhe mundësi të mjaftueshme për të mbledhur forcat dhe për t'u përgatitur për luftë.

Në këtë rast duhej që në një ditë të caktuar, pas anulimit të njëanshëm të marrëveshjes, papritur t'i sulmonte dhe t'i zhdukte ata.

Shohim se shumë prej idhujtarëve e shfrytëzuan këtë periudhë katër mujore, duke studiuar mësimet islame dhe iu rikthyen fesë islame.

2- Kur filloi kjo periudhë katër mujore?

Për përgjigjen e kësaj pyetjeje ka shumë mosmarrëveshje në mesin e komentuesve të Kur'anit. Por ajo që përftohet nga kuptimi i ajeteve të lartpërmendura, periudha katër mujore është nga koha

kur kjo shpallje iu lexua të gjithë njerëzve, në ditën e festës së Kurban Bajramit (më dhjetë Dhil Hixhxhe), deri te dita e dhjetë e muajit Rabi'u Thani, në fillim të vitit vijues.

Kjo gjë miratohet edhe nga hadithi i transmetuar nga Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*).¹

¹ Tefsiri "Burhan", vëll. 1, f. 103, "Usule Kafi", vëll. 4, f. 290. "Darul kutubul islamiye, Uesailu Shia," vëll. 11, f. 273; vëll. 14, f. 43-44. "Biharul Enuar", vëll. 21, f. 265-266, 272-274; vëll. 35, f. 292, 295 dhe 301; vëll. 96, f. 321-322, 333.

Ajetet 3 - 4

وَأَذَانٌ مِّنَ اللَّهِ وَرَسُولِهِ إِلَى النَّاسِ يَوْمَ الْحَجِّ الْأَكْبَرِ أَنَّ اللَّهَ
 بَرِيءٌ مِّنَ الْمُشْرِكِينَ وَرَسُولُهُ ۚ فَإِن تُبْتُمْ فَهُوَ خَيْرٌ لَّكُمْ وَإِن
 تَوَلَّيْتُمْ فَأَعْلَمُوا أَنَّكُمْ غَيْرُ مُعْجِزِي اللَّهِ وَبَشِّرِ الَّذِينَ
 كَفَرُوا بِعَذَابٍ أَلِيمٍ ﴿٣﴾ إِلَّا الَّذِينَ عَاهَدْتُمْ مِّنَ الْمُشْرِكِينَ ثُمَّ
 لَمْ يَنْقُصُوا شَيْئًا وَلَمْ يُظَاهِرُوا عَلَيْكُمْ أَحَدًا فَأَتِمُوا إِلَيْهِمْ
 عَهْدَهُمْ إِلَىٰ مُدَّتِهِمْ إِنَّ اللَّهَ يُحِبُّ الْمُتَّقِينَ ﴿٤﴾

"Ja shpallja e All'Ilahut dhe e të Dërguarit të Tij drejtuar njerëzve në ditën e Haxhit të madh: 'All'Ilahu dhe i Dërguari i Tij shkëpusin çdo detyrim ndaj idhujtarëve'. Nëse ju (idhujtarë) pendoheni, është më mirë për ju; por, nëse largoheni (nga pendimi), ta dini se nuk do të mund t'i shpëtoni All'Ilahu! Njoftojti mohuesit për dënimin e dhembshëm (që i pret)."

"Përrjashtim bëjnë ata idhujtarë, me të cilët keni lidhur marrëveshje e që nuk ju kanë shkelur asgjë prej saj dhe që nuk kanë ndihmuar askënd kundër jush. Respektojeni marrëveshjen me ta deri në fund. Me të vërtetë, All'Ilahu i do ata që (i) frikësohen (Atij)."

Komentimi

Marrëveshja e tyre është respektuar

Në këto ajete, theksohet sërish çështja e anulimit dhe prishjes së marrëveshjeve të politeistëve, madje caktohet edhe data e shpalljes së saj: **“Ja shpallja e All’lilahun dhe e të Dërguarit të Tij drejtuar njerëzve në Ditën e Haxhit të madh: ‘All’lilahu dhe i Dërguari i Tij shkëpusin çdo detyrim ndaj idhujtarëve.’”**

Zoti dëshiron që, me anë të kësaj shpalljeje të përgjithshme në tokën e Mekës, si dhe duke qenë një ditë e madhe, t’i mbyllë rrugët e justifikimëve të armikut dhe të bllokojë gjuhën e keqndjellsëve dhe të intrigantëve, në mënyrë që ata të mos pretendojnë se i kanë kapur në befasi, ndërkohë që ishin plotësisht të pavetëdijshëm dhe sulmuan në mënyrë të padrejtë.

Duhet të kemi parasysh se shprehja *“ilennas”*, në vend të fjalës *“ilel mushrikijn”*, tregon se ishte e nevojshme që ky mesazh t’u komunikohet të gjithë njerëzve që ishin të pranishëm Ditën e Haxhit në Mekë, në mënyrë që edhe jopoliteistët të ishin dëshmitarë për këtë çështje.

Më pas, u drejtohet politeistëve me gjuhën e kërcënimit, duke i nxitur që të udhëzohen.

Ajeti vazhdon me këtë fjali: **“Nëse ju (idhujtarë) pendoheni, është më mirë për ju...”**, që do të thotë se pranimi i fesë së monoteizmit është në dobinë tuaj, të shoqërisë dhe të jetës suaj, në këtë botë dhe në Botën Tjetër. Nëse mendoni drejt, të

gjitha paqartësitë dhe amullia juaj do të organizohen nën dritën e saj. Kjo nuk do t'i sjellë ndonjë dobi apo përfitim Zotit dhe Profetit.

Pas kësaj, kundërshtarëve dogmatikë dhe kryeneçë u drejtohet në këtë mënyrë: **"...por, nëse largoheni (nga pendimi), ta dini se nuk do të mund t'i shpëtoni All'Ilahut!..."**

Në fund të këtij ajeti e shpall rrezikun e madh që i pret ata, të cilët rezistojnë me kokëfortësi: **"Njoftoji mohuesit për dënimin e dhembshëm (që i pret)."**

Edhe më herët e kemi cekur faktin se ky anulim i njëanshëm i marrëveshjes me politeistët, ishte për ata persona, ku shenjat e përgatitjes për nëpërkëmbjen e marrëveshjes dukeshin qartë. Kjo është arsyeja që në ajetin 4 përjashtohet një grup: **"Përjashtim bëjnë ata idhujtarë, me të cilët keni lidhur marrëveshje e që nuk ju kanë shkelur asgjë prej saj dhe që nuk kanë ndihmuar askënd kundër jush. Respektojeni marrëveshjen me ta deri në fund. Me të vërtetë, All'Ilahu i do ata që (i) frikësohen (Atij)."**

Hulumtime

1- Cili është Haxh ekber?

Për Ditën e Haxhit (ekber-Haxhin) të madh, midis komentuesve të Kur'anit ka mospajtime. Ajo që përftohet nga shumë transmetime dhe hadithe, të transmetuara nga nga Ehli Bejti dhe Ehli Syneti është se dita e dhjetë e muajit Dhil Hixhxe,

dita e festës së Kurban Bajramit, ndryshe është quajtur dhe Jeumul Nehr.¹

Përfundimi i periudhës katër mujore, gjer në ditën e dhjetë të muajit Rebiul Thani, sipas asaj që është thënë në burimet islame, është një argument tjetër për këtë çështje.

Përveç kësaj, në ditën e Festës së Kurbanit përfundon dhe pjesa e rëndësishme e veprimeve të Haxhit. Pikërisht për këtë mund ta quajmë dhe Dita e Haxhit.

Kurse për sa i përket emërimit “ekber” është se në atë vit të gjitha grupet, përfshirë këtu myslimanët dhe idhujtarët (në bazë të traditës që kishin në të kaluarën), kishin marrë pjesë në ceremoninë e kryerjes së Haxhit. Një gjë e tillë u ndalua në vitet në vijim.

Përveç interpretimit të lartpërmendur, që e hasim edhe në transmetimet islame,² ekziston edhe një interpretim tjetër. Fjala “ekber” përdoret për të bërë dallimin midis Haxhit dhe Umres – “Haxh asger” (Haxhi i vogël).

Ky komentim gjithashtu është përmendur në një pjesë të transmetimeve. Këto janë dy arsyetime që shpjegojnë emërtimin e Haxhit.³

¹ “Biharul Enuar”, vëll. 96, f., 321-322, 333, K. 56, Kuptimi i “el haxhul ekber”.

² Tefsiri “Nuruth Thalkelejn”, vëll. 2, f. 184, Fondacioni “Ismailijan”, Botim i katërt, 1412 Hixhri kameri; “Biharul Enuar”, vëll. 35, f. 293; vëll. 96, f. 321-322; “Ilelul Sheraii”, vëll. 2, f. 442, Botimet “Mektebeje daveri”, Kum, “Meaniul Ehbar”, f. 296, Botimet “Xhamiu Muderissin”, Kum 1361 Hixhri shemsi.

³ Po aty, vëll. 2, faqet 185-186, Fondacioni “Ismailijan”, Botim i katërt, 1412 Hixhri kameri; “Usule kafi”, vëll. 4, f. 290; “Darul kutubul islamije Uesailu Shia”, vëll. 14, f. 43, 81, 296, dhe 298; “Biharul Enuar”, vëll. 21, f. 272; vëll. 96, f. 322, 333, 358, etj.

2- Katër nenet që u shpallën atë ditë

Edhe pse Kur'ani, shpalljen e mospëlqimit dhe mosdashjes së Zotit prej politeistëve e ka përmendur në mënyrë të përmbledhur, nga transmetimet islame përftohet që Imam Aliu ishte përgjegjës që t'u komunikojë njerëzve katër çështje:

1. Anulimin e marrëveshjes me politeistët.
2. Idhujtarët dhe politeistët nuk kanë të drejtë të marrin pjesë vitin e ardhshëm në ceremoninë e Haxhit.
3. Politeistët e kanë të ndaluar të bëjnë tauaf rreth Qabes duke qenë lakuriq. Kjo gjë ishte praktikë në atë kohë në mesin e politeistëve.

4. Politeistët e kanë të ndaluar ta frekuentojnë Qaben.¹

Në tefsirin "Mexhmaul Bejjan", nga Imam Bakiri (*Paqja qoftë mbi të!*), është transmetuar se Imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*) në atë vit, në Haxh, mbajti një fjalim. Midis të tjerave tha: *"Tani e tutje, asnjë i zhveshur lakuriq nuk ka të drejtë të bëjë tauaf rreth Qabes dhe asnjë idhujtar nuk ka të drejtë të marrë pjesë në ceremoninë e Haxhit. Atyre që nuk u ka përfunduar akoma koha e marrëveshjes me Profetin, kjo kohë do të respektohet deri në fund, ndërsa atyre që nuk kanë afat të caktuar, do të kenë katër muaj kohë."*²

Në disa transmetime të tjera është aluduar në çështjen e katërt, idhujtarët nuk lejohen të frekuentojnë Qaben.³

¹ Në disa transmetime, çështja e katërt është përmendur si "mosfutja e politeistëve në Xhennet"; "Mustedrek", vëll. 9, f. 408- 409; "Biharul Enuar", vëll. 35, f. 285, 290, 298, 301, 303 307, etj.

² "Biharul Enuar", vëll. 21, f. 267; vëll. 35 f. 296 dhe 303; "Mexhmaul Bejjan", ajetet 1-2 të sures "Et Teube".

³ "Biharul Enuar", vëll. 21, f. 266-267 dhe 274; vëll. 35, f. 292, 295, 296 , etj.

3- Cilët persona kishin marrëveshje me afat të caktuar?

Duke u bazuar në thëniet e historianëve dhe të disa prej komentuesve dalim në përfundim se grupi që kishte marrëveshje me afat të caktuar ishin nga fisi Beni Kenane dhe Beni Dhamra, të cilëve u kishte ngelur dhe nëntë muaj nga afati i marrëveshjes për mosluftim. Meqenëse ishin treguar besnikë ndaj neneve të marrëveshjes, si dhe nuk kishin ndihmuar për përforcimin e armiqve të Islamit, Profeti i qëndroi besnik marrëveshjes së tyre deri në përfundim të afatit të saj.¹

Disa të tjerë e kanë përmendur fisin Beni Khuzae si pjesë të këtij grupi, që marrëveshja e tyre ishte me afat.²

¹ "Mexhmaul Bejjan", vëll. 5, ajeti në diskutim; "Biharul Enuar", vëll. 36 f. 138; vëll. 21, f. 268; vëll. 35, f. 300-302.

² Tefsiri "El Manar", vëll. 10, ajeti në fjalë.

Ajetet 5 - 6

فَإِذَا أَنْسَلَخَ الْأَشْهُرَ الْحُرْمَ فَاقْتُلُوا الْمُشْرِكِينَ حَيْثُ
 وَجَدْتُمُوهُمْ وَخُذُوهُمْ وَأَحْصُرُوهُمْ وَأَقْعُدُوا لَهُمْ كُلَّ مَرْصَدٍ فَإِنْ
 تَابُوا وَأَقَامُوا الصَّلَاةَ وَآتَوُا الزَّكَاةَ فَخَلُّوا سَبِيلَهُمْ إِنَّ اللَّهَ
 غَفُورٌ رَحِيمٌ ﴿٥﴾ وَإِنْ أَحَدٌ مِنَ الْمُشْرِكِينَ اسْتَجَارَكَ فَأَجِرْهُ
 حَتَّى يَسْمَعَ كَلِمَ اللَّهِ ثُمَّ أَبْلِغْهُ مَأْمَنَهُ ۚ ذَٰلِكَ بِأَنَّهُمْ قَوْمٌ لَا
 يَعْلَمُونَ ﴿٦﴾

"Kur të kalojnë muajt e shenjtë (në të cilët ndalohet lufta), atëherë i vritni idhujtarët kudo që t'i ndeshni, i zini robër, i rrethoni dhe u bëni pusi kudo! Por, nëse pendohen, falin namazin dhe japin zekatin, atëherë i lini të qetë! Vërtet, All'Ilahu është Falës dhe Mëshirëplotë."

"Nëse ndonjë nga idhujtarët kërkon mbrojtje nga ti (Muhammed), mbroje, në mënyrë që të dëgjojë fjalën e All'Ilahut, e pastaj përcille në vendin e tij të sigurt. Kështu duhet, sepse ata janë njerëz që nuk dinë."

Komentimi

Veprim i ashpër i shoqëruar me butësi

Në ajetet 5 dhe 6 është përcaktuar detyra e myslimanëve pas përfundimit të afatit të caktuar të politeistëve, pra pas katër muajve, si dhe është lëshuar urdhri më i ashpër për ata: **“Kur të kalojnë muajt e Shenjtë (në të cilët ndalohet lufta), atëherë i vritni idhujtarët,¹ kudo që t’i ndeshni, i zini robër, i rrethoni dhe u bëni pusi kudo!²**

Këtu vërehen katër urdhra të ashpra ndaj tyre; mbyllja e rrugëve, rrethimi i tyre, zënia rob dhe në fund, vrasja e tyre. Këto katër çështjet nuk janë në formën e alternativave. Por duke pasur parasysh kushtet e mjedisit, të kohës, të vendit, si dhe të personave, duhet praktikuar dhe duhet zbatuar ajo çështje që përcaktohet si e përshtatshme.

Nëse vihen nën presion të mjaftueshëm vetëm me anë të zënies rob, rrethimit, apo mbylljes së rrugës, duhen zgjedhur këto rrugë.

Dhe nëse, përpos vrasjes, nuk do të kishte rrugëzgjdhje tjetër, vrasja e tyre është e lejuar.

Kjo sjellje e ashpër ndaj tyre bëhet se programi i Islamit ishte çrrënjësja e idhujtarisë (paganizmit) në të gjithë botën. Ashtu siç e kemi përmendur më lart, çështja e lirisë fetare, që do të thotë mos detyrim i pranimit të Islamit për ndjekësit e feve të tjera, u

¹ Fjala “inselekhe” rrjedh nga fjala “insilakh” dhe ka kuptimin e të dalit jashtë. Rrënja e saj është nga fjala “selekhe shah”, që do të thotë të heqë lëkurën e deles.

² Fjala “mersed” rrjedh nga rrënja “resed” dhe ka kuptimin e rrugës apo strofkës.

përket vetëm feve qiellore dhe Njerëzve të Librit, si hebrejve dhe të krishterëve, por nuk i përfshin idhujtarët, sepse adhurimi i idhujve nuk është fe dhe besim i mirëfilltë që të respektohet. Ajo është dekadencë, besëtytni, devijim dhe sëmundje, që pavarësisht çmimit dhe faktorëve të tjerë, duhet të çrrënjohet.

Kjo ashpërsi dhe ky zemërim nuk është se atyre u është mbyllur rruga e kthimit, por ata, në çdo kohë dhe në çdo moment që dëshirojnë, mund të ndryshojnë drejtimin e tyre: **“Por, nëse pendohen, falin namazin dhe japin zekatin, atëherë i lini të qetë! Vërtet, All’llahu është Falës dhe Mëshirëplotë.”**

Si rrjedhim, ata nuk do të kenë asnjë ndryshim me myslimanët e tjerë, por do të kenë të gjitha detyrimet dhe të drejtat e tyre, sepse Zoti i Madhëruar është **“Falës dhe Mëshirëplotë.”** dhe personi që dëshiron të kthehet te Ai, Ai nuk e dëbon.

Më pas këtë urdhër e plotëson me një urdhër tjetër, në ajetin 6, në mënyrë që të mos mbetet asnjë dyshim se synimi i Islamit është shtrirja e monoteizmit, fesë së vërtetë, drejtësisë dhe jo përvetësimi, shfrytëzimi dhe konfiskimi i pasurisë dhe pronave të tjerëve. All’llahu thotë: **“Nëse ndonjë nga idhujtarët kërkon mbrojtje nga ti (Muhammed), mbroje, në mënyrë që të dëgjojë fjalën e All’llahut...”** , që do të thotë, sillu me qetësi dhe jepi atij mundësinë për të reflektuar dhe për të përsiatuar në mënyrë që të shqyrtojë lirisht përmbajtjen e ftesës tënde, dhe, nëse drita e udhëzimit shndrit në zemrën e tij, pranoje atë!

Më pas shton: **“e pastaj përcille në vendin e tij të sigurt.”**

Në fund e shpjegon arsyen e këtij urdhri: **“Kështu duhet, sepse ata janë njerëz që nuk dinë.”**

Për pasojë, nëse para tyre hapet mundësia (dyert) e përfitimit të njohurisë, ekziston shpresa, se ata do të heqin dorë nga idhujtaria, që ka ardhur si pasojë e injorancës dhe e paditurisë. Hedhja e hapave drejt rrugës së monoteizmit dhe adhurimit të Zotit vjen nga dituria dhe shkenca.

Në burimet shi'ite dhe të Ehli Syneetit është transmetuar se njëri prej idhujtarëve, pasi thyen marrëveshjen me myslimanët, iu drejtua Imam Aliut: *"O djali i Ebu Talibit! Vallë a do të jetë i sigurt ndonjëri nga ne pas kalimit të këtyre katër muajve, nëse dëshiron të takohet me Profetin dhe të diskutojë me të për çështje të ndryshme, ose dëshiron të dëgjojë fjalën e Zotit?!"*

Imam Aliu iu përgjigj: *"Po, sepse Zoti i Madhëruar ka thënë: **"Nëse ndonjë nga idhujtarët kërkon mbrojtje nga ti (Muhammed), mbroje, në mënyrë që të dëgjojë fjalën e All'llahut, e pastaj përcille në vendin e tij të sigurt. Kështu duhet, sepse ata janë njerëz që nuk dinë."***¹

Në këtë mënyrë rreptësia e jashtëzakonshme që është përdorur në ajetin e pestë ndiqet nga butësia në ajetin e gjashtë. Pikërisht kjo është metoda dhe mënyra e më e mirë e edukimit, ku rreptësia në veprim gërshetohet me butësinë dhe nga kjo përftohet ilaçi shërues.

¹ Tefsiri "Burhan", vëll. 2, f. 106; Tefsiri "Fakhr Razi", vëll. 15, f. 226, ajeti në fjalë; "Biharul Enuar", vëll. 35, f. 304; Tefsiri "Kurtubij", ajeti në fjalë.

Hulumtime

1- Cili është kuptimi i shprehjes “*el esh' hurul hurumu*”- muajt e shenjtë?

Komentuesit e Kur'anit kanë diskutuar shumë për këtë çështje. Duke pasur parasysh ajetet e kaluara, bëhet e qartë se Muajt e Shenjtë janë po ato katër muajt e ndalimit, të përcaktuar për idhujtarët. Fillimi i tyre përkon me ditën e dhjetë të muajit Dhil Hixhxe, viti i nëntë Hixhri dhe fundi i tyre është dita e dhjetë e muajit Rabiul Thani të vitit të ardhshëm. Këtë komentim e kanë pranuar shumë prej studiuesve. Është e rëndësishme se shumë transmetime e kanë miratuar atë.¹

2- A është namazi dhe zekati kusht i pranimit të Islamit?

Nga ajetet e lartpërmendura, kuptohet se për pranimin e pendimit të idhujtarëve, është e nevojshme falja e namazit dhe dhënia e zekatit. Disa juristë syni, heqjen dorë nga namazi dhe zekati e kanë konsideruar argument për mosbesim.

Por, e vërteta është se përmendja e këtyre dy urdhrave të rëndësishme islame, nëse ndiqej dhe zbatohet, përcakton besimin islam të këtyre individëve.

Një tjetër arsye e përmendjes së këtyre urdhrave është pranimi dhe zbatimi i tyre si ligje hyjnore. Ka shumë argumente se njeriu që nuk fal namaz dhe nuk jep zekat nuk radhitet në mesin e

¹ Tefsiri “Nuruth Thekalejn”, vëll. 2, f. 187, ajeti në fjalë, botim i Fondacionit “Ismailijan”, botim i katërt. Janë transmetuar disa hadithe për këtë fushë në: “Biharul Enuar”, vëll. 21, f. 274; vëll. 97, f. 53.

jobesimtarëve, porse Islami i tij nuk është i plotë. Në qoftë se heqja dorë prej zekatit vjen si kundërshtim i pushtetit islam, kjo çon në mosbesim.

3- Besimi është i lindur nga dija

Nga ajetet 5 dhe 6 përftohet se faktor i rëndësishëm për mosbesim është injoranca, padija, kurse burimi thelbësor i besimit është dija dhe dituria, ndaj për udhëzimin dhe udhëdrejtimin e njerëzve duhet të vihet në dispozicion çdo mundësi për të studiuar dhe për të medituar, në mënyrë që të gjejnë rrugën e drejtë, që të mos e pranojnë Islamin verbërisht apo si imitim.

Ajetet 7 - 10

كَيْفَ يَكُونُ لِلْمُشْرِكِينَ عَهْدٌ عِنْدَ اللَّهِ وَعِنْدَ رَسُولِهِ إِلَّا الَّذِينَ عَاهَدْتُمْ عِنْدَ الْمَسْجِدِ الْحَرَامِ فَمَا اسْتَقَمُوا لَكُمْ فَلَسْتَقِيمُوا لَهُمْ إِنَّ اللَّهَ يُحِبُّ الْمُتَّقِينَ ﴿٧﴾ كَيْفَ وَإِنْ يَظْهَرُوا عَلَيْكُمْ لَا يَرْقُبُوا فِيكُمْ إِلَّا وَلَا ذِمَّةً يُرْضُونَكُمْ بِأَفْوَاهِهِمْ وَتَأْبَى قُلُوبُهُمْ وَأَكْثَرُهُمْ فَاسِقُونَ ﴿٨﴾ اشْتَرَوْا بِعَائِدِ اللَّهِ ثَمَنًا قَلِيلًا فَصَدُّوا عَن سَبِيلِهِ إِنَّهُمْ سَاءَ مَا كَانُوا يَعْمَلُونَ ﴿٩﴾ لَا يَرْقُبُونَ فِي مُؤْمِنٍ إِلَّا وَلَا ذِمَّةً وَأُولَئِكَ هُمُ الْمُعْتَدُونَ ﴿١٠﴾

"Si mund të kenë idhujtarët besëlidhje me All'llahun dhe të Dërguarin e Tij, me përjashtim të atyre me të cilët keni lidhur ju marrëveshje të Xhamia e Shenjtë?! Sa kohë që ata t'i përmbahen marrëveshjes - përmbajuni edhe ju, sepse All'llahu i do ata që (i) frikësohen (Atij)."

"Si (mund t'u besoni) kur, nëse ju mundin, ata nuk e respektojnë as farefisninë, as marrëveshjen? Ata ju kënaqin me fjalë, ndërsa zemrat e tyre ju kundërshtojnë; shumica e tyre janë të ligj."

"Ata i shesin fjalët e All'Ilahut për një vlerë të vogël dhe i pengojnë njerëzit nga Rruga e Tij. Vërtet të shëmtuara janë veprat e tyre!"

"Ndaj besimtarëve, ata nuk respektojnë as farefisni, as besëlidhje; këta janë tejkaluesit e kufirit (në të këqija)."

Komentimi

Kufijshkelësit që thyejnë besëlidhjen

Në ajetet më lart pamë se Islami i anuloi marrëveshjet e politeistëve dhe adhuruesve të idhujve, përveç një grupi të veçantë dhe u përcaktoi atyre një afat, prej katër muajsh, në mënyrë që të merrnin vendim përfundimtar.

Në këto ajete shpaloset argumenti dhe arsyeja e kësaj vepre. Në fillim u drejtohet në formën e një pyetjeje retorike: **"Si mund të kenë idhujtarët besëlidhje me All'Ilahun dhe të Dërguarin e Tij?"**

Pra, këta, me veprat dhe shkeljet e tyre, nuk duhet të pretendojnë dhe të presin që Profeti të tregohet besnik ndaj marrëveshjes së tyre.

Më pas, menjëherë përjashton një grup nga politeistët, të cilët nuk ishin pjesë e veprimeve shkelëse dhe thyerjes së marrëveshjes: **"...me përjashtim të atyre me të cilët keni lidhur ju marrëveshje te Xhamia e Shenjtë?! Sa kohë që ata t'i përmbahen**

marrëveshjes - përmbajuni edhe ju, sepse All'llahu i do ata që (i) frikësohen (Atij)."

Në ajetin vijues, kjo çështje është paraqitur në mënyrë të qartë dhe me një theks më të madh, sërish në formën e një pyetjeje retorike: **"Si (mund t'u besoni) kur, nëse ju mundin, ata nuk e respektojnë as farefisninë, as marrëveshjen?"**

Fjala *"el il'lu"* është në kuptimin e farefisit dhe lidhjes familjare, kurse disa të tjerë këtë e kanë konsideruar në kuptimin e besëlidhjes dhe të marrëveshjes.

Në rastin e parë, këto ajete u drejtohen kurejshëve, që ishin farefis i Profetit (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) dhe një grup prej myslimanëve. Në atë kohë ata nuk i kanë kushtuar as vëmendjen më të vogël kësaj çështjeje. Kur nuk respektonin farefisin, si mund të prisnin nga Profeti (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) dhe myslimanët t'i respektonin rregullat?

Në rastin e dytë ka për qëllim theksimin e fjalës *"dhimmes"*, që edhe kjo ka kuptimin e marrëveshjes dhe besëlidhjes.

Ragibi, në librin *"Mufredat"*, rrënjën e kësaj fjale e konsideron nga fjala *"il'l"*, që është në kuptimin e ndriçimit, sepse besëlidhjet e fuqishme dhe lidhjet e forta kanë një ndriçim të veçantë.

Më pas Kur'ani shton: **"...Ata ju kënaqin me fjalë, ndërsa zemrat e tyre ju kundërshtojnë."** Asnjëherë mos u mashtroni pas fjalëve dhe bisedave të tyre të ëmbla, sepse zemrat e tyre janë të mbushura me urrejtje, hakmarrje, mizori, mospërfillje ndaj

besëlidhjes, marrëveshjes dhe marrëdhënieve farefisnore, edhe pse me gojë të tyre shprehin miqësi dhe dashamirësi.

Në fund të ajetit i referohet rrënjës thelbësore të kësaj çështjeje: **“...shumica e tyre janë të ligj.”**

Më pas, një nga shenjat e shturjes dhe të mosbindjes së tyre e përshkruan në këtë mënyrë: **“Ata i shesin fjalët e All'llahut për një vlerë të vogël dhe i pengojnë njerëzit nga Rruga e Tij...”**

Në një hadith është transmetuar se Ebu Sufjani shtroi një drekë dhe ftoi një grup njerëzish si mysafirë, në mënyrë që, nëpërmjet kësaj dreke, të ngjallte urrejtjen e tyre ndaj Profetit (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*).¹

Disa nga komentuesit kanë thënë se ajeti i referohet tregimit të lartpërmendur, por duket qartë se ajeti ka një kuptim të gjerë dhe gjithëpërfshirës, duke përfshirë aventurat e tjera të idhujtarëve, që, për të mbrojtur interesat e veta materiale dhe kalimtare, nuk i morën në konsideratë ajetet e Zotit.

Më pas ajeti shton: **“...Vërtet të shëmtuara janë veprat e tyre!”**

Ata jo vetëm që nuk e privonin veten e tyre nga lumturia, udhëzimi dhe prosperiteti, por i pengonin dhe njerëzit e tjerë. A ka vepër më të shëmtuar dhe të ligë se kjo, që njeriu t'i bartë mbi supet e vetë peshën e mëkateve të tij dhe të mëkateve të tjerëve?!

¹ “Mexhmaul Bejjan”, ajeti në diskutim; “Biharul Enuar”, vëll. 21, f. 270; Komentimet “Tabari”, “Kurtubi”, “Bahrul Muhijj”, “Fakhrul Razi”, “Alusij”, si dhe komentime të tjera. “Durrul Menthur”, vëll. 3, f. 214; “Darul Ma'rife”, Botimi i parë, 1365 Hixhri.

Në ajetin e fundit, jo vetëm e rithekson edhe një herë tjetër kuptimin e lartpërmendur, por shton: **“Ndaj besimtarëve, ata nuk respektojnë as farefisni, as besëlidhje; këta janë tejkaluesit e kufirit (në të këqija).”**

Jo vetëm ndaj jush, por e vënë dorën e dhunimit mbi të gjithë ata që kanë mundësi për t’u bërë keq.

Edhe pse përmbajtja e ajetit nëntë thekson çështjen që u diskutua në ajetet e kaluara, ka një dallim dhe diçka shtesë. Në ajetet më lart u fol për shokët e Profetit (*Paqja dhe bekimet e All’llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) dhe myslimanëve që ishin përreth tij.

Kurse në ajetin dhjetë flitet për çdo besimtar, që do të thotë se ata nuk ju veçojnë juve, por kanë armiqësi ndaj çdo besimtari dhe pasuesi të fesë së Vërtetë dhe nuk marrin në konsideratë asgjë. Pra, këta janë armiq të besimit dhe të së vërtetës.

Kjo është e ngjashme me atë që Kur’ani ka thënë për disa nga popujt e kaluar: **“Ata i munduan besimtarët, vetëm pse këta i besuan All’llahut, të Plotfuqishmit, të Denjit për çdo lavd.”**¹

Hulumtime

1- Ka diskutim në mesin e komentuesve të Kur’anit se për cilin grup flet ajeti përjashtues: **“...me përjashtim të atyre me të cilët keni lidhur ju marrëveshje te Xhamia e Shenjtë!”**

¹ Sure “El Buruxh”, ajeti 8.

Por, duke pasur parasysh ajetet e kaluara, kuptojmë se bëhet fjalë për ato fise që i kishin mbetur besnik besëlidhjes dhe marrëveshjes, pra fise si Benu Dhumre dhe Benu Khuzejme.

Kjo fjali është përforsim i kuptimit të ajeteve të mëparshme, se myslimanët duhet të jenë të vetëdijshëm për të bërë dallimin midis këtij grupi, shkelësve dhe tradhtarëve të besëlidhjes.

Kurse shprehja: **“me të cilët keni lidhur ju marrëveshje te Xhamia e Shenjtë?!”** flet për marrëveshjen që bëri një grup politeistësh me myslimanët.

Në vitin e gjashtë Hixhri, myslimanët biseduan me politeistët kurejsh, në Hujdejbije, pesëmbëdhjetë milje larg Mekës. Kësaj marrëveshjeje iu bashkuan edhe grupe të tjera politeistësh arabë dhe lidhën besën që të mos i luftonin myslimanët, të mos i konsideronin armiq ata. Politeistët kurejsh e shkelën marrëveshjen. Ndërsa në vitin e tetë gjatë përpjekjeve për çlirimin e Mekës, e pranuan Islamin. Por grupet në varësi, as nuk u bënë myslimanë, as nuk e thyen marrëveshjen.

Duke pasur parasysh që toka e Mekës është një zonë e gjerë (afërsisht 48 milje). Të gjitha këto n zona konsiderohen pjesë e Xhamisë së Shenjtë, ashtu siç lexojmë në ajetin 196 të sures “El Bekare”, për Haxhin dhe Umren: **“...ky është rregull për ata që nuk e kanë shtëpinë dhe familjen pranë Xhamisë së Shenjtë...”**

Duke u bazuar te hadithet dhe mendimet e juristëve islamë, Haxhi Temettu', është detyrim për ata persona që janë larg Mekës në një distancë prej 48 miljesh,¹ si rrjedhojë, nuk quhet gabim, nëse

¹ “Men la Jehdherehul fakih”, vëll. 2, faqe 312, Botimet “Xhamiu Muderasin”, Kum 1413 hixhri kameri; “Tehdhib”, vëll. 5, f. 32-33; “Darul kutubul ilislamije”, Teheran, 1365 hixhri shemsi; “Vesailul Shia”, vëll. 11, f. 258-259; “Biarul Enuar”, vëll. 10, f. 402 dhe vëll. 96, f. 87-88, 93, 94.

paqja e Hudejbijes, e cila ishte realizuar 15 milje larg Mekës të cilësohet "në Xhaminë e Shenjtë".

Disa nga komentuesit e Kur'anit kanë thënë se "përgjashtimi i lartpërmendur" u përket politeistëve kurejsh. Pra Kur'ani i Madhëruar e ka respektuar marrëveshjen e tyre, të cilën e kishin lidhur në Hudejbije. Thyerja e besës nga ana e politeistëve kurejsh ishte e qartë. Nëse ata nuk ishin besëthyes, atëherë çfarë ishin?

Së dyti, paqja e Hudejbijes i përket vitit të gjashtë Hixhri, ndërkohë që në vitin e tetë, pas Çlirimit të Mekës, politeistët kurejsh e pranuan Islamin, si rrjedhojë ajetet e lartpërmendura, të cilat kanë zbritur në vitin e nëntë Hixhri nuk kanë lidhje me ta.

2- Ashtu siç e cekëm dhe më lart, synimi i ajeteve që janë objekt studimi (7-10) nuk është vetëm vendimmarrja për shkeljen e marrëveshjes në kohën e fuqizimit të tyre, që shërben si leje për anulimin e marrëveshjes me ta, në mënyrë të njëanshme, por fakti është se ata këtë mënyrë të të menduarit e kishin treguar shumë herë në praktikë. Sa herë u jepej mundësia, i luftonin myslimanët, duke mos marrë parasysh marrëveshjen. Vetëm kaq ishte e mjaftueshme për anulimin e marrëveshjes dhe të besëlidhjes.

Ajetet 11 - 15

فَإِنْ تَابُوا وَأَقَامُوا الصَّلَاةَ وَعَآتُوا الزَّكَاةَ فَإِخْوَانُكُمْ فِي الدِّينِ ^ط
 وَنُقِصِلُ الْآيَاتِ لِقَوْمٍ يَعْلَمُونَ ﴿١١﴾ وَإِنْ نَكَثُوا أَيْمَانَهُمْ مِّنْ
 بَعْدِ عَهْدِهِمْ وَطَعَنُوا فِي دِينِكُمْ فَقَتَلُوا أُمَّةَ الْكُفْرِ إِنَّهُمْ لَأَ
 أَيْمَنَ لَهُمْ لَعَلَّهُمْ يَنْتَهُونَ ﴿١٢﴾ أَلَا تُقْتَلُونَ قَوْمًا نَّكَثُوا أَيْمَانَهُمْ
 وَهَمُّوا بِإِخْرَاجِ الرَّسُولِ وَهُمْ بَدَءُوكُمْ أَوَّلَ مَرَّةٍ أَتَخْشَوْنَهُمْ
 فَلِلَّهِ أَحَقُّ أَنْ تَخْشَوْهُ إِنْ كُنْتُمْ مُؤْمِنِينَ ﴿١٣﴾ قَاتِلُوهُمْ يُعَذِّبُهُمْ
 اللَّهُ بِأَيْدِيكُمْ وَيُخْزِيهِمْ وَيَنْصُرْكُمْ عَلَيْهِمْ وَيَشْفِ صُدُورَ
 قَوْمٍ مُّؤْمِنِينَ ﴿١٤﴾ وَيُذْهِبْ غَيْظَ قُلُوبِهِمْ ^ط وَيَتُوبُ اللَّهُ عَلَى مَنْ
 يَشَاءُ ^ط وَاللَّهُ عَلِيمٌ حَكِيمٌ ﴿١٥﴾

"Megjithatë, nëse ata pendohen, falin namazin dhe japin zekatin, atëherë janë vëllezërit tuaj në fe. Kështu ua shpjegojmë shpalljet njerëzve që dinë."

"Por, nëse ata e prishin betimin pas lidhjes së marrëveshjes dhe sulmojnë fenë tuaj, atëherë luftoni kundër krerëve të mosbesimit - sepse ata nuk kanë besë - që të mund të frenohen (nga të këqijat)."

"Vallë, a nuk do të luftoni kundër atyre që e kanë shkelur besëlidhjen, janë përpjekur ta dëbojnë të Dërguarin dhe kanë filluar të parët t'ju sulmojnë?! Vallë, nga ata keni frikë? All'illahu e meriton më shumë se ata që t'i frikësoheni, nëse jeni besimtarë!"

"Luftoni kundër tyre, që All'illahu t'i dënojë ata me duart tuaja, t'i poshtërojë, t'ju ndihmojë juve kundër tyre, t'i shërojë shpirtat e besimtarëve"

"dhe ta largojë hidhërimin nga zemrat e tyre! All'illahu ia pranon pendimin kujt të dojë. All'illahu është i Gjithëdijshtëm dhe i Urtë.

Komentimi

Pse keni frikë për të luftuar me armikun?

Një nga teknikat e retorikës dhe të gojëtarisë është përsëritja dhe theksimi i konceptit apo çështjes që kërkon ta bindësh tjetrin. Duke pasur parasysh se çështja e dhënies së goditjes përfundimtare idhujtarisë në mjedisin islam, si dhe zhdukja e gjurmëve të mbetura të saj, konsiderohej prej çështjeve tepër të rëndësishme, Kur'ani i Madhëruar, edhe një herë tjetër, me anë të shprehjeve të reja, jo vetëm i sjell në vëmendje çështjet e kaluara, por edhe i shpjegon në ajetet që po komentojmë.

Gjithashtu, në këto ajete ekzistojnë pika të reja, duke e nxjerrë diskutimin nga forma e përsëritjes, qoftë ajo përsëritja e lejueshme.

Në ajetin 11 të kësaj sureje All'Ilahu i Madhëruar thotë: **“Megjithatë, nëse ata pendohen, falin namazin dhe japin zekatin, atëherë janë vëllezërit tuaj në fe.”**

Në fund të ajetit thuhet: **“Kështu ua shpjegojmë shpalljet njerëzve që dinë.”**

Në ajetet e kaluara u diskutua kjo çështje, se, nëse pendohen dhe kryejnë detyrimet e Islamit, pra falin namazin dhe japin zekatin, mos i shqetësoni ata, *“fekhal'lu sebilehum”* *“atëherë ua lëshoni rrugën”*. Kurse këtu pohon *“feikhuaneikum fid'din”* *“atëherë janë vëllezërit tuaj në fe”*, që do të thotë se nuk kanë asnjë lloj diference apo dallimi me myslimanët e tjerë, përsa i përket ndjenjës së dashurisë dhe respektit, ashtu siç nuk ekziston asnjë dallim mes vëllezërve.

Kjo ndikon në përgatitjen shpirtërore, mendore dhe emocionale të politeistëve për të përqaftuar Islamin, që në një fazë rekomandon mos shqetësimin dhe lëshimin e rrugës së tyre, kurse në fazën tjetër rekomandon të drejtat ndaj një vëllai.

Në ajetin 12 shton: **“Por, nëse ata e prishin betimin pas lidhjes së marrëveshjes dhe sulmojnë fenë tuaj, atëherë luftoni kundër krerëve të mosbesimit - sepse ata nuk kanë besë.”**

Është e vërtetë që ata lidhën marrëveshje me ju për heqjen dorë nga lufta, por kjo marrëveshje nuk ka vlerë, pasi ata e kanë shkelur vazhdimisht. Ata nuk mjaftohen me kaq, po mendojnë se si do ta shkulin edhe në të ardhmen. Ndoshta duke marrë këto masa të ashpra, si dhe është fakt, që rruga e kthimit për ta është e

hapur, të pendohen dhe të heqin dorë nga veprat e veta: **“...që të mund të frenohen (nga të këqijat).”**

Më pas, për të provokuar myslimanët dhe për të larguar çdo lloj dobësie, frikë dhe pasigurie nga shpirti dhe mendja e tyre, për këtë çështje jetësore, thotë: **“Vallë, a nuk do të luftoni kundër atyre që e kanë shkelur besëlidhjen, janë përpjekur ta dëbojnë të Dërguarin...”**

Fillimi i luftës dhe shkelja e besëlidhjes nuk duhet t’ju shqetësojë dhe t’ju brengosë, sepse luftimi dhe shkelja e besëlidhjes kundër jush u nis nga ata: **“...dhe kanë filluar të parët t’ju sulmojnë?!”**

Nëse hezitimi i disave prej jush, në luftimin kundër tyre është për shkak të frikës, kjo frikë është e pavend: **“Vallë, nga ata keni frikë? All’llahu e meriton më shumë se ata që t’i frikësoheni, nëse jeni besimtarë!”**

Më pas, myslimanëve u premtan një fitore të patjetërsueshme: **“Luftoni kundër tyre, që All’llahu t’i dënojë ata me duart tuaja, t’i poshtërojë, t’ju ndihmojë juve kundër tyre...”**

Në këtë mënyrë i shëron zemrat e njerëzve besimtarë, të cilët ishin nën presion dhe torturë të madhe nga ky grup mizor, që në këtë rrugë kishin bërë shumë sakrifica. Prandaj shton: **“t’i shërojë shpirtat e besimtarëve...”**

Disa nga komentuesit e Kur’anit pohojnë se me shprehjen *“kaumi mu’minin”*- *“njerëz besimtarë”*, synohet një grup

besimtarësh nga fisi Beni Khuzae. Këtë grup besimtarësh e sulmoi një grup idhujtarësh nga fisi Beni Bekr.¹

Disa të tjerë kanë thënë se me shprehjen *“shpirtrat e besimtarëve”* synon një grup njerëzish nga Jemeni, të cilët e kishin përqafuar dhe e kishin pranuar Islamin, por meqenëse kishin emigruar në Mekë, u sulmuan dhe u torturuan nga idhujtarët.²

Por nuk është e pavend që kjo shprehje të përfshijë të gjithë njerëzit, të cilët, në një farë mënyre, ishin nën presionin dhe torturat e idhujtarëve, si dhe zemrat e tyre ishin të mbushura plot me vuajtje nga ata.

Ajeti vazhdon: **“...dhe ta largojë hidhërimin nga zemrat e tyre!”**

Kjo fjali ka mundësi të jetë një theksim për fjalinë e lartpërmendur: **“...dhe shëron zemrat e njerëzve besimtarë.”**, gjithashtu, kjo fjali ka mundësi të ndryshojë nga ajo. Fjalja e lartpërmendur mund të jetë aludim se falë fitores së Islamit, zemrat të cilat për vite me radhë ishin në dridhje, në vuajtje dhe të sëmura për shkak të Islamit dhe Profetit (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) gjetën përmirësim.

Dhe fjalja e dytë të jetë aludim se me anë të vrasjes së armiqve mizorë, Zoti i mënjanon brengat nga zemrat e atyre për shkak të humbjes së të dashurve apo farefisit, si dhe durimit ndaj

¹ “Biharul Enuar”, vëll. 21, f.271-272, “Mesned ibn el Xha'd”, f. 55, “Darul kutubul ilmije”, Bejrut; “El Musannaf ibn ebi Shejbe El Kufi”, vëll. 8, f. 533; “Darul fikr”, Botim i parë, 1409 Hixhri kameri; “Mexhmaul Bejjan” dhe tefsire të tjera, tek ajeti në fjalë.

² “Biharul Enuar”, vëll. 21, f. 271-272; “Mesnede ibn el Xha'd”, f. 55; “Darul kutubil ilmije”, Bejrut; “El Musnafa, ibn ebi Shejbe El Kufij”, vëll. 8, f. 533; “Darul fikr”, Botim i parë, 1409 Hixhri kameri; “Mexhmaul Bejjan” dhe komentime të tjera, ajeti në fjalë.

torturave dhe ngacmimeve të llojlojshme që ishin plot zemërim dhe shqetësim.

Dhe në fund të ajetit thuhet: **“All’Ilahu ia pranon pendimin kujt të dojë. All’Ilahu është i Gjithëdijshtëm dhe i Urtë.”**

Ndërkohë, fjalitë e fundit janë aludim se, nëse në të ardhmen ata pendohen, Zoti do ta pranojë pendimin e tyre, ndërsa dhuna kundër tyre nuk lejohet.

Gjithashtu është një përgëzim se njerëz të tillë në të ardhmen do të bashkohen me myslimanët, si dhe mëshira e bekimi i Zotit, për shkak të gatishmërisë shpirtërore të tyre, do t’i përfshijë.

Në përgjithësi, disa nga komentuesit e Kur’anit, ajetet 11-15 i kanë konsideruar si lajme të fshehta kur’anore, si shenja të vërtetësisë së Thirrjes profetike, sepse atë që e ka thënë Kur’ani këtu, është realizuar (dhe ka ndodhur).

Hulumtime

1- Shkelësit e besëlidhjes

Ka mosmarrëveshje mes komentuesve të Kur’anit se cilët janë shkelësit e besës.

Disa kanë thënë se shkelësit e besës është populli hebre.

Disa të tjerë kanë thënë se janë popujt që në të ardhmen u përleshën me myslimanët, si shtetet e Iranit dhe të Bizantit.

Disa të tjerë e kanë interpretuar si politeistët kurejsh.

Të tjerë, si një pjesë prej njerëzve që ishin bërë myslimanë, por kishin hequr dorë nga feja.

Por ajetet dëshmojnë se bëhet fjalë për po atë grup të politeistëve dhe të idhujtarëve, të cilët në atë kohë, teorikisht, kishin lidhur besën për të mos i luftuar myslimanët, por praktikisht e thyen besën e tyre. Ishin ose një grup prej politeistëve të rrethinave të Mekës, ose nga vendet tjera të Hixhazit.

Mundësia se ky grup mund të ishte hebre është shumë e pakët, sepse të gjitha çështjet dhe diskutimet e këtyre ajeteve kanë të bëjnë me politeistët.

Gjithashtu, nuk ka mundësi që të jetë fisi kurejsh, sepse kurejshët dhe kreu i tyre, Ebu Sufjani, e pranuan Islamin në vitin e tetë Hixhri, pas çlirimit të Mekës, ndërkohë që surja që po diskutojmë, ka zbritur në vitin e nëntë.

Po ashtu, mendimi se mund të ishin mbretërit iranianë apo bizantinë është i papranueshëm dhe shumë larg kuptimit të ajeteve, sepse ajetet flasin për një konflikt dhe mosmarrëveshje aktuale, jo për konfliktet e ardhshme. Përveç kësaj, ata nuk e kishin dëbuar Profetin (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) nga atdheu i tij.

Është e pranueshme se grupi në fjalë mund të jetë nga ata që kishin hequr dorë nga Islami, sepse historia nuk tregon se në atë kohë ekzistonte ndonjë grup i fuqishëm prej atyre që kishin dalë nga feja, në mënyrë që myslimanët të kërkojnë luftimin me ta.

Përpos kësaj, fjala "*ejman*", shumësi i fjalës "*jemin*", si dhe fjala "*ahd*", tregojnë dukshëm marrëveshjen e paqes e jo pranimin e Islamit.

Në disa transmetime islame, ky ajet është krahasuar me luftënxitësit e Xhemelit (Nakethinët) e të ngjashëm me ta, sepse fryma e ajetit dhe dispozita e tij përputhet me veprimet e Nakethinëve dhe grupeve të ngjashme, që më vonë do të vijnë në pushtet.

E vetmja pyetje që mbetet është: Nëse ajeti flet për grupin e adhuresve, të cilët e kishin thyer besën dhe për të cilët u fol në ajetet e kaluara, atëherë përse këtu shprehet: “**...nëse ata e prishin betimin pas lidhjes së marrëveshjes...**”, ndërkohë që këto grupe i kishin shkelur marrëveshjet?

Përgjigjja e kësaj pyetjeje jepet nëpërmjet shpjegimit të qëllimit të dhënies së fjalisë, nëse ata do të vazhdonin ta thyenin marrëveshjen dhe nuk do të hiqnin dorë nga shkeljet e tyre, atëherë duhet të luftoni me ta. Kjo fjali është e ngjashme me shprehjen “*ihdinas siratal mustekim*”, që do të thotë “O Zot, udhëzoni në rrugën e drejtë.”¹

Dëshmi e kësaj fjalie është fjalia e lartpërmendur: “**...nëse ata e prishin betimin pas lidhjes së marrëveshjes...**” ndodhet përbri fjalisë “**po nëse ata pendohen...**”, që do të thotë se ekzistojnë dy mundësi, ose ata pendohen dhe të heqin dorë nga idhujtaria dhe politeizmi, duke u kthyer kështu në rrugën e Zotit, ose të vazhdojnë rrugën e tyre. Në rastin e parë ata konsiderohen vëllezërit tuaj, kurse në rastin e dytë duhet të luftoni me ta.

2- Luftimi me parinë politeiste

Duhet të kemi parasysh faktin se ajetet e lartpërmendura nuk thonë: “luftoni me politeistët”, por “luftoni me parinë dhe udhëheqësit e tyre”, duke aluduar se masa e gjerë e njerëzve

¹ Sure “El Fatiha”, ajeti 6.

ndjekin parinë dhe udhëheqësit e tyre. Ju duhet t'i keni gjithnjë nën shënjestër, sepse duhet t'i mbyllni burimet e devijimit, të humbjes, të ngatërresës, të padrejtësisë dhe të korrupsionit, si dhe të shkulni rrënjën e saj, sepse, derisa ata të ekzistojnë, luftimi me pasuesit dhe ndjekësit e tyre nuk do të sjellë asnjë dobi.

Përveç kësaj, kjo shprehje konsiderohet një lloj zmadhim i pozitës, stimulim ambiciesh për myslimanët, që pala juaj kryesore janë ata, përgatituni për t'i luftuar kryetarët dhe jo njerëzit e thjeshtë.

I çuditshëm është fakti që disa këtë shprehje ia kanë dedikuar Ebu Sufjanit dhe udhëheqësve tjerë të kurejshëve, ndërkohë që një pjesë prej tyre ishin vrarë në luftën e Bedrit dhe pjesa e mbetur (si Ebu Sufjani), pas çlirimit të Mekës, e pranuan Islamin dhe në momentin e zbritjes së ajetit kishin zënë vend në rreshtin e myslimanëve, kështu që luftimi me ta nuk kishte ndonjë kuptim.

Edhe sot në ditët tona, ky urdhër i rëndësishëm kur'anor akoma nuk e ka humbur peshën e vet. Për të zhdukur dhunën dhe korrupsionin, kolonializmin dhe shfrytëzimin pozicionimi duhet të jetë kundrejt parive dhe udhëheqësve të këtyre grupeve, pasi marrja me njerëzit e zakonshëm nuk sjell dobi.

3- Vëllazëria fetare

Përdorimi i shprehjes “...atëherë janë vëllezërit tuaj në fe”, në ajetet e lartpërmendura, është shprehja më e këndshme që mund ta deklarojmë për barazinë e njerëzve të një shoqërie me lidhjet më të forta emocionale, sepse shembulli më i qartë dhe më i afërt i lidhjes së barabartë emocionale të njeriut është lidhja midis dy vëllezërve.

Por është për të ardhur keq, që ndarjet klasore, idhujt etnike dhe racore e kanë zhdukur këtë vëllazëri islame, që ishte kaq e lakmueshme për të gjithë armiqtë. Për fat të keq, vëllezërit e djeshëm sot janë rreshtuar karshi njëri-tjetrit në një mënyrë krejtësisht të pabesueshme.

Dhe ndonjëherë kryejnë aq shumë vrasje me njëri-tjetrin, saqë asnjë armik nuk e bën me armikun e vet. Kjo është një nga sekretet dhe shkaqet e prapambetjes sonë të sotme.

4- Frika nga urdhri i xhihadit

Nga fjalia **“Vallë, nga ata keni frikë?”** përftohet se në mesin e myslimanëve ekzistonte një grup njerëzish që kishin frikë nga ky urdhër i xhihadit, ose për shkak të fuqisë dhe forcës së armikut, ose për shkak të asaj që thyerja e besës konsiderohet si mëkat.

Kur’ani u përgjigjet qartë atyre, se nuk duhet të kenë frikë nga këta njerëz të dobët, por duhet të kihet frikë nga kundërshtimi i urdhrit të Zotit.

Përveç kësaj, nëse frikësoheni, do të jeni prej besëthyesve. Kjo është e pa vend, sepse ishin ata që i përgatitën të parët rrethanat e shkeljes së marrëveshjes.

5- Kush janë njerëzit që dëbuan Profetin (*Paqja dhe bekimet e All’llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*)?

Synimi i frazës **“...janë përpjekur ta dëbojnë të Dërguarin...”** aludon për çështjen e dëbimit të Profetit (*Paqja dhe bekimet e All’llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) nga Meka gjatë shpërnguljes për në Medine. Në fillim kishin vendosur ta dëbonin, por më pas e ndryshuan vendimin e tyre dhe vendosën

ta vrisnin Profetin (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*). Por me urdhrin e Zotit, Profeti (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), në po atë natë, u largua nga Meka.

Sidoqoftë, përmendja e kësaj çështjeje nuk tregon vetëm thyerjen e besës së tyre, por është një kujtim i hidhur i krimeve të idhujtarëve. Në këto krime merrnin pjesë jo vetëm kurejshët, por edhe fise të tjera. Thyerja e besës nga ana e idhujtarëve ishte bërë e qartë me anë të rrugëve të tjera.

6- Ky ajet nuk është argument për fatalizmin

Është i çuditshëm fakti se disa nga pasuesit e shkollës xhebie (fatalistët), ajetin **“Luftoni kundër tyre, që All'llahu t'i dënojë ata me duart tuaja, t'i poshtërojë, t'ju ndihmojë juve kundër tyre, t'i shërojë shpirtrat e besimtarëve”** e kanë interpretuar në favor të shkollës së tyre. Nëse i pastrojnë mendjet e tyre nga këto paragjykime, do të qartësohet se ajeti i lartpërmendur nuk përmban as argumentin më të vogël në favor të tyre.

Ky veprim i tyre është i ngjashëm me shembullin e kryerjes së një pune, ne të varemi dhe të vrapojmë pas një miku dhe t'i themi: “Shpresojmë që Zoti i Madhëruar, nëpërmjet dorës tënde, ta rregullojë këtë punë”.

Kjo nuk do të thotë që ti je i detyruar për ta kryer këtë vepër. Kuptimi është se Zoti të ka vënë forcën në dorën tënde, si dhe të ka dhënë një qëllim të pastër, në mënyrë që, me përdorimin dhe shfrytëzimin e tyre, të mund ta kryeni këtë vepër me një vullnet të lirë.

Ajeti 16

أَمْ حَسِبْتُمْ أَنْ تُتْرَكُوا وَلَمَّا يَعْلَمِ اللَّهُ الَّذِينَ جَاهَدُوا مِنْكُمْ
وَلَمْ يَتَّخِذُوا مِنْ دُونِ اللَّهِ وَلَا رَسُولِهِ وَلَا الْمُؤْمِنِينَ وَلِجَنَّةٍ
وَاللَّهُ خَبِيرٌ بِمَا تَعْمَلُونَ ﴿١٦﴾

"Vërtet mendoni se do të liheni të qetë para se All'Ilahu t'i ketë njohur ata midis jush që kanë luftuar dhe që nuk kanë kërkuar aleatë të tjerë, përveç All'Ilahut, të Dërguarit të Tij dhe besimtarëve?! All'Ilahu e di mirë se çfarë bëni."

Komentimi

Në ajetin 16, Zoti i ka nxitur myslimanët për luftë në një mënyrë të tjetër, ua ka bërë të ditur përgjegjësinë e tyre të madhe, se nuk duhet të imagjinojnë se mjafton vetëm pretendimi i besimit e çdo gjë vetvetiu do të jetë në rregull. Por sinqeriteti i qëllimit, fjala e drejtë dhe vërtetësia e besimit bëhet e qartë vetëm gjatë luftimit me armikun, luftim që është i sinqertë dhe larg çdo lloj hipokrizie.

Në fillim thuhet: "Vërtet mendoni se do të liheni të qetë..." dhe nuk do të sprovoheni? Ndërkohë që akoma nuk janë dalluar luftëtarët e denjë midis jush dhe po ashtu ata që përveç Zotit, Profetit dhe besimtarëve të ngushtë nuk kanë zgjedhur për

vete njerëz të besueshëm, me të cilët të ndajnë sekretet dhe të fshehtat e tyre. **“Vërtet mendoni se do të liheni të qetë para se All’Ilahu t’i ketë njohur ata midis jush që kanë luftuar dhe që nuk kanë kërkuar aleatë të tjerë, përveç All’Ilahut, të Dërguarit të Tij dhe besimtarëve?! All’Ilahu e di mirë se çfarë bëni.”**¹

Fjala *“uelixheten”* rrjedh nga rrënja *“vuluxh”* që ka kuptimin e *“hyrjes”* (dukhul) dhe i atribuohet personit që i mban sekretet dhe është kryesi i veprave të njeriut. Kuptimi i saj afrohet me atë të fjalës *“bitane”*.

Fjalja e lartpërmendur u rikujton myslimanëve dy çështje: e para, shfaqja e besimit nuk i vë në rregull punët në mënyrë automatike e as bën të qartë personalitetin e njerëzve. Njerëzit sprovohen me anë të dy mjeteve të sprovimit:

Në fillim, me anë të xihadit në rrugën e Zotit, për zhdukjen e gjurmëve të politeizmit dhe të idhujtarisë.

Së dyti, heqjen dorë prej çdo lloj marrëdhënieje apo bashkëpunimi me hipokritët dhe armiqtë. E para i dëbon armiqtë e huaj, kurse e dyta i dëbon armiqtë e brendshëm.

Në disa sure të Kur’anit vërehen ajete të ngjashme me frazën: **“...para se All’Ilahu t’i ketë njohur ata...”** Kuptimi i kësaj fraze është *“akoma nuk është realizuar”*, që mohimi i njohjes është në kuptimin e mohimit të *“të njohurit”*. Shprehje të tilla zakonisht përdoren për të theksuar diçka. Në të kundërt, në bazë të argumentimeve racionale dhe në bazë të shumë ajeteve të qarta

¹ Fjala *“em”* është shkronjë lidhëse. Me anë të saj lidhen dy fjali pyetëse, duke i dhënë fjalisë intonacionin pyetës. Gjithnjë vjen pas një pyetjeje tjetër. Në ajetin 16 lidhet me frazën *“ela tukatilune...”* që u përmend në ajetin 13.

kur'anore, Zoti i Madhëruar ka qenë dhe do të jetë i informuar për çdo gjë.

Në fakt, ky ajet është i ngjashëm me ajetin e dytë të sures "El Ankebut", në të cilin thuhet: **"A menduan njerëzit të thonë: 'Ne kemi besuar, e të mos vihen në sprovë?'"**

Dhe ashtu siç u shprehëm dhe në komentimin e sures "Ali Imran", sprovat hyjnore nuk janë për të zbuluar një çështje të paqartë dhe të panjohur, por kanë për qëllim lulëzimin e dhuntive e talenteve, si dhe për të zbuluar të fshehtat e individëve.

Dhe në fund të ajetit, si një paralajmërim dhe njëkohësisht theksim, thuhet: **"All'illahu e di mirë se çfarë bëni."**

Askush nuk duhet të mendojë se Zoti i Madhëruar nuk është në dijeni për lidhjet dhe marrëdhëniet e fshehta me hipokritët dhe armiqtë. Duhet ta dinë se All'illahu di çdo gjë dhe, sipas veprimeve që bëjnë individët, ashtu do të jetë dhe sjellja e Tij.

Nga stili i të shprehurit të ajetit përftohet se, në mesin e myslimanëve të asaj kohe, disa njerëz sapo kishin hedhur hapa në rrugën e Islamit dhe nuk ishin shpirtërisht të gatshëm për të luftuar. Kjo shprehje u përket atyre, pasi luftëtarët e denjë dhe të drejtë e kishin dëshmuar shumë herë në sheshet e luftës gjendjen e tyre.

Ajetet 17 - 18

مَا كَانَ لِلْمُشْرِكِينَ أَنْ يَعْمُرُوا مَسْجِدَ اللَّهِ شَاهِدِينَ عَلَىٰ
 أَنْفُسِهِمْ بِالْكُفْرِ أُولَٰئِكَ حَبِطَتْ أَعْمَالُهُمْ وَفِي النَّارِ هُمْ
 خَالِدُونَ ﴿١٧﴾ إِنَّمَا يَعْمُرُ مَسْجِدَ اللَّهِ مَنْ ءَامَنَ بِاللَّهِ وَالْيَوْمِ
 الْآخِرِ وَأَقَامَ الصَّلَاةَ وَءَاتَى الزَّكَاةَ وَلَمْ يَخْشَ إِلَّا اللَّهَ فَعَسَىٰ
 أُولَٰئِكَ أَنْ يَكُونُوا مِنَ الْمُهْتَدِينَ ﴿١٨﴾

"Nuk u takon idhujtarëve të përkujdesen për faltoret e All'Ilahut, përderisa edhe ata vetë dëshmojnë se janë mosbesimtarë. Të kota do të jenë veprat e tyre dhe në zjarrin e Xhehennemit do të qëndrojnë përgjithmonë."

"Faltoret e All'Ilahut i vizitojnë dhe i mirëmbajnë vetëm ata që besojnë All'Ilahun dhe Ditën e Fundit, që falin namazin dhe japin zekatin e që nuk i frikësohen askujt, përveç All'Ilahut. Sigurisht që këta janë në rrugë të drejtë."

Komentimi

Ndërtimi i xhamisë nuk është detyrë e çdo njeriu

Një prej çështjeve, pas anulimit të marrëveshjes me politeistët dhe urdhrit për luftë, ishte mëdyshja se pse duhet të largohen dhe të mos lejohen të futen në Xhaminë e Shenjtë gjatë ritualit të Haxhit.

Ndërkohë që pjesëmarrja e tyre në këtë ritual, nga çdo pikëpamje, ishte burim i prosperitetit për rehabilitimin e Xhamisë Shenjtë, me anë të ndihmave, të cilat i kryenin për këtë qëllim, si dhe prosperitet shpirtëror për nga pikëpamja e shtimit të popullsisë rreth Qabes.

Ajetet e mësipërme u përgjigjen mendimeve të tilla të rreme dhe të pabaza. Në ajetin 17 shprehet qartë: **“Nuk u takon idhujtarëve të përkujdesen për faltoret e All’llahut, përderisa edhe ata vetë dëshmojnë se janë jobesimtarë.”**

Dëshmia e tyre ndaj vetë politeizmit të tyre bëhet e qartë jo vetëm me fjalët e tyre, por edhe me anë të veprave të tyre, madje dhe me anë të mënyrës së adhurimit dhe ritualit të Haxhit të tyre. Të gjitha këto janë dëshmi e kësaj çështjeje.

Më pas ka përmendur argumentin dhe filozofinë e këtij urdhri: **“Të kota do të jenë vepra e tyre dhe në zjarrin e Xhehennemit do të qëndrojnë përgjithmonë.”**

Në këtë situatë, as përpjekjet, as orvatjet e tyre për rehabilitimin dhe zgjerimin e Xhamisë së Shenjtë, as vepra të tjera të këtij lloji, as numri i tyre që banojnë rreth Qabes, nuk kanë ndonjë vlerë.

Zoti i Madhëruar është i pastër dhe Shtëpia e Tij duhet të jetë e pastër dhe duart e njerëzve të papastër duhet të largohen nga Zoti dhe nga xhamitë.

Në ajetin 18, për të plotësuar këtë çështje, përmend kushtet e kujdestarëve të xhamive dhe vendeve të adhurimit dhe parashikon pesë kushte të rëndësishme për ta: **“Faltoret e All’Ilahut i vizitojnë dhe i mirëmbajnë vetëm ata që besojnë All’Ilahun dhe Ditën e Fundit.”**.

Këto i përkasin kushtit të parë dhe të dytë, që ka aspekt ideologjik dhe themeltar. Derisa të mos ekzistojë kjo, nga njeriu nuk rrjedh asnjë vepër e dëlirë, fisnike dhe e sinqertë, madje, edhe nëse në paraqitje është fisnike, në brendësi do të jetë e “infektuar” me lloj-lloj synimesh të papastra.

Më pas përmend kushtin e tretë dhe të katërt: **“...që falin namazin dhe japin zekatin...”**, që do të thotë se besimi i tyre në Zotin dhe Ditën e Gjykimit nuk duhet të jetë vetëm në fazën e pretendimit, por ta vërtetojnë atë me anë të veprave të pastra dhe të sinqerta, të kenë lidhje të forta me Zotin dhe namazin ta falin rregullisht dhe në mënyrë të drejtë, si dhe të kenë lidhje me krijesat e Zotit dhe të japin zekatin.

Si përfundim, përmend kushtin e fundit: **“e që nuk i frikësohen askujt, përveç All’Ilahut.”**

Zemra duhet të jetë e mbushur me dashurinë për Zotin dhe të ndiejë vetëm përgjegjësinë karshi urdhrorit të Tij, kurse robërit e dobët duhet t’i perceptojnë si shumë më të vegjël se sa të kenë mundësinë për ndonjë ndikim në fatin e tij, në shoqërinë e tij, në të ardhmen e tij, në fitoren, në përparimin e tij dhe në mirëmbajtjen e tempujve dhe të vendadhurimit të tij.

Në fund ajeti shton se ky grup njerëzish, që ka cilësi të tilla, mund të udhëzohen në rrugën e drejtë dhe t'ia arrijnë qëllimit të tyre, të përpiqen në mirëmbajtjen dhe në ndërtimin e xhamive të Zotit dhe të përfitojnë nga mirësitë e saj të mëdha. **“Sigurisht që këta janë në rrugë të drejtë.”**

Hulumtime

1- Cili është kuptimi i fjalës “*imaretun*” ?

Si duhet ta kuptojmë fjalën *mirëmbajtja e xhamive*? Mos vallë ka kuptimin e madhësisë së ndërtesës apo kupton grumbullimin dhe pjesëmarrjen në të?

Disa nga komentuesit e Kur'anit, në komentimin e “*imran-i mesaxhid*” te ajeti në fjalë, kanë marrë parasysh vetëm njërin prej këtyre dy kuptimeve, ndërkohë që kjo fjali ka një kuptim të gjerë, që përfshin të gjitha këto çështje.

Politeistët dhe idhujtarët nuk kanë të drejtë të marrin pjesë në xhami dhe as nuk kanë të drejtë për mirëmbajtjen dhe ndërtimin e tyre. Si rrjedhim, të gjitha këto çështje duhet të kryhen nga dora e myslimanëve.

Nga ky ajet përfitohet se myslimanët nuk duhet të pranojnë dhuratat dhe ndihmat jo vetëm të politeistëve, por të të gjitha rrymave joislame për ndërtimin e xhamisë së tyre, sepse ajeti 17, edhe pse flet vetëm rreth politeistëve, ajeti 18, që fillon me fjalën “*innema*”-*mirëmbajtjen e xhamive*, e përcakton si detyrë vetëm e myslimanëve.

Bëhet e qartë se mbajtësit dhe ruajtësit e xhamive duhet të zgjidhen prej njerëzve më të pastër. Për këto qendra të adhurimit

dhe shoqërisë islame të mos emërohen njerëz të papastër dhe të përlyer për shkak të pasurisë dhe mallit, të pozitës apo ndikimit shoqëror të tyre, ashtu si ka qenë e zakonshme dhe e pranuar në shumë vende. E vërteta është se njerëz të tillë, të korrumpuar duhen mbajtur larg nga të gjitha këto qendra të shenjta. Fatkeqësisht, nga dita që një grup nga sundimtarët tiranë ose pasanikët e korrumpuar vunë dorë në ndërtimin e xhamive dhe qendrave islame, fryma e frymëzimit dhe programet e këtyre qendrave mbeten të deformuara dhe të shpërfytyruara.

Edhe sot jemi dëshmitarë se shumë xhami të tilla janë shndërruar në xhami Zirar (të hipokritëve) dhe kanë humbur efektin e tyre.

2- Vepra e sinqertë buron vetëm nga besimi

Ka mundësi që disa të mendojnë në këtë mënyrë: Çfarë të keqe ka, nëse për mirëmbajtjen dhe zgjerimin e këtyre qendrave të shfrytëzojmë kapitalet e jomyslimanëve?

Ata që mendojnë në këtë mënyrë, nuk kanë parasysh çështjen themelore, që Islami, veprën e sinqertë, e konsideron si fryt të pemës së besimit.

Vepra, gjithnjë, është një ndriçim i qëllimeve dhe bindjeve të njeriut, si dhe gjithnjë merr ngjyrën dhe formën respektive. Synimet jo të pastra dhe jo të mira nuk kanë mundësi të sjellin një vepër të pastër dhe të japin një produkt të dobishëm, sepse vepra është reflektim i qëllimit të zemrës.

3- Mirëmbajtës guximtarë

Fjalja “...e që nuk i frikësohen askujt, përveç All’Ilahut” tregon se mirëmbajtja dhe zhvillimi nuk është e mundur vetëm në sajë të guximit dhe të trimërisë.

Këto qendra të shenjta islame vetëm atëherë e marrin formën e qendrave të formimit dhe të edukimit të njeriut, kur themeluesit dhe mirëmbajtësit e tyre janë njerëz trima dhe të guximshëm, të cilët nuk i frikësohen askujt tjetër përveç Zotit, nuk bien pre e asnjë pozite, nuk ndikohen nga ndonjë fuqi apo forcë dhe në to nuk zbatojnë ndonjë program tjetër përveç programeve hyjnore.

4- Bëhet fjalë vetëm për Xhaminë e Shenjtë?

Disa nga komentuesit e Kur’anit, ajetin 18 e kanë konsideruar vetëm për Xhaminë e Shenjtë (Mesxhidul Haram), ndërkohë që shprehjet e përdorura në ajet janë me kuptim të përgjithshëm dhe nuk ka vend për veçim, edhe pse Mesxhidul Harami, ishte xhamia më e madhe islame dhe renditej e para, kishte më shumë vëmendjen. Por ky nuk është argument për veçimin e kuptimit të ajeteve.

5- Rëndësia e ndërtimit të xhamive

Për rëndësinë e ndërtimit të xhamive ekzistojnë hadithe të shumta, të transmetuara nga Ehli Bejti dhe Ehli Syneti, të cilat nxjerrin në pah rëndësinë e jashtëzakonshme të kësaj vepre.

Nga Profeti i Islamit është transmetuar: *“Ai që ndërton një xhami, sado e madhe që të jetë, qoftë edhe në masën e folesë së një zogu, Zoti i Madhëruar në Xhennet do të ndërtojë një shtëpi për të.”*¹

Në një hadith tjetër, të transmetuar po nga Profeti (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), thuhet: *“Ai që vë një llambë në xhami, engjëjt dhe mbartësit e Fronit Hyjnor do të luten për të sa kohë që kjo llambë të qëndrojë e ndezur në xhami.”*²

Por sot, në ditët tona, ajo që ka më shumë rëndësi është rehabilitimi dhe lulëzimi shpirtëror i xhamive, thënë ndryshe, duhet të përpiqemi dhe t'i kushtojmë më shumë rëndësi formimit dhe edukimit të njerëzve të pasionuar pas xhamisë, kujdestarë dhe ruajtës të saj, se sa ndërtimit të xhamisë.

Xhamia duhet të jetë një vatër për çdo lloj lëvizje krijuese islame, në fushën e vetëdijesimit dhe të rizgjimit të njerëzve, të jetë vatër e pastrimit të mjedisit, si dhe vend i përgatitjes së myslimanëve për të mbrojtur trashëgiminë islame.

Duhet të kemi parasysh faktin që xhamia të kthehet në një qendër dhe vatër për rininë besimtare dhe të mos jetë vendqëndrim vetëm për njerëzit e moshuar dhe invalidët. Xhamia duhet të jetë vatër për shtresat më aktive shoqërore dhe jo për njerëzit e papunë, dembelë, letargjikë dhe të përgjumur.

¹ “Uesailu Shia”, vëll. 5, f. 204-205; Tefsiri “El Manar”, vëll.10, f. 213; “Men la jehdheruhul Fakijh”, vëll. 1, f. 235, Botimet “Xhameil Muderesine”, Kum; “Biharul Enuar”, vëll. 62, f. 46 dhe vëll. 66 f. 382, vëll. 74, f. 123, vëll. 80, f. 382, vëll.81, f. 4, 5, 11; “Musned Ahmed”, vëll.1, f. 241, Bejrut; “Sunen Ibn Maxheh”, vëll. 1, f. 244, “Darul fikr”, Bejrut, Hulumtues Muhammed Feuad Abdul Baki; “Sunenul Kubra i El Bejhekij”, vëll. 2, f. 437, “Darul fikr”, Bejrut.

² “Mehasine Berkij”, f. 57, “Darul kutubul islamije”, Kum, 1371 Hixhri kameri; “Men la Jehdheruhul Fakijh”, vëll. 1, f. 237, Botimet “Xhamiul Muderessin”, Kum, 1414 Hixhri kameri; “Uesailu Shia”, vëll. 5, f. 241; “Biharul Enuar”, vëll. 81, f. 15.

Ajetet 19 - 22

﴿۱۹﴾ أَجَعَلْتُمْ سِقَايَةَ الْحَاجِّ وَعِمَارَةَ الْمَسْجِدِ الْحَرَامِ كَمَنْ ءَامَنَ
 بِاللَّهِ وَالْيَوْمِ الْآخِرِ وَجَاهَدَ فِي سَبِيلِ اللَّهِ لَا يَسْتَوُونَ عِنْدَ اللَّهِ
 وَاللَّهُ لَا يَهْدِي الْقَوْمَ الظَّالِمِينَ ﴿۲۰﴾ الَّذِينَ ءَامَنُوا وَهَاجَرُوا
 وَجَاهَدُوا فِي سَبِيلِ اللَّهِ بِأَمْوَالِهِمْ وَأَنْفُسِهِمْ أَكْظَمُ دَرَجَةً عِنْدَ
 اللَّهِ وَأُولَئِكَ هُمُ الْفَائِزُونَ ﴿۲۱﴾ يُبَشِّرُهُمْ رَبُّهُمْ بِرَحْمَةٍ مِّنْهُ
 وَرِضْوَانٍ وَجَنَّتِ لَهُمْ فِيهَا نَعِيمٌ مُّقِيمٌ ﴿۲۲﴾ خَلِيدِينَ فِيهَا أَبَدًا
 إِنَّ اللَّهَ عِنْدَهُ أَجْرٌ عَظِيمٌ ﴿۲۳﴾

"Vërtet mendoni se ai që u jep ujë haxhilerëve dhe mirëmban Xhaminë e Shenjtë është njësoj me atë që beson në All'Ilahun dhe Ditën e Fundit dhe që lufton në rrugën e All'Ilahut?! Këta nuk janë të njëjtë para All'Ilahut. Ai nuk i udhëzon në rrugë të drejtë njerëzit keqbërës."

"Ata që besojnë, mërgojnë dhe luftojnë në rrugën e All'Ilahut me pasurinë e tyre dhe jetën e tyre, janë në shkallë më të lartë tek All'Ilahu. Pikërisht këta janë të fituarit."

"Zoti i tyre u jep lajmin e mirë për mëshirën dhe miratimin e Tij, si dhe për kopshtet ku do të ketë kënaqësi të përhershme për ta"

"dhe ku do të qëndrojnë përgjithmonë. Me të vërtetë, vetëm tek All'Ilahu është shpërblimi i madh."

Shkaku i zbritjes

Për shkakun e zbritjes së këtyre ajeteve janë transmetuar hadithe të ndryshme, nga burimet synite dhe shi'ite. Do të përmendim më të rëndësishmet prej tyre.

Dijetari i njohur i Ehli Syneetit, Hakim Ebul Kasim Heskani, nga Burejde transmeton se Shejbeja dhe Abbasi, secili po mburrej për veten e tij. Aty pranë kaloi Imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*) dhe i pyeti: *"Për çfarë po mburreni?"*

Abbasi i tha: *"Mua më është dhënë një epërsi që nuk i është dhënë askujt tjetër, u jap ujë vizitorëve të shtëpisë së Zotit."*

Shejbeja tha: *"Unë jam mirëmbajtësi i Xhamisë së Shenjtë (mbaj çelësat e Shtëpisë së Zotit)."*

Imam Aliu tha: *"Edhe pse ndihem i turpëruar që t'ua them, përsëri do t'ua them. Edhe pse jam në një moshë të vogël, unë mburrem me një gjë që ju nuk e keni."*

Të dy thanë: *"Për çfarë bëhet fjalë?!"*

Imam Aliu u përgjigj: *"Unë kam luftuar me shpatë deri sa ju besuat në Zotin dhe Profetin."*

Abbasi u ngrit i zemëruar dhe shkoi te Profetit (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) për t'u ankuar: "A nuk po e dëgjon se si po flet Aliu me mua?"

Profeti (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) e thirri Aliun (*Paqja qoftë mbi të!*) pranë dhe iu drejtua: "Pse ke folur në këtë mënyrë me Abbasin, xhaxhain tënd?"

Imam Aliu tha: "O i Dërguari i Zotit! Nëse unë e kam zemëruar atë, kjo ishte me shpjegimin e një të vërtete, karshi thënies së vërtetë, çdokush që dëshiron, të zemërohet dhe çdokush që dëshiron, të gëzohet!"

Ndërkohë zbriti Xhebraili dhe tha: O i Dërguari i Zotit! Zoti të bën selam dhe thotë t'u këndosh atyre këto ajete: **"Vërtet mendoni se ai që u jep ujë haxhilerëve dhe mirëmban Xhaminë e Shenjtë është njësoj me atë që beson në All'llahun dhe Ditën e Fundit dhe që lufton në rrugën e All'llahut?! Këta nuk janë të njëjtë para All'llahut. Ai nuk i udhëzon në rrugë të drejtë njerëzit keqbërës."**¹

Po i njëjti transmetim, me po të njëjtën përmbajtje, ose me shumë pak ndryshim, është transmetuar edhe në shumë libra të Ehli Syneetit, si p.sh në tefsirin "Tabari" dhe "Tha'lebij", "Esbabu Nuzul i Uahidiut", tefsirin e Khazin Bagdadiut, "Mealimu Tenzil", i Begaviut, "Menakib" i Ibn Megazeliut,

¹ "Mexhmaul Bejjan", ajeti në fjalë; "Biharul Enuar", vëll. 36, f. 39; "Shexheretu Tuba", vëll. 1, f. 153, "Mektebul Hadajrie", Botimi i pestë, 1385 Hixhri kameri; "Nuruth Thekalejn", vëll. 2, f. 194; "Mueseseh Ismailijan", Botimi i katërt, 1412 Hixhri kameri; "Te'uulul Ajat", vëll. 1, f. 200; "Matbaatul Amir", Kum, Botimi i parë, 1407 Hixhri kameri; "Hejatul Amirul Muminin an lisanehu", vëll. 1, f. 155, Botimet "Xhamiul Muderesine", Kum, Botim i parë, 1417 Hixhri kameri; "Esbabu Nuzul", f. 163; "Mueseseh Halebij ue Shurekauhu", Kajro, 1388 Hixhri kameri.

“Xhamiul Usul” i Ibn Ethirit, tefsiri i Fakhru Raziut dhe libra të tjerë.¹

Sidoqoftë, hadithi i lartpërmendur është një prej haditheve më të njohura dhe më të famshëm, që, madje edhe njerëzit paragjykues ndaj tij, e kanë pohuar dhe e kanë pranuar. Ne, pas përfundimit të komentimit të këtyre ajeve, sërish do të diskutojmë në lidhje me këtë.

Komentimi

Kriteri i mburrjes dhe i virtytit

Edhe pse këto ajete (19-22) kanë një shkak zbritjeje të veçantë, në të njëjtën kohë janë plotësuese e diskutimit të ajeteve të kaluara. Shembuj të ngjashëm me to vërehen shpesh në Kur'an.

Në ajetin 19 thuhet: **“Vërtet mendoni se ai që u jep ujë haxhilerëve dhe mirëmban Xhaminë e Shenjtë është njësoj me atë që beson në All’llahun dhe Ditën e Fundit dhe që lufton në rrugën e All’llahut?! Këta nuk janë të njëjtë para All’llahut. Ai nuk i udhëzon në rrugë të drejtë njerëzit keqbërës.”**

Fjala *“sikaje”* është edhe paskajore, në kuptimin e dhënies së ujit, si dhe ka kuptimin e *“mjetit”* dhe enës që jepet ujë (ashtu siç thuhet edhe në ajetin 70 të sures “Jusuf”). Përdoret në kuptimin e një ene të madhe, ose të një pellgu që hidhet ujë. Në

¹ Për më shumë informacion, në lidhje me këtë hadith dhe përcaktimin e dëshmimeve të tij, shih librin “Ihkakul Hakk”, vëll. 3, f. 122-128 dhe “El Kadir”, vëll. 2, f. 53-54, “Darul kutubul arabi”, Bejrut, Botim i katërt, 1397 Hixhri kameri.

Xhaminë e Shenjtë, në mes burimit të Zemzemit dhe Shtëpisë së Zotit ekziston një vend i njohur me emrin Sikajetul Abbas. Aty vendosnin një enë të madhe, në mënyrë që hanxhinjtë të merrnin ujë prej tij.

Historia dëshmon se para Islamit, kujdesi për këtë vend ishte njësoj si mbajtja e çelësit të Shtëpisë së Zotit dhe konsiderohej prej pozitive më të rëndësishme.

Nevoja e madhe e haxhinjve për ujë, gjatë kryerjes së ritualit të Haxhit, aq më shumë në atë tokë të tharë, përvëluese dhe me pak ujë, që pothuajse përgjatë gjithë vitit koha atje është e ngrohtë, i jepte një rëndësi të veçantë kësaj çështjeje. Ai që ishte përgjegjës i kësaj detyre, natyrisht që gëzonte një pozitë të veçantë, sepse shërbimi i tij ndaj haxhinjve konsiderohej një shërbim jetik.

Po ashtu, mbajtësi i çelësave, mirëmbajtësi dhe ruajtësi i Xhamisë së Shenjtë, që është vatra më e shenjtë dhe më e madhe fetare, madje edhe në kohën e paganizmit arab konsiderohej si e tillë, sillte një respekt të jashtëzakonshëm për personin apo personat që ishin përgjegjës të saj.

Me të gjitha këto, në Kur'anin e Madhëruar lexojmë se besimi në Zot dhe luftimi në rrugën e Tij është më lart dhe më i çmuar se të gjitha këto vepra.

Në ajetin 20, si theksim dhe sqarim thuhet: **“Ata që besojnë, mërgojnë dhe luftojnë në rrugën e All’Ilahut me pasurinë e tyre dhe jetën e tyre, janë në shkallë më të lartë tek All’Ilahu. Pikërisht këta janë të fituarit.”**

Më pas thuhet: Zoti i Madhëruar karshi këtyre tre veprave (besimit, shpërnguljes dhe luftës) do t'u dhurojë atyre tre mirësi të mëdha:

1- Ata i përgëzon me mëshirën e vet të gjerë dhe i bën të përfitojnë nga ajo. **“Zoti i tyre u jep lajmin e mirë për mëshirën dhe miratimin e Tij”;**

2- Ata do të përfitojnë nga kënaqësia e Tij: **“do të ketë kënaqësi”;**

3- **“si dhe për kopshtet, ku do të ketë kënaqësi të përhershme për ta”;**

Dhe në përfundim, si për ta theksuar më shumë shtohet: **“dhe ku do të qëndrojnë përgjithmonë. Sepse Me të vërtetë, vetëm tek All'illahu është shpërblimi i madh.”**

Hulumtime

1- Shtrebbërimi i historisë

Ashtu siç e lexuam edhe në shkakun e zbritjes së këtyre ajeteve, sipas një hadithi, i cili është transmetuar në shumë libra të njohur të Ehli Synetit, këto ajete kanë zbritur për Imam Aliun (*Paqja qoftë mbi të!*) dhe për shpjegimin e virtyteve të tij, sado që ato kanë një kuptim të gjerë dhe gjithëpërfshirës. (disa herë e kemi pohuar që shkaqet e zbritjeve nuk i përkufizojnë konceptet e ajeteve).

Analizat dhe shqyrtimet na e bëjnë të qartë që disa nga komentuesit e Ehli Synetit nuk i kanë shumë për qejf, që për Imam Aliun të afirmohen virtyte të larta, edhe pse atë e pranojnë

si udhëheqësin e katërt të tyre të madh, thuajse i frikësohen faktit se, nëse dorëzohen karshi dokumenteve dhe dëshmime, të cilat i japin një përparësi të jashtëzakonshëm Imam Aliut (*Paqja qoftë mbi të!*), ka mundësi që popullsia shi'ite të ngrihet kundër tyre dhe t'i vërë në pozitë të vështirë duke u thënë: Pse u keni dhënë të tjerëve përparësi ndaj Aliut?

Prandaj ndodh shpesh që t'i mbyllin sytë përpara të vërtetave historike dhe merren me dobësimin e zinxhirit të transmetimit të haditheve të tilla. Nëse nuk gjejnë ndonjë mangësi apo shkelje në transmetim, përpiqen që, në një farë mënyre, të ngatërrojnë kuptimin e tij. Paragjykime të tilla, fatkeqësisht, vazhdojnë edhe sot e kësaj dite, madje disa nga dijetarët e tyre, po ashtu vuajnë nga një obsKur'antizëm të tillë.

Po përmend këtu një bisedë që pata me njërin prej dijetarëve të Ehli Syneetit, për hadithe të tilla. Midis të tjerash, tha: "Sipas meje, shi'izmi është në gjendje që të argumentojë të gjitha konceptet parimore dhe dytësore të shkollës së vet me anë të burimeve, dëshmime dhe librave tona, sepse në librat tanë ekzistojnë hadithe të mjaftueshme që flasin në favor të shi'izmit."

Por po ai, me qëllim që ta shpëtojë veten nga të gjitha këto burime dhe transmetime të njohura, menjëherë tha: "Unë mendoj se paraardhësit tanë kanë qenë njerëz me besim të lehtë dhe të gjitha hadithet, që i kanë dëgjuar, i kanë sjellë në librat e tyre. Ne nuk mundemi të pranojmë lehtësisht atë që ata e kanë shkruar." (Fjala e tij përfshinte librat e tyre të dorës së parë, si: "Sahihat" dhe "Musnedët".)

Atij i thashë: "Metoda e drejtë e kërkimit nuk është që njeriu të pranojë një shkollë në bazë të një mori trashëgimish dhe më pas, çdo hadith që përputhet me të, ta konsiderojë të saktë, ndërsa hadithet që nuk përputhen apo nuk përshtaten me të, t'i

marrë si rrjedhojë e besimit të lehtë të paraardhësve, edhe pse mund të jetë një hadith i vlefshëm dhe autentik.

Sa mirë do të ishte që në vend të kësaj metode të të menduari, të zgjidhni një rrugë tjetër, së pari, boshatiseni veten tuaj nga çdo lloj mendimi i trashëguar; së dyti, uluni përballë dëshmimeve të logjikshme dhe në fund zgjidhni bindjen tuaj.

Kini vëmendjen, pse dhe për ç'arsye hadithet e njohura, të cilat flasin për pozitën e lartë të Imam Aliut (*Paqja qoftë mbi të!*) dhe e vërtetojnë pozitën e tij ndaj të tjerëve, janë lënë në harresë, madje janë kritikuar në mënyrë të pamëshirshme, sa ndonjëherë lihen pas dore, nuk flitet fare për ta, thuajse të gjitha këto hadithe nuk kanë ekzistencë të jashtme.

Duke pasur parasysh atë që u tha më sipër, do të përmendim një thënie nga komentuesi i njohur i Kur'anit dhe autor i tefsirit "El Manar", i cili në shkakun e zbritjes së ajeteve 19-22, e ka lënë anash hadithin që përmendëm më lart. Në vend të tij ka përmendur një hadith tjetër, i cili nuk përputhet aspak me përmbajtjen e ajeteve. Ky hadith duhet të konsiderohet si një hadith në kundërshtim me Kur'anin, por ai e quan autentik. Ky hadith është transmetuar nga Nu'man ibn Beshiri.

Po japim hadithin. Nu'man ibn Beshiri tha: "Isha ulur në mesin e një grupi shokësh, në afërsi të faltores së Profetit (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*).

Njëri prej tyre tha: "Unë, nuk mendoj se pas hyrjes në Islam, ka një vepër më të mirë se sa dhënia ujë hanxhinjve." Tjetri tha: "Mirëmbajtja e Xhamisë së Shenjtë konsiderohet si vepra më e mirë ndaj të gjitha veprave."

I treti tha: “Lufta në rrugën e Zotit është më e lartë nga këto që ju pohuat.”

Omeri ua ndërpreu atyre bisedën dhe tha: “Mos e ngrini zërin tuaj pranë faltores së Profetit (*Paqja dhe bekimet e All'Ilahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*). Kur të kemi mbaruar namazin e xhumasë, do të shkoj te Profetit (*Paqja dhe bekimet e All'Ilahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) dhe do ta pyes për këtë që ju po bisedoni.”

Pas përfundimit të namazit, shkoi te Profetit dhe e pyeti. Në këtë kohë zbritën ajetet e përmendura.¹

Ndërkohë që ky hadith, me ajetet që po diskutojmë, nuk përputhet në drejtime të ndryshme. Dimë se çdo hadith, që është në kundërshtim me Kur'anin, duhet hedhur poshtë.

Së pari, në ajetet e lartpërmendura nuk është bërë krahasimi mes luftës në rrugën e Zotit, dhënies ujë haxhinjve dhe kujdestaria e Xhamisë së Shenjtë. Por është bërë krahasimi mes dhënies ujë haxhinjve dhe kujdestarisë së Xhamisë së Shenjtë, nga njëra anë, kurse, nga ana tjetër, besimi në Zot, Ditën e Gjykimit dhe luftën në rrugën e Zotit.

Kjo tregon se njerëzit që i kishin kryer këto vepra, në kohën e injorancës, i krahasonin me besimin dhe me xhihadin. Kur'ani deklaroi qartë se këto të dyja nuk janë të barabarta dhe jo

¹ Tefsiri “El Manar”, vëll. 10, f. 215, ajeti në fjalë; “Esbabu Nuzul”, i Uahid Nishaburij”, f. 163, “Mueseseh Halebi ue Shurekauhu”, Kajro, 1388 Hixhri kameri; “Musned Ahmed”, vëll. 4, f. 269, “Dare samur”, Bejrut, në 6 vëllime; “Sahih Muslim”, vëll. 6, f. 36, “Darul fikr”, Bejrut, në 8 vëllime; “Sunenul Kubra i El Bajhaki”, vëll. 9, f. 158; “Darul Fikr”, Bejrut, në 10 vëllime; “Durrul Menthur”, vëll. 4, f. 218, “Darul Ma'rife”, Botim i parë, 1365 Hixhri kameri.

krahasimi i xhihadit me kujdestarinë e Xhamisë së Shenjtë dhe dhënies ujë haxhinjve.

Së dyti, fraza: “Popullin mizor All’llahu nuk e vë në rrugë të drejtë”, tregon që veprimet e grupit të parë ishin të shoqëruara me dhunë. Kjo ndodhi në kohën që ata ishin idhujtarë. Kur’ani deklaroi: **“Kur Llukmani, duke e këshilluar birin e vet, i tha: ‘O djali im, mos i përshkruaj All’llahut shok, sepse idhujtaria është padrejtësia më e madhe.’”**¹

Nëse krahasimi do bëhej mes besimit dhe dhënies ujë haxhinjve, të shoqëruar me besim dhe xhihad, atëherë në ajetin 19-të, nuk do të kishte kuptim fjalia: “Zoti nuk udhëzon në rrugë të drejtë popullin mizor.”

Së treti, ajeti 20: **“Ata që besojnë, mërgojnë dhe luftojnë në rrugën e All’llahut me pasurinë e tyre dhe jetën e tyre, janë në shkallë më të lartë tek All’llahu.”**, tregon pozitën e të gjithë besimtarëve, që kishin mërguar dhe kishin luftuar në rrugën e All’llahut me pasurinë dhe jetën e tyre.

Kjo nuk përputhet me hadithin e Nu’manit, sepse, në bazë të këtij hadithi, të gjithë bashkëbiseduesit ishin besimtarë, ndoshta kishin marrë pjesë në mërgim dhe në luftën në rrugën e All’llahut.

Së katërti, në ajetet 17 dhe 18, u diskutua për veprimin e idhujtarëve, të cilët nuk kishin të drejtë të përkujdesen për faltoret e All’llahut: **“Nuk u takon idhujtarëve të përkujdesen për faltoret e All’llahut.”**

Ajetet që ne po diskutojmë janë vazhdim i po kësaj çështjeje. Tema e diskutimit të këtyre ajeteve është përkujdesja ndaj faltoreve të All’llahut dhe dhënia ujë haxhinjve, duke qenë idhujtarë, kjo përputhet me hadithin e Numanit.

¹ Sure “Llukman”, ajeti 13.

Ajo që mund të thuhet karshi këtyre argumentimeve është shprehja *“eadhemu derexhe”-ata kanë pozitë më të lartë*, që tregon se të dyja anët e *“krahasimit”* janë njerëz me vepra të pëlqyeshme, edhe pse mund të ndodhë që njëra të jetë më e mirë dhe më e lartë se tjetra.

Por përgjigjja e këtij objeksioni është më se e qartë, sepse shkalla krahasore, zakonisht përdoret në raste të tilla, që njëra anë e krahasimit ka virtytin, kurse ana tjetër nuk ka *“asgjë”*.

P.sh. është e njohur shprehja: *“Më mirë vonë, se sa kurrë.”* Kuptimi i kësaj shprehjeje nuk është mos arritja e destinacionit është diçka e mirë, por arritja me vonesë është më e mirë se ajo.

Në Kur’an lexojmë: **“pajtimi (paqja) është më i mirë se lufta”**.¹ Kuptimi i kësaj shprehjeje nuk ka të bëjë me mirësinë dhe vlerën e luftës.

Në një vend tjetër në Kur’an lexojmë: **“një rob besimtar është më i vlefshëm se idhujtari.”**² Vallë a është i dobishëm dhe a ka ndonjë virtyt idhujtari?

Dhe në po këtë sure, që ne po diskutojmë, në ajetin 108, thuhet: **“Ndërsa xhamia e themeluar në përkushtim (ndaj All’Ilahut) që në ditën e parë, pa dyshim që është më e denjë për të falur namaz në të. Aty ka njerëz që duan të pastrohen. All’Ilahu i do ata që pastrohen shpesh.”**

Dimë se adhurimi në xhaminë Zilar të hipokritëve, nuk ka asnjë vlerë. Për këtë çështje ekzistojnë shumë shprehje të ngjashme jo vetëm në Kur’an dhe në frazeologjinë arabe, por edhe në gjuhë të tjera.

¹ Sure “En Nisa”, ajeti 128.

² Sure “El Bekare”, ajeti 221.

Nga tërësia e gjithë asaj që u tha, arrijmë në përfundim se hadithi i Nu'man ibn Beshirit, meqenëse është në kundërshtim me përmbajtjen e Kur'anit, duhet lënë anash dhe duhet hequr dorë prej tij. Kjo gjë përputhet me përmbajtjen e ajeteve. Është po ai hadithi i njohur, të cilin e cekëm në fillim të diskutimit për shkakun e zbritjes. Kjo është një epërsi dhe virtyt për udhëheqësin dhe prijësin e madh, Imam Aliun (*Paqja qoftë mbi të!*).

O Zot! Të lutem na mundëso të gjithëve ne, që të pasojmë të vërtetën dhe të jemi pasues, të udhëheqësve dhe prijësve të tillë, që sytë, veshët dhe mendjen tonë ta mbajmë larg paragjyqimeve.

2- Nga ajetet e lartpërmendura, përftohet se pozita e kënaqësisë, që konsiderohet prej begative më të larta dhe është një pozitë që Zoti i Madhëruar ua dhuron besimtarëve, luftëtarëve të drejtë, është ndryshe nga kopshtet e Xhennetit dhe begatitë e përhershme të Tij, si diçka shtesë ndaj Mëshirës së gjerë të Zotit.¹

¹ Përshkrimi i kësaj çështje, me vullnetin e Zotit, do ta japim në ajetin 72 të po kësaj sureje, në komentimin e fjalisë **“ue ridhuanu minell’lahi ekber”**.

Ajetet 23 - 24

يَأْتِيهَا الَّذِينَ ءَامَنُوا لَا تَتَّخِذُوا ءَابَاءَكُمْ وَاِخْوَانَكُمْ ءَوْلِيَاءَ
 اِنْ اُسْتَحَبُّوا الْكُفْرَ عَلَى الْاِيْمَانِ وَمَنْ يَتَوَلَّهُمْ مِّنْكُمْ
 فَاُولٰٓئِكَ هُمُ الظَّالِمُونَ ﴿٢٣﴾ قُلْ اِنْ كَانَ ءَابَاؤُكُمْ وَاَبْنَاؤُكُمْ
 وَاِخْوَانُكُمْ وَاَزْوَاجُكُمْ وَعَشِيرَتُكُمْ وَاَمْوَالٌ اُقْتَرَفْتُمُوهَا
 وَتِجْرَةٌ تَخْشَوْنَ كَسَادَهَا وَمَسَاكِينُ تَرْضَوْنَهَا اَحَبَّ اِلَيْكُمْ
 مِّنَ اللّٰهِ وَرَسُوْلِهِ ۚ وَجِهَادٍ فِي سَبِيْلِهِ ۚ فَتَرْبَّصُوْا حَتّٰى يَأْتِيَ اللّٰهُ
 بِاَمْرٍ ۗ وَاللّٰهُ لَا يَهْدِي الْقَوْمَ الْفٰسِقِيْنَ ﴿٢٤﴾

"O besimtarë! Mos i pranoni për mbrojtës baballarët dhe vëllezërit tuaj, nëse ata e duan mosbesimin më shumë se sa besimin. Kushdo prej jush që i merr ata për mbrojtës, është keqbërës."

"Thuaj: 'Nëse etërit tuaj, bijtë tuaj, vëllezërit tuaj, gratë tuaja, farefisi juaj, pasuria juaj që e keni fituar, tregtia për të cilën keni frikë se nuk do të shkojë mirë dhe shtëpitë ku e ndieni veten rehat, janë më të dashura për ju se sa All'llahu, i Dërguari i Tij dhe lufta në rrugën e Tij, atëherë pritni deri sa All'llahu të sjellë vendimin (dënimin) e Tij. All'llahu nuk e udhëzon në rrugën e drejtë popullin e pabindur."

Komentimi

Duhet sakrifikuar Gjithçka për Zotin

Cytja apo justifikimi i fundit, që mund të ekzistonte për një grup myslimanësh, karshi urdhrin të luftimit me idhujtarët, që në bazë të disa komentimeve, ekzistonte me të vërtetë, ishte se ata mendonin, që nga njëra anë, në mesin e politeistëve dhe idhujtarëve ekzistonin farefise dhe familjarë të tyre, që ishin kthyer në rrugën e Islamit. Kishte familje që babai ishte bërë mysliman, kurse djali kishte mbetur politeist. Ndonjëherë ndodhte e kundërta, djemtë ishin në rrugën e monoteizmit, kurse baballarët vazhdonin në rrugën e tyre të politeizmit. E njëjta gjë vlente dhe për vëllezërit, bashkëshortët dhe fiset. Nëse u duhej të luftonin me të gjithë politeistët, duhet t'i mbyllnin sytë ndaj farefisit të tyre.

Nga ana tjetër, një pjesë e konsiderueshme e kapitaleve dhe e tregtive të tyre ishte në duart e politeistëve dhe me lëvizjen e tyre tregtia lulëzohej në Mekë.

Së treti, në Mekë ata kishin shtëpi të bollshme, të ndërtuara në mënyrë të tillë, që, nëse do të luftonin me politeistët, kishte mundësi të shkatërroheshin, ose për shkak të pushimit të Haxhit nga ana e politeistëve, të humbnin vlerën dhe të dilnin jashtë "shërbimit".

Ajetet flasin për njerëz të tillë dhe u përgjigjet atyre në mënyrë të prerë. Në fillim thuhet: **"O ju që keni besuar! Mos i pranoni për mbrojtës baballarët dhe vëllezërit tuaj, nëse ata e duan mosbesimin më shumë sesa besimin."**

Më pas, për ta ritheksuar, shton: **“Kushdo prej jush që i merr ata për mbrojtës, është keqbërës.”**

A ekziston padrejtësi më e madhe se kjo, që njeriu, me anë të lidhjes së miqësisë me të huajt dhe armiqtë e së vërtetës, t'i shkaktojë dëm edhe vetes, edhe shoqërisë të së cilës i përket, si edhe të Dërguarit të Zotit?!

Në ajetin vijues, për shkak të rëndësisë së jashtëzakonshme të çështjes, po këtë çështje e përmend me theksim dhe kërcënim më të ashpër dhe i drejtohet Profetit (*Paqja dhe bekimet e All'Ilahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), duke i thënë: **“Thuaj: ‘Nëse etërit tuaj, bijtë tuaj, vëllezërit tuaj, gratë tuaja, farefisi juaj, pasuria juaj që e keni fituar, tregtia për të cilën keni frikë se nuk do të shkojë mirë dhe shtëpitë ku e ndieni veten rehat, janë më të dashura për ju sesa All'Ilahu, i Dërguari i Tij dhe lufta në rrugën e Tij, atëherë pritni deri sa All'Ilahu të sjellë vendimin (dënimin) e Tij.”**

Duhet pasur parasysh fakti se preferenca e këtyre çështjeve ndaj kënaqësisë së Zotit dhe luftës në rrugën e All'Ilahut është një lloj mos bindje dhe demoralizim i qartë, ndërsa të pasionuarit dhe të magjepsurit pas jetës materiale, nuk e meritojnë udhëzimin hyjnor.

Në fund të ajetit shton: **“All'Ilahu nuk e udhëzon në rrugën e drejtë popullin e pabindur.”**

Në tefsirin e “Ali ibn Ibrahim El Kummij” është transmetuar se në kohën kur imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*) (gjatë ritualit të Haxhit) shpalli se asnjë politeist nuk ka të drejtë të hyjë në Xhaminë e Shenjtë, kurejshët u ngritën në këmbë duke bërë titur: “Tregtia jonë u zhduk, familjet tona i humbëm dhe shtëpitë tona u

shkatërruan!". Në këtë moment zbritën ajetet e lartpërmendura (dhe Zoti iu përgjigj atyre).¹

Në ajetet 19-22 ravijëzohen linjat kryesore të besimit të drejtë nga besimi jo i drejtë, i përlyer me politeizëm dhe hipokrizi, si dhe vihen vija ndarëse mes besimtarëve të vërtetë dhe njerëzve me besim të dobët.

Shumë qartë thuhet se, nëse kapitalet tetë lloje të jetës materiale, {katër pjesë i përkasin farefisit më të afërt (baballarët, fëmijët, vëllezërit dhe bashkëshortët), një pjesë i përket grupit shoqëror dhe fisnor, pjesa tjetër kapitaleve dhe fitimeve, si dhe ecurisë së tregtisë dhe biznesit; në fund, një pjesë ka të bëjë me shtëpitë e begata}, janë më me vlerë te njeriu dhe më të çmuara se sa Zoti dhe Profeti (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), lufta në rrugën e All'llahut dhe nënshtrimi ndaj urdhrave të Tij, deri aty sa nuk është i gatshëm t'i sakrifikojë për fenë, atëherë bëhet e qartë se nuk është realizuar besimi i vërtetë.

Në Ditën e Gjykimit do të manifestohet realiteti dhe fryma e besimit me të gjitha vlerat e saj, që nuk pranon cytje dhe dyshime për sakrifica dhe fljime të tilla.

Përveç kësaj, ata që nuk janë të gatshëm të bëjnë një sakrificë të tillë, i kanë shkaktuar dhunë vetes dhe shoqërisë së tyre, madje do të bien pre e asaj që kanë frikë prej saj, sepse

¹ "Biharul Enuar", vëll. 35, f. 293; Tefsiri "Ali ibn Ibrahim", vëll. 1, f. 284; "Darul Kutub", Kum, 1404 Hixhri kameri; Tefsiri "Es Safi", vëll. 2, f. 329, "Mektebetu El Sadir", Teheran, Botim i dytë, 1416 Hixhri kameri; Tefsiri "Es Safi", vëll. 1, f. 457, Botimet e Zyrës së Propagandës, Botim i parë, 1418 Hixhri kameri; Tefsiri "El Mizan", vëll. 9, f. 216, Intesharate "Xhamiul Muderisin", Kum.

populli, që, në momentet më kulmore të historisë së tij dhe në çastet më vendimtare, nuk është i gatshëm për sakrificat të tilla, herët ose vonë, do të përballet me humbje dhe farefisi e pasuria, apo kapitali, që, për shkak të magjepsjes pas tyre, hoqi dorë nga luftimi në rrugën e All'Allahut, do të vihen në rrezik dhe do të bien në kthetrat e armikut, duke u asgjësuar.

Hulumtime

1- Lidhja farefisnore

Atë që lexuam në ajetet më lart, nuk nënkupton shkëputjen e lidhjeve miqësore dhe emocionale me familjarët dhe farefisnin, as përçmimin dhe injorimin e të mirave ekonomike, as nxitjen për të hequr dorë nga ndjenjat humane, por shënon faktin që, kur ndodhemi në udhëkryq, dashuria ndaj gruas, fëmijës, pasurisë, pozitës, shtëpisë dhe familjes nuk duhet të jenë pengesë e zbatimit të rregullave hyjnore dhe prirjes drejt luftës dhe ta parandalojë njeriun nga qëllimi i tij i shenjtë.

Prandaj, nëse njeriu nuk ndodhet në udhëkryq, zbatimi i të dyjave është i obligueshëm dhe i domosdoshëm për të.

Në ajetin 15 të sures "Lukman", në lidhje me prindërit idhujtarë, lexojmë: **"E nëse ata të dy tentojnë që ti të më përshkruash Mua shok, për çka ti nuk ke kurrfarë fakti, atëherë mos i respekto ata, po në çështjet e jetës së kësaj bote të kesh mirëkuptim ndaj tyre..."**

2- Caktimi i fitores së Profetit (Paqja dhe bekimet e All'Ilahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) është i patjetërsueshëm

Njëri komentim i fjalisë: **“atëherë pritni deri sa All'Ilahu të sjellë vendimin (dënimin) e Tij”** është po ai që u tha më lart, që është një kërcënim nga ana e Zotit për ata që interesat e tyre materiale, i paravendosin ndaj kënaqësisë së Zotit. Meqenëse ky kërcënim është shprehur në mënyrë të turbullt, edhe efekti i tij është më i madh dhe më i frikshëm, ngjashëm me rastin kur njeriu i drejtohet nëpunësit të vet: **“Nëse nuk e bën detyrën tënde, atëherë edhe unë do të bëj atë që më takon.”**

Ekziston edhe një mundësi tjetër për komentimin e kësaj shprehjeje. Nëse ju nuk jeni të gatshëm për një sakrificë të tillë, Zoti i Madhëruar, fitoren e Profetit (*Paqja dhe bekimet e All'Ilahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) do t'ia mundësojë nga rruga që Ai e di, dhe do ta ndihmojë atë me anë të rrugës që vetë All'Ilahu e ka dashur.

Në ajetin 54 të sures “El Maide” thuhet: **“O ju që besuat! Kush largohet prej jush nga feja e vet, s'ka dyshim se All'Ilahu do ta sjellë një popull që Ai e do atë (popull) që është modest e i butë ndaj besimtarëve, por i ashpër dhe i fortë ndaj mohuesve që lufton në rrugën e All'Ilahut dhe që nuk i frikësohet kërcënimit të asnjë kërcënuesi...”**

3- E kaluara dhe e sotmja në varësi të këtij urdhri

Ka njerëz që mendojnë se ajo që është thënë në ajetet më lart, u përket myslimanëve të parë dhe historisë së kaluar. Ky

mendim është i gabuar, sepse këto ajete përfshijnë myslimanët e djeshëm, të sotëm dhe të ardhshëm.

Nëse ata kanë besim të fortë, por nuk janë të gatshëm të luftojnë në rrugën e All'llahut, të sakrifikojnë, në rast nevoje të migrojnë, interesat e tyre materiale t'i vënë përpara kënaqësisë së Zotit dhe për shkak të gruas, fëmijëve, pasurisë, pozitës dhe jetës luksoze, të heqin dorë nga sakrificat, ata i pret një e ardhme e errët. Ata, jo vetëm në të ardhmen, por edhe sot e kësaj dite do të jenë në rrezik dhe të gjitha trashëgimitë, nga e kaluara, si dhe krenaritë e tyre, do të zhduken. Burimet e jetës së tyre do të bien në duart e të tjerëve dhe jeta për ata nuk do të ketë aspak kuptim se "jeta është besim dhe luftë nën hijen e besimit!".

Ajetet më lart duhet t'ua mësojmë të gjithë fëmijëve dhe rinisë myslimane si një slogan, që te ata të ngjallet shpirti i sakrificës, eposit dhe i besimit, në mënyrë që të jenë në gjendje për ta ruajtur trashëgiminë e tyre.

Ajetet 25 - 27

لَقَدْ نَصَرَكُمُ اللَّهُ فِي مَوَاطِنَ كَثِيرَةٍ وَيَوْمَ حُنَيْنٍ إِذْ أَعْجَبَتْكُمْ
كَثْرَتُكُمْ فَلَمْ تُغْنِ عَنْكُمْ شَيْئًا وَضَاقَتْ عَلَيْكُمُ الْأَرْضُ
بِمَا رَحَبْتَ ثُمَّ وَلَّيْتُم مَّدْيَرِينَ ﴿٢٥﴾ ثُمَّ أَنْزَلَ اللَّهُ سَكِينَتَهُ عَلَى
رَسُولِهِ وَعَلَى الْمُؤْمِنِينَ وَأَنْزَلَ جُنُودًا لَمْ تَرَوْهَا وَعَذَّبَ الَّذِينَ
كَفَرُوا وَذَلِكَ جَزَاءُ الْكَافِرِينَ ﴿٢٦﴾ ثُمَّ يَتُوبُ اللَّهُ مِنْ بَعْدِ
ذَلِكَ عَلَى مَنْ يَشَاءُ وَاللَّهُ غَفُورٌ رَحِيمٌ ﴿٢٧﴾

"Në të vërtetë, All'Ilahu ju ka ndihmuar në shumë beteja, si dhe në ditën e (luftës së) Huneinit, kur juve ju mahniti numri juaj i madh. Por ai numër nuk ju solli dobi aspak, sepse toka ju duk juve e ngushtë, edhe pse është e gjerë dhe kthyet shpinën duke ia mbathur."

"Pastaj, All'Ilahu zbriti qetësinë e Tij mbi të Dërguarin e Vet dhe mbi besimtarët, si dhe zbriti luftëtarë (melekë), të cilët ju nuk i patë dot e i dënoi jobesimtarët. Kështu u shpërblyen mohuesit."

"Pas kësaj, All'Ilahu e pranon pendimin për kë të dojë. All'Ilahu është Falës dhe Mëshirëplotë."

Komentimi

Masat e gjera nuk sjellin ndonjë dobi

Në ajetet e mëparshme lexuam se Zoti i fton myslimanët të sakrifikojnë në rrugën e luftës dhe të çrrënjosjes së politeizmit dhe idhujtarisë në të gjitha aspektet, si dhe i paralajmëron ashpër ata që i ka kapluar aq shumë pasioni ndaj fëmijëve, grave, fiseve, familjarëve, pasurisë dhe pozitës, saqë nuk janë të gatshëm të sakrifikojnë dhe të luftojnë në rrugën e All'Ilahut.

Në vazhdimësi të çështjes, në ajetet 25-27, përmend një çështje të rëndësishme, që secili udhëheqës, prijës, në momentet vendimtare duhet t'i tërheqë vëmendjen pasuesve ndaj kësaj çështjeje.

Nëse pasioni ndaj pasurisë dhe fëmijës bëhet shkak që një grup njerëzish t'i parandalojë nga xhihadi i madh ndaj politeistët, nuk duhet t'i shqetësojë besimtarët e drejtë, sepse Zoti i Madhëruar nuk i la vetëm as kur ishin pak në numër (Lufta e Bedrit) dhe as kur ishin shumë (Lufta e Huneinit) numri i madh i tyre u erdhi në ndihmë. Në secilin situatë ndihma dhe përkrahja e Zotit u solli fitoren.

Në ajetin 25 lexojmë: **"Në të vërtetë, All'Ilahu ju ka ndihmuar në shumë beteja..."**

Fjala “*mauatin*” është shumësi i fjalës “*mautin*”. Kjo fjalë ka shumë kuptime. Kuptimi i parë është vendi që e zgjedh njeriu për qëndrim të përhershëm ose të përkohshëm.

Kuptimi tjetër është shesh lufte, ku qëndrojnë luftëtarët për një periudhë të gjatë apo të shkurtër kohore.

Më pas shton: **“si dhe në ditën e (luftës së) Huneinit, kur juve ju mahniti numri juaj i madh. Por ai numër nuk ju solli dobi aspak...”**

Numrin e luftëtarëve islamë në këtë luftë disa e kanë shkruar dymbëdhjetë mijë, disa të tjerë dhjetë mijë persona. Hadithet e njohura kanë miratuar dymbëdhjetë mijë persona.¹ Asnjë prej luftërave islame, të zhvilluara deri në atë kohë, nuk ka shënuar një numër kaq të madh luftëtarësh. Disa myslimanë pohuan me krenari se “sot nuk kemi për të humbur me këtë numër të madh të luftëtarësh.”²

Por me vullnetin e Zotit, ashtu siç do ta pohojmë në të ardhmen, në përshkrimin e Betejës së Huneinit, kjo turmë e madhe, ku një grup prej tyre sapo ishin bërë myslimanë dhe ishin të paformuar, u bë shkak i arratisjes së ushtrisë islame dhe i humbjes në betejën e parë, edhe pse në vazhdim Zoti i mëshiroi dhe ata e fituan luftën.

¹ “Biharul Enuar”, vëll. 21, f. 146-147, 149, 155 dhe 165.

² “Biharul Enuar”, vëll. 21, f. 147, 155 dhe 160. “El Ershade i Mufidit”, vëll. 1, f. 140, Kongresi i Shejkh Mufidit, Kum, 1413 Hixhri kameri; “E’alamul Ura”, f. 113, “Darul kutubul islamiye”, Teheran; “El Ifesah”, f. 68, Kongresi i Shejkh Mufid-it, Kum 1413 Hixhri kameri; Sherh “Nehxhul Belagah” i Ibn Ebil Hadid, vëll. 15, f. 106, Libraria e Ajetullah Mer'ashit, Kum, 1404 Hixhri kameri; “Fadailu Ali Ebu Talib”, vëll. 1, f. 210, Botimet Elame, Kum, 1379 Hixhri kameri.

Për humbjen e betejës së tyre të parë Kur'ani tregon: **“sepse toka ju duk juve e ngushtë, edhe pse është e gjerë ...”**

Në kohën që ushtria islame u shpërnda në katër anët rreth fushëbetejës së Huneinit dhe me Profetin (*Paqja dhe bekimet e All'Ilahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) kishte ngelur vetëm një grup i vogël, Profeti u shqetësua dhe u zemërua ashpër për largimin e tyre. Zoti iu drejtua me këto fjalë: **“Pastaj, All'Ilahu zbriti qetësinë e Tij mbi të Dërguarin e Vet dhe mbi besimtarët, si dhe zbriti luftëtarë (melekë), të cilët ju nuk i patë dot.”**, pra, po ashtu Zoti ju dërgoi juve ushtri për t'u përforcuar dhe për t'u ardhur në ndihmë, edhe pse këtë ushtri nuk e shihnit.

Ashtu siç e thamë dhe te ajetet që flasin për Betejën e Bedrit, zbritja e kësaj ushtrie hyjnore ishte për përforcimin dhe fuqizimin e shpirtave, si dhe për krijimin e një force të qëndrueshme në zemrat dhe shpirtat e tyre dhe jo për të treguar se në këtë luftë kanë marrë pjesë engjëj dhe forca të padukshme.¹

Në fund, për rezultatin përfundimtar të Luftës së Huneinit shprehet: **“e i dënoi jobesimtarët.”**, ku një pjesë prej tyre u vranë, një pjesë u zunë rob dhe pjesa tjetër u arratis. **“Kështu u shpërblyen mohuesit.”**

Por megjithatë, për jobesimtarët, mohuesit dhe për ata që ia mbathën nga lufta, Zoti i la të hapura dyert e pendimit dhe të rikthimit, që, nëse dëshirojnë, të kthehen drejt Zotit dhe të pranojnë fenë e vërtetë. Në ajetin 27 lexojmë: **“Pas kësaj, All'Ilahu e pranon pendimin për kë të dojë.”**

¹ Për më shumë informacion referohu në po këtë tefsire, ajetet 9-12, të sures “EL Enfal”.

Fjala “*jetubu*” që është përmendur në kohën e tashme, nënkupton vazhdueshmërinë, se dyert e pendimit dhe të rikthimit për ata vazhdojnë të qëndrojnë të hapura.

“All’Ilahu është Falës dhe Mëshirëplotë”. Zoti askujt nuk i mbyll asnjëherë dyert e pendimit, si dhe asnjë njeri nuk e bën të pashpresë nga mëshira e Vet e gjerë.

Tani që komentimi i ajeteve u bë i qartë në mënyrë të përmbledhur, duhet t’i kushtojmë vëmendje disa pikave:

1- Beteja mësimdhënëse e Huneinit

Huneini është emri i një toke, e cila ndodhet në afërsi të qytetit të Taifit dhe meqenëse kjo betejë ndodhi në këtë vend, u njoh me këtë emër, Beteja e Huneinit. Kur’ani këtë e ka përmendur me emrin *jeumul Hunejn*.

Emri tjetër i saj është “*gazvetu Eetas*” (Beteja e Utasit) dhe “*gazvetu Heuazin*” (Beteja e Heuazinit). Utas është emri i një toke në ato rrethina, kurse *Heuazin* është emri i një prej fiseve që u përlesh me myslimanët.

Sipas ibn Ethirit, në librin “El Kamil”, kjo betejë filloi që atje, sepse fisi i madh i Heuazinit mori vesh për fitoren e Mekës. Kryetari i tyre, Malik ibn Afi, i mbledhi ata dhe iu drejtua: “Ka mundësi që pas fitores së Mekës, Profeti (*Paqja dhe bekimet e All’Ilahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) të luftojë me ju.”

Ata thanë: “Para se Ai të luftojë me ne, është më e udhës që ne të nxitojmë para tyre.”

Kur Profeti e dëgjoji këtë lajm, i urdhëroi myslimanët të nisen drejt tokës së Heuazinit.¹

Edhe pse mes historianëve nuk ekziston pothuajse asnjë mospajtim apo kundërshti për rrjedhën e përgjithshme të kësaj lufte, për detajet e saj ka transmetime të ndryshme, që nuk përputhen plotësisht. Ajo që do të përcjellim në vijim është në bazë të transmetimit të të ndjerit Tabarsi në “Mexhmaul Bejjan”.

Në fund të muajit të Ramazanit, ose në muajin e Sheualit, viti i tetë i migrimit, udhëheqësit e fisit të Heuazinit ishin mbledhur rreth Malik ibn Aufit dhe kishin marrë me vete pasuri, fëmijët dhe gratë e tyre, në mënyrë që gjatë përleshjes me myslimanët askush të mos mendonte për arratisjen. Në këtë gjendje hynë në tokën e Eutasit.

Profeti (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) e ngriti flamurin e madh të ushtrisë dhe ia dorëzoi Imam Aliut. Të gjithë ata që ishin mbartës të flamujve të njëjësive përkatëse të ushtrisë islame, me urdhër të Profetit (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), me po këta flamuj, u nisën në drejtim të fushës së Huneinit.

Profeti u informua se Safuan ibn Umejeh ka në dispozicion një sasi të madhe armësh dhe dërgoi dikë te ai, dhe i kërkoi hua njëqind armë.

Sefuani pyeti: “Ma thuaj të vërtetën, a është kjo huazim apo konfiskim?”

¹“El Kamilu” i ibn Ethirit, vëll. 2, f. 261, (vëll. 1, f. 624 e tutje në “Ihja Turathil Arabi”, Bejrut, Botim i parë, 1408 Hixhri kameri).

Profeti (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) tha: “Është një hua, të cilën ne do ta garantojmë dhe do ta kthejmë të plotë dhe pa të meta.”

Sefuani i dorëzoi Profetin (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) njëqind copë armë, si hua dhe vetë personalisht u nis me Profetin (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*).

Dymijë myslimanë, të cilët e kishin pranuar Islamin gjatë çlirimit të Mekës, plus dhjetë mijë ushtarë myslimanë, të cilët e shoqëronin Profetin (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) gjatë çlirimit të Mekës, gjithsej dymbëdhjetë mijë persona, u nisën për në sheshin e luftës.

Malik ibn Afi, i cili ishte burri më i guximshëm dhe më trim i fisit të vet, u dha urdhër njerëzve të tij që të thyenin këllëfët e shpatave, të pozicionoheshin në hendeqet e maleve, në luginat përreth, mes pemëve dhe t'i zinin pritë ushtrisë islame dhe, në të aguar, t'i sulmonin pa mëshirë myslimanët dhe t'i shpartallonin.

Ai shtoi: “Muhammedi (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) akoma nuk është përballur me luftëtarë të vërtetë. Tani do të shijojë shijen e humbjes.”

Profeti (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) pasi e fali namazin e sabahut me shokët e vet dha urdhër që të drejtohen në drejtim të tokës së Huneinit. Këtu ata e gjetën veten të ekspozuar dhe nën shënjestër të shigjetave të ushtrisë së Heuazinit.

Grupi që ndodhej në rreshtin e parë të ushtrisë (në mesin e tyre kishte nga ata që sapo e kishin përqaftuar Islamin) u arratis.

Kjo u bë shkak që pjesa e mbetur e ushtrisë të ndihej e trishtuar dhe e frikësuar.

Imam Aliu, i cili ishte mbajtës i flamurit, bashkë me një numër të vogël, rezistoi përballë ushtrisë së armikut dhe vazhdoi të luftojë, (Në këtë kohë Profeti ishte në zemër të ushtrisë.). Abbasi, xhaxhai i Profetit dhe disa persona të tjerë nga Beni Hashimi, gjithsej nëntë persona, i dhjeti ishte Ejmeni, i biri i Umu Ejmenit, ishin pranë Profetin (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*).

Rreshti i parë i ushtrisë, gjatë largimit dhe prapësimit nga lufta, kaluan në afërsi të Profetit (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*). Ndërkohë Profeti (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) urdhëroi Abbasin, i cili kishte zë të lartë dhe të qartë që menjëherë të ngjitej në kodrën më të afërt që ndodhej pranë tyre dhe të thërrasë: “O grupi i muhaxhirëve dhe i ensarëve! O ju për të cilët flitet në suren “EL Bekare”! O njerëz të besëlidhjes së pemës! Për ku jeni nisur? Profeti është këtu!”

Në kohën që myslimanët i dëgjuan fjalët e Abbasit, u kthyen duke bërtitur: “Lebbejk, lebbejk!” (Dëgjuam dhe jemi me ty!)

Në këtë rikthim, veçanërisht ensarët ishin paraprijës dhe, me të shtrënguar rreshtat e tyre, i mësynë armikut nga gjitha anët dhe, me ndihmën e Zotit, vazhduan marshimin, saqë fisi i Heuazinit, u shpërnda në të gjitha anët. Myslmanët i ndiqnin gjithnjë ata nga prapa.

Afërsisht njëqind vetë nga armiqtë u vranë dhe pasuria e tyre kaloi në duart e myslimanëve. Një grup prej tyre gjithashtu u zu rob.¹

Në fund të këtij transmetimi historik lexojmë se, pas përfundimit të luftës, përfaqësuesit e fisit të Heuazinit erdhën pranë Profetit (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) dhe e pranuan Islamin. Profeti tregoi dashuri të madhe për ta. Madje kur kryetari i fisit, Malik ibn Aufi e pranoi Islamin, Profeti (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ia ktheu atij pasurinë, plaçkat dhe robërit, si dhe udhëheqjen e myslimanëve të fisit të tij ia besoi atij.

Shkaku më i rëndësishëm i humbjes, në fillim të luftës, përveç mburrjes që kishin për shkak të numrit të madh të ushtrisë, ishte edhe prania e dymijë personave, të cilët sapo kishin përqaftuar fenë islame. Natyrisht që në mesin e tyre ishte një grup prej hipokritëve dhe një grup që luftonte vetëm për fitimin e plaçkave të luftës, kurse grupi tjetër nuk kishte ndonjë qëllim apo synim të caktuar. Largimi i tyre ndikoi dhe te pjesa e mbetur.

Faktori vendimtar i fitores ishte rezistenca dhe qëndresa e Profetit (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), e Imam Aliut, e një grupi të vogël të shokëve, si dhe rikujtimi

¹ "Mexhmaul Bejjan", vëll. 5, f. 33, ajeti në fjalë; "Nuruth Thekalejn", vëll. 2, f. 197; "Muesesetu Ismailie", Botim i katërt, 1412 Hixhri kameri; "El Mizan", vëll. 9, f. 230, Botimet "Xhamiul Muderesejn", Kum; "Enuarul Aluvije uel esrar el Murtedhaujje", f. 203; "Hajdarejje Nexhef", Botim i dytë, 1381 Hixhri kameri; "Fadail Ali ibn Ebu Talib", vëll. 1, f. 180; "Tab'e Hajderijeh Nexhef", 1376 Hixhri; "Biharul Enuar", vëll. 21, f. 139, Kapitulli 27; "Dhikrul heuadithu ba'del fet'hi ila gazvetil Hunejn", f. 146, K. 28, Gazuetu Hunejn, ue Et Taif uel Eutas...

i besëlidhjeve të mëparshme, besimi në Zot dhe vëmendja ndaj mbështetjes së veçantë të All'Ilahut.

2- Kush u largua nga lufta?

Pa dyshim që në këtë shesh lufte shumica prej tyre u larguan, e hoqën dorë nga lufta. Pjesa e ngelur, në bazë të transmetimit të përmendur, ishte dhjetë veta. Disa kanë thënë katër veta. Disa historianë kanë shkruar se ishin rreth njëqind veta.

Sipas disa transmetimeve të njohura, edhe kalifët e parë bënë pjesë në grupin e të larguarve nga lufta. Disa nga komentuesit syni orvaten që këtë arratisje e largim ta prezantojnë si një çështje të zakonshme.

Autori i tefsirit "El Manar" shprehet se, në kohën që u vunë në dijeni për breshëritë e shigjetave të armiqve, një grup nga Meka, i cili i ishte bashkuar ushtrisë islame, në mesin e tyre kishte hipokritë, njerëz me besim të dobët, që ishin në kërkim të plaçkave dhe pasurisë, ia kthyen shpinën fushëbetejës. Pjesa e mbetur e ushtrisë natyrisht që ishte e shqetësuar dhe e hutuar. Edhe ata, gjithashtu, në bazë të "zakonit" dhe jo për shkak të frikës, vendosën të largoheshin. Kjo është një çështje e natyrshme, që në kohën kur një grup ikën nga sheshi i luftës, pa dyshim që edhe grupi tjetër, padashur, ndihet i tërbuar. Si rrjedhojë, largimi i tyre nga beteja nuk do të thoshte heqje dorë nga ndihma e Profetit (*Paqja dhe bekimet e All'Ilahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*)

dhe kërkimin e ndihmës te politeistët, në mënyrë që të meritojnë hidhërimin dhe zemërimin e Zotit.¹

Ne nuk do të bëjmë ndonjë koment për këtë çështje dhe gjykimin e saj do t'ia lemë lexuesit.

Është e nevojshme të përmendet se kur "Sahihu i Bukhariut", kur flet për humbjen dhe arratisjen e myslimanëve nga fusha e luftës thotë: Omer ibn Khatabi ishte në mesin e njerëzve. Transmetuesi thotë: E pyeta Omer ibn Khatabin, "Çfarë bënë njerëzit?"

M'u përgjigj: "Ishte urdhëri i Zotit!" Më pas njerëzit u rikthyen te Profeti (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*).²

Nëse i lëmë mënjanë paragjykimet dhe përqendrohemi te Kur'ani, do të vërejmë që atje nuk është bërë ndonjë ndarje midis të arratisurve. Por të gjithë ata që vendosen të largohen nga lufta, qortohen në të njëjtën mënyrë.

Nuk e dimë se çfarë ndryshimi ka midis frazës "**... dhe kthyet shpinën duke ia mbathur**", që e lexuam në ajetin më lart me frazën tjetër, të përmendur në ajetin 16 të sures "El Enfal":

¹ Tefsiri "El Minar", vëll.10, f. 262-265; "Sahih Bukhari", vëll. 4, f. 57-58; vëll. 5, f. 100-101; "Darul Fikr", Bejrut, Botim i "Darul Tabaël emir bi Istanbul", 1401 Hixhri kameri; "Sunen ibn Davud", vëll. 1, f. 616, "Darul Fikr", Bejrut, Botim i parë, 1410 Hixhri kameri; Hulumtim i Said Muhammed Leham; Sunenul Kubra i El Bajhakij, vëll. 6, f. 306, "Darul Fikr", Bejrut; "Tarikh Medine Dimashk", vëll 67, f 147; "Darul Fikr" Bejrut, 1415 Hixhri Kameri, Hulumtues Ali Shiri.

² Tefsiri "El Manar", vëll. 10, f. 262-265, "Sahih Bukhari", vëll. 4, f. 57-58, vëll. 5, f. 100-101; "Darul Fikr", Bejrut, Botim i "Darul Tebaël emir bi Istanbul", 1401 Hixhri kameri; "Sunen ibn Davud", vëll. 1, f. 616, "Darul Fikr", Bejrut, Botim i parë, 1410 Hixhri kameri, Hulumtim i Saidd Muhammed lil Ham sunene Kibrjae Biheki, vëll. 6, f. 306, "Darul Fikr", Bejrut; "Tarikh Medine Dimashk", vëll. 67, f. 147; "Darul Fikr", Bejrut, 1415 Hixhri Kameri, Hulumtues Ali Shiri.

“Kush ua kthen atyre shpinën, në atë moment veç atij që kthehet për të luftuar ose për t’iu bashkëngjitur një grupi tjetër, ai ka tërhequr kundër vetes hidhërimin e All’lilhatut ...”

Andaj, nëse këto dy ajete i vëmë krahas njëri-tjetrit konstatohet se myslimanët, atë ditë, përveç një grupi të vogël, kishin kryer një gabim të madh, por më vonë u penduan dhe u rikthyen.

3- Besimi dhe qetësia

Fjala *“sekine”* rrjedh nga fjala *“sukun”* dhe është në kuptimin e një gjendjeje qetësie dhe sigurie, që largon nga njeriu çdo lloj frike, dyshimi, pasigurie dhe tmerrri dhe i dhuron atij qëndrueshmëri të palëkundur karshi ngjarjeve dhe sprovave të vështira.

Fjala *“sekine”* ka një lidhje të ngushtë me besimin, që do të thotë është e lindur prej besimit. Njerëzit besimtarë, në kohën që mendojnë për fuqinë e pafund të Zotit dhe marrin parasysh mëshirën dhe mirësinë e Tij, në zemrat e tyre vërehet një valë shprese. Kjo është arsyeja që në disa hadithe dhe transmetime vërejmë se fjala *“sekine”* është interpretuar si *“Iman”* – *“Besim”*.¹

Dhe në disa transmetime të tjera si një *“flad parajse”* në formën dhe portretin e njeriut² dhe që të gjitha i referohen po atij kuptimi.

¹ Tefsiri *“Burhan”*, vëll. 2, f. 114, (vëll. 2, f. 755, Fondacioni *“Bi’thet Teheran”*, Botimi i parë, 1415 Hixhri; *“Usul-el Kafi”*, vëll. 2, f. 15, K. *“Fi enne sekine hijel iman”*, *“Darul kutubil islamije”*; *“Biharul Enuar”*, vëll.13, f. 443 dhe vëll. 22, f. 199-200.

² *“Nuruth Thakelejn”*, vëll.2, f. 201, *“Mueseseh ismailijan”*, Botim i katërt, 1412 Hixhri kameri, *“Usul El Kafi”*, vëll.3, f. 471-472 dhe vëll. 4, f. 206, vëll. 5 f. 257; *“Darul Kutubul islamije”*, *“Uesailu Shia”*, vëll. 7, f. 396 dhe vëll. 13, f. 212-213; *“Biharul Enuar”*, vëll. 12, f. 102-103, vëll. 13, f. 443-444, 450-451; vëll. 21, f. 147; vëll. 26, f. 203; vëll. 73, f.243 dhe 286; vëll 96, f. 48-53.

Në Kur'anin e Madhërisëm, në suren "El Fet'h", ajeti 4, lexojmë: **"Ai është që në zemrat e besimtarëve dhuroi qetësinë për ta shtuar ata bindjen në besimin e vet që kishin..."**

Sidoqoftë, kjo gjendje e jashtëzakonshme psikike është një begati hyjnore dhe qiellore, që, nën ndriçimin e saj, njeriu i tret problemet apo ngjarjet më të vështira dhe brenda vetes ndien një botë të qetë dhe të qëndrueshme.

Mbresëlënës është fakti se Kur'ani, në ajetet në fjalë, nuk po thotë: "Pastaj All'llahu zbriti qetësinë e vet në të Dërguarin e Tij dhe mbi ju" ndërkohë që të gjitha fjalitë pararendëse janë përmendur në formën e adresimit, me përemrin "kum"- "juve". Por po thotë "*alel mu'minin*" - "*mbi besimtarët*". Ky është aluzion i qartë sepse hipokritët dhe ata që lakmonin këtë botë në sheshin e luftës nuk kishin asnjë përfitim. Kjo qetësi (sekine) dhe kjo begat, u përket vetëm njerëzve besimtarë.

Në hadithe lexojmë: "Ky 'fllad parajsë' ka qenë gjithnjë me të Dërguarit dhe Profetët e Zotit."¹ Kjo është arsyeja, që në ngjarje të tilla çdo njeri e humb vetëkontrollin. Ata kishin një shpirt të qetë, vendosmëri të theksuar, vullnet të hekurt dhe të palëkundur. Zbritja e qetësisë mbi të Dërguarin e All'llahut, në sheshin e Huneinit, ashtu siç e cekëm, ishte se Profetin e kaploi shqetësimi, kur pa njerëzit të largoheshin. Por ai (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) në këtë skenë ishte i

¹ Tefsiri "Burhan", vëll. 2, f. 112, (vëll. 2, f. 753, 756, Institucioni "Bi'thet Teheran", Botim i parë, 1415 Hixhri kameri; "Usul El Kafi", vëll. 4, f. 206, "Darul Kutubul islamije", "Uesailu Shia", vëll. 13, f. 212; "Biharul Enuar", vëll.12, f. 102; vëll. 13, f. 443-444, 450-451.

palëkundur dhe i qëndrueshëm si mali, po kështu edhe Imam Aliu me një grup të vogël myslimanësh.

4- Numri i luftërave të Profetit (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*)

Në ajetet 25-27 u aludua për ndihmën që Zoti u dha myslimanëve në shumë sheshe.

Ka diskutime midis komentuesve të Kur'anit për numrin e luftëtarëve që ndoqën Profetin (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*). Por në bazë të disa transmetimeve të ardhura nga Ehli Bejti, numri i tyre arrin tetëdhjetë.

Këta luftëtarë kanë marrë pjesë në luftë, qoftë me Profetin, qoftë në mungesë të tij.¹

Në librin e njohur "Usul El Kafi" është transmetuar se njëri prej kalifëve abasid kishte premtuar se, nëse do të shpëtojë nga helmimi, do t'u dhuronte të varfërve pasuri të shumtë. Kur gjendja e tij shëndetësore u përmirësua, juristët rreth tij kishin mosmarrëveshje për shumën e pasurisë që ai duhet të jepte.

Më në fund ai e pyeti Imamin e nëntë, Muhammed ibn Ali Takin (*Paqja qoftë mbi të!*) dhe ai iu përgjigj: "Kethir" (të shumtë), do të thotë tetëdhjetë."

Kur e pyetën për arsyen e saj, Imami, duke u bazuar në ajetin 27, tha: "Ne, kur llogaritëm numrin e fushëbetjave të luftës

¹ "Biharul Enuar", vëll. 19, f. 155-156; vëll. 21, f. 146; vëll. 48, f. 75; vëll. 50, f. 163 dhe vëll.100 f. 207; vëll. 101, f. 216-217, 222, 227, 230, 246 dhe 247.

midis Islamit dhe politeizmit, ku myslimanët kishin korrur fitore, numri i tyre ishte tetëdhjetë.”¹

5- Mburrja është e ndaluar

Myslmanët sot duhet t'i kushtojnë vëmendje dhe të nxjerrin mësim nga ngjarje të ndryshme, siç është ngjarja e Huneinit, që numri i madh i njerëzve dhe i popullsisë asnjëherë nuk duhet të bëhet shkak për mburrje.

Numri i madhe i popullsisë nuk siguron ndonjë sukses. E rëndësishme është prania e njerëzve të formuar, besimtarë dhe të vendosur. Edhe pse një grup i vogël, grupi i vogël i Huneinit ndryshoi fatin e luftës. Kjo tregoi se numri i madh i popullsisë, i pasprovuar dhe i paformuar, u bë shkak i humbjes dhe i dështimit.

I rëndësishëm është edukimi i njerëzve me frymën e besimit, të qëndrueshmërisë dhe të sakrificës, në mënyrë që zemra e tyre të jetë qendra e qetësisë hyjnore dhe përballë stuhive më të mëdha të jetës së tyre të tregohen të qëndrueshëm dhe të qetë si një mal.

¹ “Nuruth Thekalejn”, vëll. 2, f. 197, “Mueseseh ismailijan”, Botim i katërt, 1412 Hixhri kameri; “Usul El Kafi”, vëll. 7, f. 463-464; “Darul kutubul Islamije Uesailu Shia”, vëll. 23, f. 297 dhe 299; “Biharul Enuar”, vëll. 19, f. 165.

Ajeti 28

يَأْتِيهَا الَّذِينَ ءَامَنُوا إِنَّمَا الْمُشْرِكُونَ نَجَسٌ فَلَا يَقْرَبُوا
 الْمَسْجِدَ الْحَرَامَ بَعْدَ ءَامِهِمْ هَذَا وَإِنْ خِفْتُمْ عَيْلَةً فَسَوْفَ
 يُغْنِيكُمُ اللَّهُ مِنْ فَضْلِهِ إِنْ شَاءَ إِنَّ اللَّهَ عَلِيمٌ حَكِيمٌ ﴿٢٨﴾

"O që keni besuar! Në të vërtetë, idhujtarët janë të papastër (për shkak të besimit të kotë), prandaj të mos i afrohen më Xhamisë së Shenjtë pas këtij viti. Dhe mos kini frikë nga varfëria, sepse, po deshi, All'lahu ju bën të pasur me dhuntitë e veta. Vërtet, All'lahu është i Gjithëdijshëm dhe i Urtë."

Komentimi

Idhujtarët nuk kanë të drejtë të futen në Xhaminë e Shenjtë

Ashtu siç e cekëm më lart, një prej katër urdhrave, që Imam Aliu (*Paqja qoft mbi të!*) ia komunikoi popullit të Mekës, gjatë ritualit të Haxhit, në vitin e nëntë Hixhri, ishte se duke filluar nga viti i ardhshëm, asnjë prej politeistëve nuk ka të drejtë të vizitojë dhe të hyjë në Xhaminë e Shenjtë. Ajeti 28 i adresohet kësaj çështjeje dhe filozofisë së saj.

Ajeti nis: “O që keni besuar! Në të vërtetë, idhujtarët janë të papastër (për shkak të besimit të kotë), prandaj të mos i afrohen më Xhamisë së Shenjtë pas këtij viti...”

A është ky ajet argument për papastërtinë e idhujtarëve për nga pikëpamja e fik'hut apo jo? Ka opinione dhe kundërshtime mes juristëve islamë dhe komentuesve të Kur'anit. Për të zbërthyer kuptimin e ajetit është e nevojshme, që në fillim të shqyrtohet fjala “*nexhis*” – “*e papastër*”.

Fjala “*nexhese*” ka kuptimin e paskajores, si dhe përdoret në kuptimin e cilësisë, për të theksuar dhe për të lartësuar një çështje.

Ragibi, në fjalorin e tij të njohur “Mufredat”, për kuptimin e kësaj fjale pohon se fjalët “*nexhaset*” dhe “*nexhes*” kuptojnë çdo lloj papastërtie, “njëra është papastërti e prekshme (fizike) dhe tjetra është papastërti e brendshme”. Tabersiu në “*Mexhmaul Bejjan*” thotë: “‘*Nexhis*’ konsiderohet çdo gjë, që natyra e njeriut ndien neveri”. Për këtë arsye, kjo fjalë përdoret për raste të ndryshme, që nuk përputhen me kuptimin e saj, pra, nuk ekziston papastërti fizike dhe të jashtme, p.sh:

Arabët, dhimbjet që shërohen me vonesë, i quajnë “*nexhis*”.

Njerëzit e këqij dhe të ligë përshkruhen me këtë fjalë.

Plakjen dhe rraskapitjen e trupit, gjithashtu, e quajnë “*nexhes*”.

Nga këto, duke u bazuar vetëm në ajetin 28, mund të nxjerrim si përfundim se nuk mund të gjykohet se përdorimi i fjalës “*nexhis*” ndaj politeistëve është se trupi i tyre apo gjaku i tyre është i papastër, apo për shkak të jashtëqitjes, apo pijes

alkoolike, ose për shkak të asaj që doktrina e idhujtarisë ka një lloj papastërtie të brendshme.

Në këtë mënyrë, papastërtia (fetare) e politeistëve nuk mund të vërtetohet dhe të argumentohet vetëm me anë të këtij ajeti, por duhet të kërkojmë argumente të tjera.

Më pas, në përgjigje të njerëzve mendjeshkurtër, që pohonin se, nëse idhujtarëve do t'u ndërpritej rruga për në Xhaminë e Shenjtë, do të pësonin humbje, përfitimet dhe bizneset e tyre do të pësonin rënie. Si pasojë, do të bëheshin të varfër dhe të mjerë. Kjo është arsyeja që ajeti përfundon: **“Dhe mos kini frikë nga varfëria, sepse, po deshi, All’llahu ju bën të pasur me dhuntitë e veta.”**

All’llahu i bëri të pasur myslimanët me gradën më të lartë, me përhapjen e Islamit, që në kohën e Profetit (*Paqja dhe bekimet e All’llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), kur nisi dhe vërshimi i pelegrinëve drejt shtëpisë së Zotit, në Mekë. Kjo çështje vazhdon sot e kësaj dite. Meka, që nga pikëpamja gjeografike ndodhet në kushtet më të pavolitshme klimaterike, e pozicionuar në mes të një grusht maleve të thata, shkëmbore, pa ujë dhe pa gjelbërim, është shndërruar në një qytet shumë të popullarizuar dhe një qendër e rëndësishme e tregtisë dhe e biznesit. Ajeti përfundon: **“Vërtet, All’llahu është i Gjithëdijshëm dhe i Urtë.”** Çdo urdhër që jep, është në bazë të një urtësie dhe All’llahu është në dijeni për rezultatet e urdhrit në të ardhmen.

Ajeti 29

قَتَلُوا الَّذِينَ لَا يُؤْمِنُونَ بِاللَّهِ وَلَا بِالْيَوْمِ الْآخِرِ وَلَا يُحَرِّمُونَ
 مَا حَرَّمَ اللَّهُ وَرَسُولُهُ وَلَا يَدِينُونَ دِينَ الْحَقِّ مِنَ الَّذِينَ أُوتُوا
 الْكِتَابَ حَتَّى يُعْطُوا الْجِزْيَةَ عَنْ يَدٍ وَهُمْ صَاغِرُونَ ﴿٢٩﴾

"Luftojini ata që nuk besojnë në All'llahun e as në Ditën e Kiametit, që nuk e marrin për të ndaluar atë që e ka ndaluar All'llahu dhe i Dërguari i Tij, dhe ata, midis atyre që u është dhënë Libri, që nuk e pranojnë fenë e vërtetë, derisa të japin xhizjen (taksën) me dorën e tyre, duke qenë të përlulur."

Komentimi

Përgjegjësia jonë karshi Njerëzve të Librit

Në ajetet e mëparshme u diskutua për përgjegjësinë e myslimanëve ndaj idhujtarëve. Ajeti 29, si dhe ajetet në vijim, e shpjegojnë përgjegjësinë e myslimanëve karshi Njerëzve të Librit.

Në këto ajete, Islami ka përcaktuar dhe ka parashikuar një seri dispozitash të ndërmjetme për Njerëzit e Librit, një kuadër ligjor të ndërmjetëm, në krahasim me myslimanët dhe politeistët,

sepse ata, për nga pikëpamja e pasimit të një feje qiellore, kanë ngjashmëri me myslimanët.

Por nga ana tjetër, ngjajnë me politeistët. Kjo është arsyeja që Islami nuk e lejon vrasjen e tyre, ndërkohë që një gjë të tillë e lejon për idhujtarët luftënxitës, të cilët tregonin rezistencë. Programi islam nxit çrrënjosjen e idhujtarisë nga rruzulli tokësor.

Por bashkëjetesën me Njerëzit e Librit e lejon, vetëm nëse ata të jetojnë në paqe me myslimanët, si një pakicë e shëndetshme fetare. Respektojnë fenë islame dhe heqin dorë prej nxitjes kundër myslimanëve dhe propagandave kundër Islamit. Një prej shenjave të pranimit të një bashkëjetese të tillë paqësore është pranimi i "xhizijes", një lloj takse frymore, që për çdo vit duhet t'ia dorëzojnë qeverisë islame, kufijtë dhe kushtet e të cilës do të përcaktohen dhe do të bëhen të qartë në diskutimet e ardhshme.

Në rast të kundërt e lejon luftimin dhe përballjen me ta. Argumentin e këtij qëndrimi të ashpër e shpalos brenda tre fjalive në ajetin 29.

Në fillim lexojmë: **"Luftojini ata që nuk besojnë në All'Ilahun e as në Ditën e Kiametit..."**

Por si është e mundur që njerëzit e Librit, si p.sh hebreujtë dhe të krishterët të mos besojnë Zotin dhe Ditën e Ringjalljes, ndërkohë që ata e pranojnë edhe Zotin, edhe Ringjalljen? Kjo është sepse besimi i tyre është i përzier me besëtytni dhe çështje të pabaza.

Sa për besimin në Zanafillën dhe të vërtetën e monoteizmit, mund të japim disa argumente:

Së pari, një grup nga hebreujtë, ashtu siç do ta cekim edhe në ajetet në vijim, Uzejrin e quanin si bir të Zotit dhe të krishterët

në përgjithësi besojnë në hyjninë e Krishtit dhe të Trinitetin (tre Zotat).

Së dyti, ashtu siç do ta diskutojmë edhe në ajetet vijuese, adhurimi i tyre ishte “i përlyer” me politeizëm. Faktikisht adhuronin shkencëtarët dhe udhëheqësit e tyre fetarë, faljen e mëkateve, që është karakteristikë dhe veçori vetëm e Zotit, ata e kërkonin prej udhëheqësve dhe dijetarëve të tyre, si dhe njihnin zyrtarisht dispozitat hyjnore që ata i kishin shtrembëruar dhe i kishin modifikuar.

Për sa i përket çështjes së besimit të tyre në Ringjallje, ishte një besim i shtrembër, sepse ringjalljen, ashtu siç përftohet në bazë të fjalëve dhe bindjeve të tyre, e mendonin vetëm si ringjallje shpirtërore. Prandaj, besimi i tyre është i ngatërruar dhe i shtrembëruar, si në lidhje me “Al Mabda” (fillimin e krijimit) ashtu edhe në Ringjalljen.

Më pas përmend cilësinë e dytë të tyre: **“...që nuk e marrin për të ndaluar atë që e ka ndaluar All’Ilahu dhe i Dërguari i Tij...”**

Ka mundësi, që me grupin emëror të *Dërguarit e Tij* të shënohen Musai dhe Isai (*Paqja qoftë mbi ta!*), sepse ata, pra, Njerëzit e Librit, nuk i përmbaheshin as ndalimeve (veprat e ndaluara) në fenë e tyre dhe ishin të përlyer në shumë vepra, të cilat, në fenë e Musait dhe të Isait (*Paqja qoftë mbi ta!*), ishin të ndaluara. Madje jo vetëm që ishin të përlyer, por ndonjëherë jepnin vendim për lejueshmërinë dhe ligjshmërinë e tyre.

Synimi i përdorimit të fjalës “*resuluhu*” (i Dërguari i Tij) është për Profetin e Islamit. Urdhri për xhihadin është dhënë se ata nuk dorëzohen ndaj gjërave, që Zoti i ka ndaluar me anë të

Profetit (*Paqja dhe bekimet e All'Ilahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), si dhe kryejnë të gjitha llojet e mëkatit.

Kjo mundësi duket më e pranueshme dhe këtë e dëshmon edhe ajeti i 33 i po kësaj sureje, të cilën së shpejti do ta komentojmë: **“(All’Ilahu) Është Ai që e ka dërguar të Dërguarin e Tij me udhërrëfimin (Kur’anin) dhe fenë e së vërtetës, për ta lartësuar atë mbi të gjitha fetë, edhe sikur idhujtarët ta urrejnë këtë gjë.”**

Përveç kësaj fjala *“resuluhu”* në kohën që përmendet në Kur’an, në mënyrë absolute (të pa kushtëzuar), kupton Profetin e Zotit. Nëse me këtë synohej Profeti i tyre, atëherë nuk duhet të ishte në formën e njëjësit, por në formën e shumësit, sepse ata, për vete, kishin shumë të Dërguar. Në ajetin 13 të sures *“Junus”* lexojmë: **“...edhe pse të Dërguarit u erdhën me argumente të qarta...”** (Në Kur’an ekzistojnë edhe shprehje të tjera të ngjashme me këtë shprehje.)¹

Këtu mund të themi se ajeti është sqarim se jomyslimanët nuk i pranojnë të gjitha ndalesat e fesë islame.

Duhet të kemi parasysh se shpalosja e këtyre cilësive bëhet për të shpjeguar arsyen e lejimit të luftimit kundër tyre. Lufta me ta është e lejuar, sepse nuk i kanë pranuar ndalesat islame, si dhe janë përlyer në shumë mëkate. Nëse rezistojnë dhe prishin paqen, atëherë mund të luftohet me ta.

Më në fund përmend cilësinë e tretë të tyre: **“që nuk e pranojnë fenë e vërtetë...”**

¹ Sure *“A’raf”*, ajeti 101; Sure *“Ibrahim”*, ajeti 9; Sure *“Er Rrum”*, ajeti 9; Sure *“Fatir”*, ajeti 2; Sure *“Gafir”*, ajeti 83.

Përsëri, në lidhje me këtë fjali, ekzistojnë dy mundësitë e dhëna më lart. Por duket se me grupin emëror *“fenë e vërtetë”* shënohet feja islame.

Përmendja e kësaj fjalie pas përmendjes së mospranimi të ndalesave islame, është nga lloji i përmendjes të së përgjithshmes, pas përmendjes së të përveçmes, që do të thotë, së pari, se aludon në përlyerjen dhe përfshirjen e tyre në shumë prej gjërave të ndaluara, sepse këto kryerje mëkatesh janë më të prekshme, si p.sh: përlyerja me alkoolin, kamatën, konsumimin e mishit të derrit dhe kryerjen e shumë shthurjeve seksuale, që përditë përhapeshin dhe merrnin përmasa të reja te ata.

Më pas thotë se këta nuk i janë dorëzuar fesë së vërtetë, që do të thotë se fetë e tyre kanë devijuar nga rruga e drejtë, si dhe shumë të vërteta i kanë lënë pas dore, apo i kanë lënë në harresë dhe i kanë zëvendësuar me besëtytni të shumta. Pikërisht për këtë arsye, duhet të pranojnë revolucionin e Islamit dhe ta rinovojnë botën e tyre fetare dhe intelektuale, ose së paku të bashkëjetojnë me myslimanët si një pakicë e paqtë, duke pranuar kushtet e një bashkëjetese paqësore.

Pasi përmend këto tre cilësi, që në realitet lejon luftimin me ta, ajeti thotë: **“...prej atyre që u është dhënë Libri...”**

Fjala *“min”* nga ana kuptimore, këtu ka kuptimin e “s qarimit” dhe jo të “diferencimit”. Kur’ani po thotë se të gjithë pasuesit e vjetër të Librave Qiellorë (fatkeqësisht) janë përlyer me devijime të tilla dhe ky urdhër u drejtohet të gjithë atyre.

Pas kësaj, brenda një fjalie përmend dallimet që ata kanë me idhujtarët dhe politeistët: **“...që nuk e pranojnë fenë e vërtetë,**

derisa të japin xhizjen (taksën) me dorën e tyre, duke qenë të përulur.”

Fjala “*xhizje*” rrjedh nga fjala “*xheza*” dhe është në kuptimin e një takse që u merret jomyslimanëve që jetojnë nën strehën e qeverisë islame. Ky emërtim është se atë e japin si “një kompensim dhe detyrim kundrejt ruajtjes, mbrojtjes së pasurisë dhe jetës së tyre. (Sipas Ragibit në fjalorin “El Mufredat”).

Fjala “*sagir*” rrjedh nga fjala “*sigar*” dhe ka kuptimin e personit që kënaqet me vogëlsinë e tij. Synimi i përdorimit në ajetin 29 është se dhënia e xhizjes (taksës) duhet të jetë si përulësi karshi fesë islame dhe Kur’anit. Shprehur ndryshe, duhet të jetë shenjë e bashkëjetesës paqësore dhe pranimit të pozitës së pakicës së paqtë dhe të respektuar karshi shumicës sunduese.

Disa nga komentuesit e Kur’anit këtë fjalë e kanë përmendur në kuptim të përçmimit, të poshtërimit, të talljes dhe të përqeshjes për Njerëzit e Librit. Ky mendim i dhënë, as përftohet nga kuptimi leksikor i fjalës, as përshtatet me frymën e mësimëve islame, si dhe nuk është në një linjë me dispozitat e tjera që na kanë arritur për me mënyrën e sjelljes me pakicat fetare.

Çështja tjetër që duhet të kemi parasysh është se në ajetin e 29, edhe pse në mesin e kushteve të “*dhitmi-t*” - “*mbrojtjes*” është përendur vetëm “*xhizja*”, përdorimi i shprehjes “*hum sagirun*” - “*duke qenë të përulur*”, është një aluzion i përgjithshëm për kushtet e tjera të sigurimit të mbrojtjes. Nga kjo përftohet se ata, p.sh në mjediset islame të mos kryejnë propaganda kundër myslimanëve, të mos bashkëpunojnë me armiqtë e tyre, si dhe të mos ngrenë ndonjë pengesë në rrugën e përparimit të tyre. Këto çështje nuk

përputhen me frymën e përljes, të nënshtrimit dhe të bashkëpunimit.

Hulumtime

Ç'është xhizja?

Xhizja është një lloj takse islame për person, që u përket njerëzve dhe jo pasurive, tokave. E thënë ndryshe, është një taksë vjetore për person.

Disa janë të mendimit, që rrënja e saj është nuk vjen nga arabishtja dhe është marrë nga fjala e lashtë persiane "gizjet", që ka kuptimin e taksave që merren për përforcimin e ushtrisë.¹

Shumë të tjerë janë të mendimit se kjo fjalë është një fjalë e pastër arabe dhe rrjedh nga fjala "xheza". Taksa e përmendur është një kompensim për sigurinë dhe mbrojtjen, që shteti islam ka parashikuar për pakicat fetare. Xhizja ka ekzistuar edhe para Islamit. Disa janë të mendimit se personi i parë që ka marrë xhizjen ishte mbreti Sasanid Enu Shirvan. Edhe pse për këtë çështje nuk ka gjë të sigurt, së paku dihet se Enu Shirvani ishte udhëheqësi që i merrte taksa popullit të vet, të gjithë atyre që ishin mbi njëzet vjeç dhe më pak se pesëdhjetë vjeç, që nuk ishte punonjës qeveritar (nëpunës civil). Për secilin merrte 12, 8, 6, ose 4 dërhëm, sipas rastit si taksa vjetore për person.

¹ "El xhizje ue ehkamuha" Ali Ekber Kelantri, f. 11, Qendra e botimeve islame, Botim i parë, 1416 Hixhri kameri.

Për filozofinë e taksave kanë deklaruar se mbrojtja e pavarësisë dhe e sigurisë së një shteti është përgjegjësi e të gjithë individëve të shtetit.

Si rrjedhojë, sa herë që një grup aktivizohet për kryerjen e kësaj përgjegjësie, edhe grupet e tjera shoqërore, që për shkak të angazhimeve të tjera shoqërore, nuk kanë mundësi t'i bashkohen ushtrisë, për shpenzimet e luftëtarëve dhe mbrojtësve të sigurisë, të paguajnë taksën vjetore për person.

Kemi dëshmi që e vërtetojnë filozofinë e xhizjes, si për periudhën para Islamit, ashtu edhe gjatë periudhës së Islamit.

Grupmosha që jepnin xhizjen në kohën e Enu Shirvanit (mbi njëzet vjeç deri te mosha pesëdhjetë vjeçare) është një dëshmi e qartë për këtë çështje, sepse kjo grupmoshë u përket njerëzve që kanë fuqinë e mbajtjes së armës, pjesëmarrjes në mbrojtjen, ruajtjen e sigurisë dhe të pavarësisë së shtetit, por që, për shkak të veprimtarisë ekonomike, në vend të saj, paguajnë xhizjen.

Dëshmi tjetër është se xhizja, në Islam, nuk është e nevojshme për myslimanët, sepse xhihadi është i obligueshëm për të gjithë dhe, kur të lindë nevoja, që të gjithë duhet të dalin në sheshin e luftës përballë armikut. Por për shkak se pakicat fetare janë përjashtuar nga xhihadi, në vend të saj, duhet të paguajnë xhizjen, në mënyrë që përmes kësaj të kontribuojnë për ruajtjen dhe mos cenimin e sigurisë së shtetit islam, që të jetojnë të qetë. Po ashtu përjashtimi i të miturve të pakicave fetare, grave, pleqve dhe të verbërve të tyre nga dhënia e xhizjes është një argument tjetër ndaj kësaj çështjeje. Nga ajo që u tha më lart bëhet e qartë që xhizja është vetëm një lloj ndihme financiare, e cila jepet nga ana e Njerëzve të Librit karshi përgjegjësisë që marrin myslimanët për ruajtjen, sigurinë e jetës dhe pasurive së tyre.

Si rrjedhë, ata që e konsiderojnë xhizjen si “e drejta e konfiskimit”, nuk i kanë kushtuar vëmendje filozofisë dhe frymës së kësaj dispozite.

Ata nuk i kanë kushtuar vëmendje faktit se Njerëzit e Librit, kur përfitojnë pozitën e mbrojtjes (bëhen Njerëzit e Dhimmes - *njerëzit e mbrojtur*), qeveria islame është e detyruar t'i mbrojë ato nga çdo lloj sulmi dhe ngacmimi.

Ata nuk kanë asnjë lloj detyrimi për pjesëmarrje në luftë apo për mbrojtjen dhe sigurinë e vendit, përveç dhënies së xhizjes. Bëhet e qartë se përgjegjësia e tyre karshi qeverisë islame është më e ulët se e myslimanëve.

Ata, me anë të dhënies së një shume të vogël, përgjatë një viti, kanë të drejtë të shfrytëzojnë të gjitha mundësitë e qeverisë islame dhe janë të barabartë me myslimanët, edhe duke mos qenë të pranishëm në çështjet e sigurisë dhe duke mos u përballur me rreziqet.

Një prej argumenteve të qarta që e vërteton këtë filozofi është se në traktatet që firmoseshin midis myslimanëve dhe njerëzve të Librit për xhizjen, në periudhën e qeverisë islame, deklarohet se Njerëzit e Librit janë të obliguar të paguajnë xhizjen dhe kundrejt tyre myslimanët janë të obliguar të garantojnë sigurinë e tyre. Qeveria islame do t'i mbrojë ata, edhe nëse ata i sulmojnë dhe i ngacmojnë armiq nga jashtë.

Traktate të tilla janë të shumta. Si shembull do të përmendim një prej tyre, traktatin që Halid ibn Uelidi firmosi me të krishterët në Euftrat.

Teksti i traktatit është:

“Kjo është një letër nga Halid ibn Uelidi, drejtuar Salubasë, djalit të Nestunasë (kryetari i krishterëve) dhe popullit të tij.

Unë lidh kontratë me ju për xhizjen dhe mbrojtjen. Karshi xhizjes ju jeni nën mbrojtjen tonë dhe derisa jeni nën mbrojtjen tonë, kemi të drejtën e marrjes së xhizjes, përndryshe nuk do të kemi këtë drejtë.

Ky traktat është përpiluar dhe është shkruar në muajin Sefer, viti i dymbëdhjetë hixhri”.¹

Për t’u theksuar është fakti se, nëse nuk tregohet pakujdesi për mbrojtjen e tyre, atyre ua kthenin xhizjen, ose nuk ua merrnin aspak atë. Gjithashtu, duhet t’i kushtojmë vëmendje edhe kësaj çështjeje, që xhizja nuk ka një normë të përcaktuar. Pra sasia e saj varet nga mundësia e atyre që e paguajnë xhizjen. Ajo që përftohet nga historia islame është se zakonisht, në lidhje me këtë çështje, përcaktohej një shumë e vogël, afërsisht një dinar për një vit. Madje ndonjëherë, në traktatet, caktohej që dhënësit e xhizjes janë të obliguar ta japin xhizjen sipas mundësive të tyre.

Nga ajo që u tha më lart, kritikantët e shumta dhe paragjykimet që bëhen për këtë dispozitë islame, zbehen, si dhe miratohet fakti se xhizja është një dispozitë e drejtë dhe e logjikshme.

¹ Transmetuar nga Tefsiri “El Manar”, vëll. 10, f. 294; “El xhizje ue ehkamuha Ali EKber Kelantri”, f. 28, Fondacioni i Publikimeve Islame, Botim i parë, 1416 Hixhri kameri; “El mexhmu fi sherhil medhheb”, vëll. 19, f. 417; “Darul fikr, Tarikh Teberi”, vëll. 2, f. 57, Mueseseje ilmi, Bejrut.

Ajetet 30 - 33

وَقَالَتِ الْيَهُودُ عُزَيْرٌ ابْنُ اللَّهِ وَقَالَتِ النَّصَارَى الْمَسِيحُ ابْنُ
 اللَّهِ ذَلِكَ قَوْلُهُمْ بِأَفْوَاهِهِمْ يُضَاهِئُونَ قَوْلَ الَّذِينَ كَفَرُوا مِنْ
 قَبْلُ قَتَلْتَهُمْ اللَّهُ أَنَّى يُؤْفَكُونَ ﴿٣٠﴾ اتَّخَذُوا أَحْبَارَهُمْ وَرُهَبَانَهُمْ
 أَرْبَابًا مِنْ دُونِ اللَّهِ وَالْمَسِيحَ ابْنَ مَرْيَمَ وَمَا أُمِرُوا إِلَّا لِيَعْبُدُوا
 إِلَهًا وَاحِدًا لَا إِلَهَ إِلَّا هُوَ سُبْحَانَهُ عَمَّا يُشْرِكُونَ ﴿٣١﴾ يُرِيدُونَ
 أَنْ يُطْفِئُوا نُورَ اللَّهِ بِأَفْوَاهِهِمْ وَيَأْبَى اللَّهُ إِلَّا أَنْ يُتِمَّ نُورَهُ وَلَوْ
 كَرِهَ الْكَافِرُونَ ﴿٣٢﴾ هُوَ الَّذِي أَرْسَلَ رَسُولَهُ وَبَلَّغَهُ دِينَ
 الْحَقِّ لِيُظْهِرَهُ عَلَى الدِّينِ كُلِّهِ وَلَوْ كَرِهَ الْمُشْرِكُونَ ﴿٣٣﴾

"Hebrenjtë thonë: 'Uzejri është i biri i All'lahut', të krishterët thonë: 'Mesihu është i biri i All'lahut'. Këto janë fjalët e tyre, nga goja e tyre, i imitojnë fjalët e jobesimtarëve të mëparshëm. I vraftë All'lahu! Si po shmangen (nga e vërteta)!"

"Në vend të All'lahut, ata kanë zgjedhur për zot rabinët dhe murgjit e tyre, si dhe Mesinë, të birin e Merjemes, ndërkohë që

janë urdhëruar të adhurojnë vetëm një Zot, përveç të Cilit nuk ka tjetër që meriton të adhurohet. I lartësuar qoftë Ai mbi gjithçka që ia shoqërojnë (në adhurim)."

"Ata dëshirojnë ta fikin dritën (fenë) e All'Ilahut me gojën e tyre, por All'Ilahu ka vendosur vetëm që ta përsosë dritën e Vet, edhe sikur mohuesit ta urrejnë këtë gjë."

"(All'Ilahu) Është Ai që e ka dërguar të Dërguarin e Tij me udhërrëfimin (Kur'anin) dhe fenë e së vërtetës, për ta lartësuar atë mbi të gjitha fetë, edhe sikur idhujtarët ta urrejnë këtë gjë."

Komentimi

Idhujtaria e Njerëzve të Librit

Në ajetet e mëparshme është folur për politeistët, anulimin e marrëveshjeve të tyre, domosdoshmërinë e zhdukjes së idhujtarisë, si dhe për gjendjen e Njerëzve të Librit. Edhe këta, në bazë të disa kushteve, duhet të jetojnë në paqe me myslimanët. Në rast të kundërt, ata duhet të luftohen.

Ajetet 30-33 flasin për një tipar të përbashkët të Njerëzve të Librit, hebrenjtë dhe të krishterët, me politeistët dhe idhujtarët. Ndaj Njerëzve të Librit, deri në një farë mase, është treguar ashpërsi për shkak të largimit të tyre nga monoteizmi dhe prirjes së tyre për një lloj "politeizëm në doktrinë", si dhe "politeizëm në adhurim".

Ajeti 30 thotë: "Hebrenjtë thonë: 'Uzejri është i biri i All'Ilahut', të krishterët thonë: 'Mesihu është i biri i All'Ilahut'.

Këto janë fjalët e tyre, nga goja e tyre, i imitojnë fjalët e jobsimtarëve të mëparshëm. I vraftë All'Ilahu! Si po shmangen (nga e vërteta)!"

Për mendimet që Uzejri dhe Mesihu (Jezu Krishti) janë bij të Zotit, apo jo, do të flasim në ajetet më pas.

Në ajetin 31 aludohet për politeizmin praktik të tyre, karshi politeizmit ideologjik, ose thënë ndryshe, politeizmi në adhurim: **"Në vend të All'Ilahut, ata kanë zgjedhur për zot rabinët dhe murgjit e tyre, si dhe Mesinë, të birin e Merjemes..."**

Fjala *"ahbar"* është shumësi i fjalës *"habr"* dhe është në kuptimin e shkencëtarit dhe të dijetarit, kurse *"ruhban"* është shumësi i fjalës *"rahib"* dhe u atribuohet personave, që jetonin në manastire dhe u kushtoheshin adhurimeve, duke hequr dorë nga kjo botë.

Pa dyshim që hebrenjtë dhe të krishterët nuk binin në sexhde përballë dijetarëve dhe murgjve të tyre, si dhe për hir të atyre nuk falnin namaz, nuk agjëronin, si dhe nuk kryenin as adhurimet e tjera, por u bindeshin atyre pa asnjë kushtëzim, madje edhe dispozitat që ishin në kundërshti me urdhrat e Zotit, ata i konsideronin të detyrueshme për t'i zbatuar. Kur'ani këtë imitim të verbër të tyre dhe të palogjikshëm e ka shprehur me anë të shprehjes *"ittehadhe rabb"* (ata i morën rabinët dhe murgjit e tyre për zot).

Ky interpretim është transmetuar nga Imam Bakiri dhe Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi ta!*): *"Betohem në Zot! Ata (hebrenjtë dhe të krishterët) nuk falën namaz dhe nuk agjëruan për prijësit e tyre, kurse prijësit dhe udhëheqësit e tyre, të ndaluarën e bënë të lejuar për ta"*

dhe të lejuarën e bënë të ndaluar. Ata e pranuan, i pasuan dhe, duke qenë të pavetëdijshëm, i adhuruan ata.”¹

Në një hadith tjetër është shprehur: “Adij ibn Hatimi thotë: “Shkova pranë Profetit (Paqja dhe bekimet e All’llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!). Në qafën time kisha varur një kryq floriri. Profeti më tha: “O Adij! Hiqe nga qafa këtë idhull!” Dhe unë kështu veprova. Më pas iu afrova edhe më shumë dhe dëgjova që po e lexonte këtë ajet kur’anor: “... ata kanë zgjedhur për zot rabinët dhe murgjit e tyre...”

Kur e përfundoi ajetin, i thashë: “Ne kurrë nuk i adhurojmë prijësit dhe udhëheqësit tanë.” Profeti (Paqja dhe bekimet e All’llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) tha: “Vallë a nuk është kështu që ata, të lejuarën e Zotit e kanë ndaluar, kurse të ndaluarën e kanë lejuar dhe ju i pasoni dhe i imitoni ata?”

I thashë: “Po, kështu është.”

Profeti (Paqja dhe bekimet e All’llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) ma ktheu: “Kjo konsiderohet adhurim ndaj tyre.”²

Arsyeja e kësaj çështjeje është më se e qartë, sepse ligjvënia i përket vetëm Zotit dhe askush përveç Zotit nuk ka të drejtë të përcaktojë për njerëzit ndonjë gjë si hallall apo si haram (të

¹ “Mexhmaul Bejjan”, vëll. 5, f. 23, ajeti në fjalë; “Nuruth Thakelejn”, vëll. 2, f. 209, (me pak ndryshim); “Biharul Enuar”, vëll. 9, f. 97 dhe vëll. 24 f. 246; “Usulul Kafij”, vëll. 1, f. 53; “Darul kutubu el islamije; Uesailu Shia”, vëll. 27, f. 125; Tefsiri “Ajjashi”, vëll. 2, f. 86, Shtëpia Botuese Shkencore, Teheran, 1380 Hixhri kameri.

² “Maxhmeul Bejjan”, vëll. 5, f. 23, ajeti në fjalë; “Biharul Enuar”, vëll. 9, f. 98; “Sunen Termedhij”, vëll. 4, f. 342, botoi “Darul Fikr”, Botim i dytë, 1404 Hixhri kameri; “Sunen El Kubra i El Bejhikij”, vëll. 10, f. 116; botoi “Darul Fikr Bejrut”; Mu’xhemul Kebir, vëll. 17, f. 92: “Darul ehjahul turathul Arabi; Botim i dytë; “Xhamiul Bejjan”, vëll. 10, f. 147; “Darul fikr Bejrut”, 1415 Hixhri kameri; “Mu’xhemul ehkamul Kur’an”, vëll. 2, f. 20; “Darul kutubul ilmije”, Bejrut, Botim i parë, 1415 Hixhri kameri.

ndaluar apo të lejuar), ose të caktojë ndonjë ligj. E vetmja punë që njerëzit mund ta kryejnë është zbulimi i ligjeve të Zotit dhe zbatimi i tyre sipas nevojës. Rrjedhimisht, nëse ndonjëri shpik dhe sjell ligje që bien ndesh me ligjet hyjnore dhe ndonjë tjetër e një zyrtarisht atë, si dhe e pranon pa e kundërshtuar, në fakt i ka dhënë një qenieje tjetër pozitën e Zotit. Ky veprim është një lloj politeizmi praktik dhe idhujtari. Thënë ndryshe, një njeri i tillë adhuron një tjetër në vend të Zotit.

Nga dëshmitë përftohet se hebrenjtë dhe të krishterët për udhëheqësit e vet kishin pretendime të tilla, që ndonjëherë ligjet hyjnore mund t'i ndryshonin në bazë të interesave të tyre. Edhe sot e kësaj dite çështja e faljes së mëkatit të të krishterët është një çështje që aplikohet dhe zbatohet në mënyrë që mëkatarët rrëfehen para priftit të tyre dhe ai deklaron: "Të kam falur!"¹

Çështja tjetër, që duhet t'i kushtojmë rëndësi është mënyra e ndryshme e adhurimit. Te krishterët njihet adhurimi i Mesihut (Jezu Krishtit), ndërsa te hebrenjtë kemi adhurim pa kushte të prijësit të tyre. Njëri me të vërtetë Mesihun e konsideronte si birin e Zotit, kurse tjetri, për shkak të bindjes së pakushtëzuar, bën adhurim të liderëve të tyre. Ajeti 30 bën dallimin mes tyre, si dhe i ndan llogaritë e tyre: **"Në vend të All'Ilahut, ata kanë zgjedhur për zot rabinët dhe murgjit e tyre."**

Më pas e ka veçuar hazretin Mesih: **"si dhe Mesinë, të birin e Merjemes."** Kjo tregon se në shprehjet kur'anore merren parasysh të gjitha hollësitë dhe detajet. Në fund të ajetit theksohet për këtë çështje, që të gjitha këto adhurime janë shpikje të njerëzve. Për këto çështje të sajua dhe të rreme ajeti thotë:

¹ Në vëllimin e dytë të po këtij tefsiri, në ajetin 80 të sures "Ali Imran", kemi dhënë disa shpjegime për Njerëzit e Librit.

“ndërkohë që janë urdhëruar të adhurojnë vetëm një Zot, përveç të Cilit nuk ka tjetër që meriton të adhurohet. I lartësuar qoftë Ai mbi gjithçka që ia shoqërojnë (në adhurim).”

Kur’ani i Madhërishëm, me anë të këtij ajeti, u jep një mësim shumë të vyer të gjithë ndjekësve të vet, ndërkohë shpalos një prej nocioneve më të larta të monoteizmit që asnjë mysliman nuk ka të drejtë të pranojë bindjen e pakushtëzuar të tjetrit, sepse kjo vepër është e barabartë me adhurimin e tij. Të gjitha bindjet duhet të vihen brenda kornizës së bindjes ndaj All’llahut dhe pasimi i urdhrat të një njeriu është i lejuar deri sa të mos çojë në kundërshtim të ligjeve të Zotit, pavarësisht se kush do të jetë ky njeri, apo çfarë pozite do të ketë, sepse bindja e pakushtëzuar është e barabartë me adhurimin. Kjo mënyrë bindjeje është një formë e idhujtarisë dhe e adhurimit.

Fatkeqësisht, myslimanët, duke u distancuar nga ky urdhër i rëndësishëm i Islamit dhe “ngritjes” së idhujve njerëzore kanë rënë pre të ndarjeve, mosmarrëveshjeve, kolonializmit. Derisa këta idhuj nuk shuhen e nuk zhduken, nuk duhet të presim që gjërat të rregullohen dhe vihen në rend.

Në thelb, lloje të tilla adhurimesh të idhujve janë më të rrezikshme se adhurimet e kohës së injorancës, ku paganët i bënë sexhde gurit dhe drurit, sepse ato idhuj jofrymorë asnjëherë nuk i kolonizonin adhuresit e vet. Kurse njerëzit që marrin formën e “idhullit” për shkak të autoritarizmit, pasuesit e vet i lidhin me zinxhirin e robërimit dhe i çojnë drejt degradimit apo fatkeqësisë.

Në ajetin 32 bën një krahasim interesant të orvatjeve të kota dhe të pakuptimita jo vetëm të hebrenjve dhe të krishterëve, por edhe të të gjithë kundërshtarëve të Islamit, përfshirë këtu edhe

politeistët: **“Ata dëshirojnë ta fikin dritën (fenë) e All’llahut me gojën e tyre, por All’llahu ka vendosur vetëm që ta përsosë dritën e Vet, edhe sikur mohuesit ta urrejnë këtë gjë.”**

Në këtë ajet vërehen tre pika të rëndësishme:

1- Në këtë ajet feja e Zotit, Kur’ani i Madhërishëm dhe njohuritë islame janë krahasuar me dritën dhe ndriçimin.

Ne e dimë se drita është burim i jetës, i gjallërisë dhe i zhvillimit mbi rruzullin tokësor, si dhe filli i çdo lloj bukurie.

Islami, gjithashtu, është një fe dinamike dhe gjallëruese, që shoqërinë njerëzore e çon drejt përsosmërisë dhe është burim i çdo begatie dhe mirësie.

Përpjekjet dhe orvatjet e armiqve i ka krahasuar me fryrjen e gojës. Sa qesharak duket njeriu kur kërkon të shuajë dritën madhore, siç është drita e diellit, me anë të fryrjes.

Për personifikimin e ultësisë së përpjekjeve të tyre nuk ekziston ndonjë shprehje më e qartë se sa kjo.

2- Çështja e shuarjes së dritës së Zotit është përmendur dy herë në Kur’an. Hera e parë është në ajetin 32 të cilin e kemi dhe objekt studimi, kurse herën e dytë është përmendur në suren “Saff”, ajeti 8.

Në të dy rastet është përmendur si kritikë ndaj përpjekjeve të armiqve të Islamit. Në këto dy ajete vërehet një ndryshim i vogël në mënyrën e të shprehurit. Në ajetin 32 thuhet: **“Ata dëshirojnë ta fikin dritën (fenë) e All’llahut...”**, ndërkohë që në suren “Saff” lexojmë: **“Ata duan ta shuajnë dritën e All’llahut...”** (në arabisht “lijutfeu” dhe “en jutfeu”) padyshim që ky dallim ka një qëllim.

Ragibi në “Mufredat” në përshkrimin e dallimit të këtyre dy shprehjeve thotë: Ajeti 32 i kësaj sureje është aludim për

shuarjen e dritës pa përgatitje, kurse ajeti 8 i sures “Saff” është aludim për shuarjen e dritës me ndihmën e pajisjeve dhe duke qenë i përgatitur. Kuptimi i tyre është se ata, edhe pse me ndërmjetësim dhe me ndihmën e mjeteve të ndryshme, sërish nuk do të kenë sukses dhe do të përballen me humbjen, në rast se ngrihen në shuarjen e dritës së All’llahut.

3- Fjala “*je’ba*” rrjedh nga fjala “*iba*” dhe është në kuptimin e ndalimit dhe parandalimit kategorik të një gjëje. Kjo shprehje e vërteton vullnetin e patjetërsueshëm të Zotit dhe bëhet shkak i shpresës dhe dhënies zemër të të gjithë myslimanëve për të ardhmen e kësaj feje.

Në ajetin 33, i përgëzon myslimanët me përhapjen e Islamit në të gjithë globin. Me këtë e kompletton dhe diskutimin e ajetit 32, që përpjekjet e kota të armiqve të Islamit nuk do të sjellin dobi. Në mënyrë shumë të qartë shprehet: “(All’llahu) **Është Ai që e ka dërguar të Dërguarin e Tij me udhërrëfimin (Kur’anin) dhe fenë e së vërtetës, për ta lartësuar atë mbi të gjitha fetë, edhe sikur idhujtarët ta urrejnë këtë gjë.**”

Me fjalën “*hedajet*” synohen provat e qarta dhe argumentet e bollshme që ekzistojnë në fenë islame. Po ashtu, me fjalën “*fenë e vërtetë*” shënohet po kjo fe, parimet e së cilës janë të vërteta dhe degëzimet e saj po ashtu. Si rrjedhojë edhe historia, dëshmitë, dokumentet, provat dhe përfundimet e rezultatet e saj janë të vërteta.

Pa dyshim që feja dhe përmbajtja e saj është e vërtetë, edhe argumentet, dëshmitë dhe historia e saj është e qartë. Në fund duhet të triumfojë mbi të gjitha fetë e tjera.

Me kalimin e kohës, përparimin e shkencës, të diturisë dhe lehtësimin e komunikimit, të vërtetat do të nxjerrin fytyrën e tyre përtej perdeve të propagandës helmuese dhe pengesat e vëna do të zhduken. Në këtë mënyrë, feja e Vërtetë do të kaplojë të gjitha hapësirat, edhe pse armiqtë e së Vërtetës nuk e duan dhe nuk kursejnë asnjë sabotim, sepse lëvizja e tyre është një lëvizje kundër rrjedhës së historisë dhe në kundërshtim me traditat e krijimit.

Hulumtime

1- Kush është Uzejri?

Fjala *“Uzejr”* në fjalorin arab është e njëjtë me kuptimin e fjalës *“Izra”*, që është në fjalorin e hebrenjve. Duhet pasur parasysh se arabët kur përdorin një fjalë të huaj, zakonisht e ndryshojnë atë, p.sh, ndonjëherë, për të shprehur dashurinë ndaj saj, e ndryshojnë, duke e sjellë atë në paradigmen e *“shkurtimit”*.

Kështu që edhe fjalën *“Izra”* e ka shndërruar në *“Uzejr”* ashtu si emri origjinal i Isasë që është *“Jesua”*, ose *“Jahja”* që në rrënjë ka qenë *“Juhanna”*. Pas transformimit në gjuhën arabe kanë pësuar ndryshim dha kanë marrë formën e *“Isa”* dhe *“Jahja”*.¹

Sidoqoftë, Uzejr ose Izra, në historinë e hebrenjve, ka një pozitë të veçantë, në mënyrë që disa, bazën e nacionalizmit dhe ndriçimin e historisë së këtij populli, ia atribuojnë atij.

¹ Synimi i *“shkurtimit”*, ashtu siç thuhet edhe në çështjet e literaturës letrare, është që, për të shprehur llojin e vogël të një gjëje, krijojnë një paradigmë të veçantë nga emri kryesor, si p.sh *“rexhul”* (burrë) dhe shkurtimi i saj është *“ruxhejl”* (që do të thotë burrë i vogël). Ndonjëherë përdorimi i kësaj fjale nuk është për shkak të shkurtimit apo zvogëlimit të saj, por për shkak të shprehjes së dashurisë ndaj një personi apo ndaj një gjëje, siç njeriu shpreh dashurinë ndaj fëmijës së vet.

Ai i shërbeu shumë kësaj feje. Në kohën e Bukti Nesarit, mbreti i Babilonisë, gjendja e hebrenjve u përkeqësua. Qytetet e tyre ranë në duart e ushtarëve të Bukti Nesarit, tempulli i tyre u shkatërrua, kurse Libri i tyre, Teurati, u dogj, burrat e tyre u vranë, gratë dhe fëmijët u zunë rob dhe u transferuan në Babiloni. Për afro një shekull qëndruan aty, derisa Kirius, mbreti i Iranit, e pushtoi Babiloninë.

Izrai, i cili në atë kohë konsiderohej si një prej figurave më të mëdhenj të hebrenjve, ndërmjetësoi për ta dhe Kiriusi pranoi që hebrenjtë të rikthehen në qytetet e tyre, si dhe Teurati (Dhjata e vjetër) të rishkruhet.

Ai, në bazë të asaj që kishte mbajtur mend nga rrëfimet e paraardhësve të hebrenjve, e rishkroi Teuratin (Dhjatën e vjetër). Kjo është arsyeja pse hebrenjtë e konsiderojnë atë si një nga shpëtimtarët dhe rilindësit e fesë së tyre, prandaj dhe ai gëzon një respekt të jashtëzakonshëm te ata.¹

Kjo çështje u bë shkak që një grup hebrenjsh t’ia vënë atij nofkën “ibnull-llah” (i biri i Zotit), edhe pse sipas disa nga transmetimet, si p.sh. transmetimi në librin “Ihtixhaxh” të Tabersiut përftohet se ata këtë nofkë e përdornin në shenjë respekti ndaj “Uzejrit”.²

¹ “El Mizan”, vëll. 9, f. 243 dhe vëll. 14, f. 358, Botimet “Xhamiul Muderesin”, Kum, 1402 Hixhri kameri; “El Manar”, vëll. 10, f. 332, (Për më shumë informacion mund të referoheni në “Biharul Enuar”, vëll.14, f. 351, K. 25, “Kasas Armeja”; “Danial ue Uzejr”).

² “Nuruth Thakaljen”, vëll. 2, f. 204, “Mueseseh ismailijan”, Botim i katërt, 1412 Hixhri kameri; “El Ihtexhaxh i Tabrasij”, vëll. 1, f. 22–23, Botim i Murtezasë Meshhed, 1403 Hixhri kameri; “Biharul Enuar”, vëll. 9, f. 257–258, Komentimi “Imam Hasan Askeri”, f. 530-531, Medreseje “Imam Mehdi”, Kum 1409 Hixhri kameri.

Po në këtë transmetim lexojmë: “Profeti (*Paqja dhe bekimet e All’llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) i pyeti ata: ‘Nëse ju Uzejrin e respektoni për shkak të kontributeve të tij të mëdha dhe e thirrni me këtë nofkë, atëherë pse të njëjtën nofkë nuk ia atribuuat edhe Musait (*Paqja qoftë mbi të!*), i cili ka kontribuar dhe ju ka bërë shërbime shumë më shumë se Uzejri?’ Ata qëndruan në heshtje dhe nuk kishin përgjigje për këtë pyetje.”¹

Pavarësisht nga e gjithë kjo, ky emërtim në mendjet e një grup njerëzish kishte arritur nivele përtej respektit dhe, siç është zakoni i njerëzve të rëndomtë, në mënyrë të natyrshme e përdornin në kuptimin real dhe e konsideronin si fëmijë të Zotit, sepse ai i kishte shpëtuar nga migrimi i vazhdueshëm dhe endacakja, dhe, me anë të rishkrimit të Teuratit, risistemoi sërish fenë e tyre.

Sigurisht që të gjithë ata nuk ndanin një mendim të tillë. Në Kur’an lexojmë se një mënyrë të tillë të të menduarit e kishte vetëm një grup prej tyre, të cilët jetonin në kohën e Profetit (*Paqja dhe bekimet e All’llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*).

Arsyeja është se në asnjë histori nuk është rrëfyer se ata, me dëgjimin e ajetit të lartpërmendur, të kenë mohuar këtë fakt, ose të kenë ngritur zërat. Nëse do të ishte kështu, patjetër që do të reagonin.

Nga ajo që u tha më sipër, bëhet e qartë edhe përgjigjja e kësaj pyetjeje, që sot në mesin e hebrenjve nuk eksitojnë mendime

¹ “Nuruth Thekalejn”, vëll.2, f. 204, “Mueseseh ismailijan”, Botim i katërt, 1412 Hixhri kameri; “El Ihtexhaxh i Tabrisi”, vëll. 1, f. 22-23, Botim Murteda Meshhed, 1403 Hixhri kameri; “Biharul Enuar”, vëll. 9, f. 257-258, Komentim i Imam Hasan Askeri, f. 530-531, Medreseje “Imam Mehdi”, Kum 1409 Hixhri kameri.

dhe bindje të tilla dhe askush Uzejrën nuk e konsideron si birin e Zotit. Megjithatë pse Zoti i Madhëruar iu ka atribuar atyre një lidhje të tillë?

Shpjegimi është ky:

Nuk është e nevojshme që të gjithë hebrenjtë të kenë mendime dhe bindje të tilla. Mjafton vetëm ekzistenca e një grupi që ka mendime të tilla, që të zbrisnin këto ajete kur'anore.

Hebrenjtë asnjëherë nuk e kishin mohuar lidhjen e lartpërmendur dhe e justifikonin atë vetëm në bazë të transmetimeve. Emërtimin e *Uzejrit ibnull-llah* (djali i Zotit) e kanë paraqitur si një respekt ndaj tij. Ata mbetën gojëkryçur kundrejt kritikës së Profetit (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) kur ai u tha: "Përse këtë respekt nuk ia atribuoni Musasë (*Paqja qoftë mbi të!*)?"

Sidoqoftë, sa herë që një bindje apo besim ia përkisnin një populli, nuk është e nevojshme që t'i lidhë të gjithë njerëzit, por mjafton vetëm kjo, që një grup të kishin mendime të tilla.

2- Mesihu nuk ishte i biri i Zotit

Në lidhje me të krishterët, nuk ka vend për dyshim që ata Mesihun e konsiderojnë birin e vërtetë të Zotit. Këtë emër nuk e kanë përzgjedhur për shkak të respektit apo formalitetit, por ia atribuojnë atij në kuptimin real dhe të vërtetë. Në librat e tyre shkruajnë se përdorimi i këtij emri ndaj njerëzve të tjerë përpos Mesihut, në kuptimin e vërtetë, nuk është e lejueshme. Pa dyshim që kjo është një prej të rejave të krishterëve.

Ashtu siç e thamë edhe në vëllimin e katërt, në komentimin e ajetit 171 të sures "En Nisa", Mesihu asnjëherë nuk kishte

pretendime të tilla dhe ai veten e prezantonte vetëm si rob dhe i Dërguar i Zotit.

Nuk ka kuptim që marrëdhënia prindërore dhe fëmijërore, që i përket vetëm botës materiale (bota e qenieve të mundshme), të ekzistojë nëpërmjet Zotit ndaj ndonjë njeriu.

3- Huazimi i këtyre besëtytnive nga të tjerët

Kur'ani i Madhëruar, në ajetin 30, thotë: **“...ato ishin thënie të tyre me gojët e tyre, që imitojnë thëniet e jobesimtarëve të mëhershëm...”** Me këto fjalë tregohet veprimi imitues, duke ua ndarë pozitën zotave. Disa prej zotave i konsideronin si zoti baba, disa të tjerë si zoti djalë, madje disa të tjerë si zot nëna dhe bashkëshorte.

Në bindjet e idhujtarëve të Indisë, Kinës dhe Egjiptit të lashtë vërehen mendime të tilla, që më vonë kishin depërtuar dhe në mesin e hebrenjve dhe të krishterëve.

Në kohën tonë, një grup hulumtuesish kanë krahasuar përmbajtjet e “Dhjatës së Vjetër” dhe “Dhjatës së re” (Tora, Bibla dhe librat e ndërlidhura me ato) me konceptet e Budizmit dhe të Brahmanizmit, duke u munduar të gjejnë rrënjët e përmbajtjes së atyre librave te konceptet e këtyre rrymave fetare.

Ajo që vlen të theksohet është se shumë prej njohurive të Toras dhe Biblës që përputhen me besëtytnitë e Budizmit dhe të Brahmanizmit, madje shumë prej tregimeve dhe historive që rrëfohen në Bibël janë të njëjta me ato që ekzistojnë në ato dy religjione.

Nëse sot hulumtuesit dhe studiuesit kanë arritur në një përfundim të tillë, Kur'ani këtë fakt e ka përmendur në mënyrë të përmbledhur në ajetin 30, që para katërmbëdhjetë shekujsh.

4- Synim i togfjalëshit “katelehumullah”

Togfjalëshi “katelehumullah” ka kuptimin që Zoti ose t’i luftojë, ose t’i vrasë ata. Duke u bazuar te ajo që ka transmetuar Tabersiu në “Mexhmaul Bejjan” nga Ibn Abbasi, kjo fjali është aluzion për mallkim, që do të thotë Zoti do t’i mbajë ata larg mëshirës së vet.¹

5- Cili është kuptimi i “udhëzimit” dhe “fesë së Vërtetë”?

Kur’ani në ajetin e katërt të sures “Et Teube” thotë: **“(All’llahu) Është Ai që e ka dërguar të Dërguarin e Tij me udhërrëfimin (Kur'anin) dhe fenë e së vërtetës...”** Ky ajet tregon arsyen e triumfit të Islamit ndaj feve të tjera, sepse përmbajtja e thirrjes së Profetit (*Paqja dhe bekimet e All’llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) është udhëzim dhe intelekt. Çdo rast e dëshmon këtë, gjithashtu, duke parë se doktrinat parimore dhe çështjet dytësore të tij janë në pajtim me të Vërtetën, përkrahës dhe dashurues të së Vërtetës, natyrisht që një fe e tillë do të triumfojë mbi të gjitha fetë e botës.

Njëri prej dijetarëve të Indisë, që për një periudhë kohore kishte hulumtuar dhe kishte studiuar për fetë e ndryshme të botës, më në fund përzgjodhi Islam. Në gjuhën angleze shkroi librin “Pse jam bërë mysliman?”, ku bënte të qartë të gjitha epërsitë e Islamit karshi feve të tjera. Midis të tjerash shkruhej: “Një prej çështjeve më të rëndësishme që më ka tërhequr

¹ “Mexhmaul Bejjan”, ajeti në fjalë; “Biharul Enuar”, vëll. 3, f. 61 dhe vëll. 90, f. 115; “El Ihtexhaxh i Tabersiu”, vëll. 1, f. 250, Botim “Murteza Meshhed”, 1403 Hixhr; “Sahih Bukhari”, vëll.3, f. 40 botoi “Darul Fikr Bejrut”; “Durrul Menthur”, vëll. 3, f. 230, “Darul Mearife”, Botim i parë, 1365 Hixhri kameri.

vëmendjen ishte se **Islami është e vetmja fe që ka histori të patjetërsuar dhe të ruajtur.**"

Ai habitet me faktin se si Europa ka zgjedhur për vete një fe dhe sjellësin e kësaj feje e ka lartësuar përtej pozitës së një njeriu dhe e ka caktuar si Zotin e vet, ndërkohë që nuk ekziston një histori e dokumentuar dhe e pranueshme.¹

Studimi dhe hulumtimi i njerëzve që e kanë pranuar Islamin dhe kanë hequr dorë prej feve së tyre të mëparshme tregon se ata kanë rënë nën ndikimin e thjeshtësisë së jashtëzakonshme, argumentimit dhe integritetit të doktrinave parimore dhe praktike apo dytësore të kësaj feje, si dhe trajtesave humane të saj, trajtesa që janë të pastruara nga çdo lloj besëtytnie, nga ku rrezatohet drita e së Vërtetës dhe e Udhëzimit.

6- Triumfi i logjikës apo triumfi i forcës?

Në mesin e komentuesve të Kur'anit ka diskutime për çështjet se si do të triumfojë Islami mbi të gjitha fetë e tjera, se në ç'formë do të jetë ky triumfim.

Një pjesë prej tyre këtë triumfim e kanë quajtur vetëm triumfim logjik dhe kombëtar. Argumenti që japin është: "Ky triumfim do të vijë, sepse Islami, për nga pikëpamja e logjikës dhe argumentit, nuk krahasohet me fetë tjera ekzistuese."

Fjala "*idhhar*" është përdorur në shumë ajete kur'anore, sidomos te ky ajet tregon kuptimin e dominimit trupor dhe forcës fizike. Në tregimin e "*As'habi Kehf*" lexojmë: "**Pse, nëse ata**

¹"El Manar", vëll. 10, f. 389.

kuptojnë për ju, do t'ju mbysin me gurë, ose do t'ju kthejnë në fenë e tyre, e atëherë kurrë nuk keni për të shpëtuar.”¹

Gjithashtu, për politeistët lexojmë: **“Si (mund t'u besoni) kur, nëse ju mundin, ata nuk e respektojnë as farefisninë, as marrëveshjen?”²**

Është më se e qartë se triumfimi në raste të tilla nuk është në kuptimin e triumfimit logjik, por është triumfim fizik dhe i prekshëm.

Më e drejtë është të thuhet se fitorja dhe triumfimi i lartpërmendur të konsiderohet triumfim i gjithanshëm, sepse përshtatet më shumë edhe me kuptimin e ajetit që është i pakushtëzuar nga çdo aspekt, që do të thotë se do të vijë dita, kur Islami, si nga pikëpamja logjike e kombëtare, si nga aspekti i depërtimit gjeografik dhe pushtetit, do të triumfojë mbi të gjitha fetë e botës dhe të gjitha do t'i vërë nën ndikimin e tij.

7- Kur'anit dhe kryengritja e Mehdiut (Paqja qoftë mbi të!)

Ajeti ajeti 33, i cili është përmendur edhe në suren “Saff”, me po këto shprehje,³ si dhe me pak ndryshim në suren “El Fet'h”,⁴ paralajmëron për një ndodhi të madhe, rëndësia e të cilës është bërë shkak i kësaj përsëritjeje, lajmëron për universalizimin e Islamit dhe globalizmin e kësaj feje hyjnore.

Disa nga komentuesit e Kur'anit, fitoren për të cilën diskutohet në këtë ajet e kanë marrë në kuptimin e një fitoreje rajonale dhe të kufizuar, e cila u realizua për Islamin dhe myslimanët në kohën e Profetit apo në kohët e tjera pas tij. Duhet

¹ Sure “El Kehf”, ajeti 20.

² Sure “Et Teube”, ajeti 8.

³ Sure “Saff”, ajeti 9.

⁴ Sure “El Fet'h”, ajeti 28.

të kihet parasysh fakti se në ajet nuk është përmendur asnjë lloj kushti dhe është i pakufizuar nga çdo pikëpamje, prandaj nuk kemi asnjë arsye ta kufizojmë atë.

Kuptimi i ajetit është triumfi i gjithanshëm i Islamit ndaj të gjitha feve të botës, Islami do të përfshijë të gjithë rruzullin tokësor dhe do të triumfojë në gjithë botën.

Pa dyshim, në ditët tona kjo akoma nuk është realizuar. Por e dimë se ky premtim i patjetërsueshëm i Zotit është në realizim e sipër.

Ecuria e përparimit të Islamit në këtë botë, njohja e kësaj feje zyrtarisht nga ana e shteteve të ndryshme të Europës, ndikimi i shpejtë i saj në Amerikë dhe Afrikë, si dhe pranimi i Islamit nga shumë shkencëtarë dhe dijetarë, tregojnë se Islami ka marrë kahjen e globalizimit.

Por në bazë të transmetimeve të ndryshme, të cilat i hasim në burimet islame, kulmi i këtij programi do të ndodhë me shfaqjen e Mehdiut (*Paqja qoftë mbi të!*). Atëherë do të realizohet përfundimisht projekti i globalizimit të Islamit.

I ndjeri Tabarsij në “Mexhmaul Bejjan”, nga Imam Bakiri (*Paqja qoftë mbi të!*), për komentimin e këtij ajeti transmeton: “Premtimi që është dhënë në këtë ajet do të ndodhë në kohën e shfaqjes së Mehdiut nga familja e Muhammedit. Në atë kohë mbi rruzullin tokësor nuk do të ekzistojë asnjë njeri që të mos e ketë përqaftuar dhe të mos e ketë pranuar Islamit dhe vërtetësinë e Muhammedit (*Paqja dhe bekimet e All'Ilahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*).”¹

¹“Mexhmaul Bejjan”, vëll.10, f. 45. Ajeti në fjalë; “Mu'xhem ehadithul Imam Mehdi”, vëll. 5, f. 142; “Muesesetul meariful islamije”, Botim i parë, 1411 Hixhri kameri; “El Asfaj fi tefsirul Kur'an”, vëll.1, f. 463, Botimet e Zyrës së Përhapjes së Islamit, Botim i parë, 1418 Hixhri kameri.

Gjithashtu, në po në atë komentim, nga Profeti (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) është transmetuar se mbi faqen e tokës nuk do të mbetet asnjë shtëpi, as shtëpitë që janë ndërtuar nga balta dhe guri dhe as tendat që janë thurur nga hardhitë, që të mos përmendet emri i Zotit dhe i Islamit!¹

Po ashtu nga Saduku në librin “Ikmaluddin”, nga Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) për komentimin e këtij ajeti, është transmetuar: “Betohem në Zot, që përmbajtja e këtij ajeti akoma nuk është realizuar. Do të realizohet vetëm në kohën e ardhjes së Mehdiut (*Paqja qoftë mbi të!*) dhe në kohën e kryengritjes në asnjë cep të botës nuk do të ketë njeri që të mohojë Zotin.”²

Hadithe të tilla, me të njëjtën përmbajtje, janë transmetuar dhe nga prijësit islamë.

Një grup komentuesish të Kur’anit e kanë përmendur këtë komentim te po ky ajet.

Është i çuditshëm fakti se autori i librit “El Manar” jo vetëm që nuk e ka pranuar komentimin e lartpërmendur, por, duke marrë shkas nga rasti, është ndalur gjerësisht te hadithet për Imam Mehdiun. Duke paragjykuar shi’izmin, e sulmon vend e

¹ “Mexhmaul Bejjan”, vëll. 5, f. 45, ajeti në fjalë; “Mizanul Hikmeh”, vëll. 2, f. 1339; “Darul hadith”, Botim i parë; “Mesned Ahmed”, vëll. 6, f. 4, Bejrut; “Mestedrekul Hakim”, vëll. 4, F 430, botoi “Darul Mearife”, Bejrut, 1406 Hixhri Kameri; “Sunen El Kubra i Bejhikij”, vëll. 9, f. 181; “Darul Fikr”, Bejrut; “Mexhmuuz Zevaid”, vëll. 6, f. 14, botoi “Darul Kutubil Ilmije”, Bejrut, 1408 Hixhri kameri.

² “Nuruth Thekalejn”, vëll. 2, f. 211; “Kemaluddin ue temamul ni'meh”, f. 670, Botimet e “Xhamiul Muderesine”, Kum, 1405 Hixhri kameri; “Biharul Enuar”, vëll. 52, f. 432; “Mu'xhemul Ehadithul Imam Mehdi”, vëll. 5, f. 145 dhe 446; “Muesesetu mearife islami”, Botim i parë, 1411 Hixhri kameri; Tefsire “Saffi”, vëll. 2, f. 338, botoi “Mektebus Sadir”, Teheran, Botim i dytë, 1416 Hixhri kameri.

pavend atë, i mohon në tërësi hadithet për Mehdiun (*Paqja qoftë mbi të!*), i konsideron të papranueshme, duke pandehur se besimi te Mehdiu (*Paqja qoftë mbi të!*) i përket vetëm shí'ave dhe atyre që kanë prirje ndaj shí'izmit.

Përveç kësaj, besimi në ekzistimin e Mehdiut (*Paqja qoftë mbi të!*) e ka konsideruar si një faktor për prapambetje.

Pikërisht për këtë arsye, e ndiejmë të domosdoshme, që në mënyrë të përmbledhur e të përpunuar, të hapim një diskutim në fushën e haditheve për shfaqjen e Imam Mehdiut (*Paqja qoftë mbi të!*), rreth efekteve të kësaj bindjeje në zhvillimin e shoqërisë islame dhe rezistencës përballë dhunës dhe korrupsionit, në mënyrë që të bëhet e qartë se, sa herë të lindin paragjykime, shkenca dhe dituria do të arratisen nga dera tjetër.

Komentuesi i lartpërmendur, edhe pse ka informacione të shumta për çështjet islame, për shkak të kësaj pike të dobët (paragjykimet e verbra), disa nga të vërtetat e qarta i ka paraqitur të përmbysur dhe në mënyrë të devijuar.

8- Transmetime islame për ardhjen e Mehdiut (*Paqja qoftë mbi të!*)

Edhe pse janë shkruar shumë libra nga dijetarët syni dhe shí'ia, për ardhjen e Imam Mehdiut (*Paqja qoftë mbi të!*), sipas mendimit tonë, nuk ekziston gjë më e qartë dhe më e veçantë se sa një letër që e patën dërguar një grup dijetarësh të Hixhazit, në përgjigje të një prej pyetësve të kësaj çështjeje.

Për lexuesit e dashur po e sjellim përkthimin e plotë të saj.

Por në fillim u rikujtojmë që hadithet dhe transmetimet për ardhjen e Mehdiut (*Paqja qoftë mbi të!*) janë aq të shumta, saqë

asnjë studiues i Islamit, apo cilado shkollë qoftë, nuk mund ta mohojë popullaritetin e tij.

Deri më sot janë shkruar shumë libra në këtë fushë dhe autorët e tyre, që të gjithë, e kanë pranuar dhe kanë pohuar saktësinë e haditheve për reformatorin mbarëbotëror, Imam Mehdiun (*Paqja qoftë mbi të!*).

Vetëm një grup i vogël njerëzish, si Ibn Khalduni dhe Ahmed Emin Misriu kanë nguruar të shpalosin hadithet e Profetit (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*).

Kemi të dhëna se shkaku i këtij ngurrimi nuk ishte dobësia e këtyre haditheve për nga zinxhiri i transmetimit, por mendonin se hadithet për Imam Mehdiun (*Paqja qoftë mbi të!*) përmbanin çështje që nuk mund të besohen lehtë, ose ngaqë nuk janë në gjendje të ndanin hadithet e sakta nga hadithet e pasakta, ose nuk kishin kuptuar interpretimin e tyre.

Sidoqoftë, para se gjithash është e nevojshme, që, për lexuesit e dashur, të sjellim pyetjen dhe përgjigjen e botuar së afërmi nga organizata "Marrëdhënia Botërore Islame", e cila ndodhet nën ndikimin e fraksionit më radikal islam, Vahabizmit, në mënyrë që të bëhet e qartë se çështja e shfaqjes së Imam Mehdiut (*Paqja qoftë mbi të!*) në mesin e myslimanëve është një çështje e pranuar.

Sipas bindjeve tona, në këtë traktat të përmbledhur, dëshmitë e nevojshme janë grumbulluar në një mënyrë të tillë, saqë askush nuk e ka mundësinë ta mohojë atë. Kjo është arsyeja, që edhe vahabitët kryeneçë janë dorëzuar karshi saj.

Pothuajse afro para një viti¹ një person, me emrin Ebu Muhammed nga Kenja, i parashtrroi një pyetje organizatës “Marrëdhënia Botërore Islame” për ardhjen e Mehdiut (*Paqja qoftë mbi të!*) të premtuar.

Drejtori i përgjithshëm i organizatës “Marrëdhënia Botërore Islame”, Muhammed Salih Kazazi, në përgjigjen e pyetjes së tij, krahas sqarimit, që edhe Ibn Tejmije, themeluesi i medh’hebit të vahabizmit, i ka pranuar hadithet për ardhjen e Imam Mehdiut (*Paqja qoftë mbi të!*), i dërgoi tekstin e një traktati, të cilin e kishin përgatitur pesë dijetart të sotëm të Hixhazit (Arabisë Saudite).

Në këtë traktat, pasi përmendet emri i Imam Mehdiut (*Paqja qoftë mbi të!*) dhe vendi i shfaqjes së tij, në Mekë, lexojmë:
“... në kohën e shfaqjes së korrupsionit në botë dhe përhapjes së mosbesimit dhe dhunës, Zoti i Madhëruar, me anë të Imam Mehdiut (Paqja qoftë mbi të!), do ta mbushë botën me drejtësi dhe rregull, ashtu siç është e mbushur me korrupsion dhe dhunë...”

Ai është Imami i fundit prej dymbëdhjetë Imamëve që Profeti (*Paqja dhe bekimet e All’llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ka lajmëruar për ta në librat “Sihah”.

Shumë prej sahabëve të Profetit (*Paqja dhe bekimet e All’llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) kanë transmetuar hadithe për Imam Mehdiun (*Paqja qoftë mbi të!*), si: Osman ibn Affan, Ali ibn Ebu Talib, Talha ibn Ubejdullah, Abdurrahman ibn Auf, Abdullah ibn Abbas, Ammar Jasir, Abdullah ibn Mesud, Ebu Said Khudri, Theuban, Kurre ibn Ejjas Mezeni, Abdullah ibn Harith, Ebu Hujreje, Hudhejfe ibn Jeman, Xhabir ibn Abdullah,

¹ Viti 1976, Miladi.

Ebu Ename, Xhabir ibn Mexhid, Abdullah ibn Umer, Enes ibn Malik, Imran bin Husejn, dhe Ummi Seleme.

Këta janë njëzet persona që kanë transmetuar hadithet për Imam Mehdiun (*Paqja qoftë mbi të!*). Përveç tyre ekzistojnë edhe shumë sahabë të tjerë.

Janë transmetuar gjithashtu edhe shumë thënie nga vetë sahabët. Në to flitet për shfaqjen e Mehdiut (*Paqja qoftë mbi të!*). Edhe këto mund t'i konsiderojmë si hadithe të Profetit (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), sepse kjo çështje nuk është prej çështjeve që, me anë të ixhtihadit¹, të jetë e mundur të thuhet ndonjë gjë rreth saj. Prandaj edhe ata, natyrisht, që këtë çështje e kanë dëgjuar nga Profeti (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*).

Më pas po shton:

“Hadithet e lartpërmendura, të cilat janë transmetuar nga Profeti (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) dhe dëshmia e sahabëve, që këtu janë në pozitën e hadithit, janë përmendur në shumë prej librave të njohura islame dhe teksteve origjinale të hadithit, përfshirë këtu Sunen, Meaxhim dhe Mesanid, si p.sh: Suneni Ebu Davud, Suneni Tirmidhi, Ibn Maxhe, Ibn Amr ad Dani, Musnedi i Ahmedit, Ibn Je'ali, Bezzaz, Sahih Hakim, Meaxhim Tebrani, (i madhi dhe i mesmi), Revijani, Darkitni, Ebu Naim, në Ehbarul Mehdi, Hatib në Tarikh al-Bagdad, Ibn Esakir në Tarikh Dimeshk dhe të tjerë.”

¹ Fjala “ixhtihad” ka kuptimin e përpjekjes së studiuesit të fesë derisa ai arrin të japë opinionin e tij rreth një çështjeje të caktuar fetare (fetva).

Më pas vazhdon:

“Në lidhje me këtë, disa nga dijetarët islamë, si: Ebu Naimi ka shkruar librin “Ahbarul Mehdi”, Ibn Haxhr Hejthemi ka shkruar librin “Al Kaulul mukhteser fi alamati Mehdijul muntedhir”, Sheukani ka shkruar librin “At Teudih fi tevatur ma xhae fil Muntadhir ue Dexhali uel-Mesih”, Idris Iraki Magribiu ka shkruar librin “El Mehdi”, Ebul Abbas ibn Abdul Mu’min el Magribi ka shkruar librin “El vahmul meknun fir red ala Ibn Haldun”.

Kurse personi i fundit që, për këtë temë, ka shkruar në mënyrë të detajuar, është drejtori i Universitet Islamik në Medine. Ai ka shkruar në ca numra të revistës së universitetit.”

Më tutje letra vazhdon:

“Një grup nga udhëheqësit dhe dijetarët islamë, përfshirë këtu të kohës së kaluar dhe bashkëkohorët, në shkrimet e tyre kanë sqaruar, se hadithet për Imam Mehdiun (*Paqja qoftë mbi të!*) kanë arritur numrin më të madh dhe në asnjë mënyrë nuk mund të mohohen prej tyre:

As Sehavi në librin “Fet’hul megith”, Muhammed ibn Ahmed Sefavini në librin “Sherhul Akide”, Ebul Hasan El Iberi në librin “Menakib-i Shafei”, Ibn Tejmije në librin “Fetava”, Sujutiu në librin “Al Havi”, Idris Iraki në librin që ka shkruar në lidhje me Mehdiun, Shaukaniu në librin “Al tu’uzih fi tevaturi ma xhae fil muntedhir...” Muhammed Xhafer Kenani, në librin “Nezmut Tenathur”, Ebul Abas Ibn Abdul Mu’min në librin “Al Uahm Al Meknun”...

Në fund të diskutimit shton: “Vetëm Ibn Khalduni ka dashur t’i mohojë hadithet për Imam Mehdiun (*Paqja qoftë mbi të!*) me anë të një hadithi të pabazë dhe të sajuar: “Mehdiu nuk është askush tjetër përveç Isai (*Paqja qoftë mbi të!*)!”¹

Por të mëdhenjtë e prijësve dhe dijetarëve islamë e kanë refuzuar thënien e tij, veçanërisht Ibn Abdul Mu’min, i cili refuzimin dhe opinionin e tij e ka dhënë në një libër, i cili para tridhjetë viteve u botua dhe u shpërnda në Lindje dhe në Perëndim.

Ruajtësit e haditheve dhe dijetarët e famshëm, gjithashtu kanë vërtetuar se hadithet për Imam Mehdiun (*Paqja qoftë mbi të!*) përfshijnë transmetime të sakta dhe të mira. Tërësia e tyre konsiderohet e pamohueshme.

“Si rrjedhojë, besimi në ardhjen e Imam Mehdiut (*Paqja qoftë mbi të!*) (për çdo mysliman) është i detyrueshëm dhe kjo konsiderohet si pjesë e doktrinës së Ehli Syneetit dhe Xhematit. Vetëm njerëzit e paditur dhe të painformuar, ose ata që sjellin risi në fe, askush tjetër nuk e mohon atë.”

Drejtori i zyrës së Asamblesë Juridike Islame

¹ “Biharul Enuar, vëll. 51, f. 93; “Keshful gumme”, vëll. 2, f. 484; “Mektebul Beni Hashim”, Tebriz, 1381 Hixhri kameri; “Menakibul Ehli Bejt”, f. 299, botoi “Menshuratul islamie”, 1414 Hixhri kameri; “Mu’xhem ehadith el Imam Mehdi (*Paqja qoftë mbi të!*)”, vëll. 1, f. 53, 55, 563, 566, 567 dhe 569; “Muesesetul mearuful isalmie”, Botim i parë, 1411 Hixhri; Tehfehtul Ehvedhi, fi sherhi Termidhi, vëll. 6, f. 402; “Darul Kutubul Ilmije”, Bejrut, Botim i parë, 1410 Hixhri; “Eanul meabud”, vëll. 11, f. 244; “Darul kututbul ilmije”, Bejrut, Botim i dytë, 1415 Hixhri kameri; “Tedhkirehul mudhuuat”, f. 223; “Fejdheul kadir”, vëll. 5, f. 422 dhe vëll. 6, f. 362; “Darul Kutubul Ilmije”, Bejrut, Botim i parë, 1415 Hixhri kameri; “Keshful ikhfa”, vëll. 2, f. 123; “Darul kutubul ilmije”, Bejrut, vëll. 2, 1408 Hixhri kameri, Tefsiri “Kurtubi”, vëll. 8, f. 122; “Muesesetu tarikul Arabi”, Bejrut, 1405 Hixhri kameri.

Muhammed Muntasar Kenani¹

9- Impaktet konstruktive të pritjes së shfaqjes së Mehdiut (*Paqja qoftë mbi të!*)

Në diskutimin e kaluar mësuam se kjo doktrinë, në njohuritë islame, është prej çështjeve më të sigurta, që është marrë nga themeluesi i Islamit. Të gjitha medh'hebet islame janë në një mendim për të dhe hadithet rreth saj konsiderohen të vërteta.

Tani le të trajtojmë impaktet e kësaj pritjeje në gjendjen aktuale të shoqërisë islame dhe të shohim nëse besimi në një pritje të tillë e zhyt njeriun në ëndërrime dhe fantazira, në mënyrë që të harrojë aktualitetin dhe e bën që t'i nënshtrohet çdo lloj kushti.

Në thelbin e saj, a është kjo doktrinë dhe ky besim një lloj apeli për orvatje dhe vetëformim të individit dhe shoqërisë? Vallë a krijon lëvizje dhe dinamizëm, apo prapambetje?! Dhe më në fund, a është opium apo zgjim?

Para se të analizojmë dhe të shqyrtojmë këto pyetje, është më se e domosdoshme t'i kushtojmë vëmendje një çështjeje tjetër: Sa herë që dispozitat më konstruktive apo nocionet më të përdorshme bien në duart e personave jo të denjë, të pandërgjegjshëm apo keqpërdorues, ka mundësi që të deformohen, në mënyrë të atillë që të japin rezultate të kundërta, me qëllim që të rrjedhin në rrugë përkundër saj. Në lidhje me këtë ekzistojnë shembuj të shumtë. Çështja e "pritjes", ashtu siç do ta shohim në vazhdim, bën pjesë në po këto çështje.

Pavarësisht kësaj, për të shmangur çdo lloj gabimi në llogaritjet që u bëjmë çështjeve të tilla, ashtu siç thuhet që ujin

¹ "Hukumete xehani Mehdi", f. 144-155.

duhet ta marrim nga burimi, në mënyrë që ndotjet e lumenjve dhe të kanaleve të mos ndikojnë te ai.

E njëjta gjë është edhe për çështjen e “pritjes” së Imam Mehdiut (*Paqja qoftë mbi të!*), duhet t’i referohemi teksteve origjinale islame dhe t’i shqyrtojmë elementet e ndryshme të haditheve, që forcojnë çështjen e “pritjes”, për t’u njohur me qëllimin kryesor.

Tani të shohim me vëmendje këto hadithe:

Një njeri e pyeti Imam Sadikun (*Paqja qoftë mbi të!*): “Çfarë mendoni për atë njeri që beson në vilajetin e prijësve (Imamëve të Ehli Bejtit) dhe është në pritje të shfaqjes së Pushtetit të Drejtë dhe ndërkohë ikën nga kjo botë?

Imami iu përgjigj: “Ai është si njeriu që ka qenë në tendën e Mehdiut (mbështetësit e gjeneralit të tij).” Më pas heshti për pak çaste dhe tha: “Është si ai që ka qenë përkrah Profetit (*Paqja dhe bekimet e All’llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) në luftimet të tij.”¹

E njëjta përmbajtje është transmetuar me shprehje të ndryshme në shumë hadithe.

Në disa hadithe është transmetuar: “Përdoruesi i shpatës në rrugën e Zotit.”²

¹“Biharul Enuar”, vëll. 25, f. 125, Mehasinel Berkij, vëll. 1, f. 173, botoi “Darul kutubul islamije”; Kum, 1371 Hixhri; “Mustedrek Sefinetul Bihar”, vëll. 10, f. 90, botoi “Intesharate Xhamiatul muderrisin”, Kum, 1419 Hixhri, “Mexhamiul ehadith el Imam Mehdi (*Paqja qoftë mbi të!*)”, vëll. 3, f. 403; “Mueseseh meariful islamije”, Botim i parë, 1411 Hixhri kameri; “Mexhmau Nur”, f. 296.

²“Biharul Enuar”, vëll. 52, f. 126–146; “Mehasinul Berkij”, vëll. 1, f. 173, botoi “Darul kutubul islamije”, 1381 Hixhri kameri, “Mu’xhem ehadithul Imam Mehdi (*Paqja qoftë mbi të!*)”, vëll. 3, f. 403; “Mueseseh meariful islamije”, Botim i

Në disa hadithe të tjera thuhet: *“Është në pozitën e personit që, në prani të Profetit (Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) me anë të shpatës godet në tru armikun!”*¹

Në disa të tjera thuhet: *“Është në pozitën e njeriut që ka rezistuar poshtë flamurit të Mehdiut.”*²

Dhe në disa të tjera thuhet: *“Është në pozitën e njeriut që lufton përpara Profetit (Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!).”*³

Ndërsa në disa të tjera thuhet: *“Është në pozitën e personit që bie dëshmor me Profetin (Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!).”*⁴

parë, 1411 Hixhri kameri; “Usulul Kafij”, vëll. 8, f. 146, botoi “Darul kutubul islamije”.

¹ “Biharul Enuar”, vëll. 52, f. 126; “Mehasinul Berkij”, vëll. 1, f. 173, botoi “Darul kutubul islamije”, 1371 Hixhri kameri; “Sherhul Ehbar”, vëll. 3, f. 571; botoi “Xhamiul muderesin, Kum; “Enuarul Behije”, f. 369, botoi “Xhamiul muderesin”, Kum, Botim i parë, 1417 Hixhri kameri; “Mu'xhemul ehadith el Imam Mehdi (Paqja qoftë mbi të!)”, vëll. 3, f. 403; “Mueseseh meariful islamije”, botim i parë, 1411 Hixhri kameri.

² “Biharul Enuar”, vëll. 52, f. 142; “Usulul Kafij”, vëll. 1, f. 371, botoi “Darul kutubul islamije”, Botim i tretë, 1388 Hixhri kameri; “Sherh Usulul Kafij”, vëll. 6, f. 342; el gajbeh, “Muhammed Ibn Ibrahim Ni'mani”, f. 329; “Mektebu Saduduk”, Teheran; “Mu'xhemul ehadith el Imam Mehdi”, (Paqja qoftë mbi të!), vëll. 5, f. 231; “Mueseseh meariful islamije”, Botim i parë, 1411 Hixhri kameri.

³ “Biharul Enuar”, vëll. 36, f. 385, 387 dhe vëll. 51, f. 133; vëll. 52, f.122; “El Ihtexhaxh i Tabrasij”, vëll.2, f. 318, Botimet “Murteda”, Meshhed, 1403 Hixhri kameri; “E'lamul Ura”, f. 408, botoi “Darul Kutubul islamije”.

⁴ “Mehasinul Berkij”, vëll. 1, f. 172-173; “Darul Kutubul islamije, sherhul ehbar”, vëll. 3, f. 437, botoi “Xhamiul muderesin,” Kum; “Mu'xhemul ehadith el Imam Mehdi”, vëll. 3, f. 402; “Mueseseh meariful islamije”, Botim i parë, 1411 Hixhri

Këto shtatë cilësime, që i hasim për filozofinë e pritjes së ardhjes së Imam Mehdiut (*Paqja qoftë mbi të!*), në këto gjashtë hadithe, e bëjnë të qartë realitetin se ekziston një lloj raporti dhe ngjashmërie mes çështjes së “pritjes” dhe “xhihadit” - luftimit me armikun në formën e fundit të saj.

Në transmetime të shumta, pritja e një Pushteti të tillë është konsideruar si adhurimi më i madh.

Kjo përmbajtje është pasqyruar dhe është transmetuar edhe në disa hadithe prej Profetit (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) dhe në disa transmetime të Imam Aliut (*Paqja qoftë mbi të!*).

Në një hadith lexojmë se Profeti (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ka thënë: “Vepra më e mirë e ymetit tim është pritja e Shpëtimit nga ana e Zotit (ardhja e Imam Mehdiut).”¹

Kurse në një hadith tjetër, po nga Profeti (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) lexojmë: “Adhurimi më i vyer është pritja Mehdiut (*Paqja qoftë mbi të!*).”²

kameri, “Usulul Kafij”, vëll. 1, f. 371; “Darul kutubul islamije”; “Biharul Enuar”, vëll. 27, f. 127 dhe vëllimi 52, f. 126 dhe 142.

¹ “Biharul Enuar”, vëll. 50, f. 318 dhe vëll. 52, f. 122 dhe 128; “Ujun ehbarul Riza”, vëll. 2, f. 36, Intesharate Xhehan, 1378 Hixhri kameri; “Menakibul Ali ibn ebi Talib”, vëll. 4, f. 426, Intesharatul elame Kum, 1379 Hixhri kameri; “Mustedrekul Sefinetul Bihar”, vëll. 10, f. 90, Intesharate xhameeul muderesine, Kum, 1419 Hixhri kameri; “Mu'xhem ehadithul Imam Mehdi, (*Paqja qoftë mbi të!*)”, vëll. 1, f. 270 dhe vëll. 4, f. 249; “Mueseseh meariful islamije”, Botim i parë, 1411 Hixhri kameri; “Mizanul Hikme”, vëll. 1, f. 182; “Intesharate Darul Hadith”, Botim i parë.

² “Biharul Enuar”, vëll. 52, f. 125, vëll. 68, f. 96, vëll. 84 f. 422, vëll. 75 f. 38 dhe 326, Mu'xhem ehadithul el Imam Mehdi (*Paqja qoftë mbi të!*) vëll. 1, f. 270; “Mueseseh meariful islamije”, Botim i parë, 1411 Hixhri kameri; “Mizanul

Këtë hadith, pavarësisht faktit nëse e marrim në kuptimin e përgjithshëm të fjalës “*ferexhe*” - “*shpëtim*” apo në kuptimin e veçantë, që është pritja e ardhjes së një Reformatori të Madh botëror, na bën të qartë rëndësinë e pritjes.

Këto shprehje tregojnë se pritja e një revolucioni të tillë, gjithnjë është e shoqëruar me një orvatje, aktivitet të gjerë dhe gjithëpërfshirës. Le të kemi parasysh këtë çështje, para se të fillojmë me analizën e konceptit “pritje”. Më pas do të nxjerrim përfundime në bazë të arritjeve të analizës sonë.

a) Kuptimi i pritjes

Pritja zakonisht lidhet me shpjegimin e gjendjes së një personi, që ndihet i shqetësuar nga gjendja aktuale dhe përpiqet të krijojë një situatë më të mirë.

Për shembull, pacienti i sëmurë është në pritje të përmirësimit të shëndetit, ose babai në pritje të rikthimit të djalit të tij nga udhëtimi. Këta persona janë të shqetësuar nga sëmundja dhe ndarja nga djali dhe përpiqen të krijojnë një gjendje më të mirë.

Gjithashtu, tregtari është i shqetësuar nga rrëmuja e madhe e tregut dhe është në pritje të tejkalimit të krizës ekonomike. Nga këta shembuj shikojmë këto dy gjendje, “tjetërsimin e gjendjes aktuale” dhe “përpjekjen për përmirësimin e situatës”.

Si rrjedhojë, çështja e pritjes së Pushtetit të Drejtë, të drejtësisë së Imam Mehdiut (*Paqja qoftë mbi të!*) dhe shfaqja e

Hikmeh”, vëll. 1, f. 182; “Intesharatulê darul hadith”, Botim i parë; “Durrul Menthur”, vëll. 2, f. 149; “Darul Mearife”, Botim i parë, 1365 Hixhri kameri.

Reformatorit botëror, është e përbërë nga dy elemente, elementi i “mohimit” dhe elementi i “pohimit apo i afirmimit”.

Elementi i mohimit është po ai tjetërsim me gjendjen aktuale, kurse elementi i pohimit apo i afirmimit është kërkesa për përmirësimin e situatës.

Nëse këto dy aspekte depërtojnë thellë në shpirtin e njeriut të rrënjosur me besim, do të jenë burim i dy rrjedhave të veprave. Këto dy rrjedha veprash përbëhen nga heqja dorë nga çdo lloj bashkëpunimi me faktorët e dhunës, të korrupsionit, të luftimit dhe të përballjes me ta, nga vetëformimi, vetasistimi dhe sigurimi i kushteve trupore, shpirtërore, materiale për formimin e këtij pushteti mbarëbotëror dhe popullor, nga ana tjetër.

Nëse tregojmë kujdes, do të vërejmë se të dy pjesët e saj janë konstruktive dhe faktor i dinamizmit, i vetëdijesimit dhe i zgjimit.

Duke marrë në konsideratë kuptimin kryesor të fjalës “pritje” bëhet e qartë domethënia e haditheve të shumta, që sapo i transmetuam, për shpërblimin dhe rezultatin e aktivitetit të pritësve. Tani e kuptojmë se përse pritësit e vërtetë, ndonjëherë janë konsideruar si njerëz që janë në tendën e Imam Mehdiut (*Paqja qoftë mbi të!*), ose nën flamurin e tij, që luftojnë me shpatë në rrugën e Zotit, ose janë mbuluar me gjakun e vet dhe kanë rënë dëshmorë.

Vallë a nuk janë këta tregues për nivelet e ndryshme të përpjekjes dhe të aktivizimit në rrugën e të Vërtetës dhe të Drejtësisë, në përputhje me nivelin e formimit dhe të gradës së pritjes së njerëzve?

Pra, ashtu siç ndryshon pesha e sakrificës dhe e flijimit të luftëtarëve në rrugën e Zotit, roli i tyre, ashtu edhe pritja, vetëformimi dhe përgatitja, ka nivele të ndryshme.

Që të dyja janë luftë dhe që të dyja kanë nevojë për përgatitje dhe vetëformim. Ai që ndodhet në tendën e udhëheqësit të këtij Pushteti mbarëbotëror, është në qendrën e shtabit të përgjithshëm të forcave të armatosura të qeverisë botërore, nuk mund të jetë njeri i pavetëdijsëm, i paformuar dhe indiferent.

Aty nuk është vendi i çdokujt, por është vendi i personave që e meritojnë një pozitë dhe përgjegjësi të tillë.

Po ashtu, ai që mban armën në dorë, përkrah udhëheqësit të këtij revolucioni lufton me kundërshtarët e qeverisë së paqes dhe të drejtësisë, duhet të ketë përgatitje të nevojshme shpirtërore, mendore dhe luftarake.

Për më shumë informacion, për dobitë dhe efektet e vërteta të pritjes së ardhjes së Imam Mehdiut (*Paqja qoftë mbi të!*), shikoni shpjegimin që vjen më poshtë.

b) Pritje, do të thotë gatishmëri e plotë

Nëse unë janë dhunues dhe shtypës, si është e mundur që të qëndroj në pritjen e një personi, shpata e të cilit mbart aromën e gjakut të shtypësve?

Nëse unë jam i papastër dhe i përlyer me mëkate, si mund të jem në pritje të një revolucioni, që flakët e para të tij do të përfshijnë prehrin e të papastërve dhe të mëkatarëve?

Ushtria që është në pritje të një lufte të madhe, i shton përgatitjet luftarake të forcave të tyre, i frymëzon me shpirtin revolucionar, si dhe largon çdo lloj pike të dobët, sepse modaliteti i "pritjes" gjithnjë përshtatet me qëllimin për të cilin pritet.

Pritja e kthimit të një udhëtari të zakonshëm nga udhëtimi, pritja e kthimit të një miku shumë të ngushtë, pritja e stinës së vjeljes së pemëve dhe stina e korrjes së produkteve, secila nga këto

karakterizohet me një lloj përgatitje, për njërën duhet përgatitur shtëpia dhe duhen siguruar mjetet e pritjes, në tjetrën, përgatitja e mjeteve të nevojshme, e draprit, e autokombajnave, etj.

Tani përfytyroni njerëzit, që janë në pritje të shfaqjes së një reformatori të madh botëror. Në realitet, janë në pritje të një revolucioni, transformimi dhe ndryshimi, që është revolucioni më i gjerë dhe më thelbësor njerëzor, të cilën e ka parë historia e njerëzimit.

Një revolucion, përkundër revolucioneve të mëparshme, nuk ka aspekt rajonal, por do të jetë gjithëpërfshirës e global dhe përfshin të gjitha aspektet dhe drejtimet e jetës së njerëzve. Është një revolucion politik, kulturor, ekonomik dhe etik.

c) Filozofia e parë: vetëformimi individual

Një transformim i tillë, para se gjithash, ka nevojë për kuadër të përgatitur dhe me vlera njerëzore, në mënyrë që të jenë në gjendje të mbajnë mbi supë barrën e rëndë të reformave madhështore në mbarë botën. Kjo, para së gjithash, ka nevojë për ngritjen e nivelit të të menduarit, të njohjes dhe të përgatitjes shpirtërore dhe mendore për bashkëpunimin për zbatimin e atij programi madhështor.

Ngushtësia, mendësitë, vizionet e mangëta, mendimet e cenuara, xhelozitë, mosmarrëveshjet fëmijërore dhe të papjekura dhe çdo lloj hipokrizie dhe hallakatjeje, në përgjithësi, nuk përshtatet me statutin e “pritësve të vërtetë”.

I rëndësishëm është fakti që pritësi i vërtetë, për një ndryshim aq të thellë dhe të rëndësishëm, nuk mund t’i lejojë vetes që të ketë rolin e spektatorit, por duhet, pa humbur kohë, t’u bashkohet radhëve të revolucionarëve.

Besimi ndaj pasojave dhe epilogut të një transformimi të tillë kurrë nuk do ta lejojë atë që të renditet në radhët e kundërshtarëve, por edhe pozicionimi në radhët e përkrahësve, po ashtu, ka nevojë për “vepra të pastra”, shpirt të rafinuar, si dhe guxim e dijeni të mjaftueshme.

Nëse unë jam një person i korruptuar dhe i degjeneruar, si do të mundem të qëndroj në pritje të një sistemi, në të cilin njerëzit e korruptuar dhe të prishur nuk kanë asnjë rol në atë, përkundrazi do të dëbohen dhe do të urrehen?

Vallë kjo pritje, a nuk është e mjaftueshme për spastrimin e shpirtit dhe të mendjes, si dhe për pastrimin e trupit dhe të zemrës sime nga njolla e papastërtive?

Ushtria që është në pritje të një lufte çlirimtare, sigurisht që do të qëndrojë në gjendje gatishmërie. E siguron armatimin e nevojshëm në përputhje me kërkesat e një fushëbeteje të tillë, krijon fortifikatat e nevojshme, e rrit përgatitjen luftarake të forcave të veta, e përforcon moralin dhe frymën e luftëtarëve të vet, si dhe e ringjall dhe e ndez dashurinë dhe dëshirën për një betejë të tillë në zemrat e tyre.

Ushtria, e cila nuk është e përgatitur në këtë mënyrë, asnjëherë nuk është në pritje dhe, nëse pohon një gjë të tillë, gënjen.

Pritje e një reformatori universal dhe mbarëbotëror, do të thotë gatishmëri e plotë mendore dhe morale, materiale dhe shpirtërore për transformimin dhe reformimin e gjithë botës.

Mund të paramendoni se sa konstruktive është një gatishmëri (parapërgatitje) e tillë. Reformimi i gjithë faqes së tokës dhe dhënia fund e të gjitha padrejtësive dhe amullive nuk është shaka dhe nuk mund të konceptohet si një punë e lehtë.

Parapërgatitja për një qëllim kaq të madh duhet të përshtatet me të, pra duhet të jetë në përmasat dhe thellësinë e saj.

Për realizimin e një revolucioni të tillë nevojiten burra shumë të mëdhenj, figura tejet të vendosur, tepër të fuqishëm dhe të pathyeshëm, jashtëzakonisht të pastër moralisht dhe ambicioz, plotësisht të përgatitur dhe me vizion të thellë.

Vetëformimi për një qëllim të tillë kërkon gërshetimin e programeve etike, ideologjike dhe shoqërore.

Ky është kuptimi dhe domethënia e pritjes së vërtetë. Vallë a mundet të thotë ndonjë person, që një pritje e tillë nuk është konstruktive?

d) Filozofia e dytë: Përkrahjet shoqërore

Pritësit e vërtetë, ndërkohë që janë të obliguar të mos kujdesen vetëm për veten e tyre, por të vëzhgojnë njëri-tjetrin, dhe përpos formësimit të vetvetes, duhet të përmirësojnë vetveten dhe të ngrenë personalitetin e të tjerëve, sepse programi madhështor, për të cilin janë në pritje, nuk është një program individual, është një program që duhet të marrin pjesë të gjithë kuadrot e revolucionit.

Duhet vepruar kolektivisht dhe në mënyrë kolegjiale, përpjekjet dhe orvatjet duhet të harmonizohen, saqë thellësia dhe gjerësia e këtij koordinimi të jetë në madhësinë e po atij revolucioni botëror për të cilin janë në pritje.

Në një fushë të gjerë, në luftimin në grup, asnjë individ nuk mund të tregohet indiferent ndaj gjendjes së të tjerëve, përkundrazi, secili është i detyruar të korrigjojë çdo dobësi kudo që e vëren atë, si dhe të përforcojë çdo pozicion të cenusshëm, të fortifikojë repartet e dobëta dhe të pafuqishme, sepse pa

pjesëmarrjen aktive dhe të koordinuar të të gjitha njësive, zbatimi i një programi të tillë është i pamundur.

Si rrjedhojë, pritësit e vërtetë, krahas orvatjes për vetëformim dhe përmirësim të vetes së tyre, e ndiejnë si detyrë të domosdoshëm për veten, që të orvaten në formësimin dhe në edukimin e të tjerëve.

Ky është efekti tjetër konstruktiv i pritjes së ngritjes së një reformuesi të madh botëror. Kjo është filozofia e gjithë këtyre virtyteve, që u thanë në lidhje me pritësit e vërtetë.

e) Filozofia e tretë: Pritësit e Vërtetë nuk “shkrihen” në korrupsionin e mjedisit

Efekti tjetër i rëndësishëm, që ka pritja e Imam Mehdiut (*Paqja qoftë mbi të!*), është mosshkrimi në mjediset amorale dhe mosdorëzimi përballë ndotjeve dhe infektiveve.

Që do të thotë, në kohën që korrupsioni përfshihet gjithandej dhe prek shumicën e njerëzve, apo një pjesë të madhe të shoqërisë, ndonjëherë dhe njerëzit e pastër gjenden përpara një kolapsi të madh psikologjik, kolaps që buron nga humbja e shpresës për reformat.

Ndodh që të mendojnë se çdo gjë ka marrë fund dhe nuk ka më ndonjë shpresë për përmirësim (reformë), kështu që përpjekja për ta mbajtur veten të pastër u duket e kotë dhe e padobishme.

Ky dëshpërim dhe humbje shprese ka gjasa që t'i çojë ata gradualisht drejt korrupsionit dhe njësimit me ambientin, në mënyrë që të mos kenë mundësi që të ruajnë veten si një pakicë e pastër dhe e drejtë karshi shumicës së korruptuar dhe imorale,

madje mospërshtatjen me shoqërinë ta konsiderojnë si një turpërim.

E vetmja gjë që mund t’u injektojë “shpresë” atyre dhe t’i ftojë në rezistencë dhe qëndresë dhe të mos i lejojë që të shkrihen në mjedisin e korruptuar, është shpresa në reformën përfundimtare. Vetëm në këtë rast, ata nuk do të heqin dorë nga orvatja dhe përpjekja për ruajtjen e pastërtisë së tyre dhe edukimin e të tjerëve.

Vërejmë se në urdhëresat islame, humbja e shpresës për faljen e mëkateve është konsideruar si një prej mëkateve më të mëdha dhe ka gjasa, që persona të padijshëm dhe të painformuar të çuditën se përse humbja e shpresës nga mëshira e Zotit është konsideruar kaq e rëndësishme. Madje më e rëndësishme se shumë prej mëkateve të tjera, në realitet, filozofia e saj është po kjo, që mëkatari që e ka humbur krejtësisht shpresën nga mëshira hyjnore, nuk gjen asnjë argument apo arsye, që të mendojë për kompensimin e së kaluarës, ose së paku, të heqë dorë prej mëkateve dhe të logjikojë:

Tani që uji është mbi kokën time, çfarë rëndësi ka nëse është një apo njëqind metra (do të mbytem)?

Unë që jam i mbyturi, a duhet të frikësohem nga lagia?!

Dhe fundi është Xhehennemi, unë që tani e kam blerë atë për veten time, për çfarë të kem frikë tjetër?

Por kur rrezet e shpresës lindin te ai, shpresa në faljen e Zotit, shpresa në ndryshimin e gjendjes ekzistuese, do të bëhet një pikë kthese në jetën e tij, e cila do ta ftojë atë që të ndalojë në rrugën e mëkatit dhe të rikthehet në rrugën e pastërtisë dhe të vetëformimit.

Pikërisht për këtë arsye, shpresën gjithnjë mund ta njohim si një faktor ndikues edukativ në lidhje me personat e korruptuar.

Po ashtu, njerëzit e drejtë, të cilët janë përfshirë në mjediset e prishura dhe të korruptuara, nuk janë në gjendje t'ia dalin mbanë dhe të ruajnë veten e tyre.

Si rezultat, arrijmë në përfundimin se Pritja e ardhjes së paqësorit, reformatorit, ku aq sa bota bëhet më e korruptuar dhe amorale me aq shpresa për ardhjen e tij shtohet, ka një ndikim të madh psikologjik te besimtarët, si dhe i siguron ata karshi dallgëve të forta të korrupsionit.

Ata jo vetëm që, me anë të zgjerimit të korrupsionit në mjediset ku jetojnë, nuk e humbin shpresën, por në bazë të shprehjes: Sa më shumë që të afrohet koha e bashkimit, aq më shumë ndizet zjarri i dashurisë.

Bashkimin me synimin e shohin shumë afër para vetes dhe përpjekja e tyre për të luftuar me korrupsionin, ose për të mbrojtur vetveten, rinis e vazhdon me një dëshirë dhe mallëngjim më të madhe.

f) Përfundimi

Nga gjithë sa thamë më lart, arrijmë në këtë përfundim: Efekti prej opiumit të Pritjes është vetëm në rast se kuptimi i saj largohet apo shformohet. Jo vetëm një grup nga kundërshtarët e kanë devijuar, por edhe një grup nga përkrahësit e kanë shformuar.

Por, nëse në shoqëri dhe te individët zbatohen, në kuptimin e vërtetë të fjalës, atëherë pa dyshim do të jetë faktor i rëndësishëm i edukimit, i vetëformimit, i dinamikës dhe i shpresës.

Ndër dëshmitë e qarta, që e vërtetojnë dhe argumentojnë këtë çështje, është kjo që në interpretimin e ajetit të mëposhtëm:

“Atyre nga mesi juaj, të cilët besuan dhe bënë vepra të mira, All’lhu u premtoi se do t’i bëjë zotërues në atë tokë, ashtu si i pati bërë zotërues ata që ishin para tyre...”¹

Nga pishtarët e mëdhenj të Islamit është transmetuar se ky ajet shënon Imam Mehdiun (*Paqja qoftë mbi të!*) dhe shokët e tij.²

Në një hadith tjetër lexojmë: “Ajeti i lartpërmendur ka zbritur për Imam Mehdiun (*Paqja qoftë mbi të!*).”³

Në këtë ajet, Imam Mehdiu dhe shokët e tij janë prezantuar si besimtarë dhe bëjnë vepra të mira: **“Atyre nga mesi juaj që besuan dhe bënë vepra të mira...”**

Si rrjedhojë, realizimi i këtij revolucioni nuk është i mundshëm pa një besim të fortë, i cili largon çdo lloj dobësie, ngathtësie dhe pafuqie dhe pa kryerjen e veprave të mira, të cilat e hapin rrugën për reformimin dhe ndriçimin e botës. Ata që janë në pritje të një programi të tillë, duhet të rrisin nivelin e njohurive dhe të besimit të tyre, si dhe të përpiqen në korrigjimin dhe fisnikërimin e veprave të tyre.

Vetëm persona të tillë mund t’i premtojnë vetes që të jenë bashkudhëtarë në Pushtetin e tij, jo ata që bashkëpunojnë me dhunuesit dhe shtypësit dhe as ata, që nuk janë prej besimtarëve dhe nuk kryejnë vepra të mira, as njerëzit frikacakë, që, nën efektin e besimit të dobët, kanë frikë nga çdo gjë, madje edhe nga hija e vet.

As njerëzit e lëkundshëm, apatikë dhe të plogësht, të cilët rrinë duarkryq dhe qëndrojnë në heshtje karshi korrupsionit të

¹ Sure “En Nur”, ajeti 55.

² “Biharul Enuar”, vëll. 51, f. 58.

³ “Biharul Enuar”, vëll. 51, f. 54; Tefsiri “Ali ibn Ibrahim Kumi”, vëll. 1, f. 14, “Darul Kitab”, Kum, 1404 Hixhri kameri; “El Gibeje Tusi”, f. 177, “Mueseseh Meariful Islami”, Kum, 1411 Hixhri kameri; “El Gajbe”i Nimanij, f. 240, Mektebeh Saduk, Teheran, 1397 Hixhri kameri.

mjedisit dhe të shoqërisë së tyre, nuk bëjnë as përpjekjen më të vogël për të luftuar korrupsionin.

Ky është impakti konstruktiv i pritjes së ardhjes së Imam Mehdiut (*Paqja qoftë mbi të!*) në shoqërinë islame.

Ajetet 34 - 35

يَا أَيُّهَا الَّذِينَ ءَامَنُوا إِنَّ كَثِيرًا مِّنَ
 الْأَحْبَارِ وَ الرَّهْبَانِ
 لَيَأْكُلُونَ أَمْوَالَ النَّاسِ بِالْبَطْلِ وَيَصُدُّونَ عَن سَبِيلِ اللَّهِ
 وَالَّذِينَ يَكْنِزُونَ الذَّهَبَ وَالْفِضَّةَ وَلَا يُنْفِقُونَهَا فِي سَبِيلِ اللَّهِ
 فَسَيَّرُهُمْ بِعَذَابٍ أَلِيمٍ ﴿٣٤﴾ يَوْمَ يُحْمَىٰ عَلَيْهَا فِي نَارِ جَهَنَّمَ
 فَتُكْوَىٰ بِهَا جِبَاهُهُمْ وَجُنُوبُهُمْ وَظُهُورُهُمْ هَذَا مَا كَنَزْتُمْ
 لِأَنفُسِكُمْ فَذُوقُوا مَا كُنْتُمْ تَكْنِزُونَ ﴿٣٥﴾

“O ju që keni besuar! Në të vërtetë, shumë priftërinj dhe murgj
 përlajnë pasurinë e njerëzve pa të drejtë dhe i largojnë ata nga
 rruga e All’Ilahut. Ata që grumbullojnë ar dhe argjend dhe nuk
 e shpenzojnë për hir të All’Ilahut, paralajmëroji me dënim të
 dhembshëm. ”

“Do të vijë dita, kur (thesaret e mbledhura) do të digjen në
 zjarrin e Xhehennemit dhe me to do të damkoset balli, anët dhe
 shpina e tyre e do t’u thuhet: ‘Kjo është ajo që keni grumbulluar
 për veten; pra, shijoni atë që grumbulluat!’”

Komentimi

Grumbullimi (i pasurisë) është i ndaluar

Në ajetet e kaluara u diskutua për veprat e politeistëve, të hebrenjve dhe të krishterëve, të cilët, për dijetarët e tyre, kishin konsideratë hyjninë e tyre. Ajeti në fjalë thotë se ata jo vetëm që nuk janë në pozitën e hyjnisë, por as që kanë forcë për udhëheqjen e popullit. Dëshmia më e madhe e kësaj fjale janë veprat e ndryshme të tyre.

Këtu ky ajet u drejtohet myslimanëve: **“O ju që keni besuar! Në të vërtetë, shumë priftërinj dhe murgj përlajnë pasurinë e njerëzve pa të drejtë dhe i largojnë ata nga rruga e All'lahut...”**

Interesant është fakti, se, ashtu siç është edhe tradita e Kur'anit, këtu nuk është bërë konstatim për të gjithë dijetarët hebrenj dhe priftërinjtë, por me anë të shprehjes *“kethiran”* - *“shumë”*, në fakt ka përjashtuar pakicën e të drejtëve. Një vëmendje dhe kujdes të tillë e hasim edhe në ajetet e tjera kur'anore, të cilat i kemi diskutuar më parë. Në ajete të tjera është folur sado pak për këtë çështje dhe është rrëfyer në librat e historisë, se në ç'mënyrë ata, me pa të drejtë dhe pa leje, me anë të rrugës së falsitetit e hanin pasurinë e njerëzve. Njëra nga mënyrat ishte fshehja e të vërtetave të mësimave të fesë së Isait (*Paqja qoftë mbi të!*) dhe të Musait (*Paqja qoftë mbi të!*), në mënyrë që populli të mos kthehej në fenë e re (fenë islame), interesat e tyre të mos viheshin në rrezik, si dhe të mos ndërpriteshin dhuratat e tyre. Kjo është përmendur në ajetet 41, 79 dhe 173 të sures “El Bekare”.

Ka shumë raste të tjetra si kjo, që me anë të marrjes së “ryshfetit” nga njerëzit, të lejuarën e bënin të ndaluar dhe të ndalurën e bënin të lejuar dhe gjykonin në interes të të fortëve dhe të pushtetarëve, duke falsifikuar realitetin. Kjo thuhet edhe në ajetin 41 të sures “El Maide”.

Një prej metodave të tjera të padrejta, të grumbullimit të pasurisë nga ana e tyre, ishte marrja e pasurisë njerëzve, në emër të “blerjes së Xhennetit”, apo në emër të “faljes së mëkatit”. Në këtë mënyrë, futja në Xhennet dhe falja e mëkatit, që janë vetëm cilësi të Zotit, ua shisnin njerëzve. Kjo gjë, në historinë e Krishterimit, ka bërë bujë të madhe, si dhe ka ngritur diskutime dhe polemika.

Kurse për sa i përket parandalimit të njerëzve nga rruga e Zotit është më se e qartë: ata i devijonin dhe i shtrembëronin ajetet hyjnore, ose i fshihnin ato për hir të mbrojtjes së interesave të tyre vetjake, por e akuzonin çdo njeri që e shihnin si kundërshtar të pozitës apo të interesave të tyre dhe, me anë të ngritjes së “gjykatave fetare të inspektimit”, ata gjykoheshin në mënyrën më barbare, si dhe dënoheshin me dënime më të rënda që mund të përfytyrohet.

Nëse ata nuk do të kishin bërë një vepër të tillë dhe pasuesit e tyre të mos i kishin bërë kurban në emër të lakmive dhe të epsheve të tyre, sot shumë më shumë grupe njerëzish do të kishin përqaftuar me zemër fenë e Vërtetë, pra Islamin.

Si rrjedhojë, me plot kurajë mund të themi se mëkati i miliona njerëzve që kanë mbetur në errësirën e politeizmit, është në qafë të tyre.

Edhe sot e kësaj dite, të krishterët dhe hebrenjtë bëjnë çmos që të largojnë opinionin publik të njerëzve të botës nga Islami. Ata parashtrajnë fyerje të çuditshme dhe rrëqethëse për Profetin (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*).

Kjo çështje është aq e përhapur, saqë një grup nga dijetarët mendjendritur të Krishterimit, rishtazi e kanë pohuar faktin se metoda tradicionale, jo e denjë e Krishterimit, në luftimin e Islamit, është një prej shkaqeve të mosinformimit të njerëzve në Perëndim me mësimet e kësaj feje të pastër.

Më pas Kur'ani, duke marrë shkas nga diskutimi për dhënien pas kësaj bote të prijësve të krishterë dhe hebre, shpaloj një rregull të përgjithshëm për grumbulluesit e pasurisë ku thotë: **“Ata që grumbullojnë ar dhe argjend dhe nuk e shpenzojnë për hir të All'llahut, paralajmëroji me dënim të dhembshëm.”**

Fjala “*jeknizun*” rrjedh nga fjala “*kenz*” dhe do të thotë “*thesar*”, që kupton grumbullimin dhe mbledhjen e pjesëve të një sendi. Pikërisht për këtë, devenë e shëndoshë e quajnë “*kinazetul lahm*”. Më pas është përdorur në kuptimin e grumbullimit, të ruajtjes dhe të fshehjes së pasurisë ose të gjërave të çmuara.

Si rrjedhojë, kjo fjalë ka kuptimin e grumbullimit, të mbledhjes e ndonjëherë fshehje të një gjëje.

Fjala “*dheheb*” është në kuptimin e *floririt*, kurse fjala “*fidh' dhatun*” është në kuptimin e *argjendit*. Disa gjuhëtarë (në bazë të transmetimit të Tabersiut në “*Mexhmaul Bejjan*”), për kuptimin leksikor të këtyre fjalëve, kanë përdorur shprehje interesante: “Arsyeja se pse floriri është quajtur “*dheheb*”, për faktin që floriri të ik nga duart për shkak të përmbushjes së nevojave jetike dhe nuk është diçka që mbetet përjetësisht në dorën tënde.

Fjala “*dhehab*”, në gjuhën arabe, është në kuptimin e ikjes, vajtjes. Kurse “*argjendi*” është quajtur “*fidh’dh’e*”, sepse përhapet dhe shpërndahet shumë shpejt. (Fjala “*infidh’adh*”, në fjalor, është në kuptimin e shpërndarjes.

Këto emërtime janë të mjaftueshme për të kuptuar gjendjen e pasurive të tilla.

Që nga koha e formimit të shoqërive njerëzore, çështja e shkëmbimit të prodhimeve të ndryshme ekzistonte midis njerëzve dhe çdokush nxirrte për shitje atë që i tepronte nga prodhimet bujqësore, blegtorale dhe të tjera. Në fillim shkëmbimet ishin mall me mall, sepse monedha akoma nuk ishte shpikur dhe nuk ishte vënë në përdorim.

Duhet pasur parasysh fakti se shkëmbimi i mallit me mall tjetër krijonte probleme të shumta, meqenëse shumë persona, të cilët dëshironin të nxirrnin për shitje tepricat e tyre përtej nevojës, në atë moment nuk ekzistonte diçka që për ta të ishte e domosdoshme dhe e nevojshme, për ta shkëmbyer me të dhe dëshironin që tepricën, prodhimin e tepërt, ta shndërronin në diçka, që me anë të saj të pajiseshin me mallrat që dëshironin. Këtu u parashtrua çështja e parasë, pra, e monedhës.

Gjetja e “*argjendit*” dhe atë që është më e rëndësishmja, pra e “*floririt*” i dha jetë kësaj ideje dhe këto dy metale formuan monedhën me më pak vlerë dhe me më shumë vlerë. Me anë të tyre, tregtia dhe shkëmbimi i mallrave lulëzoi dhe përparoi në mënyrë të dukshme. Rrjedhimisht, filozofia thelbësore e monedhës është qarkullimi më i plotë dhe më i shpejtë i shkëmbimeve ekonomike. Ata që fshehin lekët në formën e “*thesarit*” jo vetëm që bëhen shkak për rënien ekonomike dhe

dëmtimin e interesave të shoqërisë, por veprimi i tyre është si përkundrejt filozofisë së shfaqjes së monedhës.

Ajeti i lartpërmendur, në mënyrë të qartë dhe rishtazi, ka ndaluar grumbullimin e pasurisë dhe të thesarit dhe myslimanët i urdhëron, që pasuritë e tyre t'i përdorin në rrugën e Zotit, si dhe në rrugën e përfitimit të robërve të Zotit dhe të qëndrojnë larg grumbullimit, rezervimit dhe nxjerrjes nga qarkullimi tregtar. Në të kundërt duhet të përgatiten për dënim të dhimbshëm.

Ky dënim i dhimbshëm nuk kufizohet vetëm në ndëshkimin e ashpër të Ditës së Kiametit, por ka të bëjë gjithashtu me dënimet e vështira të kësaj bote, që, si pasojë e shpërbërjes së balancave ekonomike, si dhe krijimin e ndasive klasore, nuk përjashton as të pasurit dhe as të varfrit.

Nëse në të kaluarën, njerëzit e tokës nuk ishin në dijeni për rëndësinë e kësaj dispozite islame, sot ne, më së miri, jemi në gjendje që ta kuptojmë domethënien e saj, sepse çrregullimet që kanë prekur thellësisht njerëzimin për shkak të grumbullimit të pasurisë nga ana e një grup njerëzish egoistë dhe të pandërgjegjshëm, kanë sjellë trazira, luftëra dhe gjakderdhje.

Ndëshkimi i grumbulluesve të pasurisë

Në ajetin vijues, është bërë një aludim për një prej ndëshkimeve të personave të tillë në Botën Tjetër: **“Do të vijë dita, kur (thesaret e mbledhura) do të digjen në zjarrin e Xhehennemit dhe me to do të damkoset balli, anët dhe shpina e tyre e do t'u thuhet: ‘Kjo është ajo që keni grumbulluar për veten. Pra, shijoni atë që grumbulluat!’”**

Ky ajet e rithekson edhe një herë tjetër këtë realitet: Veprat e njerëzve nuk zhduken, do të mbeten në vijimësi dhe po këto vepra do të personifikohen përballë njeriut në Botën Tjetër dhe do të bëhen shkak i gëzimit e i lumturisë apo i vuajtjes e i dënimit të tij.

Në lidhje me atë, që përse në ajetin e lartpërmendur, nga të gjitha gjymtyrët e trupit të njeriut janë përmendur vetëm tre, “balli”, “anët” dhe “shpina”, në mesin e komentuesve të Kur’anit ka mosmarrëveshje. Por nga Ebu Dherri është transmetuar: *“Janë përmendur vetëm këto gjymtyrë, sepse nxehtësia e zjarrit depërton në hapësirën që ndodhet poshtë këtyre tre pikave dhe e përfshin të gjithë qenien e tyre.”*¹

Kjo është për shkak se, me anë të këtyre tre gjymtyrëve, të pasurit bënin shenja përballë të varfërve, duke i ngacmuar me mimika të ndryshme, ndonjëherë i tërhiqnin fytyrat, ndonjëherë, në shenjë mosrespektimi, shmangnin përballjen ballë për ballë me ta dhe ua kthenin shpinën atyre, kështu që këto tre pjesë prej gjymtyrëve të trupit të tyre do të “digjen” me floririn dhe pasurinë e grumbulluar.

Në fund të këtij diskutimi është e nevojshme të përmendim edhe një çështje gjuhësore, që ekziston në ajet: **“Do të vijë dita, kur (thesaret e mbledhura) do të digjen në zjarrin e Xhehennemit...”** (Jeume juhma alejha) ndërkohë që në raste të tilla

¹ “Nuruth Thekalejn”, vëll. 2, f. 214, “Mueseseh ismailijan”, Botim i katërt, 1412 Hixhri kameri; Tefsiri “Ali Ibn Ibrahim Kumi”, vëll. 1, f. 297, “Darul Kutubl Kum”, 1404 Hixhri kameri; “Biharul Enuar”, vëll. 70, f. 138; Tefsiri “Es Safi”, vëll. 2, f. 340, “Mektebeh Sadr”, Teheran, Botim i dytë, 1416 Hixhri kameri; “El Mizan”, vëll. 9, f. 257; “Intesharate xhamiul muderesine”, Kum; Tefsiri “El Esfa”, vëll. 1, f. 464, “Intesharat deftere tebligat”, Botim i parë, 1418 Hixhri kameri.

nuk përdoret fjala “*ela*”, por thuhet “*juhmel haid*”- “hekurin e nxehtë”. Shprehja në fjalë ka gjasa të jetë aludim për djegien e jashtëzakonshme të monedhave (thesareve të mbledhura), sepse, nëse një monedhë e hedhin në zjarr, nuk nxehet aq shumë, sesa kur e fusim zjarrin poshtë saj apo e hedhim zjarrin mbi të. Kur’ani nuk po thotë monedhat i hedhim në zjarr, por po thotë, ato i vendosin mbi zjarr, në mënyrë që të nxehen dhe të bëhen sa më përvëluese. Kjo shprehje e gjallë shpjegon ashpërsinë e dënimit të grumbulluesve shpirtkeq.

Hulumtime

1- Vëllimi dhe kriteri i “*kenzit*” - “*depozitimit të qortueshëm*”

Ka diskutim mes komentuesve të Kur’anit se a konsiderohet vallë thesar çdo lloj depozitimi, pasuri shtesë ndaj nevojave të jetesës dhe, duke u bazuar në ajetin e lartpërmendur, a është haram kjo gjë?

Mos vallë ky urdhër i përket kohës së fillimit të Islamit dhe kohës para zbritjes së urdhrit të zekatit dhe më pas është anuluar me zbritjen e urdhrit të zekatit?

Apo, në parim, është vetëm dhënia e zekatit vjetor dhe asgjë tjetër përveç saj? Si rrjedhojë, ajeti i lartpërmendur nuk përfshin njeriun, i cili, sa herë që depoziton ndonjë pasuri, çdo vit pagan taksën islame, pra zekatin.

Në shumë hadithe, që janë transmetuar në burimet e Ehli Synetit dhe të Shi’izimit, e hasim këtë komentim. Në një hadith të

transmetuar nga Profeti (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) thuhet: “Çdo mall që e paguan zekatin e tij, nuk është depozitim pasurie.”¹

Gjithashtu lexojmë, në kohën që zbriti ajeti i lartpërmendur, myslimanëve iu vështirësuan punët dhe thanë: Me zbritjen e këtij urdhri, asnjëri nga ne nuk mund të grumbullojë ndonjë gjë për fëmijët e vet dhe të sigurojë të ardhmen e tyre. Në fund e pyetën Profetin (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) për këtë çështje.

Profeti (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) iu përgjigj: “Zoti i Madhëruar ju ka bërë obligim dhënien e zekatit, sepse dëshiron që të pastrojë mallin e mbetur nga pasuria juaj, kështu që për këtë arsye për ju ka përcaktuar ligjin e trashëgimisë për mallin që mbetet pas jush.”²

Pra, nëse do të ishte e ndalur, në tërësi, grumbullimi i pasurisë, atëherë ligji i trashëgimisë do të ishte i pavend.

Në librin me titull “Emali”, të Shejkh Sadukut, po nga Profeti (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e*

¹“El Manar”, vëll. 10, f. 404; “Biharul Enuar”, vëll. 8, f. 242; “Xhamiu Sagir”, vëll. 1, f. 465; “Darul Fikr Bejrut”, Botim i parë, 1401 Hixhri; “Kenzul Eamal”, vëll. 6 f. 294, “Mueseseh Risaletun”, Bejrut; “Fejdhul Kadir, vëll. 3, f. 204, “Darul Kutubul ilmije”, Bejrut, Botim i parë, 1415 Hixhri; “Mexhmaul Bejjan”, vëll. 5, f. 47, ajeti në fjalë; “Xhamiul Bejjan”, vëll. 10, f. 152, “Darul Fikr”, Bejrut, 1425 Hixhri kameri; Tefsire “Ibn Kethir”, vëll. 2, f. 364, “Darul Mearife”, Bejrut, 1412 Hixhri kamri; “Durrul Menthur”, vëll. 3, f. 232, “Darul mearifeh”, Bejrut, Botim i parë, 1365 Hixhri kameri.

²“Mexhmaul Bejjan”, vëll. 6, f. 13, Darul Fikr; “Mustedreke Hakim”, vëll. 2, f. 333, “Darul Mearifeh”, Bejrut, 1406 Hixhri kameri; “Sunenul Kubra i El Bejhekij”, vëll. 4, f. 84, “Darul Fikr”, Bejrut; Tefsiri “Ibn Kethir”, vëll. 2, f. 365, “Darul Mearifeh”, Bejrut, 1412 Hixhri kameri; “Durrul Menthur”, vëll. 3, f. 232, “Darul Mearifeh”, Botim i parë, 1365 Hixhri kameri.

tij!) është transmetuar po ky kuptim dhe përmbajtje: “Çdokush që e pague zekatin e pasurisë së vet, pjesa e mbetur e saj nuk konsiderohet depozitim thesari.”¹

Por në burimet islame vërejmë hadithe që, në pikëpamje të parë, përmbajtja e tyre nuk përputhet me komentimin e lartpërmendur. Si shembull mund të përmendim hadithin që është transmetuar në “Mexhmaul Bejjan” nga Imam Aliu: “E gjithë ajo që grumbullohet më shumë se sa katërmijë derhem, që zakonisht janë të ardhurat vjetore për jetesë, konsiderohet thesar.”²

Kurse në librin e njohur “El Kafi” nga Meadh ibn Kethiri është transmetuar se Imam Sadiku (Paqja qoftë mbi të!) ka thënë: “Shi’at tanë momentalisht janë të lirë nga ajo që kanë në dorë ta japin për bamirësi (dhe pjesa e mbetur për ta është e lejuar). Por me ardhjen e Imamit tonë, Imam Mehdiut (Paqja qoftë mbi të!), të gjitha thesaret dhe pasuritë e depozituara do t’i ndalojë, në mënyrë që t’i sjellin te ai për t’i shfrytëzuar karshi armikut.” Ky është kuptimi i fjalës së Zotit, i Cili, në Librin e Vet, ka thënë: “...Ata që e ruajnë arin e argjendin e nuk e japin për rrugën e All’liahut...”³

¹ “Nuruth Thekalejn”, vëll. 2, f. 213; “Biharul Enuar”, vëll. 8, f. 243 dhe vëll. 80, f. 139; “Emali i shejkh Tusit”, f. 519, “Intesharate Darul Thekafe”, Kum, 1414 Hixhri kameri; “Uesailu Shia”, vëll. 9, f. 30, Botim i Ahlul Bejtit.

² “Mexhmaul Bejjan”, ajeti në fjalë; “Biharul Enuar”, vëll. 8, f. 243; “Tibjan”, vëll. 5, f. 212, Mektebul E’lam Islami, Botim i parë, 1409 Hixhri kameri; Tefsiri “Saffi”, vëll. 2, f. 340, “Mektebetu Sadr”, Teheran, Botim i dytë, 1416 Hixhri kameri; Tefsiri “Es Safi”, vëll. 1, f. 464, “Intesharate deftere tebligat”, Botim i parë, 1418 Hixhri kameri; “Nuruth Thekalejn”, vëll. 2, f. 213, “Mueseseje ismailijan”, Botim i katërt, 1412 Hixhri kameri.

³ “Nuruth Thekalejn”, vëll. 2, f. 213, “Mueseseh Ismaililijan”, botim i katërt, 1412 Hixhri kameri; “Usulul Kafij, vëll. 4, f. 61, “Darul Kutubul Islamiye”, Et Tehdhib, vëll.4, f. 144, Darul Kutubul Islamiye, Uesailu Shia, vëll. 9, f. 547, Botim i “Ahlul Bejtit”; “Biharul Enuar”, vëll. 70, f. 143; Tefsiri “Ajashi”, vëll. 2, f. 78, Shtëpia Botuese Shkencore Teheran, 1380 Hixhri kameri; “Mukhteliful El Shia”,

Gjithashtu në jetëshkrimin e Ebu Dherrit kjo çështje është përsëritur disa herë, si dhe është transmetuar në libra të tjerë. Ai e këndonte vazhdimisht, çdo mëngjes dhe mbrëmje, këtë ajet në prani të Muavijes në Sham dhe, me zë të lartë, thërriste: *“Lajmëroi grumbulluesit e thesarit dhe të pasurisë, që edhe ballin e tyre do ta ngrohin me këtë pasuri të grumbulluar, edhe anët, si edhe shpinat e tyre, derisa nxehtësia e djegies të depërtojë brenda qenies së tyre!”*¹

Po ashtu, argumentimi i Ebu Dherrit, karshi Osmanit, me këtë ajet është dëshmi për këtë, ai ishte i mendimit se ajeti nuk i përket vetëm penguesve të zekatit, por përfshin edhe të tjerët përveç tyre.

Nga hulumtimi i haditheve të lartpërmendura, në tërësi, duke i shtuar edhe vetë ajetin, arrijmë në këtë përfundim: Në kushte të zakonshme, që do të thotë në rastet kur shoqëria nuk ndodhet në një gjendje të mjerueshme dhe të rrezikshme, njerëzit jetojnë në kushte të mira ekonomike, kanë një jetë të rehatshme, dhënia e zekatit është e mjaftueshme, pjesa e mbetur e pasurisë së tyre nuk konsiderohet depozitim thesari apo grumbullim pasurie (sigurisht duhet të kemi parasysh faktin se, me zbatimin e rregullave dhe të dispozitave islame, për të ardhurat, pasuria nuk

vëll. 3, f. 352, “Intesharate Xhamee Muderesine”, Kum, Botim i parë, 1413 hixhri; “Mu’xhemul Ehadith El Imam Mehdi (Paqja qoftë mbi të!)”, vëll. 5, f. 150, “Mueseseje Meariful Islamije”, Botim i parë, 1411 Hixhri kameri; Tefsiri “Es Safi”, vëll. 2, f. 341, “Mektebetu Sadr”, Teheran, Botim i dytë, 1416 Hixhri kameri.

¹ “Nuruth Thekalejn”, vëll. 2, f. 214, “Mueseseh Ismailijan”, Botim i katërt, 1412 Hixhri kameri; “Biharul Enuar”, vëll. 70, f. 138; Tefsire “Ali ibn Ibrahim Kumi”, vëll. 1, f. 289, “Muesese Darul Kitab”, Kum, Botim i tretë, 1404 Hixhri kameri; Tefsiri “Es Safi”, vëll. 2, f. 430, “Mektebul Sadr”, Teheran, Botim i dytë, 1416 Hixhri kameri; Tefsiri “El Esfa”, vëll. 1, f. 464, Botim i parë, 1418 Hixhri kameri; “El Mizan”, vëll. 9, f. 257, Xhamiul Muderrisin, Kum.

shtohet në mënyrë të jashtëzakonshme, sepse Islami ka përcaktuar aq shumë kushte dhe dispozita, saqë përfitimi i një pasurie të tillë zakonisht është e pamundur).

Kurse në rastet urgjente dhe në kohën kur kërkohet mbrojtja e interesave të shoqërisë islame, qeveria islame mund të deklaronte një kufizim për depozitimin e pasurisë (ashtu siç e lexuam edhe sa më lart në hadithin e Imam Aliut), ose me qëllim të ruajtjes së ekzistencës së shoqërisë islame, t'ia kërkojë popullit të gjitha depozitimet dhe pasuritë e grumbulluara (ashtu siç e cekëm më lart në hadithin e Imam Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*) për kohën e ardhjes së Imam Mehdiut (*Paqja qoftë mbi të!*), por duke pasur parasysh përmendjen e arsyes në hadith, dispozita vlen edhe për kohët e tjera, sepse po thotë: *“Për t'i shfrytëzuar përballë armikut.”*¹

Por sërish po e përsërisim që kjo çështje është vetëm në kompetencat e qeverisë islame dhe vetëm ajo ka të drejtë të marrë masa dhe vendime të tilla në rast nevojë.

Përsa i përket veprimit të Ebu Dherrit, ka gjasa të jetë dëshmi po për këtë interpretim, që në atë kohë shoqëria islame kishte nevoja shumë të mëdha, në mënyrë që grumbullimi i pasurisë në ato ditë binte ndesh me interesat e shoqërisë dhe ruajtjen e ekzistencës së saj.

Ebu Dherrri i ishte kushtuar thesarit të shtetit (Buxhetit shtetëror), i cili ndodhej në duart e khalifit Osman dhe të Muavijes. Ne e dimë se pasuri të tilla, kur ekzistojnë të vobektët

¹ “Usulul Kafi”, vëll. 4, f. 61, “Darul Kutubul Islamiye”; “Biharul Enuar”, vëll. 70, f. 143; Tefsiri “Ajashi”, vëll. 2, f. 87, Shtëpia Botuese Shkencore, Teheran, 1380 Hixhri kameri; “Uesailu Shia”, vëll. 9 f. 547.

dhe njerëzit në nevojë, nuk mund të grumbullohen për asnjë çast, por duhet t'u jepet atyre që takojnë dhe nuk ka lidhje fare me zekatin.

Veçanërisht, të gjitha librat e historisë islame, përfshirë këtu autorë shi'itë dhe syni dëshmojnë se Osmani, mallra të shumta nga thesari i shtetit, ia dha farefisit të vet, kurse Muavije, nga kjo pasuri, ndërtoi një pallat, duke ringjallur legjendën për pallatet e sasanidëve dhe Ebu Dherri kishte të drejtë t'ua rikujtonte atyre këtë ajet.

2- Ebu Dherri dhe kapitalizmi

E dimë se një prej kritikave të rënda, që i janë bërë kalifit të tretë, ishte çështja e dëbimit të ashpër të Ebu Dherrit në shkretëtirë, në Rabadhe, që përfundoi me vdekjen e këtij sahabi të madh dhe person luftarak, sakrifikues në rrugën e Islamit.¹

Po Profeti (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) për këtë ka thënë: *"Qielli nuk lëshoi hijen e vet dhe toka nuk mbarti mbi vete person, më të drejtë se Ebu Dherri."*²

Po ashtu jemi në dijeni edhe për konfliktin midis Ebu Dherrit dhe Osmanit, që nuk ishte për shkak të lakmisë së pasurisë dhe pozitës, ngaqë ai ishte një burrë i devotshëm dhe i pastër në çdo pikëpamje, por ishte shpërdorimi dhe flakja e thesarit të shtetit nga ana e kalifit të tretë, si dhe falja dhe dhurimi pa llogari e pasurisë së qytetarëve nga thesari i shtetit ndaj farefisit të tij.

¹ Për më shumë informacion, referohuni në "Biharul Enuar", vëll. 22, f. 393, e tutje, K. 22, "Kejfeju islam Ebi Dherr radhijullahi anhu" dhe... si dhe faqet 395, 399 si dhe 404.

² "Biharul Enuar", vëll. 30, f. 372; "El Istegathe", vëll. 1, f. 56.

Ebu Dherri, për çështjet financiare, veçanërisht aty ku bëhej fjalë për “thesarin e shtetit”, ishte shumë i rreptë dhe dëshironte që të gjithë myslimanët në këtë çështje të ndiqnin Profetin (*Paqja dhe bekimet e All'lahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*). Por në kohën e kalifit të tretë rrjedhja e çështjeve ishte në një mënyrë tjetër.

Sidoqoftë, në kohën që fjalët e qarta dhe të vendosura të këtij njeriu të madh dhe të nderuar për kalifin e tretë u bënë të padurueshme, në fillim ai e dëboi atë në Sham. Këtë herë, Ebu Dherri mbajti qëndrim edhe më të ashpër dhe më të vendosur për veprat e Muavijes. Çështja arriti deri aty sa Ibn Abbasi të thotë: “Muavija i shkroi Osmanit një letër. Ndër të tjera thuhej:

“Nëse ke nevojë për Shamin, ktheje Ebu Dherrin, sepse, nëse qëndron në Sham, do ta humbasësh këtë tokë.”

Osmani, me anë të një letre, e thirri Ebu Dherrin. Në bazë të disa librave të historisë e urdhëroi Muavijen, që ta dërgojë atë në drejtim të Medines, së bashku me rojtarë të ashpër, në mënyrë që natë e ditë të udhëtojnë, duke mos e lënë rehat për asnjë çast të vetëm. Kështu që Ebu Dherri, në kohën që po hynte në Medine, u sëmur rëndë. Meqenëse prania e tij në Medine ishte e padurueshme për organet e qeverisë, atë e dëbuan në Rebedhe dhe në po këtë vend u largua nga kjo botë.”¹

Ata që duan ta mbështesin kalifin e tretë për këtë, ndonjëherë e akuzojnë Ebu Dherrin, se ishte kapitalist dhe humanitar, që të gjithë pasurinë e konsideronte të Zotit dhe e mohonte pronësinë personale.

¹ “Usulul Kafi”, vëll 8, f. 206, “Darul Kutubul Islamiye”, “Biharul Enuar”, vëll. 22, f. 395396, 414 dhe 416 dhe vëll. 31, f. 174-176

Kjo akuzë është shumë e çuditshme, sepse Kur'ani e respekton pronën private me disa kushte. Ebu Dherri ishte nga personat më të afërt të Profetit (*Paqja dhe bekimet e All'Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), si dhe ishte edukuar me frymën e Kur'anit. Duke qenë se nuk ekzistonte njeri më i drejtë në të folur se sa ai, si është e mundur që t'i përshkruhet një gjë e tillë?!

Banorët e shkretëtirave të largëta ishin në dijeni për këtë dispozitë të Islamit (pranimin e pronës private), kishin dëgjuar ajetet për tregtinë, trashëgiminë dhe të ngjashëm me to. Vallë a është e besueshme që nxënësi i afërt i Profetit (*Paqja dhe bekimet e All'Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) të mos kishte dijeni për këtë çështje?

A nuk është ky realiteti që fanatikët kokëngjeshur, për të shfajësuar kalifin e tretë, apo ç'është më e rëndësishmja, për të shfajësuar pushtetin e Muavijes, shpikën një akuzë të tillë për Ebu Dherrin? Akoma një grup njerëzish vazhdojnë ta ndjekin atë me sy dhe vesh të mbyllur.

Po, Ebu Dherri, me frymëzim prej ajeteve kur'anore, veçanërisht ajeti i "Grumbullimit të pasurisë" ishte i bindur dhe e shfaqte hapur bindjen e tij: Thesari apo buxheti i shtetit të Islamit nuk duhet të shndërrohet në pronë private të individëve të caktuar dhe nuk duhet të bëhen dhurata zemërgjera me të, sepse u përket të vobektëve dhe nevojtarëve dhe duhet të shpenzohet në rrugën e përforcimit të Islamit dhe të interesave të myslimanëve, apo duhet të ringjallë sërish legjendat për pallatet dhe kështjellat e mbretërve të perandorive iraniane dhe romako-bizantine.

Përveç kësaj, Ebu Dherri kishte këtë bindje, që në kohën kur një grup prej myslimanëve ndodhen në kushte shumë të

rënda ekonomike, të kamurit e këtij populli, gjithashtu, duhet të mjaftohen me një jetesë më të thjeshtë dhe nga pasuria e tyre të japin në rrugën e Zotit. Nëse Ebu Dhërri kishte ndonjë “mëkat”, ai lidhej pikërisht me këtë. Por historianët sahanlëpirës të Beni Umejes dhe rrëfimitarët lajkatarë, servilë, për ta njollosur fytyrën e këtij burri luftëtar, i kanë atribuuar akuza të tilla të padrejta atij.

“Mëkati” tjetër i Ebu Dhërrit ishte se ai ushqente një dashuri tepër të madhe dhe të veçantë ndaj Imam Aliut (*Paqja qoftë mbi të!*). Ky mëkat mjaftonte që gënjeshtarët e Beni Umejes të vinin në përdorim fuqinë e tyre prej ferrit, për ta njollosur personalitetin dhe karakterin e Ebu Dhërrit.

Por personaliteti i tij ishte aq fisnik, njohuritë, dija dhe drejtësia e tij për çështjet islame ishin aq të qarta, saqë i turpëroi të gjithë këta gënjeshtarë.

Një prej gënjeshtreve të çuditshme që ia përshkruan Ebu Dhërrit, në mënyrë që të shfajësohej kalifi i tretë, në bazë të transmetimit të Ibn Sa'dit në “Tabakat”, ishte: “Në kohën që Ebu Dhërri ishte në Ribedhe, një grup banorësh të Kufes iu drejtuan atij, duke i thënë: “Ky burrë (pra Osmani) ka kryer të gjitha këto vepra kundër teje. Vallë a je i gatshëm që të ngrini një flamur dhe të çoheni të luftoni kundër tij?”

Ebu Dhërri tha: “Jo! Nëse Osmani mua më çon nga Lindja në Perëndim, përsëri do t’i bindem urdhrave të tij.”¹

¹ Tefsiri “El Manar”, vëll. 10, f. 406; “El Gadir”, vëll. 8, f. 325, “Darul kutubul Arabi”, Bejrut, Botim i tretë, 1387 Hixhri; “El Mesannff, Ibn Ebi Shejbeh Kufi”, vëll. 8, f. 692, “Darul Fikr”, Botim i parë, 1409 Hixhri; Hulumtim i Said Muhammed Lehham, Tabakatul Kubra të Ibn Sa'd, vëll. 4, f. 227, Bejrut, Tarikh Medine Dimashk, vëll. 66, f. 201, Darul Fikr, Botim i parë, 1415, Hixhri kameri;

Këta gënjeshtarë as që nuk i kushtuan rëndësi dhe vëmendje faktit, që, nëse ai do t'i nënshtrohej në këtë mënyrë urdhrave të kalifit, nuk do ta shqetësonte kaq shumë atë, sa që prania e tij në Medine të ishte një barrë e rëndë për kalifin dhe të mos e duronte aspak atë.

Dhe më e çuditshme se kjo është thënia e autorit të njohur të komentimit “El Manar”: *“Ngjarja e Ebu Dherrit tregon se në kohën e Sahabëve (veçanërisht të Osmanit), shprehja e bindjeve ishte e lirë. Dijetarët ishin të respektuar. Kalifët kishin dashuri. Muavije nuk kishte guxim t'i thoshte gjë Ebu Dherrit, por i shkroi letër eprorit më të lartë të tij, pra, kalifit dhe kërkoi urdhër prej tij.”*

Me të vërtetë, paragjykimi të bën të kryesh çdo lloj vepre. Vallë, dëbimi në tokën e nxehtë, të thatë dhe përvëluese të Rebedhesë, në tokën e vdekjes dhe të zjarrit, ishte shembull për respektimin e lirisë së mendimit dhe dashurisë ndaj dijetarëve?

Vallë a konsiderohet arsye për lirinë e shprehjes dorëzimi i këtij sahabi të madh në duart e vdekjes?

Nëse Muavija, nga frika e opinionit publik, nuk kurdisi personalisht ndonjë truk ndaj Ebu Dherrit, a është kjo vallë argument se ai tregonte respekt ndaj tij?

Sërish prej çudirave të këtij tregimi është se mbështetësit e kalifit thoshin: *“Dëbimi i Ebu Dherrit u ndërмор në bazë të urdhrit të ligjit ‘Përparësia e eliminimit të dëmit ndaj përfitimit të interesit’”*. Qëndrimi i Ebu Dherrit në Medine kishte interesa të mëdha dhe njerëzit përfitonin shumë nga dituria dhe dija e tij. Por Osmani mendonte se, për shkak të mënyrës së tij të menduarit, jo të

Hulumtim “Ali Shiri Sijer E'lamul Nubela”, vëll. 2, f. 72, “Mueseseh Risale”, Bejrut, Botimi i nëntë, 1413 Hixhri kameri.

ndjeshme dhe radikale, në lidhje me pasuritë, qëndrimi i tij në Medine do të ishte burim i ligësive dhe dëmeve, andaj hoqi dorë nga dobitë e qëndrimit të tij dhe e dërgoi atë jashtë Medines. Meqenëse edhe Ebu Dherri, edhe Osmani ishin muxhtehid, këtu nuk do t'iu vihet faj asnjërit prej tyre.¹

Me të vërtetë, çfarë dëmi do të lindte apo të krijohej me qëndrimin e Ebu Dherrit në Medine? Vallë rikthimi i njerëzve në traditën e Profetit (*Paqja dhe bekimet e All'Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) është ndonjë dëm dhe ligësi?

Përse Ebu Dherri nuk e kritikoi kalifin e parë dhe të dytë për çështjet financiare, që nuk zbatonin programet e Osmanit? Vallë a ishte burim i dëmit dhe i ligësisë rikthimi i njerëzve në programet financiare në fillim të Islamit?

Vallë a është burim i reformave dëbimi i Ebu Dherrit dhe mbyllja e gjuhës së drejtë të tij?

Vallë a nuk përfundoi në një shpërthim të madh, që dhe vetë kalifi u flijua për të, vazhdimësia e veprës së Osmanit veçanërisht për shkak të çështjeve financiare?

Vallë a ishte kjo humbje dhe dëm kurse heqja dorë prej saj e dobishme?!

Por çfarë mund të bëjmë? Në kohën që paragjykimet futen nga njëra derë, logjika largohet nga dera tjetër.

Sidoqoftë, vepra dhe kontributi i këtij sahabiu të madh nuk është e fshehur për asnjë studiues objektiv, si dhe nuk ekziston asnjë rrugë e logjikshme për shfajësimin e kalifit të tretë nga torturat që ia shkaktoi Ebu Dherrit.

¹ Tefsiri "El Manar", vëll. 10, f. 407.

Ajetet 36 - 37

إِنَّ عِدَّةَ الشُّهُورِ عِنْدَ اللَّهِ اثْنَا عَشَرَ شَهْرًا فِي كِتَابِ اللَّهِ يَوْمَ
 خَلَقَ السَّمَوَاتِ وَالْأَرْضَ مِنْهَا أَرْبَعَةٌ حُرْمٌ ذَلِكَ الدِّينُ الْقَيِّمُ
 فَلَا تَظْلِمُوا فِيهِنَّ أَنْفُسَكُمْ وَقَتِلُوا الْمُشْرِكِينَ كَافَّةً كَمَا
 يُقْتِلُونَكُمْ كَافَّةً وَاعْلَمُوا أَنَّ اللَّهَ مَعَ الْمُتَّقِينَ ﴿٣٦﴾ إِنَّمَا
 النَّسِيءُ زِيَادَةٌ فِي الْكُفْرِ يُضَلُّ بِهِ الَّذِينَ كَفَرُوا يُحِلُّونَهُ و
 عَامًا وَيُحَرِّمُونَهُ عَامًا لِيُؤْاطِئُوا عِدَّةَ مَا حَرَّمَ اللَّهُ فَيُحِلُّوا مَا
 حَرَّمَ اللَّهُ زَيْنَ لَهُمْ سَوْءَ أَعْمَالِهِمْ وَ اللَّهُ لَا يَهْدِي الْقَوْمَ
 الْكَافِرِينَ ﴿٣٧﴾

“Vërtet, numri i muajve te All’llahu është dymbëdhjetë, sipas
 Librit të All’llahut, që prej ditës kur krijoi qiejt dhe Tokën.
 Katër prej tyre janë të shenjtë, sipas besimit të drejtë. Prandaj,
 mos i bëni vetes dëm, duke i shkelur këta muaj! Megjithatë,
 luftoni të gjithë kundër idhujtarëve, ashtu si luftojnë ata të
 gjithë kundër jush. Ta dini se All’llahu është me ata që ruhen
 nga gjynahet.”

“Vërtet, muaji shtesë është vetëm shtesë në mosbesim. Për shkak të tij jobesimtarët shkojnë në humbje: një vit e quajnë të lejueshëm e vitin tjetër, të ndaluar, për të plotësuar numrin e muajve që i ka ndaluar All’llahu. Kështu, ata lejojnë atë që ka ndaluar All’llahu. Atyre u duken të bukura veprat e tyre të shëmtuara. All’llahu nuk i udhëzon në rrugë të drejtë njerëzit mosbesimtarë.”

Komentimi

Armëpushim i detyrueshëm

Duke pasur parasysh faktin që në këtë sure janë trajtuar gjerësisht tema të detajuara për luftën me politeistët, në dy ajetet e lartpërmendura aludon në një prej rregullave të tjera të luftës sipas Islamit. Ky është respektimi i muajve të ndaluar.

Në fillim thuhet: **“Vërtet, numri i muajve të All’llahu është dymbëdhjetë, sipas Librit të All’llahut, që prej ditës kur krijoi qiejt dhe Tokën...”**

Përdorimi i shprehjes *“kitabullah” - “Libri i All’llahut”* ka gjasa të tregojë për Kur’anin Fisnik apo Librat e tjerë Qiellorë. Por duke pasur parasysh fjalinë: **“...që prej ditës kur krijoi qiejt dhe Tokën...”** më e përshtatshme është që kjo të jetë në kuptimin e Librit të Krijimit dhe të universit ekzistues.

Sidoqoftë, që nga dita që sistemi diellor e ka marrë formën e tanishme, ka ekzistuar viti dhe muaji. Viti përbëhet nga

rrotullimi i plotë i Tokës rreth Diellit, kurse muaji përbëhet nga një rrotullim i plotë i hënës rreth Tokës, që çdo vit përsëritet dymbëdhjetë herë.

Kjo në realitet është një kalendar natyror plot me vlera dhe është i pandryshueshëm, në mënyrë që jetës së të gjithë njerëzve u jep një sistemim dhe rregull natyror dhe, në këtë mënyrë, përlllogaritjet e tyre historike rregullohen në mënyrë të saktë. Kjo konsiderohet si një prej begatave të mëdha të Zotit ndaj njerëzimit.

Në lidhje me këtë kemi dhënë shpjegime të mjaftueshme në ajetin 189 të sures "El Bekare": **"Të pyesin ty për Hënën e re, thuaj: 'Ato janë përcaktime të kohës për njerëz dhe për Haxh...'"**

Më pas shton: **"Katër prej tyre janë të shenjtë..."**, në mënyrë që në këto muaj është e ndaluar çdo lloj lufte dhe përleshje e armatosur.

Disa nga komentuesit e Kur'anit, ndalimin e luftës përgjatë këtyre katër muajve e shikojnë të vendosur që nga koha e Hazretit Ibrahim (*Paqja qoftë mbi të!*). Edhe në kohën e injorancës, pra, të paganizmit arab, respektohej si një traditë në mesin e tyre, sado që ata ndonjëherë këta muaj i ndryshonin sipas dëshirave dhe tekave të tyre.

Por në Islam, gjithnjë është e qëndrueshme dhe e pandryshueshme, në mënyrë që tre prej këtyre muajve janë të renditur njëri pas tjetrit, pra, muajt Dhilkade, Dhilhixhxe dhe Muharrem, kurse një muaj tjetër është i ndarë dhe ai është muaji Rexheb, siç shprehen edhe arabët, tre muajt "serd" - "njëri pas tjetrit" dhe një muaj "ferd" - "i vetëm".

Është e nevojshme të përmendim edhe këtë fakt, që ndalimi i luftës përgjatë këtyre muajve është atëherë kur myslimanëve nuk

u imponohet lufta nga ana e armikut. Në rast se janë të detyruar, pa asnjë dyshim, duhet të ngrihen në këmbë dhe të mos rrinë duarkryq, sepse respekti ndaj muajit të ndaluar nuk është cunguar nga ana e tyre, por është cunguar nga ana e armikut.¹

Më pas, për theksim shton: “**...sipas besimit të drejtë...**” jo zakonisht të padrejtë, që ekzistonte në mesin e arabëve se, sipas dëshirave apo tekave të tyre, i ndryshonin ato.

Nga disa transmetime² përftohet se ndalimi i luftës gjatë këtyre katër muajve, përveç në fenë e Ibrahimit (*Paqja qoftë mbi të!*), ka ekzistuar edhe në fenë e hebrejve, të krishterëve dhe në fetë e tjera qiellore. Fjalja “**...sipas besimit të drejtë...**” ka gjasa të jetë aludim edhe për këtë çështje, që do të thotë se ka ekzistuar që në fillim të të gjitha fetë, si një ligj i pandryshueshëm.

Më pas shtohet: “**...Prandaj, mos i bëni vetes dëm, duke i shkelur këta muaj!**”

Ndalimi i luftimit përgjatë këtyre katër muajve mund të keqpërdoret nga armiqtë dhe t’u jepte atyre kurajë për të sulmuar myslimanët, prandaj në fjalinë e radhës shtohet: “**Megjithatë, luftoni të gjithë kundër idhujtarëve, ashtu si luftojnë ata të gjithë kundër jush.**”

Kjo fjali ka kuptimin se, edhe pse ata ishin politeistë dhe, si rrjedhojë, idhujtaria e politeizmi janë burimi i përçarjes, ata përsëri luftojnë me ju në një rresht të vetëm (të bashkuar). Ju që jeni monoteistë dhe adhuroni Zotin Një (monoteizmi është fe e

¹ Ashtu siç e kemi dhënë shpjegimin e saj në ajetin 194, të sures “El Bekare”.

² Tefsiri “Burhan”, vëll.2, f. 122; vëll. 2, f. 773, botoi institucioni Bi'thett, Botim i parë, 1415 Hixhri kameri, “Biharul Enuar”, vëll. 24, f. 242 dhe vëll. 36, f. 393-394.

unitetit dhe e bashkimit) jeni më të denjë për të ruajtur unitetin e fjalës përballë armikut, si dhe për të qëndruar në një rresht si një mur prej hekuri (çeliku).

Dhe më në fund thuhet: **“Ta dini se All’llahu është me ata që ruhen nga gjynahet.”**

Në ajetin 37 aludon për një traditë të gabuar të injorancës, pra, në çështjen e “nesiut” - “ndryshimi i vendeve të muajve të ndaluar” dhe thuhet: **“Vërtet, muaji shtesë është vetëm shtesë në mosbesim.”**

Me anë të kësaj vepre, njerëzit jobesimtarë largohen edhe më shumë nga rruga e Zotit: **“Për shkak të tij jobesimtarët shkojnë në humbje”**.

Ata në një vit, muaj të caktuar i konsideronin si të lejuar (për luftë), kurse vitin tjetër, po atë muaj e konsideronin si të ndaluar, në mënyrë që, sipas mendimit të tyre, ta përshtatin me numrin e muajve që ka përcaktuar Zoti. Prandaj thuhet: **“Një vit e quajnë të lejueshëm e vitin tjetër, të ndaluar, për të plotësuar numrin e muajve që i ka ndaluar All’llahu. Kështu, ata lejojnë atë që ka ndaluar All’llahu.”**

Ndërkohë që me anë të këtij veprimi të shëmtuar dhe qesharak, minonin në tërësi filozofinë e ndalimit të muajve të ndaluar dhe urdhrin e Zotit e kthenin në vegël të qejfeve dhe të dëshirave të tyre vetjake. Më i çuditshëm është fakti se nga ky veprim, që ata e kryenin, ndiheshin shumë të kënaqur dhe të gëzuar, sepse **Atyre u duken të bukura veprat e tyre të shëmtuara.**

Ata, me cytjet djallëzore, ashtu siç do të flasim në të ardhmen, i ndryshonin muajt e ndaluar. Më i çuditshëm është

fakti se këtë e quanin si një lloj menaxhimi dhe administrim të jetës, ose përparim të punës në fushën e luftërave dhe të përgatitjeve për luftime. Prandaj thoshin: Stërzgjatja e armëpushimit e cenon aftësinë luftarake, ndaj duhet ndezur një luftë!

Zoti, gjithashtu, ata njerëz që nuk e meritojnë udhëzimin në rrugën e drejtë i lë të lirë në gjendjen e tyre, si dhe heq dorë nga udhëzimi i tyre: **“...All’Ilahu nuk i udhëzon në rrugë të drejtë njerëzit mosbesimtarë.”**

Hulumtime

1- Filozofia e muajve të ndaluar

Ndalimin i luftës gjatë këtyre muajve ishte një prej mënyrave të dhënies fund luftërave me kohë të gjatë, si dhe ishte një mjet për apelim për paqe dhe qetësi, sepse në kohën që luftëtarët, për një periudhë katër mujore, në vit i hedhin anash armët dhe zërat e shpatave apo fishkëllimet e fishekëve, shuhet dhe krijohet mundësia për të menduar dhe për të reflektuar, ka shumë mundësi që lufta të ndërpritej.

Gjithnjë vazhdimësia e një pune ndryshon nga rinisja e saj, pasi për një periudhë kohore kemi hequr dorë nga ajo, dhe e dyta, pra, rinisja e një aktiviteti nga e para është më e vështirë.

Nuk harrojmë se në kohën e luftës njëzet vjeçare në Vietnam me ç’zell përpiqeshin, që të arrinin një armëpushim njëzetekatër orësh me rastin e Vitit të Ri ose të ngjashëm me të.

Ndërkohë Islami, për ndjekësit dhe ithtarët e vet, për çdo vit shpall një armëpushim katër mujor. Vetë kjo është shenjë e shpirtit paqedashës të Islamit.

Por ashtu siç u shprehëm edhe më lart, nëse armiku dëshiron ta keqpërdorë këtë ligj të Islamit dhe të thyejë respektin e muajve të ndaluar, është lejuar luftimi dhe përballja me ta, sipas ligjit të reciprocitetit.

2- Kuptimi dhe filozofia e “nesi’ut” në kohën e paganizmit

Fjala “nesi’i” rrjedh nga fjala “nese” dhe është në kuptimin e vonimit (fjala mund të trajtohet si paskajore) dhe për shitblerjet me shtyrje të pagesës përdoret fjala “nesije”.

Në kohën e paganizmit arab, ndonjëherë e shtynin njërin prej muajve të ndaluar, p.sh. në vend të muajit Muharrem zgjidhnin muajin Sefer dhe riti që e shoqëronte këtë vendimmarrje ishte në këtë mënyrë: Njëri prej udhëheqësve të fisit Beni Kenane, gjatë ritualit të Haxhit, në tokën Mina, në një tubim të madh njerëzish, pas kërkesës së popullit, e artikulonte këtë fjali: “Unë këtë vit e kam shtyrë muajin e Muharremit dhe në vend të tij kam përzgjedhur muajin Sefer!”¹

¹ “Beharul Enuar”, vëll. 9, f. 98, dhe 211; vëll. 22, f. 67; Tefsiri “Ali ibn Ibrahim Kumi”, vëll. 1, f 290, “Darul Kitab”, Kum, 1404 Hixhri kameri; Tefsiri “Es Safi”, vëll. 2, f. 342, “Mektebetu Sadr”, Teheran, Botim i dytë, 1416 Hixhri kameri; “Nuruth Thekalejn”, vëll. 2, f. 217, “Mueseseh ismailijan”, Botim i katërt, 1412 Hixhri kameri.

Gjithashtu, nga Ibn Abbasi është transmetuar se këtë traditë e vendosi Amr ibn Lahij.¹ Disa të tjerë kanë pohuar se ishte Kalmes nga fisi Beni Kenane.²

Filozofia e kësaj vepre, në optikën e tyre, sipas mendimeve të disa dijetarëve, ishte: “Ndonjëherë për ta ishte i vështirë durimi i tre muajve të ndaluar rresht (Dhilkade, Dhilhixhxe dhe Muharrem). Sipas mendimit të tyre, e konsideronin shkak të dobësimit të shpirtit prej luftëtari dhe uljes së rendimentit të forcave të punës, sepse arabët, në kohën e paganizmit, kishin një dashuri të madhe për grabitjen, gjakderdhjen dhe luftën. Parimisht, “lufta dhe grabitja” ishte pjesë e jetës së tyre, kështu që durimi për një armëpushim të njëpasnjëshëm mujor ishte i padurueshëm për ta, si rrjedhojë orvateshin që së paku muajin Muharrem ta ndanin nga muajt e tjerë.

Ndonjëherë muaji Dhilhixhxe përkonte me stinën e verës dhe çështja e Haxhit për ata vështirësohej. Ne e dimë se rituali i Haxhit për arabët paganë nuk ishte vetëm çështje adhurimi, por ky ritual, i cili kishte mbetur si traditë që nga koha e Profetit Ibrahim (*Paqja qoftë mbi të!*), konsiderohej një kongres madhështor, i cili ishte shkak i rritjes së tregtisë dhe të ekonomisë së tyre. Nga ky tubim ata përfitonin dobi të ndryshme, andaj vendin e muajit

¹ “Biharul Enuar”, vëll. 9, f. 98; “Mexhmaul Bejjan”, vëll. 5, f. 53, ajeti në fjalë; “Mueseseh el ilmi lil metbuat”, Bejrut, Botim i parë, 1415 Hixhri kameri.

² “Biharul Enuar”, vëll. 9, f. 98; “Mexhmaul Bejjan”, vëll. 5, f. 53, ajeti në fjalë; “Mueseseh Islamilie lil metebuat”, Bejrut, Botim i parë, 1415 Hixhri kameri; “Xhamiul Bejjan”, vëll. 10, f. 171, “Darul Fikr”, Bejrut, 1415 Hixhri kameri; Tefsiri “Kurtubij”, vëll. 8, f. 137; “Mueseseh El Tarikh El Arabi”, Bejrut, 1405 Hixhri kameri; Tefsiri “Ibn Kethir”, vëll. 2, f. 370, “Darul Mearife”, Bejrut, 1412 Hixhri kameri; “Durrul Menthur”, vëll. 3, f. 237, “Darul Mearife”, Bejrut, Botim i parë, 1365 Hixhri kameri.

Dhilihixhxe e ndryshonin sipas interesave të tyre dhe në vend të tij përcaktonin një muaj tjetër, ku moti të ishte më i përshtatshëm. Ka mundësi që të dyja filozofitë të jenë të sakta.

Por sidoqoftë, kjo vepër u bë shkak që zjarri i luftës të qëndrojë i ndezur dhe filozofia e muajve të ndaluar të minohet, si dhe rituali i Haxhit të kthehet në një lodër në dorën e këtij apo atij, si dhe në një mjet për interesat e tyre materiale.

Kur’ani këtë vepër e ka konsideruar si “shtim në mosbesim”, sepse përveç mosbesimit dhe “mosbesimit në bindje” që ata kishin, me anë të nëpërkëmbjes së këtij urdhri, ata konsuamuan edhe “mosbesimin praktik”, sepse me këtë vepër ata kryenin dy veprime të ndaluara.

Njëri është, të ndaluarën e Zotit e bënin të lejuar dhe tjetra, të lejuarën e Zotit e kishin ndaluar.

3- Uniteti i fjalës përballë armikut

Kur’ani, në ajetet e lartpërmendura, urdhëron që gjatë kohës së luftimit me armikun, myslimanët të luftojnë të bashkuar dhe përballë tyre. Nga ky urdhër përfitohet se edhe luftërat politike, kulturore, ekonomike dhe ushtarake me armikun të harmonizojnë njëri-tjetrin dhe vetëm në sajë të një uniteti të tillë, i cili buron nga shpirti i monoteizmit islam, kanë fuqinë dhe forcën e fitores ndaj armikut.

Ky është po ai urdhër, i cili prej shumë kohësh është lënë në harresë dhe konsiderohet si një prej shkaqeve të dobësimit dhe rënies së myslimanëve.

4- Si u duken të bukura veprat e shëmtuara?

Ndërgjegjja e njeriut, në kohën që është e pastër dhe nuk është prekur nga dora e askujt, është në gjendje të dallojë të mirën nga e keqja. Por në kohën që njeriu, me vetëdije, hedh hapa në rrugën e mëkatit dhe veprave të paligjshme, drita e ndërgjegjes dobësohet dhe bëhet më e zbehtë. Puna arrin deri aty sa ligësia e shëmtimi i mëkatit gradualisht shuhet dhe bëhen të papercptueshëm për ndërgjegjen njerëzore.

Sa herë që vazhdon në të njëjtën mënyrë punën e vet, me kalimin e kohës veprat e këqija në sytë e tij duken të bukura dhe të bukurat të shëmtuara. Kjo është po ajo çështje që u citua në ajetet e lartpërmendura dhe në ajete të tjera të Kur'anit.

Ndonjëherë “zbukurimin e veprave të shëmtuara” Kur’ani ia atribuon djallit, si p.sh në ajetin 63 të sures “En Nahl” thuhet: **“...por veprat e tyre (të këqija) ua hijeshoi djalli...”**¹

Ndonjëherë është përmendur në formën e foljes pësore, si p.sh në ajetin e lartpërmendur, kryefjala e saj ka gjasa të jetë shpirti rebel dhe i pabindur apo cytjet e djallit.

Ndonjëherë i është atribuar “ortakëve”, që do të thotë idhujt, si p.sh. në ajetin 137 të sures “El En’am”.

Gjithashtu ndonjëherë ia ka atribuar Zotit të Madhëruar, si p.sh ajeti 4 i sures “En Naml”: **“E atyre që nuk besojnë Botën e Ardhshme, Ne ua kemi hijeshuar veprat ndaj dhe ata bredhin.”**

¹ Sure “El Enfal”, ajeti 48; Sure “En Nahl”, ajeti 24 dhe sure “Ankebut”, ajeti 38.

Shumë herë e kemi përsëritur që atribuimi i çështjeve të tilla ndaj Zotit është, sepse ato konsiderohen si veçori e veprimit të vet njeriut. Karakteristikat dhe veçoritë e të gjitha sendeve janë në duart e Zotit dhe Ai është “shkaktari i shkakut”. Gjithashtu pohuam se përshkrime të tilla nuk kanë asnjë lloj kundërshtie me çështjen e vullnetit të lirë dhe lirisë së përzgjedhjes së njeriut.

Ajetet 38 - 39

يَأْتِيهَا الَّذِينَ ءَامَنُوا مَا لَكُمْ إِذَا قِيلَ لَكُمْ أَنْفِرُوا فِي سَبِيلِ
 اللَّهُ أَتَأْقَلْتُمْ إِلَى الْأَرْضِ أَرْضَيْتُمْ بِالْحَيَاةِ الدُّنْيَا مِنَ الْآخِرَةِ فَمَا
 مَتَّعُ الْحَيَاةِ الدُّنْيَا فِي الْآخِرَةِ إِلَّا قَلِيلٌ ﴿٣٨﴾ إِلَّا تَنْفِرُوا
 يُعَذِّبْكُمْ عَذَابًا أَلِيمًا وَيَسْتَبْدِلْ قَوْمًا غَيْرَكُمْ وَلَا تَضُرُّوهُ
 شَيْئًا وَاللَّهُ عَلَىٰ كُلِّ شَيْءٍ قَدِيرٌ ﴿٣٩﴾

“O që keni besuar! Çfarë keni që ngurroni e mbërtheheni fort për toke kur ju thuhet: ‘Dilni në luftë, në rrugën e All’Ilahut?! A jeni të kënaqur me jetën e kësaj bote, në vend të së Amshueshmes?! Kënaqësia e kësaj bote, në krahasim me atë të Botës Tjetër, është shumë e vogël.’”

“Nëse nuk shkoni në luftë, Ai do t’ju ndëshkojë me dënim të dhembshëm dhe do t’ju zëvendësojë me një popull tjetër; Atij ju nuk do të mund t’i bëni dëm aspak, se All’Ilahu është i Fuqishëm për çdo gjë.”

Shkaku i zbritjes

Nga Ibn Abbasi dhe të tjerët është transmetuar se ajetet 38-39 flasin për Luftën e Tebukut dhe kanë zbritur në kohën kur Profeti (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ishte kthyer nga Taifi në Medine dhe i përgatiste njerëzit për luftë me Bizantin.

Në transmetimet islame thuhet se Profeti (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), zakonisht, synimet dhe qëllimet reale të tij për luftën nuk ua bënte të qarta myslimanëve përpara fillimit të luftës, që sekretet ushtarake të Islamit të mos binin në duart e armikut. Por në Luftën e Tebukut, meqenëse çështja kishte një formë tjetër, e shpalli në mënyrë të qartë se do të shkonin të luftonin me bizantinët, sepse luftimi me Perandorinë Lindore Romake (me Bizantin) nuk ishte një vepër e thjeshtë, siç ishte lufta me politeistët e Mekës apo me jehudinjtë e Hajberit. Duhej që myslimanët të ishin plotësisht të përgatitur dhe të ishin në nivelin e duhur për këtë betejë të madhe.

Largësia midis Medines dhe tokës së bizantëve ishte shumë e madhe. Përveç kësaj, ishte stina e verës, e të nxehtit të madh dhe e korrjes së prodhimeve dhe drithërave.

Të gjitha këto çështje së bashku e vështirësonin jashtëzakonisht shkuarjen e myslimanëve në sheshin e luftës, saqë disa prej tyre, në përgjigje të ftesës së Profetit (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), shfaqnin lëkundje dhe mëdyshe.

Ndërkohë zbritën ajetet e lartpërmendura dhe me një tonalitet të ashpër dhe qortues Zoti i paralajmëroi myslimanët, dha alarm dhe i përgatiti për këtë betejë të madhe.¹

Komentimi

Sërish lëvizja në drejtim të sheshit të luftës

Ashtu siç e cekëm edhe në shkakun e zbritjes, ajetet 38-39 flasin për ngjarjet e Luftës së Tebukut.

Tebuku është një vend, midis Medines dhe Shamit, që sot konsiderohet kufiri i Hixhazit (Arabisë Saudite). Në atë kohë ishte zona më e afërt e Perandorisë Romake Lindore, e cila kishte nën pushtim Shamin.²

Kjo ngjarje ndodhi në muajin e nëntë hixhri, pra, afërsisht një vit pas ngjarjes së çlirimit të Mekës. Duhet pasur parasysh fakti, se përballja në këtë luftë ishte me një prej shteteve më të fuqishme të botës në atë kohë e jo me një grup të vogël apo të madh arab, grupe të caktuar myslimanësh ishin tmerruar nga përfshirja në një luftë të tillë, andaj ishin tepër të ekspozuar ndaj dashakeqësisë dhe propagandës helmuese të hipokriteve, të cilët, nga ana e tyre, nuk kursenin asnjë përpjekjeje për dobësimin shpirtëror të besimtarëve.

¹ Këtë shkak të zbritjes, në përgjithësi, e kanë përmendur një pjesë e madhe e kometutesve të Kur'anit, si p.sh: Tabrisi në "Mexhmaul Bejjan", vëll. 5, f. 55, "Mueseseh ilmi lil metbuat", Botim i parë, 1415 Hixhri kameri; Fakhr Razi, në tefsirin "Kebir" dhe Alusi në "Ruhul Meani", "Biharul Enuar", vëll. 21, f. 189.

² Largësia mes Tebukut deri në Medine është 610 kilometër, kurse deri në Sham 692 kilometër.

Kishte arritur koha e korrjes së prodhimeve dhe vjeljes së pemëve. Njerëz që jetën e tyre e kishin të lidhur me bujqësinë dhe blegtorinë, këto ditë i konsideronin si ditë fatale, sepse mirëqenia njëvjeçare e tyre lidhej me këto ditë. Largësia dhe nxehtësia, gjithashtu, siç e cekëm, ishin në favor të këtyre faktorëve shtrëngues.

Shpallja hyjnore u erdhi në ndihmë njerëzve dhe zbritën njëri pas tjetrit ajetet kur'anore, duke iu bërë ballë këtyre faktorëve negativë. Në kulmin e këtyre problemeve, Kur'ani i fton me ashpërsi njerëzit në luftë. Nganjëherë u drejtohet me gjuhën e stimulimit, ndonjëherë me gjuhën e qortimit dhe të ndëshkimit dhe ndonjëherë me kërcënim, hyn nga çdo derë, me qëllimin e përgatitjes së tyre për luftë.

Në fillim thuhet: **“O që keni besuar! Çfarë keni që ngurroni e mbërtheheni fort për toke kur ju thuhet: ‘Dilni në luftë, në rrugën e All’Ilahut?!’”**

Fjala *“ethkeltum”* rrjedh nga fjala *“thikl”* dhe është në kuptimin e rëndesës, kurse fjalia **“...e mbërtheheni fort për tokë...”** është aludim për dëshirën për të qëndruar në vendin e tyre dhe të mos shkonin në sheshin e luftës, ose është aluzion i dëshirës për botën materiale dhe të kapurit pas shkëlqimit dhe ndriçimit të kësaj bote. Sidoqoftë kjo ishte gjendja e një grupi myslimanësh me besim të dobët.

Më pas, me një ton qortues, thuhet: **“A jeni të kënaqur me jetën e kësaj bote, në vend të së Amshueshmes?! Kënaqësia e kësaj bote, në krahasim me atë të Botës Tjetër, është shumë e vogël.”**

Si është e mundur që një njeri i zgjuar dhe i dijshtëm të pranojë një ofertë të tillë të dëmshme? Si është e mundur që të humbasë një mall me vlera të jashtëzakonshme dhe të çmueshëm kundrejt një malli të vogël dhe pa vlerë? Më pas çështja bëhet edhe më e theksuar dhe toni i qortimit merr formën e një kërcënimi serioz: **“Nëse nuk shkoni në luftë, Ai do t’ju ndëshkojë me dënim të dhembshëm...”**

Nëse paramendoni se me qëndrimin tuaj anësh dhe kthimit të kurrizit ndaj sheshit të luftës, ecuria e përparimit të Islamit do të ngecë dhe drita e fesë së Zotit do të shuhet, po gaboni shumë rëndë, sepse Ai thotë: **“...dhe do t’ju zëvendësojë me një popull tjetër...”**.

Ky grup ndryshon nga ju nga çdo pikëpamje, jo vetëm nga personaliteti, por edhe nga besimi, nga vullneti, nga guximi. Gjithashtu, edhe bindja e tyre ndryshon nga e juaja.

Me anë të këtij (rebelimi) ju nuk jeni në gjendje t’i shkaktoni as dëmin më të vogël Zotit dhe fesë së pastër të Tij: **“Atij ju nuk do të mund t’i bëni dëm aspak...”**

Ky është një realitet dhe jo një bashkëbisedim imagjinar apo dëshirë e largët dhe e kotë, sepse **“...All’llahu është i Fuqishëm për çdo gjë...”**. Sa herë që vendos në fitoren e fesë së pastër të Tij, do ta realizojë këtë pa negociim dhe pa llafe.

Hulumtime

1- Theksimet e njëpasnjëshme ndaj çështjes së luftës

Në dy ajetet 38-39, çështja e luftës është theksuar në shtatë mënyra apo rrugë:

Së pari, duke iu drejtuar njerëzve besimtarë;

Së dyti, me anë të urdhrit të lëvizjes në drejtim të sheshit të luftës;

Së treti, me anë të shprehjes “për hir të Zotit”;

Së katërti, me anë të pyetjes retorike për ndërrimin e kësaj bote me Ahiretin;

Së pesti, duke kërcënuar me “dënimin e dhembshëm”;

Së gjashti, duke i kërcënuar me këtë, që juve do t’ju zhdukë nga faqja e dheut dhe do t’ju zëvendësojë me një popull tjetër;

Së shtati, duke ua tërhequr vëmendjen ndaj fuqisë së pafundme të Zotit dhe asaj që dobësitë dhe lëkundjet tuaja nuk i shkaktojnë asnjë dëm përparimit dhe ecurisë së punëve, por çdo dëm do t’ju përfshijë vetë juve.

2- Kushtet e luftëtarit të drejtë

Nga ajetet 38-39 përftohet më së miri që varësia e luftëtarëve ndaj jetës së kësaj bote i zmbrops në çështjen e luftës.

Luftëtarët e drejtë duhet të jenë njerëz të devotshëm, të çiltër dhe indiferentë ndaj shkëlqimeve dhe kënaqësive të kësaj bote. Imam Ali bin Hyseni (*Paqja qoftë mbi të!*), në lutjen që bën për

rojet kufitare të shteteve islame, ndër të tjera shprehet: *“O Zoti im! Bëj, ata që kur të ballafaqohen me armikun, ta harrojnë këtë botë mashtruese dhe gënjeshtare! Fshij nga zemrat e tyre kujtimet mbi pasurinë magjepsëse dhe hileqare, në mënyrë që të luftojnë për Ty me një zemër të mbushur nga dashuria Jote!”*¹

Me të vërtetë, nëse kemi njohuri të plotë për gjendjen e këtyre dy botëve dhe mënyrës së të jetuarit në to, arrijmë në përfundimin se kjo botë, në krahasim me Botën Tjetër është aq e kufizuar dhe e pavlerë, sa që nuk krahasohen.

Në një hadith të transmetuar nga Profeti (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) lexojmë: *“Betohem në Zot! Kjo botë, karshi Botës Tjetër është e ngjashme me këtë, që ndonjëri prej jush gishtin e vet e fut në det e më pas e nxjerr atë nga uji dhe shikon sa ujë ka nxjerrë me gishtin.”*²

¹ “Sahifeje Sexhadije”, Lutja 27.

² “Biharul Enuar”, vëll. 70, f. 119; Tefsiri “Es Safi”, vëll. 1, f.e 411, “Mektebetu Sadr”, Teheran, Botim i dytë, 1416 Hixhri kameri; “Durrul Menthur”, vëll. 3, f. 239, “Darul Mearife”, Botim i parë, 1365 Hixhri kameri; “Musned Ahmed”, vëll. 4, f. 229, Bejrut; “Sunen Ibn Maxhe”, vëll. 2, f. 1376, “Darul Fikr” Bejrut; “Sunen Termidhij”, vëll. 3, f. 384, “Darul Fikr”, Bejrut, Botim i dytë, 1404 Hixhri kameri; Tefsiri “Kurtubi”, vëll. 4, f. 320, “Mueseseh el Arabi”, Bejrut, 1405 Hixhri kameri.

Ajeti 40

إِلَّا تَنْصُرُوهُ فَقَدْ نَصَرَهُ اللَّهُ إِذْ أَخْرَجَهُ الَّذِينَ كَفَرُوا ثَانِي
 أَثْنَيْنِ إِذْ هَمَّا فِي الْغَارِ إِذْ يَقُولُ لِصَاحِبِهِ ۚ لَا تَحْزَنْ إِنَّ اللَّهَ
 مَعَنَا فَأَنْزَلَ اللَّهُ سَكِينَتَهُ عَلَيْهِ وَأَيَّدَهُ بِجُنُودٍ لَّمْ تَرَوْهَا
 وَجَعَلَ كَلِمَةَ الَّذِينَ كَفَرُوا السُّفْلَىٰ ۗ وَكَلِمَةُ اللَّهِ هِيَ الْعُلْيَا
 وَاللَّهُ عَزِيزٌ حَكِيمٌ ﴿٤٠﴾

“Nëse ju nuk e ndihmoni atë {Muhammedin (Paqja dhe bekimet e All’lilahu qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)}, All’lilahu tashmë e ka ndihmuar ditën kur atë e dëbuan mohuesit vetë të dytë, kur ishin në shpellë e ai i thoshte shokut të vet: ‘Mos u mërzit, se All’lilahu është vërtet me ne!’ Atëherë, All’lilahu zbriti qetësinë e Vet mbi të, e ndihmoi me një ushtri të padukshme (engjëjsh) dhe bëri që fjala e mosbesimtarëve të jetë më e poshtëruara, kurse fjala e All’lilahu të jetë më e lartësuar. Vërtet, All’lilahu është i Plotfuqishëm dhe i Urtë.”

Komentimi

Zoti i Madhëruar nuk e la vetëm as në çastet më të ndjeshme

Në ajetet e kaluara, ashtu siç edhe u tha, çështja e luftës me armikun ishte diskutuar në disa mënyra, si për shembull, mos mendoni që, nëse ju hiqni dorë nga lufta dhe ndihmesa e Profetit (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), puna e tij dhe Islami do të ngelin peng dhe nuk do të përparojë.

Ajeti në fjalë e ndjek këtë çështje dhe thotë: **“Nëse ju nuk e ndihmoni atë** {Muhammedin (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*)}, **All'Ilahu tashmë e ka ndihmuar...**”

Kjo ishte në kohën kur politeistët e Mekës kishin kurdisur një plan të rrezikshëm për vrasjen e Profetit (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*).

Në ajetin 30 të sures “El Enfal” sqaruam vendimin përfundimtar të tyre, pas përgatitjeve paraprake. Një grup i madh luftëtarësh prej fiseve të ndryshme arabe do ta rrethonin shtëpinë e Profetit (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) gjatë natës deri në agim, një grup prej tyre do ta sulmonin atë, Profetin (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) dhe do ta copëtonin me shpata në shtratin e tij.

Profeti (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ishte vënë në dijeni për këtë ngjarje, me lajmërimin e Zotit, u përgatit që të dilte jashtë Mekës dhe migroi në Medine. Në fillim, me synimin që politeistët e kurejshët të mos e gjenin, u

fsheh në shpellën Theur, e cila ndodhej në Jug të Mekës dhe ishte në anën e kundërt të rrugës për në Medine. Në këtë udhëtim, bashkudhëtar i Profetit (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ishte Ebu Bekri.

Armiqtë u orvatën shumë për të gjetur Profetin (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), por u kthyen të pashpresë dhe të shqetësuar. Profeti qëndroi tre net me radhë në shpellë dhe, pasi u siguria që nuk po e ndiqte armiku, u nis natën në drejtim të Medines nëpër shtigje. Pas shumë ditë e net, arriti në Medine. Kështu filloi një kapitull i ri në historinë islame.

Ajeti 40 rrëfen një prej çasteve më të ndjeshme të këtij udhëtim historik: **“All'llahu tashmë e ka ndihmuar ditën kur atë e dëbuan mohuesit.”**

Sigurisht synimi i politeistëve nuk ishte dëbimi i Profetit (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) nga Meka, sepse ata kishin vendosur që ta mbytnin atë. Por, meqenëse rezultati i veprimit të tyre çoi në largimin e Profetit (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) nga Meka, ky epitete u është dhënë atyre.

Më pas thuhet: **“vetë të dytin...”** Ky grup emëror tregon se bashkudhëtarë i tij në këtë udhëtim ishte vetëm një person. Kjo tregon për vetminë e tij në këtë udhëtim plot me rreziqe. Bashkudhëtar i tij ishte Ebu Bekri: **“...kur ishin në shpellë e ai i thoshte shokut të vet: ‘Mos u mërzit, se All'llahu është vërtet me ne!’ Atëherë, All'llahu zbriti qetësinë e Vet mbi të, e ndihmoi me një ushtri të padukshme (engjëjsh)...”**

Ushtarët e kësaj ushtrie të padukshme ishin engjëjt, të cilët ishin ruajtës dhe mbrojtës të Profetit gjatë këtij udhëtimi të

rrezikshëm dhe të pasigurt, ose ata që nxituan pas tij për t'i ardhur në ndihmë në Luftën e Bedrit apo në Luftën e Huneinit dhe të ngjashëm me to.

Në fund thuhet: "...dhe bëri që fjala e mosbesimtarëve të jetë më e poshtëruara, kurse Fjala e All'Ilahut të jetë më e lartësuar. Vërtet, All'Ilahu është i Plotfuqishëm dhe i Urtë."

Pse të mos jetë kështu, ndërkohë që Zoti, me Urtësinë e Tij, ia tregon rrugët e fitores Profetit (*Paqja dhe bekimet e All'Ilahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) dhe me anë të fuqisë së vet i vjen në ndihmë Atij.

Hulumtime

Tregimi i ndihmësit të shpellës

Çështja e bashkimit të Ebu Bekrit me Profetin (*Paqja dhe bekimet e All'Ilahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) në këtë udhëtim, si dhe citimet e vogla që janë dhënë në ajetin 40 për këtë temë kanë gjetur trajtim të ndryshëm mes komentuesve shia dhe syni dhe kanë ngjallur diskutime të ndryshme.

Disa kanë ndërmarrë rrugën ekstreme dhe disa të tjerë rrugën e mospërfilljes, duke e shpërfillur atë. Fakhri Raziu, në tefsirin e tij, me një fanatizëm të veçantë është orvatur që nga ajeti 40 të miratojë dymbëdhjetë virtyte për Ebu Bekrin dhe, për të shumuar numrin, ka "lidhur qiellin dhe fijen", në mënyrë që, nëse do të ndalonim në përshkrimin e gjithë kësaj, kjo me të vërtetë do të ishte humbje kohe. Disa të tjerë këmbëngulin që nga ajeti 40 të nxjerrim qortime të shumta.

Së pari, duhet të shohim që fjala “sahib” a është argument për virtyt?

Në dukje, nuk është kështu, sepse, për nga pikëpamja leksikore, fjala “sahib” tregon “shoqërim” dhe “bashkudhëtar” pa ndonjë cilësim, qoftë ky shoqërues apo bashkudhëtar i mirë apo i keq. Këtë e lexojmë edhe në ajetin 37 të sures “El Kehf” në tregimin e atyre dy personave, që njëri ishte besimtar dhe adhuronte Zotin, kurse tjetri ishte jobesimtar dhe politeist: **“Atij ai shoku i vet (besimtari) i tha, duke e polemizuar atë: ‘A e mohove Atë që të krijoi ty nga dheu?...’”**

Disa të tjerë, gjithashtu, këmbëngulin që përemri “alejhi” në fjalinë “feenzelell’lalu sekejnetehu alejhi”, **“Atëherë, All’lalu zbriti qetësinë e Vet mbi të...”**, i referohet Ebu Bekrit, sepse Profeti nuk kishte nevojë për qetësi, si rrjedhojë, zbritja e qetësisë nga ana e Zotit ishte për bashkudhëtarin e tij, Ebu Bekrin.

Ndërkohë që, duke pasur parasysh fjalinë pasardhëse, ndër të tjera thuhet **“... uejdedehu bi xhunudi lem tereuha”** - **“e ndihmoi me një ushtri të padukshme (engjëjsh)...”**, si dhe duke pasur parasysh unitetin e referencës së përemrave, bëhet e qartë se përemri “alejhi”, “mbi të”, i referohet Profetit (*Paqja dhe bekimet e All’lallut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*). Është gabim që ne të imagjinojmë se fjala “sekijne” përdoret në rastet e hidhërimit dhe të pikëllimit. Por në Kur’an, në mënyrë të përsëritur lexojmë se “sekijne” ka zbritur mbi Profetin (*Paqja dhe bekimet e All’lallut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) në kohën që gjendej në kushte të vështira.

Në ajetin 26 të po kësaj sureje, për ngjarjen e Luftës së Huneinit lexojmë: **“Pastaj All’lalu zbriti qetësinë e vet në të**

Dërguarin e Tij dhe në besimtarë, zbriti një ushtri që ju nuk e patë...”

Gjithashtu, në ajetin 26 të sures “El Fet’h” lexojmë: “**...po All’Ilahu dhuroi qetësimin e Vet ndaj të Dërguarit të Vet dhe ndaj besimtarëve...**” Ndërkohë që në fjalitë pararendëse në këto dy ajete, në asnjë mënyrë, nuk u fol për hidhërim dhe pikëllim, por diskutimi ishte përqendruar rreth komplikacionit të gjendjes.

Sidoqoftë, ajetet kur’anore bëjnë të qartë se zbritja e qetësisë ndodhte gjatë kohës së problemeve shumë të vështira dhe pa asnjë dyshim, Profeti (*Paqja dhe bekimet e All’Ilahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) në shpellën Theur po kalonte çaste shumë të vështira.

Më i çuditshëm është fakti se disa kanë pohuar që fjalia “**e ndihmoi me një ushtri të padukshme (engjëjsh)...**” i referohet Ebu Bekrit.

Ndërkohë që i gjithë diskutimi i këtij ajeti fokusohet në ndihmën e Zotit ndaj Profetit (*Paqja dhe bekimet e All’Ilahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*). Kur’ani dëshiron të qartësojë se Profeti (*Paqja dhe bekimet e All’Ilahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) nuk ishte i vetëm, edhe nëse të tjerët nuk e ndihmojnë, Zoti do ta ndihmojë atë.

Si është e mundur që kanë anashkaluar personalitetin që e gjithë tema sillet rreth tij dhe të shkojnë pas një njeriu, që përmendet si figurë? Ky diskutim na e bën të qartë që paragjykime të tilla janë bërë pengesë që kuptimit të ajetit t’i tregohet shumë më pak vëmendje.

Ajetet 41 - 42

أَنْفِرُوا خِفَافًا وَثِقَالًا وَجَاهِدُوا بِأَمْوَالِكُمْ وَأَنْفُسِكُمْ فِي
 سَبِيلِ اللَّهِ ذَٰلِكُمْ خَيْرٌ لَّكُمْ إِن كُنْتُمْ تَعْلَمُونَ ﴿٤١﴾ لَوْ كَانَ
 عَرَضًا قَرِيبًا وَسَفَرًا قَاصِدًا لَّاتَّبَعُوكَ وَلَٰكِن بَعُدَتْ عَلَيْهِمُ
 الشُّقَّةُ وَسَيَحْلِفُونَ بِ اللَّهِ لَوْ
 اسْتَطَعْنَا لَحَرَجْنَا مَعَكُمْ
 يُهْلِكُونَ أَنْفُسَهُمْ وَاللَّهُ يَعْلَمُ إِنَّهُمْ لَكَاذِبُونَ ﴿٤٢﴾

“Dilni në luftë, qofshi të shëndoshë ose të sëmurë dhe luftoni me pasurinë e jetën tuaj në rrugën e All’liahut! Kjo është më mirë për ju, veç sikur ta dinit!”

“Sikur fitorja të ishte e afërt dhe udhëtimi i shkurtër, ata do të të pasonin ty. Por iu duk rrugë e largët. Dhe ata do të betohen në All’liahun: ‘Sikur të kishim mundur, me siguri do të dilnim bashkë me ju;’ dhe kështu ata e shkatërrojnë vetveten; All’liahu e di se ata janë gënjeshtarë.”

Komentimi

Konformistët lakmitar

Ashtu siç e thamë edhe më lart, Lufta e Tebukut përbënte një rast të veçantë dhe ishte e shoqëruar me parapërgatitje tejet të vështira. Pikërisht për këtë arsye, një grup njerëzish me besim të dobët apo hipokritë, sillnin justifikime që të largoheshin nga pjesëmarrja në këtë luftë. Në ajetet e kaluara, Zoti i Madhëruar qortoi një grup besimtarësh se, përse në kohën e zbritjes së urdhrit për të luftuar shfaqnin dyzime: “Urdhri i luftës është në dobinë tuaj, në të kundërt, Zoti është në gjendje që në vendin e njerëzve të pavullnetshëm dhe të pazellshëm të vërë njerëz trima, guximtarë dhe të vendosur. Madje edhe pa ndihmën e tyre All’llahu e ruan dhe e mbron të Dërguarin e Tij Muhammedin (*Paqja dhe bekimet e All’llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ashtu siç e ruajti në shpellën Theur dhe në natën kur Imam Aliu fjeti në shtratin e tij, e cila quhet “*Lejletul Mebijt*”.

I çuditshëm është fakti se disa pëlhura merimange, të cilat ishin ngjitur në hyrje të shpellës, u bënë shkak i ndryshimit të mendjes së armiqve kokëfortë dhe kryeneçë, që të kthehen nga hyrja e shpellës, çka e shpëtoi të Dërguarin e Zotit. Atëherë kur Zoti i Madhëruar, me anë të rrjetës së merimangës, është në gjendje të ndryshojë rrugën historike të njerëzimit, çfarë nevojë ka për këtë apo atë njeri, që shfaq shumë naze dhe teka?

Në realitet, të gjitha këto urdhra ishin për përsosjen dhe lartësimin e tyre dhe jo për përmbushjen e nevojave të Zotit. Në

vazhdimësi të këtij diskutimi, edhe një herë tjetër, ajeti i fton, në të gjitha mënyrat, besimtarët për në luftë dhe i qorton mospërfillësit.

Në fillim thotë: **“Dilni në luftë, qofshi të shëndoshë ose të sëmurë...”**

Fjala *“khifaf”* është shumësi i fjalës *“khafif”*, kurse fjala *“thikal”* është shumësi i fjalës *“thakil”*. Këto dy fjalë kanë një kuptim gjithëpërfshirës, që përfshin të gjitha gjendjet e njeriut, qofshin të rinj apo të vjetër, të martuar apo të pamartuar, me familje të vogël apo familje të madhe, të pasur apo të varfër, të sëmurë apo të shëndoshë.

Në secilën gjendje dhe në çdo lloj pozite qofshi, jeni të detyruar që, kur të jepet një urdhër nga ana e Zotit, duhet t'i përgjigjeni thirrjes së Tij, duhet të lini të gjitha punët, të armatoseni dhe të niseni në drejtim të fushëbetejës.

Përsa i përket asaj, që disa nga komentuesit e Kur'anit këto dy shprehje i kanë kufizuar vetëm në njërën prej kuptimeve të lartpërmendura, ata nuk kanë asnjë argument për këtë, përkundrazi, secila prej kuptimeve të lartpërmendura mbart në vetvete një prej shumësisë së këtij kuptimi të gjerë.

Më pas shton: **“dhe luftoni me pasurinë e jetën tuaj në rrugën e All'Ilahut!”**, që do të thotë një luftë e gjithanshme dhe gjithëpërfshirëse, sepse ndodheshin përballë një armiku të fuqishëm dhe të fortë, që konsiderohej prej fuqive më të mëdha të asaj kohe dhe pa të nuk ishte e mundur fitorja.

Por që ndonjë të mos e ngatërrojë dhe të mos gabojë, që këto sakrifica janë në dobi të Zotit, Ai thotë: **“...Kjo është më mirë për ju, veç sikur ta dinit!”** Kjo do të thotë se, sikur ta dinit, që lufta është çelësi i krenarisë, i lumturisë, i eliminimit të dobësisë

dhe i nënçmimit, sikur ta dinit që asnjë popull, pa luftuar, në këtë botë nuk do të arrijë lirinë dhe drejtësinë e vërtetë; sikur ta dinit se rruga që të çon te kënaqësia e Zotit, në këtë botë dhe lumturia e përhershme, si dhe lloje të ndryshme të begative dhe të mirësive hyjnore qëndron në këtë përpjekje të shenjtë, të përbashkët. Atëherë ju do të arrini të kuptoni se lufta është në të mirën tuaj.

Më pas u referohet njerëzve përtacë, dembelë dhe me besim të dobët, që, për të mos marrë pjesë në këtë luftë, sillnin lloj-lloj justifikimesh, Ai i drejtohet Profetit (*Paqja dhe bekimet e All'Ilahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) në këtë mënyrë: **“Sikur fitorja të ishte e afërt dhe udhëtimi i shkurtër, ata do të të pasonin ty.¹ Por iu duk rrugë e largët...”²**

I çuditshëm është fakti se ata nuk mjaftohen vetëm me justifikime dhe përligjje, por: **“... Dhe ata do të betohen në All'Ilahun: ‘Sikur të kishim mundur, me siguri do të dilnim bashkë me ju;...”**”

Nëse e vëreni, ne nuk marrim pjesë në këtë luftë. Kjo është për shkak të pamundësisë, të pafuqisë dhe të sëmundjes: **“...dhe kështu ata e shkatërrojnë vetveten; All'Ilahu e di se ata janë gënjeshtarë.”**

Janë plotësisht të aftë dhe të fuqishëm, por meqenëse nuk është një sofër e yndyrshme dhe e lakmueshme, në të ardhmen i

¹ Fjala “*eredh*” është në kuptimin e një gjëje aksidentale, që zhduket shpejt dhe nuk ka vazhdimësi dhe as nuk mbetet. Zakonisht përdoret për të mirat e kësaj bote, kurse fjala “*kasid*” është në kuptimin e lehtësimit dhe të mirëqenies, sepse, në thelb, rrjedh nga rrënja “*kasd*” dhe njerëzit e zakonshëm synimin e tyre ia kushtojnë çështjeve të lehta.

² Fjala “*shukke*” është në kuptimin e tokave dhe të vendeve shkëmbore apo të rrugëve të pjerrëta dhe plot kthesa, që kalimi në to është i shoqëruar me vështirësi dhe probleme.

pret një program i rëndë dhe i vështirë, mbështeten në betime të rrejshme.

Kjo çështje nuk i përket vetëm Luftës së Tebukut apo kohës së Profetit (*Paqja dhe bekimet e All'Ilahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), por në çdo shoqëri ekzistojnë grupe njerëzish dembelë, të pafuqishëm, përtacë, hipokritë, lakmitarë dhe oportunistë, që gjithnjë janë në pritje të momentit të fitores dhe futen në rreshtin e parë, bërtasin dhe brohorasin dhe e prezantojnë veten si luftëtarët më të mirë, ensarët dhe emigruesit e parë, si dhe njerëzit më të dhembshur, në mënyrë që, pa asnjë mundim, të përfitojnë nga frytet e fitores së të tjerëve.

Por po ky grup pseudoluftëtarësh dhe trima të dhembshur, gjatë përbaljes me ngjarje të rrezikshme dhe me vështirësitë, arratisen në një drejtim të caktuar dhe, për të shfajësuar veten nga largimi dhe arratisja, sajojnë justifikime dhe alibi:

Njëri është i sëmurë;

Tjetrit, fëmija i është shtruar në spital;

I treti, familjen e tij e ka kapluar skamja dhe varfëria;

I katërti, ka probleme me shikimin,

I pesti, është i zënë me sigurimin e kushteve jetësore dhe kështu me radhë....

Por për njerëzit e zgjuar dhe udhëheqësit, është e nevojshme që këtë grup njerëzish ta njohin që në fillim dhe nëse nuk ndryshojnë, t'i largojnë nga rreshtat e tyre.

Ajetet 43 - 45

عَفَا اللَّهُ عَنْكَ لِمَ أَذِنَتْ لَهُمْ حَتَّىٰ يَتَّبِعَنَّ لَكَ أَلَّذِينَ صَدَقُوا
 وَتَعَلَّمَ الْكَاذِبِينَ ﴿٤٣﴾ لَا يَسْتَعِذُّكَ الَّذِينَ يُؤْمِنُونَ بِاللَّهِ وَالْيَوْمِ
 الْآخِرِ أَنْ يُجَاهِدُوا بِأَمْوَالِهِمْ وَأَنْفُسِهِمْ ۗ وَاللَّهُ عَلِيمٌ بِالْمُتَّقِينَ
 ﴿٤٤﴾ إِنَّمَا يَسْتَعِذُّكَ الَّذِينَ لَا يُؤْمِنُونَ بِاللَّهِ وَالْيَوْمِ الْآخِرِ
 وَأَرْتَابَتْ قُلُوبُهُمْ فَهُمْ فِي رَيْبِهِمْ يَتَرَدَّدُونَ ﴿٤٥﴾

“All’lahu të fal ty që u lejove atyre të mungojnë, para se ta kuptoje se kush të flet të vërtetën dhe derisa t’i njihje gënjeshtarët.”

“Nuk do të të kërkojnë leje për të mos luftuar me pasurinë dhe jetën e tyre, ata që besojnë në All’lahun dhe Ditën e Kiametit. E All’lahu i di mirë ata që ruhen nga gjynahet.”

“Ty do të kërkojnë leje vetëm ata që nuk besojnë në All’lahun dhe Ditën e Kiametit dhe që zemrat e tyre dyshojnë. Ata luhaten në dyshimin e vet.”

Komentimi

Përpigu të njohësh hipokritët

Nga ajetet 43-45 përftohet që një grup hipokritësh shkuan pranë Profetit (*Paqja dhe bekimet e All'lahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*). Pasi sollën justifikime të shumta, madje edhe u betuan, kërkuan leje nga Profeti, për të mos marrë pjesë në Luftën e Tebukut. Profeti (*Paqja dhe bekimet e All'lahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) u dha leje atyre.

Zoti i Madhëruar, në ajetin 43, i thotë Profetit (*Paqja dhe bekimet e All'lahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*): **“All'lahu të fal ty që u lejove atyre të mungojnë...”**

Por përse nuk la të dallohen ata që e thonë të vërtetën nga ata që nuk e thonë të vërtetën? **“Para se ta kuptoje se kush të flet të vërtetën dhe derisa t'i njihje gënjeshtarët.”**

Në lidhje me këtë, që a është qortimi i lartpërmendur, i shoqëruar me shpalljen e faljes së Zotit, argument për atë që lejimi i Profetit (*Paqja dhe bekimet e All'lahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ishte një vepër e gabuar, apo vetëm “lënie pas dore e veprës së preferuar” apo nuk ishte asnjëra prej tyre, është çështje diskutimi në mesin e komentuesve të Kur'anit.

Disa prej tyre kanë nxituar aq shumë, madje me plot guxim dhe në mënyrë të paturpshme kanë thënë që ajeti 43 është argument për mundësinë e kryerjes së mëkatit nga ana e Profetit

(Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!).¹

Ata madje nuk kanë zbatuar as mirësjelljen që ka treguar Zoti në këtë shprehje ndaj Profetit, që në fillim ka folur për “faljen” dhe më pas për “qortimin” dhe kanë rënë në devijim të rëndë.

E drejta është kjo: Në këtë ajet, madje në pamje të jashtme, nuk ekziston asnjë argument për kryerjen e mëkatit nga ana e Profetit (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), sepse, në bazë të të gjithë dëshmive, bëhet e qartë se, qoftë me lejen e Profetit, qoftë pa lejen e tij, ky grup hipokrit sërish nuk do të merrte pjesë në Luftën e Tebukut. Nëse supozojmë që do të merrnin pjesë, jo vetëm që do t'u shkaktonin probleme myslimanëve, por madje problemeve të tyre do t'u shtohesh dhe një problem tjetër. Këtë do ta përmendim në disa ajete në vijim. Zoti i Madhëruar ishte i rezervuar ndaj dërgimit të tyre në frontin e luftës, sepse, nëse do të merrnin pjesë, do të ndikonin negativisht: **“Edhe sikur të dilnin me ju, ata nuk do t’ju shtonin tjetër pos ngatërresës dhe shumë shpejt do të përçanin mesin tuaj duke kërkuar t’ju turbullojnë...”²**

Si rrjedhojë, me lejen e Profetit (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) nuk u cenua asnjë lloj interesi prej myslimanëve. E vetmja gjë që ekzistonte në këtë mes ishte se, nëse Profeti (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) nuk do t'u jepte leje atyre, grushti i tyre do të hapej me të shpejtë (do të nxirrnin jashtë atë që fshihnin në brendësi) dhe në këtë mënyrë njerëzit do të njiheshin më shpejt me identitetin e tyre të vërtetë.

¹ “Biharul Enuar”, vëll. 17, f. 45; Po aty, vëll. 34, f. 384.

² Sure “Et Teube”, ajeti 47.

Por kjo çështje nuk ishte e atillë, që mosrealizimi i saj të bëhet shkak i mëkatit. Mbase asaj mund t'i thuhet se ka qenë "lënie pas dore e veprës së preferuar", me këtë kuptim që dhënia e lejes nga ana e Profetit, në kushte të tilla dhe karshi betimeve dhe këmbënguljeve të hipokritëve, nuk konsiderohej si një vepër aq e keqe, por mosdhënia e lejes ishte më e mirë se ajo, në mënyrë që ky grup të zbulohej më shpejt.

Në komentimin e këtij ajeti ekziston edhe kjo mundësi, që qortimi dhe tërheqja e vëmendjes, në rastin konkret, kishte moment figurativ dhe nuk bëhet fjalë madje për "lënien pas dore të veprës së preferuar", por thjesht synimi ishte sqarimi i shpirtit hipokrit dhe të pasinqertë e tyre, me një shpjegim tërheqës, në dukje qortues.

Këtë çështje mund ta bëjmë më të qartë me anë të një shembulli: Imagjinoni sikur një njeri bastard dëshiron të gjuajë me shpullë në faqe fëmijën tuaj. Një prej shokëve tuaj e ndalon atë, duke ia kapur dorën. Ju, jo vetëm që nga kjo vepër nuk do të ndiheni të shqetësuar dhe të brengosur, por madje do të gëzoheni dhe do të ndiheni të lumtur. Kurse, për sa i përket vërtetimit të shpirtit prej bastardi të palës tjetër, në mënyrë qortuese i ktheheni shokut tuaj, duke i thënë: "Përse nuk e lejove që ta gjuante me shpullë, në mënyrë që të gjithë njerëzit ta njohin këtë njeri bastard dhe të pashpirt?!" Synimi juaj nga ky sqarim është vetëm vërtetimi i pashpirtësisë dhe i hipokrizisë së tij, që është shfaqur në petkun e qortimit ndaj shokut përkrahës. Çështja tjetër, që të tërheq vëmendjen në komentimin e këtij ajeti, është se a nuk i njihite vallë Profeti dyfytyrëshit, që Zoti po thotë: **"...u lejove atyre të mungojnë, para se ta kuptojë se kush të flet të vërtetën dhe derisa t'i njihje gënjeshtarët."**

Në përgjigje të kësaj pyetjeje duhet thënë:

Së pari, Profeti (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) nuk kishte njohuri për gjendjen e këtij grupi nëpërmjet dijes së zakonshme dhe dituria e fshehtë nuk është e mjaftueshme për gjykimin e çështjeve të tilla, por gjendja e tyre duhet të bëhet e qartë me anë të dëshmimeve të zakonshme.

Së dyti, synimi nuk ishte të tregonte padijen e Profetit (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), por që të gjithë myslimanët të informoheshin, edhe pse ajeti i drejtohet Profetit (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*).

Më pas ka përshkruar një prej shenjave të hipokritëve dhe besimtarëve: **“Nuk do të të kërkojnë leje për të mos luftuar me pasurinë dhe jetën e tyre, ata që besojnë All'llahun dhe në Ditën e Kiametit...”**

Ata, në kohën që Zotit dha urdhër për të luftuar, nxitonin pas saj, pa ngurruar dhe pa sjellë ndonjë justifikim. Në thelb ishte besimi i tyre në një Zot dhe përgjegjësitë e tyre karshi Tij, besimi në Ditën e Kiametit, që i fton ata në këtë rrugë dhe ua mbyll rrugët e justifikimit dhe të sajimit të pretendimeve.

Në fund thuhet: **“E All'llahu i di mirë ata që ruhen nga gjynahet.”**

Në ajetin 45 thuhet: **“Ty do të kërkojnë leje vetëm ata që nuk besojnë në All'llahun dhe Ditën e Kiametit...”**

Më pas, për ta theksuar mosbesimin e tyre, thotë: **“dhe që zemrat e tyre dyshojnë. Ata luhaten në dyshimin e vet.”**

Pikërisht për këtë arsye, duke qenë peng të dyshimit dhe të luhatjes së tyre, ndonjëherë hedhin hapa para, ndonjëherë tërhiqen prapa dhe gjithnjë janë në mëdyshje dhe të përhumbur: **“Ata luhaten në dyshimin e vet.”** Prandaj, për këtë arsye, janë në pritje të gjetjes së justifikimeve dhe të kërkimit të lejes nga Profeti (*Paqja dhe bekimet e All'Ilahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*).

Edhe pse cilësitë e lartpërmendura janë përmendur në formën e kohës së tashme, synimi i saj është përmendja e cilësive dhe e tipareve të hipokritëve e besimtarëve, kurse koha e shkuar, e tashme dhe e ardhme nuk ndryshon te ata.

Besimtarët, nën ndriçimin e besimit të tyre, kanë një vendim dhe vullnet të fortë dhe të pathyeshëm, rrugën e tyre e vërejnë më së miri, objektivat e tyre janë të qarta, synimi i tyre është i përcaktuar, andaj ndër marrin rrugën me hapa të sigurt dhe të qëndrueshëm pa asnjë dyshim dhe luhate.

Kurse hipokritët, meqenëse synimi i tyre është i errët dhe i paqartë, ndihen të hutuar dhe në mëdyshje dhe gjithnjë justifikohen, vetëm me synimin që të largohen nga barra e përgjegjësisë.

Këto dy shenja dhe karakteristika nuk i përkasin vetëm “besimtarëve” dhe “hipokritëve” të periudhës së hershme të Islamit apo Luftës së Tebukut, por edhe sot, në ditët tona, me anë të këtyre dy veçorive dhe karakteristikave, jemi në gjendje të përcaktojmë dhe t'i dallojmë “besimtarët e vërtetë” nga “pretenduesit gënjeshtarë”. Besimtari është i guximshëm dhe i vendosur, kurse hipokriti është në mëdyshje, në lëkundje, frikacak, i hutuar dhe sajues justifikimesh.

Ajetet 46 - 48

﴿وَلَوْ أَرَادُوا الْخُرُوجَ لَأَعَدُّوا لَهُ عُدَّةً وَلَكِنْ كَرِهَ اللَّهُ
 أَنْبِعَانَّهُمْ فَثَبَّطَهُمْ وَقِيلَ اقْعُدُوا مَعَ الْقَاعِدِينَ ﴿٤٦﴾ لَوْ خَرَجُوا
 فِيكُمْ مَا زَادُوكُمْ إِلَّا خَبَالًا وَلَا أُضْعَوُا خِلَالَكُمْ يَبْغُونَكُمُ
 الْفِتْنَةَ وَفِيكُمْ سَمْعُونُ لَهْمٌ وَ اللَّهُ عَلِيمٌ بِالظَّالِمِينَ ﴿٤٧﴾ لَقَدْ
 ابْتَغَوْا الْفِتْنَةَ مِنْ قَبْلُ وَقَلَّبُوا لَكَ الْأُمُورَ حَتَّى جَاءَ الْحَقُّ
 وَظَهَرَ أَمْرُ اللَّهِ وَهُمْ كَارِهُونَ ﴿٤٨﴾

“Sikur ata të kishin dashur të dilnin me ty, do të ishin përgatitur; por All’Ilahu nuk e pëlqeu vajtjen e tyre, prandaj i pengoi dhe atyre u tha: ‘Rrini me ata (të paaftë për luftë) që do të ulen (në shtëpi)!”

“Sikur të kishin dalë me ju, ata do t’ju shtonin juve vetëm të keqe, do të shtinin ngatërresa midis jush dhe do të ngjallnin përçarje, sepse edhe ndër ju ka nga ata që ua vënë veshin. Por All’Ilahu i njeh mirë keqbërësit.”

“Ata edhe më parë përpiqeshin të të nxirrnin ngatërresa dhe t’i pështjellonin punët e tua, derisa erdhi e Vërteta (fitorja) dhe u tregua e qartë feja e All’Ilahut, gjë që ata e urrenin.”

Komentimi

Mosekzistenca e tyre është më mirë se prania e tyre

Në ajetin 46, Kur'ani përmend një prej shenjave të tjera të mossinqeritetit dhe të gënjeshtërsisë së hipokritëve, duke plotësuar temën e lartpërmendur në ajetin: **“All’lahu e di se ata janë gënjeshtarë.”**¹

Nëse këta e thonë të vërtetën, do të ishin të gatshëm të merrnin pjesë në luftë dhe janë në pritje vetëm të lejes tënde, duhej të kishin përgatitur të gjitha mjetet e nevojshme për luftë, përfshirë këtu armët, kuajt (për hipje) dhe çdo gjë që kishin në dorë dhe mundësi. Prandaj në Kur’an thuhet: **“Sikur ata të kishin dashur të dilnin me ty, do të ishin përgatitur.”** Ndërkohë te ata nuk u vërejt asnjë shenjë parapërgatitje dhe dëshirë për luftë.

Dhe shton, janë po këta njerëz, me zemër të errët dhe pa besim, që Zoti ndien urrejtje dhe pakënaqësi nga pjesëmarrja e tyre në këtë luftë plot krenari: **“...por All’lahu nuk e pëlqeu vajtjen e tyre...”**, andaj ua ka privuar atyre mirësinë e Vet dhe i ka parandaluar ata nga lëvizja. Atyre u është thënë: **“...prandaj i pengoi dhe atyre iu tha: ‘Rrini me ata (të paaftë për luftë) që do të ulen (në shtëpi)!’”**²

Në lidhje me këtë, kush është folësi i frazave të fundit? A është Zoti? A është Profeti? Apo shpirti dhe brendësia e vetë atyre? Në mesin e komentuesve të Kur’anit ka mosmarrëveshje.

¹ Ajeti 42.

² Fjala *“thebetehum”* rrjedh nga fjala *“tethbijt”* dhe është në kuptimin e parandalimit dhe të pengesës së kryerjes së një pune.

Në pamje të parë, duket se ky është një urdhër natyror, që lind nga brendësia dhe shpirti i tyre i papastër dhe i errët, si dhe është kërkesë e bindjeve të tyre të degjeneruara dhe e veprave të tyre të këqija. Kjo gjë vërehet shumë shpesh, që kërkesat e brendësisë i nxjerrin në formën e ndalimit apo të urdhëresës.

Nga ajeti i lartpërmendur përftohet më së miri, se çdo punë dhe çdo synim ka kërkesën e vet, që, me dashje a pa dashje, e prek njeriun. Pikërisht për këtë arsye, të gjithë njerëzit nuk janë të denjë dhe nuk e meritojnë të kryejnë vepra të rëndësishme dhe të ecin në rrugën e Zotit, sepse këtë meritë dhe bekim, Zoti ia dhuron njerëzve që kanë zemër të pastër, synim të çiltër dhe gatishmëri e sinqeritet.

Në ajetin 47 tregon faktin se mospjesëmarrja e njerëzve të tillë në frontin e luftës, jo vetëm që nuk është për të ardhur keq, por ndoshta është për t'u përshëndetur, sepse ata jo vetëm që nuk zgjidhin ndonjë problem, por, me atë shpirt hipokrizie, mosbesimi dhe degjenerimi moral, do të bëheshin shkak për shtimin e problemeve.

Ky ajet, në fakt, u jep një mësim të madh myslimanëve, që asnjëherë të mos mendojnë për shtimin ekstensiv të ushtrisë, për sasinë dhe numrin e madh, por të mendojnë për të zgjedhur njerëz të sinqertë dhe besimtarë, sado që numri i tyre të jetë i vogël. Ky ishte një mësim për myslimanët e kaluar, është një mësim për myslimanët e sotëm dhe do të jetë një mësim për myslimanët e ardhshëm.

Në fillim thuhet: **“Sikur të kishin dalë me ju, ata do t’ju shtonin juve vetëm të keqe...”**

Fjala “*khabajl*” është në kuptimin e dyshimit dhe të ankthit. Fjala “*khabel*” është në kuptimin e “çmendurisë”, kurse fjala “*khabl*” në kuptimin e prishjes së gjymtyrëve. Si rrjedhojë, prania e tyre me atë shpirt të prishur, të shoqëruar me lajthitje, hipokrizi dhe lëkundje nuk ka lidhje tjetër përpos krijimit të mëdyshjes, luhatjes dhe shkaktimit të defektit në mesin e ushtrisë islame.

Përveç kësaj, ata orvaten me nxitim që, në mesin e ushtarëve, të krijojnë përçarje, hipokrizi dhe ngatërresa: “**...do të shtinin ngatërresa midis jush dhe do të ngjallnin përçarje...**”¹

Më pas i paralajmëron myslimanët të kenë kujdes: “**...sepse edhe ndër ju ka nga ata që ua vënë veshin. Por All’lillahu i njeh mirë keqbërësit.**”

Fjala “*semma*” është në kuptimin e personit, i cili është prirur për të dëgjuar, për të ndikuar dhe pranon çdo sugjerim, pa studiuar dhe pa treguar vëmendjen e nevojshme.

Si rrjedhojë, detyra e myslimanëve me besim të palëkundshëm është të kujdesen për këtë grup të dobët, në mënyrë që të mos bien në kurthin e hipokritëve dhelparakë.

Ekziston edhe kjo mundësi, që fjala “*semma*” të jetë në kuptimin e spiunimit dhe të thashethemeve, që do të thotë se në mesin tuaj ekziston një grup njerëzish që spiunojnë për grupin hipokrit.

Dhe në fund të ajetit thuhet: “**Por All’lillahu i njeh mirë keqbërësit...**”

¹ Fjala “*euḍau*” rrjedh nga fjala “*el idau*” është në kuptimin e nxitimit në lëvizje. Këtu është në kuptimin e nxitimit, në ndikimin e myslimanëve, kurse fjala “*fitne*” këtu është në kuptimin e përçarjes dhe të mosmarrëveshjes.

Ata që i bëjnë keq vetes së tyre apo shoqërisë ku ata jetojnë, qoftë hapur apo fshehur, nuk janë të fshehtë nga dija e All'llahut. Dhe në ajetin e fundit e paralajmëron Profetin (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) se kjo nuk është hera e parë, që ky grup hipokrit merret me agitacion helmues dhe shkatërrim. Duhet të rikujtosh që ata edhe në të kaluarën kryen vepra të tilla, edhe tani shfrytëzojnë çdo mundësi për t'ia arritur synimit: **“Ata edhe më parë përpiqeshin të të nxirrnin ngatërresa.”**

Ky është një referim ndaj Luftës së Uhudit, ku Abdullah ibn Ubeje dhe shokët e tij u kthyen në mes të rrugës dhe hoqën dorë nga ndihmesa e Profetit (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*); ose është aludim për raste të tjera, ku thurën kurthe kundër vetë Profetit (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), apo njerëz prej myslimanëve. Historia e Islamit i ka shënuar ato.

Më pas shton: **“dhe t'i pësjtjellonin punët e tua...”**

Bënë plane të ndryshme, që të krijojnë përçarje brenda myslimanëve, t'i pengojnë nga lufta, që rrethi Yt të mbetet i boshatisur. Por asnjëra nga këto kurthe dhe përpjekje nuk ia arritën qëllimit.

Të gjitha planet e tyre u bënë hi e pluhur, si dhe shigjeta e tyre u përplas me shkëmbinj: **“...derisa erdhi e Vërteta (fitorja) dhe u tregua e qartë feja e All'llahut, gjë që ata e urrenin.”**

Por dëshira dhe vullneti i krijesave nuk mund të ketë asnjë ndikim karshi vullnetit dhe shpalljes së Zotit. Zoti deshi që Ti të jesh fitues, feja jote të përhapet në krejt botën, duke hequr prej rruge pengesat, pavarësisht llojit të tyre. Më në fund e realizoi

këtë gjë, por çështja e rëndësishme është fakti që të jemi të vetëdijshëm se ajo që u shpreh në ajetet e lartpërmendura, sikur temat e tjera kur'anore nuk janë specifike për kohën dhe periudhën e Profetit (*Paqja dhe bekimet e All'Ilahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), sepse në çdo shoqëri gjithnjë ekzistojnë grupe hipokrite, që përpiqen në momentet vendimtare dhe fatale me anë të propagandës helmuese dhe thashethemeve t'i ngatërrojnë mendimet e njerëzve, të zhdukin frymën e unitetit dhe ta mbjellin farën e dyshimit dhe luhatje në mendimet e njerëzve.

Por nëse shoqëria është e zgjuar, nuk ka dyshim se, me anë të ndihmës së Zotit, i cili i ka premtuar shokëve të tij fitoren, të gjitha thurjet dhe sajesat e tyre do të çaktivizohen dhe kurthet e tyre do të shuhen që në zanafillë, me kushtin që të luftojnë me cilësinë e duhur dhe me anë të mendjelehtësisë dhe të vigjilencës, duke pasur kujdes armiqtë e brendshëm.

Ajeti 49

وَمِنْهُمْ مَّنْ يَقُولُ أَسْأَلُ اللَّهَ بِمَا بَدَأْتَنِي وَلَا تَفْتِنِّي ۗ أَلَا فِي الْفِتْنَةِ سَقَطُوا
وَإِنَّ جَهَنَّمَ لَمُحِيطَةٌ بِالْكَافِرِينَ ﴿٤٩﴾

“Disa prej atyre (hipokritëve) thonë: ‘Më lejo (të mungoj në luftë) dhe mos më vër në sprovë!’ Ja, ata ranë pikërisht në sprovë. Me të vërtetë, Xhehennemi i përfshin mohuesit.”

Shkaku i zbritjes

Një grup prej komentuesve të Kur'anit kanë cituar kohën kur Profeti (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) i përgatiste myslimanët për Luftën e Tebukut dhe bënte thirrje për të lëvizur.

Një nga prijësit e fisit beni Selemeh, Xhed bin Kais, që bënte pjesë te hipokritët, erdhi pranë Profetit (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) dhe tha: “Nëse më lejon, unë nuk dua të marr pjesë në këtë luftë, sepse kam një dobësi të madhe për gratë. Nëse shikimi im bie mbi vajzat romake, atëherë ka gjasa që zemra ime të zbutet dhe të dashurohem me to dhe të heq dorë na luftimi.”

I Dërguari (*Paqja dhe bekimet e All'lahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) i dha leje. Këtu zbriti ajeti 49 dhe e dënoi veprën e këtij personi. Profeti iu drejtua një grupi prej fisit beni Selemeh: *"Kush është prijësi juaj?"*

Ata iu përgjigjen: *"Xhed bin Kais. Por ai është një njeri koprrac dhe frikacak."*

Profeti (*Paqja dhe bekimet e All'lahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) u tha: *"A ka ndonjë lajthitje më të madhe se lajthitja e koprracisë? Prijësi juaj është ky djalë i pashëm, Bishr bin Berrae (që ishte njeri bujar dhe zemërgjerë)."*¹

Komentimi

Hipokritët sjellin justifikime

Shkaku i zbritjes së përmendur, tregon: Njeriu, kur dëshiron të shpëtojë veten e tij nga përgjegjësia, sajon çdo gjë, justifikime koti. Ashtu ishte dhe alibia që hipokriti Xhed bin Kaisi e paraqiti për të mos marrë pjesë në luftë. Kjo thënie e Xhed bin Kaisit më kujton shprehjen e përdorur prej njërit nga autoritetet shtypës të regjimit të Shahut të Iranit, i cili thoshte: *"Nëse nuk i vëmë njerëzit nën presion, rrogat që i marrin, na obligojnë me përgjegjësi fetare."*, domethënë për të shpëtuar nga kjo përgjegjësi, duhet të bëjmë padrejtësi dhe t'i shtypim njerëzit.

¹ "Biharul Enuar", vëll. 21, f. 193, 212-213. Tefsiri "Ali bin Ibrahim Kumi", vëll.1, f. 291-292, botoi "Mueseseh darul kitab Kum", 1404 Hixhri kameri.

Sidoqoftë, Kur'ani, në rastin konkret, i drejtohet Profetit (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) dhe në përgjigje të njerëzve justifikues dhe të kompromentuar thotë: **“Disa prej atyre (hipokritëve) thonë: ‘Më lejo (të mungoj në luftë) dhe mos më vër në sprovë!’”**

Është shprehur edhe kjo mundësi në komentim, shkakun e zbritjes së ajetit, që ky prijës Xhed bin Kaisi kërkonte të largohej nga lufta, me justifikimin e bashkëshortes, fëmijëve dhe mallrave që do të mbeteshin pa mbikëqyrës.

Por pavarësisht kësaj, Kur'ani, në përgjigjen ndaj tij, thotë: **“Ja, ata ranë pikërisht në sprovë. Me të vërtetë, Xhehennemi i përfshin mohuesit.”**

Domethënë, ata mbështeten te alibia dhe përdorin justifikime të kota. Ka mundësi, që në të ardhmen të përlyhen me mëkat dhe Xhehennemi i ka rrethuar nga të gjitha anët. Ata e shkelin urdhrin e qartë të Zotit e të Profetit të Tij rreth nisjes për në luftë, duke e përligjur me imagjinatën për mospërputhje fetare.

Hulumtime

1- Një mënyrë për njohjen e hipokritit

Një nga mënyrat e njohjes së grupit të hipokritëve, në secilën shoqëri, është fokusimi mbi mënyrën e argumentimit dhe justifikimet që sjellin për t'i ikur kryerjes së detyrave të domosdoshme. Modeli i këtyre justifikimeve e tregon qartë anën e brendshme të tyre. Ata zakonisht kërkojnë mbështetje te një mori çështjesh të kufizuara, të parëndësishme dhe ndonjëherë

qesharake, për të shpërfillur çështjet e rëndësishme dhe të përgjithshme, me qëllim që të mashtrojnë njerëzit besimtarë.

Sipas përfytyrimit të tyre, e përdorin logjikën dhe mënyrën e të menduarit të besimtarëve dhe sjellin në mes çështje fetare, urdhrin e Zotit dhe të Dërguarit, ndërkohë që dergjën në mëkat dhe me shpatë në dorë e sulmojnë Profetin (*Paqja dhe bekimet e All'Ilahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) dhe fenë e Tij.

2- Çfarë do të thotë rrethimi nga Xhehennemi?

Komentuesit e Kur'anit, në interpretimin e frazës "Xhehennemi i përfshin mohuesit." kanë shprehur ide të ndryshme. Disa prej tyre thonë: Kjo frazë është aluzion për këtë, për faktorët dhe shkaqet e futjes në Xhehennem, që do të thotë, mëkatet i kanë rrethuar ata. Disa të tjerë shprehen: Kjo është një prej çështjeve që, me patjetër, do të ndodhin në të ardhmen dhe që shprehen në formën e kohës së kaluar dhe të kohës së tashme, që do të thotë se ata, në mënyrë kategorike, do të jenë banorë të Xhehennemit.

Por mundësia që frazën ta interpretojnë në kuptimin e saj të drejtpërdrejtë, gjithashtu, është e përfillshme, që të themi se Xhehennemi ekziston. Por tani qëndron në brendësinë dhe zemrën e kësaj bote dhe ata janë në mes të Xhehennemit, ndonëse akoma nuk është lëshuar urdhri për efektivitetin dhe ndikueshmërinë e tij, ashtu siç ekziston Xhenneti.

Ajetet 50 - 52

إِنْ تُصِيبَكَ حَسَنَةٌ تَسُؤْهُمْ^ط وَإِنْ تُصِيبَكَ مُصِيبَةٌ يَقُولُوا قَدْ
 أَخَذْنَا أَمْرًا مِنْ قَبْلٍ وَيَتَوَلَّوْا وَهُمْ فَرِحُونَ ﴿٥٠﴾ قُلْ لَنْ يُصِيبَنَا
 إِلَّا مَا كَتَبَ اللَّهُ لَنَا هُوَ مَوْلَانَا وَعَلَى اللَّهِ فَلْيَتَوَكَّلِ الْمُؤْمِنُونَ
 ﴿٥١﴾ قُلْ هَلْ تَرَبَّصُونَ بِنَا إِلَّا إِحْدَى الْحُسَيْنَيْنِ^ط وَنَحْنُ نَتَرَبَّصُ
 بِكُمْ أَنْ يُصِيبَكُمْ اللَّهُ بِعَذَابٍ مِّنْ عِنْدِهِ ۚ أَوْ بِأَيْدِينَا^ط
 فَتَرَبَّصُوا إِنَّا مَعَكُمْ مُّتَرَبِّصُونَ ﴿٥٢﴾

“Nëse ty të vjen ndonjë e mirë, ata hidhërohen; nëse të godet ndonjë e keqe, ata thonë: ‘Sa mirë që i morëm masat që më parë’ dhe largohen të gëzuar.”

“Thuaj: ‘Do të na godasë vetëm ajo që na ka caktuar All’Ilahu; Ai është Mbrojtësi ynë dhe vetëm tek All’Ilahu le të mbështeten besimtarët!’”

“Thuaj: ‘Çfarë prisni për ne, përveçse njërës prej dy të mirave (fitores ose martirizimit)? Ndërsa ne po presim që All’Ilahu t’ju godasë me dënim nga ana e Tij ose me duart tona. Pra, pritni se edhe ne me ju do të presim.’”

Komentimi

Ne jemi ngadhënjyes

Në ajetet 50-52 përmendet edhe një tjetër cilësi e hipokritëve dhe shenjat e tyre, duke plotësuar diskutimin e ajeteve të mëparshme dhe të mëpasme.

Në fillim thotë: **“Nëse ty të vjen ndonjë e mirë...”**, qoftë kjo mirësi që vjen nga përballja me armikun, qoftë nga zhvillimet e tjera. Ky shqetësim është argument për hasmërinë e brendshme dhe të mungesës së besimit të tyre. Vallë a është e mundur që dikush të ketë besimin minimal në zemër dhe të ndajë shqetësimin nga fitorja e të Dërguarit të Zotit dhe madje të një njeriu me besim të zakonshëm?

Më pas thotë: **“...nëse të godet ndonjë e keqe, ata thonë: ‘Sa mirë që i morëm masat që më parë.’”** E shpëtua veten tonë nga kjo.

“...dhe largohen të gëzuar.” Këta dyfytyrësh, zemërrrët përfitojnë çdo mundësi për interesat e tyre dhe bëjnë llafe për intelekt dhe zgjuarsi. A shikoni që kjo ishte mendja dhe largpamësia jonë, që na mundëson të mos marrim pjesë në filan fushë? Problemet që u kanosen të tjerëve kuptohen për shkak të mungesës së inteligjencës dhe të largpamësisë, nuk na prekin ne. Këtë shprehje e artikulojnë në mënyrë të atillë që pothuajse fluturojnë nga gëzimi.

Në ajetin në vijim All’Ilahu i Madhëruar thotë: **“Thuaj: ‘Do të na godasë vetëm ajo që na ka caktuar All’Ilahu; Ai është Mbrotësi ynë...’”**

Ai është Mbikëqyrësi ynë i Urtë dhe i Dashur dhe nuk na cakton fat tjetër përveç mirësisë dhe zhvillimit tonë.

“...dhe vetëm te All’Ilahu le të mbështeten besimtarët!”

Ata dashurojnë vetëm Atë, prej Tij kërkojnë ndihmë, ballin e vënë në tokë në altarin e Tij, si dhe vendmbështetja e vendstrehimi i tyre është vetëm te Ai.

Ky është një gabim i madh, që politeistët vuajnë prej Tij. Ata pandehin që me mendjen e tyre të vogël dhe me mendimin e tyre të pafuqishëm, mund të parashikojnë të gjitha problemet dhe fatkeqësitë dhe nuk kanë nevojë për Mirësinë dhe Mëshirën e Zotit. Ata nuk janë në dijeni se e gjithë ekzistenca e tyre është si penda e vogël përballë një stuhie të madhe prej ngjarjesh apo si një pikë e papërfillshme uji në një shkretëtirë të nxehtë në një ditë vere.

Nëse nuk është mirësia dhe mëshira hyjnore që ndihmon dhe përkrah njeriun e dobët, ai nuk është i aftë për asnjë punë.

Më pas thotë: **“Thuaj: ‘Çfarë prisni për ne, përveçse njërës prej dy të mirave (fitores ose martirizimit)?”**

Ata, ose i shkatërrojnë armiqtë dhe dalin fitimtarë nga lufta, ose vdesin dhe e pinë me krenari “shurupin” e shehadetit. Secilën prej këtyre e presin me shumë kënaqësi dhe krenari.

Por përkundrazi: **“...Ndërsa ne po presim që All’Ilahu t’ju godasë me dënim nga ana e Tij ose me duart tona. Pra, pritni se edhe ne me ju do të presim.”**, ju jeni në pritjen e lumturisë sonë dhe ne jemi në pritje të fatkeqësisë suaj.

Hulumtime

1- Planifikimet dhe orvatjet tona

Pa dyshim që fati ynë lidhet me punën, përpjekjen dhe orvatjen tonë. Këtë e miratojnë ajetet kur'anore, si: p.sh ajeti: **"...dhe se njeriut nuk i takon tjetër vetëm se ajo që ka punuar."**¹ si dhe po thotë: **"Secili njeri është peng i veprës së vet."**² Megjithëse, përpjekjet dhe orvatjet janë prej ligjeve të All'Ilahut dhe Ai urdhëron për to. Por kur çështja del nga kornizat e përpjekjes dhe veprimtarisë sonë, atëherë është dora e caktimit ajo që sundon fatin dhe çështjet tona. Ai caktim është në përputhje me ligjin e shkakësisë dhe përfundon te Vullneti, Dija dhe Urtësia e All'Ilahut.

Çështja është te besimi që duhet të kenë njerëzit te Zoti Një dhe i vetëm, të besojnë në Diturinë, Urtësinë, Mirësinë dhe Mëshirën e All'Ilahut. Besimtarët duhet të mendojnë se të gjitha këto paracaktime janë në përputhje me sistemin më të përkryer dhe me interesin e njerëzve. Nëse një grup njerëzish janë hipokritë, frikacakë, përtacë dhe të përcarë, ata janë të destinuar në zhdukje. Ky caktim është i patjetërsueshëm për ta.

Por një komunitet prej besimtarësh dhe njerëzish të ndërgjegjshëm, të bashkuar dhe me vullnet të çeliktë, nuk kanë caktim përpos fitores. Pra, fati i tyre është ngadhënjimi.

¹ Sure "En Nexhm", ajeti 39.

² Sure "El Mudeththir", ajeti 38.

Prej këtej rrjedh që ajetet e sapopërmendura nuk janë në kundërshti me parimin e vullnetit të lirë dhe të përzgjedhjes dhe nuk konsiderohen argument për fatalizmin njerëzor.

2- Në fjalorin e besimtarëve nuk ekziston fjala disfatë

Në ajetin 52 hasim një logjikë çuditërisht të fortë, që përmban në vete filozofinë e të gjitha fitoreve të myslimanëve të hershëm. Në qoftë se Profeti (*Paqja dhe bekimet e All'Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) nuk do të kishte ndonjë rekomandim dhe porosi tjetër përveç kësaj, prapë do të ishte e mjaftueshme për të argumentuar fitoren e ndjekësve të vet që është:

Fshirja në mënyrë përfundimtare e nocionit të humbjes nga faqja e shpimit të tyre dhe miratimi i faktit që ata gjithnjë janë fitues, edhe, nëse vriten, janë fitimtarë, nëse e shpartallojnë armikun, prapë janë fitimtarë.

Pra, ju besimtarë keni dy rrugë përballë vetes, secilën rrugë që e tejkaloni, do të mbërrini në vendin e kërkuar.

Në udhën tuaj nuk ekziston rrugë pa krye apo humnerë. Njëra udhë të çon drejt rënies dëshmor, që është kulmi i krenarisë së një njeriu besimtar dhe është dhunti më e madhe, që është e përfytyrueshme për njeriun, ku ai bie në ujdi me Zotin, që të japë jetën dhe në shkëmbim të blejë një jetë të amshueshme dhe të përhershme në prani të afërsisë së Zotit e midis begative të Tij të papërshkueshme.

Udha tjetër është fitorja mbi armikun dhe shpartallimi i forcës djallëzore të tij, bashkë me spastrimin e mjedisit të jetës së

njerëzve nga sherri i shtypësve të të padrejtëve dhe të infektuarve, gjë që është, po ashtu, një ngazëllim i madh dhe krenari e sigurt.

Ushtari që i futet fushës së betejës me këtë mendësi, kurrë nuk i lejon vetes mendimin për t'u arratisur dhe për t'ia kthyer kurrizin armikut. Ai nuk ka ndrojtje nga askush dhe asgjë, si dhe qenia e tij është imunizuar ndaj frikës, trishtimit, ankthit dhe lajthitjes.

Ushtria që përbëhet nga ushtarë të tillë, do të jetë një ushtri e pamposhtur.

Një frymë dhe mendësi e tillë, mund të kultivohet vetëm nëpërmjet mësimave islame. Edhe sot, në qoftë se me anë të edukimit dhe të arsimimit, kjo logjikë fillon të rrezatojë sërish në shpirtin e myslimanëve, ata do të kompensonin prapambetjet dhe humbjet.

Studiuesit që analizojnë dhe shqyrtojnë shkaqet e përparimit të myslimanëve të atëhershëm, krahas shkaqeve dhe prapambetjes së sotme dhe ndonjëherë e konsiderojnë këtë çështje si një enigmë të pazgjidhshme, do të bënin mirë që të meditnin në përmbajtjen e këtij ajeti, që të gjenin përgjigjen e kësaj pyetjeje në mënyrën më të qartë.

Është për t'u theksuar se në këtë ajet, pasi përmenden dy disfatat e hipokritëve, më pas i shpjegon ato, duke e sqaruar një për një.

Por kur përmend dy fitoret e besimtarëve, e kalon shumë shpejt çështjen, ngaqë është aq e qartë, saqë nuk ka nevojë fare për sqarim. Kjo është një nga teknikat e bukura dhe të hijshme të elokuencës, që është përdorur në këtë ajet.

3- Cilësia e përhershme e hipokritëve

Theksojmë edhe një herë tjetër, që këto ajete nuk duhet të trajtohen në formën e rrëfimit të një çështjeje historike, që i takon të kaluarës.

Duhet të dimë se është një mësim për të kaluarën, të sotmen dhe të ardhmen tonë dhe e të gjithë njerëzve.

Në çdo shoqëri, sipas zakonisht, jeton një grup dyfytyrësh, të paktë ose të shumtë në numër dhe cilësitë tyre pothuajse janë të ngjashme me njëri-tjetrin. Ata janë njerëz të paditur dhe, në të njëjtën kohë, egoistë dhe arrogantë, që për vete mendojnë se janë njerëz jashtëzakonisht inteligjentë dhe të zgjuar. Ata gjithnjë janë në ankth dhe torturë për rehatinë e tyre, përkundrazi gëzohen për hallet e të tjerëve. Ata gjithnjë jetojnë midis një grumbulli të madh prej përfytyrimeve të kota, dyshimit, luhatjes dhe habitës. Prandaj vendosin një hap para dhe më pas kthejnë hapin prapa.

Përballë tyre besimtarët e vërtetë gëzohen me gëzimin e njerëzve dhe solidarizohen me dhimbjet e tyre. Asnjëherë nuk mburren me diturinë dhe zgjuarsinë e tyre e as që e konsiderojnë veten e tyre të mjaftuar nga mirësia e Zotit. Kanë një zemër të mbushur nga dashuria për Zotin dhe në udhën e Tij nuk kanë frikë nga asnjë ngjarje.

Ajetet 53 - 55

قُلْ أَنْفِقُوا طَوْعًا أَوْ كَرْهًا لَنْ يُتَقَبَلَ مِنْكُمْ إِنْ كُنْتُمْ كَوْمًا
 فَاسِقِينَ ﴿٥٣﴾ وَمَا مَنَعَهُمْ أَنْ تُقَبَلَ مِنْهُمْ نَفَقَتُهُمْ إِلَّا أَنَّهُمْ
 كَفَرُوا بِاللَّهِ وَرَسُولِهِ ۗ وَلَا يَأْتُونَ الصَّلَاةَ إِلَّا وَهُمْ كُسَالَى
 وَلَا يُنْفِقُونَ إِلَّا وَهُمْ كَارِهُونَ ﴿٥٤﴾ فَلَا تُعْجِبْكَ أَمْوَالُهُمْ وَلَا
 أَوْلَادُهُمْ إِنَّمَا يُرِيدُ اللَّهُ لِيُعَذِّبَهُمْ بِهَا فِي الْحَيَاةِ الدُّنْيَا وَتَزْهَقَ
 أَنْفُسُهُمْ وَهُمْ كَافِرُونَ ﴿٥٥﴾

“Thuaj: ‘Shpenzoni me hir a me pahir, nga ju nuk do të pranohet kurrsesi, sepse ju jeni vërtet një popull i mbrapshtë.’”

“Ndhimesat e tyre nuk do të pranohen, ngase ata janë njerëz që nuk besojnë në All’llahun dhe të Dërguarin e Tij, namazit i afrohen vetëm në mënyrë të ngathët dhe nuk shpenzojnë (nga pasuria), veçse në mënyrë përbuzëse.”

“Mos u josh (o Muhammed) nga pasuria dhe fëmijët e tyre, sepse nëpërmjet tyre All’llahu kërkon t’i ndëshkojë ata në këtë jetë, kështu që t’u dalë shpirti duke qenë jobesimtarë.”

Komentimi

Bamirësia e njerëzve të korruptuar

Këto ajete hedhin dritë mbi një mori tjetër prej shenjave të hipokritëve. Fundin dhe përfundimin i përpjekjeve të tyre, bën të qartë se si veprat e tyre janë të privuara nga shpirti dhe ndikimi dhe nuk do të ketë asnjë përfitim prej tyre.

Meqenëse prej veprave të mira është zekati, me kuptimin e gjerë të fjalës, namazi, që është lidhja e krijesave me Krijuesin, të cilat kanë një pozitë të veçantë, për këtë ajetet i kushtojnë shumë vëmendje këtyre dy çështjeve.

Në fillim thotë: **“Thuj: ‘Shpenzoni me hir a me pahir, nga ju nuk do të pranohet kurrsesi...’”**

Më pas përmend argumentin e tij: **“...sepse ju jeni vërtet një popull i mbrapshtë.”**

Synimet tuaja janë të infektuara, veprat tuaja janë të pasinqerta dhe zemrat tuaja janë të errëta, kurse Zoti pranon vetëm veprën që është e çiltër dhe që kryhet nga një njeri me integritet dhe i devotshëm.

Është e qartë se korrupsioni, amoraliteti këtu nuk është një mëkat i thjeshtë dhe i zakonshëm, për arsye se ka mundësi që njeriu të kryejë ndonjë mëkat, por njëkohësisht të kryejë një vepër të singertë, prandaj kuptimi i kësaj fjale është mosbesimi, hipokrizia apo përlyerja e bamirësisë së tyre me pompozitet dhe mungesë sinqeriteti.

Po ashtu, nuk ka ndonjë pengesë që fjala “fisk”, në frazën e lartpërmendur, në kuptimin e gjerë të fjalës, të përfshijë të dy kuptimet. Ajeti në vijim do ta shpjegojë këtë pjesë.

Në ajetin vijues, sërish jep sqarime për mospranimin e bamirësisë së tyre: **“Ndihmesat e tyre nuk do të pranohen, ngase ata janë njerëz që nuk besojnë në All’llahun dhe të Dërguarin e Tij...”** dhe çdo vepër që nuk shoqërohet me besimin në Zot dhe monoteizëm, nuk pranohet te Zoti.

Kur’ani shumë herë mbështet këtë çështje. Kushti i pranimit të veprave të denja është besimi, madje, nëse vepra kryhet në bazë të besimit, por pas pak kohe kryesi i veprës ndërmerr rrugën e mosbesimit, vepra e kryer prej tij bëhet e paefektshme dhe zhduket.

Pasi përmend mospranimin e kontributeve të tyre financiare, tregon statutin e adhurimeve të tyre: **“...namazit i afrohen vetëm në mënyrë të ngathët dhe nuk shpenzojnë (nga pasuria), veçse në mënyrë përbuzëse.”**

Në realitet, bamirësitë dhe kontributet e tyre nuk pranohen për dy arsye:

Një, sepse kryhen në bazë të mosbesimit dhe të mungesës së besimit dhe, e dyta, janë fryt i detyrimit dhe i shtrëngesës.

Po ashtu, namazi i tyre nuk pranohet për hir të dy arsyeve:

Arsyeja e parë është mosbesimi, kurse e dyta është fakti që kryhet detyrimisht dhe pa dëshirë, pra, në gjendje anemie.

Frazat e përmendura shpjegojnë njëkohësisht pozicionin e hipokritëve nga pikëpamja e mos arritjes së asnjë rezultati nga veprat e tyre. Në fakt tregon dhe një shenjë tjetër prej shenjave të

tyre, kështu që besimtarët e vërtetë mund t'i njohim përmes dëshirës së zjarrtë dhe gëzimit që shfaqin gjatë adhurimit dhe kryerjes së veprave të mira. Po ashtu, vrapojnë me sinqeritet të plotë pas këtyre veprave.

Gjendjen e hipokritëve mund ta vëmë re nëpërmjet mënyrës së kryerjes së veprave, sepse ata i afrohen ndonjë vepre të mirë, duke qenë shpërfillës, pa pasion, me shqetësim dhe shtrëngesë, sikur dikush i ka detyruar dhe i ka kapur për dore dhe i çon drejt veprës së mirë, duke i zvarritur.

Është afër mendsh që veprat e grupit të parë, meqë burojnë prej dashurisë ndaj Zotit, janë të shoqëruara me përdëllim. Të gjitha ritet dhe rregullat e veprave zbatohen me përpikëri. Por veprat e grupit të dytë, përkundrazi, ngaqë kryhen me detyrim dhe me apati, janë të cinguara, të privuara nga shpirti dhe kokë e këmbë të thata.

Për pasojë, motivacione të ndryshme japin dy forma të ndryshme të veprave të tyre.

Në ajetin e fundit të këtij grupi ajetesh, i drejtohet të Dërguarit: **“Mos u josh (o Muhammed) nga pasuria dhe fëmijët e tyre...”**, që të mendosh se ata, edhe pse janë hipokritë, si është e mundur që kanë përftuar aq shumë begati hyjnore.

Ato në dukje, janë begati për ta, por në fakt, **“nëpërmjet tyre All'Ilahu kërkon t'i ndëshkojë ata në këtë jetë, kështu që t'u dalë shpirti duke qenë jobesimtarë.”**

Në realitet, ata do të torturohen në dy mënyra, për shkak të këtyre mallrave dhe pasardhësve (forca ekonomike dhe njerëzore).

E para, është kjo që njerëz të tillë zakonisht kanë fëmijë të këqij dhe mallra të pa bereqet, që janë shkak i dhimbjes dhe i vuajtjes së tyre në këtë botë. Ditë e natë duhet të punojnë për fëmijët, që janë shkak i turpërimit dhe i shqetësimit të tyre, si dhe të japin shpirt për të ruajtur mallrat që i kanë përfituar përmes mëkatit.

Nga ana tjetër, ngaqë janë të lidhur fort me këto mallra dhe fëmijët e tyre dhe nuk kanë besim në botën e gjerë plot me begati të Ahiretit dhe jetën pas vdekjes, ndarja me aq shumë pasuri është e vështirë për ta, deri aty sa besimin e vet e kanë vënë mbi ta dhe largohen me mosbesim nga kjo botë, duke dhënë shpirt në mënyrën më të vështirë. Pasuria dhe fëmijët, nëse janë të pastër dhe të denjë, është dhunti dhe shkak për rehatinë dhe komfortin, si dhe lumturinë, por nëse janë të papastra dhe të këqija, shkaktojnë vetëm dhimbje dhe torturë të madhe.

Hulumtime

1- Dallimi midis ajetit të parë dhe të dytë

Disa pyesin si ka ndodhur që në fillim të ajetit 53 është thënë, në qoftë se kontribuojnë sipas vullnetit të lirë, apo sipas detyrimit, kjo nuk do të pranohet, ndërkohë që në fund të ajetit 54, rishtazi thuhet se ata kontribuojnë në bazë të detyrimit. A nuk janë këto dy mendime të kundërshtueshme?

Duke pasur parasysh një gjë, përgjigjja bëhet e qartë: fillimi i ajetit 53, në fakt, është në formën e një propozimi kushtor, domethënë, nëse jepni, duke u bindur, apo kontribuoni, duke

qenë i detyruar në cilëndo formë qoftë, nuk do të pranohet dhe ne e dimë se forma e kushtores nuk është arsye për vënien e kushtit. Edhe në rast se kontribuojnë me dëshirë dhe vullnet të lirë, prapë nuk kanë ndonjë dobi, sepse janë pa besim.

Por në fund të ajetit 54 shprehet një propozim apo pohim real dhe i jashtëm. Ky është fakti që ata gjithnjë japin e kontribuojnë vetëm në rast detyrimi.

2- Nuk duhet të mashtroheni me adhurimin e individëve

Mësimi tjetër që mund të përftojme nga këto ajete, është se nuk duhet të mashtrohemi vetëm me faljen e namazit dhe agjërimin e njerëzve, sepse të njëjtën gjë e bëjnë edhe hipokritët. Ata edhe falin namaz, edhe në pamje të jashtme kontribuojnë në rrugën e Zotit, por duhet bërë diferencimi i faljeve dhe i kontributeve prej hipokriti nga veprat e pastra të besimtarëve të vërtetë. Kjo gjë vihet re me vrojtimin e vëmendshëm në formën e jashtme të adhurimit.

Në një hadith lexojmë: *“Mos u mjaftoni vetëm me zgjatjen e rukuve dhe të sexhdeve prej falësve të namazit, sepse kjo mund të jetë diçka që është kthyer në zakon për të, që, nëse heq dorë prej tij, e shqetëson atë. Por vëmendja juaj të jetë te sinqeriteti në të folur dhe zbatimi apo kthimi i amanetit, sepse sinqeriteti dhe amaneti burojnë prej besimit, ndërkohë që rukuja dhe sexhdeja, që është kthyer në zakon, mund të bashkohet edhe me mosbesim dhe hipokrizi.”¹*

¹ “Usulul Kafi”, vëll. 2 f. 105, botoi “Darul Kutub el islamije”, “Uesailu Shia”, vëll.19, f. 67–69, botim i i shtëpisë botuese “Ehlul Bejt”; “Biharul Enuar”, vëll. 68, f. 8–9 dhe vëll. 72, f 113 dhe 115. (me pak ndryshim).

Ajetet 56 - 57

وَيَحْلِفُونَ بِاللَّهِ إِنَّهُمْ لَمِنكُمْ وَمَا هُمْ مِّنكُمْ وَلَكِنَّهُمْ قَوْمٌ
يَفْرُقُونَ ﴿٥٦﴾ لَوْ يَجِدُونَ مَلَجًا أَوْ مَغْرَبًا أَوْ مُدْخَلًا لَّوَلَّوْا إِلَيْهِ
وَهُمْ يَجْمَحُونَ ﴿٥٧﴾

“Ata betohen për All’Ilahun se janë në fenë tuaj, ndërkohë që nuk janë prej jush, por janë njerëz frikacakë (për të treguar si janë në të vërtetë).”

“Sikur ata të gjenin ndonjë strehim, shpellë apo vend mbrojtjeje, do të niseshin atje me nxitim.”

Komentimi

Një shenjë tjetër e hipokritëve

Në këto ajete sërish është treguar një tjetër nga veprat e zakonshme dhe gjendjes së hipokritëve. Kur’ani thotë: “Ata betohen për All’Ilahun se janë në fenë tuaj, ndërkohë që nuk janë prej jush, por janë njerëz frikacakë (për të treguar si janë në të vërtetë).”

Nga frika e tepërt e fshehin mosbesimin dhe tregohen besimtarë, për të mos e pësuar keq.

Fjala “jefrekun” vjen nga fjala “fereke” dhe është në kuptimin e frikës dhe të trishtimit të tepërt.

Ragibi, në “Mufredat”, thotë: “Kjo fjalë është në kuptimin e përçarjes, të ndarjes dhe të shpërndarjes dhe do të thotë që frika e tyre është aq e madhe, saqë zemra e tyre kërkon që të copëtohet e të shpartallohet. Në fakt, meqë nuk kanë vend mbështetje në brendësinë e tyre, vuajnë nga frika dhe trishtimi i madh. Për shkak të kësaj frike dhe trishtimi kurrë nuk e shfaqin atë që e mbajnë në zemra dhe, ngaqë nuk i frikësohen Zotit, kanë frikë nga çdo gjë dhe gjithnjë janë në ankth dhe trishtim, ndërkohë që besimtarët e sinqertë, në sajë të besimit, gëzohen me qetësi dhe guxim të veçantë.”

Në ajetin tjetër, në një shprehje të shkurtër, po shumë domethënëse dhe elokuate, dëshmon ashpërsinë e urrejtjes, të armiqësisë dhe të hasmërisë së tyre ndaj besimtarëve: **“Sikur ata të gjenin ndonjë strehim, shpellë apo vend mbrojtjeje, do të niseshin atje me nxitim.”**

Fjala “el melxheu” është në kuptimin e vendstrehimit, shpellave, kështjellat e rrethuara etj.

Fjala “el megaratu” është shumësi i fjalës “megaretun”, në kuptimin e shpellës.

Fjala “muddhekel” është në kuptimin e rrugëve të fshehura, si tunelet që i ndërtojnë nëntokë dhe hyjnë nëpër to në vende të caktuara.

Fjala “jexhmehun” vjen nga rrënja “xhinah”, në kuptimin e lëvizjes së përshpejtuar dhe intensive, në mënyrë që asgjë nuk mund ta pengojë atë si vrapi i kuajve të trembur dhe të hasdisur, që nuk mund të ndalen, prandaj kalin e tillë e quajnë “xhenuh”.

Sidoqoftë, kjo është një nga shprehjet më elokuate që Kur'ani e ka artikuluar rreth frikës dhe trishtimit të hipokritëve, apo armiqësisë dhe urrejtjes së tyre, që, në qoftë se gjenin mënyra për arratisje nëpër male dhe nëpër tokë, për hir të frikës apo armiqësisë, do të largoheshin prej jush, por, meqenëse kanë të afërm, fise, si dhe mallra dhe pasuri rreth shoqërisë suaj, janë të detyruar të durojnë dhe të qëndrojnë.

Ajetet 58 - 59

وَمِنْهُمْ مَّنْ يَلْمِزُكَ فِي الصَّدَقَاتِ فَإِنْ أُعْطُوا مِنْهَا رِضْوَانًا وَإِنْ لَمْ يُعْطُوا مِنْهَا إِذَا هُمْ يَسَخَطُونَ ﴿٥٨﴾ وَلَوْ أَنَّهُمْ رِضْوَانًا مَّا آتَاهُمْ اللَّهُ وَرَسُولُهُ وَقَالُوا حَسْبُنَا اللَّهُ سَيُؤْتِينَا اللَّهُ مِنْ فَضْلِهِ ۗ وَرَسُولُهُ إِنَّا إِلَى اللَّهِ رَاغِبُونَ ﴿٥٩﴾

“Ka edhe të tillë që të qortojnë për shkak të ndarjes së lëmoshës. Nëse atyre u jepet ndonjë pjesë, ata kënaqen, por, nëse nuk u jepet, përnjëherë zemërohen.”

“Sikur ata të kënaqeshin me atë që u ka dhënë All’llahu dhe i Dërguari i Tij, do të thoshin: ‘Na mjafton All’llahu! All’llahu do të na japë nga mirësitë e Veta; edhe i Dërguari i Tij. Ne vetëm tek All’llahu i varim shpresat.’”

Shkaku i zbritjes

Në komentimin e Kur’anit “Durr'rrul Menthur”, nga librat Sahih Bukhari, Sahih Nisai dhe nga një grup tjetër, është transmetuar se i Dërguari i Zotit i ndau mallrat “nga përfitimet e luftës së tij”. Kur mbërriti një person nga fisi Beni Temim, Dhul Hueajserah, thirri: “O i Dërguar i Zotit, tregohu i drejtë!”

I Dërguari ia ktheu: “Mjerë për ty! Nëse Unë nuk tregohem i drejtë, kush tjetër e zbaton drejtësinë?”

Omeri bërtiti: *“O Profet! Më lejo që t’ia pres kokën!”*

Profeti tha: *“Lëreni atë! Ai ka përkrahës që nëse do t’i njihnit do t’i nënçmonit faljet dhe agjërimet tuaja përballë faljes dhe agjërimet të tyre. Por megjithatë, ata largohen nga feja, ashtu siç largohet shigjeta nga harku!”¹*

Këtu zbriten ajetet në fjalë dhe i këshilloi këta njerëz.

Komentimi

Egoistët mendjelehtë

Në ajetin e parë shprehet një tjetër gjendje e hipokritëve. Ata asnjëherë nuk kënaqen me pjesën e tyre dhe gjithnjë presin që të përfitojnë sa më shumë që mundën nga mallrat e përbashkëta të buxhetit shtetëror apo nga interesat publike, pavarësisht a e meritojnë atë apo jo. Miqësia dhe armiqësia e tyre vërtitet rreth po këtyre interesave. Çdokush që i mbush xhepat e tyre janë të kënaqur me të dhe çdokush që, për hir të zbatimit të drejtësisë nuk u jep në dorë hisen e të tjerëve, nuk janë të kënaqur me të.

E vërteta dhe drejtësia nuk kanë kuptim në fjalorin e tyre dhe, në qoftë se kanë, i drejtë për ata është personi që u jep sa më shumë atyre. Dhe i padrejtë është personi që nuk i lejon të hyjë në hakun e tjetrit.

¹ “Biharul Enuar”, vëll. 21, f. 173, vëll. 22, f. 37 38 dhe vëll.30, f. 579, vëll.33, f. 327, 335, 359 .

Thënë ndryshe: Ata nuk kanë asnjë lloj personaliteti shoqëror dhe kapen vetëm pas personalitetit individual dhe interesave të tyre vetjake. Çdo gjë e shohin me këtë këndvështrim.

Prandaj Kur'ani thotë: **“Ka edhe të tillë që të qortojnë për shkak të ndarjes së lëmoshës.”**

Dhe ty të konsiderojnë si ekzekutues të drejtësisë, edhe pse nuk e meritojnë. **“Nëse atyre u jepet ndonjë pjesë, ata kënaqen, por, nëse nuk u jepet, përnjëherë zemërohen.”** Dhe të akuzojnë për padrejtësi.

“Sikur ata të kënaqeshin me atë që u ka dhënë All'Ilahu dhe i Dërguari i Tij, do të thoshin: ‘Na mjafton All'Ilahu! All'Ilahu do të na japë nga mirësitë e Veta; edhe i Dërguari i Tij. Ne vetëm tek All'Ilahu i varim shpresat.’”

A ekzistojnë në shoqëritë islame sot njerëz të tillë?

A janë të kënaqur të gjithë njerëzit me përfitimet e tyre të ligjshme?

A e konsiderojnë si të drejtë personin që u jep sipas meritës dhe të drejtës së tyre?

Sigurisht që përgjigjja e këtyre pyetjeve është negative. Për fat të keq, ka akoma njerëz që kriter i matjes së të vërtetës dhe të së drejtës janë interesat personale, vetjake dhe nuk ngopen me të drejtat e tyre. Nëse dikush këmbëngul që të gjithë, sidomos të vobektit, t'i gëzojnë të drejtat e tyre, fillojnë të bërtasin dhe të bëjnë zhurmë.

Për pasojë nuk ka nevojë për njohjen e hipokritëve, që të shfletojnë fatet e historisë.

Mjafton të hedhim një shikim rreth vetes, madje të shohim veten tonë për të kuptuar gjendjen tonë dhe të të tjerëve.

Krijuesi ynë gjallëro te ne frymën e besimit!

Çrrënjose prej nesh mendimin djallëzor dhe hipokrizinë!

Lutja jonë ndaj teje është që të na dhurosh bekimin, në mënyrë që ta formësojmë veten, që të mjaftohemi me pjesën dhe të drejtën tonë.

Gjithnjë të jemi jo vetëm në kërkim të drejtësisë, por edhe të zbatimit të saj.

Ajeti 60

۞ إِنَّمَا الصَّدَقَتُ لِلْفُقَرَاءِ وَ الْمَسْكِينِ وَ الْعَمِلِينَ عَلَيْهَا
 وَ الْمُؤَلَّفَةِ قُلُوبُهُمْ وَ فِي الرِّقَابِ وَ الْغَرَمِينَ وَ فِي سَبِيلِ اللَّهِ وَ ابْنِ
 السَّبِيلِ ۖ فَرِيضَةً مِّنَ اللَّهِ ۗ وَاللَّهُ عَلِيمٌ حَكِيمٌ ﴿٦٠﴾

“Lëmosha e zekatit është vetëm për të varfrit, për nevojtarët, për ata që janë ngarkuar me mbledhjen dhe administrimin e tij, për lirimin e skllëvërve, për të rënduarit nga borxhet, për (sakrifikuesit në) rrugën e All’llahut dhe për udhëtarët e mbetur rrugëve. Këto janë detyrat e vëna prej All’llahut. Vërtet, All’llahu është i Gjithëdijshëm dhe i Urtë.”

Komentimi

Harxhimet e zekatit dhe detajet e tij

Në historinë islame vërehen dy periudha të caktuara, Periudha e Mekës, ku përpjekja e Profetit (*Paqja dhe bekimet e All’llahut qofshin mbi të e mbi familjen e tij!*) dhe e myslimanëve ishte në drejtim të përgatitjes dhe edukimit të njerëzve, si dhe në mësimin dhe predikimin e tyre dhe Periudha e Medines. Në këtë periudhë Profeti (*Paqja dhe bekimet e All’llahut qofshin mbi të e mbi*

familjen e tij!) filloi me krijimin e “qeverisë islame”, si dhe zbatimin e koncepteve apo dispozitave islame nëpërmjet kësaj qeverie të drejtë.

Pa dyshim, në formimin e një qeverie, një nga çështjet më parësore dhe më të domosdoshme, është sigurimi i financave për buxhetin e shtetit, në mënyrë që të plotësohen nevojat ekonomike të qeverisë, nevoja që, pa përjashtim, ekzistojnë për çdo qeveri.

Për këtë arsye, një prej punëve parësore që ndërmori Profeti (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të e mbi familjen e tij!*) në Medine ishte krijimi i “thesarit të shtetit”. Një prej burimeve të thesarit e përbënte zekati. Në bazë të asaj që është e njohur, ky dispozicion u miratua në vitin e dytë të migrimit të Profetit (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të e mbi familjen e tij!*). Sigurisht, ashtu siç do të tregojmë më vonë, me lejen e Zotit, urdhri i zekatit ishte shpallur në Mekë shumë para kësaj kohe, por jo në mënyrë të detyrimit të përmbledhjes së saj në buxhetin shtetëror, por njerëzit jepnin me dëshirë, pra, paguanin nga pasuria e tyre. Ajo që ndodhi në Medine ishte urdhri nga ana e Zotit, përmes ajetit 103, të sures “Teube” për mbledhjen dhe grumbullimin e tij në një vend.

Ajeti në fjalë ka zbritur pas ajetit që e bën obligim zekatin, duke shpjeguar se ku duhet harxhuar zekati. Është për të theksuar që ajeti fillon me shprehjen “*innema*” që shpreh kufizim. Kjo tregon se disa prej personave egoistë, apo të painformuar prisnin që të kishin përfitime nga zekati, pa pasur asnjë të drejtë. Fjala “*innema*” i ndalon hapur ata. Dy ajetet pararendëse të këtij ajeti e theksonin në mënyrë të qartë këtë fakt. Disa e akuzonin Profetin (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të e mbi familjen e tij!*) për

mos shpërndarje të zekatin. Kur nuk u jepej, hidhëroheshin dhe, kur u jepej, shfaqnin gëzim.

Sidoqoftë, ajeti i lartpërmendur, në mënyrë të qartë, ka përshtuar rastet e shpenzimit të zekatit. Në këtë mënyrë u ka dhënë fund të gjitha pretendimeve të kota, duke e ndarë atë në tetë pjesë:

1- Për të varfrit. Në fillim thotë: “Lëmosha e zekatit është vetëm për të varfrit.”

2- Për të vobektit, “për nevojtarët”.

Në lidhje me atë që cili është dallimi mes të “varfërve” dhe “nevojtarëve” është një çështje më vete, të cilën do ta trajtojmë në fund të këtij ajeti.

3- Për mbledhësit, “për ata që janë ngarkuar me mbledhjen dhe administrimin e tij”.

Ky grup është mbledhës dhe administrues, që përpiqet në grumbullimin e zekatit dhe në administrimin e tij. Ajo çfarë u dhurohet atyre, në fakt, është si pagë dhe shpërblim ndaj tyre, kështu që varfëria te ky grup, në asnjë mënyrë, nuk është kusht.

4- Për të dobëtit në besim, për ata që nuk kanë motivim të fuqishëm shpirtëror për përparimin e synimeve islame dhe me anë të stimulimit financiar, ka gjasa të krijohet dashamirësi te ata dhe përfitim të miqësisë së tyre. Andaj thotë: “për ata njerëz, zemra e të cilëve pranon miqësi dhe dashuria e tyre tërhiqet.” Në lidhje me këtë grup njerëzish, më gjerësisht do të flasim në të ardhmen.

5- “Për lirimin e skllevërve”.

Një pjesë e zekatit është e përcaktuar ndaj luftës kundër skllavërisë dhe dhënies fund kësaj çështjeje çnjerëzore. Ashtu siç e cekëm edhe më lart, programi i Islamit në lidhje me skllevërit

është “zhdukje graduale”, në mënyrë që rezultati i tij përfundimtar të jetë lirimi i të gjithë skllëvërve, pa u përballur me reagimet e padëshiruara shoqërore. Përcaktimi i një pjese të zekatit ndaj atyre përbën një element të këtij programi.

6- “Për të rënduarit nga borxhet” dhe për ata që pa faj dhe krim kanë mbetur të zhytur në borxhe dhe janë të paaftë në shlyerjen e tij.

7- “Për (sakrifikuesit në) rrugën e All’Ilahut.”

Ashtu siç do ta cekim edhe më pas, me anë të kësaj synohen të gjitha rrugët që çojnë në përhapjen dhe përforcimin e fesë hyjnore, përfshirë këtu çështjet e luftës në rrugën e Zotit, përhapjes së fesë islame dhe të ngjashëm me to.

8- “Për udhëtarët e mbetur rrugëve.” Udhëtarët që kanë ngelur në rrugë, nën ndikimin e ndonjë shkakut apo ndonjë arsyeje, që nuk kanë mjete transporti dhe gjëra të mjaftueshme për të arritur në vendin e tyre. Edhe pse nuk janë njerëz të varfër dhe të vobektë, por si pasojë e ndikimit të vjedhjes, sëmundjes, humbjes së pasurive të tyre, apo shkaqeve të tjera, i ka kapluar një gjendje e tillë. Njerëz të tillë duhet të ndihmohen me anë të dhënies së zekatit, për t’ia arritur synimit të nevojshëm.

Në fund të ajetit, për ta përforcuar atë që u tha për lëmoshën, thotë: **“Këto janë detyrat e vëna prej All’Ilahut.”**

Pa dyshim që këto detyra janë të mirëllogaritura, plotësisht të sakta dhe në përputhje me interesat individuale dhe shoqërore, sepse **“Vërtet, All’Ilahu është i Gjithëdijshtëm dhe i Urtë.”**

Hulumtime

1- Dallimi mes “të varfrit” dhe “nevojtarit”

Në mesin e komentuesve të Kur'anit ka mosmarrëveshje për kuptimin e këtyre fjalëve. Në ajetin e lartpërmendur, kjo fjalë a është përmendur si përforcim dhe theksim? Në bazë të kësaj, rastet e harxhimit të zekatit do të ishin shtatë.

Apo këto fjalë kanë kuptime të ndryshme?

Shumica e komentuesve të Kur'anit dhe dijetarët e jurisprudencës islame kanë pranuar variantin e dytë, edhe pse në mesin e mbështetësve të këtij varianti, në komentimin e këtyre dy shprehjeve ekzistojnë mosmarrëveshje të ndryshme. Ajo që duket më e përafërt dhe më e pranueshme është: Fjala “fakir” - “i varfër” nënkupton atë person që në jetën e tij ka probleme financiare, edhe pse është i angazhuar me punë dhe ka përfitime, dhe asnjëherë nuk i drejtohet asnjërit për ndihmë. “Miskin” - “nevojtar, mjeran” quhet ai person që ka më shumë nevojë dhe nuk është i punësuar. Për këtë arsye i drejtohet personave të ndryshëm për ndihmë.

Këtë çështje e dëshmon, së pari, vetë rrënja e fjalës “miskin”, e cila rrjedh nga fjala “sukun”, thujse një njeri i tillë është dërmuar dhe është shkatërruar nën efektin e varfërisë ekstreme dhe, së dyti, marrja në konsideratë e rasteve të përdorimit në Kur'an, të cilat e theksojnë kuptimin e lartpërmendur, si p.sh. në këto ajete:

“Ose ndonjë i vobektë që e ka molisur varfëria.”¹

“Kur të prezantojnë në pjesëtimin e pasurisë që u ka lënë i vdekuri të afërmve, bonjakë dhe varfanjakë, jepni nga ajo dhe atyre thoni fjalë të mira.”²

Nga kjo shprehjet përftohet se synimi prej “nevojtarëve” janë lypësit, të cilët janë të pranishëm në të tilla raste. Në suren “Kalem”, ajeti 24, lexojmë: **“Të mos lejojnë të afrohet sot në të (kopshtin me fruta) asnjë i vobektë.”**,³ që ka parasysh lypësit.

Po ashtu, përdorimi i shprehjes “të ushqyerit e të vobektit” ose “ushqimi i të vobektit” në ajete të shumta kur’anore është shenjë e kësaj, që nevojtarët janë njerëz të uritur, madje edhe për një racion ushqim.

Ndërkohë që në rastet e përdorimit të shprehjes së fjalës “fakir” - “i varfër” në Kur’an përftohet se janë njerëz kokëlartë, që asnjëherë nuk i drejtohen askujt për ndihmë, por janë të përfshirë në probleme financiare dhe janë të përfshirë në kuptimin e kësaj fjale. Këtë e lexojmë edhe në suren “El Bekare”, ajeti 273: **“(jepni) për të varfrit që janë të angazhuar në rrugën e All’lilaut dhe nuk kanë mundësi të gjallërojnë me tokë, duke qenë se ata nuk lypin, prandaj ai që nuk e di gjendjen e tyre, mendon se ata janë të pasur...”**

Përveç kësaj që u tha më lart, në një hadith, Muhammed ibn Muslimi përcjell nga Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) ose Imam Bakiri (*Paqja qoftë mbi të!*): “E pyetën Imamin për “të varfrin” dhe “nevojtarin” dhe ai u përgjigj: “I varfër quhet ai

¹ Sure “El Beled”, ajeti 16.

² Sure “En Nisa”, ajeti 8.

³ Sure “El Kalem”, ajeti 24.

person që nuk lyp nga të tjerët, kurse nevojitari/mjerani është në një gjendje më të vështirë dhe është një person, që lyp, e shtrin dorën dhe kërkon nga të tjerët.”¹

E njëjta domethënie është transmetuar në një hadith tjetër nga Ebu Basiri, nga Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*).² Të dy këto hadithe e qartësojnë konceptin e lartpërmendur.

Sigurisht, një pjesë prej provave dëshmojnë të kundërtën e asaj që u tha më lart. Por sa herë që marrim në konsideratë tërësinë e dëshmimeve ekzistuese, bëhet e qartë se e vërteta është po ajo që u tha më lart.

2- Vallë a duhet të ndahet në tetë pjesë të barabarta lëmosha e zekatit?

Disa nga komentuesit e Kur'anit apo juristëve islamë janë të mendimit se kuptimi i ajetit të lartpërmendur është: Lëmosha e zekatit duhet të ndahet në tetë pjesë të barabarta dhe secila prej tyre të shpenzohet në konsumimin e vet; vetëm në rast se sasia e zekatit të jetë aq e vogël dhe e pavlerë, saqë nuk është në gjendje të pjesëtohet në tetë pjesë.

Por pjesa dërmuese e juristëve islamë janë të mendimit se ndarja në tetë llojet e lartpërmendur është e lejuar. Ndarja e barabartë nuk është e detyruar.

¹ “Uesailu Shia”, vëll. 6, f. 144; “Ebuabe lil mustehekin lil zekat ue avktul teslim uel beninje”, Botim i parë, K. “Esnaf el mustehekin”, Hadithi 2; vëll. 9, f.210, Hadithi 11857. Usulul Kafi, vëll. 3, f. 502, Hadithi 18; “Darul kutub el islamije” – “Biharul Enuar”, vëll. 94, f. 57, Hadithi 3.

² “Usulul Kafi”, vëll. 3, f. 501, Hadithi 16. Uesailu Shia, vëll. 9, f. 210, Hadithi 11858.

Praktika e dëshmuar e Profetit (*Paqja dhe bekimet e All'lahut qofshin mbi dhe mbi familjen e tij!*), Imamëve të Ehli Bejtit (*Paqja qoftë mbi ta!*) dhe shokëve të tyre, gjithashtu e miratojnë këtë kuptim.

Përveç kësaj, duke pasur parasysh faktin që zekati është një taksë islame dhe qeveria islame e ka për detyrë që t'ua marrë njerëzve dhe synimi prej ligjvënies së tij është eliminimi i nevojave të ndryshme të shoqërisë islame, natyrisht që mënyra e shpenzimit të tij në këto shpenzime tetë llojeshe, do të jetë në varësi të nevojave të shoqërisë nga njëra anë dhe nga vendimi i qeverisë islame, nga ana tjetër.

3- Kur është bërë e detyruar dhënia e zekatit?

Nga ajete të ndryshme kur'anore, si p.sh ajeti 156 i sures "El A'raf", ajeti 3 i sures "En Neml", ajeti 4 i sures "Lukman" dhe ajeti 7 i sures "Fussilet", që janë sure mekase, përftohet: Urdhri i detyrimit të zekatit ka zbritur në Mekë dhe myslimanët ishin përgjegjës për kryerjen e këtij detyrimi islam. Por në kohën që Profeti (*Paqja dhe bekimet e All'lahut qofshin mbi dhe mbi familjen e tij!*) emigroi në Medine dhe vuri themelet e shtetit Islam, natyrisht lindi nevoja për themelimin e institucionit të "Thesarit të shtetit". I Dërguari (*Paqja dhe bekimet e All'lahut qofshin mbi dhe mbi familjen e tij!*) u ngarkua (caktua) nga ana e Zotit që zekatin t'ua marrë vetë personalisht njerëzve (dhe jo të jetë kështu që vetë ta harxhojnë atë sipas dëshirës dhe caktimit të tyre).

Ajeti "**Merr prej pasurisë së tyre lëmoshë...**"¹ ka zbritur në këtë kohë dhe është e pranuar që kjo ka ndodhur në vitin e dytë të hixhretit. Më pas rastet e harxhimit të lëmoshës janë shpjeguar në

¹ Sure "Et Teube", ajeti 103.

ajetin që po diskutojmë, pra, në ajetin 60 të kësaj sureje. Nuk është për t'u habitur që përcaktimi i grumbullimit të zekatit të jetë dhënë në ajetin 103, kurse përmendja e rasteve të përdorimit të tij, që pohojnë se ka zbritur në vitin e nëntë të hixhretit, të jetë dhënë në ajetin 60.

Dimë që ajetet kur'anore nuk janë grumbulluar në bazë të datës, pra, sipas dinamikës kohore të zbritjes, por me urdhrin e Profetit (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi dhe mbi familjen e tij!*) secili është vënë në vendin e përshtatshëm.

4- Cilët persona synohen me shprehjen “muel'lefetun kulubehum” - “atyre që duhet përfituar zemrat”?

Ajo që përfitohet nga shprehja “muel'lefetun kulubehum” është: Një prej rasteve të shpenzimit të zekatit janë njerëzit që u duhet dhënë zekati, për shkak të afrimit dhe të krijimit të dashamirësisë. Por a synohen vallë me ta njerëzit politeistë dhe jobesimtarë, të cilët, për shkak të nevojës për bashkëpunim në rrugën e Zotit nxiten me anë të ndihmës dhe përkrahjes financiare? Apo përfshin gjithashtu edhe myslimanët me besim të dobët?

Ashtu siç e kemi cekur edhe në diskutimet juridike islame, ky ajet dhe po ashtu ca prej haditheve që janë transmetuar për këtë temë, kanë një kuptim të gjerë. Kjo kategori përfshin të gjithë njerëzit, të cilët, me anë të stimulimit financiar, zemrat e tyre afrohen në interes të Islamit dhe të myslimanëve dhe nuk ekziston asnjë arsye për specifikimin e ajetit për jobesimtarët.

5- Roli i zekatit në Islam

Islami nuk u shfaq thjesht si një shkollë morale, filozofike apo ideologjike, por si një “fe universale”, në të cilën janë parashikuar të gjitha nevojat materiale dhe shpirtërore.

Islami, që nga periudha e Profetit (*Paqja dhe bekimet e All'lahut qofshin mbi dhe mbi familjen e tij!*) ka qenë e shoqëruar me formimin e qeverisë. Gjithashtu, duke pasur parasysh faktin që Islami i kushton një rëndësi të veçantë përkrahjes së nevojtarëve dhe luftës kundrejt diferencave shtresore (klasore), në shoqëri bëhet e qartë që roli i “thesarit të shtetit” dhe i “zekatit”, si njëri prej burimeve të të ardhurave të “Buxhetit shtetëror”, është prej roleve më të rëndësishme.

Pa dyshim që në çdo shoqëri jetojnë njerëz të tërhequr nga puna, të sëmurë, jetimë pa strehë, invalidë dhe të ngjashëm me ta, të cilët duhet të mbështeten dhe duhet të përkrahen.

Për të ruajtur ekzistencën e vet, karshi agresionit të armikut, shoqëria ka nevojë për ushtarë luftarakë, që shpenzimet e tyre të mbulohen nga ana e qeverisë.

Po ashtu, zyrtarët e qeverisë islame, gjyqtarët, prokurorët, mjetet e informimit dhe qendrat fetare, secila nga këto, ka nevojë për një shpenzim, që realizohet me një mbështetje të rregullt financiare dhe të sigurt.

Pikërisht për këtë arsye, në Islam çështja e zekatit, që në realitet konsiderohet si një lloj “takse mbi të ardhurat dhe prodhimin” dhe “tatim mbi pasurinë pasive”, ka një rëndësi të veçantë, në mënyrë që të renditet në adhurimet më të

rëndësishme. Në shumë raste është përmendur krahas namazit, madje është konsideruar edhe si kusht i pranimit të namazit.

Madje në hadithet islame lexojmë se kur qeveria islame kërkon zekatin nga një individ apo nga disa individë dhe ata e kundërshtojnë dhënien dhe shfaqin kryeneçësi, konsiderohen si të dalë jashtë feje dhe, në rast se këshillat nuk u sjellin dobi atyre, është e lejuar përdorimi i forcës ushtarake kundër tyre.

Në një hadith të transmetuar nga Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) lexojmë: *“Ai që nuk paguan një karat nga zekati, as nuk është besimtar dhe as nuk është mysliman dhe nuk ka asnjë vlerë.”*¹

Interesant është fakti që nga transmetimet përftohet që “kufiri” dhe “sasia” e zekatit është përcaktuar në mënyrë aq të saktë dhe të përpiktë në Islam, saqë, nëse të gjithë myslimanët do të jepnin zekatin e pasurisë së tyre në mënyrë të saktë dhe të plotë, nuk do të mbetej asnjë person i varfër dhe i vobektë mbi territorin e shtetit islam.

Në një hadith nga Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) lexojmë: *“Nëse të gjithë njerëzit do të jepnin zekatin e pasurisë së tyre, nuk do të mbetej asnjë mysliman i varfër apo i vobektë ... dhe njerëzit nuk bëhen të varfër, nevojtarë, të uritur dhe të zhveshur veç për shkak të mëkatit të të pasurve.”*²

¹ “Uesailu Shia”, vëll. 6, f. 20, K. 4, Hadithi 9, (vëll.9, f. 35, Hadithi 11457, Botim i shtëpisë botuese "Ehli Bejt"; “Biharul Enuar”, vëll. 93, f 11, Hadithi 12; “Men la jehdherehul fakijh”, vëll.4, f. 368.

² “Uesailu Shia”, vëll. 6, f. 4, K.1, Hadithi 6, (vëll. 9, f. 12, Hadithi 11392, Botim i shtëpisë botuese "Ehli Bejt"; “Min la jehdheruhu el Ifakih”, vëll. 2, f. 7, Hadithi 1579, (Botimet “Xhammee muderesin”); “Evaliel Ali”, vëll. 8, f. 370, Hadithi 74, Botimet e shtëpisë botuese "Sejjidu Shuheda".

Nga transmetimet përftohet se dhënia e zekatit bëhet shkak i ruajtjes së vet pronës dhe përforcimit të themeleve të saj, në mënyrë që, nëse populli e lë në harresë këtë parim të rëndësishëm të Islamit, hendeku mes njerëzve do të bëhej aq i madh, sa që në fund pasuria e pasanikëve, gjithashtu, do të vihej në rrezik. Në një haidth nga Imam Rizai (*Paqja qoftë mbi të!*) lexojmë: “*Ruani pasurinë tuaj me anë të dhënies së zekatit.*”¹

E njëjta domethënie është transmetuar edhe nga Profeti (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi dhe mbi familjen e tij!*) dhe Imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*) në hadithe tjera.²

Për më shumë informacion për këto hadithe, referohuni në kapitujt një, tre, katër dhe pesë të diskutimi rreth zekatit, në vëllimin e gjashtë të librit “Uesailu Shia”.

6- Dallimi i fjalëve dhe dallimi i rregullave

Pika e fundit që i duhet kushtuar vëmendje në ajetin 60, për katër grupet, është përmendja e pjesëzës “li”. Kjo zakonisht është shenjë e “pronësisë”. Por, në lidhje me katër grupet e tjera është përdorur pjesëza “fi” dhe kjo shprehje përdoret zakonisht për shpjegimin e “shpenzimit”.

Në mesin e komentuesve të Kur’anit për komentimin e kësaj diference, në të shprehur ekzistojnë polemika:

¹“Uesailu Shia”, vëll. 6, f. 6, K. 1, Hadithi 11, (vëll.9, f. 11, Hadithi 11391, f. 14, Botim Botim i shtëpisë botuese "Ehli Bejt"; “Usulul Kafi”, vëll. 4, f 61, Hadithi 5, (Darul kutubul islamije); “Biharul Enuar”, vëll. 48, f. 150, Hadithi 25.

² “Men la jehdherehul fakijh”, vëll. 4, f. 416, Hadithi 5914, (Botimet e shtëpisë botuese “Xhamiul muderesin”) “Uesailu Shia”, vëll. 9, f. 15, Hadithi 11402; f. 24, Hadithi 11427; f. 29, Hadithi 11443; f. 403, Hadithi 12337, Botim i shtëpisë botuese "Ehli Bejt"; “Biharul Enuar”, vëll. 75, f. 60, f. 203 dhe 208, vëll. 90, f. 288.

Disa janë të mendimit se grupi i parë katër llojesh janë pronarë të zekatit, kurse grupi i dytë katër llojesh nuk janë pronarë të tij dhe është e lejueshme që vetëm zekati të harxhohet rreth tyre.

Sipas disa të tjerëve, ky ndryshim, në shprehje është aluzion për një çështje tjetër, që do të thotë se grupi i dytë i përbërë prej katër kategorish kanë më shumë të drejtë për zekatin, sepse pjesëza "fi" është për të shprehur kapacitetin, sikur që ky grup prej katër kategorish janë "ena" e zekatit, kurse zekati e mbush "enën". Ndërkohë që kategoritë e para te grupi i parë nuk ishin të tillë. Ne këtu kemi përzgjedhur një variant tjetër, në mënyrë që gjashtë kategoritë e të varfërve, të vobektëve, të mbledhësve, të atyre që u duhet përfituar zemra, për lirim nga skllavëria, që janë përmendur pa pjesëzën "fi", janë njësoj dhe lidhen me njëra-tjetrën, kurse dy grupet e tjera, që janë të rënduarit nga borxhet, luftëtarët në rrugën e All'Ilahut dhe njerëzit që kanë mbetur në rrugë, që përmenden me pjesëzën "fi", kanë një statut të veçantë.

Mbase ky ndryshim në shprehje është për shkak se gjashtë kategoritë e para mund të bëhen pronar të zekatit dhe zekatin mund t'ua paguajmë atyre (madje borxhlinjve dhe atyre që nuk mund ta shlyejnë huan e marrë, por vetëm në rast se jemi të sigurt se do ta shfrytëzojë atë (zekatin) për shlyerjen e borxhit).

Kurse përsa i përket dy kategorive të fundit, ata nuk bëhen pronarë të zekatit dhe, në thelb, nuk mund t'ua japim zekatin atyre, por duhet të harxhohet për ta, për shembull skllëverit duhet të lirohen me anë të zekatit, duke paguar lekë për ta.

Është e qartë që këtu ata nuk bëhen pronarë të zekatit, siç është situata edhe për rastet që trajtohen nën titullin “të zellshmit në rrugën e All’llahut”, si p.sh, harxhimet për luftë, sigurimin e armatimit, apo ndërtimin e xhamive dhe qendrave fetare, ku askush nuk bëhet pronar i zekatit, por zekati harxhohet për blerjen e objekteve në fjalë.

Sidoqoftë, ky ndryshim në shprehje tregon se sa të përpikta dhe të mirëllogaritura janë shprehjet e Kur’anit.

Ajeti 61

وَمِنْهُمْ الَّذِينَ يُؤْذُونَ النَّبِيَّ وَيَقُولُونَ هُوَ أُذُنٌ قُلْ أُذُنٌ خَيْرٌ
لَّكُمْ يُؤْمِنُ بِاللَّهِ وَيُؤْمِنُ لِلْمُؤْمِنِينَ وَرَحْمَةٌ لِلَّذِينَ ءَامَنُوا
مِنْكُمْ وَالَّذِينَ يُؤْذُونَ رَسُولَ اللَّهِ لَهُمْ عَذَابٌ أَلِيمٌ ﴿٦١﴾

“Ka të atillë që e shqetësojnë të Dërguarin dhe thonë: ‘Ai dëgjon çdo gjë që i thuhet’. Thuaj (o Muhammed): ‘Ai dëgjon atë që është e mirë për ju, beson në All’llahun dhe u beson besimtarëve. Ai është mëshirues për ata që besuan nga mesi juaj. Kurse ata që e lëndojnë të Dërguarin e All’llahut, i pret një ndëshkim i dhembshëm.’”

Shkaku i zbritjes

Për ajetin 61 janë përmendur disa shkaqe zbritjesh, të cilat nuk ndryshojnë shumë nga njëri-tjetri, si p.sh: Ky ajet ka zbritur për një grup hipokritësh, të cilët ishin ulur rreth njëri-tjetrit dhe e tallnin Profetin (*Paqja dhe bekimet e All’llahut qofshin mbi dhe mbi familjen e tij!*) me fjalë të papërshtatshme dhe fyese. Njëri prej tyre tha: “Mos e bëni këtë, sepse kam frikë se Profeti (*Paqja dhe bekimet e All’llahut qofshin mbi dhe mbi familjen e tij!*) t’i dëgjojë fjalët tuaja dhe të flasë keq për ne, duke i kthyer njerëzit kundër nesh. Një njeri prej tyre, Xhelas, u ngrit dhe tha: “Nuk është e rëndësishme,

ne mund të flasim çfarë të dëshirojmë. Nëse ai dëgjon për fjalët tona, do të shkojmë te ai dhe ai do t'i pranojë fjalët tona, sepse është një njeri i dëgjueshëm, që beson shpejt, pranon fjalën e gjithsecilit, çfarëdo qoftë ajo. Në këtë moment zbriti ajeti i lartpërmendur dhe në këtë mënyrë iu dha përgjigjja atyre."¹

Komentimi

Në këtë ajet, ashtu siç e kuptojmë edhe nga përmbajtja e tij, flitet për një person apo për disa, të cilët e shqetësonin Profetin (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi dhe mbi familjen e tij!*), duke e fyer atë: **"Ka të atillë që e shqetësojnë të Dërguarin dhe thonë: 'Ai dëgjon çdo gjë që i thuhet.'"**

Fjala *"udhun"*, në thelb, është në kuptimin e veshit. Por kjo shprehje përdoret edhe për personat që i dëgjojnë shumë fjalët e të tjerëve, thënë ndryshe, janë të dëgjueshëm.

Ata, një prej pikave të forta të Profetit (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi dhe mbi familjen e tij!*), që te një udhëheqës është plotësisht e nevojshme, e shfaqnin si pikë të dobët dhe nuk ishin në dijeni të këtij fakti, që një udhëheqës i dashur duhet të tregojë miqësinë dhe dashurinë absolute. Mundësisht të pranojë justifikimet apo shfajësimet e njerëzve dhe t'ua mbulojë të metat e tyre (veç në rast se një vepër e tillë bëhet shkak e keqpërdorimit).

¹ Tefsiri "El Mizan", vëll. 9, f. 323, Botimet e shtëpisë botuese "Xhamiu muderesin"; "Biharul Enuar", vëll. 22, f. 95, Hadithi 48, (me pak ndryshim) dhe vëll. 22, f. 38-39, "Durrul Menthur", vëll. 3, f. 253, "Darul Mearif", "Mexhmaul Bejjan", ajeti në fjalë, (duke pasur parasysh faktin që ndonjëherë në burimet në vend të emrit "*Xhilas*" është përdorur emri "*Khelas*").

Andaj Kur'anit menjëherë shton: Thuaju atyre, nëse Profeti dëgjon fjalët tuaja dhe pranon justifikimet tuaja dhe sipas jush është një njeri i dëgjueshëm, kjo është në dobinë tuaj: **“Thuaj (o Muhammed): ‘Ai dëgjon atë që është e mirë për ju.’”**

Në këtë mënyrë e ka ruajtur nderin tuaj, nuk e ka shkelur personalitetin tuaj, nuk i ka lënduar ndjenjat tuaja. Me anë të kësaj përpiket ta ruajë dashurinë, miqësinë dhe unitetin tuaj. Ndërkohë që, nëse ai menjëherë i heq perdet dhe nxjerr në pah gënjeshtat tuaja, do të lindnin probleme të shumta. Përveç kësaj, disave midis jush do t'u humbiste nderi shpejt, do të mbyllej dhe rruga e rikthimit dhe e pendimit dhe njerëz të përlyer, por të denjë për udhëzim, do të zinin vend në radhët e të këqijve. Në këtë mënyrë do të largoheshin prej Profetit (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi dhe mbi familjen e tij!*).

Një udhëheqës karizmatik dhe i dhembshur, ndërkohë i ditur dhe i mençur, duhet të kuptojë dhe të vërë re çdo gjë, por shumë prej gjërave që i di nuk duhet t'i shfaqë, në mënyrë që ata që janë të denjë për edukim, të korigjojnë veten e tyre, të mos largohen nga shkolla e tij, si dhe të mos zbulohen të fshehtat e njerëzve.

Ekziston edhe kjo mundësi për kuptimin e ajetit, që Zoti i Madhëruar, në përgjigje të atyre që e shqetësonin dhe e fyenin Profetin (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi dhe mbi familjen e tij!*), thotë: “nuk është ashtu, që ai dëgjon të gjitha fjalët e njerëzve.

Por ai dëgjon fjalët që janë në dobi dhe në të mirën tuaj, që do të thotë, e dëgjon shpalljen hyjnore, dëgjon propozimin dhe

sugjerimin e dobishëm, si dhe pranon justifikimet e njerëzve kur ato janë në dobi të tyre apo në dobi të shoqërisë.”¹

Më pas, për shkak të asaj që fyesit të mos e keqpërdornin këtë shprehje dhe të mos e përdornin atë si pretekst, shton: **“Ai beson në All’llahun dhe u beson besimtarëve.”**

Në realitet, Profeti (*Paqja dhe bekimet e All’llahut qofshin mbi dhe mbi familjen e tij!*) ka dy lloj programesh: Njëri është programi i ruajtjes së anës së jashtme dhe parandalimit të grisjes së perdeve të privatësisë dhe tjetri, programin në fazën e praktikës, në fazën e parë i dëgjon fjalët e të gjithëve dhe nuk i kundërshton ato. Kurse në pozitën e praktikës, vëmendja e tij është vetëm ndaj urdhrave të Zotit, propozimeve dhe fjalëve të besimtarëve fjalëdrejtë. Një udhëheqës dhe lider i drejtë duhet të jetë i tillë dhe sigurimi i interesave të shoqërisë nuk është e mundur përveç në këtë mënyrë. Kështu që menjëherë shton: **“Ai është Mëshirues për ata që besuan nga mesi juaj.”** “

Këtu lind pyetja: Pse në disa vende në Kur’an lexojmë: **“Profeti është mëshirë për botët.”**²

Ajeti në fjalë thotë: **“Ai është mëshirë për besimtarët.”** A përputhet vallë ai kuptim i “përgjithësim” me këtë “veçim”?!

Por duke pasur parasysh një gjë, bëhet e qartë edhe përgjigjja e kësaj pyetjeje, e cila është: Mëshira mbart në vetvete

¹ Në realitet, në bazë të komentimit të parë, fjala “uhunu khejr”, është si shtim i emrit ndaj mbiemrit. Në bazë të komentimit të dytë, është si shtim i kallëzuesit emëror ndaj kallëzuesit.

Në bazë të mundësisë së parë, kuptimi i shprehjes do të ishte: “Ai është një pranues i mirë për ju”. Në bazë të mundësisë së dytë, kuptimi i shprehjes do të ishte: “Ai dëgjon fjalët e dobishme dhe të mira në dobinë dhe të mirën tuaj dhe jo çdo fjalë.”

² Sure “Enbija”, ajeti 107.

grada dhe nivele, në mënyrë që një prej niveleve të saj është “potenciale dhe në perspektivë”, kurse niveli tjetër është “aktual”.

Për shembull, shiu është mëshirë e Zotit, që do të thotë, aftësia dhe kapaciteti për të qenë burim i bekimit, i zhvillimit dhe i jetesës ekziston në të gjitha pikat e shiut, por padyshim që realizimi dhe manifestimi i efekteve të kësaj mëshire bëhet vetëm në tokat e gatshme dhe të përpunuara.

Në bazë të kësaj, ashtu siç mund të themi se të gjitha pikat e shiut janë “mëshirë”, gjithashtu është e drejtë, të themi “pikat e shiut janë burim i mëshirës në tokat e gatshme dhe të përpunuara”. Fjalja e parë është aludim për fazën e “kërkesës dhe e potencialit”, kurse fjalja e dytë është aludim për fazën e “ekzistencës dhe të aktualitetit”.

Profeti (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi dhe mbi familjen e tij!*) është mëshirë për të gjithë botët, por në fakt (aktualisht) është vetëm për besimtarët. E vetmja çështje, që mbetet këtu është se ata që e shqetësojnë dhe e fyejnë Profetin (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi dhe mbi familjen e tij!*) të pretendojnë dhe të imagjinojnë, se do të mbeten pa u ndëshkuar. Është e drejtë dhe detyrë e Profetit (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi dhe mbi familjen e tij!*) të silltet me ata me zemërgjerësi, me dashuri dhe të përmbahet nga fyerja dhe turpërimi i tyre. Por kjo nuk do të thotë, që ata nuk do të ndëshkohen për veprat e tyre.

Andaj në fund të ajetit thotë: **“Kurse ata që e lëndojnë të Dërguarin e All'llahut, i pret një ndëshkim i dhembshëm.”**

Ajeti 62 - 63

يَخْلِفُونَ بِاللَّهِ لَكُمْ لِيُرْضُوكُمْ وَاللَّهُ وَرَسُولُهُ أَحَقُّ أَنْ يُرْضُوهُ
 إِنْ كَانُوا مُؤْمِنِينَ ﴿٦٢﴾ أَلَمْ يَعْلَمُوا أَنَّهُ وَمَنْ يُجَادِدِ اللَّهَ وَرَسُولَهُ
 فَأَنَّ لَهُ نَارَ جَهَنَّمَ خَالِدًا فِيهَا ذَلِكَ الْخِزْيُ الْعَظِيمُ ﴿٦٣﴾

“Ata ju betohen për All’llahun për t’ju kënaqur, por është më e drejtë të kënaqin All’llahun dhe të Dërguarin e Tij, nëse janë besimtarë.”

“Vallë, a nuk e dinë ata, se për atë që e kundërshton All’llahun dhe të Dërguarit e Tij, është përgatitur zjarri i Xhehennemit, në të cilin do të qëndrojë përherë? Ky është poshtërimi më i madh!”

Shkaku i zbritjes

Nga thëniet e disa prej komentuesve të Kur’anit përftohet se ajetet 62-63 janë plotësuese të ajetit 61 dhe ka zbritur pikërisht për rrethanat dhe ngjarjet në kohën e zbritjes. Një grup tjetër nga komentuesit e Kur’anit kanë përcjellë një tjetër shkak zbritjeje për këto dy ajete.

Me rastin e qortimit të njerëzve, që nuk iu bashkuan Betejës së Tebekut, zbritën disa ajete. Njëri prej hipokritëve tha: “Betohem në Zot, ky grup është prej të mirëve dhe fisnikëve tanë. Nëse atë që e

thotë Muhammedi për ata, është e drejtë, këta janë edhe më poshtë se sa shtazët me katër këmbë."

Njëri nga myslimanët, pasi e dëgjoji këtë fjalë, u ngrit dhe tha: *"Betohem në Zot, atë që e thotë Profeti është e drejtë. Edhe ti je më poshtë se kafshët!"*

Kjo bisedë arriti te veshët e Profetit (*Paqja dhe bekimet e All'lahut qofshin mbi dhe mbi familjen e tij!*) dhe ai u nis pas njeriut hipokrit dhe e pyeti se pse foli në atë mënyrë. Ai u betua se nuk kishte thënë diçka të tillë. Besimtari që vetë e kishte vënë në dijeni Profetin (*Paqja dhe bekimet e All'lahut qofshin mbi dhe mbi familjen e tij!*) për këto fjalë, tha: *"O Zot! Vërteto të drejtin dhe përgënjeshtro gënjeshtarin!"*

Ndërkohë zbritën ajetet e lartpërmendura dhe ua bëri të qartë gjendjen e tyre.¹

Komentimi

Fytyra prej të drejtit të hipokritëve

Një prej shenjave të hipokritëve, veprave të shëmtuara dhe të liga të tyre, që Kur'ani e ka përmendur shumë herë, është se ata, për të mbuluar fytyrat e tyre, mohonin shumë prej veprimeve të tyre të liga. Me anë të betimeve të rreme dëshironin që të mashtronin njerëzit dhe të kënaqnin veten e tyre.

Në ajetet e lartpërmendura, Kur'ani i Madhëruar ka hequr një perde nga kjo vepër e tyre e shëmtuar dhe i qorton ata.

¹ "Biharul Enuar", vëll.22, f. 39, vëll. 17, f. 183; "Mexhmaul Bejjan", ajeti në fjalë.

Myslimanët i bën të vetëdijshëm që të mos bien pre e këtyre betimeve të rreme. Në fillim thotë: **“Ata ju betohen për All’llahun për t’ju kënaqur.”**

Është e qartë që synimi i tyre nga këto betime të rreme nuk është shprehja e së vërtetës, por dëshirojnë që, me anë të mashtrimit dhe të hiles, të maskojnë fytyrën e tyre të vërtetë në optikën tuaj dhe në këtë mënyrë t’ia arrijnë qëllimit. Në të kundërt, nëse synimi i tyre do të ishte ky, që me të vërtetë dëshironin t’i gëzonin besimtarët e vërtetë, më e nevojshme do të ishte kjo që të kënaqnin Zotin dhe Profetin e Tij, ndërkohë që ata, me anë të veprave të tyre, në mënyrë të rëndë e kanë bërë të pakënaqur Zotin dhe Profetin (*Paqja dhe bekimet e All’llahut qofshin mbi dhe mbi familjen e tij!*).

Andaj Kur’ani thotë: **“...por është më e drejtë të kënaqin All’llahun dhe të Dërguarin e Tij, nëse janë besimtarë.”**

I rëndësishëm është fakti, që në fjalinë e lartpërmendur, meqenëse bëhet fjalë për Zotin dhe Profetin (*Paqja dhe bekimet e All’llahut qofshin mbi dhe mbi familjen e tij!*) me patjetër që përemri “*jurdh’uhu*” duhet të ishte në shumës, ndërkohë që përemri është përdorur në njëjës. Kjo shprehje është aludim që kënaqësia e Profetit nuk është e ndarë nga kënaqësia e Zotit dhe pëlqen atë që pëlqen Zoti. Thënë ndryshe, është aludim për thelbin e “monoteizmit vepror”, sepse Profeti (*Paqja dhe bekimet e All’llahut qofshin mbi dhe mbi familjen e tij!*), karshi Zotit, nuk ka asnjë pavarësi nga vetja e vet, andaj kënaqësia dhe hidhërimi i tij, që të gjitha, i kthehen Zotit, çdo gjë është për Të dhe në rrugën e Tij.

Në disa hadithe është transmetuar se në kohën e Profetit (*Paqja dhe bekimet e All’llahut qofshin mbi dhe mbi familjen e tij!*) një burrë gjatë fjalimeve të veta u shpreh në këtë mënyrë: “*Ai që i bindet Zotit dhe Profetit të Tij është në rrugë të drejtë, kurse ai që i*

kundërshton këta të dy (Zotin dhe Profetin) i është shmangur rrugës së drejtë."

Kur Profeti e dëgjoji këtë shprehje, që personi atë (Profetin) dhe Zotin i ka renditur në një nivel dhe i ka përmendur me përemrin në shumës, u shqetësua dhe tha: *"Ti je një njeri që flet përçart! Përse nuk the çdokush që e kundërshton All'llahun dhe të Dërguarin e Tij ... ? dhe në vend të përemrit në shumës përmende përemrin në njëjës dhe the: "Çdokush që i kundërshton ata të dy.)"*¹

Në ajetin në vijim i kërcënon ashpër njerëzit hipokritë: **"Vallë, a nuk e dinë ata, se për atë që e kundërshton All'llahun dhe të Dërguarit e Tij, është përgatitur zjarri i Xhehennemit, në të cilin do të qëndrojë përherë?"**

Më pas, për ta theksuar atë, shton: **"Ky është poshtërimi më i madh!"**

Fjala *"juhadid"* rrjedh nga fjala *"muhadde"* dhe rrënja *"hadd"* është në kuptimin e anës dhe fundit të një gjëje. Duke pasur parasysh faktin se njerëzit armiq dhe kundërshtarë gjithnjë ndodhen përballë palës së kundërt, kjo fjalë *"muhadde"* është përdorur edhe në kuptimin e armiqësisë dhe të urrejtjes, ashtu si në bisedat e përditshme, grupin emëror *"pala e kundërt"* e përdorim në kuptimin e *"kundërshtimit dhe të armiqësisë"*.

¹ Tefsiri "Ebul Fetuh Razi", ajeti në fjalë; Tefsiri "Kurtubi", vëll. 14, f. 233, ajeti 56 i sures "El Ahzab"; botoi "Muessesetul tarikhul el Arabi; Sahih Muslim": vëll. 3, f. 12, K. "Tekhfife el salat uel khutbe", botoi "Darul fikr Bejrut" (vëll.2, f. 594, hadithi 870; "Darul ihja el turathul Arabi"); "Biharul Enuar", vëll. 86, f. 233 dhe vëll. 88, f. 101; Gjithashtu, i ndjeri Mexhlisi, pas përmendjes së një hadithi të ngjashëm, ka dhënë një shpjegim.

Ajetet 64 - 66

يَحْذَرُ الْمُنَافِقُونَ أَنْ تُنزَلَ عَلَيْهِمْ سُورَةٌ تُنَبِّئُهُمْ بِمَا فِي قُلُوبِهِمْ
 قُلِ اسْتَهْزِئُوا إِنَّ اللَّهَ مُخْرِجٌ مَّا تَحْذَرُونَ ﴿٦٤﴾ وَلَئِنْ سَأَلْتَهُمْ
 لَيَقُولُنَّ إِنَّمَا كُنَّا نَخُوضُ وَنَلْعَبُ قُلْ أَبِاللَّهِ وَعَايَاتِهِ وَرَسُولِهِ
 كُنْتُمْ تَسْتَهْزِئُونَ ﴿٦٥﴾ لَا تَعْتَذِرُوا قَدْ كَفَرْتُمْ بَعْدَ إِيمَانِكُمْ
 إِنْ نَعَفَ عَن طَآئِفَةٍ مِّنْكُمْ نُعَذِّبْ طَآئِفَةً بِأَنَّهُمْ كَانُوا
 مُجْرِمِينَ ﴿٦٦﴾

“Hipokritët druajnë se do të shpallet ndonjë sure e cila do t'i lajmërojë se ç'ka në zemrat e tyre. Thuaj: 'Talluni po deshët! All'Ilahu sigurisht që do ta nxjerrë në pah atë së cilës ju i druheni.'”

“Nëse i pyet, ata do të të përgjigjen: 'Ne vetëm po bënim shaka dhe po luanim'. Thuaj: 'A mos vallë me All'Ilahun, Shpalljet dhe të Dërguarin e Tij po talleni?'”

“Mos u shfajësoni! Ju e mohuat fenë, pasi patët besuar. Nëse Ne i falim disa prej jush (për shkak se u penduan), do t'i ndëshkojmë të tjerët, ngase janë fajtorë (nuk u penduan për talljen që bënë).”

Shkaku i zbritjes

Shkaqet e zbritjes së ajeteve 64-66 janë të shumta. Të gjitha kanë të bëjnë me veprimet e hipokritëve pas Luftës së Tebukut. Po japim një shembull: Një grup hipokritësh, në një takim të fshehtë, kishin thurur komplot për vrasjen e Profetit (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi dhe mbi familjen e tij!*). Në rrugën e kthimit nga Lufta e Tebukut, t'i ngrinin pritë, duke fshehur fytyrat e tyre në një nga kthesat e rrugës dhe devenë e Profetit ta trembnin. Në këtë mënyrë ta vrisnin Profetin.

Zoti i Madhëruar e vuri në dijeni Profetin (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi dhe mbi familjen e tij!*) për këtë plan dhe ai urdhëroi një grup myslimanësh të jenë të kujdesshëm dhe t'i largojnë ata. Në kohën që Profeti (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi dhe mbi familjen e tij!*) arriti te ajo kthesa, Amari i kishte në dorë frenat e devesë së Profetit (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi dhe mbi familjen e tij!*), kurse Hudhejfeja e drejtonte nga prapa atë. Kur grupi i hipokritëve, që i kishin maskuar fytyrat e tyre, iu afruan, Profeti (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi dhe mbi familjen e tij!*) i tha Hudhejfesë: "Goditi devetë e tyre dhe largoji ata."

Hudhejfeja veproi në mënyrën e kërkuar. Në kohën që Profeti (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi dhe mbi familjen e tij!*) e kaloi kthesën pa ndonjë rrezik, iu drejtua Hudhejfesë dhe i tha: "A i njohe ata?"

Ai iu përgjigj: "Jo, nuk njoha asnjërin prej tyre."

Pas kësaj, Profeti (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi dhe mbi familjen e tij!*) ia tregoi atij të gjithë një nga një me emrat e tyre.

Hudhejfeja tha: “Meqenëse është kështu, përse nuk dërgon një grup njerëzish për t’i mbytur ata?”

Profeti tha: “Nuk dëshiroj që arabët të thonë: ‘Profeti (Paqja dhe bekimet e All’llahut qofshin mbi dhe mbi familjen e tij!), pasi fitoi mbi shokët e vet, filloi vrasjen e tyre!’”¹

Ky shkak zbritjeje është transmetuar nga Imam Bakiri (Paqja qoftë mbi të!) dhe është përmendur dhe në libra, hadithe dhe tefsire të shumta.

Në shkaku të zbritjes thuhet se një grup hipokritësh, kur panë pozitën e Profetit (Paqja dhe bekimet e All’llahut qofshin mbi dhe mbi familjen e tij!) karshi armikut, në Luftën e Tebukut, në shenjtë talljeje, thanë: “Ky burrë pretendon që do të pushtojë pallatet e Shamit, si dhe kështjellat e fuqishme të tyre, çka është e pamundur, e pamundur.”

Zoti i Madhëruar e informoi Profetin (Paqja dhe bekimet e All’llahut qofshin mbi dhe mbi familjen e tij!) për këtë ngjarje dhe Profeti urdhëroi që ta bllokojnë rrugën për këtë grup hipokritësh. Më pas i thirri dhe i qortoi për ato që kishin folur. Ata u justifikuan që nuk kishim ndonjë synim dhe qëllim të keq, po bënim shaka dhe u betuan për një gjë të tillë!²

¹ “Biharul Enuar”, vëll. 21, f. 196, “Mexhmaul Bejjan”, ajeti në fjalë.

² “Biharul Enuar”, vëll. 21, f. 196–197, “Mexhmaul Bejjan”, ajeti në fjalë.

Komentimi

Plani tjetër i rrezikshëm i hipokritëve

Në ajetet e kaluara vërejtëm se si hipokritët, pikat e forta i mendonin si pika të dobëta, dhe për të krijuar përçarje në mesin e myslimanëve, bënë propaganda kundër tyre. Në ajetet në fjalë, Kur'ani tregon një pjesë tjetër të planeve dhe të prapështive të tyre.

Nga ajeti 64 përftohet se Zoti i Madhëruar, për ta likuiduar rrezikun e hipokritëve kundrejt Profetit (*Paqja dhe bekimet e All'Ilahut qofshin mbi dhe mbi familjen e tij!*), ndonjëherë e hiqte perden nga sekretet e tyre dhe ia prezantonte shoqërisë, në mënyrë që myslimanët të bëhen të vetëdijshëm dhe të mos bien në kurthin e tyre. Nga ana tjetër, edhe ata gjithashtu të vetëdijsoheshin për pozitën e tyre dhe në këtë mënyrë të mblidhnin mendjen. Pikërisht për këtë arsye, zakonisht ata jetonin në një gjendje frike dhe paniku. Kur'ani, duke aluduar këtë gjendje, thotë: **“Hipokritët drujnë se do të shpallet ndonjë sure e cila do t'i lajmërojë se ç'ka në zemrat e tyre.”**

Por i çuditshëm është fakti se ata, nën efektin e kryeneçësisë dhe të armiçësisë së ashpër, përsëri nuk hiqnin dorë nga tallja dhe përqeshja për veprat e Profetit (*Paqja dhe bekimet e All'Ilahut qofshin mbi dhe mbi familjen e tij!*), andaj Zoti i Madhëruar në fund të ajetit 64 i drejtohet Profetit (*Paqja dhe bekimet e All'Ilahut qofshin mbi dhe mbi familjen e tij!*) duke i thënë: **“Thuaj: ‘Talluni po deshët! All'Ilahu sigurisht që do ta nxjerrë në pah atë së cilës ju i druheni.’”**

Është e qartë që fraza *“Talluni po deshët!”* është urdhër për kërcënim, ngjashëm me atë që njeriu i thotë armikut të vet: *“Kryej sa të kesh forca, marrëzi, ngacmim dhe shqetësime, këtyre do t'u përgjigjem njëherësh!”* Shprehje të tilla përdoren në pozitën e kërcënimit. Përveç kësaj, duhet të kemi parasysh që nga ajeti 64 përftojme gjithashtu se hipokritët në zemër ishin të vetëdijshëm

për vërtetësinë e thirrjes së Profetit (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi dhe mbi familjen e tij!*) dhe marrëdhënien e tij me Zotin e dinin më së miri. Por nën efektin e armiqësisë, të inatit dhe të kryeneçësisë që kishin ndaj së Vërtetës, në vend që t'i dorëzoheshin Atij, kryenin vepra jo të hijshme. Pikërisht për këtë arsye, Kur'ani thotë: *"Hipokritët kishin frikë nga kjo, që të zbritnin ajete kundër tyre, pasi në këtë mënyrë zbuloheshin planet e fshehta të tyre."*

Gjithashtu, duhet të kemi parasysh që grupi foljor *"do të zbresë mbi ta"* nuk është me këtë kuptim, që ajete të tilla i zbrisnin hipokritëve. Por synimi është që ajetet që zbrisnin kishin të bënin me ta dhe ishin kundër tyre, ndonëse i zbrisnin personalisht Profetit (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi dhe mbi familjen e tij!*).

Në ajetin vijues ka përmendur një prej programeve të tjera të hipokritëve dhe thotë: **"Nëse i pyet, ata do të të përgjigjen: 'Ne vetëm po bënim shaka dhe po luanim.'"**¹

Në realitet, kjo ishte një rrugë arratisjeje e çuditshme, që në fillim thurnin komplete dhe bënin propagandën e tyre helmuese, me qëllim që, nëse sekreti i tyre nuk do të zbulohet, do të realizohet synimi i tyre ogurzi, të arrinin qëllimin e vërtetë. Por nëse do të hiqeshin mënjanë perdet dhe do të zbuloheshin sekretet e tyre, fshihnin veten e tyre nën petkun e *"shakasë dhe të lojës"* dhe me anë të këtij justifikimi dhe shfajësimi të iknin nga ndëshkimi i Profetit (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi dhe mbi familjen e tij!*) dhe të njerëzve.

Hipokritët e sotëm dhe hipokritët e çdo kohe dhe periudhe, kanë programe të ngjashme dhe përfitojnë shumë nga kjo metodë,

¹ Fjala *"heudh"* ashtu siç është thënë edhe në librat e fjalorëve, është në kuptimin e hyrjes graduale në ujë. Më pas, si aluzion, është përdorur edhe në kuptimin e hyrjes në punët e ndryshme, por zakonisht në Kur'an është përdorur në kuptimin e hyrjes, të fillimit të punëve të shëmtuara dhe të këqija.

madje ndonjëherë ndodh që çështjet më serioze i trajtojnë nën petkun e shakave të thjeshta dhe të dëfrimit dhe, nëse ia arrijnë qëllimit të vet, aq më mirë. Në të kundërt, me anë të shprehjeve se ishte shaka dhe dëfrim ajo që thamë, do të iknin nga kthetrat e dënimit dhe të ndëshkimit.

Por, Kur'ani u përgjigjet atyre me anë të një shprehjeje vendimtare dhe goditëse. E urdhëron Profetin (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi dhe mbi familjen e tij!*): **“Thuaj: ‘A mos vallë me All'llahun, Shpalljet dhe të Dërguarin e Tij po talleni?’**”, që do të thotë, vallë a mund të bëhet shaka me çdo gjë, madje dhe me Zotin, Profetin (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi dhe mbi familjen e tij!*) apo ajetet kur'anore?

Vallë a bëhet shaka me këto gjëra, që janë çështjet më të rëndësishme?! Vallë trembja e devesë së Profetit (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi dhe mbi familjen e tij!*) dhe vrasja e tij në atë greminë të rrezikshme është gjë që mund ta mbulojmë nën petkun e shakasë? Apo mos vallë fyerja dhe tallja me ajetet kur'anore, si dhe me informacionet e Profetit, në lidhje me fitoret e së ardhmes, është një çështje që duhet të merret si shaka dhe lojë?! Të gjitha këto janë dëshmi e synimeve të tyre të rrezikshme, të cilat fshiheshin nën to.

Më pas Profetin (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi dhe mbi familjen e tij!*) e urdhëron në këtë mënyrë: Menjëherë thuaju këtyre hipokritëve: **“Mos u shfajësoni! Ju e mohuat fenë, pasi patët besuar.”**

Kjo shprehje është aludim se grupi i lartpërmendur nuk ishte në radhët e hipokritëve që në fillim, por ishte në radhët e besimtarëve me besim të dobët. Pas ngjarjes së lartpërmendur, ata e mohuan fenë dhe morën rrugën e politeizmit. Në komentimin e

fjalisë së lartpërmendur gjithashtu ekziston edhe kjo mundësi, që ky grup para kësaj ngjarjeje, gjithashtu, ishin në radhët e hipokritëve, por, meqenëse në dukje nuk kishin kryer ndonjë vepër të paligjshme, Profeti (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi dhe mbi familjen e tij!*) dhe myslimanët e kishin për detyrë që ata t'i merrnin si njerëz besimtarë. Kurse pas ngjarjes së Luftës së Tebukut çdo gjë u bë e qartë dhe doli në shesh mosbesimi dhe hipokrizia e tyre, ata u paralajmëruan që këtej e tutje nuk do të rreshtoheshin me myslimanët.

Si përfundim, ajetin e përfundon me këtë fjali: **“Nëse Ne i falim disa prej jush (për shkak se u penduan), do t'i ndëshkojmë të tjerët, ngase janë fajtorë (nuk u penduan për talljen që bënë).”**

Arsyeja e asaj që thotë se ne do t'i dënojmë dhe do t'i ndëshkojmë për shkak të krimeve dhe mëkateve të tyre është kjo, që “grupi i falëkërkuesve” janë njerëz që efektin e krimit dhe të mëkatit e kanë larë nga ekzistenca e tyre me anë të ujit të pendimit. Në ajetet në vijim, si p.sh. në ajetin 74, ekziston një evidencë për këtë çështje. Janë transmetuar shumë hadithe për këtë ajet, që na e bëjnë të qartë, që disa prej këtyre hipokritëve, u bënë pishman për veprat e veta dhe u penduan. Por disa të tjerë, po ashtu, vazhduan rrugën e tyre, që e kishin ndërmarrë. Dhe qëndruan në të njëjtën gjendje pa ndryshuar.¹

¹ Për më shumë informacion, referohuni në tefsirin “Nuruth Thakelejn, vëll. 2, f. 239; “Biharul Enuar”, vëll. 21, f. 221, vëll. 30, f. 77; Tefsiri “Kumi”, vëll. 1, f. 301, botim i “Muaseseh darul kitab”.

Ajetet 67 - 70

الْمُنْفِقُونَ وَالْمُنْفِقَاتُ بَعْضُهُمْ مِّنْ بَعْضٍ يَأْمُرُونَ بِالْمُنْكَرِ
 وَيَنْهَوْنَ عَنِ الْمَعْرُوفِ وَيَقْبِضُونَ أَيْدِيَهُمْ نَسُوا اللَّهَ فَنَسِيَهُمْ
 إِنَّ الْمُنْفِقِينَ هُمُ الْفَاسِقُونَ ﴿٦٧﴾ وَعَدَّ اللَّهُ الْمُنْفِقِينَ
 وَالْمُنْفِقَاتِ وَالْكُفَّارَ نَارَ جَهَنَّمَ خَالِدِينَ فِيهَا هِيَ حَسْبُهُمْ
 وَلَعَنَهُمُ اللَّهُ وَلَهُمْ عَذَابٌ مُّقِيمٌ ﴿٦٨﴾ كَالَّذِينَ مِّنْ قَبْلِكُمْ كَانُوا
 أَشَدَّ مِنْكُمْ قُوَّةً وَأَكْثَرَ أَمْوَالًا وَأَوْلَادًا فَاسْتَمْتَعُوا بِخَلْقِهِمْ
 فَلَسْتَمْتَعْتُمْ بِخَلْقِكُمْ كَمَا اسْتَمْتَعَ الَّذِينَ مِّنْ قَبْلِكُمْ
 بِخَلْقِهِمْ وَخُضْتُمْ كَالَّذِي خَاضُوا أُولَئِكَ حَبِطَتْ أَعْمَلُهُمْ فِي
 الدُّنْيَا وَالْآخِرَةِ وَأُولَئِكَ هُمُ الْخَاسِرُونَ ﴿٦٩﴾ أَلَمْ يَأْتِهِمْ نَبَأُ
 الَّذِينَ مِّنْ قَبْلِهِمْ قَوْمِ نُوحٍ وَعَادٍ وَثَمُودَ وَقَوْمِ إِبْرَاهِيمَ
 وَأَصْحَابِ مَدْيَنَ وَالْمُؤْتَفِكَاتِ أَتَتْهُم رُسُلُهُم بِالْبَيِّنَاتِ فَمَا
 كَانَ اللَّهُ لِيَظْلِمَهُمْ وَلَكِن كَانُوا أَنفُسَهُمْ يَظْلِمُونَ ﴿٧٠﴾

“Hipokritët dhe hipokritet janë të ngjashëm me njëri-tjetrin: kërkojnë që të bëhen vepra të këqija e pengojnë të mirat dhe janë dorështrënguar. Ata e kanë harruar All’llahun, por edhe Ai i ka harruar ata. Me të vërtetë, hipokritët janë keqbërës.”

“All’llahu u ka premtuar hipokritëve, hipokriteve dhe mosbesimtarëve zjarrin e Xhehennemit, ku do të qëndrojnë përgjithmonë; ai do t’iu mjaftojë atyre! All’llahu i ka mallkuar dhe ata do të kenë dënim të vazhdueshëm.”

“(Ju hipokritë jeni) si ata që kanë qenë para jush! Ata kanë qenë më të fortë se ju, kanë pasur më shumë pasuri dhe fëmijë. Ata janë kënaqur me pjesën e vet të kësaj bote, por edhe ju po kënaqeni me pjesën tuaj siç janë kënaqur edhe ata; edhe ju jeni dhënë pas të këqijave, ashtu siç ishin dhënë ata. Veprat e tyre do të zhduken në këtë botë dhe në Tjetrën; ata janë të shkatërruar.”

“A nuk kanë dëgjuar ata për popujt që kanë qenë më përpara: për popullin e Nuhut, për fiset Ad dhe Themud, për popullin e Ibrahimit, për banorët e Medjenit dhe për qytetet e përmbysura (të popullit të Lutit)? Të Dërguarit e tyre u sollën shenja të qarta. All’llahu nuk u bëri padrejtësi, por ata i bënë padrejtësi vetvetes.”

Komentimi

Shenjat e hipokritëve

Në këto ajete gjithashtu flitet për hipokritët, sjelljet dhe shenjat e tyre. Ajeti 67 thekson një çështje të përgjithshme: Ka mundësi që shpirti hipokrit të shfaqet në forma të ndryshme, si dhe të manifestohet me fytyra të llojllojshme, në mënyrë që në

fillim nuk të tërheq vëmendjen, sidomos manifestimi i shpirti hipokrit te burri dhe te gruaja, mund të jetë tepër e ndryshme. Por nuk duhet të mashtrohem me ndryshimin e fytyrave të hipokrizisë te hipokritët. Me pak vëmendje dhe përqendrim bëhet e qartë që të gjithë janë të ngjashëm dhe kanë një mori karakteristikash, që konsiderohen si masa e përbashkët e tyre. Prandaj thotë: **“Hipokritët dhe hipokritet janë të ngjashëm me njëri-tjetrin.”**

Më pas përmend pesë cilësi të tyre:

Së pari dhe së dyti, ata prej njerëzve **“kërkojnë që të bëhen vepra të këqija e pengojnë të mirat.”** Kurse te besimtarët e vërtetë dhe të drejtë ndodh e kundërta e kësaj. Ata gjithnjë, me anë të “urdhrit për të mirë” dhe “ndalimit nga e keqja”, orvaten ta reformojnë dhe ta spastrojnë shoqërinë nga imoraliteti dhe korrupsioni. Hipokritët gjithnjë përpiqen që korrupsioni dhe imoraliteti të përhapet kudo dhe e mira dhe e dëlira të zhduket nga shoqëria, në mënyrë që ta kenë më të lehtë për t’ia arritur synimeve të tyre ogurzeza në një shoqëri të tillë të turbullt.

Së treti, **“janë dorështrënguar”**. Nuk japin në rrugën e Zotit, as nuk nxitojnë në ofrimin ndihmë të të varfërve dhe të vobektëve, si dhe as familjarët apo farefisi i tyre nuk përfitojnë nga ndihma e tyre financiare. Është e qartë se, meqenëse ata nuk besojnë në Ditën e Gjykimit, rrjedhojat dhe shpërblimet e bamirësisë në dhënien e pasurisë së tyre janë shumë koprracë, edhe pse për t’ia arritur synimeve të tyre të liga dhe ogurzeza shpenzojnë shumë nga pasuria e tyre, ose dhurojnë në shenjë

hipokrizie, por asnjëherë nuk janë të gatshëm që të shpenzojnë në shenjë sinqeriteti ose për hir të Zotit.

Së katërtri, të gjitha veprimet, fjalët dhe sjelljet e tyre tregojnë qartazi **“ata e kanë harruar All’Ilahun, por edhe Ai i ka harruar ata.”** Gjendja e jetesës së tyre tregon që Zoti i ka harruar ata, që do të thotë, me ata ka lidhur marrëveshjen e harresës dhe pasojat apo efektet e këtyre harresave vërehen qartë në të gjitha aspektet e jetës së tyre.

Është më se e qartë, që atribuimi i “harresës” ndaj Zotit nuk është në kuptimin e harresës së vërtetë, por është aluzion i kësaj që me ata sillet si njeriu harrestar, që do të thotë, atyre nuk u kushton asnjë vëmendje e as i bën pjesë në mëshirën dhe mirësinë e Vet.

Shprehje të tilla madje i vërejmë edhe në bisedat e përditshme, p.sh. kur themi: Meqenëse ti e ke harruar kryerjen e detyrës tënde, edhe ne në momentin e dhënies së shpërblimit, do të të harrojmë ty, që do të thotë nuk do të të shpërblejmë dhe nuk do të të paguajmë.

Ky kuptim, gjithashtu, është transmetuar edhe në hadithet e Ehli Bejtit.¹ Duhet të kemi parasysh faktin që çështja e “harresës” së Zotit i është kthyer harresës së tyre me anë të pjesëzës “fa”, që shpreh pasojën, që do të thotë se impakti i harresës së tyre, në lidhje me urdhrin hyjnor dhe Qenien e pastër të All’Ilahut është

¹ Tefsiri “Nuruth Thekalejn”, vëll.2, f. 239 dhe 240. (“Muaseseje Ismailijan”, Botim i katërt, 1412 Hixhri kameri); “Ejune Ekhhbare Ridha”, vëll. 1, f. 125, Hadithi 18; “Meaniul Ehbar”, f. 14, Hadithi 15, (intesharate xhamee muderesin) “Biharul Enuar”, vëll. 4, f. 63 dhe 91 dhe vëll. 90, f. 98-99.

ky, që edhe Zoti do t'i privojë ata nga Mëshira dhe Mirësia e Vet. Ky është rezultati i veprës së tyre.

Së pesti, është: **“Me të vërtetë, hipokritët janë keqbërës.”**

Ajo çfarë u tha në ajetin e lartpërmendur, në lidhje me cilësitë e përbashkëta të hipokritëve, vërehet në çdo epokë dhe në çdo periudhë kohore. Hipokritët e kohës sonë, me anë të fytyrave të reja që kanë sajuar për veten e tyre, në cilësimet e mësipërme janë të ngjashëm me hipokritët e shekujve të mëparshëm, edhe stimulojnë në imoralitet dhe korrupsion, edhe parandalojnë veprën e mirë, po ashtu janë edhe koprracë dhe dorështrënguar, si dhe e kanë harruar Zotin në të gjitha aspektet e jetës, si dhe nuk zbatojnë ligjin dhe janë të prishur e të degjeneruar.

Dhe më i çuditshëm është fakti, se, edhe pse i kanë këto cilësi, përsëri pretendojnë se besojnë në një Zot, si dhe besojnë fort dhe janë këmbëngulës në parimet fetare dhe islame.

Në ajetin 68, me anë të një fjalie të shkurtër, Zoti i Madhëruar ka shpalosur dënimet e tyre të ashpra dhe të rrezikshme: **“All’llahu u ka premtuar hipokritëve, hipokriteve dhe mosbesimtarëve zjarrin e Xhehennemit, ku do të qëndrojnë përgjithmonë; ai do t’iu mjaftojë atyre!”**

Thënë ndryshe, ata nuk kanë nevojë për asnjë dënim tjetër, sepse në Xhehennem ekzistojnë të gjitha llojet e torturave dhe të dënimeve trupore dhe shpirtërore. Në fund të ajetit thuhet: **“All’llahu i ka mallkuar dhe ata do të kenë dënim të vazhdueshëm.”**

Duhet të dimë që ky mallkim i Zotit dhe largim nga Ai, është dënimi më i madh, si dhe konsiderohet si ndëshkimi më i rrezikshëm për ta.

Përsëritja e historisë dhe marrja mësim nga e kaluara

Në ajetin 69, për t'ia tërhequr vëmendjen këtij grupi hipokritësh, vë përpara tyre pasqyrën e historisë dhe, duke krahasuar jetesën e tyre me hipokritët dhe kryeneçët e mëparshëm, u jep mësimet më të dobishme dhe thotë: **“(Ju hipokritë jeni) si ata që kanë qenë para jush! Ata kanë qenë më të fortë se ju, kanë pasur më shumë pasuri dhe fëmijë. Ata janë kënaqur me pjesën e vet të kësaj bote, por edhe ju po kënaqeni me pjesën tuaj siç janë kënaqur edhe ata.”**

Fjala *“khilak”* nënkupton hisen dhe përfitimin. Ragibi, në *“Mufredat”*, shprehet se kjo fjalë rrjedh nga rrënja *“shulk”* - *“karakter”* (ndoshta është për këtë arsye që njeriu interesat vetjake në këtë botë i përfiton në përputhje me karakterin e vet).

Më pas shton: **“edhe ju jeni dhënë pas të këqijave, ashtu siç ishin dhënë ata.”**

Më në fund, fundin e punës së hipokritëve të mëparshëm e shpreh me anë të dy fjalive, si shenjë paralajmërimi për të gjithë hipokritët dhe grupin e hipokritëve të kohës së Profetit (*Paqja dhe bekimet e All'Ilahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*).

Në fillim thotë: **“Veprat e tyre do të zhduken në këtë botë dhe në Tjetrën.”** Dhe tjetra: **“...ata janë të shkatërruar.”**

Ka mundësi që ata të kenë përfitime të *“përkohshme”* dhe në mënyrë të *“kufizuar”* nga veprimet e tyre hipokrite. Por nëse

shohim më saktë, do të vërejmë se as në këtë botë, me anë të kësaj, do të korrin ndonjë dobi dhe as në Botën Tjetër do të kenë ndonjë përfitim. Edhe historia e popujve të mëparshëm e ka dëshmuar një gjë të tillë, e ka bërë të qartë se si i kapluan dhimbjet dhe trishtimet e hipokrizisë dhe i tërhoqi ata drejt zhdukjes dhe asgjësimit. Fundi i tyre ogurzi dhe i mjerë është përshkrues i fatit të tyre në Botën Tjetër.

Vërejmë se ata, me gjithë ato mundësi dhe të mira materiale, pasuri dhe fëmijë, nuk kanë arritur asgjëkund dhe veprat e tyre u zhdukën dhe u shfarosën, që të gjitha nën efektin e faktorit të hipokrizisë, si pasojë e asaj që ishin pa themel, po ju që jeni në një shkallë dhe nivel më të ulët se ata, për nga pikëpamja e forcës dhe e fuqisë, është tepër e sigurt që do të keni një fat të tillë ogurzi dhe të mjerë.

Më në fund i drejtohet Profetit (*Paqja dhe bekimet e All'Ilahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) me anë të një pyetje retorike: **“A nuk kanë dëgjuar ata për popujt që kanë qenë më përpara: për popullin e Nuhut, për fiset Ad dhe Themud, për popullin e Ibrahimit, për banorët e Medjenit dhe për qytetet e përmbysura (të popullit të Lutit)?”¹**

Këta popuj, që dikur kishin nën pushtet territore të rëndësishme të botës secili nga ata, në një farë mënyrë, i kaploi ndëshkimi hyjnor si pasojë e ndonjë krimi, rebelimi apo kryeneçësie, apo largimit nga e vërteta dhe rruga e drejtë, si dhe kryerjes së ndonjë dhune, padrejtësie dhe korrupsioni.

¹ Fjala “*mutefikat*” rrjedh nga fjala “*i'tefak*” dhe është në kuptimin e revolucionit dhe të rrënimit. Është aludim për qytetet e popullit të Lutit (*Paqja qoftë mbi të!*), që u rrënuan me anë të tërmetit të fuqishëm.

Populli i Nuhit (*Paqja qoftë mbi të!*) u shkatërrua me anë të valëve të fuqishme të stuhisë dhe përmytjes, populli i Adit {populli i Profetit Hud (*Paqja qoftë mbi të!*)} me anë të erërave të forta dhe trishtuese, populli i Themudit {populli i Profetit Salih(*Paqja qoftë mbi të!*)} me anë të tërmeteve shkatërruese, populli i Ibrahimit (*Paqja qoftë mbi të!*) me anë të mohimit të llojeve prej begative, banorët e Medjenit {populli i Shuajbit (*Paqja qoftë mbi të!*)} me anë të reve flakëruese dhe populli i Lutit (*Paqja qoftë mbi të!*) me anë të rrënimit të qyteteve të tyre.

Vetëm gjallesat jo frymore dhe kockat e kalbura nën dhé, apo nën valët e ujërave mbeten prej tyre.

Këto janë tregime tronditëse dhe rrëqethëse, në mënyrë që studimi dhe hulumtimi i tyre e trondit zemrën e çdonjërit që mund të ketë sado pak ndjenja humane në zemrën e tij.

Edhe pse Zoti nuk i privoi ata asnjëherë nga mëshira e Vet: **“...të Dërguarit e tyre u sollën shenja të qarta.”**, por ata asnjëherë nuk i dëgjuan fjalët dhe këshillat e këtyre Lajmëtarëve hyjnorë dhe nuk vlerësuan mundimet dhe përpjekjet e tyre të palodhshme në rrugën e orientimit të krijesave të Zotit: **“All’Ilahu nuk u bëri padrejtësi, por ata i bënë padrejtësi vetvetes.”**

Ajetet 71 - 72

وَالْمُؤْمِنُونَ وَالْمُؤْمِنَاتُ بَعْضُهُمْ أَوْلِيَاءُ بَعْضٍ يَأْمُرُونَ بِالْمَعْرُوفِ
 وَيَنْهَوْنَ عَنِ الْمُنْكَرِ وَيُقِيمُونَ الصَّلَاةَ وَيُؤْتُونَ الزَّكَاةَ وَيُطِيعُونَ
 اللَّهَ وَرَسُولَهُ ۗ أُولَٰئِكَ سَيَرْحَمُهُمُ اللَّهُ إِنَّ اللَّهَ عَزِيزٌ حَكِيمٌ ﴿٧١﴾
 وَعَدَّ اللَّهُ الْمُؤْمِنِينَ وَالْمُؤْمِنَاتِ جَنَّاتٍ تَجْرِي مِنْ تَحْتِهَا الْأَنْهَارُ
 خَالِدِينَ فِيهَا وَمَسَاكِنَ طَيِّبَةً فِي جَنَّاتٍ عَدْنٍ وَرِضْوَانٌ مِّنَ اللَّهِ
 أَكْبَرُ ذَٰلِكَ هُوَ الْفَوْزُ الْعَظِيمُ ﴿٧٢﴾

“Besimtarët dhe besimtareet janë miq për njëri-tjetrin. Ata urdhërojnë që të bëhen vepra të mira dhe i ndalojnë të këqijat; falin namazin, japin zekatin dhe i binden All’Ilahut dhe të Dërguarit të Tij. Këta janë ata që do t’i mëshirojë All’Ilahu. Se, All’Ilahu me të vërtetë, është i Plotfuqishëm dhe i Urtë.”

“All’Ilahu u ka premtuar besimtarëve dhe besimtareve kopshte, nëpër të cilat rrjedhin lumenj dhe ku do të banojnë përgjithmonë, si dhe pallate të mrekullueshme në Xhennetin e Adnit. Por kënaqësia prej All’Ilahut është shpërblimi më i madh. Kjo është fitorja madhështore.”

Komentimi

Shenjat e besimtarëve të drejtë

Në ajetet e kaluara u prezantuan shenjat dhe qasjet e përbashkëta të burrave dhe të grave hipokrite, të cilat u përmbloodhën në pesë pjesë: “stimulimi për të keqen”, “ndalimi nga e mira”, “dorështrëngimi dhe koprracia”, “lënia në harresë nga ana e Zotit” dhe “kundërshtimi i urdhrit të Zotit”.

Në ajetet që po diskutojmë janë pasqyruar shenjat e burrave dhe grave besimtare, që edhe këto përmbliidhen në pesë cilësime. Secila nga këto janë pika e kundërt e secilës prej karaktereve të hipokritëve të lartpërmendur.

Ajeti i parë fillon në këtë mënyrë: **“Besimtarët dhe besimtares janë miq për njëri-tjetrin.”**

Interesant është fakti që për hipokritët nuk u tha që ata janë “miq” të njëri-tjetrit, por është përdorur shprehja “janë armiq të njëri-tjetrit”, që është argument për synimin e njëjtë dhe harmonia që ekziston mes karakteristikave dhe sjelljeve, duke aluduar në këtë që hipokritët, edhe pse renditen në të njëjtin rresht me njëri-tjetrin dhe grupet e ndryshme të tyre në përcaktime dhe programe janë të përbashkët, në mesin e tyre nuk ekziston një shpirt miqësor dhe bashkues. Interesat e tyre personale vihen në rrezik, madje janë në gjendje të tradhetojnë edhe shokun apo mikun e vet. Kjo është arsyeja e përmendjes në ajetin 14 të sures “El Hashr”: **“...mund të mendohet për ata se janë të bashkuar, e në realitet zemrat e tyre janë të përçara...”**.

Pas prezantimit të këtij parimi të përgjithshëm, i përshkruan me detaje cilësitë dhe karakteristikat e besimtarëve:

1- Në fillim thotë: **“Ata urdhërojnë që të bëhen vepra të mira.”**

2- **“dhe i ndalojnë të këqijat”.**

3- Ata, përkundër hipokritëve që e kishin harruar Zotin, **“falin namazin”**, e kujtojnë Zotin, dhe me anë të kujtimit dhe përmendjes së Tij i mbajnë zemrat gjallë, mendjen zgjuar dhe të ndërgjegjshëm.

4- Ata, përkundër njerëzve hipokritë, që ishin njerëz dorështrënguar dhe koprracë, e japin një pjesë nga pasuria e tyre në rrugën e Zotit, në ofrimin e ndihmës dhe mbështetjes ndaj krijesave të Zotit dhe rilindjes së shoqërisë: **“japin zekatin”**.

5- Hipokritët janë kryeneçë dhe të pabindur ndaj urdhrave të Zotit, përkundër besimtarëve: **“...i binden All'Ilahut dhe të Dërguarit të Tij.”**

Në përfundim të këtij ajeti përmendet përparësia e parë e besimtarëve, për nga pikëpamja e rezultatit dhe e shpërblimit: **“Këta janë ata që do t'i mëshirojë All'Ilahu.”**

Fjala *“rahmet”*, që është përmendur në këtë ajet, ka një kuptim shumë të gjerë dhe gjithëpërfshirës, e cila përfshin çdo lloj bamirësie, dobie, dhe lumturie në këtë botë dhe në Botën Tjetër. Kjo fjalë qëndron diametralisht kundërt me gjendjen e hipokritëve, që Zoti i Madhëruar i ka mallkuar dhe i ka privuar nga Mëshira e Vet.

Pa dyshim që premtimi i mëshirës ndaj besimtarëve, nga ana e Zotit, është i patjetërsueshëm dhe i sigurt: **“All'Ilahu me të vërtetë, është i Plotfuqishëm dhe i Urtë.”**

As që nuk premtion pa ndonjë arsye dhe as që dështon në zbatimin e premtimit pas dhënies së premtimit.

Ajeti vijues shpalos një pjesë të kësaj mëshire të gjerë të Zotit, që përfshin njerëzit besimtarë në dy aspekte, “materiale” dhe “shpirtërore”. Në fillim thotë: **“All’Ilahu u ka premtuar besimtarëve dhe besimtareve kopshte, nëpër të cilat rrjedhin lumenj.”**

Prej karakteristikave të kësaj begatie të madhe dhe të gjerë është se në të nuk ekziston rrugë për shkatërrim, eliminim apo ndarje: **“dhe ku do të banojnë përgjithmonë...”**

Prej të mirave të tjera hyjnore, për ata që Zoti do t’u japë është: **“...si dhe pallate të mrekullueshme në Xhennetin e Adnit.”**

Fjala “*adn*” është në kuptimin e banimit dhe qëndrimit të vazhdueshëm në një vend, andaj “*maden*” (miniera) përdoret për të shënuar vendin ku ka grumbull prej elementeve, pra, pasurive të veçanta nëntokësore. Si rrjedhojë, kuptimi i “Adnit” përputhet me pavdekësinë, por duke pasur parasysh faktin që në fjalinë pararendëse u përmend çështja e pavdekësisë, prej këtu del që **“Xhenneti i Adnit”** është një vend i posaçëm brenda Xhennetit të Zotit, i cili ka epërsi ndaj kopshteve të tjera të Xhennetit.

Kjo epërsi është shpjeguar në forma të ndryshme edhe në hadithet islame dhe në fjalët e komentuesve të Kur’anit. Në një hadith të transmetuar nga Profeti (*Paqja dhe bekimet e All’Ilahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) lexojmë: *“Adni është ajo shtëpi e Zotit, të cilën nuk e ka parë asnjë sy dhe nuk e ka paramenduar mendja e asnjë njeriu. Në të do të banojnë vetëm tre kategori njerëzish: Profetët, të*

drejtit (ata që i kanë afirmuar Profetët dhe i kanë mbështetur ata) dhe dëshmorët.”¹

Në librin “Khisal”, nga i Dërguari i Zotit, përcillet: “Ai që dëshiron të ketë jetën e tij si jetën time dhe vdekjen e tij si vdekjen time dhe të jetë në Xhennetin që Zoti më ka premtuar, në Xhennetin e Adnit, duhet të dojë Ali ibn Ebu Talibin dhe pasardhësit e tij.”²

Nga ky hadith bëhet e qartë se “Kopshtet e Adnit” janë kopshte të Xhennetit, në të cilën do të banojë Profeti (Paqja dhe bekimet e All’lilhat qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) dhe një grup i veçuar njerëzish prej shokëve të tij.

Kjo përmbajtje është transmetuar edhe në një hadith tjetër nga Imam Aliu, se “Kopshtet e Adnit” janë vendqëndrimi i Profetit (Paqja dhe bekimet e All’lilhat qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!). Më pas përmend begatitë dhe shpërblimet e tyre shpirtërore: **“Por kënaqësia prej All’lilhat është shpërblimi më i madh.”**

Askush nuk është në gjendje të përshkruajë atë kënaqësi shpirtërore që i jep një njeriu për shkak të kënaqësisë së Zotit ndaj tij. Në bazë të disa thënieve të disa komentuesve të Kur’anit, madje vetëm një pjesë nga kjo kënaqësi shpirtërore është më e lartë dhe më e madhe se i gjithë Xhenneti, se begatitë apo mirësitë e tij shumëngjyrëshe dhe të pafundme.

Sigurisht, ne kafazin e kësaj bote dhe në jetesën e saj të kufizuar, nuk jemi në gjendje të përfytyrojmë asnjë prej begative

¹ “Mexhmaul Bejjan”, ajeti në fjalë. “Biharul Enuar”, vëll. 8, f. 85, në lidhje me “Xhennetin e Adnit” Gjithashtu janë transmetuar edhe hadithe të tjera. “Biharul Enuar”, vëll. 8, f. 171, vëll. 81, f. 126; “Men la jehdherehul fakijh”, vëll. 1, f. 296, botim i “Xhamiul Muderresin”.

² “Nuruth Thekalejn”, vëll. 2, f. 241; “El Khisal”, vëll. 2, f. 558; “Emali i Saduk”, f. 36; “Usulul Kafi”, vëll. 1, f. 209, Hadithi 6; “Biharul Enuar”, vëll. 23, f. 136–138

të Botës Tjetër dhe as që bëhet fjalë për këtë begati të madhe shpirtërore.

Por, një përshkrim të dobët, në lidhje me dallimet shpirtërore dhe materiale, jemi në gjendje ta bëjmë edhe në këtë botë, si p.sh. kënaqësinë që na e jep takimi me një mik shumë të ngushtë dhe të përzemërt, pas ndarjes dhe largimit prej tij për një kohë të gjatë.

Apo ndjenjat e veçanta shpirtërore që krijohen për ne nga konceptimi i një çështjeje të ndërlikuar shkencore, pasi me muaj apo vite të tëra kemi qenë pas zhbirimit dhe kuptimit të saj.

Apo ekzaltimi shpirtëror dhe ngazëllues që përfitojmë me anë të një adhurimi të sinqertë dhe lutjeve të shoqëruara me praninë e zemrës, nuk mund të krahasohen me kënaqësinë e asnjë lloj ushqimi dhe të ngjashëm me to prej kënaqësive materiale.

Duke u nisur nga kjo, gjithashtu bëhet e qartë se ata që pohojnë se Kur'ani, gjatë përshkrimit të shpërblimeve të besimtarëve dhe vepërmirëve, është mbështetur vetëm te begatitë materiale dhe nga begatitë shpirtërore, as që nuk bëhet fjalë, vërtet kanë gabuar. Në fjalinë e lartpërmendur kënaqësia e Zotit, që veçanërisht është përmendur në mënyrë të pashquar si aludim për një pjesë të kënaqësisë së Zotit, është konsideruar më e rëndësishme se të gjitha begatitë materiale të Xhennetit. Kjo tregon se sa i çmueshëm dhe me vlerë është ai shpërblim shpirtëror.

Sigurisht, edhe arsyeja e kësaj epërsie, po ashtu, është e qartë, sepse “shpirti”, në realitet, është si “xhevahiri” dhe “trupi” është si “margaritari”. “Shpirti” është komandanti, kurse “trupi” është i komanduari, përsosmëria e shpirtit është synimi kryesor,

kurse përsosmëria e trupit është mjet. Pikërisht për këtë arsye, të gjitha manifestimet e shpirtit janë më gjithëpërfshirëse dhe më të gjera se trupi. Kënaqësitë shpirtërore nuk mund të krahasohen me kënaqësitë trupore, ashtu si dhimbjet shpirtërore janë shumë më të dhimbshme se ato fizike.

Në fund të ajetit ka përmendur të gjitha këto begati materiale dhe shpirtërore: **“Kjo është fitorja madhështore.”**

Ajeti 73

يَا أَيُّهَا النَّبِيُّ جَاهِدِ الْكُفَّارَ وَالْمُنَافِقِينَ وَاعْلُظْ عَلَيْهِمْ
 وَمَأْوَاهُمْ جَهَنَّمُ وَبِئْسَ الْمَصِيرُ ﴿٧٣﴾

“O i Dërguar! Lufto kundër mohuesve dhe hipokritëve dhe bëhu i ashpër ndaj tyre! Strehimi i tyre është Xhehennemi; sa vendbanim i shëmtuar.”

Komentimi

Luftimi me mohuesit dhe hipokritët

Më në fund, në këtë ajet urdhërohet për përballim të ashpër me femohuesit dhe hipokritët: **“O i Dërguar! Lufto kundër mohuesve dhe hipokritëve dhe bëhu i ashpër ndaj tyre!”**

Këto janë dënimet e tyre në këtë botë, kurse në Ahiret: **“Strehimi i tyre është Xhehennemi; sa vendbanim i shëmtuar.”**

Mënyra e luftimit me mohuesit është e qartë dhe është luftimi në të gjitha aspektet, veçanërisht luftimi i armatosur. Por mënyra e luftimit me “hipokritët” është çështje diskutimi, sepse Profeti (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) nuk kishte luftuar ushtarakisht me hipokritët, sepse hipokrit është ai person që në dukje qëndron në radhët e myslimanëve dhe

sipas rregullit, për të zbatohen të gjitha veprat e Islamit dhe trajtohet si mysliman, sado që në realitet, për nga brendësia, është sabotues dhe mohues. Ka shumë njerëz për të cilët jemi në dijeni që nuk janë besimtarë të mirëfilltë, por për shkak se në paraqitje tregohen si besimtarë dhe shfaqin Islamin nuk mundem të sillemi me ata si jo mysliman.

Andaj, ashtu siç përftohet edhe nga hadithet islame dhe nga thëniet e komentuesve të Kur'anit duhet të themi se synimi i luftimit me hipokritët është një lloj dhe formë tjetër luftimi, që përjashton luftimin e armatosur, si p.sh qortimi, ndëshkimi, kërcënimi i tyre. Mbase si fjalia **“dhe bëhu i ashpër ndaj tyre”** mund të jetë aludim për këtë kuptim.

Në komentimin e këtij ajeti ekziston se hipokritët duhet të munden, për sa kohë që gjendja e tyre është e qartë dhe, përderisa sekretet e brendshme të tyre akoma nuk janë zbuluar, për ta zbatohen rregullat islame. Por në kohën që gjendja e tyre është bërë e qartë, do të gjykohen si politeistë armiqësorë dhe luftimi i armatosur me ata është i lejueshëm.

Kurse, ajo çka e zbeh këtë mundësi është se përdorimi i fjalës “hipokrit” nuk është i drejtë ndaj tyre dhe ata do të klasifikohen si “politeistë armiqësorë”; sepse ashtu siç e cekëm edhe më lart, hipokrit është ai që në dukje është si mysliman, por në brendësi është si jobesimtar dhe politeist.

Ajeti 74

يَحْلِفُونَ بِاللَّهِ مَا قَالُوا وَلَقَدْ قَالُوا كَلِمَةَ الْكُفْرِ وَكَفَرُوا بَعْدَ
 إِسْلَامِهِمْ وَهَمُّوا بِمَا لَمْ يَنَالُوا وَمَا نَقَمُوا إِلَّا أَنْ أَغْنَاهُمُ اللَّهُ
 وَرَسُولُهُ مِنْ فَضْلِهِ ۚ فَإِنْ يَتُوبُوا يَكُ خَيْرًا لَهُمْ ۗ وَإِنْ يَتَوَلَّوْا
 يُعَذِّبُهُمُ اللَّهُ عَذَابًا أَلِيمًا فِي الدُّنْيَا وَالْآخِرَةِ وَمَا لَهُمْ فِي الْأَرْضِ
 مِنْ وَلِيٍّ وَلَا نَصِيرٍ ﴿٧٤﴾

“Hipokritët betohen për All’llahun se nuk thanë asgjë (të keqe). Por, në të vërtetë, ata thanë fjalën e mosbesimit, mohuan pas (pranimit të) Islamit dhe synuan të bënin gjëra të paarritshme. Ata u bënë keqdashës, vetëm sepse All’llahu dhe i Dërguari i Tij u kishin dhënë (besimtarëve) nga të mirat e Tij. Nëse pendohen, do të jetë më mirë për ta; por, nëse kthejnë shpinën, All’llahu do t’i ndëshkojë me dënim të rëndë në këtë jetë dhe në Tjetrën dhe ata nuk do të kenë kurrfarë mbrojtësi apo ndihmësi në Tokë.”

Shkaku i zbritjes

Në lidhje me shkakun e zbritjes së këtij ajeti janë transmetuar shumë hadithe. Që të gjithë transmetimet tregojnë se disa nga hipokritët kishin fyer Islamin dhe Profetin (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) dhe, pasi u zbuluan të fshehtat e tyre, u betuan rrejshëm që nuk kishin deklaruar një gjë të tillë. Gjithashtu thurën dhe një komplot kundër tij, por që nuk solli rezultat.

Si p.sh njëri nga hipokritët, i njohur me nofkën Xhelas, gjatë periudhës së Betejës së Tebukut, pasi kishte dëgjuar disa nga fjalimet e Profetit (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) e mohoi dhe e përgënjeshtroi ashpër atë. Një person, me emrin Amir ibn Kejs, i cili e kishte dëgjuar këtë ngjarje, pasi u kthye nga Medina, erdhi pranë Profetit (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) dhe e informoi për fjalët e Xhelasit.

Në kohën që vetë Xhelasi erdhi te Profeti (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) e mohoi një gjë të tillë. Profeti i urdhëroi të dy që të betohen në foltoren e xhamisë, që nuk janë duke gënjer. Ata u betuan, por Amiri tha: “O Zoti im! Zbriti një ajet Profetit (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) dhe prezantoja atij njeriun e drejtë!”

Profeti (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) dhe besimtarët, që të gjithë pohuan: “Amin!”

Ndërkohë zbriti Xhebraili dhe ia shpalli ajetin e lartpërmendur. Kur arriti Profeti (*Paqja dhe bekimet e All'llahut*

qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) te artikulimi i shprehjes: **“Nëse pendohen, do të jetë më mirë për ta.”**, Xhelasi tha: *“O i Dërguari i Zotit! Zoti më ka kërkuar të pendohem dhe unë jam bërë pishman për mëkatin tim dhe pendohem.”* Profeti (Paqja dhe bekimet e All’llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) e pranoi pendimin e tij.¹

Ashtu siç e kemi cekur edhe në të kaluarën, një grup prej hipokritëve kishin planifikuar që gjatë kthimit nga Lufta e Tebukut t’i dilnin në pritë Profetit, ta trembnin devenë e tij dhe më pas ta rrëzonin atë nga maja e malit te lugina.

Por Profeti (Paqja dhe bekimet e All’llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!), nën dritën e Shpalljes hyjnore, u informua për këtë ngjarje dhe e prishi planin e tyre ogurzi, duke ia dhënë devenë Amar bin Jaserit, kurse Hudhejfen e caktoi që ta ndiqte atë nga mbrapa në mënyrë që deveja të ishte plotësisht nën kontroll.

Madje edhe njerëzit i urdhëroi që të merrnin një rrugë tjetër, në mënyrë që hipokritët të humbisnin mundësinë për t’u fshehur midis tyre dhe të zbatonin planin e tyre. Atëherë, në errësirën e natës, kur u dëgjuan disa zëra prapa tyre, disa nga bashkudhëtarët i urdhëroi t’i ndalonin menjëherë. Grupi që përbëhej nga dymbëdhjetë apo pesëmbëdhjetë veta, e kishin mbuluar një pjesë të fytyrës. Kur panë që nuk po ia arrinin synimit të tyre, u prapësuan. Por Profeti (Paqja dhe bekimet e All’llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) i njihte ata dhe emrat e tyre i përmendi një për një në prani të disa shokëve të tij.²

¹ “Biharul Enuar”, vëll. 17, f. 184; “Mexhmaul Bejjan”, ajeti në fjalë dhe komentime të tjera.

² Marrë nga tefsiri “Mexhmaul Bejjan” dhe tefsiret “El Manar”, “Ruhul Meanij”, si dhe tefsire të tjera; “Biharul Enuar”, vëll. 17, f. 184.

Ashtu siç do ta shohin edhe në të ardhmen, ajeti aludon në të dy programet e hipokritëve, një, thënia e tyre pa vend dhe tjetri, komploti i tyre ndaj Profetit (*Paqja dhe bekimet e All'Ilahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) i cili nuk u realizua. Në këtë mënyrë, arrijmë të kuptojmë se të dy shkaqet e zbritjes janë të sakta dhe të vërteta.

Komentimi

Komplot i rrezikshëm

Lidhja e këtij ajeti me ajetin e lartpërmendur është plotësisht e qartë, sepse këto ajete flasin për hipokritët.

Në ajetin 74 flitet për zbulimin e një komploti tjetër djallëzor të hipokritëve. Kur panë që e fshehta e tyre ishte zbuluar, e mohuan të vërtetën dhe realitetin, madje, për të vërtetuar pohimet e veta, u mbështetën në betime të rrejshme.

Në fillim thotë: **“Hipokritët betohen për All'Ilahun se nuk thanë asgjë (të keqe).”** Ndërkohë: **“Por, në të vërtetë, ata thanë fjalën e mosbesimit...”,** dhe në këtë mënyrë: **“...mohuan pas (pranimit të) Islamit.”**

Kjo është e dukshme. Ata, në fillim nuk ishin myslimanë. Ata vetëm pretendonin se ishin myslimanë dhe pranues të fesë islame. Si rrjedhojë, po këtë Islam, në dukje dhe formal, e thyen me shprehjen e mosbesimit dhe të politeizmit.

Dhe më e rëndësishme: **“dhe synuan të bënin gjëra të paarritshme.”**

Ky synim ka gjasa të jetë aludim për një komplot për zhdukjen e Profetit (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) në natën e "Lejletul Akabe". Përshkrimin e saj e dhamë te shkaku i zbritjes.

Ose të jetë aludim për të gjitha veprimet dhe veprimtaritë që i kryenin, për të shkaktuar rrëmujë në shoqërinë islame, si dhe për ta korrptuar atë, për të ndjellë hipokrizi dhe ndarje. Por këto synime asnjëherë nuk u realizuan.

I rëndësishëm është fakti që vigjilenca e myslimanëve ndaj ngjarjeve të ndryshme bëhej shkak që të njiheshin hipokritët dhe planet e tyre. Myslimanët gjithnjë ishin në përgjim të tyre, në mënyrë që, nëse dëgjonin ndonjë fjalë nga ata për parandalimin dhe kundërveprimin, në kohë reale të raportonin te Profeti (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*). Kjo vigjilencë dhe reagim në kohën e duhur, pas saj zbritja e ajeteve dhe vërtetimi i Zotit, u bënë shkak të komprometimit të hipokritëve dhe mosrealizimit të synimeve të tyre.

Më pas, me qëllim që veprimtaritë e turpshme dhe të shëmtuara të hipokritëve, si dhe mosmirënjohja e tyre të bëhet plotësisht e qartë, shton se ata nuk kishin parë asnjë padrejtësi nga Profeti (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), si dhe nuk iu shkaktua asnjë dëm nga ana e Islamit, por ndodhi e kundërta. Nën dritën e qeverisë islame, kishin përfituar lloj-lloj begatish materiale dhe shpirtërore, si rrjedhojë: **"Ata u bënë keqdashës, vetëm sepse All'llahu dhe i Dërguari i Tij u kishin dhënë nga të mirat e Tij."**¹

¹ Duhet të kemi parasysh faktin se në fjalinë e lartpërmendur, edhe pse fjalia "të mirat e Zotit dhe Profetit" përemri "*min fadhlihi*" është përmendur në numrin

Pa dyshim që përmbushja e nevojave të tyre nën dritën e mirësisë së Zotit dhe shërbimeve të Profetit (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) nuk ishte një çështje që donin të hakmerreshin për shkak të tij, madje ishte për mirënjohje dhe falënderim. Por këta përbuzës, me karakter të shëmtuar, kësaj mirësie dhe begatie iu përgjigjen me krim.

Kjo është një shprehje e bukur dhe elokuyente, që përdoret në shumë shkrime dhe thënie, si p.sh. ndaj një njeriu që i kemi shërbyer me vite të tëra dhe më pas na ka tradhtuar dhe është treguar mosmirënjohës, i themi se mëkati ynë ishte vetëm që e strehuam, e mbrojtëm dhe treguam dashuri maksimale.

Më pas, ashtu siç është edhe tradita e Kur'anit, atyre u ofroi mundësinë e rikthimit dhe të pendimit: **“Nëse pendohen, do të jetë më mirë për ta...”**

Kjo është shenjë e realizmit Islam dhe kujdesit për çështjen e edukimit, si dhe lufta me çdo lloj ashpërsie, pa vend dhe reagim të tepruar, në mënyrë që jo vetëm që e la të hapur rrugën e pendimit dhe të paqes për hipokritët që kishin thurur komplot për Profetit (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) dhe kishin artikuluar fjalë fyese dhe femohuese, por i ftoi ata të pendoheshin.

Me të vërtetë, ky është imazhi i vërtetë i Islamit. Por sa të padrejtë janë ata persona që Islamin, me një fytyrë të tillë, e prezantojnë si fe të dhunës dhe të presionit.

njëjës dhe jo në shumës, shkak i kësaj shprehjeje është po ajo që u përmend në disa ajete pararendëse. Shprehje të tilla përdoren për vërtetimin e së vërtetës së monoteizmit dhe që të gjitha punët janë në dorën e Zotit dhe, nëse Profeti kryen ndonjë punë, atë e bën me urdhrin e Zotit, si dhe nuk del jashtë vullnetit të Tij.

Vallë a ekziston në botën e sotme ndonjë qeveri, që edhe pse me një butësi maksimale, të jetë e gatshme për një fleksibilitet dhe dashuri të tillë kundrejt komplotistëve që kanë thurur plane ogurzeza ndaj saj? Ashtu siç lexuam në shkakun e zbritjes, një prej organizatorëve kryesorë të këtyre programeve hipokrite, u pendua dhe Profeti (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) e pranoi pendimin e tij.

Megjithatë, me qëllim që këtë fleksibilitet të mos e shohin si shkak të dobësisë, i paralajmëron ata: **"...por, nëse kthejnë shpinën, All'llahu do t'i ndëshkojë me dënim të rëndë në këtë jetë dhe në Tjetrën..."**

Nëse mendojnë se ka mundësi që, karshi dënimeve hyjnore, t'u vijë ndonjë për ndihmë, me të vërtetë kanë gabuar rëndë: **"dhe ata nuk do të kenë kurrfarë mbrojtësi apo ndihmësi në Tokë."**

Sigurisht, dënimet e tyre në Botën Tjetër janë të qarta, kurse dënimet e tyre në këtë botë janë po ato komprometimet, turpërimi, poshtërimi, mjerimi, fatkeqësia dhe të ngjashëm me këto.

Ekziston edhe kjo mundësi që, pas zbardhjes dhe zbulimit të veprimeve të hipokritëve, në rast të mospendimit, duhet të penalizohen në këtë botë, në përputhje me ligjin, sepse kanë kaluar kufijtë e hipokrizisë dhe vazhdojnë të jetojnë jetën e komplotistëve. Kjo, po ashtu, bëhet shkak i nxitjes së të tjerëve, gjë që është e patolerueshme dhe duhet shmangur.

Ajetet 75 - 78

وَمِنْهُمْ مَّنْ عَاهَدَ اللَّهَ لَئِنِ آتَيْنَا مِنْ فَضْلِهِ ۗ لَنَصَّدَّقَنَّ
 وَلَنَكُونَنَّ مِنَ الصَّالِحِينَ ﴿٧٥﴾ فَلَمَّا آتَاهُمْ مِّنْ فَضْلِهِ ۗ بَخِلُوا
 بِهِ ۗ وَتَوَلَّوْا وَهُمْ مُّعْرِضُونَ ﴿٧٦﴾ فَأَعْقَبَهُمْ نِفَاقًا فِي قُلُوبِهِمْ إِلَى
 يَوْمٍ يَلْقَوْنَهُ ۗ بِمَا أَخْلَفُوا اللَّهَ مَا وَعَدُوهُ وَبِمَا كَانُوا يَكْذِبُونَ
 ﴿٧٧﴾ أَلَمْ يَعْلَمُوا أَنَّ اللَّهَ يَعْلَمُ سِرَّهُمْ وَنَجْوَاهُمْ وَأَنَّ اللَّهَ عَلَّامُ
 الْغُيُوبِ ﴿٧٨﴾

“Ka nga ata (hipokritë) që kanë bërë besëlidhjen me All’llahun, duke thënë: ‘Nëse Ai na jep nga dhuntitë e Tij, sigurisht që do të japim lëmoshë dhe sigurisht që do të bëhemi njerëz të mirë!’”

“Por kur Ai u dha atyre nga dhuntitë e Veta, ata u bënë koprracë dhe kthyen shpinën, duke u larguar.”

“Prandaj, Ai ua lidhi hipokrizinë në zemrat e tyre, deri në ditën kur do të dalin para Tij, sepse e shkelën premtimin dhënë All’llahut. Ata e kishin zakon gënjeshtren.”

“Vallë, a nuk e dinë ata se All’llahu i di të fshehtat e tyre dhe bisedat e fshehta?! Në të vërtetë, All’llahu është Ai që i di të gjitha fshehtësitë.”

Shkaku i zbritjes

Në mesin e komentuesve të Kur'anit është e njohur se këto ajete kanë zbritur për njërin prej shokëve të Profetit, të quajtur Thalebe ibn Hatib, i cili ishte një njeri i varfër. Shkonte gjithnjë në xhaminë e Profetit (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) dhe kishte kërkuar nga Profeti të lutej për të, që Zoti t'i jepte pasuri të madhe.

Profeti (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) e këshilloi atë: *“Shuma e pakët për të cilën mund t'ia paguash detyrimet është më e preferuar se sa shumta e madhe parash. Vallë a nuk është më mirë që të shkosh pas gjurmëve të Profetit dhe të jetosh një jetë të thjeshtë?”*

Por Thalebeja këmbëngulte dhe nuk hiqte dorë prej kërkesës së parashtruar. Në fund iu drejtua Profetit (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) duke i thënë: *“Betohem në Zotin që të ka dërguar me të vërtetën, nëse Zoti do të më dhurojë ndonjë pasuri, do t'i paguaj të gjitha detyrimet e saj.”*

Profeti (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) u lut për të. Nuk kaloi shumë kohë dhe (në bazë të një transmetimi) i vdiq djali i xhaxhait të tij, shumë i pasur. Në këtë mënyrë përfitoi një pasuri të madhe.

Në bazë të një transmetimi tjetër, bleu një dele, e cila polli shumë shpejt. Në pamundësi të mbajtjes së tyre në Medine, u detyrua të dilte rrethinave të Medines. Në këtë mënyrë u pasuria shumë nga ana materiale, sa që filloi të mos merrte dot pjesë në namazin kolektiv, madje as në namazin e xhumasë.

Pas një periudhe, Profeti (*Paqja dhe bekimet e All'Ilahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) dërgoi te ai përgjegjës in mbledhjes së zekatit për t'i kërkuar zekatin e pasurisë së tij. Por ky njeri, i sapo pasuruar dhe koprrac, u shtang nga pagesa e detyrimit hyjnor (zekatit), jo vetëm që u shtang dhe u prapësua, por e kundërshtoi dhe protestoi edhe për ligjëvënien e saj dhe tha: "Ky urdhër është simotra e "xhizjes". Ne jemi bërë myslimanë që të përjashtohemi nga dhënia e "xhizjes ". Çfarë dallimi mbetet mes nesh dhe jo besimtarëve, pasi ne duhet të paguajmë zekatin?!

Nga ky fjalim arrijmë të kuptojmë se ai nuk kishte kuptuar as konceptin e "xhizjes" dhe as konceptin e "zekatit", ose i kishte kuptuar, por dhënia pas kësaj bote nuk e kishte lejuar të shprehte dhe të shfaqte të vërtetën.

Sidoqoftë, në kohën që Profeti (*Paqja dhe bekimet e All'Ilahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) i dëgjoji fjalët e tij, tha: "Mjerë për Thalebenë! Mjerë për Thalebenë!"

Këtu zbritën ajetet e lartpërmendura.¹

Në lidhje me ajetet e lartpërmendura gjithashtu janë përmendur edhe shkaqe të tjera zbritjesh, që pothuajse janë të ngjashme me tregimin e Thalebesë. Nga tërësia e shkaqeve të lartpërmendura dhe përmbajta e ajeteve përftohet se personi apo personat e përmendur në fillim nuk ishin në radhët e hipokritëve, por për shkak të po këtyre veprave u bashkuan në radhët e tyre.

¹ "Biharul Enuar", vëll. 22, f 40; "Mustedrekul Uesail", vëll. 13, f. 256, Hadithi 15289, "Mexhmaul Bejjan", ajeti në fjalë; Tefsiret "Kurtubi", "Tabari", ajeti në fjalë.

Komentimi

Hipokritët janë njerëz pa kapacitet

Këto ajete përmendin një prej cilësive të tjera të hipokritëve, që ata, në gjendje dobësie, pafuqie, varfërie apo ankthi, shfaqen si besimtarë tejet të denjë, saqë askush nuk është në gjendje të besojë se një ditë ata do të renditen në radhët e hipokritëve.

Madje, ata i përqeshin edhe ata persona që kanë pasuri dhe janë në kushte të mira ekonomike, që pasurinë dhe mundësitë e tyre nuk i shpenzojnë për njerëzit e rëndomtë dhe të varfër. Por, me t'u pasuruar, zhyten dhe fundosen aq shumë në këtë botë, saqë të gjitha premtimet dhe marrëveshjet e tyre me Zotin i lënë në harresë dhe heqin dorë prej tyre, thuajse kanë ndryshuar tërësisht personalitetin e tyre dhe shohin me një shikim dhe optik tjetër. Dhe po kjo mungese kapaciteti, rezultati i së cilës është adhurimi i kësaj bote, koprracia, dorështrëngimi dhe egoizmi, shpirtin e hipokrizisë e përqendron aq shumë te ata, saqë e mbyll rrugën e pendimit dhe të rikthimit të tyre.

Në ajetin e parë thuhet: **“Ka nga ata (hipokritë) që kanë bërë besëlidhjen me All’llahun, duke thënë: ‘Nëse Ai na jep nga dhuntitë e Tij, sigurisht që do të japim lëmoshë dhe sigurisht që do të bëhemi njerëz të mirë!’”**

Kurse në ajetin vijues thuhet, që këto fjalë i thoshin vetëm në kohën që dora e tyre ishte e privuar nga të gjitha anët: **“Por kur Ai u dha atyre nga dhuntitë e Veta, ata u bënë koprracë dhe kthyen shpinën, duke u larguar.”**

Rezultati i kësaj vepre, i kësaj nëpërkëmbje të marrëveshjes dhe koprracisë ishte: **“Prandaj, Ai ua lidhi hipokrizinë në zemrat e tyre, deri në ditën kur do të dalin para Tij, sepse e shkelën premtimin dhënë All’llahut. Ata e kishin zakon gënjeshtren.”**

Në fund i qorton dhe u tërheq vërejtjen me anë të kësaj fjalie: **“Vallë, a nuk e dinë ata se All’llahu i di të fshehtat e tyre dhe bisedat e fshehta?! Në të vërtetë, All’llahu është Ai që i di të gjitha fshehtësitë.”**

Hulumtime

1- Fraza **“Prandaj, Ai ua lidhi hipokrizinë në zemrat e tyre,”** na e bën të qartë më së miri se shumë prej mëkateve dhe cilësive të shëmtuara, madje politeizmi dhe hipokrizia janë “shkak” dhe “pasojë” e njëri-tjetrit.

Fjalja e lartpërmendur thotë se koprracia dhe thyerja e besëlidhjes së tyre u bë shkak, që hipokrizia të rrënjëzohej në zemrat e tyre dhe po kështu mëkatet dhe punët e tjera të shthurura. Kjo është arsyeja se pse në disa shprehje lexojmë: “ndonjëherë mëkatet e mëdha bëhen shkak që njeriu të ikë nga kjo botë si jobesimtar.”

2- Kuptimi i fjalës “jeume jelkaunehu” (Dita që e takojnë Atë), përemri i së cilës i kthehet Zotit është po ajo “Dita e Ringjalljes”, sepse shprehja “lika-ull’llah” dhe të ngjashme me to, që përmenden në Kur’an zakonisht janë në kuptimin e “Kiametit”.

Është e vërtetë që me vdekjen përfundon dhe periudha e veprimtarisë së njeriut, si dhe mbyllet dosja e veprave të mira dhe e veprave të këqija, por efektet vazhdojnë të ekzistojnë në shpirtin e njeriut deri në Ditën e Kiametit.

Gjithashtu e kanë dhënë edhe këtë mundësi që përemri te fjala “*jelkeunehu*” i kthehet fjalës “*bukhl*” (koprracisë), që do të thotë: “Deri në kohën kur t’i shohin rezultatit dhe ndëshkimin e koprracisë së tyre.”

Po ashtu, është supozuar që synimi i “takimit me Zotin” të jetë çasti i vdekjes.

Por të gjitha këto bien ndesh me pamjen e ajetit. Kuptimi i ajetit është po ai që e thamë.¹

3- Përveç kësaj, nga ajetet e lartpërmendura përftohet se thyerja e besës dhe gënjeshtria është prej cilësive të hipokritëve dhe vetë ata shkelin marrëveshjet që i lidhnin me anë të theksimeve të shumta me Zotin, madje e gënjejnë dhe Zotin e tyre. Edhe hadithi i njohur, i transmetuar nga vetë Profeti (*Paqja dhe bekimet e All’llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), e qartëson këtë realitet: “*Hipokriti ka tre shenja; kur flet, gënjen; kur premtion, e shkel premtimin dhe tradhton me gjënë që i besohet.*”²

Interesant është fakti se në tregimin e lartpërmendur (tregimin e Thalebesë) ekzistojnë të tre shenjat, ai edhe gënjeu, edhe shkeli besëlidhjen, edhe abuzoi me pasurinë që Zoti ia kishte dhënë si amanet.

Hadithi i lartpërmendur është transmetuar edhe nga Imam Sadiku, nga Profeti (*Paqja dhe bekimet e All’llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) në një formë më të përforcuar, në librin “Usuli Kafi”: “*Quhet hipokrit ai që ka tri gjëra, edhe pse agjëron apo fal*

¹ Në lidhje se cili është synimi i takimit me Zotin, referohu ajetit 46 të sures “El Bekare”, vëll.1.

² “*Mexhmaul Bejjan*”, ajeti në fjalë; “*Men la jehdherehu el fakijh*”, vëll. 4, f 361; “*Biharul Enuar*”, vëll. 69, f. 205–206, Hadithet 6-7 dhe vëll. 74, f. 53; *Kurbul esnad*”, f. 15; “*Mekarimul Akhlak*”, f. 438.

namazin dhe veten e konsideron mysliman, ai që abuzon me amanetin, gënjen kur flet dhe shkel premtimin.”¹

Sigurisht ka mundësi që mëkatet e lartpërmendura të kryhen rrallëherë edhe nga njerëz me besim dhe më pas të pendohen, por përsëritja e tyre është shenjë e shpirtit hipokrit dhe e hipokrizisë.

4- Gjithashtu është e nevojshme dhe duhet të theksojmë se ato që lexojmë në ajetet e lartpërmendura nuk janë një çështje vetëm të kohës së kaluar, por është sqarim i një realiteti moral dhe shoqëror, në mënyrë që në çdo kohë dhe epokë, dhe në çdo shoqëri, pa përjashtim, ekzistojnë shembuj të shumtë.

Nëse i hedhin një vështrim vetes sonë, (madje edhe rreth vetes sonë) do të vërejmë shembuj të sjelljes së Thalebes bin Hatibit dhe mënyrës së reflektimit të tij, ekzistojnë edhe shumë persona që, në kushte të zakonshme apo në kushte të vështira, rreshtohen krahas besimtarëve dhe njerëzve të devotshëm dhe me besim të fortë, marrin pjesë në të gjitha aktivitetet fetare, përqafojnë secilën ide reformiste, i bashkohen çdo thirrjeje të drejtë dhe për drejtësi dhe luftojnë për veprat e mira, si dhe mbajnë qëndrim ndaj çdo korrupsioni dhe parregullsie.

Por, në kohën që u jepet një mundësi, bëhen pasanikë, arrijnë në ndonjë pozitë, pra, thënë ndryshe, arrijnë në kushte më komode jetese, menjëherë u ndryshon fytyra dhe marrin një pamje tjetër. Ç’është më e keqja, ndryshojnë edhe natyrën e tyre. Ajo dashuri e madhe dhe e zjarrtë ndaj Zotit dhe fesë shuhet, nuk marrin më pjesë në mbledhje dhe tubime të tilla fetare dhe

¹ “Sefinetul Bihar”, vëll. 2, f 607; “Usulul Kafi”, vëll. 2, f 290, Hadithi 8; “Uesailu Shia”, vëll. 15, f 339, Hadithi 20687; “Biharul Enuar”, vëll. 69 f. 108, Hadithi 8.

reformiste, as luftojnë për të vërtetën dhe të drejtën, si dhe as ngrenë zërin kundër së keqes dhe të shtrembrës.

Atëherë kur në të kaluarën nuk kishin asnjë rol në shoqëri, as ndonjë pozitë, kishin lidhur me mijëra marrëveshje dhe premtime me Zotin, që, nëse një ditë do të kenë mundësi dhe kushte të volitshme, do të bënin këtë dhe atë heroizëm. Madje kishin njëmijë e njëqind vërejtje dhe qortime ndaj të pasurve të papërgjegjshëm. Por kur gjendja e tyre ndryshoi, i lanë në harresë të gjitha besëlidhjet dhe betimet e bëra dhe të gjitha objeksionet e vërejtjet u shkrinë si bora në stinën e verës.

Po, kjo mungesë kapaciteti është një nga shenjat e spikatura të hipokritëve.

Në dukje është i besueshëm. Për këtë arsye njerëzit kanë besim te ai dhe i japin atij për ruajtje amanetet e tyre dhe ky në praktikë i tradhton ata. A nuk vuan një person i tillë nga dyzimi i personalitetit? Po ashtu, a nuk konsiderohen hipokritë njerëz që bien në ujdë dhe lidhin marrëveshje, por kurrë nuk u përmbahen atyre?!

Sigurisht, një nga sëmundjet më të mëdha të shoqërisë dhe shkaku i prapambetjes është pikërisht ekzistenca e hipokritëve në shoqëritë njerëzore. Në qoftë se nuk i mbyllin sytë dhe të mos e gënjejnë veten, hipokritë, të ngjashëm me Thalebenë, mund të gjejmë rreth vetes sonë dhe në shoqëritë islame.

Çudi është fakti që, me gjithë këtë ligësi, shturje dhe largim nga fryma e mësimëve islame nga ana jonë, sërish ia hedhim fajin e prapambetjes sonë Islamit.

Ajetet 79 - 80

الَّذِينَ يَلْمِزُونَ الْمُطَّوِّعِينَ مِنَ الْمُؤْمِنِينَ فِي الصَّدَقَاتِ وَالَّذِينَ لَا يَجِدُونَ إِلَّا جُهْدَهُمْ فَيَسْخَرُونَ مِنْهُمْ سَخِرَ اللَّهُ مِنْهُمْ وَلَهُمْ عَذَابٌ أَلِيمٌ ﴿٧٩﴾ أَسْتَغْفِرُ لَهُمْ أَوْ لَا تَسْتَغْفِرُ لَهُمْ إِنْ تَسْتَغْفِرُ لَهُمْ سَبْعِينَ مَرَّةً فَلَنْ يَغْفِرَ اللَّهُ لَهُمْ ذَلِكَ بِأَنَّهُمْ كَفَرُوا بِاللَّهِ وَرَسُولِهِ ۗ وَاللَّهُ لَا يَهْدِي الْقَوْمَ الْفَاسِقِينَ ﴿٨٠﴾

“Sa për ata (hipokritë) që përqeshin besimtarët që japin lëmoshë me vullnet dhe tallen me ata që nuk janë në gjendje të japin gjë përveç (fryteve të) punës së tyre, All’Ilahu do të tallet me ta. Ata do të kenë dënim të dhembshëm. ”

“U lute për ta apo nuk u lute (o Muhammed), All’Ilahu nuk do t’i falë, edhe sikur ti të kërkosh falje për ta shtatëdhjetë herë! Kjo sepse ata e mohuan All’Ilahun dhe të Dërguarin e Tij. All’Ilahu nuk i udhëzon në rrugë të mbarë njerëzit e pabindur. ”

Shkaku i zbritjes

Për shkakun e zbritje së këtyre ajeteve janë transmetuar shumë ngjarje. Nga tërësia e tyre përftohet se Profeti (*Paqja dhe bekimet e All'Ilahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) po përgatiste ushtrinë islame për luftë me armikun (ndoshta Lufta e Tebukut) dhe kishte nevojë për ndihmë nga populli.

Në kohën që i parashtrroi mendimet e veta, ata që kishin mundësi financiare dhe ishin në gjendje të mirë ekonomike ua kontribuan një shumë të konsiderueshme si “zekat” apo si garant, apo “asistencë vullnetare” për nevojat e ushtrisë islame.

Por, disa punëtorë të thjeshtë, me të ardhura të ulëta, si Ebu Akil Ensariu ose Selim ibn Amir Ensari, duke punuar punë shtesë, si dhe duke nxjerrë ujë gjatë natës, siguruan afërsisht 6 kilogramë hurma. Një pjesë e ndanë për familjen, kurse pjesën tjetër ia sollën Profetit (*Paqja dhe bekimet e All'Ilahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) si kontribut, në dukje e vogël, për programin madhështor të Islamit.

Hipokritët dashakeq i akuzonin këto grupe. Ata që kishin ofruar shuma të konsiderueshme, i prezantonin si njerëz hipokritë, kurse ata që kishin kontribuar me një shumë të vogël, i tallnin dhe i përqeshnin: “Vallë a ka nevoja ushtria e Islamit për një ndihmë të tillë?!”

Ndërkohë zbritën ajetet e lartpërmendura dhe i kërcënuan ashpër ata, si dhe Zoti i frikësoi me dënim të ashpër.

Komentimi

Sabotimi i hipokritëve

Në këto ajete është përmendur një tjetër cilësi e hipokritëve. Ata janë njerëz kokëfortë, justifikues, denigrues dhe sabotues, që me anë të sajimeve të shëmtuara, çdo gjë pozitive e poshtëronin dhe e paraqisnin në mënyrë të deformuar. Kështu që edhe njerëzit i largonin nga kryerja e veprave të mira dhe mbillnin farat e pesimizmit dhe të dyzimit në opinionet e tyre, saqë me anë të kësaj ulnin marshin e aktiviteteve dhe të veprimtarive të dobishme dhe produktive në shoqëri.

Kur'ani Fisnik e qorton ashpër këtë sjellje jo njerëzore të tyre dhe myslimanët i bënë të vetëdijshëm që të mos ndikohen nga kurthe dhe intriga të tilla abuzive, si dhe hipokritët ta dinë që "boja" e tyre nuk ka "blerës" në shoqërinë islame.

Në fillim thotë: **"Sa për ata (hipokritë) që përqeshin besimtarët që japin lëmoshë me vullnet dhe tallen me ata që nuk janë në gjendje të japin gjë përveç (fryteve të) punës së tyre, All'lahu do të tallet me ta. Ata do të kenë dënim të dhembshëm."**

Fjala "jelmidhun" rrjedh nga fjala "lemz" dhe është në kuptimin e përqeshjes, kurse fjala "muta'uuin" rrjedh nga rrënja "tau" dhe është në kuptimin e bindjes. Por shprehje të tilla zakonisht përdoren për personat bamirës dhe ata që, përpos veprave të obligueshme, i kryejnë edhe ato të pëlqyeshmet.

Nga ajeti i lartpërmendur përftohet se hipokritët talleshin me një grup dhe përqeshnin një grup tjetër njerëzish, i tallnin ata

njerëz që ishin në gjendje t'i ofronin një ndihmë të vogël ushtrisë islame, kurse, afërmendsh, përqeshja e tyre kishte të bënte me njerëz të kamur, të cilët, në kundërshtim me të parët, ofronin ndihmë të madhe. Grupin e dytë e përqeshnin për hipokrizi, kurse grupin e parë si njerëz që kursehen tepër.

Në ajetin vijues, Kur'ani fokusohet më hollësisht mbi ndëshkimin e këtij grupi hipokritësh dhe e përmend edhe kërcënimin e fundit rreth tyre dhe, duke iu drejtuar Profetit (*Paqja dhe bekimet e All'lahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) thotë: **“U lute për ta apo nuk u lute (o Muhammed), All'lahu nuk do t'i falë, edhe sikur ti të kërkosh falje për ta shtatëdhjetë herë! Kjo sepse ata e mohuan All'lahun dhe të Dërguarin e Tij.”**

Është e qartë që udhëzimi i Zotit u përket atyre njerëzve që ecin në rrugën e së vërtetës dhe janë në kërkim të së vërtetës, por **“All'lahu nuk i udhëzon në rrugë të mbarë njerëzit e pabindur.”**

Hulumtime

1- E rëndësishme është cilësia e punës dhe jo sasia

Ky realitet përftohet më së miri nga ajetet kur'anore që Islami, në asnjë rast, nuk është mbështetur në “volumin e madh të veprës”, por kudo i ka kushtuar rëndësi “cilësisë së veprës”, duke i kushtuar rëndësi të jashtëzakonshme sinqeritetit dhe nijetit të pastër. Ajetet e lartpërmendura janë një shembull i qartë i logjikës kur'anore.

Ashtu siç e vërejtëm, Zoti i Madhëruar i ka kushtuar një rëndësi të jashtëzakonshme veprës së vogël të një punëtori mysliman, i cili kishte qëndruar zgjuar përgjatë gjithë natës, duke punuar me një dashuri të madhe për Zotin, me sinqeritet dhe me ndjenjën e përgjegjesisë ndaj problemeve të shoqërisë islame dhe kishte mundur që, me këtë përkushtim gjatë natës, ta ndihmojë ushtrinë islame në këto çaste kaq vendimtare dhe të ndjeshme, me afro tre kilogram hurma që kishte mbledhur, kurse i qorton dhe i kërcënon ashpër ata që i përqeshnin këto vepra që, në dukje, ishin të vogla, por në realitet ishin të mëdha dhe të dobishme: **“Ata do të kenë dënim të dhembshëm.”**

Prej këtej, gjithashtu, bëhet e qartë edhe një realitet tjetër se gjatë shfaqjes së problemeve në një shoqëri të shëndoshë islame të gjithë duhet të ndiejmë rëndesën e përgjegjesisë. Nuk duhet t'i ngulisim sytë vetëm te të pasurit, sepse Islami u përket të gjithëve. Secili duhet të orvatet në mbrojtjen dhe ruajtjen e tij, sipas mundësisë së tij.

E rëndësishme është që askush të mos kursejë ato aftësi që ka. Pra, këtu nuk bëhet fjalë për volumin e madh apo të vogël, por bëhet fjalë për ndjenjën e përgjegjesisë dhe të sinqeritetit.

Duhet të kemi parasysh faktin që jep një hadith: *“E pyetën Profetin (Paqja dhe bekimet e All'Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!): ‘Cila bamirësi dhe lëmoshë është më e vyera?’*

Profeti (Paqja dhe bekimet e All'Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) u përgjigj: ‘Përpjekja dhe orvatja e njerëzve me pak të ardhura.’”¹

¹ “Mustedrek”, vëll. 7, f. 163, botim i shtëpisë botuese “Ehli Bejt”; “Men la jehdherehu el fakijh”, vëll. 2, f. 70; “Usulul Kafi”, vëll. 4, f.18, botoi “Darul kutubul islamije”; “Uesailu Shia”, vëll. 9, f. 431, botim i shtëpisë botuese “Ehli Bejt”; “Biharul Enuar”, vëll. 93, f. 178.

2- Përpjekja për dëshpërimin e zemrave të besimtarëve

Cilësinë që e lexuam në ajetet e lartpërmendura për hipokritët e kohës së Profetit (*Paqja dhe bekimet e All'Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), ngjashëm me cilësitë e tjera të tyre, nuk kanë të bëjnë vetëm me atë grup dhe atë kohë, por janë prej cilësive të shëmtuara të të gjithë hipokritëve në çdo kohë dhe në çdo epokë. Ata, me shpirtin e veçantë prej pesimizmi që kanë, orvaten që çdo vepër pozitive dhe të dobishme t'ia humbasin efektin me anë të sajesave të shëmtuara, përpiqen që çdo vepërmirë, në një farë mënyre, ta demoralizojnë dhe madje ta thyejnë personalitetin e njerëzve me mundësi modeste financiare me anë të lloj-lloj përqeshjeje dhe talljeje, duke denigruar kontributet e tyre të dëlira, me qëllim që çdo lloj veprimtarie pozitive në shoqëri të shuhet dhe ata të arrijnë synimet dhe qëllimet e tyre ogurzeza.

Por, myslimanët e ndërgjegjshëm dhe të vetëdijshëm, në çdo kohë dhe epokë, duhet të jenë gjithnjë të kujdesshëm e vigjilentë ndaj këtij synimi fatkeq të hipokritëve dhe duhet të veprojnë plotësisht në kahun tjetër, që do të thotë t'i stimulojnë veprimtarët e shquar të shoqërisë, kontributeve në dukje të vogla, por të shoqëruara me sinqeritet t'u japin vlera të mëdha, në mënyrë që i vogli dhe i madhi të ndihet i inkurajuar dhe i përkushtuar në raport me profesionin e vet. Gjithashtu, të gjithë duhet të vihen në dijeni dhe të ndërgjegjësohen ndaj këtij synimi dhe planifikimi shkatërrimtar të hipokritëve, në mënyrë që të mos dëshpërohen.

3- Kuptimi i talljes së Zotit me ta

Fjalja **“All’llahu do të tallet me ta.”** nuk është në këtë kuptim që Zoti i Madhëruar do të kryejë vepra të ngjashme me veprat e tyre. Komentuesit e Kur’anit janë shprehur se synimi është dënimi dhe ndëshkimi i tallësit ose do të sillët në mënyrë të atillë me ata që do të poshtërohen, ashtu siç poshtërohen ata që janë tallur.

4- Numri shtatëdhjetë

Pa dyshim, që numri *“seb’in”* (shtatëdhjetë), që është përmendur në ajetet e lartpërmendura, shënon *“shumësinë”* dhe jo *“numrin”*. Thënë ndryshe, kuptimi i ajetit është se sado që të kërkosh falje për ta, Zoti nuk do t’i falë ata, pra vendimi i All’llahut është përfundimtar dhe i pakthyeshëm.

Shprehje të tilla përdoren për theksimin e çështjes, prandaj dhe në suren *“El Munafikun”*, ajeti 6, po kjo çështje është përmendur si mohim absolut: **“Njësoj është, u lute për faljen e tyre apo nuk u lute, Allahu kurrsesi nuk do t’i falë. Në të vërtetë, Allahu nuk e udhëzon popullin e pabindur.”**

Dëshmi tjetër e kësaj çështjeje është edhe arsyetimi i përmendur te ajeti i lartpërmendur: **“Kjo sepse ata e mohuan All’llahun dhe të Dërguarin e Tij. All’llahu nuk i udhëzon në rrugë të mbarë njerëzit e pabindur.”**

Është e qartë se për njerëz të tillë, pavarësisht se sa herë kërkohet falja, ajo nuk do të bëhet shkak i shpëtimit të tyre. Por i çuditshëm është fakti se në shumë hadithe, që janë transmetuar nga ana e Ehli Syneetit, lexojmë se Profeti (*Paqja dhe*

bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!), pas zbritjes së ajetit të lartpërmendur, është shprehur në këtë mënyrë: *“Betohem në Zot, do të kërkoj falje për ta më shumë se shtatëdhjetë herë, me shpresën që Zoti do t’i falë ata.”*

Në këtë kohë zbriti ajeti i sures “El Munafikun”: “Njësoj është, u lute për faljen e tyre apo nuk u lute, Allahu kurrsesi nuk do t’i falë. Në të vërtetë, Allahu nuk e udhëzon popullin e pabindur.”¹

Kuptimi i haditheve të lartpërmendura është se Profeti numrin shtatëdhjetë, të përmendur në ajet, e ka konsideruar në kuptimin e “numrit”, andaj ka thënë, që unë do të kërkoj falje për ata më shumë se shtatëdhjetë herë, ndërkohë që ajeti në diskutim, veçanërisht duke pasur parasysh arsyetimin që është përmendur në fund të tij, në mënyrë të qartë, na bën të kuptojmë që me shtatëdhjetë shënohet “shumësi” dhe është aluzion për mohim absolut, i shoqëruar me theksim.

Si rrjedhojë, hadithet e lartpërmendura, duke qenë se janë në kundërshti me Kur’anin, asnjëherë nuk mund të pranohen si autentike, veçanërisht që, sipas nesh, edhe burimi i tyre është i dobët.

E vetmja vëmendje dhe përkushtim që i duhet kushtuar haditheve të lartpërmendura është se Profeti (*Paqja dhe bekimet e*

¹ Shumë hadithe që kanë ardhur si prurje me këtë tematikë janë grumbulluar në tefsirin “Tabari”, vëll. 10, f 138, (faqet 198–199 në darul fikr Bejrut, 1405 Hixhri kameri, f. 253; botoi “Darul Fikr” Bejrut, 1415 Hixhri kameri; Tefsiri “Kurtubi”, vëll. 8, f 217, Kajro, 1372 Hixhri kameri, botim i dytë; “Sahih Muslim”, vëll. 4, f. 1865 dhe 2141, botoi “Darul ihja et turathul arabi” Bejrut, “Sahih Bukhari”, vëll. 4, ft 1715-1716, botoi "Darul ibn Kethir el imame" Bejrut, 1407 Hixhri kameri, botim i dytë.

All'lahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) e tha këtë para zbritjes së ajeteve të lartpërmendura. Në kohën që zbritën ajetet, hoqi dorë nga kërkimi i faljes për ta.

Në lidhje me këtë është transmetuar gjithashtu edhe një hadith tjetër, që ka gjasa të jetë burimi kryesor i haditheve të lartpërmendura, por që gjatë interpretimit të kuptimit të ketë pësuar ndryshime: Profeti (*Paqja dhe bekimet e All'lahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) të ketë thënë: “Nëse do ta dija që Zoti do t’i kishte falur nëse do të kisha kërkuar falje më shumë se shtatëdhjetë herë për ta, kështu do të veproja.”¹

Kuptimi i kësaj thënieje (sidomos duke pasur parasysh pjesëzën “*leu*”, që është për mosrealizim) është se Zoti nuk do t’i falë ata, por zemra ime është caq e mbushur me mallëngjim për udhëzimin dhe shpëtimin e robve të Zotit, saqë, nëse ata do të gjenin shpëtim, nëse do të kërkoj falje më shumë se shtatëdhjetë herë, patjetër që do të veproja në këtë mënyrë.

Sidoqoftë, kuptimi dhe domethënia e ajeteve të lartpërmendura është e qartë dhe çdo hadith që bie në kundërshtim me ato ose duhet ta interpretojmë nën dritën e ajeteve kur’anore, ose duhet të hiqet dorë prej tij dhe duhet lënë mënjane.

¹ “Mexhmaul Bejjan”, ajeti në fjalë; Tefsiri i “Ibn Kethirit”, vëll. 1, f. 50 dhe vëll. 2, f 380, botoi “Darul fikr” Bejrut, 1401 Hixhri kameri; “Sunen Termidhi”, vëll. 5, f 279, botoi “Darul Ihjaje el turathul Arabi”, Bejrut.

Ajetet 81 - 83

فَرِحَ الْمُخَلَّفُونَ بِمَقْعَدِهِمْ خِلَافَ رَسُولِ اللَّهِ وَكَرِهُوا أَنْ
يُجَاهِدُوا بِأَمْوَالِهِمْ وَأَنْفُسِهِمْ فِي سَبِيلِ اللَّهِ وَقَالُوا لَا تَنْفِرُوا فِي
الْحَرْبِ قُلْ نَارُ جَهَنَّمَ أَشَدُّ حَرًّا لَوْ كَانُوا يَفْقَهُونَ ﴿٨١﴾ فَلْيَضْحَكُوا
قَلِيلًا وَلْيَبْكُوا كَثِيرًا جَزَاءً بِمَا كَانُوا يَكْسِبُونَ ﴿٨٢﴾ فَإِنْ
رَجَعَكَ اللَّهُ إِلَى طَائِفَةٍ مِّنْهُمْ فَاسْتَعِذْنَاكَ لِلْخُرُوجِ فَقُلْ لَنْ
تَخْرُجُوا مَعِيَ أَبَدًا وَلَنْ تُقَاتِلُوا مَعِيَ عَدُوًّا إِنَّكُمْ رَضِيتُمْ
بِاللَّفْعِودِ أَوَّلَ مَرَّةٍ فَلَقُّعُدُوا مَعَ الْخَالِفِينَ ﴿٨٣﴾

“Ata që mbetën në shtëpitë e tyre, pas (daljes për luftë të) të Dërguarit të All’lilaut, u gëzuan; nuk u pëlqente të luftonin në rrugën e All’lilaut me pasurinë dhe jetën e tyre dhe thanë: ‘Mos shkoni në luftë, nëpër vapë!’ Thuaju: ‘Zjarri i Xhehennemit është edhe më i nxehtë!’ Veç sikur të kuptonin!”

“Le të qeshin pak (në këtë botë) e të qajnë shumë (në Botën Tjetër) si dënim për atë që kanë bërë.”

“Dhe, nëse të kthen All’lilahu (pas betejës) te një grup i hipokritëve e ata kërkojnë leje nga ti që të shkojnë me ty në

luftë, thuaju (o Muhammed): 'Kurrë nuk do të vini me mua në luftë dhe kurrë nuk do të luftoni me mua kundër armikut! Ju ishit të kënaqur kur nuk erdhët herën e parë, prandaj rrini me ata që ngelin pas.'

Komentimi

Sërish sabotimi i hipokritëve

Edhe në këto ajete flitet për hipokritët dhe u bëhet një prezantim me anë të veprimeve, sjelljeve dhe bindjeve të tyre, në mënyrë që myslimanët ta njohin qartë këtë grup njerëzish dhe të mos ndikohen nga sajimet e tyre ogurzeza.

Në fillim thotë: **"Ata që mbetën në shtëpitë e tyre, pas (daljes për luftë të) të Dërguarit të All'Ilahut, u gëzuan; nuk u pëlqente të luftonin në rrugën e All'Ilahut me pasurinë dhe jetën e tyre."**

Nuk u mjaftuan me mospjesëmarrjen e tyre në luftë, por, me anë të cytjeve të tyre djallëzore, u orvatën t'i parandalonin edhe të tjerët nga një gjë e tillë, ose t'ua prishnin mendjen: **"... dhe thanë: 'Mos shkoni në luftë, nëpër vapë!'"**

Ata në realitet, dëshironin ta dobësonin vullnetin e myslimanëve, të grumbullonin rreth vetes sa më shumë njerëz për të bërë ortak në krimin e tyre.

Por Kur'ani i drejtohet Profetit (*Paqja dhe bekimet e All'Ilahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) me një ton të ashpër dhe të

fortë: **“Thuaju: ‘Zjarri i Xhehennemit është edhe më i nxehtë!’
Veç sikur të kuptonin!”**

Pra, është për të ardhur keq që, nën efektin e besimit të dobët dhe mos konceptimin e mjaftueshëm nuk janë në dijeni se çfarë zjarr i dhimbshëm dhe përvëlues është në pritje të tyre, një zjarr shkëndijat e vogla të të cilit janë më përvëluese se zjarret e kësaj bote.

Në dy ajetet vijuese tregon se ata, duke hamendësuar që kishin korrur një fitore me mospjesëmarrjen në luftë, si dhe kishin arritur njëfarë qëllimi me ndjelljen e pesimizmit të një grupi luftëtarësh, i mbërthen e qeshura dhe ndihen shumë të gëzuar ashtu siç janë të gjithë hipokritët në të gjitha epokat dhe në të gjitha kohërat.

Por Kur’ani i paralajmëron në mënyrë të ashpër: **“Le të qeshin pak (në këtë botë) e të qajnë shumë (në Botën Tjetër)”**.

Të qajnë për të ardhmen e errët që kanë përpara.

Të qajnë për dënimet e dhimbshme që janë në pritje të tyre.

Të qajnë për hir të asaj që të gjitha urat e rikthimit i kanë shkatërruar njëra pas tjetrës.

Dhe më në fund, të qajnë për faktin se tërë kapitalin dhe potencialin e jetës së tyre e kanë humbur duke blerë për vete fatkeqësinë, mjerimin dhe ekzistencën e ulët.

Në fund të ajetit shton: **“...si dënim për atë që kanë bërë.”**

Nga ajo që u tha më lart, bëhet i qartë synimi. Ky grup duhet të qeshë pak dhe të qajë shumë në këtë botë, sepse ata i presin dënime të dhimbshme, në mënyrë që, nëse vetëdijesohen për ato, do të qajnë shumë dhe do të qeshin tepër pak.

Por, një grup nga komentuesit e Kur'anit kanë paraqitur një interpretim tjetër rreth kuptimit të kësaj shprehjeje: Sado që të qeshin në këtë botë, duke pasur parasysh jetën e shkurtër në të, në të Përtejmen do të qajnë aq shumë, saqë qarjet e kësaj bote do të duken të papërfillshme.¹

Por, komentimi i parë përshtatet më shumë me ndërtimin e jashtëm të ajetit dhe shprehjet e ngjashme, të cilat përdoren në gjuhën e përditshme dhe letrare. Duhet të kihet parasysh fakti se interpretimi i dytë kërkon që mënyra urdhërore e foljes të merret në kuptimin e pësore. Kjo bie ndesh me ndërtimin e fjalisë.

Edhe hadithi i njohur, të cilin e kanë transmetuar nga Profeti (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) shumë prej komentuesve të Kur'anit thuhet: *"Nëse ju do ishit në dijeni për (dënimet e dhimbshme të Kiametit) ashtu siç unë jam në dijeni, do të qeshnit pak dhe do të qanit shumë."*², gjithashtu është miratim për kuptimin e parë.

Në ajetin e fundit të diskutimit tonë përmendet një prej metodave të tjera, të mirëllogaritura dhe të rrezikshme të hipokritëve. Në kohën që e kryejnë hapur një vepër të jashtëligjshme, për të shfajësuar veten, tregojnë përpjekje për kompensimin e saj. Me anë të këtyre veprimeve kontradiktore dhe luhatjes, e fshehin fytyrën e vërtetë të tyre.

Ajeti deklaron: **"Dhe, nëse të kthen All'llahu (pas betejës) te një grup i hipokritëve e ata kërkojnë leje nga ti që të shkojnë me ty në luftë, thuaju (o Muhammed): 'Kurrë nuk do të vini me**

¹ "Mexhmaul Bejjan", ajeti në fjalë.

² "Biharul Enuar", vëll. 55, f 107, vëll 56, f 199' Sherh "Nehxhul Belaga i Ibn e bil Hadid, vëll. 1, f. 94, "Mexhmueh Ueram", vëll. 1, f. 269.

mua në luftë dhe kurrë nuk do të luftoni me mua kundër armikut!”

Profeti (*Paqja dhe bekimet e All'lahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) duhet t'ua shuajë shpresën dhe t'ua bëjë të qartë. Askush nuk do ta mashtrohet me sjelljet e tyre dhe do ishte më mirë t'i çonin në një vend tjetër kurthet e tyre, sepse këtu askush nuk do të bjerë pre e kurtheve dhe e mashtrimeve të tyre.

Gjithashtu, është e nevojshme të përmendim edhe këtë fakt: Si fjalia “*taifetun minhun*” “*një grup nga ata*” tregon që ata, të gjithë, nuk ishin të gatshëm të ndërmerrnin këtë rrugë dhe të sugjeronin pjesëmarrje në luftë të tjera. Mbase kjo është për shkak se disa ishin aq të turpëruar dhe të komprometuar, saqë nuk ishin të gatshëm as të paraqiteshin te Profeti (*Paqja dhe bekimet e All'lahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) dhe të jepnin një propozim të tillë.

Më pas, arsyen e mospranimit të propozimit të tyre e shpreh në këtë mënyrë: **“Ju ishit të kënaqur kur nuk erdhët herën e parë, prandaj rrini me ata që ngelin pas.”**

Hulumtime

1- Pa dyshim që, nëse ky grup nga hipokritët, pas pjesëmarrjes në luftë do të ishin bërë pishman dhe do të pendoheshin dhe më pas për t'i larë gabimet e tyre të kaluara, do të kishin propozuar të merrnin pjesë në luftë të tjera, Zoti do të kishte pranuar propozimin e tyre dhe Profeti (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) nuk do të kishte vënë dorën e refuzimit mbi ta.

Si rrjedhojë, bëhet e qartë, që edhe ky propozim, gjithashtu, ishte një lloj djallëzie dhe veprim hipokrizie. Thënë ndryshe, ishte një taktikë për maskimin e fytyrës së shëmtuar të tyre, si dhe për vazhdimësinë e veprimeve të kaluara.

2- Fjala "*khalif*" është në kuptimin "*ai që ngel*" dhe është aludim për njerëzit që nuk merrnin pjesë në luftë me apo pa justifikim.

Disa të tjerë gjithashtu kanë thënë se fjala "*khalif*" është në kuptimin e "*kundërshtimit*" dhe është aludim që edhe ju bashkojuni grupit kundërshtar. Këtë fjalë e kanë interpretuar edhe në kuptimin e "*prishjes*" dhe të "*korruptionit*"; sepse në fjalor, fjala "*khaluf*" është në kuptimin e "*prishjes*", kurse "*khalif*" në kuptimin e njeriut "*të korruptuar*", "*të shthurur*".

Ekziston edhe kjo mundësi, që të gjitha kuptimet e lartpërmendura për këtë fjalë shënohen edhe në ajetin e lartpërmendur, sepse grupi i hipokritëve dhe miqtë e tyre kanë të gjitha këto cilësi të shëmtuara.

3- Sërish është e nevojshme të tërheqim vëmendjen rreth kësaj çështjeje, që myslimanët e kohës sonë, gjithashtu, karshi

hipokritëve të mjedisit të tyre, të cilët përdorin metoda të ngjashme me hipokritët e kohës së kaluar, duhet të pasojnë po atë sjellje të fortë të Profetit (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*). Pasi bien një herë në kurthin e tyre, e njëjta gjë të mos përsëritet herë tjetër, si dhe të mos mashtrohen pas lotëve prej krokodili dhe qesharake të tyre, sepse “Myslimani asnjëherë nuk bie dy herë në të njëjtin kurth.”¹

¹ Libri “Usulul Kafi”, vëll. 2, f. 241, Hadithi 38, botoi “Darul kutubul islamije”; “Uesailu Shia”, vëll. 15, f. 193, Hadithi 20255, Botim i shtëpisë botuese Ehli Bejt; “Biharul Enuar”, vëll. 12, f. 277, Hadithi 49 dhe vëll. 19, f. 345-346.

Ajetet 84 - 85

وَلَا تُصَلِّ عَلَىٰ أَحَدٍ مِّنْهُمْ مَاتَ أَبَدًا وَلَا تَقُمْ عَلَىٰ قَبْرِهِ ۗ إِنَّهُمْ
 كَفَرُوا بِاللَّهِ وَرَسُولِهِ ۗ وَمَاتُوا وَهُمْ فَاسِقُونَ ﴿٨٤﴾ وَلَا تُعْجِبْكَ
 أَمْوَالُهُمْ وَأَوْلَادُهُمْ إِنَّمَا يُرِيدُ اللَّهُ أَنْ يُعَذِّبَهُمْ بِهَا فِي الدُّنْيَا
 وَتَزْهَقَ أَنفُسُهُمْ وَهُمْ كَافِرُونَ ﴿٨٥﴾

“Askujt prej hipokritëve, kur të vdesin, mos ia fal xhenazen, as mos rri afër varrit të hipokritit, sepse ata e kanë mohuar All’llahun dhe të Dërguarin e Tij dhe qëndruan të pabindur deri në vdekje.”

“Mos u josh (o Muhammed) nga pasuria dhe fëmijët e tyre, sepse nëpërmjet tyre All’llahu kërkon t’i ndëshkojë ata në këtë jetë, në mënyrë që t’u dalë shpirti duke qenë jobesimtarë.”

Komentimi

Qëndrim më të fortë kundrejt hipokritëve

Hipokritët, pas refuzimit hapur të pjesëmarrjes në luftë, u ekspozuan plotësisht dhe veprimi i tyre u zbulua. Zoti i

Madhëruar e urdhëron Profetin (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) që të mbajë ndaj tyre një qëndrim më të ashpër dhe më të fortë, në mënyrë që të hiqet përgjithnjë nga mendja e të tjerëve mendimi për hipokrizi. Hipokritët, po ashtu, të jenë në dijeni se në shoqërinë islame nuk do të ketë asnjë vend për ta.

Andaj thotë: **“Askujt prej hipokritëve, kur të vdesin, mos ia fal xhenazen, as mos rri afër varrit të hipokritit.”**

Ky është një lloj luftimi negativ dhe tepër ndikues kundrejt hipokritëve, sepse për shkak të arsyeve të ndryshme, që i përmendëm më lart, Profeti (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) nuk ishte në gjendje të urdhëronte zyrtarisht vrasjen e tyre, duke spastruar kështu shoqërinë islame. Luftimet negative do të kishin ndikim të mjaftueshëm për denigrimin e tyre, izolimin dhe dëbimin nga shoqëria islame. E dimë se një besimtar i vërtetë, është i respektuar, si në këtë botë, ashtu edhe në Botën Tjetër. Kjo është arsyeja se pse në programet islame është urdhëruar për guslin, qefinin, namazin mbi trupin e tij, si dhe varrosjen, në mënyrë që të varroset me sa më shumë respekt, me ceremoni të veçantë. Madje edhe pas varrosjes të grumbullohen rreth varrit të tij dhe të kërkojnë nga Zoti falje për gabimet dhe mëkatet e mundshme të tij.

Moskryerja e këtij programi ndaj një njeriu është në kuptimin e përjashtimit të tij nga shoqëria islame. Nëse ky përjashtim bëhet nga vetë Profeti (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), kjo do të jetë një goditje e rëndë ndaj personalitetit të individit të përjashtuar.

Ky ishte një program i mirëllogaritur kundrejt hipokritëve të asaj kohe, që edhe sot në ditë tona, gjithashtu, myslimanët duhet të përdorin metoda të ngjashme me to.

Përderisa njerëzit shfaqen si dashamirës të Islamit dhe në paraqitje sillen si myslimanë, duhet të sillemi si myslimanë me ta, edhe pse në brendësi janë krejtësisht të kundërt. Por nëse i heqin perdet dhe shfaqin hipokrizinë e tyre, duhet të sillemi me ta si me të huajt, jomyslimanët.

Në fund të ajetit sërish e bën të qartë arsyen e këtij urdhri: **“sepse ata e kanë mohuar All’llahun dhe të Dërguarin e Tij.”**

Ata vdiqën duke qenë të devijuar dhe të pabindur ndaj urdhrit të Zotit. Veprat e tyre nuk u peshuan dhe as u pastruan njollat e mëkateve të tyre me ujin e pendimit: **“dhe qëndruan të pabindur deri në vdekje.”**

Ka mundësi që në këtë pikë, për myslimanët të ketë lindur ose të parashtrohet pyetja: Nëse me të vërtetë hipokritët janë kaq larg mëshirës së Zotit dhe myslimanët nuk duhet të shfaqin ndaj tyre dashuri, atëherë përse Zoti i Madhëruar është treguar aq shumë i dashur me ta dhe u ka dhuruar atyre kaq shumë pasuri dhe fëmijë (forcë ekonomike dhe njerëzore)? Zoti, në ajetin vijues, i drejtohet Profetit (*Paqja dhe bekimet e All’llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) dhe i përgjigjet kësaj pyetjeje: **“Mos u josh (o Muhammed) nga pasuria dhe fëmijët e tyre.”**

Sepse, përkundrejt asaj që njerëzit sipërfaqësorë e mendojnë, këto pasuri dhe fëmijë jo vetëm që nuk janë faktor i lumturisë së tyre, **“sepse nëpërmjet tyre All’llahu kërkon t’i ndëshkojë ata në këtë jetë, në mënyrë që t’u dalë shpirti duke qenë jobsimtarë.”**

Ky ajet, ngjashëm me ajetin 55 të po kësaj sureje, pohon këtë realitet: Mundësitë ekonomike dhe burimet njerëzore në duart e njerëzve jo të drejtë jo vetëm që nuk prodhojnë lumturi, por zakonisht shkaktojnë dhimbje, mjerim dhe probleme, sepse persona të tillë as që e shpenzojnë siç duhet pasurinë e tyre, në mënyrë që të përfitojnë rezultat të dobishëm dhe as që kanë fëmijë të edukuar, besimtarë dhe në rrugën e duhur, të cilët do të bëhen shkak i gëzimit e i lumturisë së jetës së tyre.

Realiteti është krejt ndryshe. Ata, pasurinë e tyre e shpenzojnë në rrugën e epsheve, të rebelimit, të prodhimit të korrupsionit, si dhe për përforcimin e themeleve të shtypjes, të dhunës. E gjithë kjo bëhet shkak i harresës ndaj Zotit dhe mospërfilljes së tyre ndaj çështjeve thelbësore të jetesës. Edhe fëmijët e tyre janë në shërbim të dhunuesve dhe të të korruptuarve, si dhe përlyhen me lloj-lloj devijimesh etike. Në fund do të jenë shkaktarë të telasheve dhe të problemeve.

Por për ata persona, që burimet njerëzore dhe pasurinë e mendojnë si parimore dhe nuk i kushtojnë rëndësi mënyrës së shpenzimit, në pamje të parë, jeta e tyre duket e bukur, e këndshme. Por nëse i afrohemi më shumë brendësisë së jetës së tyre, si dhe i kushtojmë vëmendje edhe këtij realiteti, do të shohim se ata kurrë nuk do të jenë njerëz fatlumë.

Hulumtime

1- Në lidhje me shkakun e zbritjes së ajetit të parë janë transmetuar hadithe të shumta, që nuk janë pa kundërshtime. Disa nga këto transmetime përftohet se, në kohën kur vdiq Abdullah ibn Ubeji (hipokrit i njohur), Profeti (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) fali namaz për të, qëndroi pranë varrit të tij dhe u lut për të. Madje këmishën e vet e përdori si qefin për të. Më pas zbriti ajeti i lartpërmendur dhe e ndaloi Profetin nga përsëritja e një vepre të tillë.¹

Nga disa transmetime të tjera, përftohet se Profeti (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) kishte vendosur ta falte namazin mbi të. Ndërkohë zbriti Xhebraili dhe ia përcolli atij këtë ajet dhe e ndaloi Profetin (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) nga një veprim i tillë.²

Disa të tjerë shprehen se Profeti (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) as nuk fali namaz për të, as që kishte vendosur të kryente një vepër të tillë, por vetëm, këmishën e vet i dërgoi fisit të Abdullahut për t'i nxitur ata, në mënyrë që ta përdornin si qefin atë. Kur e pyetën Profetin (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) se përse e ndërmori një veprim të tillë, duke qenë se ai ishte një njeri pa besim, Profeti (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi*

¹ "Biharul Enuar", vëll. 21, f. 199, vëll.30, f. 572.

² "Biharul Enuar", vëll.21, f. 199; Tefsiri "Nuruth Thekalejn", vëll. 2, f. 251, Hadithi 262; Tefsiri "Tabari", vëll. 10, f. 141 ajeti në fjalë,

familjen e tij!) iu përgjigj: “Këmisha ime nuk do të jetë shkak i shpëtimit të tij nga dënimi hyjnor, por unë shpresoj që për hir të këtij gjesti të treguar, shumë njerëz do të përqafojnë fenë islame dhe do të bëhen myslimanë.” Ashtu ngjau dhe pas kësaj ngjarjeje shumë njerëz nga fisi Khazrexh e përqaftuan Islamin.¹

Duke pasur parasysh që këto hadithe ndryshojnë shumë nga njëri-tjetri, pra janë të papërfillshme, ne hoqëm dorë nga përmendja e tyre si shkak zbritjeje, pasi, në bazë të thënieve të disa komentuesve të mëdhenj, Abdullah ibn Ubej ka vdekur në vitin e nëntë Hixhri, ndërkohë që ajetet e lartpërmendura kanë zbritur në vitin e tetë.²

Por ajo që nuk mund të mohohet është fakti, se Profeti (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) para zbritjes së këtij ajeti falte namaz për hipokritët dhe qëndronte mbi varrin e tyre, sepse ata, në dukje, ishin myslimanë.³ Por pas zbritjeje së këtij ajeti, ky program u mbyll në mënyrë përfundimtare dhe përgjithmonë.

¹ Tefsiri “Kurtubi”, vëll. 8, f. 221; “Biharul Enuar”, vëll. 21, f. 199; Tefsiri “Nuruth Thekalejn”, vëll. 2, f. 251, Hadithi 266; Tefsiri “Alusij”, vëll. 10, f. 153, ajeti në fjalë.

² “El Mizan”, vëll. 9, f. 367.

³ Disa hadithe lënë të kuptohet se pas zbritjes së këtij ajeti Profeti (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) përsëri falte namaz për hipokritët, por nuk thoshte më shumë se katër Tekbire, që do të thotë se hiqte dorë nga këndimi i tekbitit të fundit, që është lutje ndaj xhenazes. (Tefsiri “Kurtubi”, vëll. 8, f.219”, ajeti në fjalë) Këto transmetime atëherë janë të pranueshme. Fjalja “*la tusali*”, në ajetin në diskutim, do të thotë “*mos u lut*”. Por nëse do të ishte në kuptimin “*mos fal namaz*”, këto transmetime bien ndesh me Kur’anin, janë të papranueshme dhe nuk mund ta mohojmë që fjala “*la tusali*”, në dukje, është në kuptimin e dytë. Prandaj ne nuk mundemi që, për nga pikëpamja e urdhrimit të Islamit ndaj njerëzve të tillë, të falim namaz dhe për shkak të hadithit të dyshimtë të heqim dorë nga zbritja e ajetit të lartpërmendur.

Nga ajeti i lartpërmendur, po ashtu, përftohet që është e lejueshme qëndrimi pranë varreve të besimtarëve dhe lutja për ta, sepse ndalimi të ajeti u përket vetëm hipokritëve. Si rrjedhojë, kuptimi i ajetit është: Vizita e varrezave të besimtarëve, pra, qëndrimi pranë varreve të tyre dhe lutja për ta është e lejueshme.

Por ajeti i lartpërmendur, nuk shprehet nëse është e lejuar të kërkohet ndërmjetësim nëpërmjet varreve të tyre dhe në sajë të bekimit së tyre të kërkohet nga Zoti ndonjë nevojë, edhe pse kjo çështje është e lejuar nga pikëpamja e haditheve islame.

Ajetet 86 - 89

وَإِذَا أَنْزَلَتْ سُورَةً أَنْ ءَامِنُوا بِِ اللَّهِ وَجَاهِدُوا مَعَ رَسُولِهِ
 أَسْتَعِذْنَاكَ أَوْلُوا الطَّوْلِ مِنْهُمْ وَقَالُوا ذَرْنَا نَكُنْ مَعَ الْقَاعِدِينَ
 ﴿٨٦﴾ رَضُوا بِأَنْ يَكُونُوا مَعَ الْخَوَالِفِ وَطُبِعَ عَلَى قُلُوبِهِمْ فَهُمْ
 لَا يَفْقَهُونَ ﴿٨٧﴾ لَكِنِ الرَّسُولُ وَالَّذِينَ ءَامَنُوا مَعَهُ وَجَاهِدُوا
 بِأَمْوَالِهِمْ وَأَنْفُسِهِمْ وَأَوْلِيَّكَ لَهُمُ الْخَيْرَاتُ وَأَوْلِيَّكَ هُمْ
 الْمُفْلِحُونَ ﴿٨٨﴾ أَعَدَّ اللَّهُ لَهُمْ جَنَّاتٍ تَجْرِي مِنْ تَحْتِهَا الْأَنْهَارُ
 خَالِدِينَ فِيهَا ذَلِكَ الْفَوْزُ الْعَظِيمُ ﴿٨٩﴾

“Dhe kur shpallet një sure që thotë: ‘Besoni All’llahun dhe luftoni së bashku me të Dërguarin e Tij!’ pasanikët e tyre (hipokritëve) kërkojnë leje, duke thënë: ‘Na lini të rrimë me ata që nuk shkojnë në luftë!’”

“Kënaqen të jenë me ata që nuk shkojnë në luftë, zemrat e tyre janë të vulosura e ata nuk kuptojnë!”

“Por, i Dërguari dhe ata që besojnë në të, luftojnë me pasurinë e tyre dhe jetën e tyre. Për ata do të ketë çdo të mirë dhe pikërisht ata do të jenë të shpëtuarit.”

“All’Ilahu u ka përgatitur atyre kopshtet e Xhennetit, nëpër të cilët rrjedhin lumenj dhe ku do të banojnë përgjithmonë. Kjo është fitorja madhështore.”

Komentimi

Njerëzit e ligë dhe besimtarët e drejtë

Në këto ajete sërish flitet për hipokritët. Këtu është bërë krahasimi i veprave të tyre të shëmtuara me veprat e mira të besimtarëve, në mënyrë që me anë të këtij krahasimi të bëhet i qartë devijimi dhe trishtimi i tyre. Në ajetin 86 thotë: **“Dhe kur shpallet një sure që thotë: ‘Besoni All’Ilahun dhe luftoni së bashku me të Dërguarin e Tij!’ pasanikët e tyre (hipokritëve) kërkojnë leje, duke thënë: ‘Na lini të rrimë me ata që nuk shkojnë në luftë!’”**

Fjala *“ta’ul”* është në kuptimin e mundësive dhe të fuqisë financiare. Si rrjedhojë, shprehja *“ulut ta’ul”* nënkupton personat që kanë mundësi të mjaftueshme materiale për të marrë pjesë në luftë. Megjithatë kishin dëshirë të qëndronin në radhët e njerëzve të pafuqishëm, që nuk kishin mundësi fizike dhe financiare të mjaftueshme për të marrë pjesë në luftë. Rrënja e kësaj fjale rrjedh nga fjala *“tuul”* (gjatësia) e kundërta e *“gjerësisë”*. Përputhshmëria e këtyre dy kuptimeve me njëra-tjetrën është plotësisht e qartë, sepse fuqia financiare dhe trupore nënkupton vazhdimësi dhe shtrirje të fuqisë.

Në ajetin vijues, Kur'ani, me anë të kësaj fjalie i qorton ata, duke u thënë: **“Kënaqen të jenë me ata që nuk shkojnë në luftë...”**

Ashtu siç e kemi cekur edhe më parë, fjala *“khaavalif”* është shumësi i fjalës *“khaalife”*, që rrjedh nga rrënja *“khulf”* dhe është në kuptimin prapa kokës. Për këtë arsye, gratë që mbeten në shtëpi pas daljes së burrave të tyre nga shtëpia i quajnë *“khalife”*. Në ajetin në fjalë, synimi i *“khevalif”* janë të gjithë njerëzit, që, në një farë mënyre, nuk kishin mundësi të merrnin pjesë në luftë, përfshirë gratë, pleqtë, të sëmurët apo fëmijët.¹

Më pas shton: **“zemrat e tyre janë të vulosura e ata nuk kuptojnë!”** Në lidhje me vulosjen e zemrave kemi diskutuar më gjerësisht në fillim të sures *“El Bekare.”*²

Në ajetin 88 flitet për një grup, që ndodhet në anën e kundërt të grupit të lartpërmendur, duke dhënë tiparet dhe mendësinë e tyre, si dhe përfundimin i tyre. Ajeti thotë: **“Por, i Dërguari dhe ata që besojnë në të, luftojnë me pasurinë e tyre dhe jetën e tyre.”**

Në fund arriten lloje të ndryshme mirësish: **“Për ata do të ketë çdo të mirë dhe pikërisht ata do të jenë të shpëtuarit.”**

Fjala *“al khajrat”* është *“trajta e shumësit”*, së bashku me *“elif lam”* (trajta e shumësit në formën e shquar) dhe nënkupton gjithëpërfshirje. Është një shprehje universale, e cila përmbledh në

¹ *“Mustedreku Uesail”*, vëll. 11, f. 17, Hadithi 12038-34, botim i shtëpisë botuese *“Ehli Bejt”*); *“Biharul Enuar”*, vëll. 21, f. 200, 214 dhe 236.

² *Xhuzi.1*, fundi i ajetit 7.

vete çdo lloj suksezi, fitoreje, mirësie dhe begatie, përfshirë mirësitë materiale dhe ato shpirtërore.

Shprehjet e këtyre dy fjalive, në bazë të rregullave të trajtuara në shkencën e “metrikës”, tregojnë veçimin, që do të thotë, shprehjet e lartpërmendura tregojnë se të shpëtuarit do të jenë vetëm ky grup dhe, po ashtu, ata që e meritojnë çdo lloj të mire dhe lumturie është vetëm ky grup: ata që luftojnë me gjithë ekzistencën dhe mundësitë e tyre.

Nga ky ajet përftohet më së miri se, nëse “besimi” shoqërohet me “luftën”, atëherë këta të dy do të sjellin me veten çdo lloj mirësie dhe bereqeti dhe vetëm në sajë të tyre arrihet shpëtimi dhe suksezi, si dhe përfitime prej të mirave dhe dobive materiale dhe shpirtërore.

Gjithashtu i duhet kushtuar vëmendje edhe kësaj çështjeje, që nga krahasimi i tipareve të këtyre dy grupeve bëhet qartë se hipokritët, për shkak të mungesës së besimit dhe përlyerjes së jashtëzakonshme me mëkate, janë njerëz të paditur dhe të papërgjegjshëm. Pikërisht për këtë arsye janë të privuar nga “ambicia pozitive”, e cila është fryt i perceptimit, të medituarit dhe ndërgjegjësimit. Ata janë të gatshëm të qëndrojnë me të sëmuret dhe fëmijët. Por, me gjithë këto krenari, refuzojnë pjesëmarrjen në luftë.

Por në anën e kundërt, njerëzit besimtarë janë aq mendjendritur, të vetëdijshëm, të ditur dhe me ambicie të lartë, që rrugën e vetme të ngadhënjimit ndaj problemeve e kanë gjetur te lufta dhe atë me të gjitha mundësitë e tyre. Ky është po ai mësim i madh që Kur’ani na e ka dhënë në shumë ajete dhe ne sërish jemi mospërfillës ndaj tij. Në ajetin e fundit, Zoti ka përmendur një pjesë nga shpërblimet e jetës pas vdekjes për këtë grup: **“All’lahu u ka përgatitur atyre kopshtet e Xhennetit, nëpër të cilët**

rrjedhin lumenj dhe ku do të banojnë përgjithmonë. Kjo është fitorja madhështore.”

Përdorimi i shprehjes *“eadd All’llahu lehum”, “All’llahu u ka përgatitur atyre kopshte”* është shenjë e rëndësisë së çështjes, si dhe është një respekt, që Zoti ka treguar ndaj këtij grupi, në mënyrë që paraprakisht i ka përgatitur këto begati për ta.

Ajeti 90

وَجَاءَ الْمُعَذِّرُونَ مِنَ الْأَعْرَابِ لِيُؤْذَنَ لَهُمْ وَقَعَدَ الَّذِينَ كَذَبُوا
 اللَّهَ وَرَسُولَهُ سَيُصِيبُ الَّذِينَ كَفَرُوا مِنْهُمْ عَذَابٌ أَلِيمٌ ﴿٩٠﴾

“Disa beduinë erdhën me shfajësime, duke të të kërkuar leje, që të mos shkonin në luftë. Dhe munguan ata që e gënjen All’llahun dhe të Dërguarin e Tij. Ata prej atyre që mohuan, me të vërtetë, do t’i godasë një dënim i dhembshëm.”

Komentimi

Shfajësuesit e vërtetë

Në këtë ajet, në përputhje me diskutimet e kaluara, flitet për hipokritët justifikues dhe shfajësues, duke aluduar dy grupet e shmangura prej luftës. Në fillim përmend grupin që me të vërtetë kishin justifikim. Grupi tjetër, pa asnjë alibi, por në shenjë rebelimi dhe kryeneçësie, hoqi dorë nga kryerja e këtij obligimi të madh.

Në fillim thotë: “Disa beduinë erdhën me shfajësime, duke të të kërkuar leje, që të mos shkonin në luftë.”

Dhe kundrejt tyre: “Dhe munguan ata që e gënjen All’llahun dhe të Dërguarin e Tij.”

Në fund të ajetit e kërcënon ashpër grupin e dytë: **“Ata prej atyre që mohuan, me të vërtetë, do t’i godasë një dënim i dhembshëm.”**

Nga njëra anë vërejmë se këto dy grupe janë vënë kundrejt njëri-tjetrit. Fjala “*minhum*” tregon se këto dy grupe nuk ishin jo besimtarë. Nga tërësia e këtyre dy grupeve përftohet se “*shfajësuesit*” ishin me të vërtetë njerëz të shfajësuar.

Por kundrejt këtij interpretimi, ka dhe dy komentime të tjera: Së pari, synimi i fjalës “*muadhahirun*”, “*shfajësuesit*” ishin ata persona që thurnin justifikime dhe shfajësime të rreme për t’u arratisur nga lufta. Grupi i dytë nuk mendohej të thurte justifikime të rreme, por rebeloheshin ndaj urdhrit të Zotit për të marrë pjesë në luftë.

Së dyti, fjala “*muadhahirun*” i përfshin të gjitha grupet, që me shfaqjen e justifikimeve, qofshin të rreme apo të vërteta, i shmangeshin pjesëmarrjes në luftë. Por dëshmitë tregojnë se me “*muadhahirun*” synohen po ata të shfajësuar të vërtetë.

Ajetet 91 - 93

لَيْسَ عَلَى الضُّعَفَاءِ وَلَا عَلَى الْمَرْضَى وَلَا عَلَى الَّذِينَ لَا يَجِدُونَ مَا
يُنْفِقُونَ حَرَجٌ إِذَا نَصَحُوا لِلَّهِ وَرَسُولِهِ ۚ مَا عَلَى الْمُحْسِنِينَ مِنْ
سَبِيلٍ ۚ وَاللَّهُ غَفُورٌ رَحِيمٌ ﴿٩١﴾ وَلَا عَلَى الَّذِينَ إِذَا مَا أَتَوْكَ لِتَحْمِلَهُمْ
قُلْتَ لَا أَجِدُ مَا أَحْمِلُكُمْ عَلَيْهِ تَوَلَّوْا وَأَعْيُنُهُمْ تَفِيضُ مِنَ الدَّمْعِ
حَزَنًا أَلَّا يَجِدُوا مَا يُنْفِقُونَ ﴿٩٢﴾ ۝ إِنَّمَا السَّبِيلُ عَلَى الَّذِينَ
يَسْتَعِذُونَكَ وَهُمْ أَغْنِيَاءُ رَضُوا بِأَنْ يَكُونُوا مَعَ الْخَوَالِفِ وَطَبَعَ
اللَّهُ عَلَى قُلُوبِهِمْ فَهُمْ لَا يَعْلَمُونَ ﴿٩٣﴾

“Nuk është gjynah të mos shkojnë në luftë të dobët, as të sëmurët, as ata që nuk mund të sigurojnë shpenzimet, nëse janë të sinqertë me All’llahun dhe të Dërguarin e Tij. Nuk ka vend për vërejtje ndaj punëmirëve. All’llahu është Falës dhe Mëshirëplotë.”

“(Nuk ka gjynah) as për ata të cilët, kur vijnë te ti për të kërkuar kafshë shalimi e ti u thua: ‘Unë nuk mund t’ju siguroj kafshë shalimi’, kthehen me sytë e tyre që u rrjedhin lot, ngaqë nuk mundën të gjenin gjë për të dhënë (në rrugë të All’llahut).”

“Por ka vend për t’u qortuar ata, që kërkojnë leje nga ti, duke qenë të pasur. Ata kënaqen të rrinë me ata që nuk shkojnë në luftë. All’llahu ua ka vulosur atyre zemrat, por ata nuk dinë.”

Shkaku i zbritjes

Për ajetin 91 është transmetuar se një nga shokët e sinqertë të Profetit (*Paqja dhe bekimet e All’llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) tha: “O i Dërguari i Zotit! Vallë a jam i shfajësuar nga mospjesëmarrja në luftë, duke qenë se jam një plak i verbër dhe i pafuqishëm, në mënyrë që, edhe nëse ndokush më kap për dore, sërish nuk jam në gjendje të marr pjesë në luftë?”

Profeti (*Paqja dhe bekimet e All’llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) heshti. Më pas zbriti ajeti i parë dhe njerëzve të tillë u dha leje.¹

Nga shkaku i zbritjes së këtij ajeti përftohet se madje edhe të verbrit nuk ia lejonin vetes mospjesëmarrjen në luftë pa dijeninë e Profetit (*Paqja dhe bekimet e All’llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*). Mbase prania e tyre në luftë, në një gjendje të tillë, do të ishte e dobishme për nxitjen e luftëtarëve, ose, së paku, do të shërbente në shtimin e numrit të ushtrisë. Ata kërkonin nga Profeti (*Paqja dhe bekimet e All’llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) mendim se si të vepronin.

¹ “Mexhmaul Bejjan”, ajeti në fjalë; “Biharul Enuar”, vëll. 21, f. 200.

Për ajetin 92 gjithashtu në transmetime lexojmë se shtatë veta nga shokët e ngushtë të Profetit shkuan pranë tij dhe kërkuan nga ai që, në dispozicion të tyre, të vinte një mjet për pjesëmarrjen në luftë. Por meqenëse Profeti nuk kishte ndonjë mjet që ta vinte në dispozicion të tyre, e refuzoi kërkesën e tyre. Ata u larguan me sy të përlotur prej tij. Më pas u njohën si *“bekkaun”*.¹

Komentimi

Të shfajësuarit që derdhnin lot nga dashuria për Zotin

Në këto ajete, për të qartësuar gjendjen e të gjitha grupeve, për nga pikëpamja e të qenit apo të mos qenit të shfajësuar për pjesëmarrjen në luftë, janë bërë kategorizime dhe janë përmendur pesë grupe njerëzish. Katër grupe prej tyre janë të shfajësuar, kurse një grup është hipokrit dhe nuk është shfajësuar.

Në ajetin 91 thotë: **“Nuk është gjynah të mos shkojnë në luftë të dobëtit, as të sëmurët, as ata që nuk mund të sigurojnë shpenzimet.”**

Këta tre grupe njerëzish, janë të falshëm te çdo ligj, madje falja e tyre bie në ujdi edhe me arsyen dhe logjikën njerëzore. Është e qartë se ligjet islame, në asnjë rast, nuk janë të shtjelluara nga mendja dhe logjika.

Fjala *“harexh”*, në thelb, është në kuptimin e qendrës së grumbullimit të një gjëje dhe, duke pasur parasysh që

¹ “Mexhmaul Bejjan”, ajeti në fjalë; “Biharul Enuar”, vëll.21, f. 218.

grumbullimi e numri i madh i popullsisë është i shoqëruar me ngushtimin dhe mbushjen e hapësirës së lirë, kjo fjalë është përdorur në kuptimin e “ngushtimit dhe shtrëngimit”, “shqetësimit” dhe “përgjegjësisë e obligimit”, kurse në ajetin në fjalë është përdorur në kuptimin e fundit, pra, në kuptimin e “përgjegjësisë dhe detyrës”.

Më pas, përmend një kusht të rëndësishëm për lejimin e faljes së tyre: **“nëse janë të sinqertë me All’Ilahun dhe të Dërguarin e Tij.”**

Edhe pse nuk janë në gjendje të marrin armën në dorë dhe të dalin në sheshin e luftës, ata e kanë mundësinë dhe forcën që, me anë të fjalimeve dhe sjelljeve të tyre, t’i nxisin luftëtarët e tjerë, t’u japin zemër dhe kurajë, si dhe të forcojnë frymën e tyre me anë të kujtimit të fryteve të luftës. Në anën tjetër, të mos kursehen në përpjekjet për dobësimin e frymës së armikut dhe sigurimin e parakushteve të humbjes së tyre.

Fjala “nas’h” është në kuptimin e sinqeritetit, është një fjalë universale, që përfshin çdo lloj dashamirësie dhe përpjekje të sinqertë. Meqenëse bëhet fjalë për luftë, u dedikohet orvatjeve dhe përpjekjeve që ndërmerren në këtë fushë.

Më pas, për të shprehur arsyen e kësaj çështjeje ajeti shton: **“Nuk ka vend për vërejtje ndaj punëmirëve.”**

Në fund të ajetit Zoti e përshkruan Vetën e Tij me dy cilësi, si një argument tjetër për faljen e këtyre tre grupe njerëzish: **“All’Ilahu është Falës dhe Mëshirëplotë.”**

Fjala “gafur” rrjedh nga rrënja “gufran” dhe është në kuptimin e fshehjes dhe të mbulimit, që do të thotë se Zoti i

Madhëruar, në bazë të këtyre cilësive, hedh një perde mbi punët e njerëzve të shfajësuar dhe të dobët dhe pranon justifikimin e tyre.

Kurse të qenët “Rrahim” - “Mëshirëplotë” të Zotit kërkon që të mos obligojë asnjë njeri me angazhim e detyrë tejet të vështirë dhe ta falë atë. Nëse këto grupe njerëzish do të ishin të detyruar të merrnin pjesë në luftë, kjo nuk do të ishte në përputhje me Mëshirën dhe faljen e Zotit, që do të thotë se Zoti është Falës dhe Mëshirëplotë dhe me patjetër që do t'i falë ata.

Nga disa hadithe që komentuesit e Kur'anit i kanë transmetuar rreth këtij ajeti përftohet se grupet e shfajësuar jo vetëm që janë të falur nga përgjegjësia dhe u janë shmangur dënimeve, por në bazë të dëshirës së tyre për pjesëmarrje në luftë bëjnë pjesë në shpërblimet dhe krenaritë e luftëtarëve të luftës.

Këtë e lexojmë edhe në një hadith të transmetuar nga Profeti (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), në kohën që Profeti po kthehej nga Lufta e Tebukut, duke arritur në Medine tha: “Ju në këtë qytet keni lënë prapa burra të mëdhenj, të cilët gjatë gjithë rrugës ishin bashkudhëtarë me ju! Kanë qenë bashkudhëtarë me ju në çdo hap që keni bërë, në çdo kontribut që keni dhënë dhe në secilën tokë që keni shkelur në të!”

E pyetën: “O i Dërguar i Zotit! Si kanë qenë bashkudhëtarë me ne, ndërkohë që kanë qëndruar në Medine?”

Profeti (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) u përgjigj: “Ata, për shkak të pamundësisë, nuk arritën të merrnin pjesë në luftë, por zemrat e tyre ishin me ju.”¹

¹ “Durrul Menthur”, në bazë të transmetimit të “El Mizanit”, vëll. 9, f. 368; “Biharul Enuar”, vëll. 21, f. 248 dhe vëll. 33, f. 542-543.

Kurse në ajetin vijues përmend grupin e katërt, që edhe ata janë të shfajësuar nga pjesëmarrja në luftë: “(Nuk ka gjynah) **as për ata të cilët, kur vijnë te ti për të kërkuar kafshë shalimi e ti u thua: ‘Unë nuk mund t’ju siguroj kafshë shalimi’, kthehen me sytë e tyre që u rrjedhin lot, ngaqë nuk mundën të gjenin gjë për të dhënë** (në rrugë të All’llahut).”

Fjala “*tefidh’u*” rrjedh nga fjala “*fejedhan*” dhe është në kuptimin e rrjedhjes si pasojë e mbushjes. Në kohën që njeriu ndihet i shqetësuar, nëse nuk është shumë i shqetësuar, i mbushen sytë me lot, por lotët nuk zbresin poshtë në faqe. Nëse shqetësimi bëhet tepër, atëherë i rrjedhin dhe lotët.

Kjo tregon se ky grup nga shokët e Profetit (*Paqja dhe bekimet e All’llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ishin aq shumë të dhënë dhe të pasionuar pas luftës së shenjtë, saqë jo vetëm që nuk u gëzuan nga shfajësimi nga ana e Zotit, por, nën pikëllimin e privimit nga lufta, qanin me aq dënësë, sikurse iu ka vdekur e përzgjedhura e zemrës së tyre.

Sigurisht që grupi i katërt nuk është i ndarë nga grupi i tretë që u përmend. Por për shkak të epërsisë së veçantë që ka ndaj tyre dhe gjithashtu për të treguar mirënjohje ndaj këtij grupi, Zoti në një ajet të ndarë ka përshkruar situatën e tyre. Tiparet dalluese të tyre janë:

Së pari, nuk u mjaftuan vetëm me mungesën e mjeteve të nevojshme për pjesëmarrje në luftë, por erdhën pranë Profetit (*Paqja dhe bekimet e All’llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) dhe me këmbëngulje kërkuan nga ai kafshë shalimi.

Së dyti, në kohën që Profeti (*Paqja dhe bekimet e All’llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) iu përgjigj negativisht atyre, jo

vetëm që nuk u gëzuan nga shfajësimi, por u tronditën jashtëzakonisht, u pikëlluan dhe u mërzhiten shumë. Për shkak të këtyre dy arsyeve, Zoti i Madhëruar i prezantoi ata në mënyrë të veçantë.

Në ajetin e fundit përshkruan gjendjen e grupit të pestë, ata që nuk u shfajësuan dhe nuk do të falen asnjëherë nga ana e Zotit: **“Por ka vend për t’u qortuar ata, që kërkojnë leje nga ti, duke qenë të pasur.”**

Më pas shton: **“Ata kënaqen të rrinë me ata që nuk shkojnë në luftë.”**

Mjafton ky ndëshkim ndaj tyre që për shkak të veprave të tyre të shëmtuara Zoti i ka privuar nga aftësia e reflektimit dhe e perceptimit: **“All’Ilahu ua ka vulosur atyre zemrat, por ata nuk dinë.”**

Hulumtime

1- Ushtarët e pasionuar pas luftës

Në këto ajete kristalizohet më së miri fryma e fortë dhe e ngritur e ushtarëve të Islamit, se si zemrën e tyre e mbante ngrohtë dashuria për luftë dhe rënia dëshmor. Këtë krenari e vendosnin para çdo lloj krenarie tjetër.

Prej këtej bëhet e qartë edhe një prej faktorëve të rëndësishëm të përparimit të shpejtë të Islamit në atë kohë dhe të prapambetjes në kohën që po jetojmë.

Si mund të pretendojmë ne që të jenë të ngjashëm njerëzit, që gjatë shfajësimit për të mos marrë pjesë në luftë derdhin lot si

retë në pranverë me ata, që me njëqind e njëmijë justifikime, dëshirojnë të dalin nga radhët e luftëtarëve?! Nëse fryma e besimit dhe e pasionit për luftë, si dhe krenaria me martirizimin vitalizohet edhe sot midis nesh, myslimanëve, fitorja do të jetë ashtu siç ka qenë në fillim të përhapjes së Islamit.

Fatkeqësia është këtu, që ne, Islamin, e kemi vënë për veten tonë si një mbulesë sipërfaqësore, pa depërtuar në thellësinë e shpirtit tonë dhe përsëri pretendojmë që të zëmë vendin e myslimanëve të parë.

2- Fazat e xhihadit

Nga ajetet e kaluara, gjithashtu, përftohet edhe kjo çështje, që asnjë njeri në përgjithësi nuk është i shfajësuar nga bashkëpunimi me luftëtarët në rrugën e Zotit, madje edhe të sëmuret dhe të verbrit dhe natyrisht nuk janë në gjendje të armatosen dhe të dalin për të luftuar, por me anë të gjuhës dhe sjelljes së tyre mund të jenë inkurajues të luftëtarëve dhe mbështetës të programeve të tyre. Edhe ata, po ashtu, nuk duhet të harrojnë këtë mision të tyre dhe të mos heqin dorë nga programet e veta.

Në realitet, lufta ka aspekte të ndryshme dhe shfajësimi nga njëri aspekt nuk është në kuptimin e shfajësimit ndaj aspekteve të tjera.

3- Rregulla “Nuk ka vend për vërejtje ndaj punëmirëve”

Fjalja “Nuk ka vend për vërejtje ndaj punë mirëve” në çështjet e fik’hut është burim i një postulati të përgjithshëm dhe prej tij janë nxjerrë shumë ligje, si p.sh. sa herë që nga dora e një njeriu të besuar humbet një amanet, pa dhunuar kushtet e ruajtjes

së zakonshme, një person i tillë nuk mban përgjegjësi. Një prej argumenteve në favor të tij është ajeti i lartpërmendur, sepse ai është punëmirë dhe nuk është i përlyer me ndonjë vepër të keqe. S'ka dyshim që ajeti i lartpërmendur flet për luftëtarët. Por jemi në dijeni që rasti konkret i një ajeti nuk redukton rregullin e përgjithshëm, thënë ndryshe, rasti konkret asnjëherë nuk është veçues.

Fundi i xhuzit të dhjetë.

PËRMAJTJA E LIBRIT

TEMA

Ajeti 41	5
Komentimi.....	5
Një e pesta (khums-i), obligim i rëndësishëm Islam.....	5
Hulumtete.....	7
1 - Dita e ndarjes mes të vërtetës dhe të kotës (Dita e Furkanit).....	7
2 - Nuk ka antagonizëm (kundërshti) mes dy ajeteve.....	8
3 - Kujt i referohet fraza “Dhil kurba” (të afërmit)?.....	8
4 - Kujt i referohet fraza e ajetit “...jetimëve, të varfërve dhe udhëtarit (që ka ngelur në rrugë)...”	10
5 - A janë të kufizuara plaçkat vetëm në plaçkën e luftës?.....	10
Thëniet e komentuesve.....	13
6 - Të mos konsiderohet gjysma e një të pestës që i jepet fisit Beni Hashim, si largues ndërmjet myslimanëve.....	17
7 - Çfarë nënkuptohet me frazën “Pjesa e All'Ilahut”?.....	21
Ajetet 42 - 44	22
Komentimi.....	23
Çështje e domosdoshme.....	23
Ajetet 45 - 47	29
Komentimi.....	30
Gjashtë çështje të tjera për luftën.....	30

Ajetet 48 - 51	34
Komentimi.....	35
Politeistët, hipokritët dhe ngacmimet e shejtanit.....	35
Ajetet 52 - 54	42
Komentimi.....	43
Vendimi dhe caktimi i All'llahut nuk pranon ndërhyrje dhe ndryshime.....	43
Hulumtime.....	45
Shkaqet e jetesës së popujve dhe të vdekjes së tyre.....	45
Nuk ka imponim në dënim e as në çështje të tjera.....	49
Ajetet 55 - 59	51
Komentimi.....	52
Përballje me atë që kundërshton ashpër marrëveshjen.....	52
Ajetet 60 - 64	56
Komentimi.....	57
Shtimi i mobilizimit ushtarak dhe qëllimi i tij.....	57
Dy hulumtime.....	58
Qëllimi i përgatitjes së armatimit dhe i shtimit të mjeteve ushtarake.....	62
Dy hulumtime.....	64
1- Cilët janë ata që nënkuptohen në ajet me frazën “ju nuk i njihni ata”?.....	64
2- Përgatitja në çdo vend dhe në çdo kohë.....	65
Synimet e luftës në Islam dhe shtyllat e saj.....	66
Gadishmëria për paqe.....	67
Dy hulumtime.....	70
Ajetet 65 - 66	73
Komentimi.....	73
Hulumtime.....	76
1- A është abroguar ajeti i parë?.....	76
2- Legjenda e balancimit të forcave.....	77
3- Çfarë nënkuptohet prej dy ajeteve?.....	80

Ajetet 67 - 71	81
Komentimi.....	82
Robërit e luftës.....	82
Hulumtime.....	86
Ajetet 72 - 75	94
Komentimi.....	95
Katër grupime të ndryshme.....	95
Hulumtime.....	101
1- Migrimi dhe Xhihadi.....	101
2- Ekzagjerimi dhe për përpjekjet e shumta për pastrimin e Sahabëve.....	104
3 - Trashëgimia në rregullat e Islamit.....	107
4- Çfarë nënkuptohet me fjalët <i>trazirë</i> dhe <i>shkatërrim i madh</i> ?.....	108
Sure "Et-Teube"	111
Disa shënime:.....	112
Emrat e kësaj sureje.....	112
Kur ka zbritur kjo sure?.....	112
Përmbajtja e sures "Et Teube".....	113
Pse kjo sure nuk nis me fjalën "Bismil'lah"?.....	114
Mirësitë e leximit të kësaj sureje.....	115
Perceptimi i një të vërtete historike.....	117
Sqarim dhe shqyrtim.....	122
Ajetet 106 - 108	125
Komentimi.....	125
Marrëveshjet e politeistëve do të shfuqizohen.....	125
Hulumtime.....	125
1- A është i drejtë anulimi i njëanshëm i marrëveshjeve?.....	125
2- Kur filloi kjo periudhë katër mujore?.....	129
Ajetet 3 - 4	131
Komentimi.....	132
Marrëveshja e tyre është respektuar.....	132
Hulumtime.....	133

1- Cili është Haxh ekber?.....	133
2- Katër nenet që u shpallën atë ditë.....	135
3- Cilët persona kishin marrëveshje me afat të caktuar?.....	136
Ajetet 5 - 6	137
Komentimi.....	138
Veprim i ashpër i shoqëruar me butësi.....	138
1- Cili është kuptimi i shprehjes " <i>el esh'hurul hurumu</i> " - muajt e shenjtë?.....	142
2- A është namazi dhe zekati kusht i pranimit të Islamit?.....	142
3- Besimi është i lindur nga dija.....	142
Ajetet 7 - 10	143
Komentimi.....	144
Kufijshkelësit që thyejnë besëlidhjen.....	144
Ajetet 11 - 15	150
Komentimi.....	151
Pse keni frikë për të luftuar me armikun?.....	151
Hulumtime.....	155
1- Shkelësit e besëlidhjes.....	156
2- Luftimi me parinë politeiste.....	157
3- Vëllazëria fetare.....	158
4- Frika nga urdhri i xhihadit.....	159
5- Kush janë njerëzit që dëbuan Profetin (<i>Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!</i>)?.....	160
6- Ky ajet nuk është argument për fatalizmin.....	161
Ajeti 16	161
Komentimi.....	161
Ajetet 17 - 18	164
Komentimi.....	165
Ndërtimi i xhamisë nuk është detyrë e çdo njeriu.....	165
Hulumtime.....	167
1- Cili është kuptimi i fjalës " <i>imaretun</i> " ?.....	167

2- Vepra e singertë buron vetëm nga besimi.....	168
3- Mirëmbajtës guximtarë.....	169
4- Bëhet fjalë vetëm për Xhaminë e Shenjtë?.....	169
5- Rëndësia e ndërtimit të xhamive.....	169
Ajetet 19 - 22.....	171
Shkaku i zbritjes.....	172
Komentimi.....	174
Kriteri i mburrjes dhe i virtytit	174
Hulumtime.....	176
1- Shtrembërimi i historisë.....	176
Ajetet 23 - 24	183
Komentimi.....	184
Duhet sakrifikuar Gjithçka për Zotin.....	184
Hulumtime.....	187
1- Lidhja farefisnore.....	187
2- Caktimi i fitores së Profetit (<i>Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!</i>) është i patjetërsueshëm.....	188
3- E kaluara dhe e sotmja në varësi të këtij urdhri.....	188
Ajetet 25 - 27.....	190
Komentimi.....	191
Masat e gjera nuk sjellin ndonjë dobi.....	191
1-Beteja mësimdhënëse e Huneinit.....	194
2- Kush u largua nga lufta?.....	200
3- Besimi dhe qetësia.....	201
4- Numri i luftërave të Profetit (<i>Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!</i>).....	203
5- Mburra është e ndaluar.....	204
Ajeti 28.....	205
Komentimi.....	205
Idhujtarët nuk kanë të drejtë të futen në Xhaminë e Shenjtë.....	205
Ajeti 29	208
Komentimi.....	208

Përgjegjësia jonë karshi Njerëzve të Librit.....	208
Hulumtime	214
Ç'është xhizja?.....	214
Ajetet 30 - 33	118
Komentimi.....	119
Idhujtaria e Njerëzve të Librit.....	119
Hulumtime	226
1- Kush është Uzejri?.....	226
2- Mesihu nuk ishte i biri i Zotit.....	230
3- Huazimi i këtyre besëtytnive nga të tjerët.....	230
4- Synimi i togfjalëshit "katelehumullah"	231
5- Cili është kuptimi i "udhëzimit" dhe "fesë së Vërtetë"?.....	231
7- Kur'ani dhe kryengritja e Mehdiut (<i>Paqja qoftë mbi të!</i>).....	232
6- Triumfi i logjikës apo triumfi i forcës?.....	233
8-Transmetime islame për ardhjen e Mehdiut (<i>Paqja qoftë mbi të!</i>).....	236
9- Impaktet konstruktive të pritjes së shfaqjes së Mehdiut (<i>Paqja qoftë mbi të!</i>).....	242
Kuptimi i pritjes.....	246
Pritje, do të thotë gatishmëri e plotë.....	248
Filozofia e parë: vetëformimi individual.....	249
Filozofia e dytë: Përkrahjet shoqërore.....	251
Filozofia e tretë: Pritësit e Vërtetë nuk "shkrihen" në korrupsionin e mjedisit.....	252
Përfundimi.....	254
Ajetet 34 - 35	257
Komentimi.....	258
Grumbullimi (i pasurisë) është i ndaluar.....	258
Ndëshkimi i grumbulluesve të pasurisë.....	262
2- Ebu Dherri dhe kapitalizmi.....	269
Ajetet 36 - 37	275
Komentimi.....	276
Armëpushim i detyrueshëm.....	276

Hulumtime	280
1- Filozofia e muajve të ndaluar.....	280
2- Kuptimi dhe filozofia e “nesi’ut” në kohën e paganizmit.....	281
3- Uniteti i fjalës përballë armikut.....	283
4- Si u duken të bukura veprat e shëmtuara?.....	284
Ajetet 38 - 39	286
Shkaku i zbritjes.....	287
Komentimi.....	288
Sërish lëvizja në drejtim të sheshit të luftës.....	288
Hulumtime	291
1- Theksimet e njëpasnjëshme ndaj çështjes së luftës.....	291
2- Kushtet e luftëtarit të drejtë.....	291
Ajeti 40	293
Komentimi.....	294
Zoti i Madhëruar nuk e la vetëm as në çastet më të ndjeshme.....	294
Hulumtime	296
Tregimi i ndihmësit të shpellës.....	296
Ajetet 41 - 42	299
Komentimi.....	300
Konformistët lakmitar.....	300
Ajetet 43 - 45	304
Komentimi.....	305
Përpiqu të njohësh hipokritët	305
Ajetet 46 - 48	310
Komentimi.....	311
Mosekzistenca e tyre është më mirë se prania e tyre.....	311
Ajeti 49	316
Shkaku i zbritjes.....	316
Komentimi.....	316
Hipokritët sjellin justifikime.....	317
Hulumtime	318
1- Një mënyrë për njohjen e hipokritit.....	318
2- Çfarë do të thotë rrethimi nga Xhehennemi?.....	319
Ajetet 50 - 52	320

Komentimi.....	321
Ne jemi ngadhënjyes.....	321
Hulumtime	323
1- Planifikimet dhe orvatjet tona.....	323
2- Në fjalorin e besimtarëve nuk ekziston fjala disfatë.....	324
3- Cilësia e përhershme e hipokritëve.....	326
Ajetet 53 - 55	327
Komentimi.....	328
Bamirësia e njerëzve të korruptuar.....	328
Hulumtime	331
1- Dallimi midis ajetit të parë dhe të dytë.....	331
2- Nuk duhet të mashtroheni me adhurimin e individëve.....	332
Ajetet 56 - 57	333
Komentimi.....	333
Një shenjë tjetër e hipokritëve.....	333
Ajetet 58 - 59	336
Shkaku i zbritjes.....	336
Komentimi.....	337
Egoistët mendjehhtë.....	337
Ajeti 60	340
Komentimi.....	340
Harxhimet e zekatit dhe detajet e tij.....	340
Hulumtime.....	344
1- Dallimi mes “ <i>të varfrit</i> ” dhe “ <i>nevojtarit</i> ”	344
2- Vallë a duhet të ndahet në tetë pjesë të barabarta lëmosha e zekatit?.....	346
3- Kur është bërë e detyruar dhënia e zekatit?.....	347
4- Cilët persona synohen me shprehjen “ <i>muel’lefetun kulubehum</i> ” - “ <i>atyre që duhet përfiturat zemrat</i> ”?.....	348
5- Roli i zekatit në Islam.....	349
6- Dallimi i fjalëve dhe dallimi i rregullave.....	351
Ajeti 61	354
Shkaku i zbritjes.....	354

Komentimi.....	355
Ajeti 62 - 63	360
Shkaku i zbritjes.....	360
Komentimi.....	360
Fytyra prej të drejtit të hipokritëve.....	360
Ajetet 64 - 66	363
Shkaku i zbritjes.....	364
Komentimi.....	366
Plani tjetër i rrezikshëm i hipokritëve.....	366
Ajetet 67 - 70	370
Komentimi.....	371
Shenjat e hipokritëve	371
Përsëritja e historisë dhe marrja mësim nga e kaluara.....	375
Ajetet 71 - 72	378
Komentimi.....	379
Ajeti 73	385
Komentimi.....	385
Luftimi me mohuesit dhe hipokritët.....	385
Ajeti 74	387
Shkaku i zbritjes.....	388
Komentimi.....	390
Ajetet 75 - 78	394
Shkaku i zbritjes.....	395
Komentimi.....	397
Hipokritët janë njerëz pa kapacitet.....	397
Hulumtime.....	398
Ajetet 79 - 80	402
Shkaku i zbritjes.....	403
Komentimi.....	404
Sabotimi i hipokritëve.....	404
Hulumtime.....	405
1- E rëndësishme është cilësia e punës dhe jo sasia.....	405
2- Përpiqja për dëshpërimin e zemrave të besimtarëve.....	407
3- Kuptimi i talljes së Zotit me ta.....	409

4- Numri shtatëdhjetë.....	408
Ajetet 81 – 83	411
Komentimi.....	412
Sërish sabotimi i hipokritëve.....	412
Ajetet 84 – 85	418
Komentimi.....	418
Qëndrim më të fortë kundrejt hipokritëve.....	418
Ajetet 86 – 89	425
Komentimi.....	426
Njerëzit e ligë dhe besimtarët e drejtë	426
Ajeti 90	430
Komentimi.....	430
Shfajësuesit e vërtetë.....	430
Ajetet 91 – 93	432
Shkaku i zbritjes.....	433
Komentimi.....	434
Të shfajësuarit që derdhnin lot nga dashuria për Zotin.....	434
Hulumtime.....	438
1- Ushtarët e pasionuar pas luftës.....	438
2- Fazat e xihadit.....	439
3- Rregulla “Nuk ka vend për vërejtje ndaj punëmireve”	440

أالمثل فى تفسير كتاب الله المنزل

مؤلف: العلامة الفقيه المفسر ناصر مكارم الشيرازى

الجزء العاشر

الترجمة الى اللغة الألبانية: والبونا حروزووا

تيرانا: 2016

نام کتاب: الامثل فی تفسیر کتاب الله المنزل (جزء دهم)

نویسنده: فقیه مفسر حضرت آية الله العظمی ناصر مکارم شیرازی (دام ظلّه)

ترجمه به زبان آلبانی: والبونا حرزوووا

زیر نظر: وُلْنَتْ مِرْيَا

ویرایش: کلودیانا اسمایلی و یریدا کولا

مقابله: لدیو دمولی

تصحیح ادبی: ویولسا کارای

صفحه بندی و جلد: صبریه فرا

ناشر: جمعیت "نسیم"

چاپ: انتشارات "لیلو"

تیرانا: 2016